

Jusuf BUXHOVI

Libri i të mallkuarve

Roman triptik

(Botim i plotësuar)

....

Shënimi hyrës i Kronistit

...më thanë se Perandoria, krahas mijëra e mijëra librave të rëndësishëm, ruan edhe një të vetëm,që i frikësohen njësorj të mëdhenjtë e të vegjlit,të gjallët e të vdekurit...

...më thanë se ai libër është plot e përplot me ngjarje e persona që duhet t'i takojnë harresës së përhershme dhe shurdhe. Sepse vetëm qoftëlargu pati punë me ata shpirtra të shqetësuar mbase edhe pavetëdijshtëm,që u mallkuan aq rëndë sa të largohen përgjithmonë nga kujdesa perandorake...

...më thanë se duhet të ruhem,sepse Libri i mallkuar prore pikon helm dhe vret pamëshirshëm...

.....

Kulla e harresës

Në fillim të verës u hapën fjalë se një shpirt apo një i vdekur bridhte nëpër varre. Fjala gjithë shqetësim së pari u dëgjua në Kullë pastaj shkoi në Blinishtë, e më vonë u përhap gjithandej nga shtrihej Flamuri dhe Principata e dikurshme. Dhe, sa më larg që ato shkonin, u shtoheshin të tjera,kështu që në pjesën veriore të vendit,aty ku mbaronte Principata,që nuk ishte më dhe fillonte bota e përzier e gjuhëve të tjera, tregimi i përngjante një përralle të çuditshme, gjë që kur në Kullë pëshpëritej për një si hije, që shfaqej herë pas here dhe linte një lule gjashtëfletësh mbi varrin e Mrikës (së bijës së Martin Tanushit,vëllamit të Flamurtarit), në Blinishtë, hija bëhej njeri, që herë dukej e herë nuk dukej,ndërkohë që në qendrën e dikurshme të Principatës, ku tashmë gjendeshin garnizonet e ushtrisë së huaj dhe zyrat e para me mëkëmbësin perandorak në krye, flitej për një dragua të pashoq... Kjo krijesë e çuditshme, thuhej, po gatitej të hakmerrej kundër ushtrisë perandorake për masakrat që kishte bërë ajo në Liman, meqë thuhej se shpirtrat e mijëra e mijëra të të vrarëve në pabesi dhe të masakruar keqas nuk prehen të qetë...

“Ata po bëhen gati... Do të derdhet gjaku rrëke... Masakra e Limanit nuk harrohet... Limani do shpajim...”

Gojë më gojë, thashethemet ranë edhe në veshin e Flamurtarit. Plaku i verbër, moti i kredhur në një natë të pafundme dhe vetëm me përfytyrimet e gjata shqyente perden e rëndë të territ, në fillim nuk ua vuri veshin atyre që dëgjoji.

“Na kanë mbetur vetëm ëndrrat” i tha Djaloshit dhe vazhdoi t’u jepej mendimeve të pasosura rreth kështjellarëve që nuk ishin më dhe për betejat e gjata nëpër të cilat kishte kaluar mbi gjashtëdhjetë vjet rresht...

Mirëpo, nuk kaloi shumë dhe Djaloshi hetoi shqetësim tek mendimet e plakut.

“Bashkëluftëtarët po më rrallohen paksa. Edhe ata që vinë nuk janë më të dikurshmit... Sillën vërdallë dhe heshtin... Dike e shoh pa këmbë... Dike pa sy... Ndonjë tjetër me del para si gjysmë dhe çmos më keq... Në atë katandisje fistarët i harrojnë armët dhe se disa prej tyre kanë filluar me i harrue edhe emrat... Çfarë më duhet një ushtri e tillë memece?... Me të nuk mund të vdiset e lërë më të fitohet?...“

Shumë kohë Plaku i përsëriti si përçartë fjalë, që shpesh e më shpesh i ngatërroheshin... Djaloshit, që përherë i rrinte pranë, i vinte keq për ato përpëlitse, që po i ktheheshin në çapitje... Por, pas një heshtje që kishte zgjatë ditë të tëra, kur dukej se Plaku nuk do të fliste më, papritmas pyeti se në cilin varr shihet ajo lulja që nuk është lule...

„Në varrin e Mrikës...”

Plaku një copë herë u hamend. Dora e tij e ftohtë mbante krahun e Djaloshit dhe dridhej, sikur të dëshironte që një pjesë të shqetësimit ta bartte tek ai. Dikur foli e tha:

„Më në fund qenka kthyer...”

Të njëjtat fjalë Plaku i përsëriti disa herë sapo mbeti vetëm dhe iu kujtua mëngjesi i vjeshtës së vonë para njëzet e gjashtë vjetësh, kur i madh e i vogël në Kështjellë iu gëzuan rrebeshit të parë të shiut që e pritën aq gjatë. Atëbotë, retë e dendura u shfaqën si rëndom nga deti, por edhe përkundër që dukeshin të fryra me shi, silleshin e mbështilleshin mbi Kështjellë dhe, pasi daroviteshin, shkonin tutje-tëhu dhe zbrazeshin në bjeshkë. Ata e shihnin bjeshkën e qullur dhe gjithë dëshpërim shikonin nga deti dhe uronin që shirat të vinin sa më parë. Sepse, me të filluar ato, ushtria e huaj shkrehte tendat e shumta dhe ikte dika për t’u mbrojtur nga lagështia e papërmbajtshme që s’i bënte ballë. Rreth tyre mbeteshin vetëm pararojat që silleshin gjithë plogështi dhe topat e rëndë të drejtuar kah Kështjella. Të qullur, ata dukeshin si korba të zezë, që lenin për të kuptuar fare qartë se mbyllja do të vazhdonte për të marrë përmasat e fushatës sapo të ndreqej moti... E, kështjellarët e shkallmuar nga rrethimet e gjata përpiqeshin të merrnin veten, kush tek shëronte plagët, kush duke u marrë me ndonjë zeje të dobishme, e kush tek meremetonte të plasurat e shumta të mureve të Kështjellës, të shkaktuara nga gjylet e topave, nëpër vrimat e të cilave kullonte ujë...

Ditën që kështjellarët panë morinë e flamujve të huaj në të mbrapsur, dikush hapi lajmin se Kryekështjellarin e kishin zënë. U tha se në kohën e rrebeshit të parë të shiut, kur ai doli në pjesën lindore të muranës së madhe dhe po shikonte tërheqjen e ushtrisë së huaj, befasha në një kurth të litarëve që ishte ngritur gjatë natës. Kryekështjellari nuk pati kohë të bënte gjë. Kështu, gëzimi për shiun aq të pritur u bë i hidhur ngaqë dihej se ç’fat e priste atë. Andaj, me urdhrin e Princit, qysh atë pasdite me shi të imtë, në varret e Kështjellës u vu një kryq i ri, i cili gjatë gjithë stinës së shirave u stolis me degë të njoma të qiparisave. Por, erdhën kohë kur kryqit zunë t’i vyshkën degët e qiparisave dhe kjo ndodhi pikërisht kur qeli pranvera dhe sërish fusha përreth nxiu nga taborët e shumta të ushtrisë së huaj, kështjellarët zunë të dyshonin se mos vallë njeriu i tyre, nga torturat e jashtëzakonshme kishte thënë diçka nga ato që nuk bënte t’ia kallëzonte as natës së varrit?... Dyshimi u rrit kur së pari u prenë damarët e ujit, që vinte nga pjesa e bjeshkës (udhën e fshehtë që e dinte vetëm Princi dhe Kryekështjellari), e më vonë edhe kur u mbyll dalja kryesore nga ana e lumit, nëpër të cilën bëheshin furnizimet kryesore gjatë kohës së rrethimeve të gjata. Një ditë kur uji i sterrave ishte në të sosur, Princi foli gjithë dëshpërim rreth asaj se të huajt tashmë e kishin në dorë

fatin e tyre... Ngjau diçka e jashtëzakonshme, shfreu ai me shikimin e tretur kah liqen, i cili atëbotë dukej si i megjulluar nga vapa e gushtit...

Edhe pse nuk e zuri n'gojë emrin e Kryekështjellarit, që aq shumë e deshi, të gjithë e patën të qartë se Princit i qante zemra mos vallë i kishte shpëtuar ndonjë fjalë nga ato që nuk duhej t'i shpëtonte kurrë. Dyshoi apo nuk dyshoi ai, kahet e luftës kishin ndryshuar dhe kishte ndodhur që në vend të mbrojtësve të pathyeshëm, ata ishin kthyer në pengje që pritnin mëshirën e shiut...

Ç'është e vërteta, sado që qëndruan atë verë, të gjithë e kishin të qartë se në ato rrethana Kështjella nuk mund të mbrohej gjatë... Me ujin bëhej disi, pasi u hapën ca puse të përkohshme, por si të bëhej me furnizimet?... Udhë e sigurt ishte prerë dhe në vend të saj duheshin bërë sulme të befasishme jashtë Kështjellës për t'u hapur kalime të tërthorta karavaneve të ushqimit. Kështu, shumë nga kështjellarët ende pa kaluar mirë rrethimin, e edhe ata që hidheshin tutje, e kishin edhe më të vështirë që ushqimet t'i futnin në Kështjellë, ngaqë çdo thërrime lahej me gjak...

Flamurtarit i pat ndodhur që t'i udhëhiqte dy ekspeditat e fundit. Vetëm, me pak veta, para agimit i sulmoi njësitë vëzhguese të armikut që gjendeshin në krahun e djathtë të Kështjellës, mu aty ku fillonte kënetat e gjatë, e cila përfundonte në liqen. Ushtarët e huaj, të cilët nuk ishin mësuar që kështjellarët t'u vinin ashtu te goja, u zunë ngushtë. Nuk ua mori mendja se ky ishte një karrem për t'u hapur udhë karavaneve të ushqimeve, që vinin nga ana tjetër.

Herën tjetër cak të befasisë zgjodhi tendat ngjyrë kaltra, ku rrinin çallgaxhinjtë dhe gratë e haremit. Kishte vite që ato tenda i shikonte me zët. Edhe pse nuk i shihte mirë, sikur i bëhej se syri ia zinte sapo binte nata, kur ato merrnin gjallëri të paparë. Përreth tyre flakëronin drita të laryshme, liroheshin gjithfarë flakadanë dhe dëgjoheshin meloditë mbytëse të gërnetave, që ia rrëqethnin trupin. Gjithçka tjetër në atë mëri ushtrie i dukej e rëndomtë. Të rëndomta madje i dukeshin edhe masakrat e tyre të jashtëzakonshme (sidomos kur i zinin kështjellarët dhe i ngulitnin në hunj të gjatë dhe endeshin me ta duke kënduar gjithë çirrje). Ushtrisë, mendonte, i ka hije ashpërsia, gjaku, dhuna e gjithçka tjetër, pos lavireve dhe haremit. Ato e bëjnë luftën të ndryrë dhe të neveritshme, e edhe fitores, sado e madhe të jetë, ia ulin vlerën... Në fillim, mu atëherë kur nisi rrethimi i parë, që zgjati dymbëdhjetë vjet rresht, ëndërronte ditën kur do të futej midis atyre tendave të ndyra për t'i kallur me ato që mbanin brenda. Tjetër vdekje pos flakës nuk meritonin ato, mendonte. Vetëm zjarri mund ta pastrojë edhe tokën e ndotur, edhe ajrin, edhe ujin dhe çdo gjë tjetër nga kundërmimi i tyre i rëndë dhe i sëmurë... Mu pse gjithçka tjetër ëndërronte (taboret e shumta që shkriheshin, komandantët që vinin e shkonin, armët që shkriheshin para syve të tyre), e ato mbeteshin të njëjta, iu pat shtuar edhe më ndjenja e tërbimit dhe e hakmarrjes së tmerrshme. Bile, kur flitnin për fitoren, e cila megjithatë duhej të vinte dikur, pa marrë parasysh çmimin që do t'i paguhej dhe pa marrë parasysh se në ç'rrethana do të ndodhte, mendja prorre i shkonte te tendat dhe gratë e haremit se si do të dukeshin kut do të mbeteshin jashtë xhurulltisë që i rrethonte dhe njëherësh i shfrytëzonte? Po t'i shihte ato tek zvarriteshin pas bishtit të ushtrisë, do të kthente. Prandaj, ja pse e përfytyronte dhe e dëshironte zjarrin, një zjarr të madh, që do t'i përpinte para se të shfaqej trishtimi. Por, me kalimin e kohës, sidomos kur mbrojtja e Kështjellës që dobësuar dhe rrethimi bëhej gjithnjë e më i egër, zjarri që përherë e mbante të ndezur, sikur po i fikej. Një mllef i thellë seç i thoshte se ato duhej bërë copë e grimë, duhej ngulur në thika...

Dhe kur iu dha rasti ta bënte sulmin e befasisëm, pa një e pa dy vendosi t'i sulmonte tendat e kaltra, pa menduar mirë se a do t'i hapte me tamam udhë të sigurt karvanit të ushqimeve. Ndjenja e urrejtjes, që e kishte ushqyer aq gjatë dhe aq fuqishëm ishte më e fortë se gjithçka tjetër. "Tash ju kam... Nuk më shpëtoni... Nuk më shpëtoni" – kërcënohej dhe ishte i lumtur se edhe po të vdisnin pak nga pak çdo ditë, së paku nuk do t'i dëgjonte të qeshurat e tyre hingërisëse dhe çallgitë që ia gllabëronin shpirtin. Natën e sulmit, nga pirgu, një copë herë i shikoi tendat e kaltra dhe se si iu duk se dritat laryshëse i erdhën më të zbehta, flakadanët të

errësuar,e edhe klithjet e të përdalave iu duken më të fashitura,sikur të ishin grahma që paralajmëronin kobin... Jehona e gërnetës,që i erdhi si vajtim,thujse ia tumirte këtë,ndërkohë që koka po ia thurte një gjakderdhje makabre,tepër makabre,nga ato që kishte dëgjuar si fëmijë dhe për këtë i duhej zhurma, i duhej hareja e tendave, i duhej hingërisja e grave të përdala të haremit në mënyrë që gjithë atë shfrenim ta ndërpriste tmerrshëm. Ndryshe as që e merrte me mend hakmarrjen. Sa më e madhe të jetë zhurma, mendonte, aq më e fuqishme duhet të jetë e qëlluara... Madje,kur po i shikonte tendat ashtu gjysmë të heshtura, sesi i shkoi mendja që sulmin ta shtynte për ndonjë herë tjetër, kur gjithçka e tyre t'i nënshtrohej përfytyrimit të krijimit të kushteve të plota... Por, kjo ishte punë që nuk bëhej, ngaqë tashmë ishin dhënë njoftime për kohën dhe vendin e ardhjes së mallrave.

Megjithatë, tendat i sulmoi. Por këtë e bëri pasi u fut në pjesën perëndimore,shkatërroi dy tenda dhe, në të kthyer,kur prapa la hutimin e ushtrisë së huaj, hyri në tendat e kaltra dhe shkatërroi gjithçka që gjeti në to nga çallgaxhinjtë, që iu bë se flinin, rojat e përgjumura si dhe gratë e lakurike, që i kishte molisur harlisja e gjatë e natës...Pastaj i copëtoi edhe daullet e mëdha, theu xhymbyshët dhe veglat me tela dhe të tjerat, që nga të rënat që i mernin dukej se qanin. Në atë shkrim se si i shkoi mendja te gërneta. Ku ishte vallë? Shikoi përreth por nuk ia zuri syri gjëkund.

“Gërneta!...Gërneta i dua... M'i gjeni të mallkuarat,sepse ato do të vajtojnë prapë...Do të vajtojnë përherë!...Gjëma e tyre duhet të marrë fund...”

Mbase edhe më tek do të çirrej në kërkim të gërnetave, por njëri nga përcjellësit ia bëri me dije se ishte koha të iknin sa më parë...Ndjenja e mllëfit të kamotshëm, e bartur si ankth prej shumë vitesh,bëri që të kërkonte ndihmë nga zjarri. Në të dalë e hodhi flakadanin poshtë, ku tashmë yndyra e qirinjeve ishte bashkuar me gjakun dhe telat e instrumenteve...Kur kaloi nga pjesa e lumit,prej nga karvanët po sosnin në Kështjellë,pa zjarrin e madh që po u ngjitej tendave... Një copë herë e shikoi flakën dhe sikur për pak u ngushëllua...

Të nesërmen Princi i tha se me flamurin e vet duhej të largohej nga Kështjella. “Ngjitu lart në male dhe sulmo ushtrinë e huaj ku të mundësh dhe si të mundësh...Të bie përgjegjësia të vendosesh se kur duhet bërë kjo dhe si duhet bërë...Le të mendojnë se jemi shumë dhe kudo...Mbase ashtu do t'ia dalim që sado pak të lirojmë Kështjellën nga trysnia e rrethimit?...“

Kur u ndanë veshi ia zuri disa gjysmë fjalë që Princi po i thoshte rreth asaj sesi njëri nga komandantët e tyre shfaqej me shëmbëllesën e çuditshme të njerëzve tanë...

“Çka s'ka në këtë botë të ngatërruar...”

Flamurtari e mori me mend pse qahej Princi. Gjatë luftërave që bëri jashtë Kështjellës (gjithsej dyzet e tri),i ra të dëgjonte gjithfarë kallëzimesh prej të cilave të luante mendja,ku jo rrallë pararojat dhe të tjerët i thoshin gjithë habi dhe shqetësim sesi kryeoficeri i ushtrisë së huaj dukej si t'ia kishte këputur kokën Kryekështjellarit... Koka po i ziente nga ato fjalë që ia vrisnin shpirtin dhe pa ndarë e thyente mendjen se mos ishte fjala për ndonjë përfitim që u shfaqej luftëtarëve në atë gjendje të rëndë në të cilën ndodheshin,apo fjala ishte për ndonjë mashtrim që bënin të huajt për t'i shkatërruar shpirtërisht sa më parë?...

Një ditë i thanë se në disa tenda dhe mu në pjesën kryesore të taborëve të huaja, ishte parë e shfaqur një pëlhurë e madhe në të cilin ishin të bindur se rrinte Kryekështjellari i vizatuar. Ata që ia sollën lajmin i thanë se ai që i përngjante Kryekështjellarit ishte hiq më pak se kryekomandanti i ushtrisë së huaj... Njëri nga vëzhguesit më të zhdërvjelltë,i cili disa herë,si tebdil ishte përvjedhur në mesin e taborëve të ushtrisë së huaj,kishte bërë be e rrëfe se në atë syret të madh pesë pash njeriu, shfaqej fytyra e Kryekështjellarit, që e njihte mirë...

“Nishaneve të tij, u falën të gjithë me radhë...”

Edhe të tjerët i thanë fjalë të njëjta dhe, kjo bëri që herë pas here përpara t'i shfaqej një perde e madhe,e zezë,në të cilën dukeshin vijat e mjegulluara të pamjes së Kryekështjellarit tek rrinte me nishanet e huaj dhe po e përqueshte... Në atë përfitim trishtues,që dëshironte ta mbante sa më larg, megjithatë assesi t'i shkonte mendja se ai kishte bërë tradhti.

Jo. jo. E njihte si veten dhe kjo ishte e pamundur. Por, përkundër kësaj, më kohë gjithnjë e më shumë po e mundonin dyshimet rreth gjetjes së burimit të ujit nga të huajt, pastaj hetimi dhe prerja e shtegut të furnizimeve, kur këtë e dinin vetëm Princi dhe ai... I mbarsur me trysninë e këtyre mëdyshjeve që nuk po u gjente dot përgjigje, sikur nisi të besonte se diçka e tmerrshme kishte ndodhur dhe pa marrë parasysh se ishte apo nuk ishte fajtor Kryekështjellari, që mendohej si i vdekur nga çasti kur u kishte rënë në duart të huajve, atyre medoemos u duhej përfytyrimi i tradhtisë dhe i tradhtarit si një shtysë që do të vihej në shërbim të pengimit të shterimi të forcave që i kishin në të sosur, në mënyrë që ajo ndjenjë, çastin që do të ndodhte të binte Kështjella në duart e të huajve, t'i mbante tok dhe të gjallë qoftë edhe si hakmarrje që shpirtin do t'ua shpëtonte nga përgjumja që mund të sjell jeta në rrethanat e ndonjë shuarje apo robërie të gjatë... Natyrisht, që ajo që për të tjetër merrej si tradhti dhe si e tillë edhe duhej të vlerësohej, për të paraqiste vetëm mbërthimin e një mospajtimi me gjendjen e humbjes së lirisë, që do të pasqyrohej me ndjenjën e kundërshtimisë së përhershme, pa marrë parasysh se si motivohej... Ky gjykim mbase edhe te ai si tek të tjerët, ballafaqimit me Kryekështjellarin, të kthyer në komandant të ushtrisë së huaj, sesi ia jepte kuptimin e një shfrimi kundërvënës, që mbase nuk do të mund të mbahej i gjallë pa përfytyrimin se njëherësh luftohej kundër së keqes së brendshme, që shpërthen çastin që asaj i jepet rasti për të vepruar edhe pavullnetshëm... Kur natës së errët gjithnjë e më shumë po i largohej ylli i shpresës, ishte i bindur se rizgjimi i domosdoshëm mund të bëhej vetëm në sajë të pastrimit të hesapeve me vetveten...

Fati i luftës, megjithatë deshi, që me kundërshtarin tashmë të përfytyruar si njeri i tyre që udhëhiqte ushtrinë e huaj, të cilit duhej hakmarrë dosido dhe pa bërë hesap çmimin që duhej t'i paguhej, të mos takoheshin, ngaqë asaj nuk i printe ai, siç do të duhej, por ai syneti i madh, që ushtarët e huaj e hiqnin gjithnjë përpara... Ç'luftë i thonë asaj kur duhet të ndeshesh me hije të hedhura në pëlhurë dhe jo me kundërshtarin, shfrynte dhe mendja i shkonte te kështjellarët dhe dëshpërimi i tyre i pamasë kur ballafaqoheshin me atë pamje... Kuptoi se një natë, me siguri pa lejen e Princit, një dhjetëshe e zgjedhur i ishte sultur pikturës së madhe dhe e kishte bërë copë-copë. E kishin shkelur pamëshirshëm dhe e kishin pështyrë. Por shfrimi u kushtoi me kokë, ngaqë kur ata ishin në të sosur të shkallmimit të pëlhurës dhe përdhosjes, çastin që po bëheshin gati të largoheshin të kënaqur që sadopak ia kishin dalë disi t'i hakmerreshin asaj hije që i nënçmonte pareshtur, ushtria e huaj, e cila një gjë të tillë kishte pritur qëmoti dhe mbase gjithë çështjen e kishte kurdisur, u ra nga prapa dhe i theri një nga një. Të nesërmen kështjellarët panë një pikturë edhe më të madhe që u rrinte përpara dhe nën të dhjetë kështjellarët e masakruar... Dhe ishte mu ajo piktura e madhe e cila përfundimisht u fut në Kështjellë dhe zuri vend në pikën e saj më të lartë, mu aty ku kohë më parë rrinte flamuri i tyre. Ngjau kjo nga mesi i rrethimit të njëzet e dytë me radhë...

Flamurtari pati derdhur lot kur i thanë se piktura, si një shpirt i lig, më në fund ishte futur në Kështjellë. Lotët në shpirt i derdheshin pareshtur sa herë i shkonte mendja tek kështjellat tjera në të cilat thuhej se buzëqeshte e njëjta pamje në pëlhurë... Djalli ka njëmijë fytyra mendonte dhe thoshte se është i pakapshëm... Megjithatë, ai duhet mundur nga brenda dhe assesi ndryshe...

Me atë mendim, që i ishte kthyer në një sëmbim të përhershëm shpirti, i tërhequr thellë në male, nuk e kthente dot kokën nga Kështjella, edhe kur këtë mund ta bënte dhe ndjente nevojë për përfitim të saj të derdhur në mjegull... Druante se shikimi mund t'ia zinte atë pëlhurë, e cila i bëhet se i hiqej ngado që shikonte si një mallkim i cili do t'i ndiqte gjatë kohës... Kokën madje, nuk e ktheu nga Kështjella as kur i thanë se piktura, për arsyet të panjohura, nuk spikatej më... Megjithatë, me kalimin e moteve, përfitimi i Kryekështjellarit tek rrinte me nishanet e huaj në atë pjesë të mbërthyer të pëlhurës, po merrte përmasat e një lëvizjeje të çuditshme, një ndërlihdjeje, që ai i frikësohej tmerrsisht, ngaqë në pamundësi ta përjashtonte, ajo sikur zhvishej nga ngarkesa e mbindërtimit të urrejtjes dhe merrte pamjen e atij që dëshironte të thoshte diçka, si amanet... Për herë të parë i shkoi mendja se mbase do të

ishite kuptimi i harresës si dënim apo çfarëdo tjetër,që do ta shpëtonte nga kjo ndërlidhjeje së cilës i druante aq shumë...Madje, një çast, iu bë se ato mendime që duhej t'i mbante të ndryra, i ishin kthyer në rrokje shpërthyesë dhe kishte folur diçka rreth asaj se si ai ishte përjashtuar nga kujtesa e tyre,se merrej si i paqenë dhe kështu përfundonte gjithë ajo që së paku shpirtrat e tyre duhej t'i ruante nga prishja e përgjithshme...

Por ja se në atë gjendje,ai tjetri,nuk po pajtohej që t'i takonte harresës dhe as të përjashtohet nga kujtesa,e aq më pak të bëhej i paqenë...E ndiqte dhe i thoshte se me kot e kishte, ngaqë nuk do ta linte të qetë kurrë as atë e as të tjerët...T'i je i paqenë, i bëhej t'i thoshte Flamurtari... Pse mundohesh për të kundërtën kur këtë nuk do ta arrish?...Pse?...E Kryekështjellari nuk jepej që nuk jepej...Përpiquej t'i thoshte diçka,ndonëse fjalët i kishte shurdhe... Kjo mbase paksa e ngushëllonte dhe i bëhej se i thoshte se si për të nuk kishte shpëtim... Kurrë!... Kurrë nuk do të kthehesh!... Kurrrrrë!... Kurrrrrë...

Me kurrërë-kurrin që i ishte kthyer në një jehonë shpirti, me të cilën sikur pareshtur ndeshej, Plaku ndjeu t'i hapej dera prej nga lagështia e mëngjesit të ftohtë sikur ia hoqi sikletin që e kishte mbërthyer...

Djaloshi që ia dinte mundimin,priti e i tha:

„Isha ndër varre. Sapo ra terri i parë,i rashë trup Blinishtës dhe ktheva rrugën në të majtë që t'u ikja shikimeve të ushtarëve të huaj. Kur hyra në katund,vëzhgova mirë e mirë dhe u futa në kishën gjysmë të rrënueme, prej nga trerët kundërmonin shkrumb. Prapa më rrinte një ikonë e kallur. Më vonë, zvarrë u futa në mes të varre,mu aty ku qëndronin dy skelet e këmbanares së dikurshme. Nata ishte me yje dhe unë fillova t'i numëroja ata sa për ta mashtruar gjumin që po m'i rëndonte sytë. Dhe pasi numërova qindra yje dhe pasi u ngatërrova shumë herë me ta,dëgjova një trok kali. Vinte shumë i lehtë sa më bëhej se mund të ishte ndonjë mashtrim. Por, ja se një çast trokun e zëvendësuan ca hapa të butë,që shpërndareshin shkujdesshëm andej-këndej nëpër varre sikur të ishin të dikujt që bredhte ashtu kot apo ishte ngatërruar në kalim. Me gjithë hapat që herë dëgjoheshin dhe herë tretnin,nuk po shihja njeri. Përftimi i disa hijeve,që po më shfaqeshin si hijalle,sikur ma mbushte mendjen se ishin shpirtrat e të të vdekurve që po lëviznin ashtu dhe kjo ndjenjë që po më pushtonte gjithnjë e më shumë,më mbërtheu me të dridhura. Në atë përpëlitje hijallesh dhe hapash që i përngjanin njëfarë loje dikur m'u bë se afër një varri m'u përftua një si trup i gjatë që po sillej rreth tij. Nga terri por edhe nga dridhërimat që nuk po më ndaleshin, nuk isha në gjendje të hetoja me tamam se ç'ishte në të vërtetë ajo që sillej rreth varrit: hije apo njeri?...Me atë hamendje që nuk isha në gjendje ta qartësoja, më zu ferku i mëngjesit, që përpara po ma shpalonte heshtjen e thellë të varreve dhe lagështinë e vesës që i kishte mbërthyer ato...Dikur iu afrova varrit kah më bëhej se ishte sjellë hija dhe gjeta një lule të kuqe me gjashtë fletë. Lulja ishte e freskët e të freskëta ishin edhe ca gjurmë përreth varrit...”

„I kujt ishte varri?“ - pyeti Plaku prajshëm.

„I Mrikës së Mal Tanushit...”

„I Mrikës së Mal Tanushit,the?”

„I Mrikës ishte“,- tha Djaloshi dhe doli.

E bija e Malës së Tanush Malës - pëshpëriti Plaku dhe ndjeu një mallëngjim aq të madh sa iu mbushën sytë me lot. Mendja e lodhur tash po ia shpalonte një kujtim të kamotshëm, mbase nga rrethimi i parë,(Plaku e maste kohën me rrethime),kur në pìrgun e lartë, ku po vëzhgonte taborët e ushtrisë së huaj që po shkrinin një top të madh,nga më të mëdhenjtë që kishin parë ndonjëherë para Kështjellës,iu afrua Mala i Tanush Malës dhe i tha se i kishte lindur vajzë. Në atë kohë lufte,kur të gjithë u gëzoheshin djemve,Mala iu gëzua çupës me arsye,ngase kishte shtatë djem rresht. Shtëpia pa bija është e shurdhër, thoshte. Flamurtari i pati thënë se do t'i bëhej nun dhe do t'ia gjente trimin kur të rritej.Jotja është,Flamurtar,i pat thënë Mala.U rritë e lirë,ia pat kthyer ai...Po vajza që Flamurtari e pagëzoi Mrikë, nuk ishte e thënë të rritej në liri por nën peshën e rrethimeve të pafundeta.

Dhe, pikërisht në të gjashtëmbëdhjetën, kur vajza ishte bërë selvi dhe i përdorte me shkathtësi armët, me lejen e të atit, Flamurtari e fejoj me Kryekështjellarin. Kur e shpalli fejesën, e dinte se po fliste me zemrat e të rinjve, ngaqë kishte hetuar që moti se si njëri-tjetrit ia kishin lëshuar syrin. Në Kështjellë i madh e i vogël iu gëzua fejesës. E bëfshim dasmën në liri, uronin. Por, liria për të cilën luteshin dhe luftonin pareshtur, dukej se nuk ishte afër e as që përfonte, meqë rrethimet nuk kishin të sosur. Bile, erdhën kohë kur edhe vajzave u binin mbi supe sakrificat e shumta. Kjo e shtyri Kryekështjellarin të merrte leje prej Kuvendit të luftës që ta formonte njësitin e vajzave, në të cilën, ndër të parat u fut Mrika. Kështu, të rinjtë, që deri më atëherë, shiheshin vetëm gjatë meshës së të dielës, gjithnjë e më shpesh ndodheshin pranë njëri tjetrit. Flamurtari u gëzohej të dyve dhe priste pranverën që t'ua vinte në gisht unazën e martesës. Edhe pse martesat bëheshin gjatë stinës së shirave, pra kur rrethimet ndërpriteshin përkohësisht, Flamurtari luti kuvendin që dasma të bëhej mu në pranverë, ditën kur predha e parë e topit që do të hidhej nga jashtë, me të cilën fillonte stina e rrethimit. Do t'u tregojmë se gëzohemi, se nuk jemi molisur, se do të qëndrojmë e mbi të gjitha se do të përtërihem. Dhe kështu Flamurtari përfytyronte një dasmë të madhe, të jashtëzakonshme, që do të bëhej në një ditë me behar, ku së pari do të jehonin daullet e pastaj këngët dhe vallet e gjata, ndërkohë që tutje, përtej mureve, ushtria e huaj do t'i përshëndeste me predha topash e me zjarr të furishëm nga të gjitha anët... Ç'madhështi, mendonte ai. Në njërën anë daullet dhe në tjetrën predhat e topave... Në atë këmbim predhash dhe këngësh nusja heq duvakun para syrit të armikut... Predhat do të vinë nga të katër anët, ndërsa dasma do të vazhdojë... Nusja do të luajë vallen me dhëndrin, pa marrë parasysh se në tryezat e mbusha me verë do të gjente vendin ndonjë prej tyre... Edhe në ato rrethana vera do të pihet me kupa, këngët do të jehojnë, e nusja e re do të ëndërrojë vogëlushin si rritet më shpejt se behari...

Por, dasma që e priste nuk u bë as atë pranverë e as kurrë. Pas rënies së Kryekështjellarit në kurth, dëshpërimin e thellë Mrika e shprehu në një mënyrë të veçantë kur veshi rroba djemsh dhe me lejen e Princit iu bashkua vëzhguesve, që ngarkoheshin me sulme të herë pas herë jashtë Kështjellës. Një vit më vonë, çastin që u pre damari i ujit e kalimi i fshehtë i furnizimeve u mbyll përgjithmonë, Mrika nuk u pa në Kështjellë. Nuk u duk as të nesërmen e as kurrë më... I madh e i vogël e merrte me mend fatin e saj. Flamurtari vështroi nga pirgu i lartë fushat përreth dhe kah nuk i shkonte mendja. Mos vallë edhe ajo kishte pësuar fatin e të fejuarit?... Mos kishte pasur midis tyre ndonjë lidhje të fshehtë?... Mos vallë Mrika i kishte ditur të gjitha?... Ç' nuk i thoshte mendja, sado që krrajatjeve të saj nuk dëshironte t'u jepej...

Ditën e katërt u hap një lajm (që më vonë u vërtetua në tërësi) se Mrika futej nëpër tendat armike dhe priste ushtarët. Thuhej se hynte befas, gjithnjë aty ku nuk e pritnin dhe ikte duke lënë pas currila të shumtë gjaku. Ushtria e huaj që shqetësuar së tepërmi, për vetë faktin se sulmet ishin aq të shpejta e aq të ashpra sa kush nuk mund ta merrte me mend se ato i kryente një dorë e vetme dhe më së paku që ishte femër... Komanda e huaj mendonte se mund të ishte ndonjë shpirt i jashtëzakonshëm, ndër ata të shumtët që thuhej se silleshin në hapësirën e Tokës së Lashtë, i cili hetohej vetëm pasi linte gjurmët e gjakut pas. Krahmasave të jashtëzakonshme të mbrojtjes, u vunë në lëvizje gjithfarë hafijesh e çështja u shtrua me ngut edhe në këshillin e lartë të mbrojtjes dhe pas pak edhe atë të fesë. Nga ulemaja dhe të tjerët u kërkua të vërtetohej se mos ishte fjala për ndonjë shpirt hakmarrës nga ata për të cilët në Kryeshehër thuhej se në këtë pjesë të botës kishte me bollëk. Këtë shqetësim me të shpejtë e hetuan edhe kështjellarët. Nga muret, qysh në agim përcillnin ceremonialet e varrimit që bëheshin në afërsi të tendave ngjyrë vjollcë. Se përnjëmend po ngjiste diçka e papritur dhe e rëndë dëshmoi edhe heshtja që i përfshiu tendat e kaltra. Jeta e natës, që rëndom fillonte pasi binte terri i parë, u shua, kështu që taborët e shumta pa zhurmën e haremeve dhe çallgite dukeshin të përgjumura e të frikësuar...

Ditën e shtatë u kuptua se ishte vrarë një oficer i rëndësishëm dhe kjo dëshmohej me parakalimin e togut të nderit nga tenda e gjelbër e deri te tenda e praruar. Ndërsa ditën e nëntë nuk mund të dyshohej fare se ishte vrarë një oficer i lartë, në mos njëri ndër më të rëndësishmit që drejtonin fushatën e rrethimit. Këtë e treguan shenjat e zisë, që për herë të parë u duken qysh se kishin filluar rrethimet. Kështjellarët panë flamurin e huaj në gjysmështizë dhe dëgjuan uluritjet e dervishëve gjithë ditën. Gjëmimi i tyre u bë edhe më i trishtueshëm kur ra nata dhe terri futi në pushtetin e vet taborët e pa fund, të cilat sikur dukeshin si të paqena nën jehonën e atij gjëmimi që përhapej si ogur i ligë mbi to... Kështjellarët atë natë nuk vunë gjumë në sy ngaqë e dinin se të nesërmen do të pasonte një sulm i jashtëzakonshëm me rrebeshe të papara deri më atëherë. Ishin mësuar që dëshpërimi apo hidhërimi i të huajve t'u derdhej pamëshirshëm. Por, për habinë e tyre të madhe, sapo gdhiu, vendin e gjëmës që nuk kishte pushuar sa që nata, e zuri një hare e trishtueshme e mbarsur me çallgi dhe uturimë gjithfarë çirrrjesh, nga ato që rëndom dëgjoheshin pas ndonjë sukse si ushtarak... Zallahia e krijuar nga përziera e ushtarëve me dervishë ishte përfshirë në një valle që nuk i shihej as koka e as bishti, po që hiqej mundimshëm prej tendës në tendë, duke krijuar një si labirint përmasash të papara. Ai dëlir marramendës vazhdoi deri sa dielli mori teposhtën. Atëherë, befas, labirinti i valles u shthur dhe gjithë ato trupa të shkallmuara nga lëvizjet e pandalshme, këputshëm iu afruan tendës së praruar. Nga ajo lartësi, kubeja e saj që vezullonte vrazhdë, kështjellarëve iu duk si një varr i madh përmasash pa fund...

Pasi ranë daullet e komandës dhe dikush tha diçka, nga poshtë u lirua një e çirur e tmerrshme, që mbyti hapësirën deri në liqen. Pastaj, para turmës, sekush e nxori një hy të madh, ku shihej një trup njeriu i ngulitur në të. Turma prapë zuri të ulërinte dhe të nxirrte çirre lemeritëse. Ishin dervishët që para hurit të përgjakur u hodhën në vallen e ziçrit...

Gjithë ajo që panë më vonë, kështjellarëve ua ngjethi mishtë, me që nuk e patën të vështirë të shohin se në majë të atij hurit, qëndronte Mrika e torturuar tmerrësisht...

Ceremoniali i përdhosjes zgjati deri kur perëndoi dielli. Pastaj nga turma e shfrenuar u liruan dy kalorës, të cilët, me hurin në dorë, u drejtuan nga hyrja e Kështjellës. Pasi bënë një vrap të lazdrueshëm, lanë drurin me viktimën e masakruar dhe ikën...

Pastaj ra nata, një natë e ethshme që dukej se nuk do të kishte fund kurrë. Në atë gjendje mbyttëse, Princi urdhëroi rapsodët të këndonin. Zëri i tyre dukej se ikte nga Kështjella, shkonte në liqen dhe prej andej i ripërtëritur nga kaltërsia e ujit, shpërndahej në gjithë Principatën si një kumt lufte, që duhej ta dëgjonin të gjithë, i madh e i vogël, guri e druri...

Atë kumt e ndjeu edhe Flamurtari, koka e të cilit tashmë po ia rikrijonte përmasat e llahtarit. Por, ajo vdekje, sado makabre sikur e qetësoi. Me dëshirë, në atë gjendje, do ta shihte edhe Kryekështjellarin. Në varrin e tij do të rriteshin lulet dhe bari në vend të dyshimit të pafundët që nuk e la të qetë asnjëherë... Në atë tallandim, Plaku për pak sikur u harrua dhe i erdhi mirë që nuk do ta shqetësonte më Mrikën, të cilës i kërkoi falje që nuk po e lenin të qetë as në varr... Por, pas pak, kur ishte i bindur se do të shkëputej nga ato që e ngarkonin me ankth, serish përfytyroi Mrikën të veshur me të bardha që po i ngjitej një kodrine bleroshe, e më pas iu bë se po shihte Kryekështjellarin që shkonte të njëjtës rrugë... Dukej si hije që niste diku në një errësirë, prej nga nuk shkëputej, por vetëm zgjatej mundimshëm kah ajo përndjekje... Në atë përpëlitje, hija që ai e merrte për të Kryekështjellarit, shkiste drejt një rrëmujë dhe përcillej nga disa klithma dhe gjëmime që vinin nga thellësia e territ... Dikur, megjithatë, hija e kthyer në një shumëhije, ia doli të shkëputej dhe nxitoi t'i hiqej pas Mrikës që ecte fare e qetë asaj përpjetës që shfaqej si e pafund... Nuk ishte i sigurt se çfarë ndodhi më tutje, ngaqë e gjithë pamja e kodrinës bleroshe iu nxi dhe në atë futë humbën edhe përmasat e hijes bashkë me përfytyrimin e Mrikës, por hetoi se tashmë vetëm shkonte nëpër një kjasinë gjithë myshqe të kalbura, që kundërmonin rëndë, e që asaj përpiqej t'i largohej jo me anën e ecjes, por me anën e krahëve që i kishte në vend të duarve, prej nga gjendja as ecje as fluturim më shumë i pengonte se sa që i ndihmonte të përballonte atë... Nga frika e njëfarë mbytteje në atë kënetë,

nisi të kërkonte ndihmë dhe sikur po zinte n'gojë emrat e luftëtarëve të tij të dikurshëm,por që ata ndonëse ishte i bindur se e dëgjonin prej dika,nuk po i përgjigjeshin e as po i vinin në ndihmë.Dhe kur ia mori mendja se aty do të ngulfatej përgjithmonë, gjë që kjo i pasqyrohej me terrimin që po e mbërthente në të gjitha anët dhe mungesën e frymëmarrjes,që e ndjente se si po ia shtjerrke kraharorin,iu shfaq një vegulli nga lindja, ku hetoi ca veta që nga një kodrinë e butë, po zbrisnin drejt kënetës...Me nga një gur varri përmbi dukeshin xhuxhimaxhuxha... Në atë përpëlitje,që i vinte paksa më e shlrshme nga ajo e pakmëparshmja kur shkonte kah ngulfatja,njohu bashkëluftëtarët e dikurshëm,që kush andej e kush këndeje,kishin rënë nëpër fushëbeteja të ndryshe dhe të shumta... Ku po shkoni,ndjeu të thoshte?...A nuk po shihni se po i afroheni kënetës në të cilën do të mbeteni përgjithmonë?...Por, ata me rrasa në kokë,dhe gjithnjë e më të vegjël,ecnin patundshëm kah kënetë, që pas pak prekën ujin e trashë dhe një nga një sharruan në të, ndërkohe që në syprinë kishin mbetur rrasat e varreve, të cilat notonin mbi shavarin dhe myshkun e shumtë...I dëshpëruar pyeti rreth katandisë dhe ligatinave,por ajo pseja që i ishte ngjitur për goje dhe në vend të kuptimeve i ishte kthyer vetëm në një klithmë të thjeshtë mbytëse,bëri që të merrte vetën dhe të nisej nga kënetë për t'i shpëtuar bashkëluftëtarët e dikurshëm,që tashmë kishin sharruar në të...Në atë zvarritje të mundimshme hetoi se më nuk i kishte përpara as rrasat e varreve që notonin mbi shavarinë dhe nuk shihte as ujë,pos një thernaje myshqesh dhe murrizash të ngatërruar me njëri tjetrin, që krijonin pamjen e një labirinti të pakapërcyeshëm në të cilin po futej. Në atë gjendje pa shpesë,megjithatë i bëhej se shoqërohej nga një qenie tjetër,që nuk e shihte por ishte i bindur se ishte Kryekështjellari, të cilit i sikur i ankohej pse po ia shpartallonte ashtu ushtrinë...

Ajo ndjenjë trishtuese bashkë me çirret e brendshme sikur e nxorën nga përftimi i rëndë dhe ai hetoi se ishte mbytur në djersë që i ishin ftohur dhe se ato po i ktheheshin në ethe...Trupi po i dridhej si thupra në ujë sa nuk po i ndihmonin as lëkurat e mëdha të ogiçëve që i hodhi përmbi. Në atë gjendje se si pëshpëriti diçka rreth akullnajave të botës,që e kishin rrethua,që një copë herë i zuri n'gojë ato i bindur se ishte bërë pjesë e tyre. Por,për habi,i mbërthyer nga merdhimi dhe ngrirja,ku çfarëdo lidhjeje me jashtësinë pamëshirshëm shkëputet , sikur ndjeu se kishte dikën pranë, që po i thoshte diçka rreth asaj se gjatë ishte marrë me të...Ishte i bindur se ato që po i hynin në kokë nëpërmes atij mërdhini nuk ishin tjetër pos fjalë të Kryekështjellarit, që i rrinte përpara si shpirt i padukshëm...Tek e fundit, a nuk ishte gjendja e mërddhinit të përgjithshëm dhe të paqartësuar ajo që u shkonte shpirtrave, ku të verbrit siç ishte ai kahmot,dhe të mallkuarit,siç ishte Kryekështjellari,mund të bisedonin lirisht për të gjitha pa qenë në gjendje që të bartin përgjegjësinë por as pasojat e veprimeve të ndërjegjeshme?...Ajo mëdyshje sikur e qartësoi dhe e ktheu para bashkëbiseduesit,që serish nuk mund ta shihte,por e merrte me mend dhe e përfytyronte si atëherë kur e shihte. Ai tash po i thoshte se marrja me të e kishte kthyer në këtë gjendje...

Flamurtari sikur u zu ngushtë,por ishte i bindur se duhej t'i nënshtrohej bisedës,ngaqë në të kundërtën rrezikonte që përfytyrimi t'i kthehej në gjendje reale,që nuk do ta dëshironte dhe pas një heshtjeje, që iu bë se zgjati shumë, i tha se ishte përjashtuar nga kujtesa e tyre...Nuk ia tha arsyet, por serish ia përsëriti këtë...

Ai tha se kjo nuk ishte e mundur,ngaqë ai ishte dhe mbetej pjesë e tyre, e deshi apo nuk e deshi këtë kush...

Flamurtari sikur e pyeti rreth asaj që kishte ndodhur pas largimit të tij, gjë që tjetri kishte heshtur dhe nga kjo heshtje ai serish i kishte shtruar pyetje të tjera siç ishin ato rreth shterjes së ujit,rreth ndërprerjes së furnizimeve dhe veçanërisht i kishte folur rreth masakrës së jashtëzakonshme që kishte ndodhur në Liman,ku mijëra dhe mijëra kështjellarë ishin marrë peng dhe ishin sjellë pranë detit për t'u therur si delet...I kishte thënë se nga gjaku i tyre ishte skuqur edhe deti dhe se kjo kasaphane kishte qenë ndër më të tmerrshmet që kishte shkalluar keqas drurin e tyre të jetës...

Pas atyre që kishte thënë me folje të pakryera, Plaku sikur kishte hetuar se ndodhej në një gjendje jashtë mërdhimit me Kryekështjellarin përpara, që i bëhej se tashmë e shihte, gjë që e kishte shtyrë t'ia përsëriste dhe përsëriste ato që kishin ndodhur në Kështjellë dhe përreth saj pas kapjes së tij...Kishte folur aq shumë dhe aq thekshëm sa tjetri një çast ia kishte bërë me dije se i dinte të gjitha madje në hollësi dhe se ishte e udhës që më në fund ta dëgjonte edhe atë dhe rrëfimin e tij që kishte pritur aq gjatë t'i thuhej dikujt për t'u liruar paksa nga pesha e mallkimit...

“Nga mallkimi nuk lirohesh kurrë“, i kishte thënë Flamurtari...“Ajo është pjesë e jotja, por edhe jona“. Ndërsa ai i kishte thënë se „do të ishte dëm i madh që ca gjëra të mos merreshin vesh, meqë ato kishin të bënin me atë pjesë të fatkeqësisë, që nuk ishte vetëm e njërit e as e tjetrit, por më tepër e të gjithëve njëherësh...“

Plaku për pak kishte heshtur ndërsa ai kishte filluar t'i tregonte si kishte bërë një rrugë të gjatë që kishte kaluar nëpër kohë dhe shekuj të ndryshëm, që herë-herë, me ato që ngërthenin, dukeshin sikur përmbylleshin në një ditë të vetme, të shkrirë në një dritë-kohë, siç tha, ku e djeshmja ishte edhe e nesërme edhe e sotme, ku e sotmja ishte edhe e djeshme dhe e nesërme dhe ku e nesërmja ishte edhe e djeshme dhe e sotme njëherësh dhe që e gjitha ndodhte jashtë hapësirës së përcaktimit...

“Sipas kësaj që thua“, foli Plaku, “kjo që po ndodh ka ndodhë dhe do të ndodh, se ajo është vazhdimësi e një kobi që nuk ka të ndalur?...Këtë nuk është dashtë të ma thuash meqë e di fare mirë...”

„Nuk e kisha fjalën vetëm te kobi si kob që sillet si vërtitje në çastet e caktuara kur qëllon rëndë e më rëndë“, foli tjetri, “por për më tepër për të kuptuarit e tij si pjesë e një pleksje të gjatë dhe të pafund, që i takon pikërisht përsëritjes së të njëjtës, asaj që ka qenë dhe nuk është, por që njëherësh është dhe megjithatë do të jetë si ndërlidhje e pashkëputshme...”

„Të paqenët nuk mund të kuptohet“, foli Plaku prajshëm. “Andaj, pse të mashtrohem i serish?...“

„Të ka molisur ndodhja e asaj që është dashtë të kuptohet si pjesë e përsëritjes së të njëjtës e jo si dështim...”

„Aq më keq...Kjo do të thotë se humbja është fat që nuk mund t'i iket...”

„Është pikërisht e kundërta, me të cilën dëshmohet se vetëm ai që ndjehet dhe që është, mund të humb, por edhe mund të fitojë...Po të mos ishim, po të mos përsëritshim, me siguri se nuk do të përsëritej as ndodhja dhe as ato që mund të merren për dështime...”

„Kështjella është në duart e tyre dhe ne pa Kështjellë nuk paraqesim asgjë pos mjeranëve të shkapërderdhur, që u mbesin andrallat si ngushëllim, siç na kanë mbetur...Mbase këtë duhet ta dish?...“

„Ndërrojnë rolet... Ata të mbyllur, në mbrojtje dhe në të lirë, që t'i sulmojmë...A nuk duhet menduar rreth kësaj gjendjeje në vend se të merremi me humbjen?...“, - tha tjetri.

„Lëri gjeputat dhe atë përfytyrimin e marrë se marrja apo humbja e Kështjellës do të thotë se ne mund të bëhemi ata dhe ata mund të bëhen ne...”

„Unë po të flas jo nga pikëpamja e asaj që ndodh tash, por nga ajo e përsëritjes së të njëjtës...Ky është një dallim i madh...” - ia ktheu tjetri.

„Kjo është vetëm mbllaçitje dhe asgjë tjetër“, ia ktheu Plaku dhe kërkoi që mos ta lodhte më me aso dokrrash koti...

Fjalët e fundit Plaku i tha me aso theksimi sa për pak iu bë se ato kishin qenë shpata që kishin qëlluar tjetrin sa ai ishte bërë copë e grimë prej tyre. I erdh keq se kjo mund të kishte ndodhur dhe ia la fajin ndjenjës së hakmarrjes që gjatë kohë e kishte bartur si mllef të papërmbajtur...Në atë gjendje tashmë terrimi i syve po i kthehej në një terrim mendjeje dhe kjo e dëshpëroi pa masë, veçmas të kuptuarit e asaj se i ishte dhënë urrejtjes së brendshme dhe mos përmbajtjes...Në atë kollofitje, kur ishte i bindur se vetmia e tij nuk do të kishte fund dhe se kjo mund t'i shfaqej si ndëshkim për atë se kishte ushqyer urrejtjen në vend se të ndodhte e kundërta, megjithatë sikur hetoi se ai tjetri po i rrinte pranë dhe po bëhej gati të

fliste...Deshi t'i kërkonte falje dhe t'i thoshte se nuk ishte vrasës,por ishte zëri i tjetrit që i tha se e kuptonte hidhërimin e tij dhe se ai ishte aty për t'i thënë ato që duhej t'i thoshte për të cilat theksoi se kishte kaluar shekujt pa marrë parasysh se në atë rrugëtim u ishte nënshtruar përsëritjeve dhe përsëritjeve që mendimet të tij do të mund të ishin ngatërruar edhe me kuptime të tjera,nga ato që kishin mbetur të bredhin jashtë kohës dhe jashtë hapësirës, e që në atë sillje e sipër ishin shtuar dhe ishin ndërlidhur ndër veti sikur të ishin pjesë e tërësisë së të kundërtave.

I kënaqur që më në fund midis tyre ishte kthyer paqja e fundit,siç i përftoi Plakut ta cilësonte gjendjen e rikrijuar,ai bëri me dorë se ishte i gatshëm të dëgjonte ato që ai kishte me ia thënë dhe u mbështet me fytyrë kah toka,prej nga kundërmimi i dheut dhe lagështia ia ktheu përqendrimin,ndërkohë që Kryekështjellari nisi rrëfimin e gjatë...

„Kobi im filloi ditën e fundit të rrethimit të njëzetë,pra ditën kur pas një pritjeje të gjatë, retë e mbarsura me lagështi sollën pikat të shiut dhe ne e dinim se ushtria e huaj do të mblidhte tendat për t'u kthyer serish pas stinës së shirave...Atëbotë po ecja mendueshëm nëpër përgjymtorët e Kështjellës dhe po shikoja tendat e shumta që fillonin rrëzë mureve tona dhe mbaronin diku afër ujërave të liqenit. Më shkoi mendja se pjesa më e madhe e atyre tendave bashkë me ushtarët do të shfaqeshin serish pas katër muajsh. Atyre do t'u bashkohen edhe tendat tjera dhe ne nuk do të kishim të vështirë t'i dallojmë të rejat nga ngjyrat të tyre më të dhezëta karshi të mëparshmëve që dielli ynë i zbehte. Kjo mbase kishte bërë që edhe kronistët tonë ta kishin më të lehtë të shënonin ndryshimet e forcave armike dhe shtimin e tyre që bëhej nga rrethimi në rrethim...Kur kalova përgjymtoresh anësore (andej prej kah lumi merrte kthesën e fundit për t'u derdhur në liqen), roja e lagur sikur më tha se vinte koha të çlodheshim paksa dhe ato qenë fjalët e fundit para se të shkëputesha nga qenia ime... Më pastaj nuk e di se si u futa në një mjegullim të pafund, në të cilin koka ime çuditërisht përnjëherësh përjashtoi gjithçka të veten sikur gjithmonë të kishte qenë e zbrazur...Nga ajo gjendje kotësie shkallmuese, në të cilën nuk e di se a kisha qëndruar një apo njëmijë vite,më nxori një prarim i paparë, që më ndriçimin që krijoi, mu bë se ma hoqi pa qenësinë dhe kështu, ngadalë po më përvijohesh pamja e një turme që po më rrinte pranë dhe përcillte lëvizjet e mia... Një çast, kur tashmë isha i bindur se ndodhesha përpara një purpuri prej nga dëgjoja të më thuhej diçka,që të tjerët që më rrinin pas të përkulur e përsëritnin si me një zë që më vinte si ulërimë,u lirua njëri që ma zuri dorën tek gishtat dhe më uroi mirëseardhje.

-Të pritëm, më tha ai...Moti të kemi pritur...

Ato fjalë sikur më vinin nga të gjitha anët dhe shumëfishoheshin sa më shumë që theksoheshin.

-E dinim se do të vije...E dinim dhe të pritnim...Engjëlli mirëtor këtë ia tha Lartmadhërisë çastin që Perandoria po bëhej gati të përballohej me kthesa të jashtëzakonshme...Ne tash jemi të lumtur që përpara e kemi ardhmërinë fitimtare...

Dëgjova edhe disa fjalë të tjera, që nisën të më ngatërroheshin në kokë sa të ndjeja mundim dhe mbase do të përplasesha ashtu para tij po të mos kishte prajtur...Më tha se më duhej pushimi ngaqë na priste një rrugë e gjatë...

Kur mbeta vetëm dhe butësia e kadifeve po më miklonte,serish m'u bë se po dëgjoja ato fjalët për ardhmërinë e perandorisë,që shoqëroheshin me disa të tjera,që nuk ua merrja vesh kuptimet...Ato ishin të shkëputura dhe plot klithma...Më kot u përpoqa t'i përjashtoja ato rrokje,të cilat nga çasti në çast më përplaseshin në kokë dhe qëllonin pamëshirshëm qetësinë time,që e dëshiroja aq shumë... Me shfaqjen e territ, kur ndodhi që klithmat e kohëpaskohshme ishin zëvendësuar me një shushurimë, mbaj mend se më hipën në një karrocë të madhe dhe ata që hynin dhe dilnin në të patjetër se puthnin dorën time dhe përkuleshin deri në tokë sikur të ishin të thyer...Koka ime zinte vetëm fjalët përgëzuese që i thoshin kur buzët e tyre preknin dorën time që rrinte si e shkallmuar bashkë me njëfarë urimi

që të jetoja sa malet...Dikur,njëri që rrinte në gjunjë para meje dhe dukej si i ngrirë, më tha se do të udhëtonim gjatë,shumë gjatë,por që në rrugë e sipër do të bënim pushimet e duhura që ajo të përballohej sa më lehtë...

Kështu filloi rrugëtimi im i gjatë nëpër mjegullim,që më bëhej se i përngjante njëfarë lëvizjeje të përsëritshme dhe të pafund,që ishte aty për të lidhur gjendjen time të brendshme, thuajse të përhumbur dhe të përdalë nga vetvetja, me atë të jashtmen,që nuk ishte tjerë pos një sjellje në rreth,ku shkëputjet e mia përmbusheshin me përvijimin e kotësisë të ngjashme me sonte një hipësi...Aty hetova se kokën e kisha të zbrazur nga mendimet e mëparshme dhe ajo ishte e mbushur me një terrim ngulfatës, në të cilin herë pas here përftonin si vetëtima vetëm ato që kisha dëgjuar çastin që m'i tha ai që ishte i veshur me krypsiten mavi e që kishin të bënë me ardhmërinë e ndritshme të perandorisë dhe njëfarë pritjeje që lidhej me mua pa ditë pse ishte e tillë...Me një fjalë, isha një hiç që nuk e dinte se kush ishte dhe prej nga ishte,pa qenë në gjendje që me asgjë të lidhte kujtesën apo të kuptonte se pse qenia e tij ishte shfaqur ashtu befás në atë mjegullim të pafund,me prirjen e vetme që të kuptonte dhe të ndjente të tanishmen, si një gjendje e papërcaktuar dhe tepër e mundimshme?...Megjithëqë e ndodhur në atë gjendje si të paqenë,hetova se koka ime bënte përpjekje të hidhej tutje asaj hiqësie në të cilën isha mbërthyer fuqishëm sa më bëhej se pas shumë e shumë përpëlajtës të mundimshme,herë pas here prej meje lirohej një si gjëimim në formë të pyetjes „kush jam“,që shpejt ngulfatej nga shurdhimi i brendshëm, që megjithatë kthehej në një lëmsh, ku vazhdonte të rifomësonte atë se kush isha, që si mbërthim sfidonte gjithë qenien time... Ky farë mundimi u kishte rënë në sy atyre që më shoqëronin saqë të shqetësuar më rrethoheshin pranë e më pranë për të ma përkujtuar si në kor se isha i dërguar, se isha një yll që do të shndriste përgjithmonë,se nuk isha si të tjerët...Hetova,pra,se ata serish thoshin ato që dikur kisha dëgjuar nëpërmes pjesëzave të shkëputura rreth perandorisë së pakufishme dhe ardhmërisë së saj të ndritshme,të cilave u shtoheshin edhe shumë e shumë të tjera, që koka ime nuk ishte në gjendje t'i pranonte e lërë më t'i shpjegonte... Ata, megjithatë, flisnin si shumë, ndërkohë që terri im ishte aq i madh dhe aq i dendur, sa fjalët e tyre,ndonëse përsëriteshin,i bënte të paqena siç më kishte bërë edhe mua...Përsëritja, që nuk kishte të ndalur,megjithatë, më lodhte, më turbullonte dhe më bënte të vjellja (ndonëse kjo nuk më ndodhte edhe përkundër dëshirës që ashtu të çlirohesha)...Ndjenja e ngulfatjes dhe djersët që më kaplonin sikur i trimëronin ata të vazhdonin edhe më tutje që, kokën time ta bezdisnin me ato që thoshin...Ky mundim megjithatë mori fund çastin që u ndal karroca dhe për pak mbretëroi një qetësi shurdhe, në të cilën zura të ndjehesha si i liruar nga zabullima e mbërthimit të deriatëhershëm pa ditë as vetë pse ndodhte kështu dhe cili ishte shkaku i njëmendët i asaj ndjenjë që aty për aty më pushtoi...Megjithatë,kur u hap dera dhe përpara më doli një pallat i praruar si të rrinte as në tokë e as në qiell dhe mrekullisht përballonte atë hapësirë që unë e shihja të çliruar nga mjegulla nëpër të cilën aq gjatë kisha bredhur bashkë me ata që më shoqëronin, sikur mendja më tha se ndjenja e kënaqësisë ishte shenjë e një paralajmërimi se gjendja ime mund të ndryshonte nga hiqësia që nuk ia dija kuptimin kah të kuptuarit e hiqësisë dhe se këtë ndjenjë sikur ma sforcoi kubeja e përflakur e atij pallati, që edhe më tutje më bëhej se rrinte i shkëputur në hapësirë,prej nga hetova një si thirrje që po më vinte jo nëpërmes zërit,por me anën e përftimit të dritës që shkëlqente dhe në atë përftim e sipër hynte tek unë jashtë shikimit,me anën e një ndijimi të çuditshëm...Si i varur në qiell nxitova kah kubeja. Ecja apo fluturoja,këtë nuk e dija,por e rëndësishme ishte se lëvizja dhe se lëvizja më shkëpuste nga një gjendje në një tjetër prej nga hetoja se gjithnjë e më shumë i afrohesha një turme,e cila pasi që hapej-ndahej përgjysmë dhe ma çelte rrugën gjithnjë përkulshëm dhe me fjalë që nuk i kuptoja...Në atë çelje mespërmes turmës,që më vinte disi e frikshme, m'u bë se serish po përhumbesha dhe shikimi im gjithnjë e më shumë po mjegullohej sa tashmë përpara shihte vetëm shfaqjen e disa konturave dhe disa ngjyrymeve të përziera që shkriheshin tek njëra tjetra çartshëm...Më vonë hetova se përpara nuk e kisha turmën, e as përftimet e ngjyrymeve të përziera që i nënshtroheshin asaj prishjeje, por kisha

lule të shumta,që përvijonin njëfarë rrugice të ngushtë të cilën e ndiqja sikur ajo të mos kishte fund...Mbase do të kisha krijuar bindjen se isha gjykuar të mbetesha në atë labirint,po të mos ndodhte që përpara një shkallore,që m'u hap befas,të shihja një turmë tjetër që po ashtu më përkulej dhe hapnin një të çarë nëpër të cilën duhej të kaloja...Dhe kështu hajtmorëhajt ndoqa të çarën dhe pasi kalova nëpër një tis të lehtë, ku mbeti shkallorja dhe gjithë ai rrëmim që në të,iu lëshova një puhatje të qetë që zhytej në njëfarë gjelbërimi. Tutje tij, megjithatë serish u shfaqen shkallorët e bardha nëpër të cilat kishte shumë ushtarakë me shumë nishane,që nderonin dhe përkuleshin në përputhje me lëvizjet e mia...Moria e ushtarakëve me nishane sa vinte e shtoej dhe kjo ma mbushi serish kraharonin me një ngulf, që po ia prishte harmoninë shkallores së pafund, e cila më bëhej se kthehej në disa zik-zake që nxirrnin terr, që mbetej i sipërfaqshëm, që gjërave, megjithatë, ua jepte një ndriçimi të brendshëm...Një copë herë eca nëpër atë terrim të thyeshëm dhe po kërkoja kubënë e praruar që nuk e shihja më...Mungesa e kubesë sesi më molisi dhe nuk vonoi dhe iu dhashë një lëvizjeje të ngadalshme që isha i bindur se pashmangshëm më bartte kah një greminë e pafund, e që nuk isha në gjendje të kundërshtoja,por as të bëja ndonjë përpjekje që të ndal atë theqafje,e cila sa vinte e bëhej më e papërmbajtshme në tërheqjen e saj kah humbëtira... Për habi,kur ndjeva se ajo tërheqje kishte përfunduar bashkë me molisjen që më ngarkonte gjatë asaj lëvizjeje të fuqishme teposhtë,hetova se ndodhesha i zhytur në një prarim të butë,fillikat vetëm,pa shkallmimin e lodhjes dhe pa gumëzhimin e kokës...Kadifeja e purpurt dhe qetësia në të cilën sharrova sikur ma ndolli gjumin,të cilit iu dhashë me dëshirë me shpresën të mbetesha përgjithmonë në të... Nuk e di sa kohë ndoja ashtu: një apo një mijë vjet,por më kujtohet se kur hapa sytë pashë një fron të artë,në të cilin dikush i veshur i tëri me rroba të praruara rrinte dhe më shikonte butësisht, sikur gjatëkohë të kishte pritur atë çast. Pas një kryqëzimi të gjatë të shikimeve,që mua më dukeshin fare të pakuptimta,ai foli e tha:

-Mirë se erdhe,Daut Pashë Shkodrani...

Edhe më tutje mbeta si i ngrirë dhe nuk e dija se çfarë kuptimi kishin ato fjalë dhe ai emër,që u tha aq përzemërsisht...

Meqë prej meje nuk doli kurrfarë përgjigje, që mbase edhe nuk e kishte pritur aty për aty, zbriti nga froni dhe më mori ngryk sa një kohë ndjeva se nga ai shtrëngim i fortë po më thyheshin eshtrat.

-Të kemi pritur siç e pret toka e uritur shiun, - foli gjithë përzemërsi.

M'u bë se ato fjalë nuk m'i thoshte vetëm ai, por edhe një mori tjetër e papërshtkueshme, që megjithatë nuk e shihja, po e ndjeja si brohoriste:

-Rroftë Daut Pashai!

-Rroftë!...

-Rroftë!... Rroftë!

-Rroftë!

-Perandoria ndodhet në një udhëkryq vendimtar. Duhet të shkojmë edhe tutje kah lindja.

Këto po m'i thoshte ai që për pak zbriti nga froni i artë dhe serish u kthye në të.

-Kah lindja!Kah lindja!,- po ia kthente turma,që nuk e shihja por e ndjeja praninë e saj gjithnjë e më shumë.

-Duhet të shkojmë edhe kah perëndimi,- foli ai prapë fare prajshëm...

-Kah perëndimi! Kah perëndimi!...- ulërinte turma.

-Perandoria mbetet perandori vetëm kur lëviz...

-Lëvizje!...Lëvizje!...

-Kush nuk lëviz,sëmuret, - vazhdoi ai.-Vdes...

-Poshtë sëmundja! Poshtë...

-Erdhi,pra koha të ecim përpara...

-Ecje!... Ecje!...Vetëm ecje!...

-Marshimi ynë do të jetë i pandalshëm...

-Marshim!... Marshim!...

Ai foli edhe më tej rreth lëvizjeve, rreth marshimeve, rreth luftërave që nuk do të kishin të sosur, ndërsa që turma që nuk e shihja, përcillte fjalët e tij me çirrje lemëritëse, që po më shkallmonin sa të mos isha në gjendje të vëreja asgjë. Pas një kllapuritje, që nuk e di sa kishte zgjatur, hetova si dikush, që doli nga hapësira e mjegullt, nga përfytyroja turmën që çirrej, po më afrohej me një libër në dorë. Ra një heshtje e ngjashme me atë të varreve. Ai që mbante librin dhe vinte nga unë sikur nuk ndalej, megjithëqë në atë lëvizje e sipër hapësira midis nesh çuditërisht mbetej e njëjtë, e papërballueshme po aq sa e pakapshme, që unë, megjithatë, nuk isha në gjendje të kuptoja pse ndodhte që përkundër lëvizjes ne nuk afroheshim... Atë shpërputhje dukej se dikur libri po e përballonte, meqë hetova se ai po më afrohej e po më afrohej dhe kur më erdhi fare pranë e pashë të gjelbër fare, me shkronja të praruar që vinin nga e majta në të djathtë dhe lakadredhshin qëllimisht sikur të dëshironin të më futnin sa më parë në atë mbërthim... Gjatë kohë shikova shkronjat lakadredhe dhe sa më shumë që ua ngulitja sytë aq më të numërta më dukeshin leqet, që shumoheshin e shumoheshin dhe krijonin një pyll të dendur, ku po humbja... Mbase e gjitha do të kthehej në një mundim tjetër për mua, po të mos dëgjoja të më thuhej prej dika se librin duhej ta puthja dhe të betohesha t'i shërbeja me mendje dhe zemër Perandorisë... Shikimi im i turbullt serish gjeti atë që rrinte në fron. Nga qëndrimi i tij kuptova se duhej të veproja ashtu siç kisha dëgjuar të më thuhej prej dika, që nuk e përcaktoja dot... Se ç'domethënie kishte puthja dhe betimi që më urdhërohej ashtu, nuk isha në gjendje të gjykoja, ngaqë koka ime nuk e kishte ende të qartë fjalën „betim“. Kjo sikur më solli një tjetër mundim, të përcjellë me një oshtime të zhurmshme, e cila kokës sime po i vinte nga të gjitha anët, që ajo pasuksesshëm mendohej t'i ikte disi. Mbase oshtima do të më bënte të paqenë fare po të mos ishte urdhri i lëvizjes, që kokën time e afronte kah libri, ku buzët e mia prekën atë dhe pas asaj prekje që ishte e ftohtë pushoi zallahia dhe gjithë ajo që më ngarkonte me siklet të paparë. Një copë herë mbeta si i ngrirë dhe ndoshta do të rrija ashtu i ngrirë po të mos kisha hetuar se midis meje dhe librit tash po afrohej një gjësend tjetër, që thyente ajrin dhe krijonte njëfarë plasaritje të thekshme, si prerje prej nga më bëhej s shihja një shpatë të artë, që po më afrohej nga ana e majtë dhe po plotësonte hapësirën, e cila deri më atëherë i kishte takuar asaj heshtjeje të akullt. Ndjenja se shpata ma kërkonte kokën nuk më shqetësoi fare. Një çast sikur u pajtova me atë që do të ndodhte dhe madje ndjeva se po çlirohesha nga gjithë ai mundim, ku isha futur dhe assesi të lirohesha... Serish mbylla sytë dhe nisa të përfytyroj ndarjen e kokës sime nga trupi si dhe gjendjen që do të krijohej më pas... Dhe ashtu me hamendjen e pritjes së prerjes së kokës sime, që gjykuar sipas përjashtimit të jashtësisë dhe të brendisë me të cilën përballesha si dhe shpërputhjes së pashpjegueshme me ato që më rrethonin e që mbase në ndërkohë edhe do të kishte mundur të ndodhte, hetova se si shpata më ra në dorë dhe unë po e mbaja pa ditë si të veproja. Mbajtja e shpatës megjithatë kishte shkaktuar një shpërthim emocionesh në të gjitha anët, si një përplasje qielli, që u fashit paksa kur ai që po rrinte në fron uroi që ajo të më prarohej në dorë... Turma, që edhe më tutje nuk po e shihja, por po e dëgjoja, atyre që tha ai që rrinte në fronin e praruar, iu përgjigj me çirrjen „amen“, e kthye në një jehonë, që përplasej nga të gjitha anët dhe sa më shumë që përplasej bëhej më e fuqishme.

-Tash e tutje Perandoria jonë ka dorë dhe shpatë të fortë, -foli prapë ai që rrinte në fron, ndërkohë që turma çirrej dhe përsëndeste nga të gjitha anët, që ma ndolli dëshirën për të sharruar në pa qenësi, që m'u bë se kështu edhe po ndodhte...

Por, ç'ë do se as pa qenësia nuk po më mbronte. Ajo sikur me përplasi tutje në fronin e praruar prej nga dy veta, që rrinin përkaj tij, lexonin ca libra të trasha prej nga kokës sime i drejtoheshin gjithfarë fjalësh dhe fjalish, që çuditërisht ajo i gëlltiste të gjitha në formën e mirëfilltë që thuheshin...

“Libri i shenjtë është libër perandorak... Ka njëmijë vjet që ky libër shkruhet e shkruhet dhe assesi të plotësohet... Libri i Shenjtë është i pakryer...”

Pak më vonë dëgjova të thuhej se si „Toka e Lashtë“ është një vend i çuditshëm, një si nyje, që për shekuj e ndan botën në dy pjesë, prej nga kalon kufiri i Lindjes dhe i Perëndimit... Perandoritë e mëdha pareshtur u ndeshën në atë hapësirë të ngushtë për t'ia ngrënë kokën njëra-tjetrës sikur këtë ta kishin fat dhe mallkim... Andaj, nuk është për t'u habitur që çdo pëllëmbë e saj është e larë me gjak të përzier të kundërshtarëve, që kishin një qëllim, që ajo hapësirë paraqiste fillimin e njërit dhe fundin e tjetrit... Mbase prirja fatale që fillimi të lidhet me fundin dhe fundi të lidhet me fillimin bëri që ajo të mbetej asnjëherë?... Thuhet se nga ky fatalizëm i ka rrënjët njëfarë besimi që është kthyer në një shenjtëri dhe se bindja rreth shenjtërisë, që nuk është tjetër pos sjellje në rreth, e cila është kushtëzuar nga veprimi i baraspeshës së forcës në të njëjtën pikë, do të duhej zhvendosur sa më shpejtë dhe sa më parë, në mënyrë që më në fund të kuptohet e vërteta se është mosforca e forcës ajo që ushqen besimet e rreme dhe ato që lidhen me të dhe krijojnë ngatërresa të panevojshme dhe jo ai farë besimi dhe shenjtëria që bartet nga brezi në brez dhe përfolët në mënyra të ndryshme sa të ushqejë ndjenjën se asnjëherë është e pakalueshme, e pathyeshme, e përhershme dhe përputhje e vetme e shpërputhjeve dhe e kundërthënive... Duhet thyer sa më parë këtë përfolje për t'ia lëshuar vendin të kuptuarit të njëmendët se përballimi i asaj shenjtërie dhe besimi në të do të thotë rimarrje e nyjës së botës, prej nga pastaj do të ndodh ajo lëvizja madhështore që do të mund të arsyetohet dhe të shpallët edhe si luftë e shenjtë...

Në përpëlitzje me mendimet që më thuheshin err e terr, të cilat koka ime tashmë kishte filluar t'i pranonte dhe mbi bazën e tyre të krijonte fjali dhe ndonjë mendim të shkëputur, zura t'i lexoj librat e trasha, që quheshin të shenjta. Vihesha mbi to dhe si i urituri që mbledh secilën therimi, nuk lija gjë pa futur në kokë... Mbase asnjëherë nuk do të largohesha nga ai lexim po të mos më thoshin se duhej të shkoja tek Pallati i Praruar, ku edhe e kisha vendin...

Kur dola jashtë dhe dielli m'i dogji sytë sesi më përftoi të menduarit rreth kohë zgjatjes së shkëputjes pa ndodhur që koka ime asaj t'ia krijonte ndonjë qartësi... Kjo mbase nuk ishte e rëndësishme çastin që tashmë isha jashtë dhe po ecja drejt Pallatit të Praruar, kubeja e së cilës shkëlqente si atëherë kut zbrita nga karroca dhe e pashë për herë të parë. Me atë përshtypje kalova nëpër të njëjtin kalldrëm dhe vëreja të njëjtat roja që përkuleshin dhe ngjita të njëjtat shkallë të pallatit, që i lidheshin hyrjes së saj. Nuk e di se përse për pak u ndala aty dhe ktheva shikimin pas. Mos ishte vallë ngacmimi i shtytjes për të kuptuar ndryshimet ajo që po më shpërqendronte kalimthi?... Hetova se nga ajo pikë bota dukej si e frikësuar dhe e rrasur thellë në vetvete sikur të dëshironte ta mundte atë ndjenjë që kuptohej...

Korridoreve të Pallatit ecja ngadalë dhe i kapja shikimet e ushtarakëve që përkuleshin sapo u afrohesha për të mbetur ashtu në atë gjendje. Kur dola para fronit të praruar, m'u bë se atë pjesë e njihja jo nga e kaluara, por nga e ardhmja, prej nga nuk e di se si përfytyrimi i saj ma hapte të nesërme që tashmë çuditërisht më bëhej se e njihja!... Kisha bindjen se të kuptuarit e një realitetit nga ajo që duhej të ishte tek ajo që është dhe jo në të kundërtën, pra si një veprim i drejtë që niste nga pikënisja e zhdrejtë, bëri që Lartmadhëria të lëshonte fronin dhe të më merrte ngryk ende pa iu afruar mirë shkallës së madhe, që aty për aty më shtyri që sjelljen e tij ta gjykoja si një veprim të natyrshëm të atij ndryshimi, që tashmë kishte ndodhur... Kjo ma krijoi bindjen se *unë isha ai* dhe *ai ishte unë* dhe se nën trysninë e këtij ndryshimi ndodhte ahengu i madh që na përtheqoi dhe gjithë ai parakalim i pafund i valltarëve, çallgaxhinjve, palaçove dhe të tjerëve ishte në shërbim të përkujdesjes që gjendjet e reja që unë i perceptoja si *kthim te atij tek unë dhe futje e ime tek ai* bashkë me kapërcimet e domosdoshme që ndodhnin brendapërbrenda atmosferës së atij ahengu, dhe se kur kishte ndodhur kjo dhe na tashmë ishim të vetëdijshtë për gjendjet e reja, zhurmën e kishte zëvendësuar një qetësi e prajshme, prej nga ai m'u kishte lutur t'i thosha si e shihja të ardhmen e Perandorisë, gjë që unë, pa një pa dy, fola dhe thashë se dielli ynë do ta nxehë botën për të vazhduar pastaj të pohoja se si rrezet e tij do të shkëlqejnë në veri e në jug, në lindje dhe në perëndim dhe kur të bëhet kjo, e për t'u bërë do të bëhet patjetër, në rruzullin

tokësor do mbretërojë lumturia dhe rregulli i pashoq, meqë kudo do të flitet e njëjta gjuhë, do të mbretërojë i njëjti mendim dhe kudo do të mësohet i njëjti libër – Libri i Shenjtë perandorak...

Më tutje kisha thënë edhe këto:

-Për t'ua bërë kjo, njëherë e mirë, duhet t'ua shpallim luftë deri në vdekje të gjitha gjuhëve dhe të gjitha mendimeve që nuk janë perandorake, e mbi të gjitha duhet ta luftojmë atë që e krijoi e djeshmja dhe e pardjeshmja, që nuk i shkon të sotmes dhe të nesërme në mënyrë që dielli ynë t'i djeg pamëshirshëm fosilet e padobishme dhe të dëmshme me të cilat ngarkohet kujtesa me ato që mund ta ngacmojnë për të keq...

Më vonë kisha ligjëruar sikur të urdhëroja me zë të lartë:

-Perandoria duhet të lirohet nga gjërat e parëndësishme dhe të rrezikshme... Duhet të lirohet nga herezia dhe sëmundja e shpirtit dhe kjo mund të bëhet nëse do të ketë vetëm të sotme të përdorshme dhe të nesërme të lavdishme, e cila duhet të jetë plot lule dhe rreze të praruara...

Mendimin e përfundova me këtë fjalë:

-Në vend të shumë shkrimeve duhet të ketë vetëm një shkrim dhe atë perandorak; në vend të shumë librave të ngatërruar dhe të çoroditur, duhet të shfaqet vetëm një - Libri i shenjtë i Perandorisë, që do të jetë faqe e pafund, i hapur dhe i papërfunduar, ku do të ketë vend për kundrimet e secilit...E gjithë kjo, pra, duhet të bëhet sa më parë në mënyrë që të jepen dëshmitë e duhura dhe të pamohueshme se historia nis dhe vazhdon vetëm me bartësit e forcës, pra me fitimtarët dhe assesi ndryshe...

Më tutje nuk fola. Rrija si i shtanguar dhe më bëhej se ato që i thashë nuk ishin të miat, por të dikujt tjetër që ishte strukur në mua dhe po vepronte jashtë vullnetit tim...I mbërthyer me këtë pandehmë, që megjithatë nuk më mundonte siç pritja të ndodhte kur ngatërrohesha me mendimet që nuk i njihja, dëgjoja se si Lartmadhëria, *që më bëhej se ishte unë dhe unë isha ai*, më uroi për ato që kisha thënë dhe ma shtrëngoi dorën butësisht sa m'u bë që edhe ma puthi. Ai më përgëzoi prapë dhe uroi kokën time, që edhe më tutje të mbërthehej me mendime të mrekullueshme...I thashë se ato i kisha nga Librat e shenjta, me të cilat isha shoqëruar aq shumë...Ai më shikoi një copë herë gjithë adhurim dhe më tha se ato ishin aq të fuqishme ngaqë i kisha lidhur, u kisha dhënë jetë dhe i kisha vu në vendet e veta...Pa këtë mrekulli, tha ai, ato mendime do të mbeteshin të shkëputura siç kishin qenë deri më atëherë...

Pas pak ai më tha:

-Ka kohë që po e përfytyrojmë diellin perandorak, që e zutë n'gojë mrekullisht, por diçka e çuditshme, si një ngecje, në të cilën ndodh plogështimi dhe sëmundja, nuk po lejon që ai të shihet...

Kur i tha fjalët rreth diellit perandorak, që ai thoshte se diçka e çuditshme ia ndalonte rrezatimin, se pengonte që koha të lidhej për hakun ku e djeshmja ishte e sotme dhe e nesërme njëherësh, hetova se si shikimi i butë i treti dhe vendin ia zuri një brengë që me anën e një vije të trashë i niste në ballë dhe i lëshohej mollëzave. Por pas shumë e shumë përpëlitjeve ai foli çapitshëm rreth njëfarë „Toke të Lashtë“, që nuk e dija se pse i shfaqej ashtu si mendim, që i ngjitej për trupi dhe assesi t'i shkapej... M'u bë se dikur atë fjalë e lidhi me njëfarë si mallkimi drejtuar një kështjelle, që e nxori si gjëmë mbytëse, që mbrohej me mbyllje, që e quajti djallëzore!...

Duke e parë në atë gjendje, koka ime që gjithë kohës pranonte vetëm ato që i thuheshin nga jashtë bashkë me ato që i merrte nga librat që i lexoja, sikur t'i ishte rrokullisur diçka e jashtëzakonshme, për herë të parë përfytyrimit tim ia shfaqti përvijimin e një kështjelle të madhe të ngjitur diku për një shkrep të zhveshur të rrethuar me shumë taborre, që sikur nuk ishin aty për ta marrë, por për ta mbrojtur atë nga thneglat, që i drejtoheshin nga të gjitha anët, nga një mori aq e madhe thneglash, që nuk mund të përballoheshin ndryshe pos me anën e një zjarri, që duhej mbajtur përherë të ndezur, por që në

atë gjendje ai më shumë përpinte mbrojtësit e çuditshëm se sa thneglat,të cilat në rrugë e sipër për ta pushtuar kështjellën, që rrinte në atë shkrepin e jashtëzakonshëm,i cili nganjëherë shfaqej as në tokë e as në qiell,megjithatë gjenin rrugë për t'i bishtnuar flakës...Dhe në atë përpëlitjeje në të cilën sikur nuk kishte as fitues e as humbës të qartë,nga që as thneglat nuk ia dlinin të futeshin në kështjellë (edhe përkundër bishtnimit që ia bënëin zjarrit me anën e futjes nëpër damarët e tokës),por as mbrojtësit e saj që nga jashtë dukeshin si rrethues,nuk përpiheshin të tërë nga flaka,çuditërisht ndodhte që ata edhe kur dukej se shkumboheshin dhe bëheshin qymyr,me t'i prekur njëfarë vese e lehtë që ngrihej para ferkut të mëngjesit,serish ringjallehin dhe nxitonin t'i merrnin pamoret e shkumboara dhe flamujt e kalbur për të dëshmuar përkushtimin për të mbrojtur kështjellën nga thneglat... Ky farë dëshmimi dhe vetëdëshmimi me anën e kalljes dhe rikalljes, që pasonte pas secilës ringjallje që e shkaktonte prekja e vesës bashkë me përsëritjen e depërtimeve dhe ridepërtimeve të thneglave kah kështjella, e cila ndonjëherë dukej me gur të përflakur që nxirrnin avuj të bardhë dhe lironin disa shpërthime nga brendia,në atë përfytyrim të shkapërderdhur ma kishte krijuar pamjen e kështjellës së mundur,që vinte nga njëfarë shembje e brendshme,ku krimba të shumtë ia brenin gurtë dhe kështu ia krijonin një lëkundje të mureve,që pasqyrohej me shembjen e tyre deri në themel...Me përfitim të shembjes,që vinte nga krimbat,nuk e di pse m'u tek të krijoja mendimin se kështjella do të shembej,që e thashë fare prajshëm për ta përsëritur edhe një herë tjetër në atë mesokohën sa ai më shikonte si i pagojë.

Me ta dëgjuar gjykimin tim të prerë rreth asaj se si kështjella përfundimisht do të shembet, që m'u shkëput nga ajo ngjizje e përfytyrimit të mjegullueshëm, Perandori luajti nga vendi. Fërkoi sytë,sikur të dështonte të më shihte më mirë dhe preku veshët,thujse donte t'i zinte peng ato që thashë.

-Mendon se shembet ajo?...

-Nuk ka tjetër pos shembjes...

-Kështu flitej dikur,por ato që ndodhen më vonë nuk na dhanë të drejtë... Mbeti e tëra për t'u tallur me ne...

-Do të shembet dhe do të bëhet hi e pluhur...

-Ah,po të ndodh kjo?

-Shembja është gjë e natyrshme, që lidhet me ligjin e fundit, që është i pashmangshëm...

Ai më shikonte me një kureshtje, me të cilën kërkonte të sqaroja se si do të dukej fundi,që atij i shfaqej i pamundshëm,ndërkohë që mua sesi m'u tek të flisja rreth sendeve që thashë se janë si njerëzit, që lindin,rritën dhe më në fund shkojnë...

-Krahasim i bukur,foli ai për të thënë se i shfaqej paksa i pabesueshëm.- Përdërisa njerëzit kanë kohën përafërsisht të caktuar të jetesës, kështjellat mbahen me qindra e qindra vjet. E kur këtyre u shtohen edhe meremetimet,atëherë duken sikur janë për të mos u shembur kurrë...

-Edhe kështjellat,pa marrë parasysh sa qëndrojnë,janë si njerëzit dhe sikur bëjnë jetën e tyre,madje edhe vdekjen e ndajnë me ta...

Ai po më shikonte sy e vesh dhe ishte e qartë se priste t'i flisja sa më parë për vdekjen e kështjellave...

-Kështjella,vazhdova,është vetë njeriu. Po të mos ishin njerëzit a do të kishte kështjella?...

Ai dukej sikur i zënë ngushtë.

-Po të ishte puna për njerëz,pa marrë parasysh sa janë,nuk do të çanim kokën. Telashe po na qet kështjella, që i mbron dhe i strehon ata. - foli ai.

-Duhet ndërruar bindja se po luftohet me gurët,që mbase ka qenë fatale. Lufta bëhet kundër njerëzve, pa marrë parasysh se a janë pak apo shumë,të fortë apo të dobët,tinëzarë apo djallëzorë...Këtu qëndron çelësi i dështimeve dhe i dëshpërimeve...

-Mendja ma thotë se atje lufta nuk bëhet si çdo luftë tjetër...Aty ka diçka të jashtëzakonshme, që duhet përballuar,qoftë edhe me ndonjë armë që nuk është parë ndonjëherë...

-Kështu ka ndodhur ngase çdo gjë ka filluar me ndjenjën e triumfit të me çdo kusht me anën e demonstrimit të shkatërrimit nga jashtë...Tash e tutje nuk do të ketë luftë të tillë..

-Po çfarë lufte tjetër do të ketë?-pyeti ai gjithë kureshtje.

-Nuk do të ketë fare luftë...

-Do të thotë se duhet të heqim dorë?... Se duhet të sprapsemi?... A nuk do të thotë kjo disfatë pa luftë?...

-Përkundrazi, do të ketë fitore pa luftë...

-Diçka të tillë nuk ka...Apo,së paku nuk ka pasur deri më tash,- foli ai me një qëndrim paksa më të rrudhur.

-Tash e tutje do të ketë.

Ai heshti. Priste që edhe më tuje të hapesha...Por mua nuk më jepej të flisja më, ngaqë serish m'u lidh përfytyrimi për atë Kështjellën e kapur për bjeshkët, e cila më bëhej se tash nga thneglat mbrohej me anën e një thatësie përcëlluese ,që sikur e ndjeja të bëhej gjithnjë e më e madhe, që më përfshinte në vllugun e saj, gjë që kishte bërë të flisja thuajse përçarhtë rreth shfaqjes së njëfarë zjarrmie, që sillte etje dhe pas saj vinte po ashtu ai farë shpëtimi... Megjithatë ato që kisha thënë rreth thatësisë,etjes dhe shpëtimit kishin zgjuar shqetësim përreth saqë hetova se si Lartmadhëria qartaqefash fliste rreth shiut që binte atje, së paku një të treten e vitit dhe mbushte serrat,që pastaj ato shfrytëzoheshin gjatë kohës së thatësirave,e të tjera e të tjera... Mirëpo fjalët për shiun që po i thoshte ai, po më futeshin si njëfarë fresku dhe ma nxirrnin zjarminë, që më kishte mbërthyer çastin kur befas m'u shfaq ai përfytyrimi në të cilin Kështjella mbrohej nga thneglat me anën e vapës përcëlluese, që kishte bërë që ato për pak të tërhiqeshin tutje mureve të saj dhe të prisnin shiun për të rifilluar përpjekjet e ripushtimit... Ky përfitim seç ma krijoi bindjen të flisja për ujin si mjet të luftës. Pasi fola e fola rreth rëndësisë së ujit, gjithnjë duke përsëritur se është arma më e fuqishme dhe njëherësh më tinëzarja, ai më tha se nuk ia merrte mendja se kjo do të mjaftonte që të arrihej fitorja që pritej aq shumë, gjë që më shtyri t'i thosha se disfatat e shumta ia kishin humbur besimin dhe se kishte ndodhur kështu ngaqë çdo gjë ishte synuar të arrihej vetëm me anën e forcës, e forca megjithatë,sado e madhe të jetë, nuk është në gjendje kurdoherë të arrijë qëllimet e parashtruara nga shkaku i vetëm se në disa rrethana vendimtare bie ndesh me vetveten,pra pengon veten... Pastaj nuk e di se si m'u tek të flisja edhe për furnizimet e Kështjellës dhe pyeta se a i kishte shkuar kujt mendja se me çka mbahej shpirti atje (pos me ujë dhe me ajër,që vinë nga qielli),gjë që ai heshti dhe mua më shtyri ta pyetja, gjithnjë duke iu nënshtruar atij tjetrit që fliste në mua me gjuhën ushtarake, se a kishte kalime të fshehta që Kështjellën e lidhnin me botën prej nga hynin dhe dilnin mallra të ndryshëm...Ai më tha se janë ndërmarrë të gjitha që kanë të bëjnë me burimet e qëndresës...

-U janë shkatërruar të lashtat,- tha Lartmadhëria...-U janë djegur hambarët dhe gjithë ato që do t'u shërbenin për ushqime....A nuk mjafton kjo?...

-Pikërisht mënyra e tillë i ka detyruar të kërkojnë rrugë tinëzare për t'u lidhur me botën, së cilës ata i takojnë dhe janë përherë pjesë e saj edhe kur duken se jetojnë në atë që ne e marrim për kështjellë, por që nuk është e tillë, fola me gjuhën e ushtarakut, që edhe më tutje më detyronte të ruaja atë qëndrim...

-Është bërë çmos që t'u shkëputen të gjitha rrugët tinëzare dhe burimet e ujit nga jashtë,por ata kanë vazhduar të qëndrojnë,- ma bëri ai me dije.

-Megjithatë,folat me një përkushtim tepër të madh, që vinte nga njëfarë vendosmërie që nuk e kuptoja ,-rrugët e fshehta të furnizimeve dhe damarët e ujit do të gjenden dhe do të priten njëherë e përgjithmonë me çka ne i shkëpusim nga bota e hapur së cilës i takojnë, ndonëse ne i kemi parë të mbyllur...

Ai heshti dhe serish po më shikonte fytyrëhapur.

-Ato rrugë do t'i gjej dhe do t'i pres... Kjo do të ndodh gjatë fushatës së parë dhe me këtë merr fund historia e një mashtrimi bashkë me gabimet e bëra nga mendjemadhësia dhe me këtë hapet rruga kah pjesa tjetër e botës së cilës ata i takojnë...

Fola ashtu gjatë dhe sa më tepër që flisja për atë fitore historike, aq më tepër më bëhej se ai tjetri që ndodhej në mua e që më shtynte të përfolja aso mendimesh, të cilat të shumtën fare nuk i kuptoja, dikur bënë që Lartmadhëria, i kënaqur si fëmija që ngashërehet pas ndonjë lodre që më në fund e ka gjetur, të më zinte përfaqe...

-E dija se je vetë shpëtimtari... E dija ...

Hetova se lotët e tij preknin fytyrën time, ndërsa duart e tij dridheshin tek i mbanin të miat, që i ledhatonin...

Ndaj mesditës Lartmadhëria urdhëroi të fillonte ahengu. Shpalli gazmend të përgjithshëm treditör dhe ndau ndihma të mëdha dhe fali nishane. I madh e i vogël parandienin lëvizjen e pritur...

Ditën e katërt thirri Këshillin e luftës dhe shpalli dekretin me anën e të cilit ngarkohesha me detyra të jashtëzakonshme...

Kur po hanim drekë vazhdoi të fliste se si ajo puna e ujit edhe më tutje i dukej paksa e pabesueshme...

-Jeni marrë me gjëra të mëdha dhe nuk ua keni vënë veshin cikërrimave, - i thashë, i bindur se tashmë përnjëmend isha bërë një me mendimet e atij tjetrit që rrinte në mua dhe u paraprinte mendimeve të mia...

Pas një heshtjeje ai zuri n'gojë njëfarë telashe që lidhej me ujin, që do të mund të kthehej në pengesë të madhe... Kur e pyeta se ç'telashe ishte ajo foli për njëfarë besimi, që me sa duket e kanë kthyer në shenjtëri.

-Gjepura! -ia ktheva mos përfillshëm.- Shterja e ujit do t'i bind se besimin e kanë pasur të kotë.

-Dikush një herë më pati thënë se atje uji rrodhi nga flijimi, nga flijimi i një gruaje që na qenkësh muruar mu në themelet e Kështjellës... Pra, ka të ngjarë, se po t'i besohej kësaj legjende, ai farë burimi i ka rrënjët tek besimi i tyre, në shpirt, që do të thotë se kërkimi i rrënjëve të tij përreth është mundim i kotë?...

-Përrallat e tilla duhet të marrin fund një herë e mirë... Zaten, pikërisht marrja me ato përralla ka bërë që të ndodhin ato sorollatej si të pa kokë rreth Kështjellës dhe gjithë faji t'i lihet njëfarë besimi. Në të vërtetë nuk ka qenë besimi i tyre ai që ka mbrojtur Kështjellën, por bindja e gabuar që ajo të merrej vetëm me anën e luftës së hapur dhe assesi ndryshe, në vend se të shikohen edhe rrugët tjera që atë e mbajnë të lidhur me botën së cilës i takon... Përdorimi i papërmbajtur i forcës në një hapësirë të vogël si dhe derdhja e saj e shpërputhshme, ka sjellë ngatërrimin me vetveten në vend se të hiqeshin qafësh atë që kishin dalë në rrugë dhe kishin zënë kalimin... Po t'u shterej uji me kohë dhe t'u shkëputeshin furnizimet, pra lidhjet me botën me të cilat ata ushqehen përherë, e gjitha do të përfundonte me disfatën e tyre të shpejtë pa pasur nevojë përsëritjen dhe ripërsëritjen e fushatave bashkë me disfatat që u ndihmuam të krijojnë bindjen se është besimi ai që po i mban dhe i bën të pathyeshëm... Kujtoj se tash duhet gjetur damari i ujit, i cili nuk është në shpirtin e tyre, siç thuhet, por diku nën tokë dhe sapo të gjendet do të këputet dhe do të shihet se si pa ujë do të thahen bashkë me ato legjendat dhe baladat mashtrimtare... Më pastaj, kur të shkëputën nga bota së cilës i kanë takuar, besimi i tyre do të tretet dhe ata do të shturën dhe do të shkapërderdhën sikur të mos ishin... Dhe kur të ndodh kjo, që patjetër se do të ndodh, krahas shembjes së legjendave dhe baladave me të cilat janë krenuar dhe krekosur duke e ngritur dallimin me të tjerët përreth në njëfarë virtyti, duhet të krijohet besimi i ri, pra besimi perandorak, i cili kryekreje dhe gjithmonë do të mbështetej në forcë...

Lartmadhëria një copë herë mbeti si i ngrirë nga ato që i thashë. Kruante vetullat e trasha dhe thyente gishtërinjtë pareshtur. Mbase fjalët e mia për herë të parë po ia shembnin me themel mosbesimin e ngulitur nga disfatat e shumta që lidheshin me atë Kështjellë dhe at

vend që i thoshin *Tokë e Lashtë*... Dhe pas një heshtje që m'u bë se zgjati amshueshëm, në përvijimin e së cilës isha i bindur se tashmë kisha përballuar ngatërrimin e tjetrit në mua dhe atë shpërputhjen e dyshësisë që më bënte të mos e njihja vetveten,hetova se si ai më uroi të mbarën dhe më tha se mund të merrja çfarë të doja për të përballuar njërën ndër pengesat më të mëdha që i përherë i rrinte mes dy boteve...

Dhe prej atij çasti,o Flamurtar, i zbrazur nga qenia ime dhe i mbushur me një të tjetri,iu dhashë punës për marrjen e Kështjellës. Bëra ato që u desh të bëheshin dhe u nisa në drejtim të *Tokës së Lashtë*. Çastin që po më përcillte, Lartmadhëria më tha se duhej të kisha kujdes,ngase kisha të bëja me një vend të nëmur...

Kur i lamë fushat dhe iu qepëm grykave të maleve,koka shpejt m'u mbush me relieve të ngrira,që herë hapeshin e herë ngushtoheshin frikshëm sa më bëhej se bjeshkët e thepisura do të shembeshin mbi mua. Shpjeguesi i ëndrrave,që nuk më hiqej duke u marrë me shenjat e gjumit tim të shthurur,ma bëri me dije se deri te Kështjella duhej të kalonim dyzet e dy gryka,duhej të kalonim shtatë lumenj, duhej të përballonim njëmbëdhjetë qafa malesh dhe të përvidheshim nëpër dy kënetë, që nuk thahen kurrë, sipër të cilave hiqen mushkonja që sjellin ethe të tmerrshme dhe çmendi madje. Të gjitha këto duhet t'i kalojmë medoemos,më tha ai dhe shtoi se për të mirën time ishte që të flija ditën e të rrija i zgjuar natën. Këtij ugunsuzllëku mund t'i bëhet ballë vetëm nëse ndërrohet dita me natën...Ia ktheva se ditën do ta bëj ditë e natën natë, i bindur se çështjet duhet përballuar me syqeltësi e jo me perden e gjumit...Kur i thashë këto,pashë fytyrën e plakut si u ngrys vetëtimthi. Mori një pamje të ngrirë dhe tejet të paqartë. Mendja ma thoshte se ato që ia thashë i shihte si pjesë e shqetësimit tim,që ishte në vlim e sipër. I mësuar që të ballafaqohesh me ëndrrat dhe shqetësimet e ushtarakëve të lartë,që andejpari i kishte përcjellë gjatë shumë e shumë rrethimeve,të cilat përfundonin me disfata,i bëhej se përpara kishte njërin nga humbësit e ardhshëm, që më shumë duhej mbrojtur nga dëshpërimi se sa nga ballafaqimi me realitetin, që ishte i njëjtë për të gjithë.“Kjo është hera e pesëmbëdhjetë që bëj të njëjtën rrugë“,foli gjithë dëshpërim.“Dashtë i madhi zot që të jetë e fundit se eshtrat e mia të plakura janë fanosur nga lodhja dhe klima e ashpër e këtyre maleve...” Plaku më tutje sqaroi se për të kishte vetëm dy stinë:pranverën e nisjes dhe vjeshtën e kthimit...Tha se si koha midis të dyjave ishte kohë pakohë, me plot rënkime, dëshpërime dhe mallkime të atyre që humbnin dhe e dinin se çfarë i priste. Dhembja dhe dëshpërimi i tyre, shtoi, ishte edhe dhembje dhe dëshpërim i tij, aq më tepër kur duhej medoemos t'i ngushëllonte me të vetmen përsëritmë se nuk ishin as të parët e as të fundit që e pësonin ashtu... Dikur shfreu rreth dënimit që i madhi e kishte ngarkuar që gjithnjë të shoh të njëjtat gjëra...“Pse vallë,unë qatipi i vogël duhet t'u rri karshi halleve të mëdha të Perandorisë?...A nuk është shumë kjo për një njeri të vockël?...“

Pasi i tha këto plaku zuri sytë më duar dhe më bëhej se dëneste. Më erdhi keq për të dhe e pashë të arsyeshme se duhej ta ngushëlloja disi. Ia thashë ca fjalë nga libri i shenjtë perandorak,por hetova se dëshpërimi i tij nuk kishte nevojë për ato që kishte dëgjuar sa e sa herë,e që i dinte përmendësh,por i duhej e kundërta,pra t'i jepej rasti të fliste e të fliste dhe kështu të lirohej nga një mulla që iu kishte lidhur në fyt prej kohësh për t'iu shtuar nga rrethimi në rrethim sa i kthyer në një ngulfatje... I thashë se mund të fliste çfarë të donte dhe sa të donte pa çarë kokën se ato do të mund t'i hakmerreshin. I trimëruar si fëmija që merret në mbrojtje në çastet e frikësimit lemëritës nisi të hapej.

-Më së vështiri më vjen përsëritja e së njëjtës,foli plaku pasi kishte marrë vetën paksa,-pra ajo që lidhet me secilin që përcjell, kur shoh shenjat e njëjta të shqetësimit,që shprehen me frikë,me siklet dhe me përftime ngulfatëse prej të cilave kërkohet shpëtim...Po shoh zogj të zezë,më thuhet...Po shoh ujë të turbullt...Po shoh akullnaja, ankohen...E unë i gjori duhet t'i ndjek ato çapitje,që jo rrallë shkojnë deri te lemëria e çmendisë... Ç'është më keq,duhet t'i shënoj të gjitha një nga një dhe duke i shënuar të vuaj bashkë me ta...Me dëshirë do t'i leja anash defterët,por ç'e do që Pallati i ëndrrave i kërkon të gjitha,të gjitha,sidomos ndryshimet

që shfaqen nga rrethimi në rrethim...Dhe unë,duke u marrë me ëndrrat dhe përfitimet që shfaqen, prore e takoj të njëjtin kundërshtar,që në atë vend të nëmur na kundërvihet jo me kështjellarët, siç thonë, se na presin sapo kalojmë grykat e fundi dhe na sulen tmerrësisht për të na shkallmuar, por me shpirtrat... Kur shoh se si taborret tona vendosen para Kështjellës dhe xhenierët fillojnë t'i shkrijnë topat dhe bëjnë gati armët e shumta shkatërrimtare, parandiej se ushtria e tyre e shpirtrave është në veprim dhe bën punën e vet duke sulmuar ëndrrat dhe qetësinë tonë...Në këto rrethana vetes dhe vetëm vetës ia pranoj se si bëhet një luftë e pakuptimtë dhe e kotë,përherë e pabarabartë,ku ne njërën anë shpalosen armët e rënda dhe taborret e pafunda të ushtrisë që nxinë gjithë hapësirën deri në liqen,e në anën tjetër pason kundërpërgjigjja tinëzare me ushtrinë e shpirtrave,të rreshtuar padukshëm në të gjitha anët...A nuk është kjo luftë e paluftë,them?...A nuk është koha të mendohet edhe ndryshe për luftën që bëhet kot dhe atë që nuk duhet të jetë e kotë?...Një herë,kur isha i vendosur që të merrte fund mundimi im,qoftë edhe me shkarkimin tim nga kjo detyrë,njërit nga këshilltarët e Pallatit të Ëndrrave si shkarazi i fola rreth asaj se si jemi futur në një luftë të pakuptimtë,pa gjasa për ta fituar nga shkaku se mungojnë frontet dhe betejat,të cilat zëvendësohen me dredhi...Fola pastaj për botëkuptime të kundërta dhe për prirje po ashtu të kundërta brenda të cilave duhet kërkuar të vërtetën e ngecjeve...Fjalën ngecje e thashë ashtu që të kuptohej si disfatë... Për habinë time,këshilltari i Pallatit të Ëndrrave,nuk më gjykoj rëndë,siç pritja dhe as nuk kërkoi ta mbyllja gojën në përputhje me detyrën time,që ishte vetëm të venëroja gjendjet shpirtërore të atyre që i përcjellja dhe t'ua shënoja shqetësimet dhe ëndrrat...Pasi heshti një copë herë, më pyeti gjithë kureshtje se çfarë duhej bërë që njëherë e mirë të merrte fund ky siklet perandorak...Pa një pa dy i thashë se duhet bërë luftë shpirtrash...Ai psherëtiu thellë dhe pasi u mat ta thoshte atë që i ishte lidhur për gjuhe bëri të ditur se të pranosh suljen me shpirtra,është njësoj si ta pranosh se ata janë të pathyeshëm dhe të devotshëm...Libri ynë i shenjtë perandorak nuk e pranon një gjë të tillë. Aty thuhet shkurt e trup se perandorisë nuk ka kush që ia qet dorën para,ngaqë forca e saj është e jashtëzakonshme...Për pak heshta dhe me që hetova se ai kërkonte edhe më tutje të flisja, hezitova të pandehja se duhej pas parasysh edhe çështjet që janë të paprekshme dhe të padukshme e me këtë edhe të paarritshme dhe njëherësh të pamundshme...Ia bëra me dije se ligjet fizike e mbajnë botën,se ato përcaktojnë përmasat e veprimeve, se ato doemos krijojnë rregulla dhe i nënshtrohen logjikës së forcës,por që këtë rregullsi përherë e çrregullon ideja e kundërvënies shpërputhëse që rrënon baraspeshën,të cilën nuk duhet kërkuar në qarkun e lëvizjes, por të shpërqendrimit të energjisë nga forca në frymë me prirjen që të ruhet e njëjta...Tek kjo parregullsi,shtova, duhet kërkuar idenë e flijimit dhe gjithë ato që lidhen me shpirtin si kredhës të energjisë...Isha më se i bindur se kisha shkuar shumë larg me mendime heretike,që nuk e di se si m'u qepen ashtu dhe prej nga më erdhën, dhe se nuk më priste tjetër pos ndëshkimi i rëndë,që do të më shpëtonte nga mundimet e mëtutjeshme...Por, në vend se të ndodhte kjo,hetova se këshilltari i Pallatit të Ëndrrave iku duke çapitur diçka që nuk i merrej vesh...Më nuk e takova këshilltarin e Pallatit të Ëndrrave. Gjatë mendova se ç'ishin në të vërtetë ato që ia thashë atij:mendime të mia, apo pjesë e ndonjë herezie nga ajo që njeriu e bart pa dashje diku në thellësinë e trazuar, por që mundohet ta ndryjë nga shkaku i mosgatishmërisë që të merret me zbërthimin dhe qartësimin e saj,ose pse shpalimi i saj mund të sjell kob?...Mendja ma thotë se çështja e flijimit, e besimit dhe e gjithë asaj që lidhet me ta,nuk është tjetër pos pjesë e kthimit të energjisë në frymë dhe assesi tjetër me të cilën zhdëmtohet mungesa e forcës kundërvënëse...Them se kështu, qenia e tyre është kthyer qëllimisht në një ëndërr të pafund, që hiqet zvarrë mbi kokat tona si gjarpër i zi,i cili tmerron dhe se ai gjarpër,që dikur ishte hyj i tyre,mbrojtës dhe kushedi se çfarë tjetër, t'i gjen doemos ëndrrat siç ua ka gjetur edhe të tjerëve çastin që u janë afruar asaj hapësire...

Kur i thashë se nuk shihja ëndrra,se koka ime me kohë kishte përjashtuar përfytyrimet dhe ato që lidheshin me të,ai më tha se kjo ishte për keqardhje, ngaqë të tillët janë fare të pambrojtur...

Një ditë prej ditësh e arritëm Kështjellën. Lajmëtarët bënë me dorë andej nga perëndonte dielli,ndërkohë që mua syri ma kapi një muranë që shkëputej nga bjeshka e thepisur që dilte aty si një prishje e asaj që mund të quhej harmoni midis tokës dhe ujit. Shpjeguesi i ëndrrave kishte mbërthyer fytyrën imcake me të dyja duart dhe fliste me rënkim:

-Nuk ma shohin dot sytë...

Më shpëtoi një buzëqeshje e lehtë,e cilët m'u bë se plakun e qëlloi më tepër nga përpjekja që t'i ikte shfaqjes së saj.

-Kështu silleshin edhe të tjerët sapo e shihnin... Mendohej se çdo gjë do të merrte fund me një aheng...

Kur hetoi se nuk ia ktheva, plaku u zymtua edhe më. Nisi me folë për jetën me rrethime,që nisnin dhe sosnin njësoj dhe gjithë ato që mbërthente ai rrënim që pashmangshëm mbyllej me dëshpërim çastin që fillonte stina e shinave dhe lagështimi shfaqej për të mbushur hapësirën shurdhe që mbetej e pa pushtuar nga rrethimi në rrethim...Duke e pasur gjithnjë mendjen tek ajo gjendje amullie,që sikur soste dhe niste në të njëjtën kohë, dridhej dhe fliste përçartë për një si mjegullim në të cilën e shihte botën tek sharronte...

Për ta ngushëlluar i thashë se nuk ia shihja për të madhe ligështimin,pas gjithë atyre ecejakeve të pafund,por ia bëra me dije se ky do të ishte rrethimi i fundit...I thashë se do të shkohet më tutje,ndërsa ai do të prehej në qetësinë që e meriton...

-Dashtë zoti!Dashtë zoti! – ma ktheu gjithë ngashërim.

Më në fund u përballa me Kështjellën. Më kujtohet mirë kuqërremi që m'i ngacmoi sytë çastin që nga afër hetova muranën,që dukej sikur të ishte një pemë që ishte degëzuar nga trangu i gurtë për ta sforcuar shpërfilljen që shfaqej në atë hapësirë. Në atë shpërqendrim dritash, në një piring të lartë pashë flamurin me zog të zi në mes si valonte, ndërsa prapa hetoja morinë e ushtrisë që priste urdhrin për të marrë pozicionet përqëndruese prej nga do të fillonin sulmet e njëpasnjëshme me shpresën se do të përfundonin me marrjen e zemrës së saj. Nuk e di se si atë çast nëpër kokë me përftoi ajo që ma kishte thënë Shpjeguesi i ëndrrave për shpirtrat e panumërt që bëhen gati t'u sulen ëndrrave tona sapo t'u afrohem mureve të Kështjellës,kështu që ajo tamam m'u duk si një zog i zi përrallor që pret terrin t'i sulet gjumit tonë...Zogu i zi,mendova,do të ngrihet mbi taborët tona për ta nisur luftën e padukshme,që m'u bë se tashme kishte filluar shtrirjen për t'u pasqyruar nëpër ëndrrat tona deri tek përmasat e lartësisë perandorake, që do të merrte nga shpjegimet që atyre do t'u bëheshin gjithanshëm prej plakut...

Atë natë nuk futa gjumë në sy. Megjithatë, kisha ndjenjën se edhe në atë gjendje, diçka e padukshme sikur po më ngacmonte me fjalë të turbullta ndër të cilat m'u bë se qartësoheshin vetëm ato që bënë të ditur për njëfarë ployë gjaku në të cilën do të ngulfatesha...

Sapo zbardhi dita,që u pasqyrua me një diell tepër të ndritshëm, rrezet e të cilit pas thyerjes në liqen bëheshin edhe më të shkëlqyeshme,komandantëve që po pritnin urdhrin për të nisur sulmin u thashë qetas se atë ditë nuk do të sulmohej.

Hetova se si shikimet e tyre u derdhën mbi mua fare si uji i një lumi të turbullt vërshues,që merr turr prrockave të vogla për t'i shkërmoqur ato që i dalin sa më parë drejt vrullit të nisur...

Edhe për të dytën herë ua thashë të njëjtën dhe ua bëra me dije se ushtria duhej të rreshtohet para Kështjellës pa armë për të pritur ashtu përderisa të merren urdhrat tjera. Theksova se ata duhet të mbajnë shikimet kah Kështjella pa ndodhur që të përgjumen. Shpjegova shkurtazi se edhe sehiri është pjesë e luftës.

Ushtarakët mbetën si të ngrirë dhe nuk u behej t'u besonin atyre që kishin dëgjuar prej meje. Megjithatë,e dinin se fjala ime nuk bëhej dysh dhe shpejt dolën për të zbatuar urdhrin.

Çastin që ushtria e paarmatosur zuri vendet përpara Kështjellës dhe flamujt e shumë perandorak, që valëviteshin nga një erë e lehtë e cila vinte nga ana e bjeshkës, Shpjeguesit të ëndrrave i thashë se ishte koha të bënim shëtitjen e mëngjesit. Ai e kishte të qartë se për çfarë ishte fjala dhe më ndoqi i heshtur si mumie. Fytyra i dukej e zbetë dhe sytë e shtjerua. Pasi lamë kthesën e parë dhe dolëm në anën prej nga shihej liqeni që i afrohej pjesës së skajshme të Kështjellës, plaku nisi të fliste se si lufta nuk do të merrte përgjigjen e parë prej tyre, pa marrë parasysh se sa do t'u afrohen ushtarët mureve të tyre... Më tha se ata me muaj dhe me vite të tëra mund të rrinë kështu pa ndodhur të reagojnë... Pastaj më foli se si shpesh herë e kishte vrarë mendjen pse ndodhte kjo dhe se kishte ardhur tek njëfarë pandehmë se kjo lidhej me bindjen e tyre se ai që qëllon i pari duhet ta ketë humbur durimin dhe besimin në vete... Ia ktheva se ai që nuk sulmohet nuk ka arsye të sulmojë, aq më tepër kur është i vetëdijshëm për gjendjen në të cilën ndodhet dhe se këtu duhej kërkuar edhe arsyet e sjelljeve të tyre dhe assesit tek besimet apo bindjet...

Edhe ditën e dytë dhashë urdhër që ushtria të dilte para Kështjellës dhe të bënte sehir. Të njëjtin urdhër e përsërita edhe ditën e tretë, e dhashë edhe ditën e katërt, dhe ditën e shtatë... Komandantët, që ishin mësuar me luftëra, pa marrë parasysh sorollatjet rreth mureve që përkundër dëmtimeve që ua bënin, nuk i përballonin dot, më shikonin vëngër. Njëri prej tyre, mbase dikur mori guximin dhe nisi të fliste rreth njëfarë mpirje, që tha se shkallmon eshtrat dhe shthur shpirtin... Ishte e qartë se dëshironte, që së paku tërthorazi, të kërkonte sqarime se kur do të përfundonte ajo gjendje e pazakontë, kur pritja shfaqej si luftë... Desha t'i thosha diçka rreth durimit, si sprovë tepër e rëndësishme e çfarëdo nisme, por heshta meqë nuk kisha nevojë të arsyetohesha para askujt rreth atyre që kisha ndërmend të ndërmerrja... Megjithatë, më kohë vërejta, se krahas ushtarakëve, durimin paksa po e humbnin edhe kështjellarët, të cilët nuk ishin mësuar t'i shihnin taborët tona të rreshtuara para Kështjellës tek rrinin të qetë dhe shikonin kah maja e pìrgut të tyre, ku rrinte flamuri me zogun e zi në mes... Nga përgjuesit mora vesh se si ditën e parë kështjellarët nuk u vërejtën fare dhe kjo ishte e natyrshme nga shkakut se tinëzisht përgjonin nga frëngjitë dhe pjesët tjera të gatshëm që sulmeve tona, të cilat rëndom fillonin me hedhjen e predhave nga largësia, t'u kundërviheshin me zbutjen e pasojave si dhe marrjen e masave të shpejta për shërimin e pjesëve të dëmtuara. Ditën e dytë prapë nuk u shfaqën, por hetoheshin lëvizjet e tyre kah pjesa e brendshme e mureve, që mund të merreshin me mend se kishin të bënin me masat për të mos rënë në ndonjë kurth të papritur, ndërkohë që dritën e tretë përfatuan kujdesshëm nëpër përgjimtore dhe në pjesën e skajshme të pìrgut. Një ditë më vonë u panë pa mburoja, ndërsa ditën e shtatë nisen të sillen pa armë dhe fare shlrshëm pjesëve të skajshme, ku paramendohej se mund të fillonin sulmet tona të papritura. Kur edhe kjo nuk ndodhi dhe gjithçka nisi të kthehej në një rëndomëni të pa rëndomtë, një ditë të vetme, sikur t'i kishte lëshuar toka, nuk u panë, në mënyrë që të shfaqen të nesërmen dhe të tjerat thujse kudo, ku ne i parafytyronim përherë tek vepronin nga prapavija. Mendja ma thoshte se ata kishin parë se këtë herë ballafaqimi ynë me ta do të ishte ndryshe dhe se kjo mbase i shqetësonte më shumë nga ajo që pritnin e me të cilën ishin mësuar, andaj këtë brengë ua pasqyronin edhe lëvizjet fare shqetësuese, që ishin më se të dukshme edhe nga largësia prej nga herë pas herë i shoqëruar nga Shpjeguesi i ëndrrave venëroja... E kur ditën e katërmëdhjetë urdhërova që në pjesën veriore të fillonin gropimet përgjatë murit jo më shumë se pesëmbëdhjetë hapa larg tij, ata nuk u dukën më. Tashmë e kishin kuptuar qëllimin tonë dhe nxitonin të ruanin secilën pikë të ujit para se të bëhej vonë dhe të siguronin kalimet e fshehta... Nuk e di pse atë natë urdhërova të binin çallgitë, që kështjellarët nuk patën vështirësi ta kuptonin se këtë herë ballafaqimi ynë bartej nga mbitoka në nëntokë, se fjala ishte për një luftë tinëzare, për t'i shkëputur nga lidhjet e jashtme me botën me të cilat ushqeheshin, ku dredhia do të vendoste fatet e saj dhe jo demonstrimi i forcës së hapur si deri më tani...

Po atë mëngjes, kur ushtarët tanë dukeshin paksa të përgjumur nga ahengu i natës, aty ku gërmonin, papritmas ndeshëm qen të ngordhur. Dhashë urdhër që gërmuesit që u ndodhën aty të helmoheshin me ushqim dhe ndaj mbrëmjes të futeshin në një gropë rrëzë bjeshkës. Kur po e përfytyroja aktin e helmimit të tyre tinëzar, m'u kujtua Shpjeguesi i ëndrrave dhe fjalët e tij për mendjen e tyre të zezë që pjell çmos kur e kanë pisk. Megjithëqë masakrimi i ushtarëve tanë m'u duk tepër i rëndë, puna e qenve të ngordhur më ngushëlloi disi, ngase ishte arma e tyre e fundit, me të cilën ata zbuluan fshehtësinë kryesore të mungesës së burimit të ujit në Kështjellë, rreth të cilit më pat folur Lartmadhëria. Po ta kishin atë, nuk do të shqetësoheshin gjithaq. Pra, me këtë bëhej e ditur se ata nuk ishin të pavarur nga bota, siç mendohej te ne, por përkundrazi, të lidhur me të qenësisht e me këtë edhe të lëndueshëm. Mendja ma thoshte se kisha zgjedhur mjetin e drejtë dhe se koha e qëndresës së tyre ishte në të sosur...

Edhe të nesërmen u shfaqën qentë e ngordhur. Serish dhashë urdhër të helmoheshin gërmuesit që punuan atë ditë. Por që dëshpërimi i tyre nuk kishte kufi ndërkohë që ballafaqimi me humbjen ishte i pashmangshëm dhe fare afër, kjo u vërtetua qartazi ditën e katër, pra një ditë pa e gjetur damarin e ujit, kur pararojat tona zunë pesë veta që po bëheshin gati të futeshin në prapavijën tonë, që kishin përgatitur një dredhi të jashtëzakonshme dhe tepër të rrezikshme, e cila dështoi falë njëfarë parashenjë, që nuk e di se si m'u shfaq si një paralajmërim se ata mund të ishin të sëmurë masuz me detyrën e flijimit, që mikrobet e saj t'i bartnin tek ne. Pra, me t'i zënë kështjellarët, të cilët në saje të asaj parashenje tashmë e dija se ishin të sëmurë, kryeroja erdhi gjithë gëzim dhe më tha se i kishin në dorë ca robër të rëndësishëm, që do të na hynin në punë për t'u argëtuar me ta, por edhe për të nënçmuar kundërshtarët, siç veprohej rëndom gjatë fushatave shterpe, kur shfaqeshin shenjat e lodhjes dhe të dëshpërimit në prag të fillimit të stinëve të shirave, kur tendat mblihdeshin për t'u shfaqur në fillim të stinës së verës. Mend plasa nga tërbimi i atij mendimi, por u përmbajta. Nuk i thashë se ai ishte një kurth i tmerrshëm, që do të na kushtonte rëndë, por urdhërova që kështjellarët aty për aty të nxirreshin buzë liqenit dhe të hidheshin në ujë. Kryeroja që e dinte si veprohej me të tillët, (rëndom nxirreshin në shesh të lidhur, i endnin kah tenda e kaltër dhe pas tri-katër ditësh argëtimi, vriteshin ngadalë), sikur u zu ngushtë. Moti nuk kemi pasur të tillë, tha, por ia preva me fjalët se tash e tutje me kundërshtarët nuk do të tallen...

Fati i kështjellarëve i gjeti edhe rojet tona që patën punë me ta. Dhashë urdhër që të nxirreshin jashtë tendave dhe të vriteshin afër Kështjellës. Kryehafijës ia bëra të ditur që të hapte fjalë sikur ushtarët tanë atë natë kishin rënë në një pritë që kishin vënë kështjellarët dhe ishin masakruar tmerrësisht...

Të nesërmen në mesditë, kryepunëtori ma solli lajmin për gjetjen e damarit të ujit. Shpjegoj se si ai kalonte nëpër një shkëmb e që i kishin rënë në fije në saje të lëvizjes së mive dhe një gjarpri të larmë, që gjatë gjithë kohës ishte përvijuar pranë tyre, sikur të ishte me detyrën e përgjimit... Daullet e përcollën me të shpejt lajmin që e pritnim kaherë, ndërkohë që mua nuk më hiqej nga mendja gjarpri i larmë, që kishte ndjekur rrjedhën e burimit të ujit dhe gjatë gjithë kohës kishte lëvizur disa fishkëllima shurdhe, që u kishin ngjarë ogureve të pakuptueshme por tepër rrëqethëse... Atë pasdite prita komandantët e të gjitha njësive dhe u thashë se njëra ndër betejat më të rëndësishme për marrjen e Kështjellës kishte përfunduar me sukses. Tash që i lamë pa ujë, nuk u duhet edhe shumë të kuptojnë se vetëmbyllja kokëforte, me të cilën mburreshin nuk ishte kurrfarë besimi në forcën e vet të pathyeshme, por prerje e lidhjes me botën e jashtme, prej nga qenësia e tyre ka damarët...

Atë natë mendova gjatë për hyrje-daljet e fshehta në Kështjellë, që ishte më se e qartë se pa to ajo as që do të mund të merrej me mend e lëre më të qëndronte për t'u kthyer në një pikë, ku ngatërroheshin edhe perandoritë dhe çuditërisht derdheshin dhe plekseshin kundërshtimitë e skajshmërive prej nga dukej se fillimi ishte fund dhe fundi njëherësh ishte fillim, varësisht nga këndvështrimi që si pikëmbështetje kishte lindjen apo perëndimin e diellit... Mendja ma tha se Kështjellat e tilla, që u shërbejnë pleksjes së kundërimeve tejet të

ndryshme dhe të papajtueshme fare, praktikisht mbijetimin ia nënshtrojnë forcës së të fshehtës (nga jashtë),që sa më shumë që ruhet dhe sa më e pakapshme bëhet, pashmangshëm ngritët në shkallën e një besimi të pakufishëm... A nuk më kishte folur Shpjeguesi i ëndrrave aq shumë për rëndësinë e misterit të jashtëzakonshëm që gjësendet e atjeshme i mjegullon për aq sa ato duken joreale dhe jashtë funksionit të njëmendët. Ky farë përkufizimi ngatërrues, që të vërtetën e bënte të pavërtetë dhe të pavërtetën e kthente në të vërtetë,nuk ishte tjetër pos pjesë e përcaktimit që përmasat e të njëmendtës të shfrytëzohen që kuptimi i saj të prodhonte mistifikimin e qëllimshëm, i cili pastaj nuk ishte vështirë të ngrihej në pedestalin e një besimi ushqyes... Megjithëqë ky gjykim i shkonte përshtati të menduarit rreth çështjeve të padukshme,që asaj ia shtonin rëndësinë dhe vlerën tutje masës,ishin pikërisht gjërat e prekshme që atë e mbanin dhe e bënin të qëndrueshme, ndër të cilat gjithsesi se hyrje-daljet e fshehta,që sipas të gjitha gjasave duhej të kalonin nëpër liqen,paraqisnin damarët kryesor të qarkullimeve dhe të lidhjeve të saj me jashtë...Kjo pandehmë sikur më liroi nga barra e një mbërthimi,por njëherësh ma shtoi njëfarë etje të çuditshme që më digjte...Ajo përflakje më futi në një kllapi prej nga dola në saje të një ankthi që m'u kishte shkaktuar nga një zjarr që po e përthekonte ngadalë nga dika Kështjellën dhe se për t'i ikur atij zjarri kafshët e egra futeshin nëpër disa zgafelle gurësh prej nga pastaj shfaqeshin në liqen...Brofa në këmbë me bindjen se ishte vetëm zjarri,një zjarr i madh,që duhej ndezur nga të gjitha anët që do të ndihmonte gjetjen e hyrje-daljeve të fshehta të Kështjellës...Nëse gjithësia ka dalë prej flakës dhe në të i ka rrënjët,atëherë pse edhe zgjidhjet e rëndomta të mos kërkohej te kthimi tek ajo?...

Pasi u kthellova paksa thirra komandantin,i cili erdhi me ngut dhe sapo më pa më tha se dukeshja paksa i shkallmuar. I thashë të urdhëronte menjëherë rreshtimin e ushtrisë,gjë që atij iu hap çehra sikur të kishte marrë lajmin e ndonjë fitoreje të madhe.

-Kështjellën ta funti në një rreth të madh dy mijë hapa larg saj dhe ashtu të pritni deri sa dielli të prek cepin e bjeshkës...

Komandanti,që pak më parë dukej i lumtur,nisi të rrudhej, ndërkohë që buza i dridhej.

-Kur ta rreshtosh ushtrinë si të thashë dhe të shohësh rënien e muzgut të parë,urdhëro ndezjen e zjarreve të mëdha përreth Kështjellës që në to të kallet gur e dru. Kur zjarri të marrë hov e të pushtojë çdo gjë,kujdesuni që egërsirat dhe gjallesat tjera të mos kalojnë prapa jush,pra kah bjeshka,por të marrin rrugën kah Kështjella. Përgjoni se nga futen dhe shënjoni mirë të gjitha shtigjet ku ato përbirohen.

Ushtaraku dukej shkërmoq. Nuk ia kishte marrë mendja se do të vinte koha kur ai bashkë me ushtrinë e tij të panumërt do të merrej me punë të tilla...Meqë e dinte se fjala ime nuk mund të bëhej dysh,uli kokën dhe mezi tha se i kishte kuptuar ato që duhej t'i kuptonte.

Dikur tymi gjeti edhe tendën time dhe kjo sikur më futi në një gjendje të njëfarë mpirjeje joshëse që më mbajti gjithë natën prej nga të menduarit për flakën si fillim dhe mbarim të gjithëçkahës nuk e di se pse ma krijonte bindjen se duhej të paraqiste aktin e fundit të sqarimeve të mashtrimeve mbi të cilat ishte ngritur dhe kishte qëndruar ngatërrimi i përsëritjes së të njëjtës...Ndaj mëngjesit u kthjella dhe kur dola jashtë pashë se si flaka kishte mbërthyer Kështjellën nga të gjitha anët dhe tymi i zi tashmë kishte përpirë edhe flamurin e tyre me atë zogun e zi në të,që nuk dukej më. Me bindjen se po i afrohej fundi një shqetësimi të madh,më vonë u ngjita në njërën nga shkalloret e përgjimit dhe pashë se si flaka kishte përpirë çdo gjë përreth Kështjellës dhe ajo tashmë soste rrëzë gurëve të saj prej nga shihej vetëm bloza e zezë. Ajo gjendje seç më turbulloi paksa dhe po të mos ishte komandanti i cili po ma bënte me dije shfaqen e egërsirave, mbase do të ktheja dhe me të shpejtë do të largohesha për t'i shpëtuar atij përfytyrimi trishtues. Dhe njëmend,pas pak u dukën egërsirat e para. Në fillim qenë disa lepuj,që po i drejtoheshin Kështjellës dhe po atë kohë kur egërsirat kërkonin vrimat dhe të çarat shpëtimtare, nga Kështjella u hodhën shtizat e para drejt tyre. Egërsirat e shkreta nuk kishin nga t'ia mbanin ngase nga prapa i ndiqte zjarri e nga para

shtizat vdekjeprurëse. Së voni, kur numri i egërsirave u shtua, ata zunë të hedhin gurë, katran dhe gjëra të tjera. Vetëm atëherë e pata të qartë se ç'rrebeshe të hatashme u kishin rënë përsipër atyre që kishin provuar ta merrnin Kështjellën...

Në atë përpëlitje për jetë a vdekje, dolën edhe dhelprat. Vraponin shpjet dhe gjithë dinakëri. Por asnjëra nuk ia doli t'i afrohej Kështjellës, ngaqë sjelljet e tyre përgjoheshin me kujdes të veçantë nga kështjellarët. Më vonë pashë edhe ujë, pashë derra të egër madje vëreja edhe ca rosa çalamane që kërkonin me çdo kusht t'i iknin zjarrit. E mora me mend se flaka kishte përfshirë çdo pëllëmbë dhe i ishte afruar edhe kënetës. Kundërmimi i rëndë i mishit të djegur sa vinte e shtoej.

-Këso hataje nuk kam parë, -më tha Shpjeguesi i ëndrrave. -Kam parë gjithfarë vdekje, por djetë të tilla të tmerrshme të kafshëve dhe të egërsirave jo.

-Edhe kjo është pjesë e luftës...

-Luftën e di tjetër për tjetër dhe jo të tillë, -ma ktheu plaku duke u kollitur.

-Luftë nuk është vetëm kur vriten njerëzit, por edhe kur vriten ato që i ndihmojnë jetës... Disa gjëra duhet kuptuar drejt dhe pa shqetësime...

-Mëkat, -oshti plaku. -Mëkat. Po vjen koha që luftë të quhet çdo gjë, madje edhe heshtja...

-Pikërisht të tillë e dua luftën...

Plaku kishte ulur kokën dhe thujse dëshironte t'i përjashtonte nga shikimi gjithë ato tmerre për të cilat mendonte që nuk i kishin hije luftës...

Ndërkohë që ai po heshte mora lajmin se kishte filluar lëvizja e buklave drejt Kështjellës. Dhashë urdhër që ato të përgjoheshin me vëmendje të madhe dhe të shënoheshin me përpikëri drejtimit e tyre. Nuk vonoi dhe buklat bashkë me gjarpërinjtë u drejtuan kah ana e rrëpishme e Kështjellës, aty ku shkëmbinjtë masiv derdheshin në liqen. Fërshëllima e gjarpërinjve më vinte në kokë gjithë trishtim, por që njëherësh me lironte nga pesha e ankthit që m'u kishte qepur gjatë natës së kaluar.

-Të ikim që këtej, për perëndi, se plasa! -m'u lut plaku.

Tumira me kokë dhe shkuam nga ana tjetër e Kështjellës, por edhe aty dëgjuam fërshëllima gjarpërinjsh dhe pamë shumë egërsira që dëshpërueshëm vërtiteshin afër mureve të Kështjellës para se të shkrumboheshin. Kundërmimi i rëndë desh ma zuri frymën. Plaku ma dha një shami dhe më tha se ishte koha të mbroheshim nga ai tmerr.

E shikova me miratim dhe fytyra e tij m'u duk si një merimangë e madhe, prej nga tashmë ziente nga shqetësimet e shumë e shumë armatave, që u mbërthyen kotnasikoti në atë hapësirë të vogël, por të ngatërruar pa masë. Merimanga në fytyrën e tij shfaqej me plot ëndrra trishtuese, kishte ankthe dhe përplot përfytyrime, që ishin lidhur një në secilën pjesë të saj. Po të hapej ajo merimangë, mendova, një pjesë e Perandorisë do të mbulohej sa ora me sëmundjen e disfatës së pashmangshme...

Tek tenda plaku foli e më tha:

-Kur do të ndalet ky zjarr i mallkuar?

-Sapo të arrijë fundin.

-Tash e kam të qartë këtë hata.

-Është pjesë e luftës, që e përjashton disfatën...

-E qartë. Por, a është e thënë që çmimin e saj ta paguajnë kurdoherë njerëzit dhe egërsirat?...

-Tek e fundit ky është fat i tyre i përbashkët...

-Gjë makabre, -oshtiu plaku.

-Megjithatë, këtë herë, kjo luftë do të fitohet pa çmimin e viktimave në njerëz. A nuk të ngushëllon kjo?...

Plaku sikur u zu ngushtë. Nuk ia merrte mendja se lufta merrte fund me kaq. Edhe ato që ia thashë më vonë rreth dorëzimit të pashmangshëm nesër a pasnesër nga mungesa e ujit dhe e furnizimeve të jashtme, sikur nuk i hynin në kokë dhe i merrte me dyshim.

-Nuk ma thotë mendja se gjithçka mori fund...Nuk më bind njeri se këtejpari nuk do të ketë më luftë...Luftërat këtu kanë nisur mu atëherë kur dukej se janë në të sosur...Këtu sikur nuk bën pa ndonjë luftë apo ngatërresë të madhe,që përcillet me shpjegimet që më së paku i përkasin luftës...

Ai dikur më tha se edhe po të ndodhte që Kështjella të merrej dhe të mos ishte më dhe që shenjat e saj të mos dukeshin gjëkund, ajo do të shfaqet si hije,si përfytyrim apo si diç tjetër,që do të ushqejë ato pa të cilat nuk mund të jetohet në pjesët e kundërta të botës...Më tha se botës i duheshin kështjellat e tilla për t'i nxitur lëvizjet e domosdoshme kah njëra apo tjetra anë...Pa to do të rrënohej baraspesha e forcës...

-Të kanë bezdisur rrethimet e shumta,-i thashë,-kështu që gjithçka e saj të duket si pjesë e një nyje pa të cilën nuk bën...Mbase nuk ke faj?...

-Pashë shumë luftëra,pashë shumë rrethime,pashë shumë sorrollatje dhe po aq dëshpërime, - ma ktheu ai mundimshëm.

-Tash e tutje do të jetë ndryshe,-i thashë.-Lufta do të bartet nga logu i betejës kah ndeshjet e padukshme,por që sjellin fitore të pashmangshme...

-Kjo sikur nuk më besohet... Ky mund të jetë ndonjë mashtrim dhe hiç tjetër...

-Ke parë luftëra të tjera,që për nga dështimet i kanë ngjarë njëra-tjetrës sa ty të është bërë se ndodhesh në një rreth të mbyllur ku gjithçka sillet njësoj. Tash po sheh se nuk po përdoren topat dhe as nuk po ndërmerren sulme të njëpasnjëshme,që të shumtën përfundonin pranë mureve të saj. Në vend të tyre po sheh pritje,po sheh zjarr dhe po dëgjon të flitet për kalimet nëntokësore, që duhet të gjenden dhe të priten,për t'u shkëputur lidhjet e tyre me botën, pikërisht ajo që i ka mbajtur gjallë dhe i ka kthyer në shëmbëllesë. Ne pra, do të përdorim dredhinë dhe ata duhet të zgjedhin shkallmimin e pashmangshëm, apo, sapo të humbin durimin, të sulmojnë dhe kështu të bëjnë vetëvrasje. Rrugë tjetër nuk ka...

-E po qe se nuk zgjedhin as njërën e as tjetrën?...

-Dika duhet t'ia mbajnë...Tek e fundit tashmë kjo edhe nuk ka ndonjë rëndësi të madhe...Sido që veprojnë do të jenë vetëm humbës...

Ai serish heshti. Mbase dëshironte të ma përkujtonte çështjen e shiut dhe mundësitë tjera që diheshin dhe nuk diheshin që përherë shfaqeshin përballë mbijetimit të me çdo kusht, por druante se përgjigjet e mia të gatshme,do ta rrënonin edhe më tepër. Pasi që i thashë se ishte koha paksa të çlodheshim nga ato që na kishin ngarkuar aq shumë kohëve të fundit dhe pasi ia bëra me dije se çastin që do të përfundonte fushata do të nderohej me pushimin e përhershëm, plakui më shikoi si i thyer dhe më tha se nuk i bëhej kur dëgjonte premtime të tilla,ngaqë ato ia përkujtonin të ngjashmet, që përherë i ishin bërë para se të arrinin Kështjellën,prapa të cilave vinte kobi...

I thashë se këtë herë ato do të përmbusheshin dhe ai do të prehej në qetësinë e merituar...

-Sidoqoftë,-mërmëriti plakui,- për mua dhe shpirtin tim nuk ka qetësi, ngaqë kam parë si shumë disfata dhe kam përjetuar shumë dëshpërime...Koka ime përherë do të ndiqet nga sikleti i atyre që dëshironin shumë dhe arrinin pak apo aspak për të përfunduar në zhgënjim të plotë...Më bëhet se qenia ime është e mbushur plot e përplot këso dëshpërimesh dhe oshtima thyerjesh,lutjesh,rënkimesh dhe mallkime madje...Për mua edhe marrja e Kështjellës,edhe shuarja e saj e plotë, edhe shkatërrimi i çdo gjurme jete në të dhe përreth saj assesi nuk do të thotë fund i luftës,ngaqë këtë nuk e len prania e frymës së dy boteve për mbizotërim të pareshtur, që këtu shtrihet prej shekujsh si baraspeshë,por edhe si mallkim...

-Të gjitha këto i di, plak i mirë. Të gjitha i di... Megjithatë,jam këtu për të treguar të kundërtën,se baraspesha e forcës,që e ka ruajtur Kështjellën nuk është më, nga shkaku se atë e ka rrënuar gatishmëria dhe vullneti që të shkohet tutje asaj pike që përherë është shikuar si nyje prej nga është menduar se fillimi i njëjës anë njëherësh paraqet edhe fundin e tjetrës anë dhe të kundërtën...Nëse dikur kjo hapësirë dhe kjo Kështjellë,si e askujt, u është deshtë edhe atyre që dëshironin të shkonin tutje saj, por që kësaj nuk ia dilyn nga shkaku i shpërputhjeve

me synimet e tyre, e u është deshtë edhe tyreve që me çdo kusht dëshironin të mbroheshin nga ana tjetër,nga shkaku i mos aftësisë që të shkonin tutje saj,sot kjo më nuk vlen,meqë ne jemi të gjykuar të prishim këtë asnjësi dhe të shkojmë tutje që lindja të bëhet perëndim dhe perëndimi të kthehet në lindje, sepse vetëm kështu bota do të jetë e drejtë, e qetë dhe e lumtur dhe pa ato që deri më tash e penguan dhe e mbërthyen kah ngecjet dhe prapësitë...

Fola edhe më tutje rreth atyre që nuk e di se pse kisha nevojë t'ia thosha një plaku të shkallmuar dhe të frikësuar,i cili isha i bindur se nuk më merrte tjetër për tjetër nga ata që kishte parë edhe ata që kishte përcjellë sa e sa hera,pos që më shikonte me keqardhje...

Kur po largohej më tha:

-Sonte,patjetër ëndërro diçka...

Të nesërmen u zgjova herët dhe pashë si bloza e zezë i kishte mbuluar tendat tona me një tis që ato i bënte të dukeshin të zymta. Pushi i zi,që ishte përhapur gjithandej deri te pjesa e bjeshkës edhe Kështjellën e kishte bërë pjesë të atij terrimi prej nga u lirua me vështirësi vetëm atëherë kur dielli u ngjit lartë dhe rrezet e tij të forta,të thyera nga liqeni, iu përplasën mureve të nxira. Duke e parë ashtu si një zog me krih të thyer të paaftë që të ngrihej kah lartësitë, urdhërova të fillonin gërmimet e thella,që nuk do të pushonin err e terr. Komandanti serish u prish në çehre me shtrëngimin e luftës së pa luftë që bëhej,të cilën ai e bluante,por nuk guxonte ta shprehte. Kur po largohej m'u bë se po më thoshte se ndërrimi i armëve me veglat e punës edhe fitoren çfarëdo qoftë e bënte të pahijshme...

Pasdite,i shoqëruar nga Shpjeguesi i ëndrrave, u ktheva te pjesa veriore,ku bëheshin gërmimet e para. Një hendek i gjatë,që tashmë kishte zënë të shfaqej,m'u bë si një gjarpër përmasash përrallore,që rrëshqiste ngadalë për ta mbërthyer Kështjellën. Ky përfytyrim m'u duk edhe më i përafërt qysh se kisha marrë vesh se gjarprin e kishin pas shenjtëri me besimin se në prag të derës,ruante shtëpinë si dhe frymët nga e liga. Mendja ma tha se gjarpri që i kishin besuar,që e mbanin tek pragu i shtëpisë,tash bëhej gati t'ua zinte frymën dhe me këtë u rrënohej besimi i moçëm...Dikur syri ma zuri zogun e zi në flamur,i cili nga tymi dhe bloza ishte shpërfillur fare. Edhe ai,mendova, është pjesë e atij besimi,që lirinë e përkufizon në lëvizje edhe përkundër faktit se Kështjella dhe mbetja në të nuk paraqiste tjetër pos një ngecjeje e cila kundërshtonte lëvizjen... Nuk e di pse m'u tek që plakut t'i thosha se ai shpend shpejt do të bjerë përdhe për të mos u ngritur fare,por mbase ishte shtytja e të menduarit rreth luftës tinëzare kundër besimit të tyre që kisha zgjedhur ajo që më shtynte të flisja edhe ato që nuk duhej t'i thosha para kohe...Sikur ta kishte hetuar tundimin tim,plaku heshti. Hetova se si shikimi nga lart i ra poshtë tek istikamet prej të cilave tashmë lirohej një tis i hollë avulli që përhapte kundërmim toke të kalbur. Pas pak ai u gjunjëzua dhe mori një grusht dhe,që zuri ta shprishte me gishtërinjtë e thatë. E mbajti një copë herë dhe më tha se ai ishte si shumë i rinuar me gjak...

E shikova me dhimbsuri, ngaqë ishte e kotë ta shtyje të mendonte ndryshe. Koha e kishte bërë të vetën dhe ai vështirë se do të lirohej nga ankthi i disfatave,me të cilat ishte mësuar gjatë e gjatë...

-Serish do të derdhet gjak... Këtë po ma thotë kundërmimi i kësaj toke...

Plaku la dheun dhe shikimin e derdhi në liqen,mu në atë pikën ku mjegulla e lehtë dukej se mbytej në ujë. Dikur foli e tha:

-Sa do të jetë i gjatë ky hendek?

-Nuk i dihet... Do të shkohet nga përroska e vogël për t'u kthyer te shkëmbi i lartë,mu nën muranë. Mandej, shohim e bëjmë. Tash për tash kjo është pika më e dyshimtë,prej nga doemos fillon ballafaqimi me nëntokën e tyre dhe të papriturat e saj...

-Do të thotë se do t'i qasemi territ të tyre, që të bëjmë t'ua ndalim dritën?...

-Ashtu disi...Do të futemi thellë e më thellë në të për ta qartësuar se nga i shkojnë damarët...

-Po qe se gërmuesit do të bredhin kot së koti nëpër katrahurë në kërkim të atyre burimeve, ose damarëve, që thuhet, a do të pranohet dështimi, që nënkupton kthimin tek armët dhe sistemi i deritanishëm i luftërave?...

-Dështim nuk do të ketë, e as kthim tek armët nuk do të ketë...Këtë herë do të mbesim tek nëntoka, tek terri dhe pushteti i tij përderisa të gjejmë ato që kërkojmë, pra lidhjet që i mbajnë gjallë dhe i bëjnë të duken të pathyeshëm...

Plaku nuk foli më mbase nga droja e keqkuptimit se me dyshimet që shprehte sikur ishte aty që të mbyllte kurdoherë shtigje në të gjitha anët.

Tek përroska anësore shumë gjarpërinj dhe bukla nxitonin kah një e çarë në pjesën e rrëpishme të gurit, ku tashmë kishte shumë gjurmë gjaku. Një copë herë shikova gjakun e trashur dhe sa më shumë që vëreja më bëhej se egërsirat që përvijoheshin nëpër pllajën e gjakut për të shkuar tutje kah e çara e padukshme paralajmëronin diçka të kobshme. Dhe nuk vonoi dhe një gjëmë që erdhi nga ana e djathtë më trishti.

-Na vranë!.. Na vranë! – po çirrej njëri që vinte me të shpejt nga ne.

Shpjeguesi i ëndrrave më zuri për krahu sa hetova gjithë peshën e trupit të tij si lëshohej në mua.

Ushtarakët kërkuan shpjegime, ndërkohë që ai nisi të sqaronte më tutje:

-Punët po na shkonin mirë, kur pa një pa dy, një breshëri shigjetash na u derdh përsipër. Aty për aty vdiq kryeinxhinier me dy ndihmësit...

Kërkova të shkonim tek vendi i fatkeqësisë. Rojet që më shkonin para dhe prapa me qëllim që të më mbronin nga të papriturat që mund të vinin nga ana e tyre, nuk më lanë ta shihja mirë gjithë atë që kishte ndodhur. Megjithatë pashë letrat e tyre me plot vija lakadredhe që nga gjaku dukeshin të kuqe dhe të përhumbura...

Në të kthyer Shpjeguesi i ëndrrave më foli gjithë ngashërim se nuk kishte hetuar kot aromën e gjakut... Më tha se parandiente diçka të tillë, ngaqë këtu pa gjak nuk bën asgjë... Isha si shumë i tronditur për të gjetur ndonjë përgjigje që do ta qetësonte plakun, sado që isha i bindur se kështjellarët, të shtyrë nga përpëlitja e fundi të mbronin atë që nuk mund ta mbronin më, kishin bërë një gabim të pafalshëm...

-Është lehtë të bëhesh vlerësues zyresh dhe të vesh gjithfarë vijash nëpër letra e harta, - vazhdoi plaku. - Raportet mund të shkruhen edhe pa qenë afër luftës. Ka kalemxhinj të shkathtë që gjërat i teletisin aq bukur sa ta merr mendja se rrota sillet me një të prekur dhe gjen pikën e dëshiruar...

-Kështjellarët ranë në kurthin e vet. - fola pas pak. - Bën një gabim që do t'ju kushtojë me kokë. Me t'ju qëlluar inxhinierët tanë, ata pranuan se gjendemi mu aty ku dhemb dhëmbi, pra fare afër vendit nga përshkohet kalimi i fshehtë, që ata i lidh me botën, që i mban gjallë. Po të mos vritnin patjetër se nuk do të na bënim me dije se ndodheshim në gjurmë të asaj që kërkojmë, sado që ne nuk do të ndaleshim pa e gjetur...

Plaku po qante.

Po atë mbrëmje xhenierët i varrosëm atje ku gjaku i tyre preku tokën. Urdhërova që varret të rrethoheshin me shumë qirinj sa të ngrihej një dritë mortare, që do të dukej nga larg, me të cilën atyre u përkujtohej kobi që e kishin fare pranë...

Kur po kthehesha nga varrimi pashë Shpjeguesin e ëndrrave që ecte si i thyer. Një tis i zi rreth syve ia bënte edhe më të mugët fytyrën, gjë që më erdhi keq që po e shihja në atë gjendje. E zura për krahu dhe hamendesha sesi ta ngushëlloja: së pari t'ju flisja për disfatat që nuk do të shfaqeshin më, apo për ndonjë përfytyrim, që do t'ju duhej. Më në fund zgjodha atë që atij kohëve të fundit i ishte ngjitur si ilet dhe i thashë se varre do të kishte, se do të kishte edhe vdekje, se do të derdhej ende gjak në të gjitha anët, por që e gjitha do t'ju nënshtrohej lëvizjes së pashmangshme, që doemos ka çmim, shpesh edhe të lartë, por që ia vlen...

Zuri të më shikonte pak më ngrohës.

-Këto varre që u hapën sonte, do të mbesin në kujtesën perandorake,si diçka e çmueshme dhe për to në të ardhmen do të flitet aq shumë saqë legjenda e murimit bashkë me të tjerat që këtu qarkullojnë në të gjitha anët do të zvetënohet deri në harrim. Kështjellarët e ardhshëm përpara do të kenë vetëm tre varre për të cilat do të luten, do të flasin dhe do të këndojnë pareshtur...Legjenda perandorake nuk do të mbyllet vetëm midis këtyre shkrepave për t' u folur e përfolur sipas tekeve të trashëgimive,por ajo do të jetë e shkruar si histori e një sakrifice të shenjtë, që lidhet me lëvizjet e perandorisë kah lindja dhe kah perëndimi drejt asaj madhështie që do ta mahnitë botën,që do të frymëzojë dhe do të udhëzojë njëherësh...Mendja ma thotë se nesër a pasnesër,kur të shkojmë atje ku duhet të shkojmë, këto varre nuk do të shënjojnë më pikën e skajshme të perandorisë,ku ndodhet tash, por mesin e saj,atë mes që fundin e bën fillim dhe fillimin fund, gjendje kjo që e tillë duhet të mbetet përgjithmonë...

-Pra,kjo do të jetë një luftë shpirttrash?-m' u drejtua plaku me bindjen se me ato që flisja i isha kthyer asaj që atë përherë e kishte preokupuar dhe kishte menduar se është e vetmja armë që ndihmon.

-Po çfarë bëj unë?-ia ktheva.-Kot merrem me ujin?...Kot merrem me kalimet e fshehta?...Po të mendoja ndryshe do të sulmoja siç u veprua deri më tash pa ndonjë sukses. Synoj që sa më parë të humbet besimi në vetvete, pra të shihet se ata janë pjesë e një vegeze midis boteve, që më nuk do të jetë e tillë, dhe sapo të ngjajë kjo, atëherë nuk duhet drujtur më nga shpirtrat për të cilët flitet err e terr si për një shenjtëri që përsëritet e rilindur pas çdo rrethimi, por për një ballafaqim me një realitet të ri...

Më vonë i fola edhe për kronikat e reja që do të shkruheshin prej këtu dhe do të lidheshin me këtë vend si për një nyje të një besimi të ri, që në të vërtetë nuk do të jetë tjetër pos shfaqje e gjendjes së një vlere të përgjithshme, që del nga mbretërimi i pikëpamjeve të ndryshme në kohë dhe hapësirë...

Plaku më dëgjoi me aso kureshtje sa mendja ma thoshte se ai nga çasti në çast shkrihej si një qiri që lufton me terrin për ta mundur atë. Kur u largua nuk foli fare, përshëndeti lehtas me dorë,sikur dëshironte të ma bënte me dije se i vinte mirë që brenda për brenda asaj vlere të përgjithshme ai do të mbetej i përsëritshëm dhe i përhershëm, gjë që si Shpjegues i ëndrrave, mund të merret me mend se përherë kishte qenë pranë kësaj gjendjeje,se e kishte ndjerë atë,se ishte përpëlitur me shqetësim e saj, e të tjera e të tjera,por që nuk kishte guxuar ta shprehte nga frika e herezisë... Kjo pandehmë sikur ma krijoi përshtypjen se Shpjeguesin e ëndrrave e kisha pranë si hije, që herë pas herë më pyeste për tri varret dhe legjendat e reja,që më bëhej të thoshte diçka rreth madhështisë së legjendave,por për më tepër denjonte të dinte rreth njëfarë pike,që e quante nisma dhe sosma e çdo gjëje,prej nga çasti mund të kthehej në mijëvjeçar dhe mijëvjeçari në çast në përputhje me të kuptuarit të qenit në kohë... Dikur m' u bë se hija e plakut u formësua e tëra dhe ai po më rrinte përpara, por tash fare i qetë dhe kështu ndodhi përderisa iu dhashë një kllapie që më mbajti deri në mëngjes...

Kur u zgjova më thanë se Shpjeguesi i ëndrrave kishte vdekur. E kishin gjetur të pajetë skaj varreve të reja me një libër në dorë,pasi që pak më parë, një shtizë e hollë,që kishte ardhur nga ana e Kështjellës, tejprtej ia kishte çarë kraharonin e thatë. Qiriu që kishte pasur pranë lëshonte një flakë të zbetë,ndërkohë që një curril i hollë gjaku,që soste aty ku plaku mbeti pa frymë,kishte rrethuar tri varret ende të freskëta...

Me t' u larguar komandanti,të cilit ia dhashë udhëzimet si duhej vepruar që plaku po atë ditë të varrosej aty ku kishte gjetur vdekjen, nëpër kredhjen e mjegullimit që më mbërtheu në atë kreshpërim, serish m' u shfaq Shpjeguesi i ëndrrave,i veshur me të bardha,me mjekrën e gjatë që ia prekte tokën...Mu bë se më thoshte se dëshironte të bëhej pjesë e legjendës dhe se kjo i takonte...

“Kush u ndesh më shumë se unë me hallin e Perandorisë?... Kush u ngarkua më shumë se unë me brengat dhe shqetësimet e saj?...A nuk e meritoj të prehem aty ku edhe më tutje do të bien ndesh shpirtrat e dy botëve dhe besimet e tyre?...“

Fjalët e tij po shuheshin dhe kur ato po tretnin fare m'u bë se më tha se si në varrin e tij,herë pas here, do të dalin lule të zeza si paralajmërim rreth kobëve të papritura me të cilat mund të ballafaqohet Perandoria...

"Keni kujdes lulet e zeza mbi varrin tim...Keni kujdes!...Ato paralajmërojnë kobët e përhershme..."

Kur dielli theu rrugën kah bjeshka e varrosëm Shpjeguesin e ëndrrave. Në të kthyer,gjatë gjithë rrugës, sikur më bëhej se plakun e kisha pranë tek më fliste për vdekjet që do të vinin patjetër.

"Lufta edhe mund të humbet pa viktimë,por nuk ka fitore pa mund dhe pa viktimë..."

Dhe njëmend,nuk vonoi,e ne u ballafaquam edhe me vdekje të shumta, që sa vinin e shtoheshin. Shtatë ditë pas vdekjes së Shpjeguesit të ëndrrave ndodhi që u shemb tuneli kryesor,që kishte zënë mbi dyqind veta që po punonin. Komandanti që ma solli lajmin më foli për një hata të tmerrshme,që nuk ishte parë ndonjëherë andejpari...

Jashtë hetova shikimin e ftohtë të ushtarakëve,të cilët sigurisht se në vete bluanin mllëfin rreth humbjeve që pësoheshin jo nga armët dhe fushëbetejat, siç u ka hije ushtarakëve, por nga argatllëku dhe veglat e punës,që u ishin kthyer në mjete luftime. Pa ua vu veshin eca dhe m'u bë se në atë mospërfillje u ballafaqova me një akullnajë të furishme që po më mbërthente bashkë me taborët që shtriheshin të heshtura në pjesën e poshtme të rrugës. E dija se ky ishte një ligështim që gjithsesi duhej përballuar në luftë me vetveten, pa ndodhur që më asgjë të jepja shenja dëshpërimi. Megjithatë,në ecje e sipër,ndjeja se si në kokë po më hapej një vrimë e madhe si një e qarë e pafund,që në rritje e sipër po jepte shenjat e shembjes nga të gjitha anët dhe se çuditërisht atë shembje e pritja, ngase ishte paga e pashmangshme që duhej t'i paguhej triumfit përfundimtar mbi Kështjellën. Sikur të kaloja nëpër një pahintikë të cilën e njihja,përfytyroja kështjellarët që bëheshin gati të shembnin dhenë mbi gërmuesit sapo ata t'u afroheshin kalimeve, sado që me vdekjet tona në të njëjtën kohë do të nënshkruanin humbjen e përhershme... A nuk ishte ky çmim tepër i vogël ndaj një fitoreje historike,të cilën Perandoria e priste ç'prej kohësh?...

Atë pasdite thirra komandantët dhe u thashë:

-Rruga drejt Perëndimit u hap...

Sapo ra terri, fare padiktueshëm mora rrugën e Kryeshehrit. Zgjodha natën, se dëshiroja një gjumë të thellë e të gjatë sa vetë rruga. Por, gjumi i dëshiruar nuk më mori që nuk më mori. U përpoqa t'i jepesha plogështisë,po as ajo nuk më ndihmoi nga mendja t'i hiqja gjërat e tepërta dhe ato që tashmë nuk duhej të kishin vend në të. Përkundrazi, sa më shumë kalonte koha (edhe pse më bëhej se kisha sharruar në një kotësi),koka më zinte nga një lëmsh i madh dhe më digjte si të kishte zjarr në të. Dikur m'u bë se ai zjarr po më pushtonte të tërin bashkë me karrocën dhe ata që më shkonin pas. Një çast seç më erdh të çirresha me sa forcë kisha,por hetova se nuk kisha zë!Në gojë e në fyt më sillej njëfarë shurdhimi,që nuk më hiqej se nuk më hiqej. Në atë angështim,m'u duk se dëgjova një zë,që si jehonë e thellë, vinte nga një largësi e paanë dhe përplasej në karrocën që digjej. Ai zë sikur afrohej e afrohej dhe qartësohej,saqë një çast e njoha. Ishte Shpjeguesi i ëndrrave, i cili po më thoshte se po shkoja kah një fund,ku do të bashkoheshim përgjithmonë...

"Rrugët tona nëpër mjegull nuk do të kenë të ndalur..."

Në atë përpëlitje më bëhej se plakun e kisha pranë,fare pranë dhe se dikur më pyeti se çfarë kishte ndodhur me *Kullën e Harresës*?...

Rrudha krahët sikur të kërkoja sqarime rreth atyre që dëgjoja për herë të parë.

„Është koha t'i kuptosh më në fund disa gjëra. E di se do të dëshpërohesh,por ç'e do që pate fat të tillë“...

Pas një heshtje të shkurtër,që m'u duk shumë e gjatë,sikur më tha:

„Ç’prej kohësh je i paqenë...Te ti ka folur një qenie tjetër. Qenia e *Kullës së Harresës*. Qenia e njeriut, që nuk duhet të ketë as të djeshme e as të pardjeshme,pos të sotme kalimtare dhe të nesërme të kurdisur...”

Desha t’i thosha se kishte gjetur një mënyrë aspak të hijshme të më hakmerrej për veprimet e mia rreth Kështjellës, me të cilat ai nuk pajtohej, por goja ime, në pamundësi të lironte lëmshin që i ishte zënë, nuk nxjerri tjetër pos një shurdhim mbyttës...

Si ta kuptonte atë që nuk ma qiti goja,më tha:

„*Kulla e Harresës* të zhveshi nga qenia jote dhe të zbrazti të tërin çastin që të mori në dorë dhe ti ia nise nga fillimi,sipas urdhrave të saj të përpikta... Kështu, gjatë zbrazjes së furishme, që mund të quhet shlyerje e turit dhe rimbushje e ngadalshme apo rishkrim, kalove nëpër zyrat e *Kullës*,për të cilat di vetëm Perandori. Në ato bodrume ka kohë që veprohet kundër kujtesës së veçantë me synimin e *krijimit të njeriut të ri, njeriut perandorak*,që si i përparë nga vetvetja,t’u shërbejë verbërisht qëllimeve të saj të larta. Kështu, nga kështjellari që ishte,pasi t’u shlyen ato që kishte në tru,sipas nevojës, u ktheve në një urrejtës të vetvetes. Të bënë të tillë që të luftosh me mish e me shpirt kundër Kështjellës...Si krijesë e kurdisur,e përparë dhe e mbushur me vullnetin e pashembullt për fuqi, falë përkushtimit tënd të jashtëzakonshëm,Perandoria ia doli të fitonte një luftë në të cilën,për rreth një çerek shekulli, pati jo më pak se njëzet e tri disfata rresht...

Megjithëkëtë,s’që e mundur që gjithçka të dalë ashtu siç që paraparë. Ngjanë disa gabime të vogla,të cilat ia ngatërruan hesapet *Kullës së Harresës* për atë sa të dështojë,ndërkohë ti mbete as andej,as këndej,as me qenien e mirëfilltë e as me atë rikrijuar... Mbetë i mallkuar përgjithmonë... Përgjithmonë... Edhe përkundër këtij dështimi Perandoria,megjithatë, ruan *librin e fshehtë*,në të cilin bëhet fjalë për tjetërsimin tënd,për rimbushjen dhe rizbrazjen e çuditshme dhe për mallkimin...

(Jeta dhe vdekja e Daut Pashë Shkodranit,hartuar nga *Kulla e Harresës* dhe e përcjellë me shënime tepër sekrete)

1.

Daut Pashai u kthye fitimtar ditën e parë të vjeshtës së hershme. Kur doli para Pallatit të Praruar dukej si i përgjumur. Një copë herë shikimi i brodhi nga kaltërsia e detit dhe ndoqi fluturimin e ca pulëbardhave që po shkonin nga perëndimi. Vetëm atëherë Pashai hetoi se para kishte shumë veta që po e përshëndetnin,që po i përkuleshin thellësisht,që po i hidhnin lule të bardha nga të gjitha anët dhe që ai duhej të ndiqte shtrirjen e qilimit të kuq,i cili shkonte drejt brendisë së Pallatit të Praruar. Kuqërremi i atypëratyshëm që iu përplas syve, i nxori një të dridhur të lehtë, që i la pas ndjenjën e zjarrmisë sa nxitoi të çante përpara prej nga e dinte se së shpejti,si edhe herën e parë,do të ballafaqohej me fronin e praruar dhe të tjerat që i përkisnin atij...Kur qilimi sosi dhe përpara i dolën sexhadët e mëdha ngjyrë çela, pa ngritur fare shikimin,nderoi në drejtim të fronit të madh. Por kur u drejtua hetoi se Lartmadhëria nuk ishte në të,por po e priste i ngritur bri shkallores së madhe,prej nga e kishte përcjellë për në *Tokën e Lashtë* dhe i kishte dëshiruar fat dhe kthim të mbarë. Lartmadhëria e mori ngryk dhe po i thoshte diçka që ai nuk ishte në gjendje ta kuptonte nga jehona e fanfarave dhe tamtamet e daulleve që shpërthyen nga të gjitha anët. Me dëshirë do të ulej, që të përballonte më lehtë zallahinë që po e përpinte,por e dinte se këtë nuk mund ta bënte, së paku përderisa Lartmadhëria vazhdonte t’i fliste diçka për fitoren e madhe dhe për hapësirat e pafunda që shfaqeshin pas saj...Vetëm kur hetoi se Lartmadhëria ia vuri një dekoratë me rreze të praruara në gjoks, me çka mori fund edhe jehona e fanfarave, iu bë se shpëtoi.

Daut Pashai mezi priti të ulej. Edhe pse i shkallmuar dhe me vëmendje të shpërqendruar, *dukej krenar* *.Sytë ia pasqyronin një rrezatim të jashtëzakonshëm,që u ka hije vetëm njerëzve të krijuar për fronet më larta. Pashai nuk foli as kur e pranoi dekoratën,e as kur mori vesh fermanin e lartë me të cilin emërohej kryezir i Perandorisë. I ngrirë dukej edhe kur iu përkulen ministrat dhe i parakaluan një nga një ushtarakët e lartë, këshilltarët e shumë si dhe ulemaja...

- Ç'kështjellë e mallkuar që ishte,- po i thoshte Lartmadhëria.-Qemë kyçë aty si të mpirë dhe assesi nuk lëviznim përpara...Ishte një sëmundje ajo që na e kishte mbushur shpirtin me plogështi...Ishte një si mallkim i papërshtatshëm sikur të qe vendosur qëllimisht në atë vend për të mbjellë farën e dyshimit...Ku do të ishim tash po mos ta kishim para atë pengesë?...

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

* ...dukej krenar:

... *Pashai dukej tepër mospërfillës,gjë që krijohej përshtypja se nuk i bënin përshtypje as fjalët e Lartmadhërisë...Seksioni i qëndrimeve është dashur ta kishte parasysh edhe çështjen e qëndrimit të Kryeziritit çastin që do të emërohej në atë post në mënyrë që sjelljet e tij të mos lenin në hije Lartmadhërinë,siç ndodhi....Lëshimet e ngjashme nuk bënë të përsëriten...*

2.

Vezirët pritnin me shqetësim Kryezirin e ri.Ca prej tyre thyenin gishtërinjtë e të tjerët rrinin të rrasur në minder. Të gjithë e dinin se fjala ishte për një njeri të jashtëzakonshëm,i cili kishte bërë atë që s'e kishin bërë shumë e shumë të tjerë edhe përkundër armëve më të forta dhe taborëve të pafund, që kishin me vete. Andaj e kishin fare të qartë se kishin të bënin me dike,fjala e të cilit nuk e bëhej dysh as nga Lartmadhëria,që për rrethanat e reja shfaqej si pushtet mbi pushtet...

Daut Pashai, me ca letra në dorë, hyri thuajse i paparalajmëruar. Përsëritet ftohtas dhe u ul në shilten ballore sipër së cilës qëndronte vetëm stema perandorake.

Një copë herë mati më shikim ministrat dhe vetëm pasi kaloi nga njëri tek tjetri foli e tha:

- Lufta jonë ende nuk ka marrë fund. Madje, sipas disa të dhënave të besueshme, *Perandoria po ballafaqohet me shumë rreziqe të reja** . Ato, deshëm a nuk deshëm, na detyrojnë të shpallim shtetrrëthimin bashkë me gjendjen e jashtëzakonshme. Është koha që,më në fund, ushtarakët, me veprime e tyre, të përkujdesën për ruajtjen e asaj që u arrit pas shumë e shumë kohësh...

Kaq tha Kryeziri dhe mbylli mbledhjen...

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

*... *Perandoria po ballafaqohet me shumë rreziqe të reja:*

Gjatë takimit të parë me Lartmadhërinë menjëherë pas mbledhjes me vezirët,Daut Pashai shtroi planet e hollësishme rreth atyre që duhej bërë në Tokën e Lashtë pas shpalljes së shtetrrëthimit dhe të gjendjes së jashtëzakonshme. Pashai kërkonte edhe këto:

- a) mobilizimin e dhunshëm të popullatës së aftë,*
- b) dërgimin e saj në frontin perëndimor,pra në vijën e parë të luftës,,*
- c) zhvendosjen e popullatës nëpër krahinat e largëta të Perandorisë dhe*
- d) pasi të bëheshin këto, në gjithë krahinën, të ndizej fushata e kërkimit të armiqve të shtetit,që kohë e kohë kishin zhytur duart me gjakun e shenjtë të ushtrisë*

perandorake... “Na kanë shumë hak të tillët”,kishte thënë Daut Pashai. “Na kanë aq hak sa edhe po të zhbihen nga faqja e dheut bashkë me gurë dhe drunj nuk na shpaguhen borxhet...Mënyra si u sollën gjatë njëzet e pesë vjetëve të fundit na jep të drejtë të përdorim çdo mjet kundër tyre...”

Lartmadhëria u pajtua me ato që tha Daut Pashai dhe i uroi punë të mbarë.

“Kush për asgjë nuk ta qet dorën përpara...” - i tha.

Ndërsa Kryeveziri ia ktheu:

“ Është kohë e përshtatshme t’i qërojmë njëherë e mirë hesapet me ta...Tash ose kurrë...” Takimi,që zgjati tri orë,filloi në iqindinë e ditës së katër të muajit të njëmbëdhjetë të vitit të madh perandorak.

Lartmadhëria i dha tre muaj kohë Kryeveziri, Daut Pasha, që t’i kryente të gjitha që duhej t’i kryente në mënyrë që plani më i rëndësishëm perandorak për nënshtrimin përfundimtar të Tokës së Lashtë të zbatohet në tërësi dhe me sukses të plotë.

- “Gëzohem,tha Lartmadhëria, që Perandoria nuk do ta zërë më në gojë as për të keq atë vend të mallkuar...”

3.

Veziri i madh i thirri komandantët e armatës perëndimore dhe u tha:

-Po nisemi në një fushatë të lavdishme,që ka për qëllim zgjerimin e mëtutjeshëm të Perandorisë sonë të pafund. Nga kjo varet e ardhmja e jonë, por edhe e gjithë botës. Gabimi më i vogël mund të na kushtojë shtrenjtë. Prandaj,nga ky çast,ndodheni nën betimin e shenjtë perandorak, që secili e ka të qartë çfarë nënkupton ai...

Kryeveziri, pastaj,foli edhe për ca gjëra të tjera që kishin të bënin me shtetrrëhimin dhe me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Së fundit, priti një ushtarak me të cilin, sy më sy,bisedoi shumë kohë.*

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

**...priti një ushtarak:*

Ushtaraku asnjëherë i parë deri më tani në qarqet e larta qeveritare,një trupshkurtër,me sy të mbufatur dhe mjekër vezore, edhe për vetë Kullën mbeti i panjohur!Te kota qenë përpjekjet tona ta dinim se cili ishte ai njeri,prej nga vinte dhe nëpër ç’rrugë u fut deri tek Kryeveziri për të gëzuar gjithaq besim... Megjithatë ne ia dolën t’i shënojmë disa nga ato që Kryevezi ia tha,që paraqiten me sa vijon:

-Merr një njësi ndër ato më të përgatiturat për veprime të veçanta,veshi me rroba të harbutëve dhe sulmo taborët tona. Gjatë sulmeve të befasishme mos kij kurrfarë mëshire...- i tha Kryeveziri ushtarakut.

Ushtaraku i panjohur për ne, sikur u zu ngushtë. Na ra në sy sesi fërkoji mjekrën e dalë dhe një copë herë çapiti diçka pa krijuar asnjë fjalë të qartë...

-Nuk ke pse shqetësohesh,- i tha Kryeveziri.-Do t’i sulmosh garnizonet tona dhe pikë. Këtë urdhër e ke prej meje dhe nuk e di kush tjetër. Pasi të fillosh sulmet e herëpashershme, do t’ua futesh zjarrin ca objekteve të shënuara në plikon që ke përpara...Plikon do ta hapësh vetëm kur të shkosh atje dhe pasi të kesh ndërmarrë tri sulme të befasishme ndaj taborëve tona...Ato që thuhet aty duhet përmbushur medoemos dhe pa kurrfarë shqetësimi...

-Kryepasha,-tha ushtaraku gjithë shqetësim,-mbase nuk po më dëgjojnë veshët mirë?...

-Të shkretët i ke në rregull,por ti nuk po i dëgjon ata. Pra,siç thashë,do të sulmosh ushtrinë tonë ashtu siç parashihet në pliko. Kjo është detyrë e shenjtë dhe vaj halli po qe se tregon farë mëdyshjesh gjatë zbatimit të urdhrave.

-Peqe,peqe, -foli ushtaraku prapë,- por bëra kaq vjet shërbim dhe nuk më ka rënë të dëgjoj se dikush që sulmon vetveten lëvdohet...

Pasha i madh qeshi. Qeshi aq sa ushtaraku i panjohur për ne gati u shemb për tokë.

-Perandoria nuk do të ishte perandori dhe të fortit nuk do të ishin të fortë po të mos silleshin edhe ashtu që në e parë duket e pabesueshme... Ca gjëra njëmend se bëhen vetëm me sakrificë dhe mund të madh, por ka edhe ca të tjera që arrihen me mashtrime,dredhi dhe me veprime të tjera që duken të pabesueshme...Njeriut të rëndomtë,e aq më tepër ushtarakut besnik,këto gjëra nuk ia merr mendja... Po ta them se përpara ke një detyrë jashtëzakonisht të rëndësishme,që kërkon vendosmëri të madhe, që lidhet me fatin e Perandorisë... Kjo të ngarkon me një përgjegjësi të madhe,ngaqë ke të besh me një fshehtësi të rendit të parë,e cila duhet mbrojtur me çdo kusht,qoftë edhe me rrezikimin e kokës...

-Peqe,peqe!- ia ktheu ushtaraku i panjohur për shërbimin tonë të përgjimit.- Për Perandorinë nuk më dhimbset koka...

-Këtë e kam të qartë.- foli Kryeveziri.-Por tash është e rëndësishme ta kuptosh rolin dhe gjendjen e re, që ty atje bashkë me njësitin të kthen në armik të përbetuar të Perandorisë,që nuk ngurron të vrasë edhe njerëzit e saj... Atje, pra,bashkë me njerëzit që i ke nën urdhër, je kështjellar,që lufton kundër Perandorisë...Kështu do të veprosh përderisa prej meje dhe vetëm prej meje do të marrësh urdhër tjetër...Pra,mos harro se je kështjellar,se je armik i Perandorisë...

Fjalën armik, Kryeveziri e theksoi ashtu sa ushtaraku u zbeh..

-Unë,armik?...Kjo mos qoftë!...

-Armik madje shkuar tij,- tha Veziri i madh si me shpoti....

-Mos o zot!... Mos o zot!...

Pashai sërisht qeshi. Ia hodhi dorën krahaqafë dhe i tha:

-Në të vërtetë ti je njeriu më i besueshëm i Perandorisë. Ti je heroi i njëmendët i saj...Ti nuk je i vetëdijshëm se ç'hero je dhe çfarë heroizmesh të presin bashkë me ata që do të kesh në shërbim...Me këtë bindje duhet të shkosh atje dhe të veprosh. Këtë bindje duhet t'ua futësh edhe trimave tu,të cilët ngjet që atje vdesin me mallkimin e armiqve por që vdekja e tyre është e madhe dhe në shërbim të vatanit... Ju jeni të vetmit që edhe si vrasës,e edhe si të vrarë,bëheni heronj...Këtë privilegj e ka rrallëkush....

-O zot,-tha ushtaraku i panjohur për shërbimin tonë,- assesi nuk po ma kap e shkreta rradaqe sesi mund të jetë vrasësi i vetes, hero?...

-Nisu!-i tha Kryeveziri ushtarakut dhe ia dha fermanin e fshehtë,ku ishin të shkruara ato që duhej të bënte sapo të arrinte Tokën e Lashtë...

4.

Veziri i madh po shfletonte me kureshtje letrat që kishte para. Vezirëve, që i rrinin pranë të heshtur dhe pritnin ato që do t'ua thoshte, u shkonte mendja tek lajmet gjysmëzyrtare dhe të tjerave që thuheshin lidhur me rebelimin në Tokën e Lashtë, që me shfaqjen e sulmeve të papritura ndaj garnizoneve të skajshme, po merrte përmasa gjithnjë e më shqetësuese mu atëherë kur në Kryeshehër flitej me krenari sesi ai vend ishte shtruar njëherë e përgjithmonë.

Pasi i solli disa herë letrat dhe pasi bëri në to disa vija,Kryeveziri nisi e tha:

-Duket se disa gjëra janë si ajo bima e keqe, që qet krye sapo fara e saj të prek tokën*...Kështu po ngjet edhe në atë vend të mallkuar,në të cilin derdhëm aq shumë gjak e bëmë aq mund për ta shtruar...Kur na thoshte mendja se nuk do të kishim më të bënim me të,(veçmas pas rënies së kështjellës së fundit),ai prapë na preokupon. Dhe ç'është me keq, nëse deri më dje armikun e kishim kryesisht në Kështjellë dhe e mbanim të rrethuar, jashtë saj, tash është thuajse i padukshëm dhe i pakapshëm dhe gjendet kudo. Kështu, ai shfaqet nëpër male, shfaqet nëpër gryka, shfaqet nëpër shkura, e shfaqet aty ku fare nuk pritet tek na sulmon tinëzisht ushtrinë... Me një fjalë ai është i padukshëm dhe tepër i rrezikshëm. Kjo bëri që fushata kah

Perëndimi të ngecë dhe po ashtu mëkëmbësve perandorak t'u dalin telashe me shtrirjen e administratës dhe të pushtetit tonë atje,që ata i kanë shpallur luftë deri në vdekje...

Më tutje Kryeveziri foli rreth asaj se si armiku që njëhej aq gjatë, pas humbjes që pësoi dhe kur dukej se nuk do ta merrte më veten, është kthyer në një hije, që sillet duke na qëlluar rëndë e më rëndë....

-Ajo hije,si çdo hije, do të na përcjell përderisa t'i lejojmë që të na vihet pas...

Pas një pushimi të shkrutër,Kryeveziri mori në dorë një dosje nga ato që kishte pranë dhe tha:

-Këtu ndodhen *shënimet e fshehta për dëmet**,që na u shkaktuan gjatë dy muajve të fundit. Mbase ca prej tyre mund t'i keni marrë vesh edhe tërthorazi, por shpresoja se të pabërave të tyre nuk duhet kushtuar gjithaq vëmendje, ngaqë ishin vetëm rastisje, që shpejt marrin fund. Të dhënat,megjithatë,flasin për të kundërtën...

Së fundit Kryeveziri tha:

-Gjendja mund të cilësohet si shqetësuese, ndërsa armiku në veprim e sipër, që kërkon autorizime plotësuese, (marrja e përkohshme e resorit të ministrisë së luftës dhe atij të brendshëm), në mënyrë që mbi mua të bjerë gjithë barra e udhëheqjes së fushatës së re në *Tokën e Lashtë* bashkë me ato që duhet kryer në kuadër të aparatit shtetëror, që ai të jetë sa më i fortë dhe i përgatitur për betejën tonë përfundimtare... Siguria e vendit e do që ajo hapësirë, që na qiti dhe po na qet ende telashe, të pastrohet një herë e mirë, që gjatë fillimit të luftës së shenjtë kah Perëndimi të mos druajmë nga ndërskëmbësat dhe të papriturat tjera që mund të na dalin,veçmas nëse kihet parasysh se Perëndimi, gjithnjë i ka përdorur kundër nesh. Madje,as kundërvënia e tyre njëzet e pesë vjeçare, nuk do të ishte çfarë ishte,pa ndihmën e Perëndimit, që u erdhi pareshtur nga të gjitha anët. Tash, kur e kanë më se të qartë se serish do t'i ndeshin armët me ne,u mor vesh pa gjasa që të fitojnë, kërkojnë që me përdorimin e tyre prapë të na ligështojnë sa më shumë që të jetë e mundur. Prandaj, kryeneçësia e tyre është pjesë e luftës së Perëndimit kundër nesh. Madje, hyrje e drejtpërdrejt në të. Ndaj, duhet dhënë sa më parë përgjigjen e merituar...

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

*...“Duket se disa gjëra janë si ajo bima e keqe, që qet krye sapo fara e saj të prek tokën“:

Kohëve të fundit Kryeveziri gjithnjë e më shpesh thoshte se Perandoria ndodhej para sprovave tepër të vështira në hapësirën e Tokës së Lashtë. Këtë thoshte e shprehte edhe kur shtroheshin çështje që nuk kishin të bënin fare me sigurinë e Perandorisë. Shërbimi ynë shënoi se një ditë më parë,në një mbledhje ku trajtohej çështja e ujërave, Kryeveziri disa herë qe ngatërruar me Tokën e Lashtë dhe sprovat që i quajti tepër të rënda. Veziri i ngarkuar me punët e ekonomisë së ujërave,i zënë ngushtë, kërkoi sqarime rreth atyre që u thanë nga shkaku se një përcaktim i tillë, edhe si pa hiri ,do t'i kushtonte shtrenjtë. Pa dhënë sqarime plotësuese, Kryeveziri kishte thënë se do të vinte koha kur të gjitha do të qartësoheshin... Andaj, ja pse vezirët e kishin pritur me interesim të madh sqarimin që lidhej me shfaqjen e armikut aty ku mendonin, që së paku për një kohë, çështjet merreshin për të zgjidhura. Tekefundit,a nuk flitnin në dobi të kësaj zijaftet e shumta dhe dekoratat e panumërta që u ndan pas marrjes së Kështjellës...

*...“shënimet e fshehta për dëmet“:

Si dëme që u shkaktuan nga veprimtaria e armikut gjatë dy muajve të fundit Kryeveziri solli këto të dhëna:

-njëzet e një sulme nate,

-trembëdhjetë sulme gjatë mjegullës,

-shtatë sulme ditën ndaj njësiteve të pararojës dhe

-tridhjet e një zjarre.

Me rastin e këtyre sulmeve u shkaktuan këto humbje:

- 99 ushtarë të vvarë,
- 999 ushtarë të plagosur
- 99 ushtarë të zhdukur.

Nga zjarret u dëmtuan këto objekte:

- dy postkomanda të mëdha,
- u paaftësuan shtatë karakolle,
- u shkatërruan tri karroca dhe
- u hodhën në ajër katër depo armësh.

Po ashtu,ku më pak e ku më shumë, u dëmtuan:

- katër ura.
- një kalim tepër strategjik dhe
- një ujësjellës i rëndësishëm.

Kryeveziri theksoi se armiku është i organizuar mirë,se është i lëvizshëm, se di t'u përshtatet rrethanave të reja dhe,ç'është më shqetësuese,ai po bën përpjekje të futet edhe në radhët tona...

Këtë dyshim e përmbylli me njoftimin:

-Po bëhen hetime të posaçme se në ç'masë është futur ideja e armiqësisë edhe brenda qarqeve të rëndësishme ushtarake dhe shtetërore.

Fjalët e fundit i theksoi si shumë, saqë vezirët zunë ta shikojnë njëri-tjetrin sikur të kishin përpara të dyshimtin.

Mbase kjo i mjaftoi Kryevezirit të thoshte:

-Besimi është i mirë, por syçelësia është edhe më e mirë dhe se ajo duhet të vlejë përherë,pra edhe kur nuk vepron armiku...Ata kanë një fjalë që thotë se edhe uji fletë,por armiku jo...Kësaj duhet besuar me gjithë mendje dhe duhet vepruar drejt parandaljes së tij...

Në fund Kryeveziri i tha edhe këto:

-Nuk duhet lejuar që armiku i jashtëm njëherësh të bëhet edhe i brendshëm...Këtë duhet pasur në shënjestër përherë...

Në fund, shërbimi ynë shënoi edhe një pyetje që iu shtruar Kryevezirit nga Veziri i punëve të brendshme,postit i të cilit përkohësisht kishte kaluar në përgjegjësinë e Vezirit të madh:

-Sa do të zgjasë gjendja e jashtëzakonshme dhe shtetrrrethimi në Tokën e Lashtë?...

Kryeveziri tha trup e shkurt:

-Kjo do të varet prej shumë zhvillimesh...

5.

Ditën e parë të muajit të dytë të vitit vendimtar Daut Pashai nis u kah Perëndimi në drejtim të Tokës së Lashtë me shumë taborë ushtarësh dhe pajisje tjetër luftarake, që thuhej se hynte për herë të parë në përdorim. Pas dymbëdhjetë ditë udhe arriti aty ku dikur taborët e tij qenë ndalur para Kështjellës. Por, këtë herë, nuk u ndal para saj e as që i hapi tendat në rrafshinën përskaq liqenit, ku rëndom vendoseshin taborët dhe pritnin për të bërë luftën e gjatë kundër Kështjellës, që rëndom përfundonte pa sukses. Përkundrazi, ai hyri në Kështjellë dhe iu përkul flamurit perandorak, i cili valon krenar. Seç iu kujtua flamuri i kështjellarëve, të cilin nuk ia zinte dot syri,por që për habi, njëfarë ndjenje sikur ia bënte me dije se shpendi i zi në të, do të mund të ishte strehuar diku nëpër shkrepë malesh për t'u kthyer serish... Në atë përvijim dridhërimash të ftohta syri i tij sikur kërkonte zogun e zi, që nuk shihej, por kërcënohej... Më vonë shikimi i kaloi nëpër sheshin e vogël me shkalloren e gurtë në mes dhe iu duk se ngushtimi i saj që bëhej nga pjesa fundore sikur atë, bashkë me stemën perandorake, që rrinte në pjesën ballore, po e ngrehte kah gremina, që niste prapa murit mbrojtës kah ana e liqenit. Gjithçka në atë hapësirë iu shfaq e ngushtë dhe tepër e vogël për kallëzimet që kishte

dëgjuar dhe ngjarjet që lidheshin me të, për të cilat dinte e gjithë Perandoria e madje edhe bota. Si ishte e mundur që në atë hapësirë aq të vogël ishte bërë pleksja e dy boteve, parakalimi i shumë perandorive, që punën e parë që bënëin sapo arrinin aty, pa marrë parasysh humbjet dhe mundin e bërë dhe pa marrë parasysh se sa ia vlente përnjëmend gjithë ajo që ndërmerrej për të prekur atë pikë, ishte spikatja e flamujve dhe stemave të tyre. Me këtë rast, flakeshin paraprakët, që e gjitha pastaj të përshkruhej apo të përjetohej si fitore e përmasave të jashtëzakonshme me të cilat ishin matur dhe lidhur edhe fatet, që nga ngritja deri të rënia dhe e kundërta?... Këtë pyetje ia shtroi vetes disa herë, por përgjigjja jo vetëm që i mungonte, por shtruarja e saj në atë hapësirë të ngushtë dhe marrja me të në ato çaste kur shpjegimet çfarëdo qofshin ishin të parëndësishme fare, iu duk si një shenjë ligësie e pakuptueshme, që duhej shporrur sa më parë... Andaj, po atë pasdite, Kryeveziri *shpalli shtetrrëthimin**.

Ishte kjo një ditë me shi të imtë, që Pashait të madh iu duk tepër e njëtrajtshme dhe e gjatë për aq sa mendja ia thoshte se ishte zhytur në një kohë të pafund gjithë bezdi. E, kur më në fund, pa se nata po binte në Kështjellë dhe tisi i errësirës e kishte mbështjellë sipërfaqen e lëmuar të liqenit, ashtu pa qëllim thirri komandantët dhe urdhëroi një qetësi varri që do të mbretëronte gjithandej. Sikur t'i ishin përshtatur që më parë atmosferës që kërkonte Pashai i madh, komandantët, dymbëdhjetë sa ishin, në krye me Xhavid Agën, hynë në dhomën e tij qetas si ishin të padukshëm dhe të paqenë. Edhe përkundër asaj gjendje që ngado dhe kudo pasqyrohej me mbërthimin e një fashe të paparë, Kryevezirit iu bë se ata që erdhën, kush më shumë e kush më pak, sollën nga një pjesë të asaj dite të pafund, që as vetë nuk e dinte pse e mori ashtu zët. I frikësuar se mos vallë brenda do t'i përsëritej diçka e mbetur e asaj dite të përgjumur, urdhëroi të mbylleshin dritaret me çepenxhet e rënda prej druri që përdorëshin kur mbi Kështjellë lëshohej ndonjë stuhi e fortë nga ato që shfaqeshin diku nga fundi i dhjetorit. Për t'i ikur atij përfytyrimi urdhëroi të ndizeshin qirinjtë të shumtë kudo deri edhe në pjesët e jashtme të mureve...

-Dua terr e dritë, që shkojnë bashkërisht.- tha Pashai për habinë e komandantëve që po i rrinin përpara dhe kishin pritur të dëgjonin çka do pos atyre që ato çaste ua zunë veshët. Lajthitja e tyre u bë edhe më e madhe kur Kryeveziri nisi të sqaronte diçka si tërthorazi rreth kuptimit të atyre pse drita dhe terri duhet t'i ndihmonin përjashtimit të kundërshtimeve mashtrimitare që jo rrallë dritën e paraqesin të mbizotëruar nga terri dhe terrin të mundur nga drita...

I zënë nga ato që dëgjonte dhe i përhumur në ngatërrimin që i ishte krijuar prej tyre, Kadiasçeri, gjithë frymë, nxitoi të sillte qirinjtë e shumtë, që nisi t'i përhapte në gjitha anët.

- Sa ora terrimin do ta bëjmë nur perëndie, madhëri,- çapiste ai i bindur se po vepronte drejt dhe në përputhje me ato që kërkoheshin atë çast prej tij, që Vezirit të madh t'i kthehej çehra.

Në atë hakërrim dritash, që vinin nga qirinjtë e shumtë, komandantët shikonin lëbyrjen e flakës, që thyhej në fytyrën e Kryevezirit duke ia përvijuar shqetësimin e frikshëm, që sikur përhapej për t'iu sulur atyre, që rrinin ashtu të heshtur dhe pritnin ato që do t'u thuheshin pas shpalljes së dekretit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe shtetrrëthimit, me zbatimin e të cilit ngarkoheshin. Zymtia, që e hetuan sapo hynë brenda, bashkë me ato që i dëgjuan të thuheshin aq çuditshëm për terrin dhe dritën si dhe heshtja që pllakosi dhomën më pas, ua shtuan dyshimin se Pashai jo vetëm që nuk do t'u thoshte gjë prej gjëje për luftën e re, që ata e pritnin me padurim, por mund të ndodhte që lufta me Perëndimin të bëhej me mjetet të tjera, siç ngjau me rastin e rrethimit të fundit të Kështjellës dhe marrjen e saj pa mjetet e luftës... Dyshimi se edhe lufta e re mund t'i përngjante paraprakes, apo që së paku do të bëhej me marifete të tjera, që nuk i shkonin asaj, ushtarakët i kishte munduar që nga nisja, kur kishin parë se Veziri i madh nuk e kishte mbledhur këshillin e luftës për konsultime qofshin ato edhe sa për sy e faqe dhe as që kishte kërkuar shqyrtimin dhe leximin e shenjave të luftës nga shërbimet që err e terr, të shtrira nga njëri kënd në tjetrin të hapësirave të Perandorisë, merreshin me punët e tilla. Anashkalimi i komandantëve gjatë udhëtimit dhe sjellja e ftohtë, si

të mos i kishte pranë, këtë dyshim sikur e kishin përhapur dhe thelluar saqë shumë prej ushtarakëve parandienin se mund t'u ripërsëritej koha e bezdisë dhe e nënçmimit, siç kishte ndodhur gjatë fushatës së fundit, por tash në një hapësirë të gjerë dhe fare të papërcaktuar, ku mund ta humbnin fare pusullën dhe rëndësinë për t'u marrë me çka do tjetër pos me punë ushtarake. Ç'është e vërteta edhe në të kaluarën, njësi të caktuara, në pararojë apo në vëzhgimi nga paravija, ishin marrë me detyra të veçanta, që nuk kishin qenë veprime luftarake, por që ishin në shërbim të ngushtë të përgatitjes dhe bërjes së luftës, që doemos pasonte dhe shumëçka e saj varej nga përgjimet dhe ato që hetonin dhe shënjonin njësitë e pararojës. Këtë herë, nuk kishte as njësi të pararojës, as të prapavijës, pos tabore të panumërta, që zvarriteshin të përgjumura bashkë me komandantët e tyre, të cilët, ndonëse kishin në krye Xhavid Agën, njërin ndër komandantët më të njohur të armatës perëndimore, nuk u ndihmonte të dilnin nga paqartësia dhe droja se edhe fushata e re mund ta qonte më tutje humbjen e autoritetit të tyre...

E Pashai, si t'i kuptonte mëdyshjet e tyre, një copë herë ndoqi pipërrimën e flakës së qirinjve dhe këtë e bëri sikur të ishte vetëm dhe i preokupuar me lojën e flashkët të dritës drejt pushtimit të errësirës. Dikur shikimi i tij kaloi nëpër fytyrat e komandantëve, sikur të kërkonte pasqyrimin e ndeshjes së qirinjve me terrin dhe së fundi u ndal te Xhavid Agai dhe vetëm kur hetoi se atij iu rrëzua shikimi, foli e tha:

-Ka kohë që jemi nisur drejt Perëndimit dhe kemi mbetur në gjysmë të rrugës. Pse është kështu kjo dihet dhe nuk do sqarime të mëtutjeshme, ngaqë ato mund t'i shërbejnë si arsyetime mossuksesit. Meqë tashmë ka marrë fund ngecja dhe ne ndodhemi në një lëvizjeje të pandalshme drejt qëllimit përfundimtar, pra që fundin ta kthejmë në fillim dhe fillimin ta bëjmë fund dhe me këtë njëherë e përgjithmonë ta përjashtojmë gjendjen e pranisë së dy boteve aty ku ka vend vetëm për njërën (për tonën), që ishte mashtrimi më i madh dhe shkaktari i të gjitha të ligave dhe çoroditjeve që ngarkuan mendjen e njeriut me gjithfarë prapështish, si po shihni, pra, para se të nisemi për atje ku duhet patjetër të arrijmë, *kemi edhe ca për të bërë**, në mënyrë që dita e nisjes të jetë fare pranë*, dhe sapo të ndodh kjo, vendi të jetë doemos i pastruar*...

Pasi tha këto dhe pasi serish ua lëshoi shikimin dritës së qirinjve, që pipërrinin nga të gjitha anët, Kryeveziri vazhdoi:

-Sot më tepër se kurrë e kuptoj shqetësimin tuaj, që njëherësh është edhe imi. E marr me mend sa të padurueshëm jeni, që përkon me natyrën e ushtarakëve, të cilët jetojnë nga luftërat dhe sukseset e tyre. Ngecjet dhe sorollatjet e kota sjellin bezdi e mbi të gjitha çrregullojnë qarkullimin e gjakut, aq të domosdoshëm për një ushtri që të mbahet në gjendje gatishmëri dhe aftësie të duhur...E di, po ashtu se shumë prej jush, që jeni sjellë aq gjatë këtyre hapësirave dhe keni përjetuar shumë disfata të panevojshme, kërkon shpagim e mbi të gjitha lavd, që është edhe pjesë e traditës luftarake dhe se kjo mund të bëhet vetëm nëpër beteja të fuqishme, ku përdoren armë të ndryshme, ku sprovohen taktika dhe strategji të reja, e ku edhe humbjet eventuale duken më të durueshme, e edhe vdekja shfaqet e madhërishtme... E di se ju kërkon luftëra të tilla dhe se ato nesër e pasnesër do t'i gjeni patjetër...

Fjalët e fundit i theksoi ashtu sa komandantët e patën të qartë se njëherë për njëherë lufta e shenjtë kah Perëndimi shtyhej, gjë që mund të nënkuptohej se në vend të saj, serish do të merreshin me harbutët, se do të tërhiqeshin zvarrë kënetave dhe moçaleve të pafund, që e gjitha nuk ishte tjetër pos pjesë e një bezdie të pa kuptim, ku asgjë nuk mund të fitohej pos humbjes... Fjalët "nesër e pasnesër", që Kryeveziri i nxori si të ngjizura dhe të përcjella me një shurdhim, ua kujtuan tri rrethimet e fundit, kur ushtria më së paku luftoi, e megjithatë për të vdekur vdiqën si shumë veta, (herë duke ndezur zjarre rreth Kështjellës, herë duke u hapur istikame të thella, herë duke u futur nëpër tunele, e herë duke u marrë me gjëra fare të pakuptimta, që nuk kishin të bënin me luftën...) Atëkohë vdekja njëmend u bë nënçmuese dhe e pavlefshme të përmendej, sa komandantët në letrat që ua dërgonin familjeve të të vdekurve zunë të mos e shënonin fjalën e domosdoshme „ra heroikisht për vatan“, por vetëm „vdiq për

vatan“... Bile, vetë Xhavid Agai, si komandant i armatës së tretë, lejoi këtë ndryshim edhe pse e dinte se rrezikonte si shumë, por mbase për të kjo ishte mundësia më e mirë dhe e vetme, që disi të ngrehte zërin kundër mënyrës së re të luftës, të cilën e futi Daut Pashai sapo vuri në dorë gjithë pushtetin, me të cilën për herë të parë u mor nëpër këmbë krenaria ushtarake, që ishte shtylla kryesore e Perandorisë. Megjithatë, sapo ra Kështjella (kur kjo pritej më së paku), e Daut Pashai u emërua Kryevezir dhe mori përsipër gjithë mbikëqyrjen mbi armatën, Xhavit Agai, përkundër kundërshtimeve të fshehura dhe mospajtimeve të ndryshme, shpresonte se më në fund do të fitonte lavdinë e madhe, që e kishte pritur atë kohë. Gjatë asaj pritjeje, që dikur i ishte kthyer në një paralajmërim se megjithatë e priste një fund i lig, ishte ngushëlluar me mendimin se ç’përpjete do të merrte po qe se nuk do t’i shfaqej para ajo muranë e mallkuar, që ua hëngri kokën sa e sa ushtarakëve të lavdishëm e shumë të tjerëve ua fiku shpresat që në nismë. Mendja ia thoshte se ajo qe vetë kobi, që e kishte lënë pa nishanet, të cilat i kishte ëndërruar gjatë kohës kur ndodhej në krye të armatës lindore dhe e kishte lënë edhe pa lumturinë jetësore, ngaqë vetit ia kishte vu për detyrë të martohej, të krijonte familje çastin që do të përballonte këtë pengesë... Kur më në fund e mori vesh se koha kishte kaluar shumë shpejt dhe ai kishte mbetur jashtë saj, prapë se prapë, lajmi për marrjen e Kështjellës e gëzoi pa masë sa iu bë se edhe ajo që ishte fikur dhe nuk mund të kthehej më, serish po i përfntonte si një shpresë...I pat ardhur keq që Shpjeguesi i ëndrrave nuk ishte më për t’i thënë se ai farë mjegullimi rreth të cilit i fliste pareshtur, sa herë që merrej me ëndrrat e tij, më në fund ishte shthurur, që do të thoshte se ai nuk kishte pas të drejtë kur kishte parë vetëm rreth të mbyllur dhe dergije në të dhe se përkundër atij oguri ai mund ta fitonte atë që kishte gjakuar gjatë, pra famën e ushtarakut, sado që ishte i vetëdijshëm se ajo, edhe si e vonuar, do të ishte e vetmja që do t’i shërbente si ngushëllim jetësor... Por, ja se edhe ajo shpresë, që i ishte dukur, nuk ishte e thënë ta ngrohte tutje një mashtrimi... Pasi dëgjoji ato që i tha Kryeveziri rreth pritjes së domosdoshme që lidhej me përballimin e armiqve të brendshëm, serish iu kthye ai mjegullimi i papërballueshëm saqë dëshprueshëm ia pranoi vetes se kështu e kishte të shkruar dhe assesi ndryshe...

Sikur t’ia lexonte dëshpërimin e thellë, Kryeveziri zuri të fliste për ca veprime ushtarake të rendit të parë, ku do të përdorej një strategji e re... Foli e foli dhe shikimin nuk e ndau nga Xhavid Agai, ndërkohë që koka e Agait shkarazi po i pranonte ato që i thoshte Kryeveziri, megjithëqë ishte zhytur në një pikëllim të thellë sa mezi i përmbante lotët. Po të ishte vetëm, patjetër se do të qante dhe do të qante si fëmija, që ngashërehet pas gjërave të humbura...

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

*...shpalli shtetrrëthimin:

Sipas sqarimeve plotësuese, që iu dhanë ushtarakëve nga Kryeveziri, shtetrrëthimi përfshinte hapësirën e dikurshme të Principatës me gjithë Tokën e Lashtë, me çka ajo shpallej e rrezikshme dhe mbyllej nga të gjitha anët. Ushtria ndodhej në gjendje gatishmërie të rendit të parë dhe fitonte kompetenca të jashtëzakonshme. Me këtë rast pushonte pushteti i sanxhakbeut dhe i valive, të cilët viheshin nën urdhrin e ushtarakëve bashkë me qatipët dhe administratën vendore...

*... kemi edhe ca për të bërë:

Pasi shprehu këtë mendim, Kryeveziri i tha edhe këto:

-Këto që po ua them janë fshehtësi e rendit të parë...Po ua tërheq vërejtjen me kohë se besimi i Perandorisë, që e gëzoni është i madh, por edhe rreziku nga humbja e tij është po ashtu i madh. Prandaj, (pason një kollitje e gjatë dhe e tërhequr zvarrë),duhet filluar menjëherë me alarmimin e rrezikut që i kërcënohet vendit nga Perëndimi dhe qëllimet e heretikëve. Miletit duhet t’i bëhet e ditur err e terr se ç’e zezë dite u vjen nga bota armike,e

cila është e shthurur, e prishur dhe në shkatërrim e sipër... Duhet thënë se të përdalët nga urdhri i zotit kaherë kanë thurur të pabëra që t'ua fusin farën e ligë të çoroditjes, që bëhet me anën e marifeteve mashtrimtare, tërheqëse për sy e faqe, me të cilat mbillet sëmundja e pa shërueshme e shpirtit, që nis me rrënimin e familjes, për të shkuar pastaj te rrethi dhe shoqëria në përgjithësi... Nëpër sheshe, tubime dhe kudo, duhet hapur fjala se kur të ndodhë shthurja e familjes dhe të shkatërrohet besimi, mund të pritët shterja e ujit, ndryshimi i klimës dhe shfaqja e tërmeteve që do të rrënojnë çdo gjë... Për këto të liga duhet folur pareshtur si për një ogur të jashtëzakonshëm, me të cilin mbillet psikoza e frikës dhe dëshpërimit të përgjithshëm... Mandej, duhet të niset shënimi i vullnetarëve që dëshirojnë të luftojnë kundër Perëndimit, gjithnjë me arsyetimin për të parandaluar të ligën që u vjen prej andej... Vullnetarët duhet lavdëruar, duhet nxitur me fjalët se kanë nderin të jenë pararojë e luftës së shenjtë, ndërkohë që familjet e tyre duhet shpërblyer në mënyra të ndryshme, që fushata drejt Perëndimit t'ua duket edhe si leverdi e madhe, që ua heq frikën, por edhe ua hap mundësitë e shumta të mbijetimit. Po nuk piu ujë kjo, nuk na mbetet tjetër pos të shpallim mobilizimin e përgjithshëm, ku përfshihen gjithë ata që janë të aftë për luftë.. Krahës fushatës kundër Perëndimit, përherë duhet zënë n'gojë edhe ata që po na i sulmojnë kazernat, që duhet cilësuar si agjentë të Perëndimit, të cilët vinë nga radhët e plëngprishësve të këtushëm dhe assesi ndryshe. E gjithë kjo duhet bërë ashtu që i madh e i vogël ta kenë parasysh se tashmë e liga ka filluar të veprojë dhe se kundër saj nga të gjitha anët duhet ngjeshur radhët përkrah Perandorisë...

*... që dita e nisjes të jetë fare pranë:

Kryeveziri parashikonte se vullnetarët dhe të mbledhurit duhej të niseshin kah Perëndimi pas dy javësh...

*... vendi të jetë doemos i pastruar:

Rreth kësaj çështje Kryeveziri u shpreh kështu:

-Kur të nisen vullnetarët kah deti me bindjen se do të ndeshen me perëndimorët, me armiqtë e tyre të lindur, duhet të fillojë faza vendimtare për pastrimin e vendit nga e liga. Njësitë e posaçme ushtarake duhet të futen ngado dhe kudo për t'i qëruar hesapet në të gjitha ata që na kanë borxhe të vjetra dhe të reja. Se çfarë borxhesh kemi këtu ju e dini më së miri... Megjithatë, fushata asnjëherë nuk duhet të humb përqendrimin parësor se ajo bëhet për t'ua luftuar mbeturinat e armiqve, pra armiku i brendshëm, i cili është në shërbim të armikut të jashtëm, pra të Perëndimit...

*Pasi e shpalli mbledhjen të mbyllur, Kryeveziri ndali Xhavid Again dhe i tha:

-Ke rast të mirë të bësh atë që gjatë shumë e shumë rrethimeve nuk e ke bërë. Erdhi koha që mllëfin e disfatave ta derdhësh ku duhet dhe si duhet. T'ua prift e mbara!

Ushtaraku i lartë, që deri atëherë dukej i dëshpëruar pyeti:

-Pra, nuk do të merremi me punë të kota, siç ndodhi herën e shkuar?...

-Mprehe shpatën!... Të erdhi koha!

-Peqe, Pashë i madh, peqe!... Por, këtë sikur nuk e kisha pritur...

Kryeveziri ia tha edhe këto Xhavid Agait:

-Ti që ke kaluar aq shumë e shumë rrethime të gjata pranë Kështjellës dhe po aq herë je dëshpëruar, ti që ke hapur tendat në pranverë dhe në vjeshtë i ke mbledhur i bërë gjithë pëlim, më së miri e di se çfarë haku na kanë këtu... Mund të merret me mend se po të që gur ai që na doli përpara, do ta thyenim sa e sa herë; po të që edhe ujë deti, do ta shternim; po të ishte mal, do ta shembnim... Por, ishte diçka tepër djallëzore, por njëherësh e pakuptueshme, që na kyçi, që më në fund u maur vesh se ishte hileja e herezisë, që u nënçmua dhe u anashkalua nga përcaktimi se vetëm me armë arrihet çdo gjë... Dhe duhet ditur, se ky njeri-djall, po t'i jepet rasti, prapë do të veprojë kundër nesh si ngaherë. Pra, fjala është për një armik të

lindur,i cili edhe kur duket se struket,edhe kur shtiret se dorëzohet e madje edhe kur thotë se punon për ne,e ka me sherr... Tash kemi rast të jashtëzakonshëm, që me një të rame t'i bëjmë dy të vrame. Andaj, hyn kudo dhe kërko armikun tonë të përhershëm dhe qëroj hesapet me të. Kërko të pabesin!... Kërko të dyshimtit dhe mos ki mëshirë... Për ne armik dhe i dyshimtë këtu është edhe i gjalli edhe i vdekuri...

-Pra, Pasha i madh, secili është armik?

-Secili.

-Pa dallim?

-Pa dallim.

-Vlen kjo edhe për hafijet tona?...

-Edhe për ta.

-Peqe, tha Xhavid Agai i kënaqur.- Këto desha t'i dëgjoj...

-Pusho dy javë deri sa të kryhet mobilizimi i përgjithshëm e pastaj filloja. Ke tre muaj kohë që ta bësh atë që ta ka besuar Perandoria vetëm ty. Se vetëm kështu hapet rruga kah Perëndimi...

Xhavid Agai u përkul,i puthi dorën Pashait dhe kërkoi ize.

Kur po largohej Kryeveziri ia tha edhe këto:

-Mbaj ditar. Shëno të bërat dhe të pabërat. Perandoria kërkon dëshmi të shkruara për të gjitha. Ditarin duhet ta kem dhe ta shoh vetëm unë...

6.

Nga pirgu Pashai po shikonte hapësirën e liqenit, ku thyheshin ca nga maja malesh që dukeshin si të zhytura në ujë. Tisi i hollë i mjegullës që kreshpërohej nëpër sipërfaqe ia bënte pamjen edhe më të paqartë, ndërkohë që përballë asaj gjendjeje,fare pavërejtshëm, mendimet zunë t'i fluturonin tutje asaj hapësire, ku bjeshkët bashkoheshin me qiellin, sikur të kërkonin diçka të mbetur, mungesa e së cilës cyt përherë prapa. Mbase për herë të parë, koka, që rëndom i merrej me të tashmen dhe i jepej vetëm së ardhmes, nga ai vend dhe ajo lartësi që e kishte mbushur me disa përjetime të pashpjegueshme, po tregonte njëfarë prirjeje të papërmbajtshme t'i kthehej së kaluarës, asaj që i shfaqej si një mundim i madh... Sado pa dashas, gjithnjë e më shumë po i vërtitej çasti që hyri në Pallatin e Praruar kur Lartmadhëria e quajti Daut Pashë Shkodrani, që atëbotë i tingëlloi si një thirrje rizgjimi, që e nxori nga gjendja e paqenë, në të cilën ndodhej pa ditur se pse sembohej nga njëfarë vetëkuptimi i ngatërruar e gjithë mjegullim, që i vinte si shtysë jashtësie... Pastaj, zuri t'i kujtoheshin pjesëza nga koha e rrethimit të Kështjellës dhe ato që thuajse pavetëdijshtëm u hartuan prej tij drejt gjunjëzimit të saj pa luftë... Dhe sa herë koka ia kapte gjërat e tilla, të cilave me dëshirë nuk do t'u kthehej kurrë, (nga shkaku se me t'i përftuar pjesëzat e tyre kapërthehej nga një ndjenjë tepër e mundimshme ngatërrimi që assesi nuk e kuptonte), shihte Shpjeguesin e ëndrrave, që i shfaqej si gjysmëhije dhe i fliste diçka për shpirtin dhe ëndrrat vetanake, të cilat, një ditë patjetër e gjejnë vetveten dhe kullën e tyre... Ëndrra është e çuditshme, i thoshte ai. Ngjet që bredh e bredh e shképutur nëpër mote,fare e papërcaktuar dhe e mjegulluar, por një ditë i kthehet qenies së vet... Ëndrra e gjen të zonë... Ëndrra nuk plaket... Ëndrra nuk zhduket... Ëndrra është një si frymë që lëviz dhe në lëvizje e sipër ndërlidh të paqartën me të qartën, lidh të vetëdijshtmen me të pavetëdijshtmen dhe anasjelltas, siç lidh pjesën me tërësinë... Një çast iu duk se Plaku po i fliste për njëfarë zbrazëtie apo shurdhimi, se po i thoshte se njeriu pa ëndrra nuk është njeri dhe me këtë sikur po i thoshte „ëndrrat të kanë ikur, por një ditë të gjejnë dhe atëherë do të shohësh se kush je dhe cili je...”

Mend plasi nga ato përftime, që në atë lartësi i ishin qepur dhe assesi t'i ndaheshin dhe i vinin si shushuritje e mundimshme. Një copë herë ajo shushuritje e ndoqi dhe i solli aso sikleti saqë me të shpejt zbritu nga Pirgu dhe hyri në dhomën që shikonte nga bjeshka, në të cilën i pëlqente të rrinte kur ndjehej i vetmuar. I mbërthyer nga njëfarë gjendjeje tepër

shqetësuese ndjeu trokitjen e derës dhe pas pak pa adjutantit, që përherë ia sillte lajmet e ngutshme që kishin të bënim me fushatën e mobilizimit. E pa të shtanguar me gishtat që po i dridheshin.

Për t'ia hequr shqetësimin e pyeti butësisht se ç'ilet kishte që ia shfaqte gjithë trupi, ndonëse mendja ia merrte se e gjitha kishte të bënte me ndonjë të papritur, që kishte për t'ia kumtuar, e goja nuk ia nxirrte.

Adjutanti nisi të belbëzonte.

Kryeveziri prapë i tha se duhej ta merrte veten, edhe pse shqetësimi po ia kaplonte fytyrën.

Mbas atyre belbëzimeve, adjutanti mezi krijoi një fjali me të cilën bënte me dije se punët nuk shkonin mirë...

Kryeveziri, të cilit ende po i ushtonte koka nga përfitimet e pakmëparshme, sesi i kërceu gjaku sa nxori një çirrije të çuditshme nga e cila adjutanti u shemb poshtë gjithnjë me të njëjtat çapitje të lidhura për gojë, që i vinin gjithnjë e më të ngjizura.

-Zgjidhe njëherë atë të shkretë dhe thuaje atë që duhet ta thuash...

-Po ikin...Pi ikin, foli adjutanti.

-Kush ikën, or, kur ende nuk ka luftë?...

-Thonë se ikin ata që u përfshimë në njësitë tona... Ikin të gjithë...

-Ah!... Mund të jetë ky ndonjë hutim?...

-Nuk e di, Madhëri...Nuk e di... Unë sjell vetëm lajme...Tjetër nuk di... Dashtë zoti të jetë ashtu...

Kryeveziri fare papërmbajtshëm zuri të sillej nëpër dhomë. Shkoi te dritarja dhe, pasi shikoi një copë herë liqenin, urdhëroi që të vinte me ngut Shemsi Agai.

Adjutanti përshëndeti hundabuzash dhe doli me nxitim.

Po ikin, shfreu prapë Kryeveziri. Atë fjalë e përsëriti disa herë... Po ikin?... Nuk është për t'u habitur kur në gjak e kanë armiqësinë kundër Perandorisë... Këtë e dija...Por, këtë herë do ta paguajnë me kokë...Do ta paguajnë shtrenjtë...

Kryevezirit nuk iu hoq zemërimi një kohë të gjatë, ndërkohë që trillimi i përhapur prej tij për agentët e perëndimit dhe qëllimet e tyre shkatërrimtare, iu duk i vërtetë. I bëhej se vendi i ishte mbushur me ta, siç mbushet qemerit me mijë. Minjtë shumoheshin e shumoheshin sa kërkonin t'i futeshin në dhomë... Minjtë ikin sapo hetojnë dridhjet, mendoi... Minjtë të parët i hetojnë tërmetet... Po e ditkan?... Po e ditkan?...

Ky mendim i solli të dridhura. Po si e kuptuan atë që askush pos komandantëve nuk duhej ta dinte?...

Një kohë të gjatë u rropat me këtë hamendje e pastaj, sikur të dëshironte të mbrohej nga dyshimi që e kishte sajuar vetë, nisi të gjykonte se si ndonjëri nga komandantët, mbase ashtu pahiri, që të ishte sa më bindës, kishte folur për qëllimet e mobilizimit më shumë seç ishte dashtë dhe kjo kishte mjaftuar që mendja e tyre e hollë dhe tepër djallëzore të kapte fshehtësitë e asaj që po u kurdisej?... Po të kishte ndodhur kjo, atëherë të gjitha ato që ishin bërë me aq kujdes dhe përkushtim do t'i merrte uji. Bile, pasojat e dështimit do të ishin afatgjate, sepse vendësit, për vetë faktin që do t'i shpëtonin kurthit së qërimit të hesapeve, ndër më të mëdhatë deri më atëherë, që u ishte përgatitur, do të shënonin edhe një fitore tepër të rëndësishme mbase më të madhen kundër Perandorisë... Ky mendim e trishtoi. E bëri të shembej dhe të mbytej në djersë... A thua qenka shkruar të pësoj fatin e të tjerëve, po thoshte?... Dëshpërueshëm mbylli sytë dhe kërkoi t'i jepej përgjumjes. Por, nuk vonoi dhe në njëfarë mjegullimi, iu shfaq Shpjeguesi i ëndrrave, i cili po ia përsëriste ato që dikur ia kishte thënë rreth luftës së shpirtave..."Nuk të thosha kot se mendja e tyre përherë pjell diçka të pabesueshme dhe ti me shikoje gjithë nënçmim kur ta tërhiqja vërejtjen?... Mendoje se me një curril uji dhe me një kalim nëntokësor përfundonte e gjitha?... Kur unë të thosha se ata do të bëhen edhe më të rrezikshëm, se do të bëhen dhe më të paparashikueshëm kur nuk do t'i kemi më të mbërthyer në Kështjellë, ti më nënçmoje... Qeshje dhe më mëshiroje rreth

lajthitjeve, që mendoje se i kisha nga dëshpërimi i thellë i shkaktuar nga disfatat e njëpasnjëshme... E dija se jashtë Kështjellës ata bëhen edhe më të pakapshëm...Se shpërndahen në të gjitha anët dhe bëhen pjesë e Perëndimit ku e shohin shpëtimin...Nuk po të kujtohen këto?...Ë?...Ë?...“

Në atë përpëlitje, fare padiktueshëm, sikur mendja po ia kapte një mendim për lirinë jashtë rrethit të mbylljes si dhe përjetimit e vlerësimit të saj në rrethanat e reja... Mbase me nxjerrjen nga Kështjella dhe rrethimi u është mundësuar që ta kuptojnë ndryshe atë dhe ta vlerësojnë si një fitore të jashtme por edhe të brendshme, ndërkohë që është menduar se vetëm si të mbyllur dhe të rrethuar ata janë të fortë dhe mbrojnë lirinë e tyre... Dalja nga rrethi, gjykoi, i ka liruar nga *një-mendimi*, i ka liruar nga *një-mendësia*, i ka liruar nga *një-prijësia*, i ka liruar nga *një-shikimi*, i ka liruar nga *një-qëndrimi*, ndërkohë që hapësira i ka liruar nga *një-dëgjimi* dhe jashtë Kështjellës ata janë liruar nga ndjenja dhe përcaktimi i *një-njëshave*, si sasi dhe i ka bërë *njesh-një* ,të pavarur dhe si të tillë nga *një-shumës* kanë kaluar në *shumë-njësia*, në aso që lëvizin si njësh, që mendojnë si njësh, që flasin si njësh, që veprojnë si njësh, që gjykojnë si njësh... *Shumë-shumë-njëshat*, mendoi, janë të pakapshëm... Pse vallë i bëmë të tillë?... A mos do të thotë se kështu, mbollëm përgjithmonë farën e një herezie të përhershme dhe të papërballueshme,që sprovon epërsinë e njëshit ndaj sasisë?...

Ky mendim,(që ishte i bindur se i ishte qepur nga dika dhe, si të huaj dhe të panjohur, deshi ta përjashtonte sa më parë, nga që po ia ngatërronte kokën me dilema të tilla), i solli të dridhura dhe ndjenjën e njëfarë shkallmimi të thellë shpirtëror ,që nuk e kishte provuar më parë, prej nga pjesët e mendimit për mbjelljen e farës së herezisë edhe më tutje e sembonin tinëzisht...

Shemsi Aga e gjeti të bërë dyllë. Ushtaraku, që merrej me shërbimet e fshehta dhe ishte i gatshëm të përballohej me situata gjithë fare, karshi asaj gjendje sikur për pak u zu ngushtë, por falë përvojës, shpejt e mori veten. U ul këmbëkryq, sikur të mos kishte parë dhe sikur të mos kishte dëgjuar gjë prej gjëje, njësor si të ishte i padukshëm... Piu shurupin dhe nisi të luante rruazat e tespiheve për të lënë përshtypjen se merrej me çështjet e meditimimit e jo të vrojtimit të rastit, pra me gjërat që i përdëllenin përpara si kalimtare dhe të rrëshqitshme...

Kjo sjellje sikur i pëlqeu Pashait. Me njëfarë shtirje kërkoi shurup dhe pasi ndjeu se ishte liruar nga sikleti i pakmëparshëm, pa u sqaruar mirë rreth atyre që kishte dëgjuar nga adjutanti, por duke lënë të kuptonte se ishte në dijeni për të gjitha, kërkoi sqarime të hollësishme rreth atyre që po ngjitnin poshtë. Theksoi se edhe imtësia më e vogël për te kishte rëndësi jashtëzakonisht të madhe...

Ushtaraku i rryer me çështjet e prapaskenave dhe gjithë atyre që i shkonin përshtjellimit të qëllimshëm, pasi u kollit disa herë nisi të fliste se si ç'prej një jave po merrej me kryerjen e urdhrave të rëndësishme që lidheshin me kurorëzimin e fushatës dhe gjithë atyre që lidheshin me të...Tregoi se si në hapësirën e ngushtë të *Tokës së Lashtë të quajtur edhe Pellazgi*,pra asaj që i nënshtrohet dekretit të shtetrrëthimit dhe gjendjes së jashtëzakonshme, për pak kohë kishte mbledhur rreth njëmbëdhjetë mijë veta, të gjithë të moshës së re, të cilëve u ishte folur për kuçedrën e Perëndimit dhe të ligat që mund t'u sillte ajo, gjë që kishte ndikuar që ata të vinin grumbuj-grumbuj dhe të betoheshin se si për të luftuar nuk pretonin, se si i frikësoheshin molisjes në kohë paqeje të rreme, siç ishte ajo në të cilën ndodheshin ç'prej shumë kohësh, e të tjera e të tjera, që luftën e quanin pjesë të një lëvizjeje që duhej nënshtroar përherë për t'i përballuar kohët e liga...Ushtaraku i rryer më tutje shtoi se si ishte i bindur se shumë prej tyre përnjëmend kërkonin sa më parë atë luftën për të cilën u thuhej se do të ishte një luftë e madhe, e pashoqe dhe me gjithfarë armësh, luftë me gjysmën e botës, ku vetëm mund të fitohet...

-Isha i bindur se shumë prej tyre ishin të padurueshëm dhe kërkonin atë farë lufte që të niste sa më parë, ngaqë mendja ua thoshte se vetëm ajo u ndihmonte ta ndryshonin gjendjen e padurueshme në të cilën ndodheshin...

-E ç'gjendje e padurueshme ishte ajo,-pyeti Kryeveziri si i përgjumur?....

-Ishte si mpirje në të cilën ishin zhytur prej kohësh, qysh se kishte rënë Kështjella, ngaqë jashtë saj ata ndjeheshin të shthurur, të humbur, të pa kokë dhe fare të pashpresë. Pra, mund të thuhet se nuk ishin të mësuar me lirinë...

Ky gjykim Kryevezirit i solli të dridhura. Deshi t'i thoshte se mund të ishte e kundërta, por u përmbajt. Nisi të fërkonte fytyrën me duar dhe të mbyllte sytë që t'i shmangej sembimit që ia solli ajo që dëgjoi nga ushtaraku dhe vetëm pasi që për pak përjashtoi realitetin, ia doli paksa të qetësohej.

Por kjo ikje e përkohshme nuk e kishte penguar ushtarakun që të vazhdonte të thoshte ato që kishte nisur. Kështu, ai vazhdoi të fliste se si e keqja, që përherë e kishte folenë tek ata dhe pareshtur i ngre së prapështi edhe kur duket se ndodhen mbarë, e kishte bërë të veten, pra kishte nisë të merrte krye dhe për këtë dyshim ai ishte njoftuara nga këshilltarët kur ia kishin bërë me dije se tek vullnetarët kishin vërejtur njëfarë shqetësimi të pakuptueshëm... Ushtaraku tha se çështjen e kishte marrë me përkushtim dhe kishte urdhëruar të bëheshin hetime të ngutshme, ndërsa nga hafijet më të sprovuara kishte kërkuar të futeshin midis tyre, prej nga si vullnetarë të shtirur do t'i kuptonin të gjitha...

- Nuk vonoi dhe prej hafijeve mësova se dikush ishte futur midis tyre dhe u kishte thënë se si Perandoria e kishte shpikur armikun që vinte nga Perëndimi vetëm e vetëm për t'i qeruar hesapet me ta njëherë e përgjithmonë... Agjentët e padukshëm u kishin thënë se duhej të shpërndaheshin sa më parë dhe të iknin sa nuk bëhej vonë... Për të qenë edhe më keq, lajmi ishte përhapur si mortja, kështu që me ta dëgjuar, shumë prej tyre morën arratinë. U nisëm me të shpejt pas tyre dhe shkuam deri tek katundet e skajshme dhe për habi kudo gjenim shtëpi të mbyllura, që le për të dyshuar se intriga e tyre kishte arritur kudo dhe tashmë kishte bërë të veten, kështu që edhe gratë e moshuara që takonim aty-këtu na shikonin me mosbesim dhe nuk nxirrnin zë nga goja. Afër një lumi takuam një plak dhe e pyetëm se pse ndodhte gjithë kjo ikje, kur ende nuk kishte luftë dhe as sëmundje, ai na e ktheu shkurt e trup se po përgatitej një kasaphane e tmerrshme që do t'i merrte kokat që do t'i zinte... Në pyetjen se kush mund të ishte ai që do të bënte atë kasaphane, plaku na tha se kjo nuk kishte gjithaq rëndësi, ngaqë secili që vinte kishte këtë qëllim, qoftë nga lindja apo nga perëndimi... I xhindosur si kurrë, e zura për gushe dhe i thashë se ato ishin shpifje të turpshme, që i kishte përhapur Perëndimi me anën e agjentëve të tyre... I thashë se përgjithësimi dhe baraspeshimi i të ligës me arsyetimin se ngado që vjen ajo është e njëjtë dhe ka të njëjtat qëllime, nuk ishte vetëm lajthitje, por shkak i kobit që i priste... Ngado që shkuam përsëritëm të njëjtat fjalë. E ata na shikonin me dyshim dhe iknin. Duket se vështirë mund t'i fusim në grusht siç i patëm.

-Kush janë ata që ua turbulluan ashtu mendjet?-pyeti Kryeveziri prajshëm.

-Vendës, madhëri. Vendës. Kështjellarë... Po të ishin të huaj ne do t'i hetonim qëmoti... Këndejpári as njeri e as shpend nuk mund të sillet pa u vërejtur prej shërbimeve tona...

-Pra, serish kështjellarë?...

-Ca prej tyre i zumë me pelë për dore...

-Do të thotë, nuk qenka ndarë egjra prej grurit?... Do të thotë, se nuk është vepruar si duhet dhe sa duhet?... Pra, nuk është bërë asgjë?...

Ushtaraku zu të djersitej. Bënte përpjekje t'i ikte disi shikimit të rreptë të Kryevezirit, i cili gjithnjë e më shumë e tejperçonte.

-Madhëri, i bëmë ato që duhej bërë. Midis vullnetarëve futëm hafije të mjaftueshme, që ishin të sprovuar dhe të gatshëm t'u prinin drejt qëllimeve tona, por kujt i shkonte mendja se ata dinin ato që nuk duhej t'i dinte kush, gjë që mbetet të gjykohet si dhe pse ndodhi kjo. Edhe përkundër kësaj, ne u ramë në gjurmë vetëtimthi gojëkëqijve dhe sapo i zumë i dërguam në hetuesi dhe vepruam siç veprohet në rastet e tilla. Qenë tre veta, të një dukjeje dhe rrite, që nuk bënë vër me gojë edhe kur u përballuan me torturat më të rënda. Hetuesit gati ia mora kokën kur më tha se janë mumie e jo njerëz. Askush nuk guxon të hesht para nesh, i thashë dhe vendosa që aty për aty gjithë çështjen ta marr në mbikëqyrje të drejtpërdrejt. Shkova me

nxitim në hetuesi dhe u binda se përnjëmend ata ishin të shkallmuar sa s' u dilte më as fryma e nevojshme nga goja e lërë më ndonjë fjalë. Nga droja se do të vdisnin pa thënë gjë, urdhërova ndërprerjen e përkohshme të mundimeve deri sa ta merrnin paksa veten...

-Mjaft!Mjaft!-shfreu Kryeveziri.-Mjaft!Flet thuajse kemi aq shumë kohë sa t' i lusim armiqtë tanë të flasin kur t' u teket dhe çfarë t' u teket. Po harron se gjendemi para një sprove të jashtëzakonshme që ka të bëjë me fatet e mëtutjeshme të Perandorisë dhe gjithë botës. Po atë çast që i zutë është dashur patjetër të mësoni se prej nga i kishin ato mendime të mbrapshta. Kjo më duhej. Kjo!

-Madhëri,-foli Shemsi Agai me një ndjenjë të thellë faji.- mbase u tregova paksa i butë me torturat, por ta dini se kjo ndodhi nga frika se nuk do të kuptonim gjë prej gjëje nëse na mbesin në dorë nga shkakut i dhunës së pakursyer. Përvulësisht i pranoj të gjitha,por një është t' u hiqet gjuha e tjetër është t' u nxjerrën fjalët...

Kryeveziri u qetësua paksa dhe nuk e diti pse i ndodhi kjo. Një copë herë shikimi i treti në liqen dhe i zuri tisin e mjegullës, që i shfaqej gjithnjë e më i dendur. Nga ai tis, pas pak, iu duk se po liroheshin tre veta, që kishin tri koka të njëjta të ngjitur për një trup. Trupi me tri koka po i afrohej dhe po i afrohej sa dikur iu bë se ato tri fytyra disi po i njihte dhe se çuditërisht nga shikimet e tyre po i digjte koka sa i bëhej se diçka e fuqishme,por fare e pakuptueshme, do të shpërthente prej saj. Kjo e mbushi gjithë sokëllime sa me të shpejtë iku nga dritarja dhe ndeshi ushtarakun që po rrinte si i ngrirë.

-Ata te tre nuk do të flasin më -foli Pashai si të ishte zgjuar nga një trullim i thellë...- Dhe po qe se nuk do të thonë gjë prej gjëje,atëherë t' i bëjmë që të mos flasin kurrë...

-Fjala juaj, Madhëri . -foli Shemsi Agai si i çliruar.

-Pra,t' ua shkurtoni gjuhët...

-Do t' ua shkurtojmë deri në rrënjë...

-E mandej?... Mandej?... T' i verboni...

-Do të zhyten përgjithmonë në terrin që e kërkuan...

Pashai i madh i tha këto dhe serish mendja i shkoi se si do të tingëllonin përnjëmend ato që ata do t' i thoshin rreth arsyes së ikjes?... Ishte përnjëmend ndjenja i frikës që i kishte shtyrë drejt saj, apo mosbesimi ndaj qëllimeve të Perandorisë, që ata e kishin të ngulitur si mburojë edhe atëherë kur gjërat duken ndryshe?... Nga ato mendime nuk e kishte hetuar ushtarakun kur e kishte pyetur se mos kishte ndonjë dëshirë tjetër...Vetëm pasi që ai ia kishte përsëritur këtë për të satën herë dhe ai tashmë ishte i bindur se ishte mosbesimi i thellë që kishte vu në lëvizje instiktet e tyre, tha se kështjellarët pasi të verboheshin duhej të lireshin të lirë...

Fjalën e fundit e Kryeveziri e theksoi si shumë, sa iu bë se ajo i varej si një ngjizje, e cila serish mëtonte të tërhiqej për t' u riformësuar apo për t' u mbushur me kuptime të tjera... Kjo sikur ia ktheu sikletin e pakmëparshëm të dënjimit të kuptimit të lirisë, që i ishte qasur fare padiktueshëm si dhe ndikimit të saj tek përmasat e rebelimit që ndjente se ishte në veprim e sipër dhe shfaqej me një përmbajtje tjetër... A thua me urdhrin që pasi t' i verbonin t' i lenin të lirë, mos kishte bërë ndonjë gabim tjetër edhe më të madh,që do t' i shpaguej në mënyra të tjera?...Ky mendim serish e frikësoi sa deshi të urdhëronte që ai të tërhiqej sa më parë dhe mbase do ta kishte bërë këtë po të mos ishte hamendja rreth urdhrin të ri, që do të kishte të bënte me qëndrimin tjetër ndaj tyre, që nënkuptonte torturën mizore publike deri në vdekje para ushtarëve... Mendja ia tha se kjo do t' u pëlqente atyre, meqë i martizironte pa nevojë gjë që ishte në përputhje me botëkuptimin e tyre se vetëm viktima meritonte nderim dhe mund të ngrihej deri tek piedestali më i lartë i kujtesës dhe assesi logjika e mbijetimit në rrethana të ndryshme,e cila pillte vetëm dyshime, që rëndom lidheshin me tradhtinë... Por lirimi i tyre dhe kërkesa që e tha se duhej të mbeteshin të sillleshin të lirë, pra që atë ta përjetonin si nënçmim, a nuk ishte në përputhje me herezinë se gjendja e lirisë dhe të vepruarit në përputhje me të shkonte kundër mbylljes dhe fliste kundër saj?... Kjo e ngatërroi paksa dhe ishte i bindur se po të merrej edhe më tutje me atë hamendje edhe më tepër do të ndjehej nën kthetrat e atij

sheshimi që padiktueshëm kishte filluar ta mundonte dhe gjithnjë e më tepër t'i shfaqej më shumë si çështje e brendshme se sa e jashtme...

Shemsi Agai sikur nuk i kishte pritur ato që dëgjoi, por ishte Kryeveziri që ia la të mbështjella ngojë ato që deshi t'i thoshte me kërkesën që dënimi t'u bëhej në shesh, para turmës së “vullnetarëve”, ku për ta do të thuhej vetëm se ishin agjentë të Perëndimit dhe asgjë tjetër...

Ushtaraku u përkul dhe u bë gati të largohej. Kryeveziri porositi që para perëndimit të diellit t'i paraqitej Xhaivd Agai.

Tek sheshi i Kështjellës “vullnetarët” e sjellë me dhunë, i sillnin grumbuj-grumbuj dhe zinin vend para shkallores së madhe. Nuk vonoi dhe gjithë hapësira rrenzë përgut të lartë, aty ku valonte flamuri perandorak, ishte mbërthyer prej tyre.

Kryeveziri po shikonte nga dritarja mizërinë e vendësve të mbledhur dhe, me gjithë që sheshi që qe mbushur prej tyre, ai i shfaqej tepër i gjerë, aq sa do të mjaftonte të përfshinte edhe ata që ishin e edhe ata që nuk ishin, të gjallët dhe të vdekurit e tyre dhe se vetëm kjo do ta ngushëllonte atë çast. Edhe pse të mobilizuarit vinin dhe rraseshin pranë njëri-tjetrit sa edhe pikat e shiut të imët që binte pareshtur nuk gjenin tokën, i bëhej se e gjithë ajo që kishte ndërmarrë Shefqet Agai ishte pak, shumë pak, meqë mendja ia thoshte se jashtë radhëve kishin mbetur shumë e shumë veta, me të cilët Perandoria përherë do të kishte telashe, pa marrë parasysh qëndrimet dhe sjelljet e tyre, që në dukje të parë do të ishin lojale, pra sa për sy e faqe, por në të vërtetë, duke ruajtur ndërlidhjet e fshehta me pjesën tjetër të botës, pra me Perëndimin, edhe si të heshtur, edhe si të nënshtruar, ata përherë do të vepronin kundër saj... Duke shikuar ata që lageshin në shesh dhe rrinin si mumie, po merrej me mendimin çoroditës se sa armiq më tepër do të kishte Perandoria pas ndonjë dhjetëvjetëshi nëse masa e atyre që i rrinte përpara do të ktheheshin prej nga kishin ardhur, pra nëpër shtëpitë e tyre për të bërë një jetë të rëndomtë edhe në rrethanat e një nënshtrimi të plotë, ku ata si zakonisht me të shpejtë i nënshtrohen përshtatjes?... Para i dolën shifra të mëdha, tepër të mëdha, madje marramendëse, prej nga shihte armiq dhe vetëm armiq të Perandorisë tek shtoheshin e shtoheshin furishëm dhe asgjë tjetër... Ju kujtua se si dikush kishte folur rreth shumimit të tyre të shpejt, që ajo për pasojë do të kishte kërcënonte edhe qenien e Perandorisë dhe frymën e saj që nga themelet... Tash që i kishte përpara dhe fati i tyre varej prej tij dhe prej askujt tjetër, megjithatë, edhe në atë gjendje të pashpresë që i shihte, i bëhej se ata po ia kërkonin kokën dhe se nuk ishte ai që gjykonte dhe urdhëronte të dënoheshin si t'i tekej, por ishin ata që atë dhe Perandorinë e gjykonin deri në shkatërrim, bashkë me bindjen dhe kuptimin e kthyer në besim të patundshëm se Lindja ishte pikënisja dhe pikëmbështetja e botës dhe jo Perëndimi... Në atë rrënim vlerash i bëhej se kokën po ia kërkonin edhe ata që kishin ikur dhe ishin shpërndarë nëpër male, prej nga pritej se do të sulmonin pabesisht... Nga ai përdëllim sikur për pak e mori vetën kur u lut dhe nuk diti as vetë se kujt i kërkoi ndihmë për ligështimin e panevojshëm që iu kishte shfaqur çastin kur fati i tyre ishte në duart e tij dhe ai vendosej në përputhje me interesat e Perandorisë dhe pse e bëri këtë kur prej asaj pike gjithë botën e kishte në dorë dhe mund të vepronte me të si të donte?... Por pendimi për ligështimin si dhe të kuptuarit e forcës që mbizotëronte nuk i ndihmoi ta përballonte mllëfin që po i shtohej sa më shumë që shikonte masën që kishte përpara... Mendja edhe më tutje pa dashas po i shkonte tek përfytyrimi i shpatave, që i bëhej se qëmoti ia kërkonin kokën, tek ato që sikur ai dhe vetëm ai i shihte në shesh, por që ashtu edhe më tepër sembohej edhe nga mendimi rreth sjelljes së tyre në rrethanat e ndodhjes jashtë rrethimit dhe mburojës, që ai e quajti si *gjendje lirie*?... Ndjeu se në kulmin e atij shqetësimi, që assesi t'i hiqej e që pareshtur mundohej ta përballonte, serish hetoi Shpjeguesin e ëndrrave, që po i fliste për njëfarë *Kulle të Harresës* dhe *qenien e zbrazur*, e cila përherë kërkon të plotësohet me ato që i

përkasin, nga të cilat është privuar dhunshëm për t'u sjellë në një gjendjeje të zbrazjes së pavetëdijshme...

“Pjesa jote nuk të le të qetë... Pjesa jote nuk të ndahet... Ajo të ndjek pareshtur... Kujtesa është e pamposhtshme dhe kur nuk gjen udhë të tjera që të lidhet, në ndërdije pavetëdijshëm shfaqet si vetëdije për t'u ngjitur me të vetëdijshmen pavetëdijshëm... Ajo është sfidë shqetësuese, e përhershme dhe e pasoshme... Është mallkim, pa të cilin nuk ka rizgjim, nuk ka rikthim, nuk ka rinjohje...”

Fjalët e Shpjeguesit të ëndrrave për mallkimin sikur ia shtuan edhe më shqetësimin që i ishte lidhur mulla dhe assesit t'i ndahej në atë ditë të bezdisshme me shi të imë që nuk kishte të ndalur. Përftimi i Plakut si dhe të menduarit se diçka e humbur, e hequr, e harruar apo çfarëdo qoftë ajo, megjithatë gjithnjë e më shumë po e ndiqte, që i shfaqej si mundim i jashtëzakonshëm, për herë të parë e shtyri të pyeste veten se ç'ishin në të vërtetë ato që herë pas herë i sillleshin nëpër kokë si pjesëza të shkëputura apo si mendime të huaja, që i suleshin ashtu pa dashas dhe i vërtitshëm duke lënë pas zabullimën e një shqetësimi të pashpjegueshëm?... Ishin këto pasoja të ndonjë lodhjeje të brendshme, që po i nënshtrohej pahetueshëm dhe ngadalë, apo fjala ishte për ndonjë tronditje shpirtërore, që vinte nga pesha e madhe e përgjegjësisë perandorake, të cilën ai e ruante vetëm për vete, në vend se ta shpërndante në shumë pjesë dhe ta ndante edhe me të tjerët në përputhje me rregullat e pushtetit?... Një kohë të gjatë mendoi rreth këtyre dhe i pazoti të krijojë sado pak qartësi përballë njejeve që i shihte në të gjitha anët, iu afrua dritares dhe pasi shikoi një copë herë masën e të mobilizuarve dhunshëm që lageshin në shi, seç i përftoi një dëshirë e flaktë, që ai vend të lahej në gjak. Dëshiroi një gjak si përrua, që do të zbriste nga mali dhe do të futej në Kështjellë, e pasi t'i bënte muret e saj all, të shkonte tutje-tëhu në liqen, që edhe uji i tij të dukej i kuq dhe vetëm i kuq... Përfytyrimi i gjakut iu ngulit aq shumë, sa që nga ai çast gjithçka që pa nga dritarja që vetëm gjak, një gjak i freskët, që vinte nga të gjitha anët dhe pushtonte hapësirën e sheshit bashkë me shkalloren për të shkuar pastaj tek foltorja deri sa nisi t'u ngjitej mureve të kullave anësore më në fund për të arritur vetë Pirgun e lartë, në të cilin iu bë se tashmë në të serish valonte flamuri me zogun e zi dykrensh në mes... Në atë përpëlitje të ankthshme iu bë se gjaku po i futej brenda, se llava e trashur po ia pushtonte hapësirën e dhomës, se pasi e kishte nxjerrë jashtë, ai lum gjaku po e merrte me vete drejt një deti të gjerë, ku kishte vetëm gjak, gjak dhe tallaze gjaku, që ngriheshin furishëm në qiell dhe prej andej derdheshin në gjithë botën... I ndodhur në një pellg të pafund gjaku, ndjeu se po ngulfatej dhe mendja i shkoi se mbase vetëm Shpjeguesi i ëndrrave ishte ai që do t'i ndihmonte t'i shpëtonte atij tmerri... Por, Plaku nuk po i shfaqej e as fjalët nuk po ia dëgjonte... Në vend të tyre trashja e gjakut po e përpinte dhe mendimi i fundit që i përftoi ishte ai se ashtu mbytej në gjakun e vet...

Kur u lirua nga ankthi i rëndë, si në mjegull pa Xhavid Again, që po i rrinte pranë fare i qetë.

Kryevezirit i erdhi rëndë që ushtaraku i lartë e gjeti në atë gjendje, por edhe më rëndë i erdhi kur i shkoi mendja se i zhytur në atë ankth kishte folur ndonjë fjalë që nuk duhej ta fliste, e aq më pak të tjerët ta dëgjonin... Sikur t'ia kuptonte mundimin, ushtaraku i rryer i tha se sapo kishte hyrë, se e dinte se po meditonte, siç i kishte hije njeriut që mbante mbi supë barrën e gjithë botës dhe se kjo ishte e madhërishtme...

Kryeveziri e vodhi me shikim disa herë dhe deshi ta pyeste për diçka që as vetë nuk e kishte të qartë se çfarë ishte ajo që duhej ta dinte. Pasi fshi ballin nga djersët, pa ndonjë rregull, pyeti se *çfarë thonë vullnetarët për ata që mbetën pa gjuhët dhe pa sy?*...

Si të kishte pritur atë pyetje, ushtaraku bëri disa lëvizje çliruese dhe tha se vullnetarët dukeshin si të ngrirë gjatë kryerjes së dënimit dhe se askush nuk kishte lëvizur...

-Do të thotë se shikuan pa u shqetësuar gjithqë, -pyeti Kryeveziri gjithnjë me një pjesë të turbullimit që i kishte mbetur në kokë?

-Dukeshin si mumie, por kjo nuk do të thotë se nuk ishin të shqetësuar...

-Ç'u bë me ata të tre?...Nga shkuan?...

-Kuptova se shkuan drejt pjesës së rrëpishme të Kështjellës dhe u bënë pjesë e natës...

Kryevezirin sikur nuk e kënaqen ato që ia tha ushtaraku. Në atë gjendje që ishte, lente përshtypjen e një frike që i ishte futur brenda, por që i ishte qepur për fytyrë saqë lehtë i shihej. Pasi theu gishtërinjtë fare hamendshëm dhe disa herë u soll poshtë e lartë nëpër dhomë,dikur tha:

-Sonte duhet t'ia fillosh...

Xhavid Agai mori qëndrim gatitu dhe dukej fare i ngrirë.

-Merr taborët ndëshkimore dhe nisja,-foli qetas Kryeveziri.

-Peqe, Madhëri. Këtë urdhër pritja...

-Kujtoj se i di të gjitha?...

-Të gjitha,të gjitha i di,Madhëri...

-Mos harro ditarin...Shëno të gjitha dhe dije se ato më përkasin vetëm mua dhe askujt tjetër...

-E qartë,Madhëri...

Pasi një copë herë shikuan njëri tjetrin në sy si të ngrirë dhe pasi në atë ngrirje e sipër ndërsjellta u puç diçka e pathënë e afrisë ndërlidhëse,Kryeveziri i dha leje ushtarakut të nisej i bindur se me të shkonte edhe fryma e tij. Kur po largohej ushtarakut i tha edhe këto:

-Të mobilizuarit dhe të mbledhurit tjerë të rreshtohen sa më parë dhe të nisen kah deti...Atje do të ndodh një fund dhe një fillim,apo të dyja së bashku?...

(Shënimi plotësuese i Kullës së Harresës)

*...çfarë thanë vullnetarët për ata që mbetën pa gjuhë dhe pa sy:

Çastin që i morën për t'i ndëshkuar aq rëndë sa të mbesin në terrin e përhershëm dhe të gjykuar të sillen në një shurdhim të pafund, ua thanë edhe këto:shikojeni për të fundit herë botën...Hapni mirë sytë që territ tuaj t'u mbesin në kujtesë ata që së shpejti nuk do të jenë më...Pa sy dhe pa gjuhë dhe pa ata që do t'iu mëshironin, do ta provoni njërin ndër mallkimet më të mëdha...

Ata të tre dukej sikur nuk shqetësoheshin rreth asaj që i priste. Shikuan të mobilizuarit dhe si me një gojë thanë se si fryma dhe mendimet e tyre,bashkërisht do t'i shërbenin rizgjimit të pashmangshëm,pa marrë parasysh se kur do të ndodhe...

Ato që i thanë dhe qëndrimi i tyre sikur e frikësuan xhelatin, por e tmerruan edhe hosodobashin që ua mbante duart të lidhura gjatë kohës së ndëshkimit... I shqetësuar dukej edhe Shefqet Agai, i cili kërkonte që dënimi të kryhej sipas ceremonialit të paraparë.

Megjithatë,Shefqet Agai,që rrinte kundruall tyre në pjesën e sipërme të foltores, mu afër tempullit të thyer,mend plasi kur ata nuk pranuan të pendoheshin, por në vend të fjalës më shirë,ata serish zunë n'gojë rizgjimin e përbashkët dhe shpirtin si mburojë...Edhe pse e dinte se edhe pendimi më i sinqertë nuk do t'iu ndihmonte fare,ndonjë fjalë të thënë prej tyre në atë drejtim do ta dëshironte mbi botën... Por ata, pasi që për të tretën herë përsëritën fjalët për rizgjimin pritën të qetë ato që ua tha kadiasçeri rreth dënimit dhe të qetë pritën gjilpërat si u afroheshin kah sytë për t'ua marrë përgjithmonë dritën e botës... Sjellja e tyre duket se Shefqet Agai e zemëroi por edhe e ligështoi njëherësh sa që zu të dridhej dhe po të mos ndodhej në atë vend do të shfrynte me sa fuqi kishte...Por, kur shkoi në dhomë dhe u ballafaqua me terrimin, që ngadalë po i futej brenda, papërmbajtshëm nisi të çirrej dhe vazhdoi kështu të çirrej edhe për shumë kohë ngaqë i dukej se mbrohej nga qëndrimi i tyre mospërfillës e për më tepër nga jehona e fjalëve rreth rizgjimit të përbashkët,që kokës së tij po i përplaseshin nga të gjitha anët si një ogur i ligë...

Për t'i ikur atij oguri,për pak iu bë se ata i kishte pranë dhe ai po u thoshte diçka rreth asaj se si nuk i kishte dënuar,se si zbatonte vetëm urdhra, e tjera e tjera... Në atë përpëllitje,

pasi që nuk çirrej më, Agai nisi të fliste përçartë. Çapiste diçka rreth një ploje të tmerrshme dhe thoshte sikur nuk kishte hak, se të tjerët ishin ata që sajnin urdhra, që bënin plane...

Në atë gjendje ankthi e takoi edhe këshilltari i Kryevezirit, që erdhi t'i kumtonte urdhrin nga lart lidhur me ato që duhej ndërmarrë... Këshilltarit të Kryevezirit i tha se si tre veta, pa sy dhe gjuhë, po e ndiqnin...

- Nuk keni pse shqetësoheni, - i tha ai, - ngaqë ata tashmë janë atje ku e kanë merituar, pra në ferr... Pse të ndaleshin kur qëmoti ishin nisur për atje?...

- The se ndodhen në ferr? - pyeti Agai i mbytur në djersë...

- Shkuan ku e kishin vendin, aty ku gjenden kundërshtarët e Perandorisë... Kush nuk u tha të shkonin, por këmbët e tyre i bartën drejt pjesës së rrëpirët kah gremina e pafundët, ku sharruan përgjithmonë...

- Do të thotë, - foli Agai gjithë shqetësim, - nuk do të shihen më?...

- Ata nuk i takon më dot njeri, pos djallit, - foli Këshilltari prajshëm.

- Po me qëndrimin e tyre mospërfillës çfarë do të bëhet?...

Këshilltari u shtir kinse nuk dëgjoi ato që tha ushtaraku i lartë, por Shevqet Agai serish shtroi të njëjtën pyetje, bile me një zë të lartë, gjë që Këshilltarin e detyroi t'i përgjigjej kështu:

- Ata nuk patën qëndrim. Nuk e kanë pasur ndonjëherë, ngaqë ishin vetëm harbut të shkretë dhe asgjë tjetër... Nuk ia vlen marrja me ata hiça ...

- Këtë nuk do ta thosha, - ndërhyri Shevqet Agai. - Këtë nuk do ta thosha... Ai që nuk e përfill vdekjen dhe flet për rizgimin, si për një çështje të shpirtit të përsëritshëm, nuk është hiç, si po thua...

Këshilltari nuk e çoi më gjatë. Ishte i bindur se Agai nuk i kishte punët mirë dhe se për këtë duhej lajmëruar sa më parë Kryeveziri.

Kur po dilte ia la këtë porosi Shevqet Agait:

- Madhëria e tij, Kryeveziri ynë, urdhëron që në mesnatë të niseshe me vullnetarët dhe të mbledhurit tjerë. Para se të ndodh kjo së pari duhet të paraqiteni tek Madhëria... Besoj se deri atëherë do ta merrni veten...

Shevqet Agai u vesh dhe u mbath me nxitim. Disa herë u soll nëpër dhomë dhe nuk dinte se çfarë kërkonte me tamam. I shqetësuar siç ishte, doli jashtë dhe brodhi shkujdeshshëm andej nga e çonin këmbët. Ata që e panë në atë gjendje, nuk e patën të vështirë të hetonin diç jo të rëndomtë tek sjelljet e tij.

Roja anësore, kur po dëshmonte, tha se Agai i kishte thënë se po e ndiqnin shikimet e tre vetave që u gjymtuan në shesh dhe se duhej patjetër t'i takonte, pa marrë parasysh ku ishin...

"Bëri me dorë kah pjesa e rrëpirë e Kështjellës, në anën e greminës, dhe pas pak u dëgjua një jehonë e thekshme që shpejt e përpiu nata..."

7.

Kryeveziri la porosi ta zgjonin para ferkut të dritës dhe ndolli një gjumë të thellë, ku shpresonte të sharronte me të gjitha ato që e i qepeshin si mundim kohëve të fundit. Por gjumi nuk e mori që nuk e mori. Më kot u përpoq nga koka t'i përjashtonte ato që ia bënë ditën e pafund, kështu që së pari iu shfaq ai deti i kuq i gjakut, e pastaj iu shfaqën ata të tre që ua prenë gjuhët dhe i verbuan sy të mobilizuarve që i merrnin për "vullnetarë". Edhe pse nuk i pa kur i sollën para masës dhe i masakruan botërisht, në atë përfytyrim ata po vinin disi të njohur, fare të njohur, thuajse kishte qenë gjatë me ta. Dhe ata të tre, për të cilët këshilltari i kishte thënë se dukeshin të ngjashëm si të ishin një njeri i vetëm i shumëzuar në tresh, po i përvijoheshin si një krijesë me tri koka. Më vonë, iu duk se nga i njëjti trup u bënë tre sish, por tash me një kokë dhe kështu me radhë, herë një trup me tri koka e herë një kokë me tre trupa, që pa marrë parasysh dukjen dhe ndryshimet që pësonin nga çasti në çast, ata po i

afroheshin dhe po i afroheshin sa ua pa mollëzat e dala e sytë e kaltër prej të cilëve shkëndijonte një rreze e çuditshme që i ndërli dhe me shikimin dhe kërkonte t'i hynte në kokë...Në atë përpëlitje ishte i bindur se me anën e asaj rreze që kalonte nga shikimi i tyre tek ai, si një frymë e dridhshme, që pakuptueshëm po ia pranonte gjithë qenia, ata po i thoshin diçka, që megjithatë asgjë nuk kuptonte nga ato që tashmë i ndërli dhe në depërtim e sipër e mbushnin me njëfarë ndijimi, i cili, diku në brendi, i krijonte njëfarë thyerje të çuditshme, që pak më vonë iu kthye në një mundim të kuptuarit, kur i bëhej se nga moria e atyre që po i hynin disa si thermi po i shkyçte, por që pa i sqaruar mirë, ato serish i mbylleshin për t'iu bashkuar furisë së tallandisë që i sillej trupit si mundim... Pak më vonë ndjeu se thërritë e mbetura sikur herë pas here i shkëndijonin disa kuptime si shkrepitima, por që shpejt fikeshin për t'u shfaqur më pas si porosi të shkapërderdhura, që megjithatë në atë shpejtësi nuk mund të lidheshin... Në atë gjendje, që ai tashmë e ndjente si bredhje shkëputëshe nda qarkut të një hapësire jashtë kohës, hetonte se lirohej nga ankthi që e kishte mbërthyer kushedi se kur dhe se aty gjithçka i nënshtrohej përvijimit nëpër një pikë të vetme, që lidhej me njësimin marramendës të flakërimit të dritës, që mund të merrej si çast, por edhe si amshueshmëri... I paaftë që t'i afrohej asaj pike të dritës dhe në pamundësi të qartësonte vetëtimën e qarkut të shumësisë së kuptimeve, që shkonin furishëm kah pika, dikur ndjeu se po i afrohej një mjegullimi, nga i cili pas pak hetoi se po i shfaqeshin gjarpërinjtë të shumtë, që fërshellenin dhe në rrëshqitje lemëritëse i afroheshin një humnere. Çuditërisht ata nxirrnin zëre me të cilat bënin me dije se po i iknin zjarrit, që ai ua kishte vu para njëmijë vjetësh...

“Po futemi në kohën e akullnajave”,dëgjonte të fërshellenin gjarpërinjtë...“Aty do të mbesim të ngrirë gjatë njëmijë viteve të ardhshme... Atje është edhe shpirti yt... A të ngushëllon kjo?...“

Ndjenja e akullnajës dhe mbetja në atë ngrirje për njëmijë vjet e trishtoi sa që nisi të rënkonte me fjalët se pse nuk gjente qetësi askund... “Psehu” i ishte ngjitur për gjuhe si ngulfatje...

Kur i kaloi mundimi i ankthit, pa Këshilltarin si po ia fshinte djersët, por para kishte edhe ushtarakët e shtangur, gjë që iu dukën se ishin të ngrirë dhe pjesë të asaj akullnajë, që pak më parë i kishte përfutur.

-Po ndodh një lëvizje e çuditshme së cilës duhet t'i nënshtrohem,-foli Kryeveziri gjithë mundim dhe këtë e përsëriti edhe për të dytën dhe të tretën herë pa qenë i sigurt se ato që i tha qenë njëmend fjalët e tij, apo të një tjetri, që fliste me gojën e tij?... Për herë parë i shkoi mendja se mbase qenia e tij shfaqej dyshe, nga ajo që e ndjente dhe e thoshte në mënyrë fare të natyrshme, por që përbëhej edhe prej një tjetre, fare të panjohur, plot e përplot pjesë të shkëputura, me shumë e shumë shqetësim, një det i turbullt me tallaze dhe furtuna, që i përplaseshin nga të gjitha anët... Edhe këto deshi t'ua shpjegonte ushtarakëve, por me të shpejtë hoqi dorë kur i ra ndërmend se ata,që i kishte kundërshtarët më të mëdhenj dhe prisnin çdo çast që t'i hakmerreshin, këtë do ta shfrytëzonin si rast për ndonjë kurdisje tjetër, që ai vështirë do t'i kundërvihej...

-Lëvizja është pjesë e jona,e suksesit tonë... Andaj është e natyrshme se asaj duhet t'i nënshtrohet e gjithë bota...,-foli Këshilltari, i cili ashtu dëshironte të hiqte sa më parë tisin e mjegullës së dyshimit që kishte filluar të shfaqej midis tij dhe ushtarakëve pas hamendjeve të tij të fundit,që ishin gjithnjë e më të dukshme...Më tej, ai foli rreth ndërrimit të stinëve dhe ndikimit të tyre,me ç'rast përkujtoi se ndryshimet më së pari dhe më së shumti i ndjejnë mendjet e ngarkuara me punë të mëdha...

Kryeveziri heshti. Shikoi me radhë ushtarakët dhe prapë gjeti Këshilltarin, i cili po ia bënte me dije se koha e asaj lëvizje tashmë kishte ardhur dhe se duhej të nisej kah deti, meqë, sipas urdhrat të tij dhe udhëzimeve të tjera të hollësishme, të mobilizuarit që hiqeshin si vullnetarë dhe të mbledhurit tjerë (mbi njëmbëdhjetë mijë sa ishin), tashmë ishin nisur. Këshilltari theksoi se pas dy ditë rrugë, ata që hiqeshin si vullnetarë dhe të mbledhurit do të arrinin në Liman, prej nga, gjithnjë duke cituar Kryevezirin, theksoi se „do të futen në atë

luftën kundër Perëndimit, që duhet të fitohet në mënyrë që pastaj e gjithë bota të bëhet Lindje dhe vetëm Lindje, dritë dhe vetëm dritë...”

Por, Pashai i madh duket se nuk ua vuri veshin atyre që i tha Këshilltari. Rrinte si i ngrirë dhe nuk e dinte as vetë pse me sy kërkonte diçka të panjohur tek flamuri perandorak, që hapej kundruall tij në pjesën ballore... Pas një heshtje, megjithatë, fare papritmas foli e tha:

-Prej tash do të vrasim gjarpërinj... Do t'i vrasim gjithë gjarpërinjtë e botës...

Foli kështu dhe heshti, sikur të kishte dhënë një urdhër të rëndomtë, kahe të pritur, ndërkohë që me shikim edhe më tej po vidhte flamurin perandorak, ku shpata e praruar që shtrihej nga pjesa e djathtë në të majtë të hapësirës me majën kah Perëndimi, sikur ishte aty për t'ia tumirë ato që pak më parë kishte thënë Këshilltari rreth Lindjes si burim i përhershëm drite, që e siguronte vetëm forca dhe përdorimi i saj... Në mendimet e tij, që i ngatërroheshin gjithnjë e më shumë, megjithatë, ishte depërtimi i një fije të saj drite magjike, jashtë kohës dhe hapësirës, që rrudhej e rrudhej si frymë për t'u përbiruar nëpër errësirë nëpërmes një pikë të vetme, që pasi ta ketë kaluar atë, që matet më forcën e imtësisë së paparamendueshme, të shfaqej si burim i përhershëm i lëvizjes, që përsëritjes së të njëjtës i jep kuptim mbi gjërat dhe idetë... I përballuar me tronditjen e mëdyshjes rreth dritës dhe lëvizjes, që i bëhej se e zhvendoste nga njëra gjendje në tjetrën, që e bartte nga njëri përcaktim tek tjetri, ku e kapshmja i vinte si e tejdukshme, ndërsa e pakapshmja i shfaqej si sfidë i madh kureshtje kah të panjohurat, Kryeveziri nuk po jepte shenja se do të sqaronte ato që kishte thënë rreth vrasjes së gjarpërinjve, që po të lidheshin me domosdonë e ndodhjes së lëvizjes, që e tha pak më parë, do të mund të kuptoheshin se fjala ishte për qërimin e hesapeve me armiqtë, e as që po thoshte ndonjë fjalë tjetër rreth urdhrave që pritnin ushtarakët, të cilat kishin të bënë me ato që lidheshin me Limanin dhe ngjarjet në të, ku besohej se fillonte beteja aq e pritur me Perëndimin...

Në atë gjendje shurdhe, ushtarakët gjithnjë e më shumë kishin arsye të bindeshin se Veziri i madh gjithnjë e më pak merrej me punët e mëdha të Perandorisë, e gjithnjë e më shumë po sharronte në një ngatërrim shpirtëror prej nga vështirë që dilte...

Megjithatë heshtjen e mundimshme e ndërpreu Këshilltari, i cili serish iu drejtua Kryevezirit me njoftimin rreth nisjes së atyre që hiqeshin si vullnetarëve kah deti, që do të duhej të paraqiste çastin kthesë të gjithë fushatës. Sikur të ishte shkëputur nga ndonjë ëndërr e ligë, Kryeveziri brofi në këmbë dhe tha:

-Erdhi koha të ecim rrugës së pafund, drejt pikës së dritës, ku përbirmi nëpër të na bën të përhershëm apo të paqenë...

Fjalën e fundit e tha si të lënë përgjysmë. Vetëm pasi vuri nishanet dhe rregulloi shpatën e praruar, dukje me tamam ai që mbante në dorë çelësat e Perandorisë më të madhe të botës...

Kur hyri në karrocë dhe pa ferkun e dritës që me njëfarë kuqërimi të lehtë po i vijëzonte majat e maleve, Këshilltari po ia bënte me dije se ishte dita e njëzetekatërtë e muajit të tretë e vitit të shenjtë perandorak, apo dita e katër e pranverës, sipas kalendarit vendor me të cilin matej koha në hapësirën e „*Tokës së Lashtë*” dhe tutje saj kah shtrihej bota e mëkatshme e kryqit. Më tej, Këshilltari i tha se detin e kishin larg dy ditë rrugë e edhe një tjetër duhej ta bënë deri te kufiri i ndarjes së dy boteve... Këshilltari pastaj i foli diçka edhe rreth atyre që lidheshin me formacionet ushtarake që ndodheshin në Liman si dhe ato që ishin ndërmarrë rreth arritjes atje të të mobilizuarve me dhunë që heqshin si vullnetarëve... Por Kryeveziri nuk po ia vente më veshin Këshilltarit dhe atyre që thoshte se do të ndodhnin në Liman... I bëri përshtypje e dhëna se ishte dita e katër e pranverës. Në kronikën perandorake do të mbetej e shënuar vetëm si dita e njëzet e katër e muajit të tretë dhe assesi ndryshe. Thyerja e stinëve, rreth së cilës ia bëri të ditur Këshilltari, e që i përkiste matjes vendore, seç ia kujtoi thyerjen e motit e bashkë me të edhe shkëputjen e kohës, që nuk ishte vetëm çështje e ndarjes së dimrit me pranverën, por diç më shumë, ngaqë tek ai kapërcyell ndodhej pleksja e kthesave të

jashtëzakonshme nga njëra gjendje në tjetrën, që atij ia përkujtoi gjendjen e brendshme dhe përvëliment me të cilat ballafaqohej prej kohësh drejt një thyerjeje të pashmangshme, që vinte nga jashtë... Shpjeguesi i ëndrrave dikur i kishte thënë se jo rastësisht kufijtë e botës kapërcenin andej kah muajt gjysmë-gjysmë shënonin kapërcimin e stinëve, meqë vetëm nëpër ato hapësira, ndërrimi i moteve pasqyrore edhe ndryshimet shpirtërore e të tjerat dhe përcaktonte lëvizjet e tyre në përputhje me qarkun e kësaj dinamike. Aty ku vetëm një çast i vetëm, i përhershëm dhe i padiskutueshëm mundëson që kalendari i natyrës të demonstrojë fuqinë e mrekullueshme prej nga shënohen kthesat e mëdha, i kishte thënë Plaku, edhe mendja dhe sjelljet e njerëzve ndjekin kahun e kësaj ecurie... Kur Kryeveziri kishte thënë se mos kjo do të thoshte se andej kah thyhen stinët perandoritë doemos se bëhen të paqëndrueshme nga ky ndryshim dhe mbase këtu duhet kërkuar arsyet e ngecjeve pse aty dhe vetëm aty edhe më tej, si një puqje, e cila mund të merret edhe si baraspeshim, ndodh kundërshtimia e dy botëve, si një fatum të cilit duhet përshtatur, Shpjeguesi i ëndrrave, i vetëdijshëm se mund të binte në kurthin e herezisë, ishte munduar që gjithë çështjen e shfaqjes së dritës dhe forcës së rrezeve të diellit, që ai e dinte se ishte pjesë e një rregulle të thjeshtë astronomike, që ndiqte ligjet e natyrës, ta shpjegojë me mistifikimin që i bëhej këtij ndryshimi natyror me anën e përkufizimit të së mirës dhe të keqes brenda vetë njeriut, që pastaj e gjitha të marrë përmasat e besimit rreth përsëritjes së të njëjtës, ku fundi është fillim dhe fillimi njëherësh shfaqet si fund, pra të vazhdimësisë së përhershme, ku ndryshimet janë pjesa më e rëndësishme e asaj sjellje që i baraspeshonte çështjet... Ky shpjegim i Shpjeguesit të ëndrrave, që atëherë i ishte dukur i parëndësishëm dhe si pjesë e ngatërimit të tij, sikur po i ngulitej gjithnjë e më shumë në kokë dhe po e barte nëpër një lëvizjeje qarkore, ku gjithnjë e më shumë i shkonte mendja se do të mbetej përherë në ngërthimin e gjendjes as andej as këndeje, si shtysë vetënjuhje, por edhe si mallkim i përhershëm... Nga ajo tallandi mendore doli vetëm kur drita përfundimisht mundi terrin dhe ai, nuk e diti se pse, pyeti Këshilltarin për numrin e të sëmurë midis atyre që hiqeshin si vullnetarë, që nuk u nisën me eshalonët e rregullta drejt Limanit.

-Qenë rreth tetëqind veta, i tha Këshilltari si me droje, i bindur se pjesën e rrugës do ta kalonte me pyetje-përgjigje të shkapërderdhura dhe fare të shthurura, që kishin filluar çastin që Vezirin e Madh e kishte gjetur në gjendjen e atij ankthit, nga i cili assesi të lirohej.

-Ç'ilet kishin?-foli prapë Kryeveziri, gjithnjë i shpërqendruar dhe me shikim të mjegulluar.

-Kush nga ethet, kush na eshtrat, kush nga veremi, e kush nga sëmundjet që nuk u dihen emrat...

-Paskan qenë si shumë, shumë?...-mërmëriti Kryeveziri hamendshëm.

-Pati edhe më shumë, por kush çau kokën për ta që hiqeshin disi. Po të shikoheshin si duhej, gjysma do të fironte...

Kryeveziri përpak zyri fytyrën me duar dhe nuk e kishte të qartë pse nisi të çapiste fjalët „tetëqind...tetëqind herë tetëqind...tetëqind herë njëmijë ...tetëqind mijë vjet...“ Ato po i silleshin nëpër gojë mundimshëm dhe assesi t'i hiqeshin...

Megjithatë, në atë gjendje përpëlitesë të Kryevezirit, kur ishin vetëm në karrocë dhe shkonin drejt Limanit dhe nuk kishte kurrfarë arsye të përkujdesej që në kundrim me të tjerët dhe veçmas me ushtarakët, t'ia ruante baraspeshën e të menduar, Këshilltarit papritmas zunë t'i cyteshin mendimet për Perëndimin, apo për atë pikën ku do të fillonte lufta e shenjtë, ajo luftë kaherë e pritur në ethët e së cilës ndodhej Perandoria nga çasti kur Daut Pashai, që u vlerësua si një dhuratë perëndie, u kthye fitimtar nga fushata në „*Tokën e Lashtë*“, që kishte përfunduar me marrjen pa luftë të Kështjellës së saj të fundit... Kur të fillojë ajo luftë, kishte dëgjuar të flitej sa e sa herë nëpër mbledhje të rëndësishme, do të dridhet toka, do të kallet qielli, do të skuqen yjet, do të ndodh një lëvizje e paparë drejt ardhmërisë së ndritshme... Çfarë nuk kishte dëgjuar të thuhej për atë luftë të luftërave, me të cilën njëherë e përgjithmonë merrte fund ngecja e madhe... Nga të gjitha ato që thuheshin, ai krijoi doemos përfytyrimin e

vet për botën e cila një ditë do të mundej. Kështu, Perëndimi për të ishte një terr i përhershëm, një terr i thellë i vendosur kushedi se kur, në të cilin edhe dielli mashtrohej për të perënduar me çka ndodhte përsëritja e të keqes. Mendja ia thoshte se po të mos ishte ajo botë ogurzezë, edhe dielli, i cili ngrihej në lindje, pra në botën e shëndetshme dhe në lëvizje, të cilës kishte fat që i takonte, nuk do të kishte perëndim dhe me këtë nuk do të kishte as natë, nuk do të kishte as terr dhe as përshumim të ligësisë, që ndodh përbrenda saj. Prandaj, a nuk meritonte më shumë se urrejtje një botë e tillë, e cila rrafsh gjysmën e kohës e mban diellin peng?... Përvijimi mendimeve se „lindja duhet ta mund errësimin“, ia krijoi bindjen se kjo prishje, që mund të quhej edhe fatkeqësi dhe sido ndryshe, medoemos njëherë duhej ndrequr ashtu që të kishte vetëm dritë, të kishte vetëm jetë dhe kjo do të thoshte se terri duhej hequr, e bashkë me terrin hiqeshin edhe mendimet e liga dhe gjithë ato që i ndihmonin herezisë dhe asaj që quhet pjesë e mëkatshme... Nga ato që dëgjoi vite e vite u bind se çështja e shkuarjes kah Perëndimi nuk ishte vetëm çështje e luftës, që një ditë do të ndodhte dhe do të përfundonte siç duhet, por ajo për më tepër atij i shfaqej edhe si pjesë e një rregulli të ri, tjetër nga që ishte, ku nuk duhej të kishte natë, meqë ishte i bindur se ajo ishte pjesë e Perëndimit dhe si e tillë duhej të zhdukej, por nuk duhej të kishte as mendime të errëta, nuk duhej të kishte hamendje çfarëdo qofshin ato dhe nuk duhej të kishte tjetër që lidhej me të kundërtën e dritës... Në këtë ndreqje sikur nuk e kishte të qartë se çfarë do të bëhej me diellin?... A do të pushonte ndonjëherë rrugëtimi i tij dhe, po qe se do të ndodhte, që në përputhje me ndryshimet ai të ngrihej në një pikë të vetme prej nga me dritë do të ushqente gjithë botën, si do të quhej ai vend?... Si edhe shumë herë më parë, iu bë se kjo pyetje i mbeti pa përgjigje sa u kurthua. I shkoi mendja ta pyeste Kryevezirin për të gjitha, sidomos për atë se a do të shfaqej më vonë ndonjë Perëndim tjetër me të cilin lidhej herezia, dhe, a ishte e domosdoshme që përpara secilës ngecje të shfaqej doemos një rrip toke i mallkuar, siç ishte „*Toka e Lashtë*“?... Dhe nëse do të dilte ndonjë pengesë tjetër, që nuk ishte e thënë të quhej Perëndim, a ishte e domosdoshme të vendnumërohej me vite e vite në atë tokën pararoje, që luftës së shenjtë, t’i lejohej gjithçka, që përnjëmend ajo të jetë e shenjtë?... Deshi ta pyeste edhe për gjëra të tjera që aq gjatë i ishin sjellë nëpër kokë si një mjegullim i madh, por pa se tashmë ishte zbardhur dhe një rreze drite, që herë-herë gjente rrugën deri tek fytyra e Kryevezirit, i jepte asaj një ashpërsi të frikshme. Një çast madje iu bë aq i vrejtur dhe i egër sa kishte bindjen se para kishte një të mundur keqas, i cili u përngjante të tjerëve që nuk ia dolën. Mos, o zot, pëshpëriti Këshilltari, të shoh edhe një disfatë! Vetëm këtë mos ta shoh. Dhe nëpër kokë me shpejtësi i kaluan gjithë ato takime të pafundme me kryevezirët (qenë tre para të tanishmit), me ushtarakët e lartë dhe me gjithfarë titullarësh të tjerë, që nuk bisedonin për tjetër pos për Perëndimin dhe „*Tokën e Lashtë*“, që u kishte dalë përpara si bjeshkë. Kur do të marrin fund këto, pyeste veten?... Kur do të fillojë më në fund ajo fushata e shenjtë?... Kur?... Kur?... Por, kur-kurri nuk kishte të sosur. Përsëritja e saj i përngjante një krrokatë të thekshme, që shoqërohej me të njëjtat ankime, me të njëjtat dështime, me të njëjtat psherëtime dhe me të njëjtat rënie... Dhe në gjithë atë lëmsh duhej të përzihej medoemos dhe pashmangshëm „*Toka e Lashtë*“, si e pakapërcyeshme, si mallkim që doemos gjen ata që ëndërrojnë shumë pa qenë në gjendje që ta kuptojnë si dhe sa duhet rëndësinë e saj... Pas të gjitha atyre bisedave dhe disfatave, të cilat shpesh emërtoheshin „si ngecje të përkohshme“, filloi të mendonte se ai vend ogurzi mbase qe krijuar të jetë vetë kobi i perandorive, por edhe i tij, pikërisht që të ruhej ajo baraspesha e fuqisë së përhershme, që mundëson edhe të qenit. Mendja ia tha se ai dhe Perandoria kishin thuar se të njëjtin fat, që të përpëliteshin përherë brenda mbylljes në atë rreth të çuditshëm të pritjes së bezdisshme (ku gjithçka ishte e njëjtë), që bashkërisht të mbeteshin të kyçur para Kështjellës së mallkuar, e të tjera e të tjera meqë ishte pjesë e ligjit të baraspeshës... Kur erdhi Kryeveziri i ri u hapën fjalë se vendnumërimit megjithatë po i vinte fundi, por ai as që donte ta çante kokën me ato që për të ishin të pabesueshme. Mbi tridhjetë vjet pritje qenë të bollshme t’ia bënim me dije se gjithçka në këtë botë, arrin deri aty sa bëhet e pandryshueshme nga shkaku se nuk lejohej njëfuqia. I erdhi keq vetëm pse ajo gjendje ndodhi mu atëherë kur ai priste të kundërtën. Por

e ngushëlloi mendimi se meqë disa gjëra nuk mund t'i ndryshonin edhe më të fortët, andaj pse ai robi i vocërr të çante kokën me të pabesueshmet që thuheshin për Daut Pashën rreth asaj se do të çonte luftën më tej?... Madje, kur pas një kohe dëgjoji lajmin, të cilin mendja ia thoshte se nuk do ta dëgjonte kurrë, (se Kështjella e mallkuar që marrë në saje të njëfarë mrekullie të jashtëzakonshme të Daut Pashahite dhe jo me armë), i shkoi mendja se nga nivelet e larta qëllimisht që hapur ndonjë lajm i remë, me të cilin dëshirohej të shkundej letargjia e gjatë, që kishte kapluar prej kohësh Perandorinë e ngujuar nga shkaku se ligjet e baraspeshës këtë e diktonin... Megjithatë, kur po bëhej gati fushata e shenjtë dhe i kishin thënë se duhej të nisej me Kryeveziri i ri për të qenë dëshmitar i mrekullisë së mrekullive, nuk diti të shpjegojë mbërthimin që e rrëmbeu të tërin ngaqë nuk i besonte asaj, por që këtë nuk guxonte ta shprehte... Fytyrës së tij të bardhë i kaloi një zjarrmi që provoi t'ia kthente gjallërimin e dikurshëm, por hetoi se ishte i paaftë për diçka të tillë... Perëndi, fshani, pse më dënove të jem pjesë mashtrimeve që duhet t'i besohet?... Një errësim e mbërtheu kur më në fund ia pranoi vetes atë që prej shumë kohësh e dinte se tek merrej me mendimet e huaja dhe duke ua përgatitur të mëdhenjve, kishte kaluar një jetë, që mund të quhej vetëm e huaj... Vonë është, vonë, tha, për të ndryshuar diçka... Edhe njëqind fushata të shenjta po të ishin të suksesshme nuk ma ngrohin më zemrën... Vonë është... Vonë... Në këtë ngashërim vërejti një zbrazje që iu shfaq si kllapi gjumi. Mbase do të t'i jepej asaj gjendje, po të mos ishte një çirrije e thekshme, që e qëllloi në kokë. Kur hapi sytë, pa Kryevezirin të mbytur në djersë, që po kërkonte ndihmë.

Brofi dhe deshi t'i ndihmonte, por u zu ngushtë kur hetoi se ai kërkonte të çlirohej nga një shtrengim i brendshëm, që i ishte kapur për fyti. Nxitoi t'ia hiqte duart prej fytit dhe pasi ia doli kësaj me shumë mundime, pa se si Kryeveziri, befaz u qetësua. Duart, që pak më parë ia mbërthenin qafën, i dukeshin të lodhura dhe si të këputura...

Pas pak Kryeveziri tha:

*-Çfarë ngjau me mua, vallë?...**

Këshilltari mbeti i shtanguar, ngaqë nuk e kishte të qartë se kujt i shtrohej ajo pyetje. U mat të thoshte se po ecnin në karrocë që nga mesnata dhe se kishte fjetur i qetë nga çasti kur ferku i dritës ishte dukur majave të maleve, ndërsa vetë, siç i ndodh në gjendje e ngjashme, ishte marrë me disa përsiatje të kota, por iu duk se ai sqarim do të ishte fare i panevojshëm përballë asaj gjendjeje tepër të rëndë... Një çast, madje, deshi t'ia tregonte të gjitha ato me të cilat kishte vrarë mendjen gjatë atij udhëtimi për t'i thënë haptas se i dukej se ajo që quhej fushatë kah Perëndimi ishte një mashtrim dhe hiçgjë tjetër, por hetoi se nuk kishte forcë të nxirrte sheshazi mendimet e formësuara, meqë kjo lidhej me atë që ai e quante mënyrë të jetës së tij, që përkufizohej vetëm me dëgjimin e atyre që i thuheshin dhe renditjen e tyre, pa asnjë mundësi ta krijonte mendimin e vet...

Sikur t'ia kuptonte mëdyshjet që po i bluante, Kryeveziri, e shikoi butësisht dhe u mbështet shkujdesshëm në pjesën e prapme të karrocës dhe i tha ta zgjonte kur të binte terri...

(Shënimi plotësues i Kullës së Harresës)

**...çfarë ngjau me mua vallë?:*

Këtë pyetje Kryeveziri ia shtroi vetes pas një mundimi të madh, që në të vërtetë ai nuk e dinte se fjala ishte për ndeshjen e rreptë midis dy qenieve përbrenda tij...

Ç'është e vërteta, pas pesëmbëdhjetë vjetësh shërbimi të besueshëm në fronin më të lartë të Perandorisë, kur në saje të mençurisë së tij të pashoqe, jo vetëm që u hap rruga kah Perëndimi, por u përsosën ca nga metodat për nënshtrimin e plangëprishësve nëpër krahinat ogurzeza siç ishte „Toka e Lashtë“, qenia e tij e riformuar dhe e mbikëqyrur rreptësisht nga shërbimet tona, papritmas zuri të shqetësohej. Ishte më se e qartë se e ashtuquajtura vetëdije e vjetër apo e mirëfillta prej kështjellari, po i

kthehej, në fillim si një shqetësim ngërthyes e më vonë si kacafytje e drejtpërdrejtë dhe e fuqishme, gjë që zuri t'i vinte në dyshime bindjet e Kullës së Harresës për epërsinë e padiskutueshme të qenies së re, pra të asaj të kurdisurës ndaj qenies së mirëfilltë si të fshehtë, për të cilën ne tashmë mendonim se kur shlyhet një herë, nuk përsëritet më. Bile, jo vetëm që nuk përsëritet, por ai që jeton me qenien e kurdisur doemos së kthehet në urrejtës të asaj, që lidhet me të kaluarën dhe gjithë atë që i përket qenies së mirëfilltë, të liruar prej saj në sajë të përpjekjeve tona...

Atë natë kur po bëheshin hapat e fundit dhe vendimtar drejt sendërtimit e programit për p a s t r i m i n e plotë të „Tokës së Lashtë“ nga herezia, (që lufta e shenjtë kah Perëndimi të bëhej pa kurrfarë telashesh dhe pa drojë se do të pengohej nga ndonjë kryeneçësi e papritur) dhe kur ata që hiqeshin si vullnetarët, pra të mobilizuarit me dhunë me të mbledhurit e tjerë ishin në rrugë kah deti, vetëdija e vjetër, pra ajo e mirëfilltja, (e shlyer rrënjësisht nga shërbimet tona), zuri ta shqetësonte vetëdijen e re perandorake...

E gjithë kjo ngjau kështu:

Kryeveziri, (siç e përcollëm nga fillimi e deri në mbarim pasi që ishte krijesë e jona dhe ne kishim për detyrë ta përkryenim përderisa të ngrihej deri tek gjendja e shembullit), pati shqetësime të herëpashershme, që lenin për të kuptuar se gjendja e tij, që çmohej si shumë e kënaqshme, ndodhej para sprovave të dëshimit përfundimtar, që mbase edhe ishin të natyrshme përballë atyre rrethanave. Edhe përkundër këtyre shenjave, që paralajmëronin syçelësi të përhershme, ne nuk dyshonim në pjellën tonë, veçmas pas gjithë atyre që kishim arritur prej vitesh se krijesa jonë e quajtur Daut Pashai, do të kërcënohej në atë masë sa një çast të shembej në tërësi...

Pra, atë natë, pasi u masakruan ata tre veta, (që u zunë tek po flisnin kundër luftë së shenjtë që do të fillonte çastin që ata që hiqeshin si vullnetarë, të mobilizuar dhunshëm, do ta rrinin detin për t'u rreshtuar në vinë e parë kundër Perëndimit), koka e tij u turbulluar dukshëm. Së pari qenë tri hije të gjata që u sollën në shesh, që më vonë iu sulën atij dhe çuditërisht po i qartësoheshin si të njohura, që pastaj, në sajë të përfuturit të tyre, t'u hapej udha përfytyrimeve deri më atëherë të shpëputura dhe të megjulluara që të formësohen... Ky pra ishte filli i fillimit të lidhjes së fillit kah fillimi i fillimit, apo çastet e para, por vendimtare, të shpërthimit në syprinë të vetëdijes së mirëfilltë, për të cilën ne ishim të bindur se pas pesëmbëdhjetë vitesh të shkuara, të sjellës me vetëdijen e kurdisur, nuk mund të rilidhej kurrë e kurrë... Deri te ky përfundim në erdhëm në sajë të veprimeve të kështjellarit të dikurshëm e pashait të mëvonshëm, të ngritur deri tek posti i Vezirit të madh, të bëra me aq përkushtim, sa ta nxjerr Perandorinë nga ngecja në të cilën kishte sharruar, me ç'rast dëshmimi kundër rrënjës dhe trungut të vet të mirëfilltë ishte sprovë e parë dhe kryesore prej nga duhej nisur... Ai ushtroi aso masakrash mbi sojin e vet sa edhe urrejtësit më të mëdhenj nuk do të arrinin t'i bënin ato që bëri ai...

Por, ç'e do që përpjekja që shpirti i ri të udhëhiqte mendjen e vjetër ra ndesh me vetë qëllimin atëherë kur më së paku pritej kjo dhe ndodhi që kështjellari i dikurshëm hetoi qenien e mirëfilltë, si një shqetësim të pavetëdijshëm pikërisht çastin kur ndodhej në kulmin e sprovës vendimtare të qërimit përfundimtar të hesapeve me gjithë atë që nuk i shkonte mendimit dhe vetëdijes perandorake në atë hapësirë ku pritej të fillonte fushata vendimtare e luftës së shenjtë kundër Perëndimit...

Me një fjalë, kështjellari i dikurshëm hetoi tre kështjellarët e masakruar dhe ky hetim u bë shkallë-shkallë dhe nisi kur ai së pari pa tre veta që sorollateshin në shesh, (që atij iu shfaq si Sheshi i Kuvendit të Kështjellës), për të vazhduar pastaj me njëfarë përvijimi qartësues, ku tek sjelljet e tyre ai dallonte pjesët e njëfarë valleje burrash, që luhej nga të njohur, por që shpejt i paqartësoheshin deri në megjullim... Dhe në këtë kapërcim nga njëra gjendje në tjetrën, ku ai ndodhte se u afrohej disa gjërave sa dallonte ca nga shpëputje nga pamjet e tyre, për t'u larguar serish prej tyre dëshpërueshëm, ai pak nga pak do të zbrazët nga

ato që kishte pranuar për t'ua lëshuar vendin atyre që ne ishim të bindur se ishin fshirë prej tij,se kishin humbur përgjithmonë nga kujtesa... Komisioni ynë mendon se ndryshimi më qenësor megjithatë ngjau kur ai në ballafaqim e sipër me ato që po i shpalohehin ngadalë nga deti i të panjohurave, zuri të dëgjonte ca fjalë te një gjuhe që pak nga pak po i dukej e njohur... Në të vërtetë, ne hetuam se koka ia kapte ca tinguj apo ca fjalë që i bëhej se ia thoshin të masakruarit në shesh. Në kokën e tij, ato tingëllima vetëtimthi merrnin kuptime dhe po aq vetëtimthi i megjulloheshin...Gjendja, ku gjërat herë i qartësoheshin e herë i megjulloheshin, e mbushi me njëfarë sikleti sa e bëri të çirrej me sa zë kishte:

„Çfarë po ngjet me mua kështu vallë?... Kush jam unë në të vërtetë?...“

P.S.

Për ne ky ishte çast zhgënjimi dhe dëshpërimi i thellë,nga shkaku se e patëm të qartë se përpjekja jonë e parë i këtij lloji rreth njeriut të kurdisur,që ishte në udhë të mirë t'u hapte rrugën të tjerëve, dështoi...

Ç'është më keq, dështimi erdhi çastin që ne pritnim që të kryhej në tërësi programi i parashtruar dhe kështu të fillonte faza tjetër, ajo e kurdisjes masive të shpirtit të ri perandorak,apo njeriut të ri,meqë nuk na kishte mbetur edhe shumë që ta shpallnin punën tonë shumëvjeçare të kryer dhe të suksesshme...Na ndante vetëm një hap deri te kjo...Ah,vetëm një hap, që do të matej me kalimin e Limanit dhe çdo gjë do të përkryhej...Medet...

-Po shoh një botë tjetër... Po shoh diçka tjetër...- foli Kryeveziri gjithë shqetësim.

Këshilltari nuk e dinte me tamam se në ç'gjendje po i fliste ato Kryeveziri, që rrinte i shtrirë dhe me sy të mbyllur. Megjithatë, hetoi se ishte koha t'ia bënte me dije se deti shihej bashkë me atë pikën kaheër të ëndërruar, që ndante dy botet...

Sikur t'ia kishte kuptuar mendimet Këshilltarit, Kryevezir nisi të fliste përçartë rreth „botës tjetër“, “të njëmendtës”, nga e cila nuk do të ndahej më...

-Atje është shpirti im, qenia ime... unë...

Pashai fliste symbyllas,sikur të dëshironte që edhe më tutje të mbante perden që i rrinte midis asaj që e përfytyronte dhe asaj që e kishte përpara...

-Ajo që shihni Ju patjetër se duhet të jetë e madhërishtme...- foli Këshilltari përulësisht, i bindur se Kryeveziri tashmë ishte ngatërruar me disa përfytyrime që nuk po i ndaheshin...

Pas një heshtjeje Kryeveziri dukej se matej t'i thoshte diçka Këshilltarit, por shpejt e kuptoi se as vetë nuk i kishte të qarta gjithë ato që po e mundonin. A mjaftonte t'i thoshte që po e përcillnin ca klithje, disa mendim e të turbullta fare, që herë i bëhej se i kuptonte sado pak e herë i bëhej se nuk i kuptonte fare?... Dikur,megjithatë foli rreth njëfarë terrimi që po ia mbyllte shpirtin...

Këshilltari u zu ngushtë. Çfarë t'i thoshte vezirit të madh në atë gjendje kur nuk dinte se a duhej ta ngushëllonte apo t'i ndihmonte të qartësohej. Megjithatë,nisi t'i arsyetohej se terrimi dhe ai megjullimi që i shfaqej mbase lidhej me botën e errët që kishim pranë, pra me Perëndimin, me atë hapësirë të sëmurë, që duhej shëruar sa më parë me ndriçim të përhershëm,e që vetëm ai mund ta bënte këtë...

-Ju i shini gjërat ndryshe, më thellë dhe më larg, Madhëri... Andaj, është e natyrshme që Juve ju mendojnë ato që të tjetër as që mund t'i vërejnë... Është e qartë se mendja Juaj e ndritur me të drejtë ngushtohet para kthesave të tilla të jashtëzakonshme, por ajo gjithëçkahës i jep udhë dhe i gjen derman...

Kryevezirin sikur e qetësuan ato që i dëgjoi si në megjull. Një copë herë përcolli drejtimin e dorës së Këshilltarit me të cilën ai tregonte drejtimin e Limanit që pas pak do ta shihnin.

-Atje kanë arritur vullnetarët dhe të mbledhurit tjerë.-po i thoshte Këshilltari me një zë të butë sa atij po i dukej si një vajtim.-Atje tashmë janë rreshtuar që të gjithë dhe presin shenjë e fillimit të luftës së shenjtë...

Këshilltari i tha edhe diçka për luftën e shenjtë dhe për vullnetarët në Liman,por Kryevezirit serish iu shfaq mjegullimi me kështjellarët në të, që megjithatë i bëhej se i kishte pranë,fare pranë, por që tash i shfaqeshin me koka të prera ,të cilat i mbanin në duar, ashtu me currila gjaku të trashur, që ia tregonin, e që në atë përpëlitje të llahtarshme i dukej se kokat, edhe si të prera, kishin jetë, se këtë e shprehnin me anën e lëvizjeve të syve dhe ndërrimi të herë pas hershëm të çehres... I bëhej se kokat e prera e shikonin vëngër dhe kërkonin t'i thoshin diçka dhe në pamundësi ta bënin këtë shumoheshin dhe shumoheshin pandalshëm saqë pas pak ato mbushën sheshin dhe prej andej, të rreshtuara, rrokulliseshin kah deti... Në atë rrokullisje marramendëse ishte i bindur se ishte përfshirë edhe ai bashkë me të tjerët që ndodheshin në pjesën e epërme te kodrinës, e cila ndante Limanin nga deti... Ndodhi që në atë lëvizje të furishme mbi kokat që tashmë kishin arritur Limanin u vërsulen shpatat e shumta dhe thikat e panumërta, që po i prisnin pamëshirshëm... Shpatat dhe thikat fërfëllinin nga të gjitha anët, por më së shumti shfaqeshin nga ana e Kështjellës dhe rrugicat përreth që ngjiteshin me kodrinën... Për çudi, në vllugun e asaj masakre, kur gjaku po e mbulonte sheshin dhe po derdhej në det, dëgjoji fjalët për luftën e shenjtë, të filluar kushedi kur që asnjëherë nuk ishte ndalur... Në atë lemeri hetoi se kokat e prera, nuk po rrokulliseshin më. Rrinin me nga një shpatë të ngulitur dhe kullonin gjak të zi, një si katran që pandalshëm shkante kah deti... Kur ngriti kokën pa se edhe Kështjella ishte mbytur me gjak, e i mbytur në gjakun e zi ndodhej edhe sheshi i vogël që soste në det... Në atë ngulfatje gjaku, iu bë se dikush po ia bënte me dije se ajo ishte vdekja e tij, se i kishte shërbyer asaj deri sa ajo ishte bërë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse...

Kur u lirua nga ai ankth i rëndë, Kryeveziri nisi të klithte me sa zë kishte:

-Dikush po na vret!... Po na vrasin!... Ku e kam Kështjellën?... Ç'mallkim që na ka zënë!...

Ende po çirrej me fjalët n'gojë rreth vrasjes së padukshme dhe një ploje që tashmë kishte filluar dhe assesi të ndalej, kur në karrocë u futën dy vetë, që iu dukën pikërisht se ishin ata që masakruan në Liman ata që hiqeshin vullnetarët, pra të mobilizuarit me dhunë dhe të mbledhurit tjerë... Ua pa të njëjtat shpata që u nguleshin kokave dhe i njohti të njëjtat thika që masakronin pamëshirshëm ata që rrinin të qetë dhe prisnin vdekjen e tmerrshme që po i priste në të gjitha anët sapo iu afruan detit... Hetoi se po ato shpata, që kishin prerë mijëra e mijëra koka po i afroheshin dhe i erdh mirë që edhe koka e tij ashtu do t'u bashkohej atyre që tashmë ishin prerë dhe ndodheshin të shpërndara në Liman dhe buzë detit... Dhe kur më në fund shpatat ia çanë kraharorin tejprtej dhe njëra ia mori kokën, ndjeu si përfundimisht u lirua nga mjegullimi i gjatë që e kishte zhveshur nga vetvetja çastin që e kishin zbrazur për ta mbushur me qenien e një tjetri, të kurdisur dhe të mbikëqyrur...

I erdh mirë që po lirohej nga ajo qenia tjetër,e huaja, e kurdisura dhe mendimi i fundit që i përftoi që ai se jeta mund të bëhej e huaj, por vdekja jo...

Këshilltari, që nga afërsia kishte përcjellë shpatat e padukshme që furishëm i ishin qasur Vezirit të Madh në atë gjendje të mundimshme kur ai kishte folur si përçartë për vrasjen dhe kishte kërkuar Kështjellën e vet, ishte tmerruar kur pa se ai që po vdiste fare i masakruar, nuk ishte Kryeveziri, me të cilin kishin udhëtuar plot gjashtëdhjetë e tetë orë në karrocë, por një tjetër, që i ngjante njërit nga kështjellarët, që ua prenë gjuhët dhe i verbuan para se të niseshin në Kështjellën e „*Tokës së Lashtë*“...

Deshi të thoshte diçka për ta mundur habinë dhe tmerrin, por ndodhi që një shpatë, që erdhi po ashtu padukshëm nga prapa ia la përgjysmë fjalët që po bëhej gati t'i thoshte dhe mendimet që po i hakërrroheshin...

Ja kështu, o Flamurtar, kur i rashë në fund librit të „Kullës së Harresës“, Shpjeguesi i ëndrrave m’i tha edhe këto:

„Nuk është kjo e tëra...“

A thua mund të kishte diç tjetër më të rëndë?.. Nga mpirja nuk po mund e merrja veten, ndërkohë që Plaku më tha se kishin ndodhur gjëra të jashtëzakonshme.

Dikur i thashë se asgjë nuk më kujtohej...

„As Xhavid Agai?“-më pyeti gjithë kureshtje.

I thashë se as ai nuk më kujtohej.

„E pate dorë të djathtë“, -ma ktheu.

Heshta.

„Ai e bëri masakrën në Liman me urdhrin tënd dhe së fundi u çmend... E zuri lumi i gjakut që rrodhi në Liman...“

Koka po më digjte nga ato që dëgjoja.

„I pate thënë të mbante ditar të fshehtë... Këtë e bëri si duhet... Ishte i bindur se me këto dëshmi do të ngrihej edhe më lartë në hierarkinë ushtarake... As kjo nuk të kujtohet?...“

Çfarë t’i thosha kur në atë gjendje që isha ndjeja vetëm oshtimën e njëfarë zbrazeje, që më vinte si mundim i jashtëzakonshëm?... Në atë shtangim të tmerrshëm Plaku serish ma bëri të ditur se Xhaid Agai ishte pjellë ime, siç isha unë pjellë e Kullës së Harresës...

M’i tha këto dhe treti sikur të mos ishte. Në dorë ma një libër të lidhur me fjongo të zi...

(Ditari i Xhavid Agait, mbi pastrimin e „Tokës së Lashtë“ nga armiqtë e Perandorisë, i shkruar nga mesi i majit të dytë deri në mesin e muajit të pestë të vitit që duhej të ishte vendimtar...)

Faqe 1

Dita e parë e fushatës:

Diku në front... Koha me vranësira... Ende ka borë...

Rebelët i kemi rrethuar nga veriu dhe jug-lindja. Sipas të dhënave që na i sjellën hafijet e futura kastile në të gjitha anët, ata janë mbi dymijë veta të armatosur mirë. U mblodhën me të dëgjuar urdhrin se ushtria jonë është nisur drejt rrafshnaltës, pasi që është shpallur gjendja e jashtëzakonshme bashkë me shtetrrethimin. Pa mëdyshje se të gjithë janë agjentë të Perëndimit.

Në mesditë filloi fushata. Rebelët u tërhoqën me të shpejtë dhe ne i ndoqëm hap pas hapi. Kur u err, ikën kah bjeshka, prej nga edhe pritej se do të drejtoheshin, ku edhe do të jetë fundi i tyre. Në rrafshnaltë dëgjonim të lehurat e qenve të mbetur pa të zotët dhe ndonjë zog të zi, nga ata që këndeja shumë dhe thonë se bredhin vetëm natën në kohë luftërash...

Humbjet tona: dy të plagosur lehtë.

Humbjet e armikut: katër të vrarë e shumë të plagosur.

Xhavid Agai, d.v

P. S.

1. Oficerët kërkonin të vendoseshim nëpër kullat e tyre dhe aty ta shtronim ahengun. Kjo duhet bërë edhe për një arsye, më thonë, - që t’i fyejmë dhe t’i nënçmojmë... Sado që kjo më pëlqeu, nuk lejova të

shpërndaheshin nëpër kulla nga droja se mund të futeshim në ndonjë kurth të tyre...Ua përkujtova atë që këtu thuhet rreth ujit që flenë e hasmit që nuk flenë...

2. Urdhërova të ndizej një zjarr i madh me ç'rast Oficerëve u thashë që ushtarët të këndojnë dhe të argëtohen...

Faqe 2

Dita e dytë e fushatës:

Diku në front, gjurmëve të rebelëve...

Ushtinë e shpërndava kështu:dy brigada i dhashë në ndjekje pas rebelëve,një e ngarkova me fushatën e pastrimit nëpër katunde malore dhe një brigadë e lash në prapavijë, bashkë me njësitë e posaçme dhe ato elite për të hetuar gjendjen para se të fillohet me veprime të përqendruara.

Dy brigadat zhvilluan luftime e para paksa më të ashpra me rebelët dhe u detyruan të tërhiqeshin për arsye taktike përderisa vëzhguesit të hulumtojnë terrenin për sulme të befasishme,që duhet të bëhen me anën e njërive të posaçme. Urdhërova futjen e hafijeve të tjera në hapësirën ku rebelët momentalisht ndjehen paksa më të sigurt. Mendja ma thotë se ata janë më shumë seç kemi vlerësuar...

Brigada e zonës së pastrimit filloi të veprojë në dhjetë katunde. U bënë bastisje të përgjithshme me arsyetimin se kërkonim armiq të perandorisë që kishin ngritur armën kundër saj dhe me këtë ia rrezikonin themelet. Në çdo shtëpi ushtarët hynë me forcë dhe pushkatuan dymbëdhjetë të rinj,që ishin të dyshimtë,por ndër viktima pati edhe një fëmijë dhe dy gra,jo me fajin tonë por nga shkau se nuk deshën të ndahen nga ata që duhej të pushkatoheshin...

Edhe në prapavijë njësitë e posaçme bashkë me ato elite, vepruan sipas urdhrave të marra. Kërkuan me lista armiq të kamotshëm të Perandorisë për të cilët dihej se kishin vepruar pareshtur kundër interesave tona. Me emra dhe mbiemra i thirrëm të dorëzoheshin ata që në çfarëdo mënyre kishin pas lidhje me kryengritësit dhe me Kështjellën...Dogjëm pesë shtëpi,vramë pesë veta dhe një mbeti i plagosur në mal.

Komandantët i përgëzova për punën e suksesshme që kishin bërë.

Humbet e armikut:mbi gjashtëdhjetë të vrarë dhe shumë të plagosur.

Humbjet tona: një i plagosur.

Xhavid Agai,d.v.

P.S.

Natën e dytë hapëm tendat. Oficerëve u thashë se duhet pritur edhe pak para se t'u futemi nëpër kulla për t'i tmerruar dhe poshtëruar siç e meritojnë. Pastaj urdhërova të bien çallgitë dhe të ndizen zjarre të mëdha...Megjithatë,pas mesnatës, kur ushtarët tanë të ushqyer mirë i mashtroi gjumi,në pjesën veriore,rebelët kishin sulmuar tendat e skajshme me ç'rast kishin vrarë tre veta dhe disa të tjerë kishin lënë të plagosur,që si të palëvizshëm, të na mbeteshin si barrë. Oficeri i sigurimit,që ma solli këtë lajm,ishte i shqetësuar fare dhe kërkonte t'i lejohej vetëndëshkimi,që e meritonte. Kur e pyeta se pse dëshironte ta bënte këtë,ai më tha mbase nuk kishte qenë syçelë sa duhej dhe se kjo do t'ia shtonte moralin ushtresë.

-Nuk kemi ardhur këtu të vtëndëshkohemi,i thashë,por që të ndëshkojmë rebelët...

Ai rrinte si i ngrirë dhe fliste për njëfarë hataje,që kishte ndodhur,të cilën nuk e kuptonte gjithaq...

-Nuk ka ndodhur asgjë e jashtëzakonshme,i thashë.-Ata bëjnë të veten,por edhe ne duhet të bëjmë tonën...Andaj, nuk duhet humbur kohë me ato që nuk kthehen,por duhet shikuar përpara...

Oficeri që mbase nuk i kishte pritur ato që ia thosha pas humbjeve të pësuar nga moskujdesi,pas një heshtjeje më pyeti se çfarë duhet të bënte ,që e gjitha të përmirësohej sa më shpejtë?

-Fare thjeshtë, i thashë.-Përshejto ndëshkimin...Mos kurse as burra, as pleq e plaka dhe mos kurse as fëmijë...Vetëm kështu mund të mbrohemi nga thikat e tyre...Ndryshe, një ditë të pret fati i atyre që e pësuan mbrëmë...

Oficeri kërkoi falje dhe doli me ngut...

Faqe 3

Dita e katër e fushatës:

Diku në front...Bën të ftohtë.Veprimi:dy brigada pas rebelëve,një nëpër katundet malore,një në zonën e pastrimit dhe si rëndom, pas tyre, njësitë e posaçme nga prapavija..

Ditën e filluam me nderimin që ua bëme martirëve, të vrarë në pabesi. Urdhërova hetime të posaçme dhe po ashtu urdhërova hulumtime të tjera me anën e të cilave do të qartësohej se mos vallë me rebelët ndodheshin njësi të futura nga jashtë, që ishin fare të mundshme në atë hapësirë,ku së shpejti pritej të zhvillohej luftëra e dy boteve për jetë a vdekje...

Pasdite serish filloi të bjerë borë, gjë që na u shkaktuan disa ngecje gjatë ofensivës, por ato u tejkaluan me zgjerimin e linjës së ndjekjes vetëm kah bjeshka,në mënyrë që ata të detyroheshin të rraseshin në të prej nga do të mbeteshin përgjithmonë. Isha i bindur se bjeshka,mund t'u ofronte njëfarë strehimi të përkohshëm,por ajo do të shfaqej edhe si kurth, që do t'ua hante kokat...

Humbjet e armikut:katër të vrarë...

Humbjet tona:gjashtë të plagosur...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Në mbrëmje thirra oficerët që udhëhiqnin operacionet e pastrimit. U foli sesi gjithnjë e më shumë po na shtoheshin humbjet,veçmas plagosjet e ushtarëve, që po na ktheheshin në një barrë e rëndë dhe kërkova sqarime si ishte e mundur të ndodhte kjo kur ne sulmonim dhe ata ishin në ikje e sipër?...

Ata më shikuan me sy përdhe dhe më thanë se kjo mund të shpjegohej me pandehmën se në radhët e rebelëve ndodheshin përkrahës të huaj,që vepronin bashkërisht,por që ishin të përgatitur mirë për kurth të tilla... Është e pabesueshme,më tha oficeri i njësitit të posaçëm se ngado që futemi hasim shkretim,që nuk është i rastit...Gjemë shtëpi të braktisura,stalla të zbrazëta dhe hambarë të boshatisur?...Si është e mundur të ndodh e gjithë kjo lëvizje në këto rrethana pa u hetuar as nga përgjuesit tanë të shkathtë e pa u parë as nga pararojat tona të shumta,që ndodhen në pikat kryesore prej nga çdo gjë vënderohet?...Oficeri i njësitit të posaçëm sikur dëshironte të ma bënte me dije se ai do të sorollatej kot nëse edhe më tutje do të lëvizte ashtu nëpër hapësira të shkreta,ndërkohë që armiku, sikur ta kishte përpirë toka, shfaqet ku nuk pritet...

Edhe komandanti i njësitit ndëshkimor kishte të njëjtat mëdyshje. Ma bëri të ditur se në gjithë hapësirën e caktuar për ndëshkim kishte takuar vetëm një plak të verbër dhe ca kafshë të shkallmuara që nuk ishin për asgjë...Kur e pyetëm plakun se ku ishin të tjerët,ai ma ktheu me mospërfillje se çfarë mund të thoshte ai që nuk ka sy?...Pak më vonë,kur e mori vesh se kush ishim dhe çfarë kërkonim, tha se kishte dëgjuar se kishte rënë mordja, gjë që sipas tij,kishte bërë që ata që kishin këmbë e sy të iknin sa më parë...Kur i thash se këtu nuk kishte mordje dhe se ato që thoshte ishin vetëm shpifje dhe thashetheme të kurdisura,ai më tha se edhe si pa sy e hetonte vetminë dhe shkretimin që kishte ndodhur...I zemëruar për ato që dëgjoja desha ta ndëshkoja plakun,por hoqa dorë i bindur se ai këtë priste si shpëtim...Së paku ai le të vuajë,thashë...

Pasi që dëgjova ato që m'i thanë ushtarakët,urdhërova që aradhja e ndëshkimeve dhe ajo për veprime të posaçme të zgjerimin fushëveprimin,nga veriu dhe nga jugu,dhe secila të shkonte në drejtimin e kundërt sa më thellë. Prej tash,u thash oficerëve,duhet të vepron si të pavarur ndërkohë që lidhjet do të mbahen vetëm me anën e korrierëve dhe kjo bëhet që rebelët të shohin se kanë të bëjnë me shumë shtresime të sulmeve që shkojnë paralelisht,por ndjekin të njëjtin qëllim:shkatërrimin e tyre. Bashkë me shtabin operativ,vendosa të mbeteshin përgjithmonë...

Faqe 4

Dita e shtatë e fushatës:

Pozicioni ynë:pika 33 diku në bjeshkë. Bën të ftohtë. Një fërfëllizë po na përcjell pareshtur sikur të kishte për qëllim që të na vështirësonte më shumë seç duhej lëvizjet. Bora sa vjen e shtohet, ndërsa edhe ngrica është gjithnjë e më përcëlluese.

Rebelët vazhdojnë të na sulmojnë befasisht nga e djathta dhe nga e majta edhe atëherë kur kjo duket e pamundshme. Gjatë dy ditëve të fundit humbjet i patëm të vogla,por kundërshtarit nuk i shkaktuam asnjë humbje. Nga terreni,megjithatë,njoftimet janë diçka më

të mira dhe lidhen kryesisht me sukseset e brigadës ndëshkuese, e cila kishte pastruar zonën e paraparë siç ishim marrë vesh. Me këtë rast armikut i ishin shkaktuar humbje të mëdha që pasqyroheshin me njëqind e njëzet të vrarë dhe shumë të plagosur, ndërkohë që humbjet tona ishin fare të vogla: dy të vrarë dhe një i plagosur lehtë bashkë me një të zhdukur. Njësia e posaçme sikur ka disa telashe, por edhe ajo ka shënuar disa suksese të ndjeshme duke vrarë 76 vet, ndërkohë që kishte burgosur 143 veta, të cilët shpejt do të dënohen me vdekje dhe edhe më shpejt do të ekzekutohen. Sjellja ndaj grave të zëna dhe fëmijëve është ajo e parapara: të hendikepohen përgjithmonë...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Mbrëmë nuk e di pse mendova për urrejtjen?...

Faqe 5

Dita e dhjetë e fushatës:

Pozicioni ynë: pika 43. Bora nuk ka të ndalur. Fërfëlliza është gjithnjë e më e egërsuar. Nga tenda ime shoh një bardhësi të pafund. Oficerët më thonë se më tutje nuk bën të shkohet.. Do të ngrihem me çka kemi, - ankohen... Megjithatë, duhet menduar mirë para se të merret ndonjë veprim me të cilin duhet të evitohet ngujimi, që do të na kushtonte shumë.

I bindur se nuk duhej nënshtruar vështirësive që na i shkaktonte moti tepër i ligë, që mbase nuk e kishim paraparë se do të ishte i tillë, oficerëve u thashë se do të ecim përpara përderisa t' i zëmë të mallkuarit. Thashë se nëse ne mund të ngrihem një herë, armiq të tanë do të ngrihen dhjetë herë... Njëri prej tyre më tha se nuk duhej harruar se rebelët ishin fodullë, të mësuar me këtë mot dhe me këto rrethana. Ata janë të gazepit dhe sikur kërkojnë mot të tillë, që t' u vijë në ndihmë...

-Edhe ne duhet të mësohemi me të gjitha, - thashë. - Nuk na thonë kot Perandori... Tash që i kemi zënë pisk dhe nuk kanë ku të ikin, duhet t' u qepemi deri në fund... Tash ose kurrë, thashë... Kthim prapa nuk ka...

Njëri nga oficerët më tha se nuk do të ishte keq të pritej pranvera... E rëndësishme është, shtoi ai, se ata i kemi futur në një trekëndësh prej nga nuk mund të dalin më. Ndreqja e motit na mundëson qërimin përfundimtar të hesapeve me ta pa humbje të panevojshme...

Hetova se edhe oficerët tjerët sikur mendonin se duhej pritur pranverën. Njëri madje shtoi se mbase dimri i ashpër mund ta bënte punën tonë...

Pasi i dëgjova, u thashë se po lejuam që ata të dalin në pranverë, atëherë do ta kemi të kotë t' i asgjësojmë. Këtë dimër, shtova, ata nuk duhet ta kalojnë kurrë. Ky dimër është si i porositur për ne dhe këtë dhunti duhet shfrytëzuar sa më mirë...

Pas atyre që thashë, m' u bë se oficerëve u ishte ngrirë shikimi në pjesën e skajshme të tendës, ku hetoheshin kandilat e parë të akullit se si paralajmëronin pushtetin e ngricës edhe tek pjesët më të mbrojtura dhe të ngrohura me lëkurë deveje. Mendja ma thoshte se kësaj ngrirjeje madje nuk i ndihmuan as lajmet që atë natë morëm nga vëzhguesit me të cilat bëhej me dije se si pikat 23, 27 dhe 33 në zonën e ndëshkimit ishin të mbuluara me një zjarr të madh që nuk ishte parë në këto anë, ku digjeshin edhe guri e edhe druri...

Ai zjarr, që megjithatë ishte shumë larg, sikur për pak ma nxehu shpirtin...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Pa urrejtje nuk është njeriu njeri e as shteti shtet...

Faqe 7

Dita e pesëmbëdhjetë e fushatës:

Pozicioni ynë:kuota 51.

Para nesh bjeshka dhe bora dhe vetëm bora. Drunjtë janë të rrallë. Gjithçka vjen e zbrazur dhe e zhveshur .Sikur t'i kishte lëshuar toka, rebelëve nuk po u shihen gjurmët. Të rrasur në atë heshtje të ngrirë oficerët gjithnjë e më shumë hamenden se mos ata në ndonjë mënyrë tinëzare kanë qarë rrethimin dhe ndodhen në të sigurt, ndërkohë që ne ngrijmë kot së koti?Mua assesi nuk më besohet se kjo mund të ketë ndodhë. Them se si ç'prej kohësh mbikëqyrim çfarë ngjet mbi tokë dhe nën tokë prej nga as zog e as kafshë nuk mund të përvidhen të pavërejtura...Oficerët tumirin fjalët e mia dhe pranojnë se ky ishte njëri ndër rrethimet më të mëdha që është ndërmarrë ndonjëherë nga ushtria perandorake ndokund, por,të përballuar me heshtjen e ngrirë,ata sikur kanë nisur t'u besojnë thashethemeve se ata kthehen në njerëz të borës...

Çuditërisht edhe mua nganjëherë dhe fare pa dashas po më mundon njëfarë dyshimi rreth asaj si ishte e mundur që t'u kishin humbur gjurmët?...Megjithatë,nuk dua t'ia pranoj vetes se ata ndodhen jashtë rrethimit. Kjo është e pamundur,është e pamundur...

Nga zona operative bëhet me dije se njësia për veprime të posaçme përfundimisht kishte pastruar hapësirën e paraparë dhe kishte kaluar në pjesën jugore, prej nga do të vepronte në bashkëpunim me njësitë ndëshkuese,të cilat nuk ia kishin dalë që të përmbushnin detyrat e marra në përputhje me planin nga shkaku se në disa pjesë popullata kishte lëvizur më shpejtë seç ishte paraparë,ndërkohë që në pjesët e pastruara kishin filluar të shfaqen grupe të vogla rebelësh,që veprojnë papritmas. Urdhërova që aty ku shfaqen grupet e rebelëve toka të bëhet shkrumb e hi...

Xhavid Agai,d.v.

P.S.

A mund të shuhet ndonjëherë urrejtja dhe çfarë ngjet pa të?...

Faqe 7

Dita e njëzet e fushatës:

Gjendemi në kuotën 5 prej nga nuk mund të shkohet tutje. Bora është gjithnjë e më e madhe,ndërsa acari sa vjen e bëhet më i padurueshëm.

Gjatë tri ditëve të fundit nuk bëmë asnjë hap para. Me zemër të thyer dhashë urdhër të presim qetësimin e motit,sado që e kisha të qartë se këtu moti thyhej vetëm në të ikur të dimrit. Në këto rrethana as vëzhguesit nuk mund të kryejnë detyrat e parashtruara,ngaqë janë ngujuar. Oficerët nanurisin gjithnjë e më zëshëm rreth nevojës së shtyrjes së rrethimit.

-Nuk ka kthim prapa,u thashë...

Atë natë ra një borë tepër e madhe për të na ngujuar përfundimisht në atë shkretim ngrirës me çka kishim...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Për herë të parë zura të mendoj për ngujimin dhe gjithë ato që sjell ai. Paska gjëra edhe më të forta se sa forca e Perandorisë,mendova dhe më erdhi keq që diku-diku pushteti i njeriut është fare i vogël,apo fare i pavërejtshëm karshi atyre që e rrethojnë...Kjo më dëshpëroi aq sa gjithë natën mbi mendimet e mia reshi borë...

Faqe 8

Dita e njëzet e shtatë e fushatës:

Ndodhemi aty ku ishim dhe bora nuk ka të ndalur. Tash mund të thuhet se jemi shkëputur nga bota. Megjithatë, mbrëmë na ngjau një llahtari e tmerrshme që nuk na e kishte marrë as mendja se mund të ndodhte, me ç'rast rebelët, sikur të kishin pikur prej qiellit, iu kishin afruar tendave anësore dhe tri sosh i shkatërruan. Në atë ployë gjaku na u vranë 17 ushtarë dhe dy të tjerë u plagosën rëndë. Çastin që u ballafaqova me këtë masakër mendja më shkoi se mos ishte fjala për ndonjë ortek, që ishte lëshuar nga pjesa e rrëpishme e bjeshkës, rrëzë së cilës gjendeshim, por shpejt u kuptuan përmasat e të ligës që nuk do të na e merrte mendja kurrë. I thyer sa nuk bën mblodha shtabin për të sheshuar mirë e mirë si kishte ndodhur masakra e tmerrshme, kur në këtë hapësirë as zog e as njeri ç'prej kohësh nuk kishte mundësi të lëvizte e lërë më të kryente ndonjë veprim të tillë?... Vëzhguesit tanë erdhën tek përfundimi se shumëçka në atë rrethana ishte e pashpjegueshme dhe mbetej për t'u hulumtuar se ku strehoheshin ata, por njëra ishte më se e sigurt, se për t'u afruar tendave ata kishin shfrytëzuar disa kalime nën borë, në formë të tuneleve, që nisnin diku tek shkrepat e skajshëm, kahmot të sharruar nën borë... Në sheshim e sipër dolën edhe vlerësime, siç ishin ato rreth mundësisë së strehimit dhe të lëvizjes së tyre nën borë, që mund të ishin pjesë e mbijetimit të tyre të kamotshëm në këto hapësira (që nuk i ishte kushtuar vëmendja nga shërbimet tona), njoftime këto që do të mund të ishin të kobshme për ne, por u thashë të mos e çonin më gjatë nga frika se kjo do të mund të sillte panik ne radhët tona...

-Ata do të bëjnë çmos për të mbijetuar dhe kjo është e drejtë e tyre, por ne duhet t'ua pamundësojmë këtë,- thashë, pa qenë i bindur se si duhej bërë kjo...

Tutje, fola rreth misionit tonë të shenjtë, prej të cilit varet shumëçka e Perandorisë... Oficerët më dëgjonin si të thyer dhe pikërisht pse për herë të parë nuk u flisja si ushtarak, por si misionar, ata kishin arsye të ndjeheshin edhe më keq dhe të besonin se ato që ua thosha nuk ishin tjetër pos pjesë e ngushëllimit që u duhej atyre por edhe vetes...

Xhaivd Agai, d.v.

P.S.

Ai që i beson Perandorisë nuk bën të dëshpërohet kurrë... Ai që i shërben Perandorisë nuk duhet ta humb shpresën asnjëherë, edhe atëherë kur duket se ajo është vetëm një fije drite... Megjithatë, kur ndodhem vetëm për vetëm, ndjehem i humbur dhe i dëshpëruar... Në kokë me sillen disa mendime, sikur të ishin të huaj, por që më ndjekin pareshtur... Çfarë po ndodh me mua vallë?...

Faqe 9

Dita e tridhjetë e fushatës:

Bora pushoi, por ende bën të ftohtë. Dielli zuri të duket nga lindja dhe na bënte me dije se pranvera ishte në prag, sado që e dinim se në këto lartësi ajo arrin më vonë... Në atë përdëllim shprese, e shikova gjatë majën e bjeshkës dhe po mendoja si ta rrethoja atë për t'i zënë një nga një ata që na qiten as shumë telashe... Shikimi im i përhumur kërkonte diçka nëpër atë bardhësi, por mbeti i ngrirë. Dikur pashë se si një tufë zogjsh shkonte kah maja. Ishte kjo shenjë e mirë se acari, që në pjesën e poshtme moti ishte thyer, tash edhe këtu po bëhej gati të jepej...

Më në fund, pas shumë e shumë ditësh shkëputjeje nga bota, nga zona e operimit, depërtoi lajmëtari, i cili pasi na tha se poshtë të gjithë ishin të brengosur për ne me drojën se mos ishim ngrirë, bëri me dije se brigada e ndëshkimeve kishte telashe të ndjeshme gjatë kryerjes së detyrave të marra, ngaqë rebelët, të shpërndarë në grupe të vogla, kishin nisë të shfaqeshin në shumë pjesë, pikërisht nëpër katundet e zbrazura dhe të rrafshuara me tokë...

Mendova e çmendova dhe lajmëtarit që e nisa drejt zonave të operimit, në përputhje me dekretin perandorak të kompetencave të jashtëzakonshme që posedoja në rrethanat e shtetrrethimit, ia dhashë me vete një shkresë-urdhëresë për të gjitha njësitë tona që menjëherë të fillohet fushata e madhe të pastrimit, në të cilën përfshihej pjesa më e madhe e hapësirës

së „Tokës së Lashtë“,që do të thoshte shpallje e gjendjes së luftës...Isha i bindur se po nuk e shuam kryengritjen e përgjithshme,që kishte shpërthyer,fushata e shenjtë kah Perëndimi do të shtyhej apo do të dështonte...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Po nuk e pushtove majën,maja bie mbi ty...

Faqe 10

Dita e tridhjetë e pestë e fushatës:

Ndodhemi në të njëjtën pikë. Moti po zbutet dhe bora po shkrihet dhe ne po ndjejmë shenjat e para të beharit.

Oficerëve u thashë të bëheshin gati për çastin e sulmit përfundimtar. Thashë se si rebelët do të bëjnë çmos ta çajnë rrethimin ngaqë e dinë se çfarë i pret...Përsërita atë tash ose kurrë, por hetova se si ushtarakët nuk u ngazëllyen nga ato që ua thashë. Mendja ma thotë se shumë prej tyre sikur kanë humbur shpresën dhe gjithnjë e më shumë dyshojnë se nga sorollatjet tona do të dalë gjë. Bora dhe ngrica e gjatë,me të cilën nuk ishin mësuar,i kishte shkërmoqë...Tek po i shihja në atë gjendje të thyer,mendja ma thoshte se atyre u duhej gjak,shumë gjak që të ringjalleshin....Gjaku rreke do t'ua hiqte zymtinë që i kishte mbërthyer...

Atë natë urdhërova çallgitë dhe shtrova njëfarë ahengu për ushtarakët e lartë...Në atë ftohtësi zëri i klarinetit dukej si një këlthitje e ngrirë,që thyhet frikshëm në shumë pjesë...

Kur mbeta vetëm se si më përftoi një mendim se në të vërtetë ne nuk ishim sulmues,por të sulmuar që tash e tutje do të bënin përpjekje për të qarë rrethimin,që ia kishin vendosur vetes...M'u duk se si rebelët na vinin prapa dhe na i prisnin të gjitha kalimet për të na detyruar të shkonim kah maja e bjeshkës,ku do të mbeteshim përgjithmonë...

A thua po ktheheshim në të dënuar?...Ky mendim sikur më frikësoi tmerrësisht sa ngjesha shpatën dhe zura të fërfëlloj në të gjitha anët,duke prerë kështu ajrin ngulfatës që kishte mbetur në tendë...Po mos të kisha frikë se do të vërehesha,do të çirresha me sa zë kisha se si nuk e pranoj tërheqjen,pa marrë parasysh çmimin e lartë që mund t'i paguhej...

Xhavid Agai, d.v.

Faqe 11

Dita e gjashtëdhjetë e fushatës:

Pika e njëjtë,mëdyshjet e njëjta, ndonëse bora ka sharruar dhe ne së shpejti do të nisemi kah maja. Ajo duhej pushtuar patjetër,pa marrë parasysh se çfarë do të dalë prej gjithë asaj...Urdhërova të ndërmerreshin të gjitha masat e duhura që atë rrugë ta bënim pa pengesa...Hetova se në lëvizje e sipër,ushtria sikur shkapej me vështirësi nga ngurtësimi,që i kishte hyrë në palcë...U duhet lufta për ta mposhtur mpirjen, mendova dhe më erdhi mirë kur pashë se si lëvizja e ushtrisë furishëm theu ngrirjen sa m'u duk se çdo gjë mori një pamje tjetër nga ç'e kishte prej javësh sa ishim të ngujuar. Por, si ta bënim luftën,ku ata me të cilët duhej të ndeshemi nuk ishin?...A mos do të thotë se në kërkim të luftës së padukshme, na kishte mbetur një ngarendje e kotë kah maja për t'u ballafaquar me një sorollatje,që nuk mund të shpjegohet ndryshe pos humbje që kujt nuk ia kishte marrë mendja?...Ky mendim më frikësoi aq sa për herë të parë më shkoi mendja se përnjëmend kishim rënë në një kurth,që do t'i kushtonte gjithë Perandorisë...Në atë përpëlitje të ethshme sikur m'u bë se në majë po e shihja Kryevezirin,që po më priste t'i afrohesha për t'ia lënë para kokën time në tabakun e ngrirë që rrinte në një maje thike...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Ndjenja se në maje më priste Kryeveziri,apo ai tabaku i ngrirë,ku do të vendosej koka ime,sikur m'u kthye në një përftim që më ndiqte gjithnjë e më shpesh dhe assesi të ndahesha prej tij...Më kot u mundova të sjell ndërmend gjërat tjera,që i përkisnin çasteve të lumtura...Secila përpjekje që me mendje të kapërceja rrethin e borës,që na mbërthente dhe majën që më priste,dështonte,ngaqë ishte një qark tjetër,fare i padukshëm,i vendosur midis botës dhe meje,që përjashtonte të djeshmen dhe të nesërmen,që në të vërtetë i përngjante hapësirës shurdhe,ku nuk kishte tjetër pos sharrimit në hiqësi...O zot,u luta,së paku lejomë që me mendje të shkoj tutje asaj që nuk mund t'i bishtnoj...

Faqe 12

Dita e gjashtëdhjetë e pestë e fushatës:

Më në fund u nisëm kah maja. Lëvizjen e filluam me daulle...Në atë ngarendje,tamtamet e tyre m'u duken të ftohta dhe sikur ishin të ndillnin gjëmë...Pararojat që më parë kishin bërë të ditur se hapësira nëpër të cilën kalonim ishte e shkretë,tepër e shkretë,sikur jeta që moti të kishte ikur prej saj...Këto fjalë nuk më bëhet t'i dëgjoj,i thashë kryerojës,që m'i sillte herë pas here të dhënat që vinin nga vëzhguesit dhe të tjerët që tashmë kishin hyrë dhe dalë nëpër shpella dhe kalime të fshehta pa parë gjë...

Në mbrëmje thirra oficerët e lartë,që erdhën të dëshpëruar dhe me heshtjen e tyre të akullt shpresës ia këputnin edhe fijet e fundit.. Nuk e di se a u thashë diçka për durimin që duhej pas gjatë dy-tri ditëve të ardhshme përderisa t'i afroheshim majës,prej nga mund të shkohej vetëm në qiell,por mendja ma thoshte se dallimi midis nesh sikur moti ishte shlyer ngaqë humbja e shpresës gjithnjë e më shumë na barazonte...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Mendimet ndjellakeqe janë si mordja:përhapen shpejt dhe rrënojnë pa dallim ato që u dalin përpara,por edhe të tjerat që struken...

Faqe 13

Dita e shtatëdhjetë e fushatës:

Ndodhemi në pikën më të lartë,fare pranë majës. Askund gjurmë njeriu. Bora shkrihet,por me atë sikur shkrihen edhe shpresat tona. Nga ajo pikë e zbrazët dhe në dukje shurdhe mendja ime pareshtur ndjek dymijë e sa veta,të ndodhur në një rrethim të hekurt ç'prej kohësh,të mbërthyer kah pika e asgjësimit...Çfarë ka ndodhur me ta vallë?...Ku janë?...Mos i ka lëshuar toka?...Si është e mundur që rebelët të mos kenë lënë gjurmë,kur kohë më parë befasisht dhe fare padiktueshëm kishin sulmuar taborët tona për t'u larguar siç ishin shfaqur?...Mos vallë me shkrirjen e borës edhe ata kishin tretur në ajër për t'u kthyer serish me ngricën dhe borën e ardhshme?...Kah s'i shkon mendja njeriut përballë atyre krrajatave...

Në atë gjendje gjithnjë e më të pashpresë,thirra këshillin ushtarak dhe kërkova mendimet e të gjithëve. Oficerët heshtnin si mumie. Kërkova të flisnin, të thoshin çfarëdo që sado pak do të ma hiqte sikletin që më mbërthente gjithnjë e më shumë...U thashë se lufta ishte jona,ishte e të gjithë neve,ishte e gjithë Perandorisë dhe u përkiste të gjithëve njësoj...Desha kështu t'ua bëja me dije se nëse me fitoren stolisën komandantët dhe kryekomandantët,se ishte e natyrshme të përvetësohej nga elita,e cila kurorëzohet me të,u thashë se humbja u takon të gjithëve pa dallim...Pas asaj përsiatjeje,që më së paku ishte ushtarake,oficeri i xhenios me tha se si ishim futur në një karrem,që kaherë i është ditur fundi...Ai tha se kishim ndjekur vijat që na ishin hequr,për të përfunduar ashtu siç do të përfundohet,pra me dështim...

Nuk e di pse gjithë hidhërim kundërshtova çështjen e kurthit, që na ishte vendosur, ku edhe kishim rënë, sado që këtë nuk dëshiroja t'ia pranoja vetes dhe askujt edhe në çastet më të pashpresa siç ishin ato në të cilat ndodheshim... Në atë ngulmim të kundërshtimisë, se si m'u tek të flisja rreth majës si një pikë sovrane prej nga nuk mund të shkohet më tutje, por që paraqet kulmin e idealit... Të ndodhesh në maje, thashë, do të thotë ballafaqim me një ndjenjë madhështie që nuk ka çmim... Fola dhe fola dhe më bëhej se me ato që thashë po i afrohesha një përsiatjeje që ishte fare e huaj për ushtarakët, veçmas për atë pjesë të ngarkuar me sendërtimin e parakushteve për fillimin e fushatave të mëdha, siç ishte ajo e depërtimit kah Perëndimi, me të cilën thuhej se njëherë e mirë duhej të përfundonte mashtrimi rreth mbizotërimit të dy boteve, që për shekuj e shekuj kishte ushqyer bindjet për pjesën e mirë të saj dhe atë të ligë, mbi të cilat ishte ngritur dhe kishte qëndruar ndarja, e cila duhej të merrte fund njëherë e mirë me triumfin e Lindjes...

Në fund, pasi që u largova nga bredhjet, të cilat më kishin çuar si larg, ushtarakëve u thashë se na kishte mbetur maja, që të ngjitemi në të dhe çastin që do të ndodhte kjo do të fillonte ndëshkimi i përgjithshëm i Tokës së Lashtë... Çdo gjë e saj duhet shkatërruar, thashë... Prej saj duhet nxjerrë përfundimisht fryma e herezisë... Rrugë tjetër nuk ka...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

E ndala oficerin që kishte përmendur çështjen e karremit dhe ato që lidheshin me njëfarë prirje që rebelët të bëhen të padukshëm. Ia bëra me dije se ai gjykim, i thënë ashtu, po të përsëritej „aty ku nuk kuptohej“ mund t'ia hante kokën.

-E di, më tha ai dhe shtoi- se ishte i gatshëm ta jepte sa më parë nëse ajo do t'i shërbente përballimit të asaj gjendjeje e për më tepër nëse do të dëshmohej e kundërta e hamendjes së tij... -Tek e fundit, më tha ai kur po bëhej gati të largohej, prirjen që ata të bëhen të padukshëm, nuk e kishte shpikur por e kishte parë të pasqyruar tek shënimet e tij Hivzi Pasha, njëri ndër ushtarakët më të fuqishëm të Perandorisë, i cili kishte marrë pjesë në dymbëdhjetë rrethimet e pra të Kështjellës...

-E ka pasur nga zhgënjimi, i thashë. -Ne nuk kemi nevojë të mendojmë ashtu, ngaqë ua kemi marrë të gjitha: i kemi djegë dhe pjekë, ndërkohë që tash po ua pushtojmë edhe majën, pra pikën ku ata kanë menduar se rri e paprekur fuqia dhe shpresa e tyre dhe prej andej rrezaton përherë... Çastin që në atë majë do të ngrihet flamuri perandorak, përgjithmonë shuhet ylli i shpresës së tyre...

Në fund ia thashë edhe këto:

-A nuk e di se ata jetojnë nga besimi, që lidhet me paprekshmërinë e majave?...

Ai më shikoi i heshtur dhe u largua, ndërkohë që mua më mbeti dilema e padukshmërisë së tyre, të cilën e kishte përmendur Hivzi Pasha dhe desh i kishte shkuar koka për të... Ne dëshirojmë t'i zhveshim nga ai besim, i kishte thënë Veziri i Madh, që ata i ushqen nevojë e pa nevojë, ndërsa ti dëshiron t'ua kthesh...

Faqe 14

Dita e e tetëdhjetë e pestë e fushatës:

Majën e kemi afër, fare pranë dhe nesër do ta pushtojmë. Para nesh shtrihet një hapësirë e shkretë, me borë dhe pjesë të shkëputura të akullnajave, prej të cilave aty-këtu shpërthen ndonjë shkëmb që avullon në rrezet e diellit pranveror... Ndërkohë që shikoj majën dhe koka ime bluan mendimet që lidhen me fundin e një shprese, nga të gjitha anët dëgjoj ato që m'i thonë vëzhguesit dhe pararojat rreth mungesës së gjurmëve të jetës në hapësirën e mbetur që shtrihet deri tek maja... Nuk ka jetë, them?... Nuk ka shpresë?... Nuk ka asgjë që lidh kapërcyellin e këtyre të dyjave, e megjithatë është ndjenja e një fundi që lidhet me arritjen e lartësisë, të majës, të asaj që rrënjësisht ndryshon gjendjet...

Xhavid Agai, d.v.

P.S.

Mendja më shkon te Hivzi Pashai. A thua kishte të drejtë?... Nganjëherë dëshiroj t'ia pranoj vetes se si Pashai ishte i guximshëm dhe tepër i sinqertë... Por, shpejt i bie mohut. Them se ai ishte një i sëmure, se ishte

qyqar shkuar qyqari,që për t'u arsyetuar për disfatën, mendja ia polli mendimin heretik...Perandoria pati të drejtë që nuk pranoi të hapeshin muhabetet marroqe,por kërkoi dorë të fortë...Perandoria pati të drejtë...

Dikur, në njëfarë ankthi,m'u bë se po shihja Hivzi Pashain se si ishte i veshur në të zeza dhe dukej si korb dhe se ai korb po më afrohej dhe po më afrohej...Ik,ik,po i thosha...Ik!Nuk u besoj mendimeve ogurzeze...Nuk u besoj...Unë do të ngjitem në majë për ta ngritur flamurin perandorak,mu në atë majën ku ata e kanë pasur të varur besimin...Valëvitja e tij ata do t'i bëjë të paqenë,po thosha...

M'u bë se fjalët e fundit sikur e kthyen nga korbi në njeri,që më pas dukej i qetë,por i kërrusur,sikur të bante hallet e botës mbi shpinë...

„Unë i shihja të padukshëm,ndërsa ti po i sheh të paqenë...Është e njëjta,po më thoshte. Është e njëjta lajthitje,nga që ata janë të dukshëm dhe të qenësishëm...Andaj,do ta kemi të njëjtin fat...”

M'u bë se po e kundërshtoja dhe po kërkjoja të ikte,por ai sikur nuk pranonte këtë nga bindja se ishim të njëjtë dhe duhej të kishim të njëjtin fat...

Faqe 15

Dita e fundit...

U ngjita në atë maje,në atë majë që për tetëdhjetë e dy ditë me radhë m'i mori sytë dhe mendimet. U përpoqa që prej asaj pike të përjetoj kënaqësinë e lartësisë,por ç'e do që nga ajo pikë shpirtin e sëmbonte ftohtësia dhe njëfarë mjegullimi që mbushte me zbrazëti...Heshtja shurdhe më trishtonte dhe sikur ma përkujtonte fundin,atë fund që nuk e kisha pritur se mund të vinte çastin kur do të arrihej maja...Me ato përfitime në kokë,një çast m'u bë se isha kthyer në një korb,që matej të fluturonte kah një humbëtitirë e pakthim,që i rrinte pranë,fare pranë,si një fat i pakapërcyeshëm...Madje,m'u bë se po e shihja edhe Hivzi Pashën,të shkërmoqur që po mundohej të thoshte diçka,por që assesi ta kuptoja se për çfarë ishte fjala...

„Nuk jam korb“,desha të thosha dhe të çirresha dhe mbase do ta bëja këtë po të mos hetoja se afër kisha ushtarakët,që më rrinin prapa si të thyer me flamurin perandorak,që do të vendosej aty,me të cilin ne e dinim se nuk shënohej kurrfarë fitore,pos që ngushëlloheshim bashkërisht...

I rrudhur dhe me ndjenjën e të mundurit,që nuk dëshiron t'ia pranojë vetes,zura të mendoj për hakmarrjen,për një hakmarrje të tmerrshme,që do të na ngushëllonte të gjithëve,që kishim bredhur andejpari dhe ishim nënçmuar keqas...

Dhe,aty për aty mendja më shkoi tek vullneti dhe të mbledhurit,që do të jenë nisur drejt detit për të vdekur në atë luftën që duhet të bëhet me Perëndimin. Për të vdekur,do të vdesin gjithsesi,thashë. Por, a nuk është më mirë që të vdesin nga dora ime?Pse të mos i vrasim ne në shenjë hakmarrjeje në vend që perëndimorëve t'ua qesim si kurban?...Unë do t'i vras...Do t'i vras...Që të gjithë do t'i vras...Ata do të ma paguajnë pësimin dhe nënçmimin e rebelëve...E pastaj,do t'i hedh në det që të mos kenë as varre e as gjurmë...A nuk është kjo hakmarrje shkuar hakmarrjes?...

Pasi vura flamurin perandorak,oficerëve u thashë se po atë çast duhej të niseshim me ngut kah deti...Fjalët për plojën në Liman nuk po më ndaheshin nga goja dhe më bëhej se po villja gjak të zi...

Xhavid Agai,d.v.

P.S

Në Liman,në Liman do të bëhet hataja...”

Dhe kështu,o Flamurtar,kur i rashë në fund fletores me fjongo të zi që ma dha Shpjeguesi i ëndrrave,ajo më iku prej dorës. Një stuhi që erdhi nga lindja ma mori dhe unë pashë fletët e saj të shpërndara që fluturonin si zogj të frikësuar...

„Nuk do t'i zësh kurrë“ -më tha Shpjeguesi i ëndrrave.- „Nuk do t'i zësh...Nuk sheh se u kthyen në zogj të zez?...“

Por,unë nuk u dhashë. Zura të vrapoja pa pushim pas fletëve-zogj. Vrapoja dhe sa më shumë vrapoja merrja në thua,ngatërrohesha deri sa dikur u rrëzova prej nga hetova se po futesha në një errësirë të thellë,ku m'u ngri kujtesa,ku u bëra i paqenë,ku mbeta i zbrazur dhe i shurdhër në të njëjtën kohë...

Nuk e di me tamam sa kalova në atë pa qenie, por në një çast, m'u bë se po ri zgjohesha nga një zë që po më thërriste...

Në atë thirrje rikthimi e dija se ishte zëri yt që më nxori nga ajo harresë e pakufishme, ku çuditërisht kisha sharruar...A nuk është kështu, o Flamurtar?

-Ishte thirrja e shpirtit, që të sëmboi dhe nuk të la të qetë... Ajo të nxori nga „Kulla e Harresës“

Në mëngjes Djaloshi gjeti Plakun të ngrirë. Në fytyrë i kishte mbetur një buzëqeshje e ëmbël fare e përhekët,ndërsa në dorë mbante lulen gjashtërrremash, mu si atë që e kishte gjetur mbi varrin e Mrikës...

SËMUNDJA E TERRIT

Fushën e gjerë, që lahej në rrezet e diellit pranveror dhe dukej si një det i gjelbër, siç pritej, të parët e panë pararojat. Lajmin nxituan ta çonin te rojat e para, e ata ua kumtuan truprojave, të cilët me të shpejtë njoftuan kryerojën. Në pritje të, pasi fshiu pluhurin nga uniforma dhe fërkoj sytë që to mos i dalloheshin shenjat e lodhjes, u nis gjithë nxitim kah tenda mavi. Gjatë rrugës që bëri, u hamend se me çfarë fjale do të thoshte lajmin e pritur:para e kemi vilajetin e skajshëm, apo vendlindjen e Madhërisë? Në ato çaste hamendjeje i ndihmoi hutimi, ngaqë kur pa kadiasqerin të ngrysur,ato që duhej t'i thoshte iu ngatërruan keqas, kështu që, pas një mundimi që ia shfaqti fytyra dhe gjithë trupi, më në fund, nga goja i rrodhi e shkëputur vetëm fjala „erdhëm“, e cila, ndonëse e thënë me aq mundim, kadiasqerit i mjaftoi të kuptonte se pas gjithë asaj rruge që iu duk se e kishin bërë nëpër një humbëtitë, përpara kishin vendin kryeneç me të cilin do të kishin punë...

Lajmi, që e priste, bëri që një buzëqeshje e thartë t'i kalojë nëpër fytyrë sa ta çelte paksa. Më në fund erdhi çasti im, tha me vete dhe i shkoi mendja tek nishanet që do t'i merrte kur të përfundonte fushata. Nuk do të sorollatem më udhëve të tilla të paudha, mendoi kur po bëhej gati të hynte në tendën mavi. Por, rrjedhën e këtij mendimi të mbarë, sikur për pak ia trumëhazi veqili, që i tha se Madhëria kishte dhënë urdhër të mos e trazonin deri sa dielli të mos e prekte majën e bjeshkës, që e kishin para. Kadiasqeri u mat t'i thoshte veqilit se fjala ishte për një lajm të rëndësishëm, që Madhëria e kishte pritur aq shumë, por shpejt hoqi dorë, meqë e dinte se urdhri i të madhit ishte ligj të cilit duhej nënshtruar.

Kadiasqeri shikoi diellin që gjendej në zenit dhe i erdh keq që ai ishte aq lart. Rrezet e forta i erdhën fuqishëm në sy sa ata i dogjën dhe për pak iu errësuan. Më pastaj, një copë herë sendet iu shfaqen si hije të përziera me njëfarë kuqërimi të lehtë që hiqej si mjegull purpuri. Bile një çast,mendoi se ashtu po futej në një hapësirë të përskuqur ku edhe sendet që i shfaqeshin me trajta të ngatërruara herë pas here zhyteshin në një det gjaku,që shtrihej larg dhe shumë afër dhe se ndjenja e ndodhjes në atë mes të papërcaktuar ishte e njëjtë me

gjendjen e njëfarë kllapie që shfaqet pas lodhjeve të mëdha... Kur po i bëhej se do të sharronte përgjithmonë në atë tallandi të përsququr, ndjeu se dikush po e tërhiqte prej andej gati zvarrë dhe se kur mori veten dhe i erdh mirë që u lirua prej asaj gjendjeje, hetoi se ishte veqili që po i thoshte se ishte koha të paraqitej para Madhërisë për t'ia thënë ato që kishte për t'ia thënë. Çuditërisht vendin e kllapisë së përsququr dhe atij deti me gjak ia zuri hutimi se me ç'fjalë do t'ia niste të tregonte se para kishin vendin kah i cili u nisën para dy javësh dhe udhëtuan erre e terr për ta arritur sa më parë. A mjaftonte vetëm një „erdhëm“, siç e dëgjoji të thënë aq mundimshëm nga kryeroja, apo asaj i duheshin shtuar edhe shumë e shumë sosh, para e pas, në mënyrë që lajmi të kishte peshën sa më solemne? Mendja ia thoshte se ai lajm, që nuk ishte si çdo lajm tjetër, meritonte një ngjyrim të posaçëm të zërit, por nuk ishte i sigurt me tamam se kur do ta thoshte, duhej të shprehte shqetësim apo mburrje? Hutimi iu bë edhe më i madh atëherë kur hyri në tendën e madhe dhe befaz u gjend para Madhërisë, i cili i shtruar mbi sexhadenë e purpurt, rrinte këmbëkryq si i ngrirë. Ajo pamje e shtangoi aq sa po të mos dëgjonte befaz një zë të butë që fare prajshëm po kërkonte t'ia thoshte ato që kishte për t'ia kumtuar, me siguri se nuk do të ishte në gjendje të ç'kyçte dot gjuhën që i ishte rrudhur dhe nofullat që i ishin ngjitur. Pasi që edhe për të dytën herë dëgjoji t'i thuheshin të njëjtat fjalë me çka sikur fitoi përshtypjen e një afrie të jashtëzakonshme të krijuar aty për aty, ndonëse edhe më tutje ndjehej i ngatërruar në atë gjendje në të cilën u kurthua, Kadiasqeri nxori fjalën „erdhëm“, që e tha gati çapitshëm, dhe përkundër dëshirës që të mbahej disi, së paku sa të merrte lejen, u shemb poshtë. Veqili me dy të tjerë, i mësuar me aso sjelljesh, e kapi përkrahësh dhe e qiti jashtë.

Lajmin e arritjes në vatan Kryeveziri Hasan Pashë Ohri e priti me njëfarë shqetësimi të çuditshëm, me ca të dridhura, që ia kapluan trupin, duke ia krijuar përshtypjen e një njëfarë zbrazjeje të furishme nga gjërat e tepërta, për të vazhduar tutje me njëfarë shkëputje të përgjithshme nga ato që e rrethonin... Në kushte të tjera do të thërriste mjekun dhe do t'i tregonte një nga një ato që ndjeu, por këtë herë hoqi dorë nga shpalimi i asaj gjendjeje që nuk e kishte njohtë më parë përkundër ngacmimeve nga brenda. Ishte i bindur se atë ndjenjë duhej ta ndiqte deri në fund, paçka se ajo fillimisht e ballafaqoi me një siklet të furishëm, pastaj me një marramendje me shkëputje, që ia krijonte përshtypjen se herë ishte vetja e herë jashtë saj fare, një qenie që po e humbte baraspeshën e brendshme pa ditë as vetë se ku do të përfundonte... Një copë herë mbeti në atë gjendje që nuk mund ta përcaktonte se çfarë ishte dhe mbase do të përhumbej në mjegullën e saj, po mos të ishte jehona e tamtameve të daulleve, që po i vinte befaz nga të gjitha anët, për ç'gjë, Kryeveziri për pak mendoi se tamtamet ishin qëllimisht që kokës së tij të mos ia lejonin hutimin, por shpejt mori vesh se me to po paralajmërohej fillimi i fushatës, të cilës ai i printe me urdhrin e Lartmadhërisë...

Ky qartësim sikur e sëmboi diku në thellësi, për ta nxjerrë nga përhumbeja e marramendjes, gjë që shpejt mori veten dhe iu drejtua daljes, prej nga tashmë jehona e daulleve bënte të dridhej edhe toka...

Jashtë rrezet e diellit të dobët, që ishte në të perënduar, ia ledhatuan fytyrën dhe ia krijuan përshtypjen e një mbrojtjeje nga jashtësia, që nën trysninë e daulleve i vinte e ashpër dhe ndrydhëse. Por, nuk vonoi dhe rrezet e dobëta të diellit në të perënduar, që për pak e mikluan ngrohtësisht, u fikën dhe me këtë mori fund edhe ajo gjendja e një përfytyrimi të ngrohtë, ku me dëshirë do të mbetej... Në vend të ndjenjave dhe përfytyrimeve, Kryeveziri pa se para tashmë kishte një hapësirë të gjerë që po i jepej muzgut të parë dhe ashtu ngadalë do të futej nën kthetrat e pushtetit të territ me ato që kishte për t'iu lëshuar gjumit... Por, hetoi, se në atë kapërcim, hapësira e gjerë që e kishte përpara, në vend se t'i jepej territ, bëhej e praruar dhe shfaqej si një përzierje e çuditshme, që pasqyronte gjendjen as natë e as ditë, ndryshe nga ç'e kishte marrë me mend. Mendja ia tha se e gjithë kjo mund të lidhej me atë se gjatë, shumë gjatë kujtesën e kishte ushqyer me një përfytyrim të zbetë të vendlindjes, të mbërthyer me një si vesë të praruar, e cila kishte ndihmuar që edhe gjërat e bartur nga fëmijëria, më kohë të zvetënuar, të merrnin një kuptim të ri, ndonëse të papërcaktuar, që sikur kishin për detyrë

t'ia përkujtonin përkatësinë edhe atëherë kur ajo i shfaqej fare e mjegulluar dhe largët... Atëbotë ishte gjashtëvjeçar kur familja mori rrugën e Kryeshehrit. I ati, një qatip i postës, i pat thënë se vendlindja nuk harrohej kurrë, meqë ishte pjesë e qenies, që po ta kesh larg, kthehet në kujtesë, që sëmbon përherë... Shpirti nuk tjetërsohet, i kishte thënë i ati kur po e endte nëpër të gjitha pjesët e qytezës dhe në atë shëtitje po i fliste për lumin Krena, për Çabratën, që verës sjell freski ndërsa dimrit ndal acarën që vjen nga Shkëlzeni dhe Reka...Kjo është Çarshia e Madhe në të cilën çdo të hënë derdhën Rekë e Malësi dhe mund të blihet malli i botës...Kjo është fusha e Sahatit, ku pehlivanët bëjnë mrekulli, ndërsa përgu i saj kohën e bën të kapshme për të gjithë... Ky është kroi i vashës, që vjen nga Bjeshkët e Nemuna... Historia e këtij kroi është pjesë e një dashurie tragjike... E tjera e tjera... Kishte përshtypjen se ashtu dëshironte që pamjen e secilit gur dhe secilit dru t'ia nguliste, që serish t'i rishfaqeshin në kujtesë pa marrë parasysh kohën dhe largësinë që do të futej në mes dhe do t'i ndante... I thoshte çmos sikur kërkonte me çdo kusht që koka e tij e vogël të mbushej me gjëra që duhet t'i bartte përgjithmonë të paluara dhe të gatshme të hapeshin edhe atëherë kur kjo duket e pamundur, pra në çdo kohë... Por, nuk kaloi shumë dhe ai kuptoi se koha ishte me e fortë se kujtesa e tij. Larg vendlindjes hetoi si një nga një zunë t'i mjegulloheshin pamjet e gjërave të njohura, që i mori me vete me aq nguti, disa prej tyre për t'u zvetënuar fare. Nga gjithë ato rrugica, shtëpi, kodra dhe lumenj i kishin mbetur vetëm disa pamje të shkëputura e të zbehta, të cilat edhe kur i kujtonte i përziheshin me të tjera, kështu që nuk e dinte me tamam se çka ishte kujtim i mirëfilltë, që e bartte nga vendlindja, e çka pjesë e të tjerave...

Ndoshta një ditë ai t'ia hollë i kujtesës do t'i mbetej si një pikë e mjegulluar fare dhe jashtë vëmendjes sikur Lartmadhëria të mos i kishte thënë se atje po ndodhnin gjëra të jashtëzakonshme, tepër shqetësuese... Tek po i fliste për to, e kishte derdhur shikimin nga ai më shumë se rëndom dhe kjo kishte bërë që atij t'i shkonte mendja se mbase vetëm te ai kërkohej shpjegimi i asaj brengë të Perandorisë... Njëherë deshi të pyeste se ç'ishte vallë ai shqetësim, që ai nuk e dinte (e duhej ta dinte para se të arrinte deri tek Lartmadhëria)? Dhe, kur po matej që ta shtronte këtë bashkë me atë se si ishte e mundur që ai të mos e hetonte një shqetësim aq të madh kur ai kishte marrë ato përmasa, Lartmadhëria la për të kuptuar se dëshironte të vazhdonte ta plotësonte mendimin, dhe këtë do ta bënte pasi të pinte shurupin e freskët, që rëndom e përdorte para se të merrej me ndonjë qartësim më të hollësishëm që doemos lidhej me shpalljen e fermanëve apo vendimeve të tjera të jashtëzakonshme. Rrufjet e ngadalshme si dhe derdhja e shikimit nga jargavanët e dritares ballore, që ai e hidhte herë pas here, ia bënë me dije se ato që do t'i dëgjonte së shpejti do të ishin të një rëndësie të veçantë dhe kjo ia shtonte edhe më shumë kureshtjen, por edhe drojën se mbase po vinte koha kur ai do të ballafaqohej me sprovën më të madhe të pushtetit, e cila në rrethanat perandorake, rëndom lidhej për vatanin dhe sjelljet ndaj tij, e pakapërcyeshme për gjithë ata që i afroheshin majës së fronit më të lartë, prej nga pushtimi i tij rëndom përcillej me atë hapin vendimtar për tek ai, apo në greminë... Ky mendim i futi të dridhura të shumta nga të gjitha anët si një shqetësim i paparë, saqë një çast kujtoi se do të shembej para se të dëgjonte ato që tashmë ishte i bindur se kishin peshën e një gjykimi të jashtëzakonshëm, prej të cilit varej e ardhmja e tij... Por, mbase ishte vetë sjellja e Lartmadhërisë si ngreh e mos këput, që po e mbante varë, e pasqyrua me njëfarë mbllaçitje të fjalëve të pakmëparshme, me ç'rasë fjalës „të jashtëzakonshme“, që e kishte thënë me një theksim shumë të fortë, i ishte shtuar parafjala „tepër“, që atij i ishte dukur si një kërcënim i hapur me të cilin duhej ballafaquar doemos....Dhe për t'u mbrojtur nga ai kërcënim, që ende nuk e dinte se çfarë ishte në të vërtetë, por që i lidhej me vatanin, që rëndom shumë të tjerëve u kishte ardhur si mallkim në çastet më kritike kur ishte vendosur për ngritje drejt majave, apo për rënien e pandalshme, thuajse pavetëdijshtë, Kryeveziri bëri përpjekje që të mbrohej me përfytyrimin e vendlindjes, si pjesë e vatanit. Por, me keqardhje dhe dëshpërim, hetoi se mozaiku i saj tashmë ishte pa shumë pjesë dhe fare i mjegulluar. Bile, edhe ato që i vijëzoheshin, nuk ishte i sigurt në ishin të gjitha të saj, apo përzierje të huaja. Megjithatë, ai për herë të parë po merrej aq ngulshëm

me riformësimin e atyre kujtimeve dhe pjesëzave të shkapërderdhura, dhe se, nga e gjithë ia doli që përballë mjegullimit të formësojë një shtëpi të vogël, një lumë, që nuk e dinte me tamam se çfarë përmasa kishte si dhe një kodrinë, e cila herë dukej dhe herë nuk dukej... Pak më vonë, nga ai formësim, iu bë se po shihte një derë të drunjtë, fare të rrezbitur, në të cilën varej një hallkë e madhe, që nuk e dinte se pse ishte e tillë... Mendja ia thoshte se kjo ishte dera e shtëpisë së tij, që rrinte si e shkëputur dhe assesi t'i afrohej ndërtesës së vogël, e cila dukej si e strukur prapa një mjegullimi tjetër... U mundua që atë derë dhe atë shtëpi disi t'i afronte dhe t'i lidhte, por ishte e pamundur, siç ishte e pamundur t'i shihte të ndërlydhura me të tjerat, që do të duhej të ishin në afërsi... Nga e gjitha, dikur iu bë se po shihte pjesët e një minareje, që sillej sikur të ishte në qiell, por që edhe ajo, duke u ngatërruar me përgun e një kishe sa njësohej me të, shpejt i treti në një ngatërrim fare shpërqendruar, sikur të mos ishte... I erdh keq që vendlindja i kishte sharruar në atë mjegull dhe mbase do t'i qasej edhe më tej me shpresë se prej andej do të nxirrte ndonjë pjesëz të shkëputur nga ato që ishin shformësuar, po të mos ishin fjalët e Lartmadhërisë rreth asaj që tha se si atje, kishte filluar shfaqja e një magjie me lojën e ndryshimit të pamjes së njeriut, nga e dukshmja në të padukshmen dhe anasjelltas...

“Magjia e zezë, nuk është marifet cirku, por ogur i rrezikshëm, që duhet ndalë para se të bëhet vonë...”

Fjalët e fundit sikur e mbushën me një hutim të pashpjegueshëm dhe iu dukën jashtë çfarëdo mësimi dhe përfytyrimi për njeriun si qenie, që së paku fizikisht, është e dukshme, por nga brenda e padukshme e të ngjashme që mbështetej edhe nga librat e shenjta dhe dijet... Magjia e zezë, si dhe përhapja e saj, me kërcënimin se duhej ndalë sa më parë, aty për aty ia ngatërroi parafytyrimin për natyrën e njeriut dhe ligjet e botës, sa deshi të pyeste se mos ishte fjala për ndonjë keqkuptim, por ishte ndërhyrja e mëtutjeshme e Lartmadhërisë, që tashmë kishte nisë të jepte ca hollësi rreth kësaj dukurie, që e bëri shuk.

“Ka kohë që shërbimet tona më të besueshme kanë hetuar prirjen e ndryshimit nga dukja në mos-dukje dhe anasjelltas, si diçka të rëndomtë, me ç'rast, disa njerëz, sa shihen e sa nuk shihen, gjendje kjo që thyen ligjet jetësore dhe shpirtërore njëherësh deri te përmasat e një çrregullimi të përgjithshëm të vetë natyrës së njeriut me pasoja të paparashikueshme... Meqë për nevoja të jashtme, çështjen duhet ta trajtojmë si magje, që andejpari është e përhapur dhe kështu ta zhvlerësojmë nga çfarëdo qëllimi, ndërsa për nevojat tona shtetërore duhet ta hulumtojmë në hollësi se çfarë synohet, pra krahas kësaj duhet të marrim të gjitha masat e duhura për ta parandaluar sa më parë po edhe për ta luftuar me të gjitha mjetet para se të bëhet vonë...”

Lartmadhëria më tutje vazhdoi të fliste se si me anën e një fermani të fshehtë kishte formuar një komision shteti për ta shqyrtuar gjendjen, ku njerëzit më të sprovuar të shërbimeve të posaçme, me ditë të tëra, kishin punuar rreth ndriçimit të rastit...

„Pas gjashtëdhjetë ditësh hetimesh mora raportin e besueshëm, prej nga ato që në fillim më dukeshin thashetheme, dolën si të vërteta...”

Sapo i tha këto, nxori një tubë lerash të lidhura me fjongon e verdhë, që u vihej fshehtësive perandorake të rendit të parë dhe ia la përpara Kryevezirit.

„Lexoj dhe pastaj bisedojmë”.

Kur i mori letrat, Kryevezirit iu duk se në dorë kishte gjithë shqetësimin e Perandorisë. Megjithatë, në atë gjendjeje tepër të papërcaktuar, kur nuk e dinte si ta cilësonte, nuk ishte i sigurt se mendimi i parë që i shkrep, se vetëm qoftëlargu dhe mashtrimi i tij që njerëzit t'i bënte të padukshëm, do të mjaftonte të merrej si pikënisje për t'i shpallur luftë asaj që Lartmadhëria e quante herezi dhe dihej se çfarë qëndrimi nënkuptonte, njëherësh do t'i shërbente për t'u mbrojtur nga shpërqendrimet e mundshme që ngatërroheshin tek lëmshi që tashmë e kishte përpara?... Kjo dilemë po i bëhej edhe më e madhe nga shkaku se herezia i

lidhej me vatanin, pra vendlindjen dhe jo si e keqe që ishte shfaqur në një pjesë të Perandorisë, gjë që bashkëveprimi mund të kuptohej si një luftë kundër fajësisë, me të cilën tashmë, ndonëse tërthorazi, ngarkohej?... Përballë kësaj gjendje, për herë të parë iu kthye të menduarit rreth përkatësisë trupit të përbashkët dhe përmasave të sajë të njëmenda, që ndonëse kishte dhënë çdo gjë për të dhe thuajse i ishte ngjitur në maje, sikur e shikonte si të huaj... Kjo mëdyshje, që nuk ia kishte marrë mendja se do t'i shfaqej ndonjëherë, po i fuste të dridhura dhe gjithnjë e më shumë po e mbushte me një tallandi ngulfatëse, që po i vinte pikërisht nga ajo pjesa e harruar, që lidhej me ato kujtime, për të cilat i ati i kishte thënë se duhet bartur me vete si hijall, që ushqen shpirtin në çastet më të vështira, veçmas kur ndjehet i huaj dhe i vetmuar...

Por, para se të shihte përmasat e atyre me të cilat papritmas po ballafaqohej dhe para se të gjykonte me tamam se për çfarë ishte fjala, i mbetej t'i lexonte sa më para ato që i kishte para me firmën e fshehtësisë së rendit të parë të Perandorisë... Një copë herë shikoi dyllin e verdhë përmbi vulën e Perandorisë, që e njihte aq mirë dhe iu bë se ai po i rritej e po i rritej sa po i kthehej në një njollë të zezë, ku së shpejti mund të sharronte...

(Raport i Komisionit të shtetit, rreth herezisë në Tokën e Lashtë, i themeluar me urdhrin e Lartmadhërisë

Sulltan Osmanit të Dytë,

i kryer në fillim të dimrit të vitit 1614)

„Me urdhrin e prerë të Lartmadhërisë, unë, Idriz Allajbeu, bashkë me katër nëpunës të lartë të Shërbimit të Fshehtë të Mbrojtjes së Shtetit, u nisëm për në shehrin e Tokës së Lashtë me detyrë që aty për aty t'i shqyrtojmë ato që si thashetheme po hapeshin lidhur me atë se atje n j e r ë z i t, herë pas herë b ë h e s h i n edhe t ë p a d u k s h ë m dhe anasjelltas!

Rrugën e morëm të përgatitur mirë dhe të bindur se syrit tonë nuk do t'i shpëtonte asgjë që është në interes të ndriçimit të këtij rasti të çuditshëm. Kështu, misioni ynë, filloi dhe mbaroi në rrethana tepër të fshehta, ashtu siç u kërkua dhe siç punohet në raste të tilla të veçanta...

Pas rrugës së gjatë që e bëmë sikur të ishim mumie, arritëm shehrin e Tokës së Lashtë, të mbërthyer pranë bjeshkëve. Fusha që i rrinte para na dukej se para shikimit tonë ndryshonte përmasat në përputhje me flakërimin e rrezeve të dritës që i vinin nga prapa... Kajmekamit i thamë se ishim hulumtues të ujërave dhe ia dorëzuam dëshmitë e duhura me të cilat ishim ngarkuar nga kryeqendra. Ai na priti mirë, dhe siç kërkohet nga ato që shkruheshin në letrën përcjellëse, u zotua se do të na delte në ndihmë. Që të na mundësonte punë të mbarë u tregua aq i vëmendshëm sa mori përsipër edhe cikërrimat që nuk i përkitnin fare. Mendja ma thoshte se këtë e bënte ngaqë dëshironte të mbeteshim sa më larg thashethemeve që qarkullonin andejpari, të cilat janë pjesë e asaj bote, me cilat aty kërkohet të ruhet vëmendja nga pjesa tjetër... Me këtë rast përmendi palaçot dhe fakirët e ndryshëm që argëtojnë, po edhe mashtrojnë me marifete të ndryshme... Këtë e hetuam edhe nga përcjellja e vazhdueshme që na bëhej nga të panjohur, që mund të merrej me mend se ata ishin njerëzit e tij më të besueshëm... Ne, megjithatë, tregoheshim të vëmendshëm dhe nuk lejonim që me asgjë të ushqenim dyshimet se merreshim me punë të tjera, pos me ato me të cilat zyrtarisht ishim ngarkuar. Kështu, ne hapnim hartat tona plot e përlot vija të ngatërruara dhe shtireshim sikur nuk na interesonte gjë prej gjëje pos ujërave tekanoze, që aty ishin të

shumta... Duket se sjellja jonë shpejt hoqi dyshimet e mundshme dhe ne përnjëmend merreshim si njerëz të ujërave që nuk çanin kokën për të tjerat...

Në të vërtetë, siç u morëm vesh në Kryeshehër, punës ia nisëm nga ujërat me përkushtimin se në këtë vend të merresh me ujin do të thotë të kesh punë me shenjtërinë e tyre... Ne kishim njoftime të bollshme se si askund tjetër aty mbizotëronte bindja se uji ishte i pacenueshëm, gjë që kjo shprehej edhe në qëndrimin e tyre me ç'rast atij i bëheshin flijime të shumta dhe të përhershme... Kjo bindje hetohej edhe me sovranitetin e ujit, që pasqyrohej me vijat e shumët, të cilat fillojnë nga burimi i lumit diku në bjeshkë dhe vazhdojnë të degëzohen nëpër të gjitha anët si një merimangë, herë duke hyrë e herë duke dalë lirisht nga secila shtëpi dhe secili oborr. Madje ishte pikërisht kahu e vijave të ujit që kishte përcaktuar shtrirjen e shehrit dhe jo e kundërta, siç ndodh kudo. Me një fjalë, ngritja dhe zhvillimi i shehrit ishte bërë siç kishte dëshiruar uji, prandaj ishte edhe e arsyeshme pse edhe presa më e vogël apo çfarëdo lajthitje nga kushdo për këtë vend do të thoshte shqetësim i përbashkët dhe i përgjithshëm... Nisur nga kjo bindje, ne kishim për detyrë që të jepnin dëshmi se gjatë hulumtimeve tona me asgjë nuk dëshironim ta ndryshonim këtë ligje. Madje, për të qenë edhe më bindës, hapëm fjalë se me matjet që bënim, kishim për qëllim që Perandorisë t'i parashtrojmë sjellje të njëjta me ujin në mënyrë që të ruhej ajo harmonia e mrekullueshme dhe e domosdoshme midis njeriut dhe natyrës siç e thonë edhe librat e shenjta. Në përputhje me këtë qëndrim njërit nga bashkëpunëtorët i dhashë për detyrë t'i shënonte këngët, legjendat dhe gjitha ato që thuheshin për ujin dhe ca prej tyre t'i thoshte publikisht, gjë që pati për pasojë që i madh e i vogël të na merrnin për dashamirë të njëmendët të ujit e me këtë edhe të tyre... Për të krijuar afërsi sa më të madhe me ta mësova ca nga vargjet e shënuara, që i përsërisja sa herë që e kërkonte nevoja dhe me këtë u hapnim rrugë t'i thithnim ato që na duheshin.

Çfarë pyetnim ne?

Së pari përqendroheshim kah vjetërsia e shtëpive. Pastaj, silleshim kah vijat e ujit që i përshkonin ato në hyrje dhe në dalje, për të kaluar pastaj tek pemët dhe frytet që i merrnin prej tyre, gjithnjë të ndërlidhura me ujin dhe praninë e tij... Kështu ne hetuam se e vetmja gjë që aty përshkruhej me saktësi, pa u lënë vend hamendjeve dhe mëdyshjeve që shfaqeshin me rastin e përcaktimit të vjetërsisë së shtëpive apo ngrehinave të tjera, ishin vijat e ujit të vetmet, rreth të cilave mbretëronte pajtueshmëria e përgjithshme, që pasqyrohej me pandehmën se ato ishin të përhershme dhe të paprekshme... Ata thoshin se, mund të ndryshojë edhe guri e edhe druri, por rrjedha e ujit jo...

Edhe bashkëpunëtori që merrej me çështjet e trashëgimisë së tyre gojore m'i vërtetonte ato që dëgjoja pareshtur. Nëpër legjendat e tyre rrallë takohen shenjat e shterjes, thoshte ai.-Po ngjau kjo, atëherë fjala është për shenja të tronditjeve të mëdha dhe të jashtëzakonshme që pashmangshëm përfundojnë me kobe të mëdha...

Kështu, pra, pak nga pak, gjithnjë duke u sjellë rreth ujit dhe vijave nëpër të cilat ai kalonte tejet sovran, po u afroheshim çështjeve për të cilat kishim ardhur dhe kjo së pari lidhej me hartimin e listës së përpiktë të secilës shtëpi veç e veç dhe të shehrit në përgjithësi. Në letrat tona tashmë kishim emrat, mbiemrat, ditëlindjet, gjinitë dhe marrëdhëniet familjare e farefisnore të shumicës së banorëve. I dinim lidhjet e familjeve me familje, i dinim çështjet e martesave, ato të pronësive bashkë me ngatërresat e hershme dhe të rejat që shkaktoheshin prej tyre... Ia dolëm madje që ca familjeve t'ua shënojmë emrat e pesë-gjashtë koreve dhe me këtë vërtetuam atë që dihej rreth ndryshimit të besimeve, që këtu përherë është bërë në përputhje me vënien e pushtetit. Por, krahas kësaj, hasëm edhe dukurinë e ruajtjes së dy besimeve brenda të njëjtës shtëpi, vëllezërve apo edhe fisit... Ndodhte që njëri vëlla kishte fenë tonë, ndërsa tjetri fenë paraprake, kështu që kryqi dhe gjysmëhëna bashkëjetonin në të njëjtën dhomë dhe midis njerëzve të njëjtë thuajse ishte fjala për gjëra të thjeshta, fare të parëndësishme e jo për dy bota të kundërta, që prej shekujsh luftonin për jeta a vdekje me njëra-tjetrën... Familjet me dy besime quheshin l a r a m a n ë, ndërkohë që kuptimi i l a r a-

m a n i s ë nuk paraqiste kurrfarë veçantie, apo përkufizim në planin shoqëror, pronësor apo tjetër... Përkundrazi, fituam përshtypjen se l a r a m a n i a shfaqej si favor i njëmendët, meqë ajo mbronte të gjalla lidhjet familjare dhe çështjet tjera edhe aty ku realisht do të duhej të shfaqeshin të qarat, që sjell g j e n d j a e d y s i s ë... Krahës kësaj na ra në sy edhe dukuria e përsëdytjes apo e përsëritjes së emrave në secilën familje, që përherë ndiqte rrugën e përtëritjes, me ç'rast emri i kryeparit i vihej fëmijës së parë që lindte dhe kështu me radhë,që po të shikohej nga pikëpamja e thjeshtë e regjistrave dhe rregullit që e nënkupton hyqymeti,ngatërresat i bën të pashmangshme...

Me një fjalë, ditë për ditë po futeshim thellë e më thellë në atë lëmshin e tyre shpirtëror,i cili nga jashtësia lente për të kuptuar se do ta bënte edhe më të vështirë qartësimin e çështjes me të cilën ishim ngarkuar.

Sidoqoftë, ne ia nisëm punës me përkushtim dhe të vetëdijshëm se vetëm shumësia e të dhënave do të na ballafaqonte me sprovën e asaj që duhej hetuar sa më parë dhe sa më mirë, kështu që nuk na hutonte asgjë. Gjatë regjistrimit të parë, që ua bëme njerëzve dhe gjësendeve përreth (që përpiqeshim çdo gjë të dukej si mbledhje e shënimeve të rastësishme që lidheshin me qarkullimet e ujërave), nuk hetuam asgjë të jashtëzakonshme. Ngjashëm na u duk edhe me rastin e regjistrimit të dytë, me të vetmin ndryshim se në mesokohën prej dy javësh në shehër ishin shënuar dymbëdhjetë lindje të mbara dhe dy vdekje të natyrshme... Krahës lindjeve dhe vdekjeve u shënuan tri martesë,disa fejesa dhe u lidhen tri kumbari...

Gjatë regjistrimit të tretë (që e bëme gjashtë ditë pas të dytit),hetuam se në lagjen e skajshme mungonte një plakë,që jetonte e vetmuar. Kot përgjuam nga jashtë dhe nga brenda,por plaka nuk ishte që nuk ishte. Në atë ndërkohë,kur kishim bërë sytë katër dhe përgjonim nga të gjitha anët së mos lëvizte njeri andej, hetuam se si dera e shtëpisë herë mbyllje e herë hapej,fare padiktueshëm dhe vetvetiu. Çuditërisht, ditën e katër plakën e hetuam tek rrinte me furkën në dorë pranë vatrës së ndezur (e cila edhe më parë nuk fikej). Nuk na vuri veshin edhe kur iu afruam dhe kërkuam prej saj leje të uleshim... Foli vetëm atëherë pasi që pyetëm si ishte e mundur që zjarri mbahej edhe pa njeri pranë. Na e bëri të ditur se zjarrin nuk e lente vetëm kurrë...

(Ka njëmijë vjet që zjarri jeton në vatrën time dhe ai do të mbetet përgjithmonë i tillë me apo pa mua...Shpirti im e mban të ndezur – na tha).

Kështu filloi interesimi ynë për plakën. Mësuam se quhej Shahe Krraba, se i kishte kaluar moti të njëqindtat, se ishte nënë e gjashtë fëmijëve (e një vajze dhe e pesë djemve), se djemtë i kishin vdekur moti një nga një nga një sëmundje e panjohur deri më atëherë në ato anë,ndërsa vajzën e hasretit e kishte martuar në një bajrak të largët shtatë ditë udhë kah Veriu,në një vend që plaka thoshte se qëllimisht ia kishte harruar emrin...

(Ç'më duhet emri i atij vendi dhe i atij fisi të mallkuar?...Erdhën dhe ma morën me natë dhe me natë u larguan...Të mos u shoh më u thash krushqve,sepse tash jam e paqenë...Jetoj me terrin,sepse ai më ndihmon ruajtjen e pamjes së shpirtit...)

Isha i bindur se plaka qëllimisht nuk dëshironte ta zinte n'gojë emrin e së bijës se frikësoje se po t'ia thoshte do ta gjente ndonjë e ligë,siç ia kishte gjetur të bijtë. Kjo lidhej me besimin e tyre të përhershëm se mortit të madh duhet t'i fshihen emrat doemos...

(Nga dita që më shkuan sokolat jam hije...)

Ata që kishin pasur rastin ta shihnin ndonjëherë,e të tillë ka pak,na thanë se plaka jeton me ujin...Pi nga një filxhan në ditë sa për ta mbajtur shpirtin...Prej vdekjes së të bijve,goja e saj nuk ka provuar tjetër gjë...

Neve na u hapën shumë mëdyshje rreth vetmisë së plakës,veçmas kur morëm vesh se si ajo nuk ushqehet fare, pos që merrte nga një filxhan ujë në ditë... Mendimet e saj kryesore janë këto:

...kaherë m'u ka ngatërruar kufiri midis të qenit dhe të paqenit...

...nuk e di me tamam se kur shoh dikë a kam përpara ndonjë kufomë apo ndonjë hije?...

...vetëm të vdekurit janë të njëmendët...

... vetëm botës së të vdekurve mund t'i besohet...

Një ditë i tha edhe këto:

...për mua ka të gjallë që janë të vdekur dhe të vdekur që janë të gjallë dhe kjo është e njëjtë...

Si Shahe Krrabën hasëm edhe një plakë tjetër, në pjesën lindoret të shehrit, mu aty ku vijat kryesore të ujit ndahen prej lumit dhe derdhen hareshëm nëpër të gjitha pjesët e tij. Ç'është e vërteta atë e gjetëm në sajë të grindjeve të fëmijëve.

(U befsh i paqenë si Nuria, i tha njëri tjetrit, ndërkohë që tjetri qeshi dhe iku...)

Ne që vëzhgonim me kureshtje të madhe çdo imtësi, e pyetëm fëmijën se pse ajo grua u bëka e paqenë?... Fëmija si fëmijë, rrudhi krahët dhe u skuq. E morëm me të mirë dhe i thamë se nuk kishte pse frikësohej, as nga ato që kishte thënë e as ato që mund t'i thoshte rreth këtij rasti.

(Kështu i themi atij që nuk dëshirojmë ta shohim përkohësisht...)

Plakës Nurie Futa, që i thoshin Nurë, shpejt i ramë në gjurmë. Jetonte në një shtëpi të madhe, e vetmuar prej shumë vjetësh.

(Nuk jam e vetëm, na tha... Jetoj me ujin... A nuk e ditke se uji është miku im i vetëm?... Ai më përkund... Më vë në gjumë... Më ruan ditë e natë... Kush të rri pranë si uji pa të shqetësuar?... Mjerë ai që flet keq për ujin...)

Edhe Nuria i kishte kaluar të njëqindtat. Vetmia e saj kishte filluar moti, sapo ishte martuar, kur burrin ia kishin vra në një pritë. Me të kishte kaluar vetëm shtatë net, që ajo i quante të jashtëzakonshme, që jetën e saj kishim mbushur me aso kuptimi sa përsëritja e të njëjtave do t'i zhvleftësonte... Nga ai çast u vesh me të zeza dhe nuk e kaloi më pragun e derës. Të gjithë thonë se ajo flet me vete dhe krye çdo dhjetëvjetëshi i ndërron emrat e atyre që i zë n'gojë pareshtur... Kështu vepron edhe me të shoq, të cilin herë e thërret Lis, herë Shpend, herë Ujk e herë Mal... Së fundi e quan Mot... Nga kjo përzierje e emrave megjithatë mund të merret vesh një kuptim i veçantë, që paraqet ndryshimin e gjendjeve nga koha në kohë, që ajo e shikon të ndërlidhur jashtë hapësirës... Emri Mot, mbase këtë e shpjegon më së miri, me të cilin synohet që kapërcimet të kthehen në një vazhdimësi, që gjithsesi se len edhe shumë për t'u hulumtuar...

Për dallim nga Shahe Krraba, plaka Nurë, thonë se nuk ushqehet fare. Nuk e fut në gojë as ujin, që e do mbi botën.

(Ushqehet me terrin, tha njëri. - Netëve të verës dëgjohet mbllaçitja e nofullave të saj që i përngjanë një gjemë... Ai që ha terrin, nuk vdes kurrë...)

Megjithatë, plaka Nurë, edhe si e padukshme, hetohej. Ne dëgjua plot kureshtje zërin e saj që sillej nëpër shtëpi tek lëvizte dhe tek i tregonte dikujt diçka për një bimë të zezë e cila befasisht kishte qitur një lule të kuqe:

(Si s'ë ke parë, moj?...)

Ah, sa e bukur si është...

...Sa keq...

Të kuptoj, moj e shkretë, të kuptoj...

...Kaherë ka mbetur pa sy?...)

Po ti çfarë thua për këtë?... A?... Asgjë?... Si gjithnjë?... Deri kur do të ngarkohesh me peshën e kotësisë?... A?... Nuk ke ndërmend të heqsh dorë nga gjërat e pakuptimta?... Sa keq... Sa keq...

Kush të ka faj se nuk i ik mallkimit të përditshmërisë?...

...Sa keq...)

Pastaj dëgjua një këngë që i ngjasonte një vajtimi të thellë. Dhoma mbushej me tinguj të thekshëm që përplaseshin nga njëra anë në anën tjetër dhe gjatë asaj përplasje bëheshin edhe më të thekshëm. Një copë herë plaka Nurë vajtoi apo këndoi, e dikur zu të bisedonte me dikë:

(...Ç' thua, moj Koko?... Pse nuk erdhe më parë?...

E dija se do të m'i thuash këto... E dija... Ti nuk flet ndryshe... Ka njëqind vejt që thua të njëjtat fjalë...

...Edhe para treqind vjetësh m'i the të njëjtat...)

Mendon se kam harruar?... Jo... Jo...
...Nuk i kam dyqind por katërqind vjet...Rrafsh katërqind...As më shumë e as më pak...
Po ti,moj Verore,pse je katandisur kështu?...
...Ke ngrenë yje?...
E di, e di...Mbase një ditë i kthehesh edhe hënës?...Kujdes se na len pa të...Nuk shfaqet ajo kot e grimcuar,herë pa një pjesë e herë pa tjetrën...Më kot ajo plotësohet,kur të pangopurit e hanë...
E,ti moj Bjeshkë,pse rri e brengosur?...
E ke për çupën?...
Ah,harrova...Por,ajo do të vijë...Vjen patjetër...
...The se kaluan njëqind vjet pa e parë?...
Sonte do ta kesh përpara...Sonte...Por,mos i ha të gjitha rrasat e varreve,sepse i humb gjurmët...)

Pak më vonë i tha edhe këto si pyetje:

(Ç'u bë me Gjergjin?...
Po me Gurin?...
Do ta marrë Mrikën?...
Po Verorja ç'thotë?...
Mbyll yjet në liqen?...
I ka dalë syri i tretë?...
E ka shkurtuar gjuhën?...)

Foli një copë herë ashtu dhe pastaj iu kthye vajtimin të thekshëm. Më vonë prapë ia nisi me ata emrat e ngatërruar nga të cilët na pëlçiste koka. Së voni e pamë si hyri brenda me një kërrutë të madhe...Pa na vu veshin na tha:

(Nuk kam çupë për martesë... Nuk kam... Ndoshta do ta kem pas dyqind vjetësh?... Ndoshta pas pesëqind vjetësh?...Është krejt një,por do ta kem...
Ejani pas treqind vjetësh...Atëherë ua jap...Krushqit e durueshëm kurrë nuk kthehen thatë...
Të tillët më pëlqejnë...
Por, harroni atllarët...
Harroni...)

Ajo na merrte për krushq dhe kur po bëheshim gati t'i thoshim se nuk ishim krushq, na harroi fare,sikur të mos ishim për t'iu kthyer bisedës me ato që i përfytyronte:

(A të thashë, Koko, se bota është e vogël, se mali me mal takohet...
E ti Shkruman, pse sorollatesh nëpër varret e huaja?...Pse dërdëllisësh kot dhe nxjerr yjet nga goja?...
Mos u anko pastaj se të kanë harruar ...
E ti Ujkan,pse e mban ashtu atë kryq?... Pse e tërheq zvarrë?... Të kuptoj, por e ke kot... Kot... Ka katërqind vjet që mendoj për hallin tënd, por assesi ta zgjidh... Nuk do të ngutem... Mos u merakos... Nuk do të ngutem... E di se kjo të ushqen... E di... Një ditë do ta mësosh atë që duhet ta mësosh... Patjetër... Patjetër...)

Gjatë u morëm me Nurie Futën dhe sa më shumë që e dëgjonim nuk e dinim me tamam se a fliste njëmend ajo apo një shpirt i huaj në të?...Njëherë më shkoi mendja se tek ajo ishin puqë çuditërisht disa qenie,që ngatërroheshin me njëra-tjetrën...

Raste të tjera të ngjashme nuk gjetëm. Bëmë edhe tri regjistrime të njëpasnjëshme dhe u futëm në të gjitha skutat (gjithnjë me arsyetimin se hulumtonim ujin dhe lidhjet e njerëzve me të).

Në lagjen afër shatërvanit të madh,megjithatë na thanë se ishte një djalë që ecte pas perrive dhe mund të ndodhte që këtë ecje ai e bënte herë i dukshëm e herë i padukshëm. Tri ditë dhe tri net e përçollëm çdo veprim të tij dhe vërtetua se vijon:

Djali që i thoshin Shejnur, prej babës Hysni dhe nënës Nerxhivane, ishte fëmijë i tretë. Ai çohet në pikë të gjumit nga shtrati,symblltas hapte dritaren,dilte në çardak dhe pasi sillej tri herë nëpër të,kalonte nëpër murin ballor (të gjatë pesë metra e dyzet e një centimetër) dhe

ngjitej në kulm. Sillej katër herë prej njërës anë në tjetrën e pastaj ulej mu në cep të tij dhe një copë herë mbante sytë kah qielli me hënë. Me duar të ngritura përpjetë (sikur të lutej), bënte edhe një kalim nëpër kulm, kthehej murit ballor, ulej në çardak dhe hynte në dhomë. Futej në shtrat dhe vazhdonte gjumin e rehatshëm. Në mëngjes dukej i freskët dhe nuk jepte kurrfarë shenjash të ndonjë lodhjeje apo ankthi.

(Bëra gjumë të mirë, i thoshte të s'ëmës, e cila dinte fare mirë se ç'kishte ndodhur gjatë natës).

Ne i shikuam me vëmendje të madhe të gjitha ato bredhje dhe e patëm të qartë se ai nuk ishte nga ata që bëheshin të padukshëm, edhe pse kjo mund t'i dukej dikujt. Përkundrazi, ai ecte nëpër çati në të njëjtën kohë dhe bënte të njëjtat veprime, pa u shtuar dhe pa u munguar asgjë. Bile, me të matur kohën, vërtetuam se bredhja e tij në çati zgjaste gjithnjë për aq sa numri një mund të shqiptohej gojarisht njëqind e dyzet e dy here.... As më pak e as më shumë.

(Ka kohë që Shejnuri ynë vepron kështu, na thanë prindërit e tij kur pyetëm rreth atyre që ndodhnin me të birin. -Në fillim u tmerruam... Si është e mundur që fëmija të dalë nga shtrati dhe symbylltas të ngjitet në çati për të bredhur nëpër të?... Hoxha i Vogël na tha se Shejnuri ynë do ta bëjë këtë deri sa të hyjë në bylyk. E mira e së mirës, na tha ai, është që të mos e bëjmë punën të madhe... Shtiruni kinse nuk shihni e as nuk dini gjë, ngaqë ai sheh atë që nuk e shohin të tjerët edhe në atë gjendje... Na dha një hajmali dhe na bindi se me kohë do të kthehet në rrugën e të tjerëve... Ne po presim që Shejnuri ynë së shpejti ta ndërpresë jeremin...)

Krye muajit të dytë, i mblodhëm çaklat dhe shkuam te Kajmekami. I thamë se matjet tona kishin marrë fund. Ia bëmë me dije se në Kryeshehër ktheheshim të kënaqur me hulumtimet, por edhe me ndihmën e dhënë. Mësuam shumë gjëra, i thamë, dhe po e lypi puna vijmë prapë. I keni dyert e hapura, na tha dhe i erdhi mirë që ishim komisioni i parë i rangut të tillë që kishte punuar pa i sjellë kurrfarë telashesh as atij e as shehrit. -Ata që dinë gjuhën e ujërave, patjetër se njerëzve ua njohin shpirtin si duhet, na tha kur po na përcillte...

P ë r f u n d i m

Unë, Idriz Allajbeu, hetues i lartë i Zyrës Sekrete Perandorake, pas qëndrimit disa javësh në Shehrin e "Tokës së Lashtë", deklaroj me sa vijon:

Është e vërtetë se atje është e pranishme shfaqja e gjendjeve midis të dukshmes dhe të padukshmes, si një mashtrim magjik, tepër perfid, që mund dhe duhet të zhvlerësohet me ndonjë aktrimi publik me anën e palaçove tanë, në mënyrë që e gjitha të paraqitet si një "marifet i djallit", i mundshëm aty ku mungon besimi i plotë te Libri ynë i shenjtë. Megjithatë, nga aspekti i strategjisë perandorake, e gjitha duhet të trajtohet si pjesë e kryeneçësisë kundër vullnetit perandorak.

Këtë gjendje e hetuam te këta persona:

a) Shahe Krraba dhe

b) Nurie Futa.

Se këto dy plaka, që kanë kaluar të njëqindtat, bëhen herë pas herë të padukshme, këtë e di që moti i gjithë shehri. Nga ato që sheshuam, mund të thuhet se te plakat pasqyrohet dyshësia shpirtërore, si një gjendje që tregon se midis jetës dhe vdekjes përherë ndodhet një hapësirë e cila përkujton lidhjen e tyre të pashmangshme dhe të pandashme, ku përjashtohet kufiri midis jetës së përkohshme dhe mashtrimtare dhe asaj të përshtatshme, të njëmendes, si amshim...

Rreth kësaj dukurie dëgjuam edhe këto mendime:

-E jetshmja, është njëherësh edhe e vdekshme...

-E vdekshmja, është njëherësh edhe e jetshme...

-Këto gjendje janë përherë të papërcaktuar, por që përjashtohet amshimi...

Njeri na i tha edhe këto:

- Plakat pasqyrojnë ngatërresën midis të jetshmes dhe të të vdekshmes... Andaj, herë duken e herë nuk duken, siç ngjet midis jetës dhe vdekjes...

Përkundër këtyre vlerësimeve, që duken s'i ha mendja e shëndoshë dhe mund të zhvlerësohen si marrëzira, megjithatë Lartmadhëri, kujtoj se fjala është për shenjat e kundërshtimit të botës sonë si dhe anashkalimit të tyre pa marrë parasysh praninë tonë aty...

Unë, që me aq zell ç'prej vitesh hulumtoj vetëdijen shekullore të „Tokës së Lashtë“ dhe shpirtin e gjithë asaj pjese që lidh kufirin e dikurshëm (e fatkeqësisht edhe të tanishëm) të botës së re dhe asaj të së vjetrës (e cila patjetër se do të tresë para madhështisë sonë), dhe i di se çfarë janë përmasat e kundërvënies, veçmas asaj së fshehur, kujtoj se atje, edhe kështu dhe në këtë mënyrë, vazhdon kryeneçësia kundër nesh dhe misionit tonë që na pret në atë pjesë të botës..

Ndonëse ato që thuhet rreth asaj si një plakë e rrakatur flet me të vdekur dhe herë shihet e herë nuk shihet dikujt mund t'i duken gjëra mashtrimitare, që shfaqen ashtu në saje të ndonjë magjie, që në këto anë ka mbështetje të fortë, megjithatë e imja është, që sipas urdhrit Tuaj, të bëj që gjithë çështjes me kohë t'i hiqet mjegullimi dhe t'i kthehet qartësimi, në mënyrë që të kuptohet e vërteta, e cila nuk ka si të shpjegohet ndryshe pos si shenjë e vazhdimi të asaj herezie, e cila ç'prej njëqind e më shumë vitesh, mbahet nën rrogë, por gjithnjë e gatshme të veprojë drejt zhvlefësimit të mësimave tona të shenjta, që lidhen me besimin e patundur se bota e amshueshme, është ajo që fitohet me anën e sprovës së xhenetit dhe të xhehenemi si pjesë e jetës së përshtatshme dhe të amshueshme... Të provosh të thuash se jashtë kësaj sprove gjendet një hapësirë tjetër që përcakton jetën dhe vdekjen, si të ndërlidhura dhe të përsëritshme, e ku lejohet mundësia e të kuptuarit të tyre në përputhje me shkrimin e meditimeve të ndryshme, që nuk kanë fund e as kufi, gjithsesi është fjala për herezi, që lidhet me besimin e moçëm, por që e gjitha lidhet me vazhdimin e kryeneçësisë kundër botës perandorake dhe madhështisë së saj, veçmas kundër mësimave të Librit tonë të Shenjtë... Çastin që pashë plakën Shahe Krraba dhe Nurie Futa si nunë me të vdekurit n'gojë, e pata të qartë se nuk ishte puna e ndonjë magjie e të ngjashme, që ne, megjithatë duhet t'i trajtojmë si të tilla, por ishin shenjat e para që qojnë kah shprehja demonstrative e herezisë së tyre, e cila jo vetëm që bie ndesh me mësimet tona të shenjta, por ka për qëllim të rikthejë gjendjen e njohur të asnjësisë dhe të l a r a m a n i s ë shpirtërore, që nuk përcaktohet nga mësimet e Dijeve të Vjetra, që edhe më tutje mbajnë peng kokat e tyre me çka të tjerat përjashtohen...

Kjo, pra është një kryeneçësi, që ndonëse në parë duket si një mashtrim me anën e magjisë, të cilën duhet ta luftojmë duke e shpallë të tillë, në të vërtetë është një sublimim i bindjes së kamotshme të bashkëjetesës së të dy gjendjeve (jetës dhe vdekjes) brenda për brenda të njëjtit rreth, pra të përzieria, që fuqia e të ligës ua përcakton raportin e njëmendatë... Se herezia është pjesë e të menduarit të tyre, po sjell disa shembuj, që kanë të bëjë me vlerësimin e jetës dhe vdekjes jashtë kornizave të mësimave të shenjta:

-Jeta dhe vdekja ecin në të njëjtin kalë...

-Shpirti shkon e shpirti kthehet...

-Trupi në varr e shpirti jashtë...

-Ecën si kufomë e gjallë...

-Rri si i vdekur...

-Sa shihet,sa nuk shihet...

-Sa është,sa nuk është...

Këtyre mund t'u shtohen edhe betë dhe përbetimet:

-Pasha tokë e qiell!
-Pasha njëmijë e një yje!.
-Pasha gur e dru...etj...

Mund të sillen edhe shumë e shumë shembujt të tjerë, ku në formë të pjesëzave dhe mënyrë të tjera shprehet besimi i vjetër (apo a n t i b e s i m i), nga Dijet e Vjetra, me të cilin kundërshtohen mësimet e shenjta e me këtë edhe Perandoria. Dhe, ç'është më keq, sot e gjithë ditën në atë vend, edhe pas njëqind e sa vjetësh të depërtimit të besimit tonë, nuk heqin dorë nga këto ngatërtime, gjë që len për të kuptuar se në atë botë ata shkojnë të papërcaktuar dhe truq, ku nuk vlejnë gjykimet e Allahut për vendin që duhet ta ketë secili sipas sjelljes (në xhenet apo xhehenem), por bindjet e ideve me të cilat thadrohet njeriu, ku sipas tyre, ndryshimi, si parim kryesor ndër dhjetë sosh, është i përhershëm, gjë që nuk është e rastit që pasqyrohet me atë të dukjes dhe mosdukjes, e para si kundërshtim, dhe e dyta si mashtrim... Mjafton për këtë të zihet n'gojë e dhëna kur Nurie Futa bisedon njësoj me të vdekurit që kanë emra të besimit tanë dhe me ata që ruajnë emra të besimit të tyre. Andaj, bindjet se jeta ngatërrohet me vdekjen (...ecin në të njëjtin kalë), se vdekja mund të jetë e pjesshme (...vdiq pak apo shumë), se nuk ekziston xheneti dhe xhehenemi si shpërblim dhe si dënim i merituar, por përsëritja e së njëjtës, pra e të ligës (...gjithçka paguhet në këtë botë), bashkë me çoroditje të tjera, tregojnë fare qartë se në këtë shehër po vazhdon të shfaqet rirreshtimi i tyre shpirtëror kundër vetëdijes sonë, që nuk është tjetër pos pjesë e asaj lufte që Perëndimi dëshiron ta bëjë kundër Lindjes...

Meqë sheshimet e mëtutjeshme rreth kësaj çështje bashkë me masat që duhet ndërmarrë Ju takojnë Juve, më mbetet që të pres urdhrat tjera për të filluar betejën kundër herezisë që është shfaqur në „Tokën e Lashtë“, që mund të përballohet vetëm me detyrimin me të gjitha mjetet, pa marrë parasysh çfare, që libri ynë i shenjtë dhe mësimet e tij të jetë themel i të gjithave dhe assesi besimet e lira... Kjo shfaqet si parakusht që Perandoria të ecën drejt triumfit të plotë...

I përuluri Juaj,
Idriz Allajbeu,
nëpunës i lartë i shërbimeve sekrete të Perandorisë.

Atë natë nuk futi gjumë në sy. E mbërtheu një ankth i rëndë që nuk iu hoq gjatë, kështu që herë djersitej, herë mërdhinte, e herë ngushtohej aq shumë sa i vinte t'ia hiqte vetës me bindjen se këtu lirohej përfundimisht nga lëmshi në të cilin ishte ngatërruar keq. Në atë gjendje hetoi se edhe ato vija të megjulluara të vendlindjes i kishin tretur dhe se me kot u mundua të rikujtonte imazhin e asaj që megjithatë i kishte mbetur. Në vend të vendlindjes, i shfaqej një si shkretëtirë e pafund, e mbërthyer me re të zeza përmbi, ku fjalët e Idriz Allajbejt (për të cilin ishte i bindur se i kishte shkuar koka bashkë me të tjerët, sapo raporti i tij kishte arritur Lartmadhërinë), ishin kthyer në thika, të cilat po i drejtoheshin nga të gjitha anët dhe sikur ia kërkonin kokën bashkë me ato të farefisit, që nuk e kishte njohur ndonjëherë... Mos ishte ky ndonjë kurth ndjellazi, po i thoshte vetes gjithnjë duke u munduar t'u ikte atyre fjalëve-thika, që shpërndareshin në atë shkretëtirë e zezë, që nuk ishte tjetër pos vendlindja... Pak më vonë iu bë se dikujt po i ankohej rreth asaj si ishte e mundur që një vend të shpallej heretik në bazë të asaj që merrej si pjesë e magjisë së zezë?... Psehu po i ngjizej sa dikur ato që thoshte nuk kishin kuptim tjetër pos që i ngjasonin një fërkimi të vrazhdët që po ia megjullonte kokën bashkë me ato që i silleshin shkëputshëm në të...

Edhe të nesërmen nuk fjeti. E gjumë nuk futi as shumë net të tjera. Nuk e ngushëlloi as mendimi se Lartmadhëria kishte të drejtë të bënte hulumtime të tilla dhe të jepte urdhra çfarë të dëshironte. Madje, në atë gjendje, qetësi nuk i solli as pandehma se duhej të pajtohej pikë për pikë me fjalët e hetuesit të shkretë, e qetësi nuk gjeti as kur nuk e diti pse vetes ia pranoi njëfarë ndjenje të fajësisë, ndonëse nuk e kishte të qartë se pse duhej ta merrte për të tillë ... Nga ai ngatërrim nuk u lirua as atëherë kur u pajtua me Lartmadhërinë, që për hir të interesit të Perandorisë, të merreshin sa më shpejt të gjitha masat e duhura që së keqes (që edhe më tutje i mbetej e papërcaktuar) menjëherë t'i mbyllej rruga... Hetoi se edhe si fajtor, edhe si i poshtëruar, edhe si urrejtës e edhe si asnjans, nuk lirohej nga gjendja e rëndë... Mbase ishte në prag që gjithë këtë siklet ta hiqte me anën e dorëheqjes nga posti i Kryevezirit, që do t'ia paraqiste Lartmadhërisë gjatë takimit të parë, po të mos ishin fjalët e tij të buta dhe në dukje tepër miqësore, të cilat ia tha rreth asaj se nuk kishte pse të shqetësohej nga magjia e zezë, meqë edhe asaj i gjendej ilaçi, me anën e luftës për Librin e Shenjtë.

“Magjia e zezë, nuk është sëmundje, por mashtrim. Megjithatë, atë duhet ta marrim si sëmundje dhe ta trajtojmë si sëmundje në mënyrë që ta mundimi... Sepse, po qe se nuk shërohet një pjesë e trupit, atëherë e përfshinë të tërin...”

Kur ia tha këto, fare miqësisht, Lartmadhëria ia ofroi gotën e çajit dhe nisi t'i fliste për disa gjëra që ia kishte treguar Shpjeguesi i ëndrrave lidhur me ca telashe që mund të shfaqeshin në disa krahina të lindjes, ku atij i binte barra që t'i zgjidhte...

“Sëmundjet, sado të lehta duken, po nuk u shëruan, rrënojnë trupin...”

Ato që po i dëgjonte, në kokë po i hynin të shkëputura, fare të shkëputura dhe si pjesëza pa ndonjë domethënie... Vetëm kur e zbrazti gotën e dytë iu bë se gjërat nga pak po i qartësoheshin dhe ato që po dëgjonte ishin fjalë të buta, pajtuese...

Kur piu çajin e tretë dhe ndjeu shtrëngimin e zakonshëm në lukth, (që i vinte nga ulçera), u kthjellua i tëri. Në atë çast Lartmadhëria i lëshoi para tri pliko ngjyrë hiri, të lidhura me dyll. Nuk e pati të qartë pse dylli në pliko, me vulën e madhe të Perandorisë, (që e njihte aq mirë dhe sa herë e shihte e mbërthente me ndjenjën e njëfarë madhështie), ia mori sytë dhe i solli të dridhura të frikshme...

„Plikot do t'i marrësh me vete sapo të niseshe“, - i tha ai. “Do t'i hapesh një nga një kur t'u vijë koha. Kështu, të parën do ta hapesh ditën që do t'i afroresh Tokës së Lashtë. Lexoje me vëmendje dhe vepro pikë për pikë sipas urdhrave që do t'i gjeshe aty. Kur të përmbushësh pikat e të parës, digje dhe hape plikon e dytë. Ato që do t'i lexosh janë vetëm për ty... Misioni përfundon kur ta kallësh edhe plikon e tretë. Kaq“.

Të tjerat sikur nuk i dëgjoi. Sytë i qenë ndalur të plikot dhe mendja i qe ngrirë. Plikot me dyllin e verdhë dhe me vulën perandorake në mes, herë i rriteshin e i rriteshin e i bëheshin sa bjeshka, e herë i zvogëloheshin e i zvogëloheshin sa i ktheheshin në thnegla... Iu bë se sakaq zunë të dridheshin, se shungullonin, se vegullonin... Gjithë shqetësimi ato iu shfaqen edhe kur u largua nga Pallati i praruar dhe të tilla iu duken edhe kur hyri në Pallatin blu, e edhe kur hyri në dhomën e madhe dhe u mbyll në të... Shqetësimin po ia shprehnin edhe nën jastëkun e butë, ku ai gjithë natën nuk i mbylli sytë. I bëhej se nën jastëk plikot po e kërcënonin sa dikur zunë t'ia bartnin edhe kokën kah një lartësi për ta parë e gjithë bota... Dhe bota habitej si fluturonte koka pa trup. I dukej se në atë fluturim e sipër poshtë e tallnin, se bënin me gisht nga ai dhe qeshnin i madh e i vogël... Të qeshurat nuk kishin fund dhe ai kërkonte që të ikte larg e më larg, ku nuk do ta shihnin, e prej nga pastaj nuk do t'i dëgjonte ato të qeshura... Sesi dëshiroi të ishte i padukshëm dhe kjo dëshirë iu sforcua edhe më shumë nga një si mendim i fshehur diku në brendi që po i thoshte se ishte ndërrimi i gjendjes, nga e dukshmja kah e padukshmja, që shpëton nga nënçmimi...

Ky mendim sikur e trishtoi sa brofi në këmbë trembshëm. Më ndje, Allah, tha, më ndje! M'i largo mendimet plangëprishëse... Ma largo ndjenjën heretike që të mashtron pa dashas, sepse loja me pamjet është pjellë e djallit... Më ndje dhe hiqmi mendimet e liga, që po më ndjekin pandalshëm!...

Por, mendimet e liga,që e kishin mbërthye, nuk po i hiqeshin. I bëhej se qe ngatërruar si shumë me to dhe kush e di se çfarë mundi i duhej për t'u liruar prej tyre. I dëshpëruar si asnjëherë, thirri klarinetistin plak dhe i tha t'ia merrte një melodie nga ato që rëndom ia qetësonin shpirtin. Tingujt e klarinetës shpejt mbushi dhomën me ngrohtësi, por ati nuk po i hiqej që nuk po i hiqej sikleti. Bjeri!... Bjeri!... Zuri të çirrej, ndërkohë që plaku i shkretë frynte me sa fuqi deri sa po i sosej fryma. Kur iu bë se melodia e klarinetit, e vetmuar po i vinte si gjëmë, urdhëroi t'i sillnin edhe qemanen. Por edhe ajo iu duk pak. Thirri gjithë çallgaxhinjtë që e përcillnin, dhe së fundit, në atë kohë të natës, kërkoi valltarët, sa Pallati blu u mbërthye i tëri nga njëfarë shungullime që nuk ishte dëgjuar ndonjëherë edhe pese atij i dukej se gjithë ato çallgi dhe valle ishin hiçgjë, ngaqë nuk ishin në gjendje t'ia hiqnin boshllëkun që iu kishte lidhë mulla... Një çast iu bë se valltaret gjysmë të zhveshura me vello të bardha në kokë, po i shfaqeshin herë të dukshme e herë të padukshme dhe se krypsitena e bardhë i kthehej në një tis mjegulle ku ato herë pas here treteshin për t'u shfaqur pas pak...Ky ndryshim e tmerroi. Me sa zë kishte urdhëroi ta linin vetëm...

Kur mbeti vetëm dhe kokës së tij edhe më tutje po i vërtiteshin pjesët e zhurmës së pakmëparshme, i bëhej se edhe symbyllur, herë shihte dhe herë nuk shihte... Mos më ka zënë magjia e zezë, pëshpëriti duke e zënë kokën me duar, me dëshirën që nga ajo të hiqte çfarëdo të lige që i ishte qepur pa dijeninë e tij... Më ndihmo, Allah, më ndihmo të lirohem nga magjia e zezë dhe sherri i saj, tha dhe u shemb në sexhadën e purpurt...

Ashtu i shtrirë fliste dhe lutej thuajse përçartë... Nga gjendja as në tokë dhe as në qiell, sikur u lirua, kur hyrë roja dhe i tha se po e kërkonte Lartmadhëria...

Rruga deri tek Pallati i praruar iu duk e mundimshme. Që ta përballonte sa më parë sprovën e atij sikleti nuk i ndihmoi as fresku i natës së pa hënë e as kundërmimi i jorgovanëve që e donte aq shumë. Edhe jashtë koka po i shungullonte dhe sa vinte e i shtoej. Tek shatërvani i beharit lagu ballin dhe qafën dhe mbase do ta fuste kokën në ujë po të mos kishte truprojat pas. Për herë të parë i erdhi keq që nuk mund të qante, të shante, të shfrynte e të shfrynte sipas dëshirës. I erdh keq që mbikëqyrej e mbikëqyrej nga të gjitha anët dhe duhej të bënte jetën e huaj. Me atë mendim të ngrirë gjithë dëshpërim e shikoi Pallatin e praruar dhe iu bë se ai po i largohej e po i largohej sa një çast iu duk se nuk ishte aty, ndërkohë që në vend të tij befasisht flakëronte një dritë verbuese, që ndërronte përmasat në përputhje me kundrimin. Një copë herë ndoqi përpëlajtjen e asaj drite dhe kur po bëhej gati të pranonte pushtetin e një përftimi si pjesë të çrregullimi, që i ishte qepur, po ashtu habitshëm hetoi se si Pallati po i rikthehej, tash edhe më i madh e edhe më i frikshëm... Ky farë ndryshimi serish i futi të dridhura, ngaqë ia përkujtoi mundësinë e shfaqjes së gjendjes së dukjes dhe mos dukjes edhe tek gjësendet, njësoj siç ndodhte me atë magjinë e zezë, që e kishte shqetësuar gjithë Perandorinë. Që të mos i nënshtrohej atij mashtrimit të magjisë së zezë, mbylli sytë dhe thuajse jashtë vetes ndoqi shtrirjen e qilimit perandorak, i cili kalonte nëpër shkalloret e para dhe të dyta dhe përshkonte gjithë Sarajin e artë, për të sosur para Fronit të praruar,ku rrinte vetëm Lartmadhëria... Nga ajo gjendje shurdhe megjithatë e nxorën fjalët rreth njëfarë festeje të madhe dhe uratës që duhej ta merrte para se të nisej për fushatën e shenjtë, që po i vinin nga të gjitha anët...

Këto fjalë sikur ia hoqën gjithë terrimin në të cilin ishte futur gjatë kohës sa përshkoi Sarajin me të cilin paksa ishte mbrojtur. Froni i praruar dhe shkëlqimi që iu hap e kthyen tek gjendja që i frikësohej më së shumti, pra tek fillimi i fushatës kundër vatanit...

„Së shpejti do të agojë dita më e rëndësishme, jo vetëm për ty, por për gjithë Perandorinë...”

Me këto fjalë Lartmadhëria i dëshironte fat, që atij po i vinin si mallkim...

Deshi t'ia merrte temenanë dhe ashtu të pranonte atë që e merrte për ndëshkim, por nuk pati si, ngase dorën e djathtë e kishte të zënë me plikot që i shtrëngonte me sa forcë kishte. Lartmadhëria fliste e fliste, ndërsa ai sharronte dhe sharronte në një mjegullim të

dendur ku i bëhej se herë pas here dallonte disa lule të zeza fare të gërmuqura si hapeshin e mbylleshin sikur të ishin pjesë e magjisë së zezë...

Nga ai trishtim e nxorën rrezet e diellit pranveror, të cilat së pari prekën mermerin dhe shtyllat e praruar me ar, e prej andej, të kthyer, iu përplasen furishëm, sa i dogjën sytë dhe kjo bëri që aty për aty t'i kthehej mizërisë së Pallatit, ku tashmë vendin e shungullimave të deriatëhershme ia zuri njëfarë qetësi e flashkët, e cila i dukej se befasisht kishte mbërthyer jo vetëm Pallatin e praruar, por gjithçka tjetër përreth, e madje tërë Perandorinë.

Në atë gjendje tejet të thyer e priti edhe ceremonialin e madh të përcjelljes. I ulur në anën e djathtë të Lartmadhërisë, para pa vezirët që i rrinin në pjesën balllore dhe e shikonin si të kërkonin nga ai diçka të fshehtë. Iu bë se edhe ushtarakët e shumtë, kadiasqerët, kaditë, ulemaja e edhe myderrizët me të tjerët kërkonin nga ai po atë që nuk e dinte se çka ishte... Anash pa flamujt e luftës dhe stemat e sanxhaqeve dhe të vilajeteve të panumërta të Perandorisë, që shumë prej tyre nuk i njohte fare. Hajmalitë dhe eshtrat në to bashkë me rruazat e qelibarit ia morën sytë sa iu shfaq një marramendje, ku flamujt dhe stemat e panumërta tek ngatërroheshin ia krijon një pështjellim në të cilin kafshët e egërsuara, që deri më atëherë gjendeshin nëpër stema dhe emblema, ishin liruar dhe mbase prej tij prisnin një shenjë për të gëlltitur botën... Ishte i bindur se ato, edhe pa urdhrin e tij, do t'i sulen botës e së fundit edhe Pallatit të praruar... Bishat tashmë janë liruar, po i thoshte një zë tjetër, për të cilin nuk ishte i sigurt se i vinte nga frika e vet, apo nga jashtë?... Uturima e kërcënimeve iu bë e tillë sa ishte i bindur se kafshët e çartura po i këputnin vargoit, se po i bënin copë-copë parzmoret që i mbërthenin për emblema, se ato tashmë i ishin lëshuar pas dhe po e ndiqnin pamëshirshëm... Nga frika që kishte nga kafshimi i tyre tmerrues, sikur të ishte pjesë e magjisë së zezë, po zvogëlohej e po zvogëlohej sa u kthye në një thnegël dhe dikur u bë fare i padukshëm...

Si fëmijë i kishte rënë të dëgjonte se thneglat e urta dhe punëtore nuk bëjnë tjetër pos që kohën e kalojnë në lëvizje marramendëse, që mund të quhet si jetikja... Më vonë kishte menduar se jetikja nuk ishte tjetër pos përpjekje për t'u liruar nga ndjenja e frikës, që u ishin nënshtruar qeniet më të vogla dhe më të pafuqishme që i njohte. Për të provuar se si jetikja paraqiste njëfarë fati për të vegjlit dhe të pafuqishmit, nga e cila nuk ndaheshin edhe po të kishin mundësi, në një çarçaf të bardhë e lëshoi një thnegël, ku ajo pareshtur sillej nga këndi në kënd, por assesi ta kalonte atë hapësirë të ftohtë dhe të thatë, e cila në të vërtetë për të paraqiste kufirin të lejueshmes. Disa herë bëri t'i ndihmonte thneglës të gjente rrugën e lirit nga hapësira e kufizuar në të cilën ndodhej, por ajo sapo i afrohej cepit, serish kthehej në të kundërtën dhe shkonte deri tek cepi tjetër për t'u kthyer ku ishte... I tillë iu duk vetja atë çast midis mizërisë së flamujve të panumërt dhe stemave të shumta që i shoqëronin ata... Ndodhja në atë katrahurë dhe kundrimi i pafuqishëm i gjithë asaj që ngjiste pa qenë në gjendje të bënte as lëvizjen më të vogël paraqiste vetëm një çarçaf të pafund, si kufizim, prej nga nuk do të mund të largohej kurrë... Në atë përpëlajtje nënçmuese mbase mund të ngushëllohej me pandehmën se megjithatë jetikja do të përfundonte aty ku kishte filluar, pra në vendlindje, por kjo e dëshpëroi edhe më tepër, ngaqë e gjitha duhej të ndodhte në kushtet e një fushate të jashtëzakonshme, që ai nuk ia dinte përmasat, edhe pse i printe asaj nga shkaku se ato që do të ndodhnin që më parë ishin të përcaktuara në plikot që i mbante... Kjo edhe një herë ia përkujtoi çarçafin dhe sjelljet pafund të jetikjes, të cilat i dukeshin si një jetënënçmim, që do ta barte përgjithmonë si mallkim... Me atë ndjenjë shikimi po ia kapërthente ata që kishte përballë dhe që gjithë nga ushtarakët e lartë, kadiasqerët dhe shërbimet tjera që e përcillnin po i shfaqeshin si pjesë e morisë së thneglave, që i nënshtroheshin urdhrave dhe jetëpërkuljes së përhershme... Ky mendim e turbulloi aq sa gati volli. O perëndi, pëshpëriti, dëshpërueshëm, pse qenka e thënë të kem fatin e thneglës, të cilës, nuk i ndihmon as magjia e zezë?...

Nga ajo thyerje e thellë e nxori zhurma që bënin ushtarët gjatë parakalimi. Përpara pa njësitë e shumta që ecnin me hap të rëndë dhe përshëndetnin. Me vete kishin flamujt e luftës bashkë me stemat dhe emblemat e shumta. Iu bë se kafshët në to nuk ishin të shqetësuara si

dikur, por të mbërthyera në hapësirat e stemave dhe të emblemave, i dukeshin të lidhura. Një kohë të gjatë ua pa bishtat e ulur dhe shenja e ndryshëm që i bartnin me vete si stoli që nuk u kishin hije... Kah mesdita parakalimi ushtarak u zëvendësua me atë të ulemave, dervishëve, shehlerëve dhe sekteve të ndryshme të viseve lindore të Perandorisë, me ç'rast, shumë prej tyre, lutjen e kthenin në çirrje, ku kërkohej fitore e shpejtë... Vetëm pasi që parakalimit iu qasen fytyrëgërrithësit, vajtuesit e përmoshëm si dhe fanatikët që shfaqeshin me gjilpëra në fytyrë dhe trup, që i futnin sapo i afroreshin tribunës kryesore, ku ndodhej, e pati të qartë se po nisej në një fushatë luftarake të rendit të parë. Çjerrja lemëritëse dhe gërrithjet gjakosëse bëheshin vetëm atëherë kur Perandoria nisej për të ndëshkuar vise të padëgjueshme dhe rebelime të përmasave të gjëra... Perëndi, tha, pse më bëre thnegël?...

Tjetër nuk tha. U ndry në ngrirjen e vet dhe bëri përpjekje që gjerat t'i merrte ashtu siç ishin, pa provuar as t'u shtonte e as t'u hiqte gjë. Bile, çuditërisht, gjakftohtësinë e ruajti edhe kur erdhi çasti të nisej. Uratës së Lartmadhërisë (dalsh faqebardhë!) as që iu përgjigj. Buzët e tij të ftohta mezi prekën dorën që i rrinte përmbi...

I ftohtë mbeti edhe gjatë gjithë pjesës më të madhe të rrugës. I shtrirë në karrocën e kaltër ngushëllohej me heshtjen që i ishte qepur çuditërisht dhe e mbante të shtangur. Në atë tundim mendjeje nuk i ndjente as shalakatje e pafundme të taborëve të shumta që zvarriteshin nëpër rrugën gjarpërore, nuk i dëgjonte as trokëllimat e kalorësisë, e nuk i hetonte as telashtet e njësive të xhenios që u dilnin me topat shumë të rëndë gjatë heqjes. Veshi nuk po ia kapte as dërdëllitjet e grave të haremit, që i shkonin pas me shumë shërbime të tjera, që ishin për t'ia bënë me dije përmasat e gjëra të fushatës bashkë me kohëzgjatjen e saj. Ftohtas i priste edhe raportet e përditshme që ia lexonte veqili, të hartuara në pika të shkurtra nga moria e të dhënave që i vinin nga shërbimet e shumta përcjellëse dhe ato të vëzhgimit, që shkonin para dhe pas karvanëve. Mbase qëndrimi i tij i akullt bëri që atmosfera entuziaste e fushatës, që filloi me ceremonialin madhështor në Kryeshehër, të binte pak nga pak. Bile, ata që i rrinin pranë dhe e shihnin ashtu të ngrysur dhe të nemitur, sado që nuk e thoshin, këtë e merni për shenjë të keqe. Kishin frikë se mos po përsëritej koha e fushatave të pafund, të cilat rëndom nisnin në pranverë, po me të njëjtin ceremonial dhe ndërpriteshin me të filluar shirat e para të vjeshtës me të njëjtat arsye...

Brenga e mbetjes në një rreth të mbyllur, ku do të kishte vetëm fillim pa fund, sado pa dashas, sikur e gjeti edhe Kryezëzrin dhe ajo po i shtoej sa më shumë që i afroreshin vendlindjes. Përballë kësaj frikë mbllaçiti mendimin për thneglat kishin të njëjtin fat dhe kjo e frikësoi aq shumë sa u ngrit me të shpejt dhe hodhi para plikot që mbante nën jastëk. Një copë herë i shikoi sikur të kërkonte prej tyre diçka që do t'ia hiqte frikën. Por, ato i sollën ftohtësi edhe më të madhe, që e përshkoi në të gjitha anët me të dridhura dhe rrëqethma. Numrat në to (një, dy, tre) po i ktheheshin në thika dhe ato numra-thika po e pritnin ta sulmonin diku dhe dikur që t'ia mernin kokën... Ishte e bindur se pas kokës së tij, thikat-numra kokat do t'ua mernin edhe ushtarakëve, e kokat do z'u shkonin edhe atyre të shërbimeve përcjellëse dhe të gjithëve, pa kursyer edhe gratë e haremit... Kjo e trishtoi dhe ia mori qetësinë për aq sa koka po i shungullonte nga mendime të cilave u frikësohej aq shumë, që kishin të bënin me ato rreth atyre që ndodheshin në plikot e mbyllura, të cilave me mjaft mund u kishte bërë bisht gjatë pjesës më të madhe të rrugës, ndonëse e dinte se një ditë do të ballafaqohej me to, deshi apo nuk deshi... Por, tashmë e kishte të qartë se në ato pliko kishte vetëm urdhra të shkruara, të prera, që ia përcaktonin veprimet dhe të menduarit, që duhej t'u përmbahej deri në fund, pa shfaqur as më të voglën mëdyshje... A nuk ia bënte me dije këtë edhe radhitja e tyre prej një deri në tre?... Se ishin urdhra lufte, këtë e kishte të qartë edhe për atë se me vete kishte tabore të panumërta të ushtrisë e me vete kishte edhe topat më të mëdhenj që ishin parë deri më atëherë. Por, nuk e kishte të qartë çfarë i duheshin një fushate të tillë hetuesit e shumtë, kadiasqerët, kadi të dhe hulumtuesi e ndryshëm? Mendja ia thoshte se po të qe puna e shtruarjes së një shehri, do të mjaftonte një grusht ushtarësh dhe këtë do ta bënin edhe ata që gjenden atje, pa pasur nevojë t'u vinin në ndihmë njësitë më të mira të

Perandorisë. Po të qe puna për dy-tri plaka, që herë duken e herë nuk duken, për të cilat u tha se ishin pjesë e magjisë së zezë, që duhej zhvlerësuar me ndonjë cirk palaçosh, atëherë çfarë kërkonte ushtria atje?... Ishin ato, përnjëmend, ndonjë kërcënim i padukshëm që me to duhej të merrej e gjithë Perandoria?... Me sa i kishte rënë të kuptonte nga ato që i shkruante Allajbeu, plakat merreshin me të vdekurit dhe nuk paraqitnin kurrfarë rreziku për të gjallët e aq më pak për mirëvajtjen e sigurisë publike. Ç' duhej, pra, ajo hata ushtrie?... Këtu mendja sikur iu ngri dhe koka nuk i merrte dhe as nuk jepte gjë... E vetmja, që i sillej nëpër të, ishte njëfarë gjysmë mendimi i shkëputur rreth njëfarë *gjykim-dënimi*, që nuk kishte si t'i ikej, ngaqë fuqia e tij kishte frikësuar edhe Lartmadhërinë?...

Gjyqi, tashmë, ka ndodhur dhe pritet *dënimi*... Tiktaku i kohës ka filluar, tha me ndjenjën e njëfarë turbullimi të ngatërruat me trimërim. Allajbeu duhej ta shpikte magjinë e zezë si shkas për hakmarrje?...

Me tiktakun e kohës në kokë, sikur sillej në një labirint të pafund bashkë me ata që i shkonin pas dhe se aty vërtitej e vërtitej, herë andej e herë këndeje, ndërkohë që plikot ia mbyllnin shtigjet. Ato nuk ishin tri, por shumë, shumë, tridhjetë e tri, treqind e tridhjetë e tri, tremijë e treqind e tridhjetë e tri, pra shumë e shumë treshe me zero të pafund, që ia krijonin ndjenjën e përfshirjes në lojën e magjia e zezë, si pjesë e *gjykim-dënimit*, të atij ndëshkimi, që duhej të dukej si një cirk i përmasave të jashtëzakonshme, ku koka e tij, si e prerë, do të përfundonte në një kënetë me gjarpinj... Kjo, sikur i krijoi trishtim dhe neveri njëherësh saqë deshi të oshtinte, dhe mbase këtë do bënte, po mos të shfaqej Kadiusqeri që po priste t'i thoshte diçka.

Tashmë e kishte të qartë se ai do t'ia thoshte lajmin për arritjen, me çka ai futej në kohën e urdhrave, ku *gjykim-dënimi*, do të përcillej me lojën e fushatës ndër më të mëdhatë e kohës...

Nga mbërthimi i të menduarit për kohën e urdhrave dhe përkatësinë atyre në atë labirintin e *gjykim-dënimit* si ndëshkim, sikur për pak u liruar kur hetoi se si terri kishte pushtuar fushën e gjerë në thellësinë e së cilës ndodhej shehri i vendlindjes. Për t'i ikur përfytyrimit shqetësues, që pashmangshëm do t'i lidhej me atë që tashmë e kishte pushtuar nata, ktheu kokën andej kah e dinte se fare pranë tij shtriheshin tendat e panumërta, ku ushtria i ishte dhënë çlodhjes. Në atë heshtje me mendja prapë i shkoi të plikot. Erdhi koha e tyre, pëshpëriti. Koha e urdhrave, koha e *dënim-ndëshkimit*?...

Me përtesë u kthye në tendë, ku sytë i zunë plikot. Deshi t'i shihte pa peshën që kishin pasur deri pak më parë. Por, dylli i verdhë në mes dhe vula e madhe e Perandorisë, ia bënin me dije se fjala ishte për gjëra tepër të rëndësishme... Në atë gjendje, dëshironte që ato edhe më tutje t'i merrte të zhveshura nga rëndësia e porosive që bartnin. Por, nuk vonoi e ato, sikur t'i nënshtroheshin fuqisë së magjisë së zezë, prapë po i ktheheshin në thika. Ajo me numrin një tashmë po i kërcënohej. Nga zemërimi, sikur të ishte mjeshtër i magjisë, hapi plikon e parë dhe e shqeu. Ndjeu plasaritjen e dyllit dhe shkëputjen e fjongos që lëshuan një krismë të thatë...

Përpara pa një letër të bardhë bashkë me një pliko tjetër, fare të vogël në të, në të cilën shkruhej:

„T'i dorëzohet Kryehetuesit sapo të lexohet letra bazë.“

O zot, ç'poshtërim, tha dhe u shemb sikur të ishte në çarçafin e bardhë, i kthyer në një thnegël, që zvarritej frikshëm nëpër atë hapësirë, pa më të voglën dëshirë të lirohej prej saj. Ajo ndjenjë sikur e ia bëri me dije gjendjen në të cilën ndodhej dhe pak nga pak u këndell, ndonëse trupit të shkallmuar me shumë vështirësi i kthehej forca e duhur për ta mbajtur drejtpeshimin. Dhe kur bëri të ngrihej, prapë i doli letra e vogël para me porosinë për Kryehetuesin. Ishte e thjeshtë dhe po mos të ishte shkrimi i Lartmadhërisë në të, as që do ta vërente. Megjithatë, tashmë ishte i bindur se në atë letër të vogël ndodheshin porosi të ndryshme, që kishin për qëllim fatin e tij (ndëshkim-dënimin) ta kthenin në pjesë të triumfit perandorak...

Sidoqoftë, edhe përkundër fundit që tashmë e kishte të qartë, mendja po ia bluante ato që nuk duhej t'i dinte, ndërkohë që i besoheshin një tjetri, atij që e kishte nën urdhra, të cilave duhej t'u nënshtrohej?...

Një copë herë e mundi kjo dhe sa më shumë që e vriste mendjen, çështjet i mjegulloheshin. Një çast, mbase sa për t'u ngushëlluar, mendoi se mund të ishte ndonjë porosi që nuk çonte peshë, me të cilën nuk duhej të lodhej, ngase kishte punë shumë të mëdha. Ishte gati të pajtohej me atë mendim, por kjo nuk e qetësoi ngaqë ajo porosi gjendej në atë pliko dhe kushtëzohej me urdhrin se ajo duhej t'i dorëzohej Kryehetuesit sapo të lexohet letra bazë.

Ç'lidhje mund të kishte ajo letër me letrën bazë dhe pse e gjitha kushtëzohej në atë mënyrë?... Mendja ia tha se fjala ishte për një pjesë të lojës së magjisë së zezë, që i duhej fundit të tij, që e gjitha të dukej se po zhvillohej një betejë për mbrojtjen e Perandorisë?...

Nga ky mendim u drodh dhe hetoi se po i dridhej edhe letra, që mezi e mbante në dorë dhe druante se po vazhdoi ashtu ajo do t'i shpëtonte pa e lexuar fare. Për t'i ikur asaj të papriture, e shtrëngoi me sa forcë dhe e hapi sikur të dëshironte të lirohej nga fuqia e magjisë së zezë që po ia zinte frymën. Nga lëvizja e shpejtë pa fjalën „Urdhëresë“, të shkruar me shkronja të mëdha, të cilat iu duk se ishin gjithë shqetësim. Por, pas pak ato sikur u qetësuan dhe ai lexoi:

1. Ushtria të ndalet një orë larg Shehrit.
2. Ushtria të çlodhet katër ditë.
3. Pas iqindisë së ditës së pestë të shpallet sh t e r r e t h i m i.
4. Po atë ditë fillon shpallja e Shehrit.
5. Në mbrëmje të thirren këta persona: Komandanti i operativës ushtarake - kryenihinieri Harun Oglu, Kadiasqeri - Milaim Agai, Serasqeri - Hamdi Beu, Shpjeguesi i ëndrrave, kronisti dhe përgjegjësja e haremit, Hyrije Hanmi.
6. Secili prej tyre ngarkohen me detyra të veçanta në rrethanat e gjendjes së shtetrrrethimit. Për këtë kanë tridhjetë ditë afat. Pas tridhjetë ditësh në të njëjtën kohë, secili duhet të raportojë rreth kryerjes së detyrave të marra që dalin nga Fermani. Nëse punët ngecin, shtetrrrethimi zgjatet edhe për tridhjetë ditë. E nëse ngjet që edhe pas tridhjetë ditëshit të dytë diçka të çalojë, atëherë shpallet shtetrrrethimi i pakufishëm, përderisa të vijë fermani tjetër që zhvleftëson këtë masë.
7. Plikoja e dytë të hapet pas tridhjetë ditësh, pas gjashtë dhjetë ditësh, apo vetëm atëherë kur të përmbushen të gjitha detyrat nga plikoja e parë. Kështu duhet të veprohet edhe me plikon e tretë.
8. Plikoja të kallet sapo të hapet dhe
9. Plikoja e vogël t'i jepet Kryehetuesit sapo të lexohet Urdhëresa.

Në fund pa nënshkrimin e Lartmadhërisë që e njihte aq mirë. Por tash ai nënshkrim iu duk tepër i ngatërruar, si merimangë që end rrjetën në të gjitha anët dhe vë prita për prenë e vet... A nuk ishte i kurthuar edhe ai në të?... Kjo ndjenjë e ligështoi deri aty sa të shpërthente në një vaj, prej nga nuk do të lirohej shumë kohë dhe mbase do të qante po mos të ishin fjalët e fundit të urdhëresës dhe çështja e plikos së vogël e cila duhej t'i dorëzohej menjëherë Kryehetuesit. Ishte i bindur se Kryehetuesi tashmë e priste atë thirrje dhe mendja ia thoshte se ai ndodhej fare pranë tendës për t'u futur në të me mospërfillje. Për t'i ikur edhe një nënçmimi tjetër edhe më të madh nga ai që e ndjeu kur e lexoi urdhëresën, vendosi që atë t'ia jepte veqilit që ai t'ia dorëzonte Kryehetuesit, edhe pse e dinte se bënte shkelje për të cilën herët a vonë mund të jete llogari... Nuk jam thnegël?... Apo-jo?... Atë pyetje ia shtroi vetes disa herë dhe një buzëqeshje e ftohtë që i kaloi fytyrës, sikur ia ktheu asaj për pak gjallërinë e humbur. Bile, kur erdhi komandanti me katër ushtarakët e lartë, dukej si i ringjallur, sa ata, të mësuar me ngrysjen e tij, i thanë se gëzoheshin që e shihnin në atë gjendje dhe uruan që sikleti t'i takonte të shkuarës.

U dha leje të uleshin dhe të katërt i shikoi me njëfarë dhembshurie, pa ditë as vetë pse edhe ata iu bënë se ishin pjesë e tij, se ishin ai, se ishin shumësia e tij e përsëritur, që i priste i njëjti fat, ndëshkim-dënimi... Për t'i ikur asaj ndjenje, që do t'ia kthente mundimin e pakmëparshëm nisi të fliste rreth udhëtimit të gjatë e të mundimshëm, që e kishin kaluar bashkë, por që i shërbente një qëllimi të përbashkët dhe të madh...

Ushtarakët si me një gojë tumirën ato që tha Veziri i madh.

Pas një heshtjeje, gjithnjë me bindjen se kishin të njëjtin fat që duhej t'i nënshtroheshin me dinjitet në mënyrë që të mos ktheheshin në të mallkuar, tha se si ushtria kishte hak një çlodhje.

Ushtarakët pohan, por shtuan se nuk kishin lëvizur, por jo edhe vepruar.

- Sikur janë të njëjta, tha Kryeveziri...

Ushtarakët sikur u zunë ngushtë...

Kryeveziri tha se ushtrisë i duheshin katër-pesë ditë për t'u çlodhur. Shtoi se këtë e kishin "shpërblim" nga ana e tij.

Ushtarakët u ngritën. Përsëritet sipas zakonit dhe dolën. Nuk e kishin të qartë fjalën pushimin si "shpërblim". Por, sikur shprehën kënaqësi për përkujdesjen ndaj tyre.

I kënaqur mbeti edhe Kryeveziri me atë shtirjen rreth ditëve të pushimit të ushtrisë, që i rrodhi për gjuhe aq mirë. Por, ajo ndjenjë shpejt i iku. Në kokë iu qep pika e tretë e urdhëresës, ku bëhej fjalë për shpalljen e shtetrrëthimit dhe mbylljen e Shehrit. Tash e kishte të qartë se çfarë do të thoshin edhe ato që kishin të bënë „me kryerjen e detyrave të secilit veç e veç“. Mendja ia tha se ndëshkim-dënimi i nisur për të, do të përfshinte gjithë vendin... Do të bëhet një kasaphane e paparë, pëshpëriti... Gjaku do të shkojë rrëke për t'u bërë lumë...Iu duk se atë lumë tashmë po e shihte, se ai lumë po fryhej, se ai e kishte formuar shtratin dhe se ai lumë po e merrte edhe atë bashkë me gjithë ato që kishte përpara... Tashmë e kishte të qartë se çështja e plakave si dhe magjia e zezë ishte një kurdisje e Idiz Allajbejt që t'i pritej hovi një herë e mirë herezisë që mund të përhapej prej andej si murtajë e pandalshme?... Iu bë se po e shihte Allajbeun duke agjituar në të katër anët dhe me sa fuqi kishte për t'u mbrojtur sa më parë nga rreziku i jashtëzakonshëm me anën e një fushate të shenjtë... Ai fliste pareshtur për një të ligë shkuar të ligave që e rrezikonte Perandorinë me gjithë ato që kishte... Ju nuk e dini se ç'shpirt heretik kanë ata, po çirrej... Aty ka lindur ajo ndjenja e asnjë njeriu, që ka të bëjë me pashmangësinë e dy boteve dhe aty është ushqyer edhe laramania shpirtërore, që është mashtrimi më i madh i parë deri më tash me të cilën lidhet kundërshtimi kundër Perandorisë... Ajo pikë e botës nuk është e krijuar për të mbrojtur të kundërtat nga skajshmëritë e tyre, siç thuhet, por për të ruajtur farën e së keqes, që duhet të parandalojë fitoren e lindjes ndaj perëndimit, me të cilën të mirës duhet t'i hiqet e liga dhe të ligës t'i merret e mira...

Fjalët e Allajbeut dikur i pa të kthyera në shumë shpata, që po shumoheshin e po shumoheshin nga të gjitha anët dhe suleshin si breshëri, që po e rrethonin dhe po ia kërkonin kokën... Frikshëm iu kujtuan plakat, që me ndryshimin e gjendjes mund t'i bishtnonin edhe më të keqes... Për herë të parë sesi fare pa dashas i shkoi mendja se mbase ajo prirjeje do t'i ndihmonte t'u ikte shpatave që po i kërcënoheshin... Mbase edhe më tutje do të rropatej me këtë mendim dhe sikur ishte në rrugë që t'i nënshtrohej trysnisë së mëdyshjes së fshehur rreth asaj se mos ishte ndjenja e rrezikut të përhershëm që kishte krijuar mjeshtërinë e magjinë së zezë, si mbrojtjeje nga e keqja që nuk mund t'i ikej ndryshe pos me mashtrime të tilla, por më të shpejt ndërpreu çfarëdo lidhjeje me këtë mendim nga shkaku se i druhej helmit të herezisë, e cila, edhe ashtu, fare pavetëdijshtë, mund të vepronte drejtë pranimit të mëkatit. Ishte gati të lutej dhe të kërkonte falje për këtë shkitje, por kur u përмор paksa, hetoi se rrëmetin e shpatave nuk e kishte pranë dhe nuk po e vërente as Idriz Allajbeun tek çirrej dhe tek kërkonte fushatën e shenjtë... Ishte vetëm, fillikat, shuk dhe fare i përhumur... Në atë heshtje shurdhe, preku disa herë ballin, sikur të dëshironte që nga koka t'i largonte të gjitha

mendimet e liga, ndërkohë që nga goja i rrodhi një lutje ku po kërkonte falje për njëfarë lajthitjeje me shpresën se ashtu së paku do t'i kthej qetësia dhe gjumi...

Por, qetësia dhe gjumi nuk iu kthyen as atë natë, as netëve të tjera e as kurrë më. Mendimet e liga e gjenin edhe atëherë kur ia pranonte vetes nënçmimin më të madh rreth asaj se nuk ishte tjetër pos pjesë e një mekanizmi të urdhrave që i duhej pushtetit... A nuk ishte ky shpagim i mjaftueshëm për të gjetur njëfarë qetësie të rreme?... Në atë pështjellim të anktshëm, i bëhej se dikush nga afërsia zëshëm ia përsëriste pjesët e urdhëresës, sa për ta nënçmuar edhe më tej dhe për t'ia përkujtuar gjendjen e pashpresë, e herë i bëhej se atë punë e bënin vetë plakat e padukshme, të cilat i rrinin pranë dhe dëshironin t'i thoshin diçka që ai duhej ta dinte medoemos... Për t'i ikur trishtimit, që po e mbërthente gjithnjë e më shumë, thirri çallgëxhinjte dhe valltaret. Tri ditë e tri net tenda e tij gumëzhiu me të madhe, ndërkohë që ai rrinte si i ngrirë në minder dhe të shumtën jashtë vetes. Të gjithë e dinin se ai nuk ishte aheng, por një shqetësim i thellë në të cilin ai kishte rënë dhe assesi të lirohej. Ushtarakët druanin se prapa atij ahengu të llahtarshëm fshihej ndonjë vendim që luftës mund t'ia jepte kahun e ndonjë shthurjeje tjetër të papritur, me të cilën ata sprovoheshin gjithnjë e më shumë kohëve të fundit, që ajo të humbte kuptimin që kishte përherë dhe të merrte kahun e ndonjë intrige që vendosej jashtë saj... Gjëma e ahengut megjithatë pushoi natën e katërt, kur në tendën e kaltër hyri Kryehetuesi. Pashai, që ia mbante mend emrin prej plikos së vogël, edhe pa shpjegimet e veqilit, që pasuan pas pak, e pati të qartë se ishte Kryehetuesi, vinte tamam në kohën që e kishte paraparë të shfaqej. Çështje ishte vetëm se çfarë lajmesh sillte, sado që ishte i sigurt se ato që do t'i thoshte ai njeri me fytyrë dinake e sy finok lidheshin patjetër me pikën e tretë të urdhëresës, pra me shpalljen e shtetrrëthimit dhe shkëputjen e Shehrit nga bota. Sikur ta hetonte mendimin e Pashait bashkë me ato që e mundonin, pasi u përkul dhe kërkoi leje të fliste, Kryehetuesi, nuk tha tjetër pos që bëri të ditur për ndodhjen e një masakre.

Pashai u shtang. Iu mor goja dhe vetëm pasi preku disa herë ballin dhe fytyrën mundi të krijonte pyetjen gjysmake se për çfarë masakre fliste ashtu...

-Na i masakruan ushtarët.

Foli ai ftohtas, sikur të kumtonte një lajm fare të rëndomtë, që e kishte pritur...

Kryeveziri mend plasi nga qëndrimi i tij mospërfillës. Pa shpatën që e kishte pranë dhe njëherë i shkoi mendja ta ndante përgjysmë, edhe pse e dinte se gjithçka pastaj do të ngatërrohej keqas sa t'i shkonte edhe koka në kamaren e turpit. Një copë herë e çoi mendjen gjatë dhe vetëm pasi u qetësua paksa shtroi pyetjen se kush i masakroi ushtarët.

Kryehetuesi ngrehu kokën më lart sesa duhej ta mbante në rastet e tilla.

-Kush tjetër, pos vendësve, madhëri...- tha.- Vetëm ata janë në gjendje të bëjnë prapësina të tilla...Tek e fundit, kjo nuk është hera e parë që sillen kështu...

Prapë foli në mënyrë mospërfillëse sa pashait nisi t'i zihej gjaku që mendonte se i ishte ftohur fare. Sytë prapë ia zunë shpatën dhe prapë i shkoi mendja ta ndante përgjysmë... Por, për t'i ikur asaj sprove që po e mbërthente gjithnjë e më shumë, mbylli sytë që mos ta shihte më as shpatën, që po e cyste, e as Kryehetuesin, që po i rrinte përpara dhe vazhdonte të fliste për masakrën si për diçka të rëndomtë... Koka megjithatë po ia kapte shkëputshëm ato që i thoshte Kryehetuesi rreth asaj se si ushtarët pinin ujë, se si dikush u kishte thënë se uji është i shenjtë, se nuk duron përdhosje, se pastaj, nuk dihet se prej nga ishin shfaqur thikat, të cilat kishin fërfëllitur nga të gjitha anët, e që kishin bërë të skuqej lumi me gjakun e ushtarëve... Ajo përsëritje assesi të ndalej dhe Pashai kishte ndjenjën se ai gjak po i futej nga të gjitha anët në tendë, andaj, shfreu me sa zë kishte që të heshte...Tha se po i pëlçiste koka nga ato që dëgjonte dhe se tashmë i kishte të gjitha të qarta...

Kryehetuesi u ngri ngadalë dhe po bëhej gati të kërkonte leje për largim.

Me sy të mbyllur dhe pa denjuar ta shihte, me një të lëvizur të dorës, Pashai i dha leje të shkonte. Ishte i bindur se atë njeri nuk duhej as ta shihte dhe as ta dëgjonte fare, pos ta ndante përgjysmë.

Kur po largohej, Kryehetuesi e falënderoi për durimin ta dëgjonte dhe ia bëri me dije se përpara ia kishte lënë letrën, në të cilën ai kishte shkruar ato që duhej t'i thoshte në përputhje me detyrën që kishte. Deshi të thoshte edhe diçka tjetër, por Pashai, gjithnjë me sy të mbyllur, i dha shenjë se nuk duhej të fliste më...

Kur mbeti vetëm iu bë se tenda edhe më tutje po i skuqej nga gjaku, i cili sesi rridhte nga të gjitha anët në formë të currilave të shumtë. I bëhej se para secilit curril gjaku shihte hijen e gjatë të Kryehetuesit, që i përzihej dhe i bëhej një me gjakun, në të cilin sikur ndjente se po sharronte... Nuk e kishte të qartë se a kërkoi ndihmë për t'u liruar nga ankthi i gjakut, apo nga ai që ia kishte krijuar këtë ndjenjë, por kur hapi sytë, pa ushtarakët, që po i rrinin përpara si të ngrirë dhe po prisnin t'u thoshte diçka...

-Duhet ta dini se u derdh gjak... Duhet ta dini se u bë një masakër e tmerrshme... Thika të shumta u lyen me gjakun e shenjtë perandorak... Shumë thika ishin... Shumë sosh... Shumë gjak... Një det gjak...

Ushtarakët që tashmë e dinin ndodhjen e masakrës, si të ngrirë e shikuan Kryevezirin që fliste përçartë për thikat dhe gjakun, me ç'rast goja i sillte dhe i pështillte ato fjalë pa ndonjë rend sa ata hetuan se ajo ia kishte ngatërruar keqas edhe kokën... Vetëm kur ferku i parë i mëngjesit gjeti tendën, ushtarakët panë se Pashai paksa u rrethua dhe ua tha troç ato që ia kishte thënë Kryehetuesi. Ushtarakët shënuan diçka, ndërsa ai dha urdhër që edhe të tjerët të vinin me ngut. Kur veqili kërkoi të dinte se cilët ishin ata të tjerët, që duhej të vinin, Pashai u zu ngushtë, ngaqë disa nga emrat që i kishte lexuar në urdhëresë tashmë i kishin dalë mendsh dhe nuk dëshironte që para ushtarakëve të lartë serish ta shikonte letrën, të cilën duhej ta mbante jashtë syve të të tjerëve deri sa të vinte çasti i zhvleftësimit (pra të kallej) për t'u hapur plikojat tjetër. Murmuriti disa herë dhe pas përpjekjeve të mëdha që bëri të rikujtojë emrat e atyre që gjendeshin në urdhërese, ia doli të krijonte urdhrin me emrat e atyre që duhej të vinin sa më parë. Veqili, që kishte dëgjuar me aq kujdes ato që i tha Pashai, që mos t'i shpëtonte asgjë, përmendjen e përgjegjësës së haremit deshi ta merrte si lajthitje dhe si të dëshironte ta zhbënte atë fjalë para ushtarakëve, i përsëriti emrat e atyre që duhej t'i thërriste me ç'rast qëllimisht e la pa përmendur atë të përgjegjësës së haremit. Pashai, që atë çast nuk fliste me vullnetin e vet por sipas urdhëresës, që i ishte qepur në kokë dhe duhej ta ndiqte pareshtur, shtoi se duhej ta thërriste edhe Hyrije Hanmin.

Nuk vonoi dhe në tendë, një nga një, hynë të ftuarit. E fundit erdhi Hyrije Hanmi, e veshur me një dollamë të kaltër me ca rruaza të bardha që shkëlqenin. Askush nuk e kishte të qartë se çfarë kërkonte ajo në atë mbledhje aq të rëndësishme. Për ta bërë hutimin edhe më të madh, Hyrije Hanimi, pos që përshëndeti Pashain sipas zakonit, të tjerëve nuk ua vari fare.

Pashai përcolli me sy një copë herë gruan që e njihte aq mirë, shikimi i lodhur ia kapi edhe ata që i kishte pranë dhe rrinin si të shtanguar. Si do t'ia fillonte vallë?... Nga çasti që e kishte lexuar urdhëresën dhe i mori vesh të gjitha ato që ishin në të, e pati të qartë se ai ishte venë në një lojë që i dihej fundi, pra ndëshkim-dënimi i tij, ku ai kishte rolin e udhëheqësit dhe mbikëqyrësit të njëres ndër fushatat më të mëdha, por që e gjitha duhej të ndodhte pa ditur se çfarë bënin të tjerët në prapaskenë, pos që duhej të nënshkruante dhe të rrinte në tendë prej nga do të përcillte ato që do të ngjanin tutje në vendlindjen e tij pa qenë në gjendje të ndikonte në rrjedhën e tyre. Në atë përpëlitje të tmerrshme duhej të priste tridhjetë ditë, të priste pastaj edhe tridhjetë të tjera dhe, së fundit, të jepte njëfarë mendimi për shtetrrëhimin, që nuk ishte e thënë se mund të përfillej. Dhe, ç'është më keq, ai duhej të shtirej se i dinte të gjitha, se i mbikëqyrte të gjitha, se madje edhe i parashikonte të gjitha... Kjo ia turbulloi kokën për aq sa ata që kishte përpara po i dukeshin si hije të ngatërruara, që kreshpëroheshin dhe përhapeshin frikshëm në të gjitha anët... Një copë herë u mor me hijet dhe ndoshta do të dilte jashtë për të kërkuar shpëtim po të mos kishte ndeshur shikimin e ëmbël të Hyrije Hanimit, që e nxori çuditërisht nga moria e hijeve dhe ankthi i tyre që tashmë po e shtrëngonte... Mbase vetëm ajo është e sinqertë në mesin e atyre që kishte përpara, mendoi?... Të tjerët, kush më pak e kush më shumë, kishin për detyrë të punonin kundër tij... Me një të

kollitur që e nxori dhunshëm nga kraharori shpërfilli atë mendim, të cilit nuk dëshironte t'ia ndiqte rrjedhën nga frika e shpërqendrimit. Për t'i ikur shkitjeve të paparashikueshme nisi të fliste fare qetë rreth asaj se si të gjithë e dinin lajmin e zi, që kishte tronditur të madh e të vogël...

-Masakra u bë... Ushtarët na u therën si qengjat... Kjo nuk është kurrfarë rastisjeje, pos pjesë e luftës kundër Perandorisë...

Një copë herë foli për masakrën dhe sa më shumë fliste, i bëhej se mbllaçiste diçka që i kapej për gjuhe dhe në vend se ta nxirrte jashtë ajo serish i kthej brenda si lëmsh që e rëndonte me pështjellim edhe më të madh. Për t'i ikur ndonjë hutimi tjetër, shpejt e shpejt iu kthye çështjes së urdhëresës, për t'i thënë ato që duhej t'i thoshte sa nuk bëhej vonë. Tek e fundit, e dinte se me urdhëresat e mirëfillta gjithnjë ishte më lehtë, ngaqë ai që rrinte lartë, i merrte përsipër formulimet, ndërkohë që zbatuesit i takonte përgjegjësia. Por, këtë herë, porositë-urdhëra, që në të vërtetë i merrte për ndëshkim, nuk duhej t'i thoshte siç ishin, pra të thata, por e gjitha të ngjyrosej ashtu që të dukeshin si urdhër, i hartuar aty për aty, nga gjendja e krijuar. Një e qeshur e thartë i kaloi fytyrës kur i ra ndërmend shtirja që duhej ta bënte. Ishte kjo pjesë e lojës që i nënshtrohej mbajtjes së fronit të lartë, apo e kundërta, që kishte të bënte me çmimin që duhej paguar atij?... Për t'i ikur kësaj mëdyshje, e cila gjithnjë e më shumë e mundonte dhe e dinte se po i kthehej në mallkim, nisi të fliste rreth asaj se si kur Perandoria ballafaqohet me kryeneçësi të vazhdueshme shpall fermanin e posaçëm, me anën e të cilit duhet t'i jepet fund të ligës pa marrë parasysh mjetet që duhet përdorur...

Me të dëgjuar fjalën ferman, të gjithë u ngritën dhe morën qëndrim të ngrirë. U ngrit edhe vetë Pashai, që po i dridhej letra në dorë.

Pasi i shikoi të gjithë, tha:

- Pas masakrës së përgjakshme, ku u vranë njëzet e shtatë ushtarë, e me ç' rast edhe një herë na u bë me dije se uji flenë e armiku jo, bazuar në autorizimet e plotfuqishme, të bartura nga Lartmadhëria dhe me qëllim që të mbrohen interesat e Perandorisë kudo qofshin ato, e shpall këtë ferman të plotfuqishëm.

Fjalët e fundit i theksoi aq shumë, sa ato tingëlluan si një kërcënim që u drejtohej të gjithëve, pa marrë parasysh se në ç'anë ndodheshin.

Më poshtë Pashai lexoi ato që kishte në letër:

1. Shtetrrëthimi përfshin pjesën më të madhe të Tokës së Lashtë me kryeqendrën e saj, në të cilën ndodhet kryeadministratori perandorak.

Hapësira nga bjeshkët deri në perëndim dhe luginë në lindje shpallet si e mbyllur.

2. Taborët perandorake duhet ta rrethojnë menjëherë hapësirën e përmendur.

3. Administrata ushtarake merr përsipër qeverisjen e vendit dhe mbikëqyr të gjitha pjesët e jetës shoqërore dhe private.

4. Pushteti i deritanishëm i nënshtrohet administratës ushtarake dhe vihet në shërbim të tij me gjithë ato që ka dhe shërbimet që posedon.

5. Ngrihen gjyqet e jashtëzakonshme. Ato duhet të punojnë në përputhje me ligjet ushtarake.

6. Ndaj atyre që në çfarëdo forme nuk u përmbahen urdhrave të këtij fermani apo që u bishtnojnë merren masa të rrepta gjithnjë në pajtim me ato që parasheh fermani.

7. Shtetrrëthimi, tash për tash, zgjat tridhjetë ditë dhe mund të vazhdohet edhe për tridhjetë të tjera, po që se vërtetohet se ka kushte për një gjë të tillë. Nëse edhe pas gjashtëdhjetë ditësh vlerësohet se asgjë nuk ka ndryshuar ndërkohë që rreziku mbetet, atëherë shtetrrëthimi vazhdohet pakufishëm.

8. Ky ferman mund të zhvleftësohet vetëm me fermanin e lartë të Perandorisë.

Pashai për pak u ndal për të vazhduar me tërheqjen e vërejtjes së çfarë do të thoshte të jetosh dhe të veprosh në rrethanat e shtetrrëthimit dhe të administrimit ushtarak. Me këtë ai sikur dëshironte që një pjesë të nënçmimit që po e ndjente se po i bëhej si dhe lojës që merrej me mend se çfarë do ta kishte fundin, t'ua hidhte atyre që i kishte përpara, por edhe t'i

përfshinte në të, edhe pse e dinte se shumë prej tyre në të vërtetë as që i nënshtroheshin fermanit, por ishin për punë të tjera që ai i kamuflonte. Sidoqoftë shpallja e fermanit, së paku sa për sy e faqe, atij i jepte mundësi të shtirej ai që nuk ishte, ndërkohë edhe atyre që i shërbenin fushatës dhe me verime të drejtpërdrejta tejkalonin përmasat e saj, ua bënte me dije që të kishin kujdes nga hidhërimi i Vezirit të madh, që mund t'u kthehej si hakmarrje nëse diçka do të çalonte...

Me të përfunduar leximi i fermanit, pasi kërkuar leje me arsyetimin se i pritnin detyrat e jashtëzakonshme, ushtarakët u ngritën dhe dolën. Në të dalë Pashai u tha se nga ai çast ngarkoheshin me përgjegjësi të madhe.

Të tjerët po pritnin se a do t'u thoshte Pashai edhe ndonjë fjalë para se të merrnin izën. E ai, në vend se t'u uronte punë të mbarë, një copë herë po i hante me një shikim gjithë mëdyshje, që edhe atyre u binte në sy. Disa prej tyre tashmë po i ktheheshin në hije dhe nga frika e mbërthimit të ndonjë ankthi që i shfaqej në rastet e tilla, u dha shenjë të shkonin. Dëshironte të rrinte vetëm, fillikat, që askush mos t'ia shihte ligështimin që e parandiente se do ta përfshinte së shpejti.

Tenda u zbraz dhe kur iu bë se mbeti vetëm, ndjeu prekjet dhe miklimet e buta të Hyrije Hanimit.

-Është koha,më në fund,të më vizitosh... Ka ca gjëra që nuk mund të harrohen...Tekefundit, tash më shumë se kurrë, i duhemi njëri-tjetrit... Nuk kemi nga t'ia mbajmë... Këtë e dimë që të dy... Apo jo?...

E pa fytyrën e saj të përhekt, që rëndom rrezatonte njëfarë hareje dhe iu duk se në të po shihte një ngashërim të thellë që nuk e kishte hetuar më parë, ku thyhej më shumë se shfrimi i epshit... Përballë asaj kureshtje, thuajse jashtë vetes, murmuriti rreth disa gjërave që nuk harrohen dhe sikur po i vinte mirë që ajo murmuritje po e shkëpuste nga pjesa që nuk duhej t'i takonte, së paku gjatë asaj nate... Me atë ndjenjë, që po e lironte nga ngarkesat e tmerrshme, i shkoi mendja se duhej të shkonte në tendën ngjyrë vjollce të Hyrije Hanmit dhe mbase këtë ishte dashur ta bënte më shpesh dhe ndoshta gjithë rrugën ta kalonte në të...

Hyrije Hanmi, që në fytyrë ia vërejti fikjen e flakërimit të brendshëm, tek po e zinte për dore i tha se tashmë po vinin kohë kur që të dytë ndjeheshin njëso dhe se kjo e përbashkët duhej t'i afronte edhe më, që së paku, atë ta përballonin pa u thyje fizikisht...

Ai e mbërtheu dorën e saj për të veten dhe do të shkonte po atë çast me të, po të mos i kujtohej se së shpejti duhej t'u bënte nderimin ushtarëve të masakruar para se të varroseshin.

-Në djall!... Në djall të vejë e gjithë bota!...

Dielli pranveror po shkëlqente hareshëm kur u shfaqen qerret me të masakruarit. Numëroi njëzet e shtatë tabute të mbuluara me çevre jeshil. Anash u shkonin hoxhallarët dhe dervishët e shumtë të përhumbur në lutjet e thekshme, që pushtonin hapësirën trishtueshëm.

-Allah,katilët!... Allah,dënoi katilët!... Vdekje katileve!... Vdekje!...

Hetoi se gjëma po i vinte si shfrim ogurzi dhe po e qëllonte në kokë pamëshirshëm. Më dëshirë do të largohej prej aty, por nuk kishte si. Puna e donte të rrinte dhe të nderonte shitet e Perandorisë deri sa t'u binte dheu përmbi.

Shikoi diellin dhe pa se ai po i afrohej pikës më të lartë, edhe pse i dukej se rrezet edhe më tutje i kishte mikluese. Edhe pak, mendoi, kur dita do të marrë tatëpjetën, hyn në fuqi shtetrrëthimi. Ushtria do të rrethojë Shehrin dhe do të fillojë koha e mbylljes së përgjithshme, do të fillojë koha e vetmisë së madhe, do të fillojë koha e ethshme, koha me zjarrmi, koha me frikë, koha me gjyqe të aty për atyshme, ku fjalën e parë dhe të fundit do ta kenë ushtarakët...Tridhjetë ditë?... Mbase gjashtëdhjetë ditë?... Apo, përgjithmonë: rrethim, mbyllje, vrasje të vazhdueshme të shpirtit... Kujtesa duhet të pastrohet nga gjërat e tepërta dhe të rrezikshme, nga herezia... Por, ç'ishin në të vërtetë ato që u ishte shpallur luftë e pamëshirshme nga Perandoria më e madhe e botës?... Çështje të mbijetimit i thjeshtë?... Mënyrë e përshtatjeve të vazhdueshme?... Laramania, si kuptim i pajtimimit të të kundërtave?...

Allah, ndihmo, tha, por ishte gjëma funebre që vinte na të dy anët që e ngriu, ngaqë e dinte se me to kërkohej vdekja, kërkohej një vdekje e përgjithshme, kërkohej një vdekje e përsëritshme, që do ta bënte jetën të paqenë, kërkohej një vdekje që nuk do të ishte si çdo vdekje tjetër, por një që duhej t'i shërbente shkatërrimit të përgjithshëm...

O zot, pëshpëriti prapë, shpëtona nga vdekja e tillë!

Mbase ai shfrim do ta lehtësonte paksa, për ta përballuar disi atë mundim, por ishte shfaqja e Kryehetuesit, që serish ia ktheu ligështimin. I rrethuar me serasqerët dhe hetuesit e shumtë, ai rrinte i akullt dhe shikonte funeralin. Ashtu bashkë iu duken si mbjellës të vdekjes, të asaj vdekjeje të madhe dhe të pafund, që duhej të ndodhte nga ai çast... Iu bë se Kryehetuesi ishte kthyer në një hije të zezë, tepër të madh, që ecte pas tabuteve dhe kërkonte vdekjen në sytë e të gjallëve, në mënyrë që edhe ata të ktheheshin në skelete për t'iu bashkuar funeralit të pafund...

Ai përftim lemeritës iu soll para përderisa hetoi se dielli kishte marrë rrugën e perëndimit dhe gjithnjë e më shumë afrohej koha e çindisë, kur hynte në fuqi shtetrrethimi...I erdh keq pse dielli ecte më shpejt se sa duhej...

Më në fund koha e shtetrrethimit po afronte dhe ai duhej të shpallej prej tij. Tridhjetë ditë?... Gjashtëdhjetë ditë?... Apo, pakufishëm?... Ky mendim po i sillej në kokë dhe po e qëllonte me sa forcë kishte. Tridhjetë ditë?... Gjashtëdhjetë ditë?... Gjithmonë?... Koha e Kryehetuesit... Koha e vdekjes... Medet... Mendja ia tha se Kryehetuesi tashmë ishte futur në Shehër dhe bashkë me bashkëpunëtorët tinëzar (pa u dhënë atyre kurrfarë shpjegimesh), kishte filluar punët, prej nga shërbimit të fshehtë të perandorisë (që e mbikëqyrte vetëm Lartmadhëria), do t'i dërgoheshin raportet e para, ndërkohë që ai do të rrijë në atë rrafshnaltë dhe do të presë shënimet e ushtarakëve që nuk e kanë peshën e atyre të Kryehetuesit dhe gjithë shtirje do të bëjë sehir për të pritur kohën e plikos tjetër, asaj me numër dy, e cila doemos se do të shpalojë urdhrat tjera edhe më të paparashikueshme. Në ndërkohë ai mund të zhgërryhet në tendën e Hyrije Hanmit për t'i shfryrë epshet dhe mund të dëgjojë çallgitë err e terr, ndërsa tutje, vetëm një orë larg, vendlindja i ndodhej e rrethuar nga tabore të pafunda dhe e lënë nën mbikëqyrjen e Kryehetuesit që në të kishte futur hetuesit e panumërt...

Ky mendim e tmerroi dhe bëri të pyeste veten rreth asaj si dukej jeta në kohën e shtetrrethimit dhe ç'domethënie kishte ajo kur zhvleftësohej fare, por ishte zëri i hoxhallarëve që po e paralajmëronin çindinë, që e largoi nga dënjimi i përgjigjes që ia kishte borxh vetes, meqë atë çast hynte në fuqi shtetrrethimi, që fillonte me shenjen që ai duhej t'ua jepte ushtarakëve, me çka hapej edhe koha e fushatës së jashtëzakonshme, koha e vdekjes...

Erdhi koha e shtetrrethimit, tha gjithë dëshpërim... Erdhi koha e nënçmimit, pëshpëriti dhe pa ushtarakët që po e prisnin shenjën e nisjes. Komandanti kishte dalë para tyre dhe me shpatën e ngritur para fytyrës ia bënte me dije se ushtria ishte e gatshme të niste vendosjen e shtetrrethimit.

Një copë herë nuk ia hoqi sytë shpatës së mprehtë që rrinte midis tij dhe ushtarakut të lartë, sado që një rreze drite që thyhej në të ia vriste sytë. Rrezja e përthyer në shpatë nuk po e linte të qetë sa ndjeu t'i digjnin sytë, aq sa iu bë se një shumësi shpatash tjera do ta verbonin bashkë me gjithë botën. Për t'i shpëtuar atij kërcënimi, ngriti dorën që njëherësh do të thoshte shenjë e fillimit të shtetrrethimi, që pritej ta jepte. Dora që po i dridhej, një copë herë i mbeti si e ngrirë në ajër, pa pasur mundësi ta ulte, sado që e dinte se prapa asaj ngritjeje, që ishte pjesë e instinktit të urdhrit, lëvizi diçka e madhe, se u trondit toka, se po shembeshin malet që kishte përpara, se zogjtë e tmerruar po iknin dika dhe se me të fillonte koha e vdekjes... Si në mjegull, së pari pa duakënduesit, që u nisën me lutje shfrenuese në gojë, e më pas hetoi se si u shkëput këmbësoria, që la pas një re pluhuri, e cila bëri si të paqenë taborët e shumta, të cilave ua dëgjonte gjëmimin. Por ajo re e pluhurit, sikur nuk ia kishte dalë të mbulonte stemat, emblemat dhe flamujt e shumë të luftës bashkë me kafshët e egra që i mbërthenin si shenja, të cilat po i shihnte tek lëviznin tok kah vatani për ta arritur sa

më parë. Dikur iu bë se mbi atë katrahurë ngrihej një flamur i vetëm, ai i Perandorisë, i cili jo vetëm që mbulonte taborët e pafund, por edhe diellin e bënte të paparë... Që t'i ikte për pak atij trishtimi zuri sytë me duar me shpresë se disi do të kursehej nga mundimet tjera që sa vinin e i shtoheshin. Mbase ia doli që gjithë atij rrëmeti që po i shtrihej përpara t'ia vente përqark një perde të lehtë, por pikërisht kur mendoi se ishte shkëputur nga të gjitha, veshi ia kapi çirrjet e thekshme të allxhinjve:

-Hasan Pashë Ohri shpalli shtetrrethimin!...

-Filloi shtetrrethimi!

-Pushtetin e morën ushtarakët!

-Filloi gjendja e jashtëzakonshme!

-Lavdi vezirit të madh Hasan Pashë Ohri! Lavdi!...Iu praroftë dora!...

Për herë të parë u frikësua nga emri i vet. Zuri të dridhej, ndërkohë që emri i tij hapej furishëm bashkë me terrin që po bëhej gjithnjë e më i dendur. Emri i tij përzihej me shtetrrethimin dhe hapej si ogur i ligë anembanë vendlindjes së tij... A nuk ishte kjo pjesë e një vrasjeje të tmerrshme, që po i gatitej nga të gjitha anët?... Një copë herë e sëmboi kjo mëdyshje dhe në pamundësi që asaj t'i jepte çarë do shpjegimi pos të pranonte se ishte pjesëmarrës në atë vrasje e mbase edhe shkaktar i saj, thuajse humbi drejtpeshimin dhe ishte gati të shembej. Bile ishte fare pranë rënies po të mos e kishte kapur për krah Hyrije Hanmi.

-Eja,xhan,eja... A nuk të thashë se i duhemi njëri-tjetrit?... Pse çanë kokën me ato që nuk mund t'i ndryshosh?...Pse,or?...

Ai edhe më tej po dridhej. E u dridh edhe kur Hyrije Hanmi e zuri për krah dhe e mori me vete në tendë. I shkallmuar si kurrë më parë rrinte i mbështetur në krahun e saj dhe kërkonte të mbrohej nga çirrjet e tellallxhinjve, që po e gjenin edhe aty...

Megjithatë hetoi se si pak nga pak miklimet e ëmbla po e zbraznin prej mendimeve të ngatërruara dhe po i ndihmonin të lirohej nga ankthi i rrëmbimshëm, që e kaploi çastin që ushtria u nis kah rrafshi dhe Shehri për të vënë shtetrrethimin. Sapo hyri në tendë, Hyrije Hanmi i tha se kishte ilaçin për iletin që ia dinte... Dhe nuk vonoi dhe ai ndjeu një kundërmim të këndshëm luleshqerre që iu fut me të shpejt në kraharor, kështu që gjendja e shkallmimit iu zëvendësua me atë të një qetësie shurdhe, ku kundërmimi i këndshëm po ia nxirrte shqetësimin e bërë nyje prej kohësh. Në atë gjendje, i bëhej se po notonte në një hapësirë të pafund, ku kishte gjelbërim, ku kishte gjithfarë lulesh, e ku kishte zogj të shumtë që fluturonin prajshëm... Aty hetoi një lumë, ndjeu gurgullimën e një përroske dhe më tutje ia mori mendja se gjendej një det i madh,në të cilin kishte shumë anije me vela të bardha, që po bëheshin gati për ta marrë dhe ta dërgonin ku do të mbretëronte pushteti i kaltërsisë së thellë dhe një diell i amshueshëm që përjashtonte terrin... Ashtu i megjulluar hetoi anijen, hetoi se çdo gjë ishte aq e qetë dhe aq e këndshme sa një çast i tëri sharroi në atë mirësi...

Në mëngjes gdhiu fare i qetë. Hyrije Hanmi edhe një copë herë e mikloi dhe i pëshpëriti fjalë të ëmbla. Por kur ajo deshi të largohej ndjeu se po i kthehej ankthi i mëparshëm. Në kokë serish zunë t'i pështjelloheshin flamujt e luftës bashkë me stemat dhe emblemat e panumërta, ku egërsirat në to shfaqeshin të tërbuara dhe bëheshin gati t'i suleshin. I dukej se në hapësirën që i ngjasonte një shkretëtire të pafund gjithë thera dhe lule të zeza të vyshkura do të shqyhej nga egërsirat e stemave...

Hyrije Hanmi e gjeti të zverdhur dhe të mbytur në djersë të ftohta.

-Pse çan kokën me hallet e botës?... Pse s'i heq qafesh të shkretat?...Nuk u binde ende se jemi të pafuqishëm t'i ndryshojmë disa gjëra?... Harroj ato që nuk i ke në dore... Harroj...Vetëm harrimi shpëton...Vetëm harrimi...

Si ai që dëshiron t'i rrijë sa më larg përfytyrimit trishtues, vuri kokën mbi prehrin e saj dhe mbylli sytë. Po kërkonte atë cazën me shumë lule dhe anijen me vela në atë detin e qetë...

-Të shpëton vetëm harrimi...Vetëm harrimi....

Dhe ai, me gjithë qenien, iu dha harrimit, atij harrimi që përmyt të gjitha brigjet e kujtesës. Duke ikë nga pesha e përfytyrimeve që duhej t'i flakte sa më parë, e që ishin shumë, tepër shumë, i bëhej se fluturonte në një hapësirë të kaltër, ku cicëronin zogj e ku herë pas here nga qielli kalonte në një anije me vela të bardhë që e drejtonte Hyrije Hanmi... Kundërmimi i luleshqerrave e shkëpuste nga bota së cilës tash i frikësohej aq shumë dhe e dinte se po ia hante kokën...

Por botës që e mundonte nuk kishte mundësi t'i ikte përgjithmonë, ngaqë me të ishte ngatërruar si shumë, thuajse aq sa s'dilte gjë ta shkëpuste prej saj.

Jashtë po binte një shi i imët, që barit të njomë dhe beharit mugullues ia kishte shtuar edhe më kundërmimin e këndshëm pranveror, ndërkohë që një tis i hollë mjegulle, që mezi mbahej, ia kishte vënë një perde të tejdukshme hapësirës që shtrihej tutje. Një copë herë e shikoi atë pamje që i pëlqeu pa masë dhe për herë të parë iu bë se ashtu po ndjente ngacmimin e asaj që fshihej prapa pjesës së dikurshme, nga e cila thuajse padiktueshëm kishte ikur kahmot për t'iu afruar një tjetre, e cila, sikur pranimin ia kushtëzonte me tagrin e luftimit të tmerrshëm të saj...

Mbase do të rrinte gjatë në atë shi të imët, duke e shikuar mjegullimin e lehtë po të mos e kishin penguar truporjat, që i silleshin pranë me çadra, me ç'rast, tek po kërkonin ta mbronin nga shiu, ato po i dukeshin si varre të mëdha, ku duhej të futej bashkë me ata që i rrinin pranë. Pa thënë asgjë, nxitoi të kthehej sa më parë në tendë, t'u largohej çadrave-varre që iu shfaqen si në ankth. Në tendë një copë herë ndjeu pikëlimin e lehtë të shiut, apo ashtu iu duk, saqë serish u mor me atë përfytyrimin e hapësirës tutje perdes së tejdukshme, që iu shfaq çastin që u ndodh përpara saj... Sesi mendja ia thoshte se atje do të ishte tjetër, pa brenga dhe larg pushtetit të urdhëresave, e mbi të gjitha do të ishte larg hetuesve, larg ushtarakëve dhe larg gjithë atyre që ia kishin marrë qetësinë shpirtërore dhe lirinë... Mund të ishte vetëm dhe të vraponte pas një fluturë... Një çast madje iu bë se po bredhte pas asaj fluturë laroshe, se ajo kalonte gjithë hare nga lulja në lule dhe se ai ndjehej i tillë në atë hapësirë tepër të qetë... Me dëshirë do të ndiqte fluturat po mos të kishte dëgjuar hapat e veqilit, që erdhi dhe i la diçka përpara. Pritueshëm i hapi sytë dhe pa shënimet që duhej t'i lexonte medoemos...

-Perëndi, oshtiu, pse njeriu nuk paska qetësi askund?...

(Shënimi numër një)

Dielli po i afrohej majës së bjeshkë kur pamë Shehrin. Tellallët shqyenin qiellin nga çirret e thekshme për shtetrrëthimin.

-Shtetrrëthimi!

-U vendos shtetrrëthimi!

-Shpallet gjendja e jashtëzakonshme!

-Gjendja e jashtëzakonshme!

Një kohë më oshtiu koka nga këto çirre,që nuk i kisha dëgjuar kaherë. Duhet ta them se më kishte marrë malli për to.

Pararojat na e bënë me dije se hapësira ishte e lirë dhe ne mund t'i zinim pozicionet e parapara përreth Shehrit. Kështu edhe u bë. Hapëm istikamet dhe ngritëm karakollët. Qitem telat gjembor dhe shpërndamë përgjuesit...Të gjitha i ndërmorëm me një shpejtësi thuajse marramendëse, kështu që terri i parë e zuri Shehrin të mbyllur në rrethimin tonë të pakapërcyeshëm.

Po në shehër si do të hymë? Do të na i fusin thikat pas shpine? Do të na vrasin ku të munden?...

Ne ishim të gatshëm për të gjitha dhe e dinim se po i shërbenim Perandorisë dhe jeta dhe vdekja jonë i takonte asaj. Megjithatë, atë natë nuk na trazoi njeri. Me terrin e parë u futëm në Shehër dhe punët na shkuan shumë e shumë më mirë ngaqë kishim pritur.

Hafijet tona, që më kohë ishin futur në Shehër dhe bënë punën e vet, na bënë me dije se hë për hë nuk pritej kurrfarë çrregullimi. Përkundrazi, lajmi i masakrës i kishte frikësuar të gjithë. Me ta dëgjuar atë, i madh e i vogël ishin mbyllur nëpër shtëpi dhe përgjonin se çfarë do të ngjante...

Se me tamam ishte kështu u bindem me të shpejtë, ngaqë rrugët i pamë të zbrazëta dhe dyert ngado të mbyllura. Mendja ma thoshe se ata pritnin të shihnin se çfarë do të ndodhte, në mënyrë që të kundërpërgjigjeshin më vonë... Ne vendosëm postkomandën, hapëm përgjuesit, vumë rojet e para pranë zyrave të shtabit dhe ngritëm tendën blu, në të cilën vendosej qendra e pushtetit ushtarak.

Nga gjysma e natës ngritëm flamurin perandorak.

(Shënimi numër dy)

...Shehri gdhui i shkretë...

Rojat tona dukeshin kudo. Ecnin kujdesshëm dhe të matur. Në shesh Tenda blu shfaqej madhështore. Përballë saj gjithçka tjetër në atë hapësirë germuqej keqas. Prapa hapëm dy ashqihane. Ashqitë tanë të shkathtë qitën përpara kazanët e mëdhenj me pilaf, kaçamak dhe hallvë... Aroma e ushqimeve u përhap me të shpejt, por nuk u shfaq kush të merrte prej tyre. Një kohë të gjatë pritëm që të merreshin ushqimet që ishin falas... Tellallët edhe më tutje njoftonin për shtetrrethimin. Askush nuk do të ketë telashe me ushtrinë, thoshin ata... Ushtria mbron nga e liga... Vetëm armiqtë e Perandorisë mund të frikësohen... Vetëm armiqtë e Perandorisë do të kenë punë me ushtrinë... Ata do të marrin dënimin e merituar... Bujrëm, kaçamak, pilaf, bujrëm!..

Megjithatë, kush nuk doli në rrugë. Kazanët avullonin dhe ftoheshin të paprekur. Frika, na thanë hafijet tona, u kishte hyrë në palcë. Kështu ndodhi edhe të nesërm dhe tri ditët tjera.

Ditën e katër, kur na thoshte mendja se ata edhe më tutje do të rrinin të ngujuar, pamë njërin që po zbriste pazarit me një cjaq të lidhur për dore. Cjapi i kuqërremtë rrinte dëgjueshëm për lakun e të zot dhe i shkonte krahas... Ne e përcollëm një copë herë ngarendjen e njeriut me cjaq në dorë dhe sa më shumë që e përcillnim na bëhej se kishim punë me një të marrë, i cili i bartur nga ndjenja e nuhatjes, kërkonte kazanin e kaçamakut. Askujt nuk ia merrte mendja se ai sillej ashtu që të paralajmëronte ndonjë ogur të ligë. Kur e gjeti sheshin dhe ne po prisnim më në fund ta shihnim dike të tyre të fuste turinjtë në kaçamak, ai u ndal, shikoi gjatë, mori frymë thellë (sikur të tërhiqte gjithë aromën e gjellëve që kishte para) dhe e liroi cjamin nga laku. Bëri, berr, berr dhe cjaqi u nis vetëm. Pas pak kafsha bëri dy-tri kërcime të lazdrueshme dhe kur na e mori mendja se do t'u afrohej kazanëve, u ndal. Shikoi anash dhe pas pak u drejtua kah Tenda blu, së cilës iu soll përreth dy herë. Nga pjesa lindore ne po shikonim me kujdes lëvizjet e cjamin, që po na bëhej gjithnjë e më i dyshimtë, sidomos për mënyrën si lëvizte dhe para çdo hapi kërkonte të zonë, i cili rrinte si i strukur skaj manit në anën perëndimore. Rojet tona një çast deshën ta qëllonin, por ne ua bëmë me dije ta linin të qetë, ngase ishim të bindur se diçka fshihej prapa veprimeve të cjamin.

Cjapi u soll edhe tri herë të tjera rreth Tendës blu. Cingërima e ziles që mbante në qafë po e mbushte sheshin me një ftohtësi të jashtëzakonshme sa që dridhërimat e saj po i ndjenim edhe ne bashkë me ata që fshehtas përgjonin nga të gjitha anët. Më vonë, cjaqi iu drejtua Tendës blu. Nga ajo afërsi pamë një kafshë krenare, me brirë të gjatë që vinte kujdesshëm kah ne, thuajse dëshironte të na thoshte diçka. Mendja më shkoi se si diku kisha lexuar rreth përdorimit të kafshëve për dërgimin e porosive të veçanta, me ç'rast disa prej tyre, siç ishte kaprolli simbolizonte paqen, delja dëgjueshmërinë, kali besueshmërinë, lopa plleshmërinë e

tjera,e tjera,që gjithsesi se lidheshin me kultin e vjetër të popujve barbarë, që kafshët dhe shpezët ngriheshin deri tek hyji. Në disa shënime të tjera të shërbimeve tona të veçanta,që merreshin me hulumtimin e kujtesës së disa popujve që jetonin nëpër krahinat e zhveshura të Perandorisë,lidhja për kafshët nuk shikohej si pjesë e lidhjes së dikurshme me kultin e hyjit, por më tepër shihej si pasojë e shturjes së tyre shpirtërore,me ç´rast kafshët merrnin përsipër disa nga veçoritë që ata nga shkaku i bastardimeve të përhershme nuk ishin në gjendje t´i ruanin, kështu që ato që kujtesa e tyre e megjulluar nuk i nxirrte do, këtë e bënë kafshët... Kishte,vallë të ngjarë, që edhe këtu gjërat kishin arritur deri në atë shkallë që porositë e njerëzve duhet t´i thoshin kafshët?... Kjo më gëzoi dhe për pak se urdhërova që cjaipit t´i bëheshin nderime të veçanta, sikur të kishin përpara përfaqësuesit e parisë së tyre, por u përmbajta paksa kur më shkoi mendja rreth atyre që kisha dëgjuar për këtë vend, ku thuhej se ata e bënë edhe gurin të fliste. Tek e fundit, po të mos ishte kështu, pse do t´i vihej shtetrrëthimi këtij vendi? Po të kishin ardhur në atë gjendje që kafshët t´ua bartnin porositë dhe t´i përfaqësonin para të tjerëve, askush nuk do të merrej me ta...

Ballafaqimi ynë me cjaipin e tyre zgjati një copë herë. Sillej lazdrueshëm dhe luante kokën me kreni. Çfarë kishte ndërmend kafsha?... Kjo pyetje tashmë kishte mbërthyer gjithë ushtrinë tonë, që nga ushtarakët e lartë e deri tek rojat që sillleshin sheshit dhe prisnin urdhrat prej nesh. Si ta kuptonte kërshërinë tonë, më në fund, cjaipi u afrua derës së Tendës blu dhe pasi tërfati krenueshëm, lëshoi një mori kakërdhish. Një kundërmim i rëndë na e zuri frymën dhe aty për aty një breshëri hanxharësh iu drejtuan cjaipit. Gjaku i tij spërkati Tendën blu. Bashkë me gjakun, në shesh u përhap edhe një blegërimë e hekurt. Për habinë tonë dhe të tjerëve, edhe me hanxharët e shumtë në trup,cjaipi nuk u dha. Iku si te kishte fituar fuqi të re. Vraponte i përgjakur, ndërsa zilja i lëshonte një cingërimë tepër të thekshme, që i ngjasonte një kumti të ligë. Ne pamë një curril gjaku që nisi nga Tenda blu dhe vazhdoi përmes Shehrit deri te lumi i tyre. Ushtarët tanë e ndoqën cjaipin deri sa kafsha e mallkuar u humbi sysh.(U fut në lumë dhe nuk doli më, thanë ata gjithë shqetësim).Urdhërova të bëheshin hetime të hollësishme për të parë se çfarë domethënie kishte puna e cjaipit të përgjakur, i cili edhe ashtu me shumë hanxhar në trup humbi pa gjurmë bashkë me të zonë. Urdhërova të shoshiteshin të gjitha rrethanat që këtë rast e bënë njëmend të çuditshëm.

Kajmekami që i dinte ca gjëra të këtushme, një kohë të gjatë që bërë dyllë në fytyrë. Iu qep një kollë e hollë sapo pa gjakun. Nuk është shenjë e mirë, më tha... Do të kemi telashe... Koka e tyre pjell gjithfarë marifetesh... Janë fare të paparashikueshëm...

(Shënimi numër tre)

Ditën e katër mblodhëm parinë dhe u thamë se duhej t´ua bënë me dije qytetarëve se shtetrrëthimi dhe ushtria nuk ishin këtu për të keqen e tyre. Përkundrazi, u thamë se Perandoria përherë mendon për të mirën e tyre dhe se ata armiq të Perandorisë duhet t´i marrin për armiq të vet,ngase ata janë armiq të të gjithëve... U thamë se duhet t´u ndihmojnë autoriteteve ushtarake për t´i gjetur sa më parë ata që bënë masakra. Pa u kapur ata nuk do të ketë qetësi, sepse ata do të bëjnë të tjera dhe të tjera për deri sa ta lajnë vendin me gjak... Me këtë rast u folëm edhe për dëgjueshmërinë që është barrë e çdo shtetasi të Perandorisë. Juve, u thashë, ju bie barra edhe më e madhe ta mbron dhe ta doni Perandorinë, ngase Madhëria e tij, Kryeveziri, Hysen Pashë Ohri, si vendës i juaj, udhëheq fushatën e shtetrrëthimit, me anën e së cilës serish duhet të bëheni hatër i Perandorisë. Ua bëra me dije se Madhëria e tij, Kryeveziri, është fare pranë dhe pret çastin t´i vizitonte. Por para se të ndodh kjo, duhet krijuar rrethanat e përshtatshme,që lidhen me shkatërrimin e armikut të përbashkët, që është futur midis tyre dhe kërkon ta krijojë folenë e të ligës mu aty ku Perandoria e ka zemrën...

Ata heshtën. Rrinin si të ngrirë dhe dukeshin se me heshtjen e akullt dëshironin t´i përjashtonin ato që ua thosha. Heshtën madje edhe kur i pyetëm se mos i mundonte diçka që

nuk e thoshin haptas. Heshtnin dhe shikonin stemën e madhe perandorake që u rrinte përpara. M'u bë se midis atyre shikimeve të pa qartësuar pashë edhe atë të cjapit të përgjakur...

(Shënimi numër katër)

Çarshia më në fund u hap. Ditën e pestë, fare papritmas, rrugët dhe rrugicat e saj vërshuan nga lumi i njerëzve. Para na dolën shumë fëmijë, të rinj por edhe të moshuar... Nuk na kishte rënë të shihnim një vrull aq të madh njerëzor, që kishte shpërthyer përnjëherë. Mos po na mashtronin sytë?... Mbase edhe kjo mund të ishte pjesë e asaj së ligës për të cilën erdhëm këtu?... Jo, jo, nuk po na mashtronin sytë. Ata ishin në rrugë, ishin në sheshe dhe shfaqeshin kudo. Flitnin, qeshnin, çirreshin, thuajse nuk kishte ndodhur gjë. Kjo sjellje madje na shqetësoi. Mos ishte ky ndonjë tjetër ogur i ligë?... Mendja ma thoshte se ata i udhëhiqte një forcë e brendshme, që nuk ishim në gjendje ta hetonim. A nuk mjaftonte kjo për një shqetësim të përmasave të tilla?...

E shikova gjatë turmën dhe bëja sehir. Sa armiq të Perandorisë gjenden në të?... Mbase shumë?... Aq shumë sa mund të besohet se të gjithë i kanë përlyer duart me gjakun e ushtrisë sonë?...

(Shënimi numër pesë)

Filluan burgimet dhe bastisjet. Kryhetuesi na dorëzoi një listë prej dyzet e shtatë emrash. Kini kujdes, na tha, janë shumë të rrezikshëm. Armët i fshehin edhe në gojë. Nëse tash na dalin telashe, më vonë do të humbim në ndonjë pyll, që nuk i shihet fundi...

U morëm vesh që burgimet dhe bastisjet të nisin pas gjysmës së natës për t'u mbyllur para mëngjesit. Gjithçka duhej bërë pa zhurmë.

Në fillim punët na shkuan mirë. Pa ndonjë telashe burgosëm njëzet veta, kryesisht të rinj të moshës pesëmbëdhjetë-njëzetvjeçare. Por, sapo afrohej ferku i mëngjesit ata na iknin, sikur t'i lëshonte toka... Kot i rrethonim. Dhashë urdhër për bastisje të përgjithshme. Edhe ato nuk na i hoqën brengat, ngaqë nga bastisja e përmasave të mëdha ia dolën të kapim vetëm dy veta. Shtatëmbëdhjetë të tjerë serish na ikën. Madje, ca prej tyre çuan dorë dhe na u plagosën shtatë veta, me ç'rast njëri na vdiq rrugës. Më thanë se kur po ndërronte jetë, i gjori, kishte folur si përçartë për një lulishte të madhe që po e shihte. Të gjithë, të gjithë do të shkojmë në atë jeshillëk, kishte thënë...

Ballafaqimi ynë i parë me ta na dëshpëroi. Më doli ajo që parandieja për lidhjet e mira me njëri-tjetrin, kështu që përpara kishim një rrjetë merimange, e cila ishte në gjendje që edhe dridhërimën më të vogël ta barte shpejt e shpejt nga njëri kënd në tjetrin.

Këtë merimangë, u thashë ushtarakëve, duhet ta shkatërrojmë patjetër. Por duhet pasur kujdes që mos ngatërrohemi në të...

(Shënimi numër gjashtë)

E mblodha me ngut parinë. U fola ashpër për gjakun që ende po derdhet. Ua bëra me dije se armiku i Perandorisë nuk do të jepet lehtë, përderisa të gjejë mbështetje tek pjesa më e madhe e popullatës.

Ata prapë heshtën. Rrinin të ngrirë dhe nuk bënë vër me gojë. Heshtja e tyre po më brengos sa edhe vetë armiku, i cili assesi të prajë. Në fund u thashë se do të fitojmë bashkë, ose do të pësojmë bashkë. Rrugë tjetër nuk ka. Me këtë dëshiroja t'ua bëja me dije se nëse ushtria jonë gjakosej, atëherë do të gjakoseshin edhe ata njëmijë herë më shumë...

Ata prapë heshtën...

Pasдите varrosëm ushtarin e vrarë. Ziçri i dervishëve nuk kishte të ndalur. Masa shikonte e ngrirë therjen e shehlerëve para tabutit të mbuluar me flamurin perandorak. Funerali u soll dy herë nëpër Shehër dhe se fundi u ndal në kopshtin e shatërvanit. Ziçri i shehlerëve vazhdoi edhe kur trupi i tij preku tokën e zezë,ku do të mbetej përgjithmonë...Urdhërova që sheshi kryesor të pagëzohej „Sheshi i sheitëv të Perandorisë“. Edhe si i vdekur ushtari perandorak atyre nuk do t’u largohet kurrë nga përditshmëria...Ky do të jetë një dënimi tmerrshëm për ta...

Qenka derdhur gjak,tha Pashai. Së pari gjaku i një cjapi e pastaj gjaku i ushtrisë sonë. Do të ketë gjak,shumë gjak...Gjaku do gjak...Gjak...Gjak...Gjak...

Iu bë se gjaku, që ishte derdhur,po gufonte dhe po gufonte,po përhapje në të gjitha anët dhe së fundi edhe po i futej në tendë. I frikësuar doli jashtë. Ajri i freskët e kthjelloi paksa,por kishte përshtypjen se gjaku po e ndiqte pas. Sytë e lodhur, megjithatë, i zunë retë e ulëta që po ndrydhnin horizontin e gjerë bashkë me përgun e vrojtimit,i cili rrinte si i pikëlluar. Tek po e shihte ashtu,seç i shkrepë një dëshirë e çuditshme të ngjitej në atë majë dhe prej andej të shikonte luginën e përgjumur. Pa një pa dy,me hapa të shpejt u nis drejt përgut. Truprojat, që po i shkonin pas,nuk e dinin se nga po ia mbante dhe çfarë synonte ashtu befas. Para përgut,oficeri i mbikëqyrjes e priti me nderime të mëdha,por fare i befasuar,ngaqë nuk ia kishte marrë mendja se ai vend i vetmuar do t’ia zgjonte kërkshërinë Kryevezirit për t’iu afruar me aq ngut. I habitur dhe i zënë ngushtë, zuri t’i fliste sesi ditë e natë nga ai vend syri i rojeve kap çdo gjë, madje edhe ato që shihen me vështirësi. Oficeri i tha se gjendeshin midis armiqve dhe se syçeltësia luante një rol të madh...Uji fle, e hasmi jo, i tha ai disa herë, i bindur se këtë fjalë mund ta thoshte pa drojë si diçka me të cilën më së lehti dhe më së miri matej besueshmëria ndaj Perandorisë. Por Pashai nuk ia vuri veshin. U nis drejt shkallëve dhe pas pak hetoi se po u ngjitej atyre me nxitim,saqë druri i lagur nën to bashkë me peshën e atyre që i shkonin pas lëkundej frikshëm. Në pikën më të lartë, rojet e përshëndetën sikur të ishin të ngrirë,meqë nuk ishin mësuar që në atë lartësi, e cila rrinte si e shkëputur midis tokës dhe qiellit,të ngjiteshin as oficerët më të thjeshtë e lërë më Kryeveziri. Sikur t’ua kuptonte hutimin,Pashai i madh i shikoi butësisht dhe ua ktheu përshëndetjen fare prajshëm para se t’ia lëshonte një sy luginës që për habinë e të gjithëve kërkoi ta linin vetëm. Oficeri i përgut bashkë me të tjetër u zunë ngushtë dhe shtirëj sikur të mos kishte dëgjuar gjë. Por,kur Pashai prapë ia tha të njëjtat fjalë, zbriti gjithë frikë, ngaqë druante nga ndonjë e papritur...

Pashai nuk po shihte gjë nga ajo lartësi ngasë retë që kishin sharruar poshtë thuajse gjithçka qëllimisht kishin mbuluar. Megjithatë, nga ajo pikë, mendimet ia gjetën vendlindjen. Sado që kujtimi i ishte zbehur (e qartësuar i kishte mbetur vetëm shtëpia e madhe dhe lumi që s’e dinte më sa a ishte lumë apo përroskë), përpara po i shfaqej një qytezë me rrugica dredhake, me shtëpi përdhese me çfarëdo qe përpara që u dilni si sy... Më vonë po i qartësohej edhe një shatërvan midis një çarshie të madhe, ku ngatërroheshin rrugicat dhe derdheshin të gjitha kalimet... Nëpër ato rrugica kishte plot njerëz,që i njihte dhe e njihnin... Sikur i bëhej se ata po e përshëndetnin, se po i afroheshin dashamirësisht dhe se po i i thoshin sa mirë që kishte ardhur e tjera e tjera fjalë dashamirësie...

Dikur,fjalët e fundit, që zgjateshin thekshëm, po i ktheheshin në thekamë,që ia prishën përfytyrimin. I mbeti vetëm klithja miiiii....miiiii, që i sillej furishëm, si marramendje,e cila po i shtoej dhe po i shtoej sa kishte bindjen se përpara po i shfaqej një katrahurë,në të cilën do të zhytej doemos...Çastin që iu bë se marramendja e mundi dhe ai po shkonte kah humnera,ndjeu se dikush nuk po e lente të merrte atë rrugë... Ishte Hyrije Hanmi që po i thoshte diçka rreth rrezikut të lartësisë...

Kur preku tokën, i erdhi të villte. Iu bë se Hyrije Hanmi serish po ia thoshte fjalët se si i duheshin njëri tjetrit dhe i po i ndihmonte të përhumbej. Në atë angështim të bëftë përmendi hiqësinë dhe mallkimin e saj...Gjatë i përsëriti ato fjalë. Hyrije Hanmi e përkëdhelte dhe

mundohej t'ia hiqte sikletin. Pak më vonë kërkoi t'ia sillnin barishtet e veçanta me të cilat harrohej vetja...

Shiu i imët që ra disa ditë më në fund i lëshoi vendin një dielli të ngrohtë, që i dha hov të ri gjelbërimit. Ai shikonte mugullimin e natyrës dhe i bëhej se po zhytej në të, se po futej në një det të pafund gjelbërimi, ku gjithçka ishte e mahnitshme... Por hareja i treste sapo kthehej në tendë dhe shihte shënimet e ushtarakëve që i vinin nga zona e shtetrrrethimit. Në to gjithnjë e më shpesh lexonte për burgimet e shumta, merrte vesh për bastisjet dhe për telashtet që përsëriteshin nga dita në ditë thuajse në të njëjtën mënyrë. Ç'është më keq, aty derdhej gjak. Në njërin nga shënimet e fundit lexoi se ishte vrarë një fëmijë tetëvjeçar. "Ne hapëm fjalët, i shkruante ushtaraku, se fëmijën e vranë armiqtë e Perandorisë për të shtuar mosbesimin ndaj nesh..."

Në një shënim tjetër i bëhej me dije se punët jo vetëm që nuk ndreqeshin, por kishte shenja të shumta që tregonin për shfaqjen e rebelimit të përmasave të mëdha... Vlerësimet gjithnjë e më të ashpra shfaqeshin edhe ndaj parisë së Shehrit si dhe autoriteteve të tjera vendore:

"Nuk po na ndihmojnë fare..."

"Vijnë e shkojnë si të ngrirë... Heshtin si toka... Ngado rrethohemi prej heshtakëve... Ngado heshtakë... Kot mundohemi t'ua nxjerrim gjuhën... Kot... Heshtin dhe me siguri se në kokat e tyre bluajnë shumëçka kundër nesh... Edhe kur ndodh që ndonjëri prej tyre të flasë, atëherë më tepër murmurisin dhe thonë diç nga ato që nuk na duhen..."

"I madh e i vogël i shikonin me sy të keq..."

"Kur na ndeshin rrëzojnë shikimin përdhe... Kudo ftohtësi... Kudo mospërfillje... Kudo armiqësi..."

Edhe shënimi i parë që i erdhi nga Kryhetuesi ishte plot e përplot me ankime dhe mosbesim ndaj gjithçkahes. Dërgesën e kishte pritur shumë më herët, edhe pse ishte i bindur se ai shkaras do t'i shkruante sa për sy e faqe, ndërsa shënimet kryesore do t'ia drejtonte në Kryeshehër drejtpërdrejt Lartmadhërisë me anën e emisarëve të fshehtë që vepronin në përbërje të Shërbimit të Shtetit, që i kishte me vete.

„Allahu i plotfuqishëm robin e vet e krijoi me kokë, me mendje, me trup dhe me ndjenja, që zhvillohen sipas rrethanave të caktuara... Mendja ma thotë se prej kësaj rregulle nuk bën të largohemi dhe kjo duhet të na shërbejë si pikënisje për të gjitha veprimet dhe hetime tona. Pikërisht kështu ia nisa edhe unë. Por, ca gjëra, siç nuk përcjellin rrjedhën e natyrshme të çështjes, po ashtu edhe dalin prej saj... Këtë po e has në këtë vend... Siç e dini edhe nga raportet e ushtarakëve, deri më tash burgosëm shumë veta. Bëmë bastisje dhe ndërmorëm thuajse të gjitha masat që Shehri të mbetej i shkëputur nga bota, ndërkohë që për t'i pasur më të lehta hetimet e duhura, në të njëjtën kohë bëmë ndalimet e përkohshme në vendet e caktuara të atyre që vlerësonim se mund t'i ndihmonin përhapjes së kryeneçësisë. Hiq disa sherre, që janë të rëndomta gjatë veprimeve të tilla të mëdha dhe të thella (fjala është për një ushtar të vrarë e shtatë të plagosur në anën tonë dhe një fëmijë i vrarë e tridhjetë e dy të plagosur tek ata), nuk mund të thuhet se nuk po i përmbushim parashikimet tona. Por, e gjitha është e kotë përderisa armikut t'ia gjejmë kokën, që po e mban të fshehur në dukje, por fare të pranishme në veprime, kështu që edhe kur mendojmë se e kemi afër, na ikën çuditërisht, sado që burgosëm mbi njëqind e tridhjetë veta dhe dy fish më shumë morëm në pyetje bashkë me shumë të tjerë që po i mbajmë në mbikëqyrje të përhershme..."

Letrën nuk e lexoi deri në fund. Ajo iu duk ngulfatëse, ngaqë me ato që thuheshin ishte më se të qartë se Kryhetuesi kërkonte shtyrjen e shtetrrrethimit, që me mbajtjen e gjendjes së tendosur, t'i fuste duart kudo dhe ngado, gjithnjë në emër të mbrojtjes së interesave të Perandorisë. Në të vërtetë, me këtë arsyetim, ai kërkonte koka, kërkonte shumë koka, kërkonte të gjitha kokat e vlefshme të Shehrit dhe të gjitha të tjerat e Vilajetit të

skajshëm që lidheshin me të, që një ditë ajo pjesë e Perandorisë që kufizohej, siç thuhej, me botën tjetër, me botën kundërshtare, të mos ishte në gjendje të ruante vlerësimin e hapësirës tepër të rëndësishme ku puqeshin lindja dhe perëndimi, por të shfaqej vetëm si zonë ushtarake prej nga Lindja do të bëhej gati të shkonte kah Perëndimi pa ndodhë që aty t'i shfaqeshin pengesat e njohura dhe të panjohura, të dukshme dhe të padukshme rreth afërsisë së të kundërtave dhe ndërlidhjeve të tyre me të cilat ruhej ajo baraspesha e dy boteve, që heretikët e merrnin për domosdoshmëri... Iu bë se Kryehetuesi po i përsëriste ato që tashmë i kishte dëgjuar në Kryeshehër nga shërbimet e veçanta perandorake rreth asaj se si duhet të ketë vetëm një botë, që i përket Lindjes dhe assesi pjesës tjetër që lidhet me perëndimin e diellit, që paraqet vetëm terrin dhe errësimin e shpirtit dhe të mendjes dhe se për këtë e vlente të sakrifikohej gjithçka, gjithçka sepse ashtu mbrohej Perandoria bashkë me detyrën për krijimin e njeriut të ri si shprehje e këtij përcaktimi dhe botëkuptimi...

Tek po përcillte këtë gjykim sesi i shkoi mendja se kjo që po ndodhte vetëm pak hapa tendës së tij përkonte edhe me qëndrimin që luftimi dhe shkatërrimi i herezisë patjetër se rrëronte edhe një pjesë qenies së tij, që mbase nuk e kishte vërejtur gjithaq, ngaqë kishte qenë i bindur se ajo si e tillë ishte pjesë e pronësisë së gjithëmbarshme perandorake, e ndërlidhur me të dhe duhej t'i shërbente forcimit dhe assesi dobësimin të saj sa të cilësohej si e rrezikshme dhe armiqësore madje, që nënkuptonte luftimin e saj edhe me anën e një fushate ushtarake, siç ndodhte, të cilës sa për sy e faqe duhej t'i printe ai, por përmasat e saj të njëmendta t'i kryenin hetuesit e shumtë bashkë me ushtarakët dhe shërbimet tjera të fshehta që kishin ardhur me bindjen se aty dhe vetëm aty mbrohej Perandoria nga rreziku i jashtëm që i vinte nga brenda... A nuk thuhej kjo fare troç edhe në vlerësimet e Idriz Allajbeut drejtuar Lartmadhërisë, kur ai „të ligën dhe të rrezikshmen“ e shihte tek shpirti „që ruante prirjet e përhershme për t'u lidhur me mendimet heretike“, për të cilin ai thoshte „se është në gjendje, që edhe pavetëdijshëm për të kërkuar vetëdijesim, që bie në kundërshtim me mendimin perandorak...“ A nuk e vërteton këtë, djallëzisht edhe Kryehetuesi me pohimin se „të gjithë heshtin“, „kush nuk bën vër me gojë“, „bluajnë diçka në kokat e tyre“, „shikojnë me mospërfillje“ dhe tjera dhe tjera, të cilave kur u shtohet edhe ajo se „nuk po ua gjejmë kokën, pa të cilën nuk ka fitore“, është njësoj si të thuash „se kanë lindur dhe duhet të vdesin si armiq të Perandorisë“?... Kryehetuesi këtë e thotë. Ai është i bindur që më parë se këtu urrejtja kundër Lindjes është e lindur, se ajo është pjesë e vetëdijes së tyre, e cila ku më pak e ku më shumë vepron, që do të thotë se atyre nuk duhet besuar, se ata janë të dyshimtë dhe mbesin të dyshimtë, që po ashtu do të thotë se të tillët duhet të mbahen të rrethuar, duhet të mbahen të mbikëqyrur, se të tillët duhet përherë të mbahen në shënjestër, se të tillëve nuk duhet lenë paqe mbi kokë, e mbi të gjitha kujtesës së tyre duhet t'i vihet një mur i madh dhe i përhershëm deri sa të mjugullohet përfundimisht për të qenë në gjendje të pranojë si të vetat vetëm ato që i afrohen nga qendra dhe assesi ndryshe... Me një fjalë ata duhet të kalojnë nëpër pastrimin e luftës së shenjtë... Pra, rroftë lufta e shenjtë!

Lufta e shenjtë?... Këto fjalë i mbetën të ngrira në kokë si kërcënimi i përhershëm me të cilin duhej të pajtohej, gjë që nënkuptonte se ajo për çmim të parë dhe kryesor duhej ta kishte kokën e tij për ç'gjë e gjitha ishte lidhur me atë kurdisjen e magjisë së zezë të ndryshimit me mosdukje që duhej të përfundonte me zhdukje ... Gjithë dëshpërim sytë ia zunë plikot, atë me numër dy dhe atë me numër tre, që i rrinin përpara sikur të ishin aty ta nënçmonin para se t'ia merrnin kokën. Kur do t'u hap?... Kur?...po thoshte...Mbase kurrë ngaqë nuk duhej të mësohej e vërteta?... Ajo kurrë i erdhi si krrokatë, sa ndjeu frikë prej vetvetes dhe prej tyre...Pak më vonë i mori në duar dhe po i rrotullonte sikur t'i luste që të hapeshin patjetër... Në atë gjendje fare të nderë atyre po u fliste rreth asaj se ishte një Kryehetues shumë i fuqishëm, por fare i padukshëm, por i pranishëm kudo... Kryehetuesi, po thoshte, merr koka... Kryehetuesi, vret shpirtin... Kryehetuesi rri mbi mua dhe mbi kokën time, për ta marrë më në fund për ta vu në kamaren e turpit, si plëngprishës... Koka ime e shkrete... Koka ime që nuk vlen për tjetër pos të dëshmohet kundër vetvetes... E shkreta kokë...

I erdh keq që kishte rënë në atë gjendje, por edhe më keq i vinte që këtë më në fund duhej t'ia pranonte vetes...

Ky mendim sikur e çliroi për pak dhe ai ndjeu se ishte fare pranë bindjes kur gjërat duhej t'i merrte ashtu siç ishin dhe të përcaktohej se a do ta duronte atë gjendje, apo do ta kundërshtonte, pa marrë parasysh se çfarë çmimi do t'i paguante?... Kjo megjithatë, nuk i ndihmoi të përballonte mundimin që ia sillnin mëdyshjet, që assesi t'i ndaheshin...

"Mjerë njeriu që nuk është as për luftë e as për paqe, as të durojë, as të kundërshtojë..."

Pak më vonë ndjeu se po i rrotullohej tenda, se bashkë me të po rrotullohej e gjithë bota drejt një prishjeje të pandreqshme. Në atë rremet vetëm plikot rrinin të qeta dhe i bëhej se ia bënin me dije se duhej t'i kryente detyrat që kishte përpara, e pastaj t'u afrohej...

Por, ç'e do që detyrat nuk po kryheshin gjë që kjo ia vazhdonte mundimin që duhej të merrte fund sa më parë në mënyrë që të çlirohej qoftë edhe në atë mënyrë. Ushtarakët ia bënin me dije për burgime të shumta. I shkruanin për bastisje dhe kryeneçësi që nuk kishin fund. Kryehetuesi i fliste për mbajtjen e njëfarë gjendjeje të vazhdueshme të shtetrrethimit deri sa të binin të gjitha kokat e dyshimta e mbi të gjitha përderisa të kapej ajo kryekoka, që thuhej se nga dika drejtonte kryeneçësinë dhe rebelimin shpirtëror kundër bindjes dhe mësimave perandorake, ndonëse gjithnjë e më tepër bindje se ishte për të tijen... Krahës këtyre, ishin edhe të tjerët, që i takonin fushatës, që akoma nuk i kishin raportuar. Kjo edhe më tepër ia shtoi sikletin, ngaqë po afrohej tridhjetë ditshi, kur përpara do t'i shfaqeshin një nga një të gjitha ata me të cilët u pat takuar çastin që do ta shpallte shtetrrethimin dhe gjendjen e jashtëzakonshme në përputhje me udhëzimet e marra nga plikojat me numër një. E merrte me mend se ç'takim i mundimshëm dhe poshtërues që to të ishte ai kur secili do t'i fliste në përputhje me detyrat që kishte dhe atij nuk do t'i mbetej tjetër, pos të thotë shtirazi se shtetrrethimi vazhdohej edhe për tridhjetë ditë të tjera nga shkaku se nuk janë arritur ato që ishin paraparë...

Se do ta shtynte shtetrrethimin këtë e kishte më se të qartë, por zuri të vriste mendjen se si do të vepronte po qe se edhe pas tridhjetë ditëshit të dytë do të dëgjonte të njëjtat fjalë dhe të njëjta arsyetime hipokrite?... Për këtë nuk kishte menduar shtruar, por ishte i bindur se shpejt do të vinte dita, kur ushtarakët do t'i thoshin troç se armiku nuk ishte mundur, se ai vepronte, se ai shfaqej gjithnjë e më i paparashikueshëm e të tjera e të tjera, ndërkohë që Kryehetuesi me finokëri do t'i fliste për kokën që nuk e kishte gjetur, por që gjithsesi se ishte midis tyre e që duhej medoemos të gjendej për të marrë fund njëherë e mirë kryeneçësia shpirtërore dhe ajo herezia që binte ndesh me mësimet perandorake... Kadiasçeri do t'i shpjegonte serish rreth atyre që dinte për të burgosurit, për të dënuarit dhe për mënyrën e re të mbajtjes në vetmi „në emër të ruajtjes së sigurisë“ së Perandorisë, që u nënshtroheshin njerëzit e dalluar... Me një fjalë, të gjithë do t'ia thoshin të njëjtën gjë rreth asaj se si vazhdon armiqësia, se si vazhdon heshtja, do t'i thonë se kryekoka nuk duket kund, e të tjera e të tjera... Madje, edhe Hyrije Hanmi do t'ia thotë të njëjtat fjalë (por kur do të ballafaqoheshin), ndërkohë që ai do të shtirej se i dinte të gjitha, se err e terr njësoj ndjente të njëjtat mundime dhe do të vazhdonte të hidhte nënshkrimin për fundi urdhëresave dhe letrave të tjera me të cilat veprime pa qenë në gjendje të shihte përmasat e atyre që ndodhnin dhe bëheshin me emrin dhe nënshkrimin e tij...

Ky mendim sikur e tmerroi dhe bëri që për herë të parë të ndjehej vrasës i vetvetes...

Medet! – oshtiu dhe u shemb sikur të mos ishte.

Në sexhaden e butë ndjeu vetën jashtë asaj fyerje dhe atij mallkimi të tmerrshëm, që nuk po e lente të qetë. Deshi t'i jepej harrimit, por i shtrirë ashtu, seç iu bë se po shihte cjamin e përgjakur, që kishte brirë të mëdhenj sa përthekonin gjithë taborët e shtrira përreth dhe madje degët e tyre po i afroheshin edhe atij bashkë me cjamin, i cili megjithatë po e shikonte butësisht dhe sikur dëshironte t'i thoshte diçka... A thua kafsha përnjëmend sillte ndonjë porosi që njerëzit e tij nuk kishin si t'ia thoshin?... Kishin shkuar punët deri aty sa nuk kishte

mënyrë të tjera të shpjegohej tmerri që ndodhte?... Shumë pyetje të tilla po i silleshin në kokë dhe ato po e turbullonin edhe më sa iu bë se dikur cjapi treti, por që një qenie tjetër, që nuk e shihte, e kishte pranë... Mendja i shkoi te plakati e padukshme dhe një çast gjykoj se mund të ishin pikërisht ato që po i rrinin pranë dhe po i thoshin diçka për njëfarë uji që duhej ta kalonte patjetër për të shpëtuar nga ajo gjendje e rëndë bashkë me ata që ishin lënë në mëshirën e pamëshirë ushtarakëve dhe hetuesve të panumërt... Fjala uje po i vinte si shushurimë, e herë-herë, si vërshim, që ia mbushte tendën, por edhe që do të duhej t'ia bënte me dije domosdonë e lëvizjes, asaj lëvizjeje me të cilin ndryshohet gjendja e pashpresë... Ndjente se tenda po i mbushej me ujë, me një ujë të turbullt, që vinte nga të gjitha anët dhe se ai mund të mbytej pikërisht nga shkaku i mungesës së lëvizjes, pa marrë parasysh se çfarë do të ishte, por edhe ngurrimi që ajo të pranohej, bëri të çirrej për ujin si për diçka me të cilën lidhej çlirimi nga gjendja e rëndë... Kur u përmor pa se ishte i mbytur në djersë, ndërkohë që heshtja shurdhe barte thërrmitë e një mendimi të dromcuar që i bëhej se ia formësonte kuptimin rreth domosdosë së ballafaqimit me njohjen e vetës...

Po dridhej. Zuri sytë me duar që të mos shihte gjë. Kishte frikë nga ato që iu bë se dëgjoi dhe një copë i mbeten në kokë si përplasjeje të çuditshme... Përballë asaj përpëlitje kishte frikë t'i hapte sytë, e frikë kishte të rrinte edhe me perden e territ që ia vuri vetes, ngaqë njësoj e mundonte qartësimi si dhe mosqartësimi i asaj që kishte dëgjuar rreth ballafaqimit me njohjen e vetvetes, me qenien e ndrydhur... Në atë gjendje të mpirë nuk e dinte se çfarë duhej të bënte?... Megjithatë, mendja ia thoshte se më shumë i ndihmonte terri se drita, ku do të gjente ngushëllim nga lutjet, me anën e të cilave, mendja ia thoshte se mësimet e shenjta i ndihmonin ta përballonte të ligën... Kjo për pak sikur e qetësoi dhe ishte gati t'u jepej lutjeve, por sesi i shkoi mendja se këtu nuk kishte të bënte me të ligën, por me sprovën e ballafaqimit me vetveten për të qenë në gjendje t'i kundërvihej të ligës nga jashtë, që ishte ngritur atëtinëzist deri tek përmasat e një herezie të përgjithshme... Por, a kishte vallë fuqi ta bënte këtë?... Mendja po i megjullohej sa më shumë që kërkonte t'i afrohej këtij qartësimi, që patjetër se nënkuptonte edhe çështjen e asaj lëvizjeje, që iu bë se ia paralajmëruan plakati e padukshme... Por, ç'ishte lëvizja që i bëhej se i erdhi si përfitim i porosisë nga plakati e padukshme dhe si mund të shfrytëzohej ajo, për ta kthyer në kahen prej nga i ikej shkatërrimit?... Kjo çështje e sillte përpara një gjendjeje tjetër, kur duhej ta shpërqendronte një energji të jashtëzakonshme nga njëra anë në tjetrën, që ai nuk do të mund ta bënte edhe po të kishte mijëra dhe mijëra të tjerë me vete... Atë energji e kuptonte, meqë ndodhej në majat e saj, por nuk e drejtonte dot, pos që i shërbente asaj... Kjo, sikur ia mbylli të gjitha dyert. U ndje atë keq sa nisi, ashtu me çapitje të ngatërruara të kërkonte ndihmë, edhe pse nuk e dinte se çfarë duhej të ishte dhe prej nga do t'i vinte?...

Atë natë foli përçarhtë rreth lëvizjes si fuqi dhe fuqisë si lëvizje, pa ditë as vetë pse ato mendime i ishin qepur dhe pse i silleshin ashtu të shkëputura dhe kështu ndodhi përderisa erdhi Hyrije Hanmi dhe e mori në tendën e saj dhe e pravulliti me avullin e luleshqerrës dhe me barishtet tjera që i ruante vetëm për të. Megjithatë, ai plot dy ditë nuk erdhi në vete. Murmuriste diçka për njëfarë uji të turbullt dhe zinte n'gojë një cja të përgjakur dhe brirët e tij të mëdhenj në të cilët e mbante botën... Por, edhe kur i kaloi ankthi, rrinte si i ngrirë dhe nuk e ndihmonin përkëdheljet e Hyrije Hanmit, të cilat rëndom bënin t'i kthehej hareja e herëpashershme e trupit bashkë me afshin, i cili kur shpërthente, bëhej i papërmbajtshëm... E brengosur për gjendjen e tij shpirtërore, Hyrije Hanmi, për herë të parë i foli për nevojën e mjekëve, që duhej ta vizitonin medoemos. Por ai, me të dëgjuar për ta, tha se në vend të shërimit i duhej harrimi, një harrim në të cilin do të zhytej i tëri dhe përgjithmonë... Duhet të bëhem i paqenë, i tha Hyrije Hanmit, për të shpëtuar nga mundimet që nuk i ka kush...

I ngrirë dhe fare i pandjenja Pashai u duke edhe ditëve të tjera, e thuajse në atë gjendje e priti edhe të tridhjetën, ditën që sa për sy e faqe duhej të shtirej se merrej me denjimin e vendosjes të heqjes apo të mos heqjes së shtetrrëthimi. Mirëpo, çastin që pa se si po hynin ushtarakët e heshtur, ndërsa pas tyre shkonte Kryehetuesi, kadiasqeri,

kryenixhinieri, serasqeri, shpjeguesi i ëndrrave, kronisti dhe Hyrije Hanmin, që me të shpejt zunë vendet e veta (në njërën anë ushtarakët e në tjetrën të tjerët), befasisht hoq ngrirja. Ndjeu se doli nga të mërdhëturit dhe denjoi se ngecjen, që për pak ia kishte ndaluar të menduarit, e kishte nga shkaku se nuk kishte qenë në gjendje të gjykonte siç duhej rreth çështjeve të lëvizjes së fuqisë dhe fuqisë së lëvizjes me të cilën do t'u kundërvihej atyre që po i kurdiseshin nga të gjitha anët. Kështu, sa ora solli ndërmend thujtja të gjitha shënimet e ushtarakëve, atë të Kryehetuesit dhe ca letrat të tjera që i kishte marrë nga myderrizët dhe ulemaja. Këta të fundit i shkruanin për çështjet që lidheshin me moralin dhe shpirtin, me theks te veçantë te fenomenet e thashethemeve dhe të paraqitja e herëpashershme e njëfarë cjadi, i cili në atë mes luante një rol të çuditshëm... Ndryshe nga shënimet e ushtarakëve, ku për cjamin flitej si për „një variant taktik të armikut që fuste në përdorim edhe kafshët e ushtruara mirë për të arritur qëllime të caktuara“, myderrizët shtronin mëdyshje, që kishin të bënin me ngatërrimin dhe ndërlikohen e instinkteve njerëzore tek shtazët dhe atyre të shtazëve tek njerëzit në masën sa e para bëhej mbizotëruese tek të dytët dhe e dyta mbizotëronte tek të parët...

„Po qe se njerëzit gjejnë gjuhë të përbashkët me kafshët dhe përmes tyre dërgojnë porosi, atëherë të arsyeshme janë masat, sado të egra qofshin, që kanë për qëllim të shporrin shtazarakën nga njerëzorja dhe njerëzoren ta largojnë nga shtazarakja...“

Me një fjalë, sipas myderrizëve, shtettrrethimi duhet ta bëjë këtë pastrim dhe çdo gjë duhej të shkonte kësaj rrjedhe e të zgjasë përderisa të vërtetohet se shtazarakja është larguar nga njerëzorja apo është zvogëluar për aq sa përherë të mbikëqyret nga kjo e dyta...

“Por edhe po qe se vërtetohet se përmasat midis njerëzores dhe shtazarakes janë në dobi të së parës, kur shtazarakja përdoret për qëllime të caktuara, atëherë edhe me këtë rast shtettrrethimi e arsyeton veten bashkë me masat që e përcjellin atë...”

Kështu, ulemaja, kërkonin që rreth kësaj çështjeje të ngrihej një trup i veçantë, i cili do të merrej me hulumtimin e mëturjes së mirës dhe të keqes si dhe përmasat e tyre në rrethanat e shqetësimeve të mëdha, siç ishin këto të fundit në mënyrë që Perandoria të gjente ilaçin e mbrojtjes...

Një copë herë mendimet e shpëputura iu përplasen nëpër kokë, ndërkohë që herë pas herë ua lëshonte sytë atyre që i rrinin pranë dhe prisnin t'u jepej leje të flisnin për t'i thënë ato që ai tashmë i merrte me mend se çfarë ishin. Në atë përpëlitseje zvarritëse, iu bë se ata dukeshin të padurueshëm dhe kjo i pëlqeu. Andaj vazhdoi t'i përcillte me shikim që ta hetonte sa më mirë këtë ndjenjë. Për ta sforcuar atë edhe më tepër, kapi letrat që kishte përpara dhe po i shikonte fare me mospërfillje, si gjëra të pavlefshme. Mendja ia tha se kështu ata ndjeheshin të shqetësuar, gjë që mund të ndikonte tek qartësia dhe demonstrimi i parashtrësive që kishin bërë gati dhe duhej t'i thoshin sikur të ishin gjëra që vetëm duhej të dëgjoheshin dhe të pranoheshin siç shtroheshin dhe assesi ndryshe. Dikur, shikimi i zuri fytyrën dinake të Kryehetuesit dhe u ndal me qëllim tek ajo saqë hetoi se ai dridhej nga shqetësimi që ia kishte sjellë pritja. I erdh mirë që mbase ashtu sado pak ia kishte dalë t'i shqetësonte ata që i luanin pas shpine, që ai tashmë fare mirë e dinte se ishin pjesë e gjithë asaj kurdisjeje që vepronte kundër tij. Këta janë urith të neveritshëm, i tha vetit...

“Mendojnë se koka ime duhet të mbetet e mallkuar mu aty ku lindi, që me këtë të ndërpritet drejtimi i Perandorisë prej atyre që trupin e kanë në Lindje e kokën në Perëndim?... Të tillët përhapin thashetheme se si fryma e „Tokës së Lashtë“ e ka pushtuar Perandorinë nga majat e saj, prej nga një ditë atë do ta kthejë në një krijesë laramane as mish e as peshk...”

Tek po i sillte ato mendime, nën gishtat e tij letrat kërcisnin gjithë vrazhdësi dhe me këtë sikur dëshironte t'ua bënte me dije se i dinte të gjitha, se nuk do të rrinte përherë peng i kurtheve të tyre dhe se beteja midis tyre sapo kishte filluar dhe se epilogu i saj ishte fare i hapur...

Me atë bindje dhe paksa i trimëruar nga mendimi se nga brendia po i shkëndijonin prirjet për kundërvënien, gjatë shumë gjatë i solli letrat nëpër duar dhe vetëm kur hetoi

parashenjat e mjegullimit, me të cilin i paralajmërohej ankthi i rëndë, fare qetas kërkoi prej tyre t'i thoshin ato që duhej t'i thoshin, por pa u zgjatur me hollësitë e panevojshme dhe gjërat e tepërta që tha se nuk hynin në punë.

Fjalët e fundit, që i nxori aq mospërfillshëm, duket se tek të pranishmit shkaktuan huti edhe më të madhe se sa pritja e gjatë me të cilën u ballafaquan, nga shkak i vetëm se që të gjithë kishin pritur fjalë mirënjohëse, ku do të lavdëroheshin përpjekjet dhe sakrificat e tyre për të mirën e Perandorisë dhe do t'u paralajmëroheshin edhe mirënjohjet që i pritnin në Kryeshehër... Kjo vlente veçmas për ushtarakët, të cilët nuk mund ta merrnin me mend se takimi i tyre me Vezirin e madh të fillonte pa leximin e një urate për ushtarët e masakruar dhe të tjerët që ranë në përpjekje për ta mbikëqyrur shtetrrëthimin dhe gjendjen ushtarake dhe pa marrë ndonjë urim lidhur me ato që kishin bërë, pa të cilat të tjerat as që mund të fillonin. Bile edhe Kryehetuesi dinak, që tashmë e kishte të qartë dyshimin ndaj veprimeve të tij, që kishin të bënin me lidhjen e drejtpërdrejtë me Lartmadhërinë, së paku për hir të këtij fakti, që kishte domethënie të madhe hierarkike, priste ndonjë vlerësim për punën e palodhshme të hetuesve të shumtë, të cilët nuk bënin gjumin gjumë që me përpjekjet e tyre të pareshtura, të cilat pasqyroheshin me dhënien e urdhrave për arrestime, atyre për bastisje dhe mbajtjen në vetmi të personave të dyshimtë dhe të rrezikshëm, t'ia ngushtonin hapësirën armiqve të perandorisë, gjithnjë duke rrezikuar edhe kokën... Të njëjtën gjë kishin pritur edhe kadiasqerët, të cilët nuk pranin me mbajtjen e proceseve të njëpasnjëshme, ku thuajse nuk kalonte ditë pa u dënuar me dhjetëra veta me burgime të gjata... Ata sa nuk po i thoshin: ne kemi punë edhe me fëmijët... Dënojme edhe ata që u qet buza tëmbël...

I kënaqur që më në fund paksa po u hakmerrej atyre që i kishte për kundërshtarë, për të dytën herë përsëriti fjalën „nisjani“ dhe shikimin e drejtoj kah ushtarakët. Të zënë ngushtë, ushtarakët e dinin se duhej t'ia nisinin disi dhe ai që duhej të fliste ishte komandanti i zonës së rrethimit, por nuk kishin pritur që raportimi të fillonte në rrethanat e një ftohtësie të tillë. Më në fund, ai që e merrte me mend se ia dërgonte raportet nga Shehri, u ngrit gjithë përtesë dhe pasi përshëndeti, zuri të fliste për mënyrën e rrethimit, për shpërndarjen e postkomandave e deri të gatishmëria për të kryer çdo urdhër që lidhej me ato që parashihte fermani. Ai vazhdoi të fliste se si veprimet e bëra ishin të përpikta dhe të matura, ashtu siç e kërkonin rrethanat. Tha se ushtarakët kishin tejkaluar me shumë suksese sprovën e parë, atë më të vështirën, edhe përkundër asaj se ishin ballafaquar me masakrën dhe vrasjen e ushtarëve, dhe se edhe më tutje do të vazhdonin të vepronin në përputhje me detyrat që kishin...

Fjalimin e thatë e më shumë përsëritje e mbylli me zotimin se „ushtria nuk do të tregojë kurrfarë shenjash të lodhjes apo të shqetësimit edhe po qe se do t'i urdhërohet të mbetet këtu gjatë, shumë gjatë... Për ne ruajtja dhe mbrojtja e Perandorisë është detyrë e shenjtë për të cilën nuk kursehet as jeta“.

Edhe pasi mbylli fjalimin dhe priste t'i jepej leja për t'u ulur, Kryeveziri e la të presë komandantin e zonës së rrethimit, sikur dëshironte t'ia bënte me dije se nuk kishte ndërmend të hiqte dorë nga shtirja e mospërfilljes për të cilën ishte përcaktuar. Për ta vazhduar qëndrimin e nisur Veziri i madh serish zuri t'i maste me shikim ata që i kishte përpara dhe prisnin të flisnin sipas radhës. Tash ato fytyra po i dukeshin edhe më të mbyllura dhe më të paparashikueshme. Pas një bredhjeje, shikimi iu ndal te Kryehetuesi dhe pa folur fare i dha shenjë me dorë që të ngrihej.

Kryehetuesi u zu ngushtë. Nuk kishte pritur se dikush (qoftë edhe Kryeveziri) do t'i drejtohej me aq mospërfillje. Këtë hutim ia tregoi fytyra thatake (që iu bë si e pajetë) dhe ia shfaqen edhe duart e vogla, të cilat po i dridheshin papërmbajtshëm. I bindur se nuk kishte nga t'ia mbante (edhe pse kishte pritur se do të paraqitej i fundit për t'i dhënë kapak bisedës), u ngrit dhe nisi të fliste se si puna e tij dhe e gjithë hetuesve të tjerë, që kishte nën mbikëqyrje, nuk kishte filluar çastin e shpallje së shtetrrëthimit, por qysh në Kryesheher...

Këtu i mbeti fjala në gjysmë. U përpi disa herë si të kërkonte të tërhiqte pas ato që tashmë kishte thënë e nuk duhej t'i thoshte fare... Pashai hetoi se ai ishte zënë në kurth dhe tash po bëhej gati ta ndreqte disi atë që e kishte prishur nga zemërimi i pashoq.

-Pra, zuri të belbëzonte Kryehetuesi,- pra, këëëtëëë punnnëëë tejet të rëndësishme ne e morëm me shumë përkushtim, si edhe të gjitha të tjerat, ngaaaqëëëë e dinim se çfarë do të thotë për Perandorinë çrregullimi i rrethanave në një pikë tejet të rëndësishme siç është kjo, ku shekuj e shekuj kaloi kufiri i dy boteve, i dy besimeve dhe i kundërshtimeve të papajtueshme, që shkojnë edhe deri tek përkufizimi i të mirës me të keqen dhe anasjelltas... Pra, çastin që u shpall shtetrrëthimi me fermanin e plotfuqishëm, ne ishim të gatshëm të jepnim çdo gjë, madje edhe shpirtin... Këtë gatishmëri dhe përkushtim e kemi edhe tash dhe do ta kemi përherë, pa marrë parasysh se çfarë do të jetë vullneti i armikut që të ecën me të vetën... Ne kemi detyrë ta gjejmë, ta kapim dhe ta shkatërrojmë...

Fjalët e fundit Kryehetuesi i tha të ngjyrosura ashtu sa Pashait iu bë se po ia drejtonte atij. Ishte e qartë se dëshironte të hakmerrej aty për aty ndaj mospërfilljes që i ishte bërë. Por, meqë Kryeveziri nuk po i jepte shenjë të ulej, kuptoi se duhej të fliste edhe më tutje. Pas një pushimi të shkurtër ai vazhdoi:

-Armiku, siç thashë dhe siç e dimë të gjithë, (dhe për këtë kemi pasur rast të bindemi mirë e mirë gjatë këtyre ditëve), pra armiku, ka vullnet të madh për të vazhduar me të veten, pa marrë parasysh se jemi këtu dhe nuk do të ndalemi në gjysmë të rrugës. Tek e fundit, një fjalë e tyre e urtë thotë se uji fle, e hasmi nuk fle... Kujtoj se kjo u përshtatet rrethanave tona dhe këtë duhet ta kemi më se të qartë...

I bindur se ishte gjykuar të fliste edhe më tej, por që kjo nuk duhej të merrej përherë si një shtirje apo tërheqje e panevojshme, por edhe si kundërvënie, që duhej bërë kujdesshëm, Kryehetuesi vazhdoi të fliste rreth asaj se si armiku po i përdorte të gjitha mjetet e mundshme kundër Perandorisë për të dëshmuar se ndeshja me të ishte diçka e pritur dhe e pashmangshme, ishte si një sprovë që duhej të pasqyronte në njërën anë besimin tek bindja se besimi i tyre kishte mbledhur si shumë fuqi gjatë kohës së sjelljeve të zbeta të Perandorisë ndaj tyre dhe në tjetrën anë të shprehte epërsinë dhe vazhdimësinë e mësimave heretike rreth domosdosë së l a r a m a n i s ë si puqje e të kundërtave dhe pathyeshmërinë e saj dhe përkundër rrethanave të reja të cilat e përjashtojnë atë tërësisht... Pasi që vazhdimësinë e armiqësisë e lidhi me një përcaktim të përhershëm, ai tha se fjala ishte për një bindje që kishte kaluar në vetëdije.

-Na pëlqeu apo nuk na pëlqeu kjo,-tha Kryehetuesi,- e tillë është gjendja. Çfarëdo vlerësimi tjetër do të na mashtrojë jo vetëm ne, por edhe Perandorinë. E, për mashtrime nuk kemi nevojë. Mjaft jetuam me to dhe na sollën në këtë gjendje, gjë që tash mund të thuhet se gjendja e shtetrrëthimit në këtë anë nuk është dashtë të hiqet asnjëherë as kur ua futëm në dorë kështjellat e fundit e as kur pranuan nënshtrimin dhe thanë se pranojnë besimin tonë. Është dashtë t'i mbajmë nën mbikëqyrje të përhershme prej nga do t'u hiqej nga koka dhe shpirti herezia dhe jo të ndodh që ajo t'u forcohet edhe më tutje me anën e përshtatjes, që dinë ta shfrytëzojnë aq mirë në përputhje me qëndrimin që të marrin sa më pak dhe të ruajnë sa më shumë... Po të vepronim kështu, në vend se pas njëqind e sa vjetësh, të rrinim të brengosur dhe të vraponim ditë e natë pas armikut që ka lëshuar rrjet ngado, do të merreshim me çështje të tjera më të rëndësishme...

Ndoshta e zgjata paksa, por njerëz jemi, nga mishi e gjaku dhe na ka hije edhe dëshpërimi, që assesi nuk bën të na thyejë, por të na japë forcë të ecim tutje gjithnjë duke i ndrequr gabimet e djeshme, në mënyrë që të nesërmen ta kemi më të lumtur dhe më të qetë...

Kaq pata. Allahu na ndihmoftë të kthehemi faqebardhë!“

Pashai, që më pak e kishte dëgjuar e më shumë ia kishte shikuar sytë që i lëviznin herë djathtas e herë majtas, nuk i dha izë të ulej. E shikoi një copë herë mospërfillshëm, sikur t'ia bënte me dije se nga ai kërkonte ato që ruante për të tjerët. Pas një heshtjeje i tha se ato që kishte thënë ishin si shumë të përgjithësuara dhe se kërkonte të dhëna të tjera për të dëshmuar

gjestet e shprehjes së armiqësisë praktike dhe jo asaj që kishte të bënte me gjykimet që diheshin dhe i takonin vetëm Këshillit Perandorak, pra që udhëhiqej prej tij dhe mbikëqyrej nga Lartmadhëria.

Kryehetuesit iu ndërrua çehereja. Sytë që deri pak më parë i lëviznin si në ujë, iu ngrinë dhe fytyra, që nxirrte buzëqeshje të tharat, iu bë dyllë. Nuk kishte pritur që aty së pari do t'i zhvleftësohej puna dhe pastaj do t'i shtroheshin edhe aso pyetje me të cilat i kërkoreshin hollësi, që mund të thuheshin vetëm në katër sy. Njëfarë tërbimi po i sillej hovshëm, por bënte përpjekje të përmbahej, pa marrë parasysh besimin e madh që kishte nga qarqet e larta perandorake që merreshin me çështjet e sigurisë dhe autorizimet e mëdha që sillte prej andej. Kryeveziri, megjithatë ishte mbi të dhe mbi shërbimet tjera të besueshme, që njiheshin dhe nuk njiheshin dhe këtë duhej ta kishte parasysh. I përballuar me këtë gjendje, që nuk ia kishte marrë mendja se do të ndodhte, për herë të parë i shkoi mendja se autorizimet sado të fuqishme që ishin, me asgjë nuk duhej t'i jepnin shkas Vezirit të madh të dyshonte në të dhe punën e tij. Përkundrazi, ato duhej t'i përdorte ashtu që t'ia gërryente dhenë nën këmbë pa marrë vesh gjë. Çështje e vërteta, kur po nisej, i kishte shkuar mendja tek telashet që mund t'i dilnin me Pashain për atë se ai vinte nga ky Shehër dhe, sado që ai interesin e Perandorisë e vinte mbi gjithçka, nuk do të pajtohej me prapaskenën e fushatës, nëse ajo do të bëhej tej mase. Mënyra se si po sillej ai tash, ia bënte me dije se Pashai jo vetëm që nuk ishte shkëputur nga ndjeshmëria për vendlindjen, por kërkonte ta mbronte atë me çdo kusht, edhe pse me këtë rast do të duhej ta sulmonte i pari... Këtë deshi t'ia thoshte Pashait, por u përmbajt, ngaqë ishte nën urdhrin e tij dhe çfarëdo aludimi në këtë drejtim mund t'ia vështirësonte edhe më gjendjen sa t'i shkojë edhe koka. Ato që e mundonin duhej t'i ndrydhte, t'i shoshiste me vetveten dhe t'ia thoshte personalisht Lartmadhërisë, sapo t'i jepej rasti, nëse kjo do të ndodhte fare. Kjo ndjenjë frike për herë të parë i solli të dridhura turpit dhe i bëri me dije se Kryeveziri ishte Kryevezir pa marrë parasysh gjendjen në të cilën ndodhej dhe pa marrë parasysh prapaskenat që i kurdiseshin nga qarqe të ndryshme, qofshin ato edhe me arsyetime nga më të qëndrueshmet, siç ishin rreth rrezikut që Perandorisë i kërcënohej nga vezirët dhe pashallarët që vinin nga vilajetet e skajshme, që shtriheshin aty ku puqej Lindja me Perëndimin, të cilave ai u besonte dhe shpresonte që një ditë t'i shihte të ngritura deri tek niveli i pandehmës së herezisë, me të cilat do të ngarkoheshin ata për përgjegjësi të drejtpërdrejt, që jo vetëm do t'i rrënonte nga froni më i lartë perandorak, por përgjithmonë do t'i mbante larg tij gjithë ata që me aq vullnet gjejnë mundësi t'i afrohen dhe ta pushtojnë, siç ishte edhe Kryeveziri i fundit, Hysen Pashë Ohri... Vetëtimthi i shkoi mendja tek betimi i dhënë në Kryeshehër dhe kjo e trimëroi paksa. Por, për të tejkaluar atë gjendje, megjithatë duhej të thoshte te diçka. Duhej të fliste ashtu që mishi të piquej e helli të mos digjej dhe kjo po e ballafaqonte me mundimin se si duhej bërë këtë aty për aty që të mos rrënonte të gjitha urat e prishura me Kryevezirin, por edhe të mos nënshtrohej tej mase?... Edhe përkundër sikletit që po i lidhej mendja ia tha se nuk ishte ngritur kot në atë post dhe se puna e donte që përballë gjendjeve të rënda që i vinin pa pritur duhej të gjente zgjidhje të atypëratyshme që do t'i mundësonin vazhdimin e punës së nisur. Tek e fundit a nuk i mësonte ai hetuesit se njeriu i këtij zanati mund të ndërronte sa ora një mijë fytyra që të mbrohej ajo e vërteta, e cila nuk bënte të hapej? Dhe, aty për aty iu kujtua fletorja e Poetit të masakruar ditë më parë në kështjellë. A nuk ishte ajo e fuqishme për t'u përdorur si armë e fundit?...

Kryehetuesit iu kujtua çasti kur i thanë se gjatë bastisjeve të fundit që iu bënë autoriteteve të Shehrit (veçmas atyre që merreshin me krijimtari), hetuesit kishin gjetur një fletore, në të cilën Poeti kishte hartuar një ditar, që e kishte quajtur „Jeta në kohën e shtetrrëthimit“. Kuptohet se Poeti nuk kishte dëshiruar që ditarin t'ua jepte hetuesve. U kishte thënë se „meditimi ishte çështje personale, që nuk u nënshtrohej hetuesive...“ Hetuesit, që nuk kishin qarë kokën për arsyetimet e Poetit, e kishin bërë të veten dhe ia kishin marrë ditarin me dhunë dhe i kishin thënë se ato shkarravina nuk ishin për tjetër pos për argëtim publik... Poeti i tërbuar nga fyerjet që ia kishin bërë asaj që ai e quante „pjesë të shpirtit“, hetuesit i

kishte quajtur xhelatë, vrasës dhe çmos tjetër, që vinin me detyrë për ta shkatërruar atë që nuk mund të shkatërrohet me dhunë, gjë që atyre, siç kishin pritur, u kishte dhënë rast për ta arrestuar. Ishte gjysma e natës kur e thirrën me ngut në kështjellë me arsyetimin se kishin një peshk të madh në dorë... Ishin të bindur se Poeti ishte njëri nga ata të cilët mund t'i takonin kokës, asaj koke që e kërkonin kudo me aq ngulm ditë e natë... Që veshur e mbathur me përtesë, sepse e dinte fare mirë se Poeti për të cilin flitej nuk mund të ishte tjetër pos një i mjerë si gjithë poetët, të cilët ai i quante tuhafë bjerrakohës, që nuk meritojnë vëmendje. Madje, ai kishte një mendim edhe më fyes për poetët, që nuk guxonte ta thoshte haptas nga shkaku i udhëzimeve që kishte se edhe poetët duhej të merreshin si armiq. Edhe pse në shërbim gjithnjë dëgjonte të thuhej se si poetët përherë duhej mbajtur në shënjestër dhe herë pas herë e lyp puna të frikësohen në mënyrë që të mos merren me „çështje të mëdha“, por të mbesin në nivel të xhingliminglave, me këtë qëndrim nuk ishte pajtuar asnjëherë. Në vend se t'i frikësonte, jo rrallë i tallte dhe këtë e bënte me anën e nënçmimit të punës së tyre... Megjithatë, këtë herë, gjërat duhej t'i merrte ndryshe, meqë edhe me hoka dhe shaka të rëndomta hapeshin mendimet armiqësore... Çështja e cjapit kishte bërë që çdo veprim i tyre të merrej si i dyshimtë dhe t'i nënshtrohej shqyrtimeve të holla...

Kur hyri në shkalloren e errtë të bodrumit të kështjellës, era e pishës dhe e tymit ia zunë frymën. Në pjesën e fundit pa një të lidhur të shkallmuar keqas. Currilat e gjakut në trup i qenë ngrirë, ndërkohë që as fytyra nuk i shihej. Këtë e merrni për të rrezikshëm, u pat thënë hetuesve?... Ata, të djersitur si ishin, mend plasën nga dëshpërimi. I thanë se ishte poet, se madje ishte poeti më i rëndësishëm i Shehrit dhe se kishin bërë mjaft mund deri sa e kishin hequr për gjuhe që t'u jepte shkas ta fusnin në dorë... Ky nuk është as i rrezikshëm e as i gjallë, u tha. Mëkat që nuk do të shkruajë më shkarravina me të cilat do të argëtohet mileti... Hetuesit e shikuan me habi dhe i thanë se Poeti, deri pak më par, përkundër mundimeve të mëdha që ia bënin, fliste. Na fyente zi e më zi, i thanë Kryehetuesit. Na thoshte se shpirti nuk shkatërrohet, përkundrazi me vuajtje dhe mundime vetëm sa forcohet dhe fisnikërohet... Andaj, si të vepronim me të ndryshe, kur edhe si i lidhur ia doli që një çast të na e merrte fletoren dhe ta puthte. Kjo mund të dëshmohej edhe me gjurmët e gjakut që la në të...

U ngutet, u tha. U desh të pritnit. Me të do të bisedoja ndryshe. Me ndonjë shaka apo thashetheme do ta qitja nga lëkura dhe ai do t'i thoshte ato që do të mjaftonin për ta paditur rëndë e më rëndë. Me të tillët nuk është vështirë. Nuk mbajnë gjë të fshehtë. Kështu si vepruat, bëtë telashe, sepse ai bëhet i pavdekshëm, ndërsa ne do të shikohem si vrasës të shpirtit. Për atë tuhaf njeri do të thurën edhe këngë, ndërsa shkarravinat që ka lënë nëpër rrugica dhe mejhane, që pak kush ua ka vu veshin, sa ora do të kthehen në gjëra që do t'i takojnë kujtesës së tyre dhe ai do të ngrihet në majat e saj që si i gjallë nuk do t'i prekte kurrë... Ç'ë do që këtu edhe një hajgarexhij sa ora bëhet martir?... Kësaj i jam druajtur...

Hetuesit mbetën si të ngrirë. Nuk e dinim se është kaq i lig, i thanë. Po ta dinim nuk do ta preknim me dorë, sado që ndaj tij nuk u përdor as gjysma e asaj që u jepet të tjerëve.

Për t'i qetësuar hetuesit, që ndjeheshin fajtor dhe të dëshpëruar, u tha se kishin menduar mirë, por puna e krijuesve përherë kërkon disa dredhi, që kur nuk mbyllin gojë, atëherë e mira e së mirës është, që me hapjen e thashethemeve se janë hafije të hyqymetit, se shkruajnë sipas urdhrave e tjera e tjera, të cilat pinë ujë si shumë tek çarshia, t'u njolloset krijimtaria... Vënia e tyre në çfarëdo lidhjeje me hyqymetin i vret njëmijë herë më tepët se sa burgosjet apo dënimet, që mund t'u jepen... Të tillët, pra, i dënon kur shtiresh se nuk ua ve veshin, apo kur ua lavdëron krijimtarinë... Për t'i dhënë kapak punës, u tha se duhej të hapnin fjalë se Poeti kishte ikur nga rrethimi pasi që kishte sulmuar rojat, të cilat provuan ta ndalonin me rastin e shkeljes së rendit publik... Urdhëroi që trupin e pajetë të Poetit ta gjuanin në pjesën e errët të katakombeve të kështjellës, aty ku fekalet bashkoheshin me ujërat e vdekura të kënetës që i rrinte për fundi.

Kur po largohej, hetuesit ia dhanë fletoren e Poetit. U mundua të mos i prekte gjurmët e gjakut në të. Dikur ua lëshoi shkarazi një sy faqeve të para dhe e futi në çantën që asnjëherë

nuk e ndante prej vetit, ku ruante gjërat tepër sekrete, që do t'i dorëzonte me dorë në Kryesheher. Nuk qenka shkruar që Poetit t'i shkojë zëri aq larg, tha vetë me vete, kur e nxori fletoren dhe ia la para Pashait.

-Kujtoj, Madhëri, tha prajshëm, se këtu ka mjaft të dhëna që flasin për armiqësinë e tyre shpirtërore. Sado që fjala është për shkarravitës, si shumë të tjerë që ka në këtë vend, prapë se prapë ata të përbashkët e kanë kundërshtimin Perandorisë dhe frymës së saj, si diçka që e quajnë të huaj, ndaj të cilës duhet mbrojtur me frymën vetanake, që nuk është tjetër pos pjesë e herezisë, tashmë të njohur nga shfaqja e asnjësisë e deri tek laramania si kulm i mashtrimit... Ngjet që ky njeri e ka kaluar shtetrrethimin për t'i përhapur mendimet e mallkuara në gjithë „Tokën e Lashtë“ dhe tutje saj. Por ne do ta kërkojmë ditë e natë, në tokë dhe në qiell...

Pashai e mori fletoren dhe pasi ia lëshoi për pak një sy e la mbi plikot që mbante përpara pa i shkuar mendja se kështu kishte bërë një shkelje të rregullit perandorak, meqë ato mbanin vulën e Lartmadhërisë dhe përherë mbaheshin të hapura dhe mbi të tjerat. Një copë herë shikimi i tij kaloi nga Kryhetuesi tek fletorja e Poetit. Gjurmët e gjakut në të thuajse ia bënë me dije fatin tragjik të Poetit. Kryhetuesi uli shikimin nga frika se ai do ta tradhtonte.

-Do të flasim prapë, -tha Pashai si të ishte liruar nga një kllapi. -Por mos harro se i di të gjitha... Të gjitha i di...

Kur e mori izën, Kryhetuesi u shemb poshtë si ta kishte zënë për fundi ndonjë bjeshkë, gjë që Kryevezirit i erdh mirë që e pa në atë gjendje, edhe pse i shko i mendja se mos vallë e kishte tepruar. Ky dyshim nuk iu hoq një copë herë, kështu që atyre që folën pas tij (kryeinxhinieri, kadiasqeri, serasqeri) nuk ua vuri veshin fare. Herë pas here i vështronte shkarazi dhe ua bënte me dorë që të uleshin sapo ndjente se nuk kishin tjetër për të thënë. Vetëm Shpjeguesin e ëndrrave e dëgjoi me vëmendje. Mbase kjo lidhej me bindjen se ai mund të ishte ndër të vetmit që kishte me vete, që nuk i dërgonte shënime të fshehta Kryeshehrit nga shkaku i vetëm se ëndrrat dhe shenjat tjera duhet t'u nënshtroheshin shqyrtimeve dhe shpjegimeve që u bëheshin në tabir saraj vetëm si të mbledhura në një afat jo më pak se prej gjashtëdhjetë ditësh.

-Unë, Kahraman Ogllu, shpjegues i ëndrrave i rendit të parë, -filloi të fliste ai, -i ngarkuar me detyrën tepër të rëndësishme të përcjelljes së ëndrrave të shtetasve tanë në këtë pjesë të botës, që ende ruan tiparet e Perëndimit, gjatë punës së mundimshme dhe të pandërprerë në pjesën e rrethuar, mora në shqyrtim njëmijë e një ëndrra dhe gati aq përfytyrime dhe hijalle të tjera. I vetëdijshëm se fjala është për një punë me interes të madh për të sotmen dhe të ardhmen e Perandorisë sonë, i shënova të gjitha me kujdes dhe një nga një. Edhe pse këto ëndrra do të shoshiten veç e veç kur t'u vijë koha në Pallatin e ëndrrave bashkë me shumë e shumë të tjera që vijnë nga të gjitha anët e Perandorisë dhe për to do të jepen vlerësime të merituar dhe do të bëhen shkoqitje të hollësishme, bazuar në këto që pata në shqyrtim, mund të nxjerr përfundimin se shtetasit tanë në këtë pjesë të Perandorisë kanë një botë të fuqishme shpirtërore, me plot shenja të një vrulli të madh, që kërkon lëvizjen. Mund të them, gjithnjë duke u mbështetur tek shenjat e hetuara, se këtu prirja për të krijuar është prirje e përgjithshme dhe shkon mbi mesataren e pjesëve tjera të vendit, sado që shumë prej tyre nuk i kanë të qarta se shqetësimet me të cilat sfidohen janë pjesë e kësaj dhuntie dhe assesit e ndonjë sëmundje siç janë të prirë të thonë shumë prej tyre kur flasin rreth sikleteve që u qepen dhe assesit t'i kthjellojnë...

Megjithatë, Madhëri, duhet thënë se tek ëndrrat e tyre hetova shumë pak zogj të zi, siç ndodh tek popujt që vuajnë nga neurozat e përbashkëta dhe nuk hasa asnjë deve dhe shkretëtirë, gjë që kjo është e pabesueshme për ata që gjithnjë shpresojnë se bota e amshueshme është kufiri i fundit ku i gjithëfuqishmi ndanë vendet sipas të bërave dhe të pabërave në botën kalimtare. Kot pyeta për devetë dhe për shkretëtirat. Shumë prej tyre nuk dinin se ç'është deveja dhe nuk kishin dëgjuar se mund të ketë botë të tharë, ku ka vetëm rërë dhe thera të zeza. Më shikonin me habi dhe thoshin se diçka të tillë as që mund ta merrnin me

mend. Njëri më tha se kishte dëgjuar se në bazë të disa këngëve që këndonin disa fakirë bredhacakë të lindjes gjendet edhe një botë e tillë e shkretë dhe e tharë, por gjithnjë mendonte se kjo ishte pjellë e mendimeve të stërkequra... Bota nuk mund të jetë e thatë, thonë... E edhe po të jetë, atëherë njerëzit janë fajtor pse ajo është e tillë... Nuk duhet lejuar që thatësia ta pushtojë botën, por të bëhet e kundërta... Nëse thahet bota, atëherë thahet edhe njeriu, thahet edhe shpirti... Kur e do puna edhe nga guri duhet nxjerrë lagështi... Edhe për devenë, si kafshë të gërmuqur, më folën ngjashëm. Si është mundur, thoshin, që kafsha ta udhëheq njeriun?... Kjo është e mundur vetëm aty ku jeta zhvlerësohet aq shumë sa njeriu të humb përparësitë që duhet t'i ketë ndaj të gjitha qenieve të gjalla dhe ato kalojnë në anën e kafshëve...

Pallati i ëndrrave këtyre çështjeve duhet t'u kushtojë rëndësi dhe të nxjerr përfundime të nevojshme. Edhe pa vlerësimin përfundimtar dhe meritë, kujtoj se fjala është për një homogjenitet të madh shpirtëror, që po ashtu mbetet t'u shpjegohen rrethanat pse është i tillë... Por, nëse nuk hasa elemente të përbashkëta me ato të ëndrrave perandorake (siç janë zogu havakush, deveja dhe shkretëtira), këtu hetova praninë e ujit dhe të erës, që pashmangshëm shfaqet si element mbizotërues i gjithë sistemit të ëndrrave. Uji si ujë dhe era si erë, hasen kudo dhe janë veçori të përgjithshme. Por, tek ëndrrat e tyre, uji dhe era, gjithnjë lidhen me hapësirën e tyre pa u përgjithësuar fare. Kështu, uji shfaqet i qetë, i kaltër, që rrjedh nga njëra pjesë në tjetrën hapësirë, e që asnjëherë nuk paraqitet si tallas apo si det i turbullt, ndërsa era gjithnjë vjen nga perëndimi dhe shkon tutje kah bjeshkët me të cilat ata rrethohen... Uji dhe era përherë ndërlidhen dhe vlerësohen si shenja të mira, shenja jete, shenja qenësie... Midis ujit dhe erërave, me anën e të cilave fluturojnë si shpesh, ndodh që shfaqen edhe kuajt të bardhë dhe të kuq, që bredhin fushave dhe maleve. Kuajt lodrojnë dhe jo rrallë ndërrojnë ngjyrën nga e bardha në të kuqe dhe nga e kuqja në të bardhë. Nuk më ka rënë të dëgjoj për kuajt të zi. Mbetet, megjithatë, për t'u parë pse një zog i zi ka gjetur vend në emblemat e flamurit të tyre?... Me siguri se fjala është për ndonjë kult, që po ashtu, duhet t'i gjendet arsyeja?...

Me një fjalë, sipas shenjave që vijnë nga ëndrrat e tyre, unë nuk shoh paralajmërimin e ndonjë të lige, që kërcënohet si shpërthim. Përkundrazi, po që se bazohemi nga shenjat e yjeve, nga kjo pjesë e botës edhe më tutje duhet pritur vullnet të madh për ecje përpara drejt majave të Perandorisë...

Vlerësimet e mia mund të duken pak si të pa rëndomta për gjendjen në të cilën ndodhemi. Por, duhet ta dini, Madhëri, se unë bëj vetëm regjistrimin e shenjave të yjeve dhe porosive që vinë nga shpirti i tyre me anën e ëndrrave, që mbesin përcaktuesi më i fuqishëm i asaj që amshueshëm sillen në mendjen e njeriut jashtë përkufizimeve kohore, ku e përditshmja nuk luan kurrfarë roli...

Fjalët e fundit Shpjeguesi i ëndrrave i tha me një zë fare të butë, thuajse dëshironte të kërkonte falje për ato që tha dhe duhej t'i thoshte pa marrë parasysh se si tingëllonin në ato rrethana kur derdhej gjak dhe jeta i ishte nënshtruar rrathëve të rrethimeve të ndryshme.

Pashai e shikoi një copë herë plakun e thinjur tepër miqësisht dhe e falënderoi për vlerësimet e sinqerta.

-Vrojtimit tua janë me shumë interes, tha.

Plaku, i befasuar, shikoi disa herë andej-këndej, dhe vetëm pasi u bind se Pashai dukej i qetë, falënderoi dhe u ul.

Një copë herë mendoj për vlerësimet e Shpjeguesit të ëndrrave. Edhe pse ato i pëlqyen, nuk mjaftonin për ta hequr shtetrrethimin e as për të menduar për një vendim të tillë. Gjykimet e Plakut mund t'i shërbenin për meditime, por jo për të dëshmuar të kundërtën e atyre që ia kishin parashtruar ushtarakët dhe Kryehetuesi, të cilat ishin të ndërlidhura, me peshë të caktuar veprimi dhe me synime të qarta. Andaj, nuk i mbetej tjetër pos ta vazhdonte shtetrrethimin edhe për tridhjetë ditë të tjera. Megjithatë, fjalën për vazhdimin e shtetrrethimi, që duhej ta thoshte medoemos, nuk po ia nixirte goja. Disa herë u mat ta thoshte atë fjalë që

së paku t'i largonte sa më parë nga tenda të gjithë ata që po i dukeshin si hije gllabëruese, por ajo po i sillej e po i sillej si lëmsh i madh që i kishte mbetur në fyt. Një kohë të gjatë u mundua me atë lëmsh, i cili sa më lart që i ngjitej, aq më shumë e digjte. Dikur zuri fytin me duar dhe nisi ta shtrëngonte. Vetë shtrëngimi po e ngulfaste dhe ai kishte përshtypjen se tashmë ndodhej në një teposhtëze prej nga po rrokullisej drejt një greminë të pafund... Nga ndjenja se shpejt do ta arrinte atë fund përballoi vetë shtrëngimin dhe ndjeu sesi prej tij rrodhi njëfarë si rrëmeti që më në fund formësoi fjalët:

-Shtetrrëthimi vazhdohet...

Shungullima e nxori nga mbërthimi dhe ai, befas, pa fytyrat e atyre që i rrinin para si rrezatonin kënaqësi. Mend plasi nga ato vështrime, por për t'u ikur atyre sa më parë tha se nga ai çast fillonte koha e riprovimit, që ishte i bindur se ashtu papritmas atë formulim aq të qëlluar për rrethanat ia kishte formësuar mllëfi që kishte ndaj gjithë atyre që i kishte me vete.

-Duhet ta dini se riprovimi nuk është shaka...

Ato fjalë i theksoi kërcënueshëm. Një copë e asaj jehone iu bë se, e shkëputur, po i sillej nëpër gojë, nëpër kokë dhe nëpër trup, duke lënë pas një fishkëllimë, që tashmë e kishte të qartë se nuk ishte vetëm një urdhër i huaj...

Tenda u zbraz shpejt dhe ai mbeti vetëm, por edhe si fillikat, i bëhej se pranë i kishte ata që dolën dhe po bëheshin gati t'ia thoshin ato që ia kishin fshehur. Në atë përpëlitse ata po i shihte të mjegulluar, herë si hije e herë si qenie të përdala, neveritëse. Të tillë e pa edhe Kryehetuesin me hetuesit që i rrinin pranë dhe i pëshpëritnin diçka nga afër, ndërkohë që ai, si i llahtarshëm që ishte, herë pas herë prekte një thikë, që e ruante diku nën sqetulla. Thikat po u vezullonin edhe hetuesve, që u kullonin gjak, një gjak të trashur i cili binte diku në një si pellg që tashmë po mbushej... Më kot u mundua t'i largohej pellgut, që sa vinte e rritej... Dhe kur ishte i bindur se ai pellg do ta përfshinte, pa cjamin me brirët e mëdhenj, në të cilët mbante një pjesë të botës... Cjapi mekërinte dhe nga ajo mekërimë liroheshin ca si porosi të përzgjatura, që po i lidheshin kokës si një fashë e nxehtë... Më vonë iu bë se po i shihte plakat e padukshme tek fluturonin, ndërsa Poeti ente një rrjetë merimangash me anën e fjalëve dhe vargjeve që nuk kishin fund...

-Ndihmo,zot!-tha dhe u shemb për tokë.

Koha e shtetrrëthimit

(E shkruar nga thashethemet gjithfarë në një kohë të çuditshme, ku edhe shelgu mund të bënte rrush, ku edhe plaka mund të bëhej nuse, ku edhe nusja mund të bëhej plakë, sikundër që edhe miza mund të bëhej buall dhe bualli mund të bëhej mizë...

Autori i këtyre rreshtave herë-herë mori guximin që fare pa të keq, thashethemeve, që i shënoi me përpikëri, t'ua shtonte edhe ndonjë fjalë të vetën ose gjykim, që nuk është e thënë të përfillet fare...)

1. Thashethemet në Kohën e shtetrrëthimit

Rremë Batarja tha:

-Ushtria e mbretit po kërkon kuçedrën...

Kuçedra është shfaqur dhe është kërcënuar se shpejt do t'ia ndalë ujin gjithë botës, po qe se ne e zëmë n'gojë borën...

Baba mbret e di se kuçedra mundet vetëm atëherë kur gjithë ushtria ia del që një herë në ditë asaj t'ia përshurr folenë... Andaj, mos shihni kusure...Ushtria do të përshurr ngado dhe me atë përshurje na rriten flokët dhe mbretërinë do ta shpëtojë... Apo jo?...

*Rroftë shurra e ushtrisë shpëtimtare!
Mos e përmendni borën!*

Ukë Currani tha:

*-Delja e Balisë polli dy thi... Një të zezë dhe një të kuqe!
I kam parë me këta dy sy,thotë.
Ky është paralajmërim i kobit,shton ai.
Vaj halli për ata që jetojnë në kohë kur delja pjell thi...*

Lon Keqi tha:

-Shahe Krrabës do t'i kthehet vajza pas nëntëqind vjetësh. Do ta sjellin nëntëqind krushq të padukshëm, që i bartin kokat nën sqetulla e ëndrrat i kanë të shpërndara në gjumin e huaj.

*Pra,
-të lajmërohen gjithë ata që nuk i merr gjumi,
-të lajmërohen gjithë ata që nuk shohin ëndrra,
-të lajmërohen gjithë ata që nuk u rëndon koka mbi shpatulla...
se i pret një sihariq i madh...*

Lytë Ziu tha:

*-Myzhde:
se deti do të bëhet kos,
se gratë do të veshin vetëm krypsiten të kuq,
se i madh e i vogël do t'i lyejë buzët me mjaltë,
he lum e lum për ne!
Ai tha edhe këto:
Baba mbret është hidhëruar paksa, por nuk e ka ndërmend me dënua flenë me sy hapur dhe shohin ëndrra pa natë...
Gëzohuni,pra!*

Dan Pelimi tha:

*Them se gjithë bota na sheh në ëndërr!
Çudi!
Them se bien e zgjohen me ne në kokë?... Nuk u shkoqemi prej saj...Ç'është ky farë sikleti që na zuri me ta, thonë xhuxhimaxhuxhët?...
Dikush thotë se kobi i pret ata që bëhen ëndërr e të tjerëve... Megjithatë ne hamë hekur me dhëmbë, kemi sy të përflakur, shfaqemi me hënë e yll në ballë...
Çudi!
Na i dinë emrat e krojeve.
Na i dinë emrat e përroskave.
Na i dinë edhe ato që nuk i themi.
Na i dinë dhëmbët në gojë.
Na i dinë zorrët në bark.
Çudi!*

Mendja e Danit thotë se këto janë vetëm thashetheme të Dile Patarrocës, që nuk e zë gjumi nën Urën e Taliqit...

Cen Karremi tha:

-Një e një bëjnë tre...

Dhe nuk qau kokën pse e quajtën të marrë.

Të nesërmen sërish tha:

-Një e një bëjnë katër...

Dhe nuk qau kokën pse u shqyen së qeshuri me të.

Pas disa ditësh tha se një e një bëjnë pesë...

Dhe njerëzit e zunë për gushe dhe deshën për me e varë.

-Pse tallesh me ne, i thanë?

-Keni me u bindë, u tha, nëse më falni deri nesër.

Dhe të nesërmen, Cen Karremi, ra pazarit vetë i pesti. Dy foshnje i mbante ai dhe tri e shoqja...

Ec e merre ti për të marrë Cen Karremin?...

Gonit të Gecit i shpëtuan edhe këto:

-Shoh se çfarë ngjet përtej shtatë bjeshkëve dhe dëgjoj se çfarë thuhet përtej shtatë mbretëve...

Kur e pyetën të thoshte rreth shurrës së ushtrisë së mbretit tha:

-Nuk e ha Goni ma...

E veja e Tushit u përбетua:

-Njoh një plakë që është me barrë...

2.1 marri Sylë dhe cjapi i tij në kohën e shtetrrethimit

I marri Sylë kishte një cjaп me brirë e me zile në qafë, me të cilin fliste si me njeri. Cjapi e dëgjonte të zonë dhe bënte ato që thoshte ai. Por, ama, thonë se edhe Sylë nuk ia prishte cjaпit dhe i merrte me shumë mend ato që ia thoshte me anën e mekërimës.

Të gjithë e dinin se Sylë dhe cjaпi jetonin në një kasolle përtej Çabratit dhe nuk merreshin fort me punët e dynjasë. Megjithatë, ndodhi që një ditë bashkë me cjaпin, ngarendi në qytet dhe tha se, që të kalonte çarshisë, ku nuk do t'i shkelte këmba kurrë, e kishte detyruar paralajmërimi i një kobi të madh që do të vinte. Beri be e rrëfe se këtë ia kishte vërtetuar edhe cjaпi, por ata, si rëndom, qeshën me të...

-Të kanë rrokur ethet e verës, i thanë...

Sylë edhe përkundër përbuzjes ua përsëriti ato që thoshte se tashmë i dinte edhe cjaпi. Foli e foli deri sa u lodh. Njerëzit e panë si cjaпi ia lëpinte të zot djersët nga sikleti që askush nuk ia vinte veshin...

Atë natë dukej se zëri i Sylës dhe mekërima e cjaпit mbetën të shpërndara nëpër rrugë e rrugica si jehonë e shkëputur që bredhte nga njëra anë në tjetrën.

(Unë e dija, tha Dan Pelimi më vonë, se fjala ishte për një të ligë të madhe që po afrohej, dhe ne si ne, gjërat i morëm me të qeshura, ngaqë ishim mjegulluar nga dhalli ...)

Të nesërmen erdhi ushtria dhe shpalli shtetrrethimin. Thonë se Sylë derdhi lot të kuq. Të kuq ia panë lotët edhe cjaпit...

Por, thuhej se çastin që ushtria ngriti flamurin e vet, Sylë bashkë me cjaпin ia kishte marrë një kënge të gjatë, ndërkohë që cjaпi ishte ngjitur në maje të manit dhe kishte

mekëruar gjatë. Të nesërmen Syla nxitoi të tregonte se cjapi kishte biseduar me yjet dhe ata i kishin thënë se qyteza do të mbushet me minj e urithë,që do të flasin,e pastaj mund të fryjë një erë e thatë,që do të përhap kundërmimin e kërmave kah merr syri dhe kah shkon zëri...

Nga maja e Çabratit, Syla kishte shqyer gurmazin duke thënë se minjtë dhe urithët do të flasin. Gjithë ditën ishte çjerrur me ato fjalë në gojë pa ia vu kush veshin.

Vetëm e veja e Tushit u besoi fjalëve të Sylës dhe, thanë, se nga brenga i qepi kapakët e syve.

(Nuk më bëhet të shoh më, tha vejusha e bukur. Nuk dua me e pa botën e çoroditur...)

Dy ditë askush nuk doli në rrugë. I madh e i vogël fshehtas shikonin sorollatjet e ushtrisë dhe dëgjonin tellallët me ato që thoshin rreth shpalljet së shtetrrethimit dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Burrat i fshihnin sytë nga fëmijët, e plakat i shkundnin furkat e thara. Ndezën krande dhe nxituan që gacat e flashkëta t'i hidhnin para dyerve të oborreve. Ra një heshtje e shurdhër, që prishej herë pas here vetëm nga kënga e Sylës dhe nga mekërima e cjamin të tij...

Përballë asaj zezone Syla i kishte thënë cjamin edhe një herë të ngjitej në maje te manit dhe të pyeste yjet se çfarë mund të ndodhte tjerë? Pra a kishte më zi? Cjapi ishte ngjitur pa përtesë në maje të manit dhe kishte pritur me kot të shihte yjet. Njëfarë mjegulle kishte përthekuar qiellin sa nuk shihej gjë...

Edhe të nesërmen cjapi i Sylës gjithë natën kishte mbetur me sy kah qielli. Yjet nuk po dukeshin që nuk po dukeshin,thua jse mjegulla dhe retë e dendura qëllimisht kishin zënë qiellin që të pamundësonin leximin e shenjave nga yjet. Cjapi ishte dëshpëruar pa masë dhe po të mos i dhimbsej i zoti, pra Syla, do të fluturonte larg-larg...

(Të ikim nga kjo botë e shurdhët dhe e verbët ,të ikim sa më parë, i kishte thënë cjapi të zot.-A nuk po sheh se do të verbohemi dhe do të shurdhohemi?...)

Syla megjithatë kishte kundërshtuar cjamin dhe i kishte thënë se duhej të kishte edhe pak durim.

(Për me u largue nga kjo botë patjetër se do të largohemi, por të presim sa të vijë koha kur nuk e vlen më të merresh me të...)

Nuk vonoi dhe nga një bisedë që cjapi kishte bërë me një dru shëlg, Syla mori vesh se në Tendën Blu, që ishte ngritur në shesh, rrinte mbreti më i madh i botës bashkë me komandantët që hanin hekur me dhëmb. Shëlg i kishte thënë cjamin, e cjapi pastaj ia kishte përcjellë Sylës, se ai mbret i mbretërve, siç e quante veten me kreni, kishte tre sy (dy në ballë dhe një pas kreje) dhe se me ta shihte mbi tokë dhe nën tokë,se shihte njësoj në dritë dhe në terr-skëterrë...

Syla ishte gëzuar pa masë dhe këtë gëzim e kishte shprehur me një të qeshur të thekshme nga e cila ishin thyer xhamat e xhamisë së Hadumit.

-Moti, moti kam pritur që ta përdhos haptas më të madhin e më të mëdhenjve, tha Syla. Ata që i shkojnë pas do të shohin se sa i lig është i forti, e sa i fortë është ai që duket i pafuqishëm. Mbreti i mbretërve a nuk i ka hak disa kakërdhi të freskëta?...

Po atë pasdite, Syla dhe cjapi u panë të zbrisnin nga Çabrati tek ecnin gjithë kreni tatëpjetës së Rrypës. Syla shkonte pas cjamin e cjamin ecte para të zotit. Dikur Syla u ndal e cjapi vazhdoi rrugës së shkretë në të cilën kishte vetëm ushtarë që silleshin si të rrudhur. Kur hyri në shesh, cjapi u ndal një copë herë dhe lazdrueshëm ngriti këmbët e para. Pastaj u nis kah Tenda Blu dhe iu soll gjithë hare katër herë. Kazanët me gjella të nxehta për pak që nuk ia morën mëndët cjamin. Çoi mendjen tek lezeti i të zot që kishte për kaçamakun dhe tatlitë. Më në fund, iu afrua derës, ktheu prapanicën nga ajo dhe lëshoi një grumbull kakërdhish. Ato liruan avull dhe po atë çast një breshëri thikash dhe shpatash gjeti trupin e cjamin nga i cili nisi të rridhte gjak, një gjak gjithë currila me të cilin u spërkat Tenda Blu.

Por cjapi i Sylës nuk u dha. Priti deri sa të gjakosej Tenda Blu dhe kur hetoi se kishte lënë aq gjak në të sa ai të dukej edhe nga kulla e sahatit, ia mori një vrapi mes për mes sheshit drejt Çabratit. Ushtarët iu vunë pas dhe çirreshin me sa zë kishin:

-Kapeni!Kapeni armikun e Perandorisë!Kapeni!...

Por si të kapej cjapi që dukej se fluturonte?

Ushtarët mbeten të tmerruar kur cjapi nuk u pa më. Mendonin që është ndonjë mashtrim, ndër ata të shumtët që këtu ndodhin dhe se ai shpejt do të vërtitej diku i ngordhur.

Por cjapi i Sylës nuk u pa as i gjallë e as i ngordhur. Më kot kërkoi ushtria e mbretit t'ia hetonte gjurmët dhe do të jepte mallin e botës po ta takonte të ngordhur. Dikur, me gjasë se u hoq dorë prej kërkimit me arsyetimin e disa dervishëve se e gjitha ishte vetëm një përfitim mashtrimtar nga magjia e zezë që në këto anë përdorej si shumë...

Por sa më shumë që kalonte koha cjapi i Sylës gjente gjithnjë e më shumë vend nëpër thashetheme me ç'rast herë merrte krahë, herë bëhej i padukshëm, herë ngjitej në hënë, herë futej shtat pash në tokë, herë luftonte me gjithë botën,e herë gjuante kakërdhi të freskëta mbi mbretërinë!...

(Unë e dija se ai cja ishte isharet perëndie,tha Shaha e Taliqëve. E dija këtë dhe isha e bindur se një ditë do të merret vesh se prapa tij fshihej një shpirt i mirë. Mjerë ne që u tallëm aq shumë me të zonë e tij...)

(Cjapi nuk ishte kafshë,por insan shkuar insanit... Ai ishte kthyer në kafshë sa për të na mashtruar dhe për të na i shtuar mëkatet. O, po i lig është ai që i nënshtrohet shkurtpamësisë, tha gjithë dëshpërim Njaziu i Qerimit.)

(Cjapi është kthyer në trajtën e vet të njëmendtë, pra, të insanit kur e pa të udhës se këtë duhej ta bënte patjetër. Ishte koha të mblidhnim mend. Qepni buzët dhe mos flisni çka t'u vijë për gjuhe,tha Rremë Batarja.)

(E dija se kjo që ngjau do të ndodhte një ditë,foli Uka i Cenaukës.-U desh që cjapi, që nuk ishte cja,atë na hiqte mjegullimin që na ka vu perde syve...A nuk është koha të mendojmë me kokën tonë?...)

(Cjapi sheh çdo gjë...)

(Cjapi dëgjon të gjitha...)

Krahas cja, që tashmë merrej për evlia, flitej edhe për Sylën .Ai nuk shfaqej më as i marrë e as i përbuzur si më parë. Nuk ishte as gjysmë-njeri e gjysmë-kafshë siç thuhej për të, por nisi të bisedohej se si ai dhe cjapi i tij u gjendën pranë njëri-tjetrit ngaqë ishin dy qenie të jashtëzakonshme, që dinin dhe shihnin më shumë se të tjerët. Fakti se Sylja pas masakrës së cja, nuk shihej më, por i dëgjohej vetëm zëri me plot porosi të dobishme (herë në namazxha,herë në fushë të sahatit, e herë në Çarshi të Madhe) i shtynte njerëzit për me besue se fjala ishte për një të arritur. Ato që i tha haptas para se të vinte ushtria e huaj, bënë që i madh e i vogël ta ndërronin mendjen...

(Vaj për ne të marrët që nuk e ditëm se ç'njeri patëm midis nesh. Mund të na gjejë edhe ndonjë hata më e madhe se kjo,tha Cyme Shelnja.)

(Sylja shtirej si i marrë, por në të vërtetë ai neve na mëshironte, meqë i vinte keq për shkurtpamësinë tonë,tha Lam Krypa.)

(Si mund të jetë i marrë ai që flet me kafshën, pyeti Lytë Bardhi?... Ai këtë e bënte meqë ne nuk ishim në gjendje t'i afroheshim gjuhës dhe mendjes së tij të hollë...)

(Patëm harruar se do ushqyer edhe koka... Patëm harruar se ka edhe diçka më të rëndësishme nga barku...U bëmë mendjefjetur dhe merreshim me thashetheme... Kënaqeshim kur fqinjit i cofte lopa... Nuk shihnim tutje thembrave... Mbase tash kthjellohemi paksa para se na merr lumi përgjithmonë, u ankua Lam Metahysa...)

(Sylja ishte mbinjeri...)

(Të paçim Sylë!)

Për Sylën u thanë edhe këto mendime:

-ishte kthyer në një qenie të padukshme për me u ndihmue të tjerëve për me e njohtë veten;

-fluturonte (bashkë me cjamin) natë e ditë mbi qytezë dhe përgjonte se mos lidhej kush me ushtarët e huaj;

-merrej vesh me Shahe Krrabën dhe Nurie Futën për me e futë në luftë kundër armatën e krushqve të vdekur kundër të huajve;

-u sulej ëndrrave të mbretit ashtu që ai të largohet ose të çmendet...

3.Thashethemet tjera në kohën e shtetrrethimit

a) Selami Dacit iu shfaq në ëndërr një vjershë, që nuk po i hiqej prej goje... Ditë e natë e thotë dhe qan .Kur e pyesin se prej nga i vinë vargjet e ngatërruara bashkë me atë sikletin që e derdh përmes lotëve, ai thotë:

-Dikush po flet në mua... Një tjetër është futur në kokën time dhe lidh këto që i flas...Të miat nuk janë?...

Kur i thonë se pse s' i heq ato të shkreta nga koka kur të mendojnë ashtu, ai thotë:

-Jo qe besa... Nuk mund t' i ndal... Më vijnë në gojë dhe burojnë si krua... Nuk di si me ia ba... Jam fare i pafuqishëm përballë dufit të tyre... Ç' hall që më zuri... Më ndihmoni se plasa...

b) Ca krijesa bredhin natën të veshur me veladonë të zinj... Nuk dihet me tamam a janë njerëz apo hije. Thonë se Shahin Lala, që gjithnjë është marrë me vezët e kumrive, mund të jetë njëri prej tyre?...

(-Nuk e keni rrenë, tha një rrapatuc që gjithnjë pëshurr nën Urën e Taliqit dhe luan me pata.-Me këta dy sy e pashë Shahinin kur i nxori nga gjiri hijet dhe i lëshoi të ecnin... Desha ta pyesja se çfarë bënte ashtu, por nuk di si m' u mor goja. Pasha bablokun e Pashtrikut u bëra gur. Një kohë të gjatë nuk mund e hapa gojën. Kur erdha në vete nuk e pashë me Shahinin e as hijet që i lëshoi...)

(Ata që bredhin me veladonë të zinj janë vjedhës dhe asgjë tjetër,-tha Meta i Lamametës.-Një natë i pashë dhe desha t' i kapja, por qenë më të shpejtë. E them me kokë se ata janë hajna shkuar hajnash.)

(Janë vetë e liga,-tha një grua e tmerruar.-M' u shfaqën kur po kthehesha nga pazari. Ishin qenie të llahtarshme. Më shpëtoi mpirja që të mos çmendem. Tash nuk bëj gjumë të qetë. Më dalin përpara dhe unë mbyll sytë me orë të tëra, por assesi të më ndahen...)

(Shahin Lalën duhet vrarë! Po i nxjerr hijet nga vezët e kumrive,- kërkoi Izet Çorri.)

(Ata që bredhin me veladonë të zinj janë pjesë e shtetrrethimit. Kanë për detyrë të na tmerrojnë sa ta humbim besimin në vetvete,-tha Hil Bryma.)

c) Rremë Batarës po i kruhen veshët si shumë. Shkulmi!... Shkulmi, i thotë Lamit. Por, kroma nuk po i hiqet që nuk po i hiqet.

-Çfarë të gjet,Rremo,-i thonë më shumë nga tallja se sa halli i tij?

-Mbase bie një shi i kuq, thotë ai?

-I ke të mëdhenj, të shkretet, i thonë dhe nuk të hynë në punë...

-Nëse nuk bie shi i kuq do t' i pres me brisk rruze, thotë ai, por as ju nuk do të kënaqeni së qeshuri, siç pritni...

d) Ali Hamalli, midis Çarshisë së Madhe i hëngri trembëdhjetë zymyla me samuna të nxehtë. Piu një fuçi me bozë dhe tha se do të hante edhe dy tepsi me bakllava me sherbet dhe të njëjtën do ta përsëriste sapo të bënte një sy gjumë...

(Ka ditë që vërej pangopësinë e shumëkujt, tha plaka Neriman.-Njerëzit hanë e hanë dhe thuajse nuk ngopen dot. Madje, edhe kërthitë po ua shkulin gjinjtë nënave. Nuk del gjë që ua fut gjuhën brenda. Druaj se po vjen koha kur mund ta hamë njëri tjetrin?... Ruana zot nga e keqja!)

(Jo vetëm njerëzit, por edhe kafshët po bëhen të pangopshme. Hanë shumë dhe qesin pak. Ndërsa zogjtë fluturojnë aq shkujdesshëm sa ka rrezik që një ditë të na nxjerrin edhe sytë, u ankua Bec Shkurti.)

(Ç'është më keq, foli njëri nga Gërçari, ka të tillë që hanë dhe e gur... Në mëhallë të Kusarëve pashë dy veta që po gërryenin muret e xhamisë. Hanin qerpiç si të ishin samuna të furrës së Talipit...)

4.Thashethemet për Shahe Kërrabën dhe Nurie Futën në kohën e shtetrrethimit

Për plakat Shahe Kërrabën dhe Nurie Futen, që një zot e di se kur janë parë në rrugë, tash flitet më tepër se kurrë. Duket se ardhja e ushtrisë dhe vendosja e shtetrrethimit i tronditi aq shumë sa, herë pas here, me ato që thonë haptas, ndonëse nuk duken, dëshmojnë praninë e tyre. Zëri i Shahe Kërrabës dëgjohet më tepër rreth Tendës Blu, me ç'rast ushtarët tmerrohen kur hetojnë se dikush që nuk e shohin, por e ndjejnë pranë, u flet herë pas here. Shumë prej tyre mbushin tëlinat dhe marrin ikën. Gjithë lemeri zënë n'gojë shejtanin që nuk po i lë të qetë...

Të njëjtat fjalë i thonë edhe para eprorëve, që bëjnë përpjekje për me ua heqë frikën. Pse shkulavi, u kërcënohen?... Por,të gJORët bëjnë me dorë nga sheshi dhe zënë n'gojë të jashtëzakonshmen...

Kur eprorët u thonë se i mashtrojnë veshët, ushtarët serish ikin. Ja ku e keni!... Ja ku e keni,- thonë duke bërë me dorë nga sheshi...- E liga sillet vërdallë andej...

Për me e mbrojtë moralin, gjyqi dënoi me vdekje tre veta nën pandehmën e dezertimit, që në rrethanat e luftës merr dënimin më të rëndë. Një pas dite me shi i pamë trupat e ushtarëve që pehateshin në litarë. Tri ditë mbetën të varur aty. Kur i hoqën mbetën trekëmbëshat e thatë, me ba me dije se çfarë i pret ata që përhapin frikë nevojë e panevojë. Por, as kërcënimet e eprorëve e as trekëmbëshat në shesh nuk patën forcë për me ua kthye guximin ushtarëve të shkretë. Së voni shfaqeshin grumbuj-grumbuj dhe i mbanin veshët përpjetë. Për me ikë nuk ikin, por kur rraseshin pranë njëri-tjetrit dhe shikonin çakërdishshëm, merrej vesh se pranë kishin Shahe Kërrabën që i tmerronte...

Selami Koka, që rëndom sillej e pështillej rreth kazanëve të ushtrisë dhe fshehtas fuste ndonjë duq halle në gojë, hapi fjalë se ushtria po çmendej. Përbehej me be e rrëfe në ploncat e Taphonës se kishte parë dy veta të lidhur si i çonin në një drejtim të panjohur. Magjupi që u rrinte pranë dhe ua fshinte shkumën prej goje i kishte thënë se kishte shumë të tjerë që binin në atë derexhe... Selami Koka po ashtu përhap i fjalë, nga ato që kishte dëgjuar nga ekmekçinjtë se nga Kyeshetri tashmë ishin nisur për këtu gjithfarë magjistarësh, me detyrë që sa më parë t'i zënin shpirtrat e mallkuar...

Sabri Hamalli tha se baba mbret kishte urdhëruar që të gjendej ilaçi, me të cilin jo vetëm që shporrej frika, por do të nxirrej gasi. Kush e pi atë barë,t ha hamalli, i shkon goja vesh e në vesh nga sevdaja. Do të pshurremi se qeshuri, he lum e lum për ne!...

Ngjashëm folën edhe ca të tjerë, që kishin të bënë me ushtrinë e huaj (kryesisht hamej, karrocierë dhe varrtarë).

Ajo që në shesh herë pas here në litarë pehateshin trupat e atyre që dënoheshin për dezertim, fliste se Shahe Kërraba po e bënte të veten. Mbase ajo e ka pritur ditën për me i shti brirët me ushtrinë e mbretit për me i tregue se është më e fortë se e gjithë mbretëria?...

Nurie Futa sillej ndryshe. Zëri i saj nuk shfaqej shesheve dhe rrugëve, por thuhej se ajo mbledhte një ushtri të madhe të të vdekurve...Ushtria ime, kishin dëgjuar të thoshte, do ta rrafshojë dynjanë... I madh e i vogël do të kërkojë birën e minit...

(Nuk është rrenë, qe besa, thanë tre veta. Me sytë tanë pamë Plakën si sillej rreth pjergullës dhe fliste sikur të kishte para asqerin e dynjasë. Gatitu!- thoshte... Kapni armët!...Të vrarët para njëmijë vitesh – këndej!... Të vrarët para dymijë vitesh – andej!...Të masakruarit në kryqëzata – andej!...Ata të luftërave vëllavrasëse – në mes!...Njësia e të verbërve – tek Ura e Qabesë!...Të vrarit tradhtisht në Malin e Shenjtë – në prapavijë!... Gatituni, pra!...Të vrarit në Tivar – djathtas!... Gati!...Të vrarit në Drenicë – përpara!...Gati!..Gati!...Gati...)

5. Ca thashetheme të tjera në kohën e shtetrrethimit

-Po hanë pulat baskia...
-Po flasin gomarët...
-Shelgun po bën rrush...
-Polli kusia e Hilit...
-Sefës i dolën brirët...
-Le qen e merr këlysh...
-Peshqit në del e fulterja në zjarr...
-Kush thumbit e kush patkoit...
-Ço një kashtë, nxjerr njëzet e gjashtë...
E tjera, e tjera...

6. Thashethemet për njeriun që e shihte botën së mbrapshti

Sakip Brini u kthye në vendlindje pas shumë e shumë vjet bredhjesh nëpër botë. Si e kaloi shtetrrethimin nuk dihet, por ai u shfaq një ditë me diell të fortë. Me vete kishte një biçikletë dhe një mori rraqesh në të, që shquheshin për ngjyrat e ndryshme dhe cijamat që lënin pas...

Njeriu trup shkurtë, i veshur çuditërisht, një copë herë lëvizi poshtë e përpjetë dhe askush nuk e hetoi se ishte yni, që si fëmijë kishte marrë botën në sy bashkë me të et, Kel Brinin. Në të vërtetë Kel Brini, pat shkuar nga qyteza pse pati vënë bast se do ta gjente fundin e botës dhe se këtë do ta bënte patjetër, ishte betuar midis pazarit. Në të kundërtën do të varej në maje të manit të Çabrait për me u ba mish i korbave...

(Mbaj mend çastin kur Kel Brini doli para njerëzve dhe nisi me folë për pikën e cila shënon fundin e botës, tha Lutë Sherri. Isha ende i ri dhe më pëlqente kur ai thoshte se rrafsh tridhjetë e tri vjet kishte menduar për këtë punë. Tash nuk ka kush ma thotë të kundërtën, thoshte Keli. Zotohej se do ta arrinte atë pikë doemos dhe atje do ta lente një shenjë të qytezës sonë, që për të ishte një bri dhie...

Më kujtohet, tha më tutje Luta, harta e madhe, të cilën e bartte me vete kudo dhe e hapte sikur të ishte diçka e jashtëzakonshme. Prekte në të ca kryqe dhe ca vija, të cilat ua tregonte të tjerëve gjithnjë duke thënë se zbulimi i tij do të jetë shumë i rëndësishëm për gjithë botën, ngaqë do të provonte që atje, me bririn e dhisë, që ai e merrte për shenjë të qytezës sonë, do t'ia dilte t'i nxëntë retë në qiell, prej nga ato nuk do të lëshonin më borë, por vetëm shi të vaktë dhe me këtë përjashtohej dimri, që do të thotë se ne nuk do të mërdhinim më... Edhe pse nuk kuptoja gjë nga ato që thoshte, ia kisha lakmi që ai fliste për mrekulli, të cilave megjithatë, askush nuk ua vente veshin. I krisur është, thoshin. I ka ngjarë të et, Colit, që sillej rrugëve me fjalët se fliste me yjet dhe dëgjonte nga ato që thonë të vdekurit në atë botë... Më vinte rëndë kur dëgjoja ato që thuheshin për të (i marrë, i krisur e çmos), sepse për mua ai ishte njeriu që dinte më shumë se gjithë bota...

Pa marrë parasysh se kush nuk ia vu veshin, një ditë prej ditësh mblodhi hartat dhe rraquet që i përdorte gjatë shpjegimit dhe u bë gati për rrugën e gjatë. Kur po nisej tha se ishte i lumtur që po ikte nga ky vend i marrë, por shtoi se çastin që do ta prekte fundin e botës, qytezën mund gjente një e keqe e papritur. Kjo e ligë do të vazhdojë për aq sa të marrët nuk

do të binden se bota nuk është tepsi, por disi si top i mbërthyer në pikën e lartë dhe pikën e fundit...)

Ata që i dëgjuan ato që tha ai, qeshën dhe i uruan te përfundonte tek mani i Çabratit...

(E dija se i panjohur i çuditshëm, që erdhi me biçikletë, ishte biri i Kel Brinit, Sakipi, i nipi i Colit, shpjegoi Kurt Mprehti. Çastin që ai po ikte nga qyteza, tek Ura e Shenjtë më tha:

„Ka me ju ra në mend për mua kur t’u gjejë e liga e pashembullt dhe kur do të shihni sërish një tjetër që do t’ju vijë mbi dy rrota të mëdha. Ai ka me qenë im bir“.

„Pse po e merr fëmijën në qafë“, i thash?

E ai ma ktheu:

„Përkundrazi. Kisha me e marrë tnë qafë nëse ai do të bënte jetën e torollakëve. Im birë ka me e pa botën dhe ka me mësue se ajo e ka pikën e fundit dhe të kundërtën, pra kulmin, dhe se për me shkue nga njëra anë në tjetrën, pra nga lartë poshtë dhe anasjelltas, së pari duhet prekur fundi. Ndryshe nuk ban... Meqë bota është si kungull, pjesën e poshtme do ta mbaj unë, ndërsa atë të epërmen, im bir...“

„Do të thotë, i thashë, atje ku shkon ti ecet me këmbë përpjetë e me krye teposhtë?...“

„Torollakëve si ti u duket kështu“, më tha dhe iku...)

Sylë Brini nuk pati nevojë të fliste si dikur i ati. Njerëzit e dinin se, pasi dardha pik nën dardhë, edhe i biri ishte si i ati.

Ata që mendonin se shtetrrrethimi lidhej me gjetjen e pikës së fundme të botës, dëshironin që Sakip Brini të nisej sa më shpejt përpjetë, për me e gjetë kulmin e botës, në mënyrë që qytetës t’i hiqej e liga që e kishte gjetur.

Sakipi dukej se për atë rrugë ishte nisur kahe. Ato që bënte ai (hapi ca harta të vjetra, lidhi ca litarë gjithnjë me shumë nje, vuri disa tela të hollë në biçikletë dhe i ngriti përpjetë), dëshmonin se ai ia kishte shkuar të et.

Tri ditë Sakipi u soll e u pështoll rreth rraqeve të veta. Të katërtën vuri syzet e zeza (që ia mbulonin thuajse gjithë fytyrën), hapi ca pasqyra me korniza të metalta dhe ngriti një tel përpjetë, në formë të kunjit. Midis pasqyrave dhe telit si kunj vuri dy bilurë të mëdhenj që rrinin lakueshëm. Të gjitha këto i ktheu nga dielli dhe për habinë e të pranishmëve zuri t’u binte shuplakave e të sillej marramendshëm. Pas pak, në hapësirën midis bilurit të parë dhe të dytë shpërtheu një flakë, e cila liroi tym të zi. Flaka shpejt u fik, por më tutje, në ca teneqe të shpërndara njëzet hapa tutje zik-zak, u bënë ca shpërthime që frikësuan të madh e të vogël.

Disa herë Sakipi e përsëriti flakën që çuditërisht vinte nga biluri si dhe shpërthimet në teneqe, të cilat bëheshin gjithnjë e më të fuqishme. Më vonë, për me tregue se mund të bënte çfarë të dëshironte, bilurët i ktheu kah sahatkulla, i afroi pasqyrat me fytyrë kah bilurët dhe pasi bëri po ato lëvizje marramendëse, foli diçka që askush nuk e kuptoi. Foli e foli si i përgjumur dhe me një çast bëri me dorë kah sahatkulla dhe, shih mrekullinë, zuri të digjej foleja e lejlekut, që gjendej në majë të shtizës ku valonte flamuri perandorak. Pas pak nga maja e sahatkullës ra një blozë dhe shtiza mbeti pa folenë e lejlekut, por edhe pa flamurin perandorak...

Pas kësaj mrekullie Sakipi mblodhi çaklat dhe pa bërë zë, u largua nga qyteza. Kujt nuk i tha gjë se nga shkonte. Vetëm ata që i mbanin mend fjalët e t’et, ishin të bindur se ai shkonte për të gjetur kulmin e botës, apo siç thoshte Keli, për me hypë në majën e kungullit...

Mrekullia e Sakipit shpejt mori dhenë. Për flakën në kullën e sahatit si dhe për shpërthimet e fuqishme me teneqe u thurën gjithfarë thashetheme, që atë sa ora e radhitën në anën e atyre që duhej kushtuar vëmendja dhe rishqyrtuar sjellja.

E dhëna se ai nuk foli, por veproji dhe fundja ia doli t’i linte gojëhapur të gjithë (dogji çerdhen e lejlekut në maje të shtizës bashkë me flamurin perandorak), mund të ishin dëshmi të bollshme se mynxyrës së përgjithshme mund t’i vinte fundi. Mbetej, pra, të besohej se bota kishte pikën e saj të fundit, (që e kishte zbuluar Kel Brina) dhe kishte pikën e epërme (që do ta prekte Sakipi). Tevona, të ligat do të shkonin ashtu si kishin ardhur... Pse jo?...

Edhe përkundër dëshmime bindëse (shpërthimeve të teneqeve dhe kalljes së folesë së lejlekut në majën e shtizës së flamurit bashkë me flamurin perandorak), për Sakip Brinin, të birin e Kel Brinit, u dhanë edhe këto:

-Se me syzet e zeza e shihte botën së prapështi;

(Pasha tokë e qiell, u përbe Nikë Zogu,i vura ato haletë të djallit dhe pashë Dile Patarrocën të vogël sa një lajthi dhe Riza Probën sa një bjeshkë... Rremë Bataren e pashë të hollë si skraje e Lytë Sherrin e pashë si buall...

Kur i thashë Sakipit se ato janë gjëra të qoftëlargut,ai qeshi dhe më tha se si vetëm i marri i sheh gjërat ashtu si janë... Për me u kuptue si duhet, bota duhet me u pa së mbrapshti...

Ik or, i thashë, ç' marifet është për me i pa sende dallash?...)

-Se Të gjallët i shihte si të vdekur dhe të vdekuri i shihte si të gjallë;

(Sapo i vura ato syza, foli Irfan Dashi, bota m'u bë lule. Pashë lulëpjeshka, pashë jargovana, pashë lulëftoi e pashë gjithfarë zambakësh... Desh të qava nga gëzimi, por Sakipi më tha: është parajsa. A nuk ke dëgjuar për të?... Unë murmurisja dhe nuk dija ta shprehja ngashërimin.... Ah, kujt po i flas, më tha, kur nuk e dini se është edhe një jeta tjetër, ku të vdekurit ngjallen dhe mbesin të tillë dhe të gjallët vdesin dhe mbesin të vdekur përgjithmonë...

Dikur, pasi shikoi qiellin, sikur të kërkonte diçka, më pyeti se kë nga të vdekurit dëshiroja për me e pa si të gjallë?

U tmerrova.

Pse tallesh me mua, i thashë?-Si mundet me u ngjallë i vdekuri?...

Ai qeshi me të madhe e unë ika. Ia mbatha me të katrat dhe herë pas herë ktheja kokën të shihja se mos më ndiqte ndonjë shpirt i lig.)

-Se shihte ato që njerëzit fshihnin në shpirt:

(Nuk e keni rrenë,foli Emrush Bryma. Një copë herë më mati me syzet e errëta dhe më tha:

E di se dëshiron për me i ngordhë lopa fqinjit tënd...)

Për Sakip Brinin u thanë edhe këto:

-Ishte palaço...

-Ishte mashtrues...

-Ishte hafije i ushtrisë së huaj...

7. Dashuria në kohën e shtetrrëthimit

Një mëngjes të butë pranveror, tek bujtina e Mon Sefasë, u duk një zonjë e rëndë. Ishte e veshur me të bardha dhe buzëqeshi ëmbël sapo shkeli pragun e derës së vjetër, që rrallë e më rrallë e kalonte kush...

Mon Sefaja hapi fjalë se ishte e bukura e dheut që ishte nisur për dika, por që rastësisht ishte ndalur nga shkaku se kundërmimi i jashtëzakonshëm i jargovanëve ia kishte thyer rrugën. Nuk ka me jargovanët tanë, thoshte Moni. Edhe të vdekurin e nxjerrin jashtë...

Zonja e rëndë,apo e bukura e dheut,siç e quante Moni, po at ditë doli në shesh dhe për pak shëtiti. Pas la aromën e luleshqerrës, që u përhap deri tek rrugicat anësore. Ajo u duk në

shesh edhe të nesërmen,por tash e veshur me një fustan lulepjeshke, që ia shpalonte fët e fët puhiza e mëngjesit. Eci krenare dhe sërish u kthye në bujtinë.

Se nga u shfaq një djalosh, që e shikoi gjatë gruan e veshur me fustan lulepjeshke dhe mbeti i ngrirë, kjo nuk dihej. Megjithatë ai sillej sikur nuk u besonte syve. Druante se po e mashtronin keq. Si ishte e mundur që midis asaj zymtie (ku kishte vetëm ushtarë të panumërt), për me u shfaqë një bukuri e tillë?... Mos ishte ky ndonjë përfitim i lig që i mashtron ata që mashtrohen lehtë?...

Para perëndimit të diellit (ah, ai diell që nuk zbriste nga kupa e qiellit),ajo u duk prapë. Këtë herë doli në dritare. Shikoi djathtas e majtas dhe së fundi ia nguliti sytë kalimthi djaloshit të shtangur. Djaloshit iu duk që ajo ia bëri me dorë.

Ai gati sa s'u rrëzua për tokë. Ishte njëmend dora e saj që lëvizi ashtu lehtë, apo e mashtronin sytë e lodhur?Jo,jo,ajo e përshëndeti. Ishte i bindur se e përshëndeti. Koka iu turbullua e trupit iu ngjit një shqetësim i paparë.

Ra edhe terri dhe erdhi nata me yje. Pastaj doli një hënë e hareshme dhe,yjet bashkë me hënë, e panë djaloshin të rrinte po në atë vend. E në atë vend e la edhe mugëtira e natës (bashkë me vesën e lehtë). Aty pastaj e gjeti edhe vesa bashkë me ferkun e dritës dhe rrezet e para të diellit...

Kur dielli sërish u ngrit në kupë të qiellit, ajo u duk prapë në dritare, e djaloshit iu bë se tash kishte përpara pranverën më të bukur të mbushur me gjithfarë lulesh...Ajo prapë ia bëri me dorë dhe u largua. Djaloshi ishte i bindur se nuk po e mashtronin më sytë sa një çast deshi të hynte në bujtinë. Madje ishte gati për me u nisë për andej, por u ndal ngaqë një hamendje që iu ngjit për kokë sikur i thoshte se ajo mund të priste një tjetër... Ky mendim e shtangoi dhe bëri që ai edhe më tutje të rrinte ashtu pa ia vu veshin diellit që i binte në të gjitha anët dhe i nxirrte djersë dhe pa ia vu veshin as atyre, që i afroreshin gjithnjë e më shumë për me mësue se ç'ishte puna e tij që rrinte ashtu i shkëputur, sikur të mos ishte pjesa tjetër e botës, që e rrethonte...

Ndaj buzëmbremjes ajo doli në shesh. E veshur me të bardha, po e pengonte natën që të vendoste pushtetin e territ. Ishte i bindur se bardhësia e saj po i afrohej dhe ajo i vinte bashkë me një mpirje që i bëhej gjithnjë e më e madhe saqë ato që kishte menduar për me ia thënë nuk po i kujtoheshin. A thua bukuria e saj ishte aq magjepse sa ia kishte ndrydhur pamëshirshëm edhe kujtesën?...

Më në fund ajo iu afruar dhe ia dhuroi një lule. I buzëqeshi lehtë dhe shikoi.

Djaloshi nuk ishte i sigurt se pa një qenie të jashtëzakonshme apo një vesë?...Nuk dihet pse, por djaloshi, sapo hetoi se atë nuk e kishte pranë, mori ikën. Vrapo si i çmendur...

U kthye apo s'u kthye më, këtë askush nuk e diti. Ca thoshin se ai ishte parë me një buqetë lulesh të ngarendte shthurshëm kah bujtina... Dikush tha se ai fare nuk kishte shkuar në bujtinë, pos që lulet i kishte lënë diku në shesh...E dikush tha se kishte të ngjarë se ata të dy,të përqaftuar kishin ikur pa gjurmë...

Megjithatë,nga moria e thashethemeve,vetëm një doli e vërtetë: se djaloshi u gjend i vdekur përtej lumit,ndërsa e bukura e dheut nuk u pa më...

(Thashethemet për dashurinë e kobshme në kohën e shtetrrëthimit)

- U tha se ajo ishte një dashuri e rëndomtë, si çdo dashuri tjetër, që mund të lindte aty për aty. Qe,pra,vetëm lidhje e thjeshtë dashurie, që kishte pasur ngaherë dhe do të kishte gjithnjë...

(Gruaja erdhi në qytezë e nxitur nga kundërmimi i luleshqerrës, bëri be Mon Sefaja, kur e pyetën të tregonte se çfarë dinte për atë dashuri tragjike.

-Djaloshi u dashura në të sapo e pa, tha ai. Ka të ngjarë që edhe ajo ngjashëm u dashurua në të?...Kush nuk i di punët e begenisë?...)

I zoti i bujtinës këtë e shpjegoi me lulen e verdhë që ajo i kishte dhënë atij, e që për të ishte shenjë e dashurisë së njëmendtë. Ai, pastaj, solli një buqetë lulesh që ajo e mori dhe, si shpërblim për to ajo i kishte dhuruar një përqaftim. E frikësuar nga shikimi i jashtëzakonshëm i djaloshit dhe ndjenja se ajo dashuri pa filluar mirë do të përfundonte me kob, ishte larguar po atë natë, ndërsa si, kur mori vesh këtë, vdiq nga pikëllimi...

(Shenjat e kobit i mora vesh herët, qysh atëherë kur ajo kërkoi t'ia gjenin një lule të verdhë,tha Moni. Kur ia solla hetova se kishte një shikim të akullt,të tejdukshëm dhe fare të frikshëm... Nuk më tha se lulen e kishte për djaloshin. Por këtë e mora me mend, ngase ajo rrinte përballë dhe e shikonte pareshtur... Kur ia dhashë lulen që e kërkoi me ngut, gjithë shqetësim më tha se kishte harruar emrin e vet... Mbase edhe djaloshi e kishte harruar veten kur rrinte si i ngrirë në shesh dhe kishte përjashtuar pjesën tjetër të botës...)

- U tha pastaj se ajo kishte ardhur qëllimisht për kurthet e dashurisë, ngaqë ishte nga ato të përdala, që shkojnë ngado dhe, aty ku shfaqen, lënë ngatërresa të jashtëzakonshme,madje edhe gjajaqe. Andaj, sherri i saj zuri edhe të shkretin djalë...

(E dija se ajo ishte e përdalë,tha Lon Guri. E dija se është e tillë edhe për faktin se ato shfaqen befaz në kohë të turbullta dhe befaz ikin. Ajo erdhi e pispillosur,e pudrosur dhe gjithë gënjeshtër kur tha se ndoqi kundërmimin e luleshqerrës...

Unë them,shtoi Leci i Lamacemit,dhe këtë mund ta dëshmoj me kokë,se ajo e mashtroi djaloshin deri sa e futi në dhomë dhe atje, pas lajkave të dashurisë që ia bëri,thirri ata që i shkonin pas të tillave dhe pasi ia morën ato që kishte,ia morën shpirtin. Të vdekur e futën në thes dhe e hodhën në lum...

Mbase punët qëndrojnë paksa ndryshe,tha Hil Lehta. Ajo mund t'u takonte të përdalave, që shfaqen kudo në rrethanat e tilla,por nuk kishte ndërmend t'i bënte ndonjë të keqe djaloshit. Ç'është e vërteta ajo kishte bërë dashuri me të,por kur ai i kishte thënë se ai nuk dëshironte të ndahej prej sa,ajo me buzëqeshje i kishte thënë se ishte e lirë dhe e lirë dëshironte të mbetej... Jam si zogu, që kërcen nga dega në degë dhe ndjek aromën e lulëshqerrave, mund t'i ketë thënë djaloshit, i cili ia kishte kthyer se ajo prej atij çastit ishte e tij dhe e askujt tjetër dhe se ai gjithë jetës e kishte pritur...Ajo prapë mund t'ia kishte përsëritur fjalët rreth kalimit nga foleja në fole,që për të ishin pjesë e jetës,saqë djaloshi, i paprishur siç i ishte dhe pa mundur të merrte me mend se dashuria mund të ishte edhe vetëm një lojë çasti,ia kishte shkrepë vetes?...)

- U tha se ajo ishte shtojzovallë dhe djaloshi pati fat të lig që ra në dashuri me të. Largimi i saj pa gjurmë flet më së miri se ajo nuk ishte tjetër pos shtojzovallë. Tekefundit a nuk shfaqen ato në kohën e ëndërrimeve të përgjithshme?...

(E dija,tha e veja Zymrije,se shtojzovallja do të vinte tek ne ngaqë ç'prej kohësh me kruheshin vetullat dhe gjumin e bëja copë-copë. Kur zgjohesha në mëngjes hetoja njolla të zeza trupit,thujse dikush me kishte shtrënguar me sa fuqi kishte. Zot Runa! Kisha frike se do të mbetesha me barrë! Atë natë që ajo iku, iku edhe ai që më hipte si hijallë përmbi...

Edhe mua më ngacmonte diçka e ëmbël në gjumë,tha njëra që nuk dëshironte t'i zihej emri në gojë. Kur zgjohesha më dukej vetja e shkallmuar,thujse bëja dashuri me shtatë burra të fortë. Ky siklet, që do ta dëshiroja më shpesh, m'u hoq sapo u hap lajmi se ajo kishte ikur. Ah, pse nuk qëndroi edhe një çikë?... Sa mirë e kisha...)

- U tha se ajo nuk ishte as e përdalë e as shtojzovallë, por ishte pjesë e luftës. Pra, i takonte së keqes,e cila u shfaq me ardhjen e ushtarëve të huaj...

(E dija se ajo ishte pjesë e shtetrrëthimit,tha Shahe Kërraba. E pispillosur si perri, nuk ishte tjetër pos strofkë me sëmundje të tmerrshme që meshkujt i marrin çastin që i prekin me dorë... Shërbimet speciale që i takojnë luftës dhe punojnë pareshtur për qëllime të caktuara, edhe mikrobin e padukshëm e kanë paraparë si pjesë të luftës. Pse jo, kur ai përhapet djallëzisht ngado pa ndonjë mund të madh dhe bën dëme njëmijë herë më të mëdha se arma... Këtë ia thashë djaloshtit sapo doli nga dhoma e nepërkës. Ai mbeti si i shtangur kur dëgjoji se ç'ishin mikrobet e liga, që tashmë i kishin hyrë në trup...Jo, jo, më tha ai i bërë akull. Ajo nuk ishte sëmundja... Nuk mund të ketë dashuri me sherr?... Këtë nuk mund ta kuptoj kurrë, sepse dashuri ka ose nuk ka...Nuk u besoj atyre që thuhet rreth intrigave të dashurisë...

I ri, i ri je, djalë, i thashë. Ca gjëra do t'i kuptosh më vonë. Ai që bie në dashuri të tillë,të singertë,nuk sheh larg. Gjithçka i duket e pastër dhe e madhërishme...Gjithçka i duket e përherëshme dhe e fuqishme...Askush nuk dyshon në dashurinë çastin e mbërthimit të saj,edhe pse ajo pikërisht atëherë verbon më së shumti...

I fola e i fola për ato që shiten për dashuri,por që janë shtirje si dhe për të tjerat që dashurinë e helmojnë dhe e mallkojnë tmerrësisht...Pasi që dikur e mori veten më pyeti se çfarë duhej të bënte që t'i ikte mallkimit që e kishte gjetur?...

Po ua deshe të mirën të tjerëve, shko në bjeshkë dhe jeto i vetmuar përgjithmonë, i thashë. Mbaj, pra, kujtimin e kësaj nate, që për ty është e madhërishme dhe mos u ndaj kurrë prej tij. Mbase kështu do ta kesh më lehtë ta përballosh dhembjen dhe mynxyrën. Nganjëherë një jetë e tërë nuk vlen sa një kujtim i bukur...

Jo, jo, më tha ai gjithë dëshpërim. Nuk jam aq i fortë sa gjithë jetën t'ia fal një kujtimi, sado i ëmbël qoftë ai...Nuk jam aq i fortë...

M'i tha këto fjalë me gjysmë zëri dhe e dija se i shkreti djalë do të përfundonte si o më zi pa kaluar njëqind hapa...

Kështu edhe ngjau...

Dikur hyra në dhomën e saj dhe ia thashë troç kush ishte dhe çfarë kërkonte bashkë me qëllimet që kishte...Prej tash,i thashë,askush më nuk do të bjerë në kurthin tënd. Këtu tashmë të gjithë e dinë se çfarë je dhe kujt i shërben...

Ajo e lemerisur doli dhe iku sikur të mos ishte...)

- U tha se ajo nuk ishte as shtojzovallë, as e përdalë,e as pjesë e shtetrrëthimit,por ishte një mashkull i veshur me rroba femrash, që kishte ardhur për me marrë hak!...

(Sapo e pashë të sillej ashtu e pispillosur dhe shikonte diellin pa ia ndarë, e dija se nuk ishte femër,por mashkull,që kërkonte diçka të veçantë, tha Hysë Arapi. Kur e shikova më shtruar, hetova se edhe ecjen nuk e kishte si të femrës,por që nuk ishte as dylber,siç mund të ndodhte kur të tillët shfrytëzonin rrobat e femrës... Qëllimisht ecte ngadalë, që të mos e tradhtonte burrëria. Shtirjen e kishte për ta futur në kurth atë që duhej ta fuste...

Çfarë s' u bie njerëzve ndërmend?)

(Qëndrimi i Kronistit ndaj kobit të djaloshtit dhe dashurisë së pafat në kohën e shtetrrëthimit)

1. Mendja ma thotë se fjala ishte për një dashuri të rëndomtë,por fakti se ngjau në kohën e shtetrrëthimit dhe përfundoi me kob,jep mundësi për thashetheme të ndryshme dhe gjithfarë shpifjesh.

Unë mendoj se ata njiheshin që më parë dhe ishte shtetrrëthimi dhe ato që solli gjendja e jashtëzakonshme që i penguan të takoheshin si më parë. Kjo mund të vlente sidomos për djaloshin, i cili, si të gjithë të tjerët, mbeti i mbyllur në qytezë. Ajo, që nuk mund të rrinte pa e parë, gjeti mënyrën si të futej në pjesën e rrethuar dhe ato që i tha i zoti i bujtinës se „kishte ardhur pse ia kishte kthyer rrugën kundërmimi i jashtëzakonshëm i jorgovanave“, ishin vetëm lojë fjalësh për t'ia fshehur gjurmët dashurisë, e cila ishte e pamundur të mbahej e pavërejtur ndryshe. Dhe të dashëruarit më në fund ishin takuar. Pas gjithë atyre shtirjeve megjithatë duket se nuk kishin mundur t'i bënin ballë ndarjes, e cila duhej të pasonte pas një nate plot epshe të zjarra. Kujtoj se gjatë atij takimi të jashtëzakonshëm, dashnorët ishin bindur se dashuria e tyre nuk kishte gjithaq gjasa të mira të ndiqte thirrjet e shpirtit kur kihej parasysh shtetrrëthimi dhe kohëzgjatja që lente për të kuptuar se do të mund të ishte e pakufishme... Të paaftë të përballonin ndarjen dhe gjithë ato që ngërthente ajo në atë kohë tepër të paqartë dhe të rrezikshme, është afër mendsh se kishin vendosur t'i jepnin fund vuajtjeve të tyre. Ajo mund t'i kishte thënë: nuk jetoj pa ty... E, edhe ai do t'ia këtë kthyer: as unë nuk jetoj pa ty... Në kulmin e atij pikëllimi, por edhe të vllgut të bindjes se vetëm ndjenja e flijimit e pavdekëson dashurinë dhe është në gjendje ta mbajë të amshueshme, djaloshi bëri vetëvrasje në zonën e shtetrrëthimit, ndërkohë që ngjashëm veproi edhe ajo sapo u largua nga pjesa e mbyllur. E tillë mund të ketë qenë marrëveshja e dashnorëve të pafat së cilës nuk i janë dashur kurrfarë zotimesh të përbashkëta, ngaqë ka qenë bindja se ajo vetëm ashtu mund të shpëtohej dhe të mbahej e përhershme dhe e paprekur. Ka të ngjarë që në këtë mënyrë ata ngritën zërin kundër së ligës që na kishte mbërthyer të gjithëve, por që më së shumti i kanosej dashurisë. Tashmë gjenden edhe asi që ata i marrin si martirë të parë që u ngritën kundër shtetrrëthimit të tmerrshëm...

2. Ka të ngjarë se ky ishte kob i dashurisë së pafat, që si të pafat e bëri shtetrrëthimi?

Në të vërtetë, fjala ishte për një marrëveshje të kamotshme të dashnorëve që të takoheshin ditën e pranverës (pra ditën kur ajo u pa në shesh, pa marrë parasysh rrethanat që do të krijoheshin), por që shtetrrëthimi, që kishte prishur çdo gjë, e ngatërroi edhe këtë takim, saqë as dashuria nuk i shpëtoi kësaj prishjeje.

Kështu që ngjau që dy të rinjtë të takoheshin, por në të njëjtën kohë edhe të dëshpëroheshin, sepse djali nuk e takoi vajzën që e priste, e as vajza nuk e takoi djalin që e priste dhe se takimi i tyre ngjau fare rastësisht, sapo ra terri i parë dhe të rinjtë që po i afroheshin njëri-tjetrit me të shpejt do ta kuptonin fatkeqësinë çastin që vajza shqiptoi një emër tjetër, e po ashtu edhe djaloshi shqiptoi një emër tjetër...

Kur u afruan, vajza pa se ai nuk ishte djali që priste, pra dashnori i saj, e edhe djaloshi pa se vajza nuk ishte ajo që priste, pra e dashura e tij, dhe se kështu ata shpejt e morën vesh të vërtetën e hidhur rreth asaj se si gjendja e krijuar që të dyve ua kishte marrë përgjithmonë dashurinë. E vërteta, pra ishte, se dashnori i vajzës ishte vrarë me rastin e burgimeve të para që u bënë sapo u vu shtetrrëthimi, e po ashtu, e dashura e djalosht, që ishte po nga ai vend i vajzës, kishte bërë vetëvrasje sapo kishte kuptuar për vrasjen e të rinjve në qytezë...

Për hir të dashurisë së madhe, që nuk e kishin më, dashnorët fatkeq, u përqaftuan në emër të dashurisë, qanë fatin e zi dhe vendosën të bënin vetëvrasje...

3. Dhe në fund, si kronist që jam, nuk mund të kaloj lehtë para atyre që i tha Shahe Kërraba (se ajo ishte pjellë e shtetrrëthimit që i shërbente qëllimeve të tij...)

Tash për tash nuk mund të jap ndonjë vlerësim të plotë se a ishte ajo në të vërtetë pjellë e luftës dhe në shërbim të saj, (sepse në kohë të tilla edhe jeta, edhe vdekja prorrë marrin shpjegime të ndryshme ndër të cilat dyshimi është më i afërti), por mund të them se, sidoqoftë ata ishin viktimat e parë të saj ...

(Edhe disa thashetheme në kohë e shtetrrëthimit)

-Lit Cenës i dolën brirët...
-Nokës së Balës i doli samari...
-Zeliasë së Rudit i dolën dhëmbët e tretë...
-Lonit të Nikollës i shpërtheu syri i tretë mu në ballë...
-Cenës së Zylfisë i doli bishti...
-E të tjera,e të tjera...

Martesa në Kohën e shtetrrëthimit

Një ditë prej ditësh u hap lajmi se Riza Probja martohej me Dile Gëzofziun.

Të premten e madhe,i madh e i vogël panë së bashku çiftin e jashtëzakonshëm:Riza Proben – dypëllëmbësh dhe Dile Gëzofziun – vajzën më të gjatë të qytezës, me lesh fytyrës dhe zë mashkulli.

Riza Probja ecte shpejt dhe i hidhte hapat vjedhshëm njëri pas tjetrit ,ndërsa Dila, ashtu si plep,mëzi lëvizte. Dora e tij e vogël kishte sharruar në atë të Diles,e cila,për ta mbajtur,ecte e gërmuq.

Megjithatë,dukej se shpërputhja qesharake nuk u pengonte të ecnin hareshëm. Riza Probja buzëqeshte si ger dhe bënte me dorë. Ndërsa Dilja gjithë gëzimin e shprehte me anën e një zgërdhitje të vrazhdë...

Çiftin e ri e përcillnin xhuxhët Goni dhe Moni. Goni mbante skajin e vellos së nuses,ndërsa Moni unazat që do t'i ndërronin para syve të botës.

Në shesh i priste Xim Llastra me një def të vogël,tek këndonte dhe kërcente si i marrë,ndërkohë që herë pas here prekte syrin e mbyllur,që s'i thahej kurrë dhe fshinte jargët që i shkonin çurg. Defi lëshonte një tingëllime të vrazhdët,si të ishte prej lëkurës së sorrës,ndërsa zëri i tij mbushte hapësirën me një si gërvishtje rrëqethëse...

Çastin që çifti i ri arriti sheshin, Xim Llastra e la defin mënjane, fshiu jargët, fërkoi syrin e mbyllur dhe pasi u përkul (si të ishte në ndonjë skenë të teatrit),vrapoi kah ata dhe u ra në gjunjë. Pas pak u ngrit dhe mori qëndrim gatitu dhe,pasi shikoi përreth,nisi të fliste diçka që nuk ishte as vjershë,as këngë,as çirrje e as ligjërim...

-Po bie shi. Po merr mot i ligë. Po fryn... Nuk shihni se ç'heqimë që na ka përfshirë?...tha Xim Llastra.

Pasi qeshi me sa zë kishte dhe disa herë theksoi atë ha,ha,ha vazhdoi:

-Po bie shi. Po fryn. Të gjithë shtiren si të verbët...

Ha,ha,ha...

Ata që kanë sy nuk shohin...

Ha,ha,ha...

Ata që kanë vesh nuk dëgjojnë...

Ha,ha,ha...

Ata që kanë kokë,nuk duken...

Ha,ha,ha...

Çil gur gojën...

Ha,ha,ha...

Askush nuk sheh...

Askush nuk dëgjon...

Askush nuk bën vër me gojë...

Nga të ftohtit kërcasin eshtrat...

Ha,ha,ha...

Të gjithë të verbër...

Të gjithë të shurdhër...

Të gjithë memecë...

Ha,ha,ha...

Rroftë Riza Probja!

Rroftë Dile Gëzofziu!

Rroftë çifti i ri!

Rrofshin ata që nuk do të jenë më as të verbër,as të shurdhër e as memecë!

Rroftë Riza!

Rroftë Dila!

Rrofshin ata që nuk janë!

Ha,ha,ha...

Pasi që tha edhe shumë e shumë gjëra të tjera,që nuk i merreshin vesh dhe pasi këndoi apo gjëmoi,krejt një, Xim Llastra mori defin dhe i ra,si në fillim. Dikur,pasi u lodh dhe dukej sikur e merrte gjumi,nga xhuxhët mori unazat dhe ua futi në duar së pari Dilës e pastaj Rizës.

-Rroftë çifti i fundit i kësaj bote,tha!

Disa herë përsëriti këto fjalë dhe si ta kishte ngacmuar kush keqas,bashkë me defin iku me të shpejtë kah Ura e Taliqit. Nuk vonoi e edhe Dilja,pasi i e kapi ngryk Riza Proben dhe e përqafoi me sa fuqi kishte, (pa mëdyshje se ky ishte përqaqimi i parë sy botës në qytezën tonë qëkur mbahet mend),u nis me të shpejt pas Ximit. Nga hapat e saj të rëndë,dukej se dridhej çarshia.

Goni e Moni i shkonin prapa dhe këndonin gjithë gëzim:

„Nusja jonë si perri,

lum e lum,o dhëndri i ri...

Nusja jonë si perri...“

Atë natë dhe shumë të tjera kënga e tyre u dëgjua nën Urëne Taliqit...

Thashethemet tjera në kohën e shtetrrëthimit:

-Cjapi i Sylës sërisht u pa në Çabrat. Këtë herë nuk mekëroi por foli si njeri!

(-Me këta vesh e dëgjova kur cjapi u kërcënua: do t'ia heq koqet mbretit me këta brirë,-përhapi fjalë Rremë Batarja. Këtyre pohimeve iu shtuan edhe shumë të ngjashme siç ishin ato se:

- e pat puna e mbretit,

ka mbetur për t'u tallur,

i janë thyer dhëmbët...

-Hani hurma para së të bini në gjumë,

e të tjera, e të tjera,që cjapi i Sylës i kishte dërguar si porosi dhe këshilla!)

-Ushtarët edhe më tutje po kërkojnë diçka në Blinishët?... Mbase kërkojnë kuçedrën?...

(-Pasha kryet e nanës,tha Riza Probja,si i vogël sa një gogël që jam, një ditë u katrrisa për leshin e një ogiçi dhe dola jashtë rrethimit pa u hetuar fare. Në Blinishtë pashë njerëz të veshur me hekur dhe të tjerë që hapnin puse të mëdha. Futeshin në ta dhe nuk dilyn prej tyre me orë të tëra. Me vete kishin ca hekurat të gjata që i mbanin si shtiza. Ata që rrinin lartë pareshtur pyesnin ata poshtë:

„E gjetët?...Ende?...“

„Kur më?...“

„Ç' damar i mallkuar që është...“

„Po zgjati, na mori e liga...“

e tjera,e tjera...

Po deshët mund t'ua tregoj vendin ku ata punonin).

-Nurie Futa po bëhet gati për luftë. I duhen edhe dy ushtarë për ta rrumbullaksuar numrin prej nëntëqind sosh...

(-Ka kohë që dëgjoj zërin e saj nëpër oborr, thotë një fqinj i saj. Atë nuk e shoh por dëgjoj zërin e saj si shpërndan urdhra:

Gatitu!

Një dy,një dy...

Gatitu!

Djathtas! Majtas! Përpara!...

Një dy,një dy...

Keni pushuar katërqind vjet...

Gatitu!

Lufta është e gjatë...

Këtë mos e harroni...

Gati!.. Nisemi!...

Ndaj mbrëmjes fashiten urdhrat e saj...Kur del hëna ndodh që dëgjohej të flasë se si luftë do të ketë në tokë e në qiell,do të ketë çmos, por pastaj, kur të marrë fund, do të bjerë një shi i imë që nuk do të pushojë shtatëqind vjet...Gjithçka duhet shpërlarë,thotë ajo,edhe toka,edhe qielli,edhe shpirti kanë nevojë për pastrim...)

- Në burgun e kështjellës një fëmijë preu në fyt tre nga hetuesit që po e mundonin dhe pastaj u bë i padukshëm!

(-Ishte një fëmijë sypishë. Ndryshe nga të tjerët,që ato ditë i sillnin në burgun e kështjellës,tregoi Xajë Sherri, i cili aty ishte për një vjedhje të vogël nga ato që i bënte si shpesh. Me sytë e mi e pashë sesi e munduan të shkretin fëmijë për vdekje dhe më vinte keq që nuk mund t'i ndihmoja. Nuk ma kishte marrë mendja ndonjëherë se ashtu mund të mundohej fëmija. E qëllonin pa mëshirë,e ai rrinte si i ngrirë. Me gjasë kjo i tërboi edhe më shumë hetuesit,të cilët me ngulm e pyesnin diçka që ai assesi t'ua thoshte edhe kur i kërcënoheshin se do t'ia merrnin shpirtin. Çuditërisht i duronte të gjitha ato mundime prej të cilave do të rrëzohej edhe bualli njëmijë okësh... Mua gati më ra të fikët kur e shihja të shkretin në atë gjendje. Dikur fëmija u lodh. U shtri dhe mendova se e lëshoi shpirti. Hetuesit nxituan ta lagnin me ujë dhe ta shkundnin. Nuk bën të ngordh pa folur,bisedonin mes veti... Kjo na poshtëron. Tek e fundit, pse nuk ia presim gjuhën, thanë? Dhe, pashë se ata nuk e kishin për mahi. Kur nxorën thikat dhe po i afroheshin t'ia merrnin gjuhën, për habi, fëmija u ngrit befas. Lëshoi një ulërimë të tmerrshme që m'u bë se mi shpoi veshët dhe iu sul hetuesve,me ç'rast ua mori thikën dhe sa çel e mbyll sytë të treve ua preu kokat.

A thua mos po më mashtronin sytë? I fërkova një copë herë, por ata nuk po më mashtronin. Para këmbëve shihja tri koka të prera, që nxirrnin gjak të freskët. Volla nga tmerrri dhe fëmijën sypishë nuk e pashë...

Shfrytëzova rrëmujën që u bë për të ikur, pasi që çuditërisht u thyen të gjitha dryrët e qelive dhe kalimeve të tjera...)

Lindja e parë në kohën e shtetrrethimit

Fjala mori dhenë se vejushës Shazije, një zonjë të rëndë, së cilës burri i kishte vdekur para njëzet e pesë jetësh me zhig të madh që nuk po i linte pas trashëgimtar,i lindi djalë!

Një natë pa hënë, kur në qytezë po bëheshin bastisje të mëdha dhe nuk dihej se kujt do t'i shkonte koka më parë, thuhet se vejusha e mbajtur mirë ndjeu dhembje të mëdha në bark. Dhembjet i pati aq të forta, sa ulëriu në kupë të qiellit.

(-Kur shkuam ta shohim se ç'kishte, treguan plakatin Nurie dhe Litë, Shazija po grithte tokën me thonj. Shtrëngonte barkun dhe thoshte se diçka e tmerrshme po i këpuste zorrët. Kërkonte ndihmë e shkreta grua sikur ta kishte kapë tatakurti. Dhe kur ia hoqëm ushkurin, pamë se barkun e kishte të fryer. U bindëm se ajo kishte dhembje fëmije dhe asgjë tjetër...

„Qenke me barrë“, i thamë.

Si ta kishim prerë me ndonjë hanxhar, kërceu dhe sa nuk na i nxori sytë.

„Ç'thoni, moj korba?... Ç'thoni kështu?... Çfarë barre?... Edhe guri e edhe druri këtu e di se si ç'prej njëzet e më shumë vitesh rri e nguuar kërcu me hijallin e tim shoq, që më la si qyqe në kohën më të mirën...“

Çfarë t'i thoshim tjetër?... Fëmija kishte marrë rrugën e vet dhe së shpejti do të shihte botën me sy... Kur ia bëmë me dije se ajo tashmë po lindte dhe pasi që e preku barkun dhe hetoi ato që po i ndodhnin poshtë, ia mori kujës.

„Djali qenka futur në mua... Korba unë... Mos qofsha!...“

Prapë zuri të ulërinte. Filloi t'i mëshonte barkut me grushte dhe të shqelmonte si e çmendur. Mbase ai tërbim bëri që vejusha plakë të lirohej sa më shpejt prej barrës së shtatzënisë, që thoshte se nuk e kishte vërejtur.

Kështu i lindi djali.

E lidhëm dhe ia vumë pranë. Kishim frikë se do t'ia merrte shpirtin, por për habinë tonë, ajo u qetësua dhe si të mos ishte e pak mëparshmja, zuri ta ledhatonte...

„Lumja unë! Lumja!... Si s'e dija se zoti kishte ndërmend që për vuajtje e mia më në fund të më shpërblente?... Lumja unë!...“

Ikëm si të ngrira...)

Thashethemet për fëmijën e vejushë në kohën e shtetrrëthimit

- U tha se vejusha plakë qëllimisht e kishte mbajtur fëmijën në bark mbi njëzet e sa vjet, ngase ishte betuar se do t'i hakmerrej të shoq për disa të pamira që kishte bërë. Andaj, fëmija kishte dalë i burrëruar: me mustaqe, me flokë të thinjur dhe mjekër...

(-E di fort mirë se ajo vetëm një natë e pati burrin në shtrat, tha plaka Nurie. Kurrë më nuk hyri në dhomën e saj. Shazija priti e priti dhe u ndry në vete. Ditë e natë mendoj si t'i hakmerrej të shoq...).

- U tha se vejusha lindi lugat...

(-Njëzet e sa vjet nuk doli jashtë, tha Shahe magjupja. Rrinte brenda dhe ushqej me far të terura e me gjak urithësh. Më kërkonte t'i sillja çdo javë nga një urith dhe këtë ma paguante me flori. Pasi thithte gjakun e urithit çonte dashuri me një të vdekur, që i hynte në dhomë herë pas here... Qe besa nuk e keni rrenë. Vejusha shfrynte epshtet e veta ditë e natë në dhomën e errët me të vdekurin... Shëmtimi u desh të dilte në këtë botë për t'i dëshmuar mëkatet e saj. Runa zot!);

- U tha se vejusha plakë as që ka lindur fëmijë. Vejusha plakë as që ka pasur dhembje, e Nura e Lita as që i kanë ndihmuar, e as që kanë pasur punë me të... Ato e kanë kurdisur punën që të fshehin një kopil të një zonje të madhe të qytezës ngaqë kështu fshihej më së miri marrja e madhe...

(-Shumë kohë i trokita në derë,tha Meremja e Gaxhisë,por mbeta pa përgjigje. Nuk dihet se kush e ndez qiriun në atë shtëpi...);

- U tha se vejusha plakë ka kohë që ka vdekur...

(-Vejusha plakë ka vdekur çastin që ka mbetur vetëm,tha Xilja e Zekës. Këtë e di fare mirë dhe kjo ngjau para njëzet e dy vjetësh. Shahin rrogëtari e varrosi në ashçihane ngaqë ashtu kishte kërkuar ajo. Nuk dua që trupin të ma kap lagështia,i kishte thënë Shahinit. Qysh atëherë në atë shtëpi rri qoftëlargu,që herë-herë vajton si fëmijë).

I marri Sylë bëhet i rrezikshëm në kohën e shtetrrethimit

Përnjëmend kohë e çuditshme kjo e jona. Kur i madh e i vogël janë futur brenda dhe kërkojnë birën e miut,i marri Sylë thonë se është bërë i padukshëm! Qysh se ia gjakosën cjamin, zëri i dëgjohet i shpërndarë në të gjitha anët e qytezës. Bile, për dallim prej herëve të tjera (pra nga koha kur shihej me cjamin dhe më shumë mekëronte se thoshte diç që i merrej vesh),Syla tash mban edhe fjalime!

Ditën e pazarit, në Çarshi të Madhe zëri i tij shungulloi gjithë ditën e lume, saqë ato që i thoshte bridhnin nga rrugica në rrugicë dhe përhapeshin edhe aty ku nuk shkelte njeri.

Ja disa nga këto që thoshte:

-Kohë e pakohë kjo e jona...

-Sa i mirë, sa i keq...

-Sa ashtu, sa kështu...

-Herë armik, e herë mik...

-Herë i madh, e herë i vogël...

-Herë burrë, e herë shurrë...

Në Lamëne druve i tha edhe këto:

-Qengji e ha ujkun...

-Peshku i vogël e ha peshkun e madh...

-Uji shkon përtpjetë...

-E të tjera,e të tjera...

Çfarë tha njëri për thashethemet e Sylës në kohën e shtetrrethimit

Syla ka filluar të mbledhë një ushtri të madhe,që do të luftojë deri në pikë të fundit.

Armata e tij përbëhet nga:

dhjetëshja e gomarëve,

dhjetëshja e demave,

dhjetëshja e derrave,

dhjetëshja e zagarëve,

dhjetëshja e maceve,

dhjetëshja e lepujve,

dhjetëshja e gjelave,

dhjetëshja e patave,

dhjetëshja e rosave,

dhjetëshja e krimbave dhe

dhjetëshja e urithëve...

Komandant i përgjithshëm është cjapi i përgjakur,që rri në maje të manit dhe flet me hënën.

U tha se Syla do të niset me ushtrinë e tij të jashtëzakonshme çastin që do të hetoj se i madh e i vogël në qytezë i kanë mbushur tlinat...

Të nesërmen, po ai njeri,i rrotulloi fjalët dhe për Sylon tha edhe këto që gjenden më poshtë:

- a) Syla as që ka folur ndonjëherë. Ai nuk ka kuptuar gjuhën e njerëzve. Ishte një kafshë që rastësisht doli me dukje njeriu. Në të vërtetë kafshë ishte dhe kafshë mbeti...*
- b) Ato që thonë se i flet Syla,i flet dikush tjetër,nga ata të padukshmit që shtohen dita-ditës...Kryehetuesi dhe hetuesit tjerë,që i kurdisin të gjitha,këto ia veshin Sylës që ashtu të kenë mundësi për të burgosur sa më shumë njerëz të rëndësishëm...*
- c) Ato që dëgjohen nëpër rrugë bashkë me pamfletet e shkruara, për të cilat thuhet se janë vepër e Sylës, në të vërtetë janë sherri që vinë nga shtabet e shtetrrethimit... Hetuesit i trillojnë të gjitha për t'i arsyetuar pastaj bastisjet, burgimet dhe dhunën,e së fundit, edhe kohëzgjatjen e pafund të shtetrrethimit. Me një fjalë, Kryehetuesi duhet të ketë „dëshmi të bollshme“ se „armiku po vepron“... Andaj, është më se e qartë pse atëherë duhet të merren masat e nevojshme dhe të domosdoshme...*
- d) Se ato që shkruhen dhe thuhën njëmend i flet ndonjë nga tanët,por që ai në të vërtetë paguhet nga Kryehetuesi dhe njerëzit e tij. Pra,kryen urdhrat e tyre?...*

P.S.

Si mos t'i luajë njeriut mendja nga ky panair mendimesh dhe gjykimesh ndër më të çuditshmet?...Si?...

Disa thashetheme të tjera në kohën e shtetrrethimit

-Sali Therra zuri peshkun njëqind okësh në livadh!

(-Me këta sy e pashë,-u përbe Himë Qafziu.-E kishte lidhur për bisht të gomarit dhe e tërhiqte zvarrë përpjetës së Rrypës. Pas i shkonin një tufë zogjsh, që ai i trembte me anën e një filikaqe...

Shtatë ditë e shtatë net me disa gecana bëri kokrrën e sefasë nën Urën e Taliqit...)

- Dile Gëzofziu vuri xhyzlykë të diellit (ndoshta ato që i solli Sakip Brini) dhe thonë se sheh botën me lule. Me Riza Probën përdore del në namazxhah dhe thotë se bota qenka sheqer...

Një garë e çuditshme publike në kohën e shtetrrethimit

Se nga erdhi një njeri i trashë dhe i shkurtër nuk dihet, por ai tërhoqi vërejtjen për çehren e zymtë dhe një kamxhik që e mbante në dorë, me të cilin herë pas herë u binte çizmeve të gjata deri në gju, që i shkëlqenin. Trashaleci shkurtalec,apo siç do të quhet,Trashaleshkurtaleci, gjatë u soll dhe u pështoll nëpër çarshi pa folur me kë. Ditën e tretë, vetë i tretë,u pa në Fushë të sahatit tek hapte një çadër të madhe. Punoi pa ua vënë veshin kureshtarëve të shumtë, që i kishin bërë sytë katër nga të gjitha anët. Buzëmbërëmjes çadra u formësua. Ajo tashmë ngrihej e rrumbullakët dhe e lidhur nga të gjitha anët me litarë të fortë dhe të gjatë,me një majë që i dukej minare. Po të mos ishte Lon Keqi të thoshte se çadra e përhimët ishte vend cirku, kushedi sa fjalë do të harxhoheshin kot së koti për t'ia qëlluar së vërtetës.

-Çadër cirku është, tha ai disa herë dhe shtoi se këtë e dinte nga një ëndërr që i ishte shfaqur shumë herë,ku ai kishte kuptuar se cirqet ishin pjesë e asaj që njeriu mund ta shihet edhe atë që nuk shihet dhe ta kuptonte edhe atë që nuk shihet...

Kur dikush pyeti se çfarë ngjet në atë farë çadre,Lon Keqi shpjegoi se aty ndodhë çmos,që veja të bëhet pulë,që pula të bëhet ve,që njeriu të ec pa kokë e që koka të ec pa njeri...

-Kjo qenka rrenë, - i thanë të pranishmit Loni...

-Do ta shihni se nuk është rrenë,- ua ktheu ai. -Do të bindeni se si njeriu bëhet zog dhe zogu bëhet njeri...

-Ky është mashtrim i qoftëlargut,i thanë...

Lon Keqi u zu ngushtë. Dëshironte për me gjetë ndonjë shpjegim që të tregonte se si e gjitha ishte pjesë e një mashtrimit të pasherr, por këtë assesi nuk mund ta thoshte, jo vetëm që nuk dinte ta përshkruante,por as që ishte në gjendje që shpjegimin e saj ta arsyetonte...Në pamundësi që t'u përgjigjej kureshtarëve, tha se disa gjëra nuk durojnë shpjegim, ngaqë pastaj e humbin rëndësinë... Kështu është edhe me cirkun...

Mbase Lon Keqi do ta pësonte nga të pranishmit, po të mos ndodhte që çastin që disa nga kureshtarët po ia vënin rrethin, të shfaqej njëri nga ndihmësit e Trashalecshkurtalecit, që më sa zë kishte zuri të fliste rreth një gare që do të mbahej të nesërmen në cirk, e ku ftoheshin të gjithë, i madh e i vogël, pa dallim.

Atë natë cirku zuri vend në mendimet e të gjithëve. Për herë të parë pas shpalljes së shtetrrëthimit,i madh e i vogël, i përjashtuan nga koka ushtarët,bastisje,burgimet dhe gjithë ato të liga që u ranë mbi kokë.

Ç'garë ishte vallë ajo?

Çfarë do të ngjiste brenda asaj çadre të çuditshme?

A thua po vinin kohë kur vëmendja do të zhvendosej nga çështjet e mbijetimit të pasigurt tek ato që i përkisnin andrallave gjithfare, siç ishte cirku, ku Lon Keqi thoshte se njeriu sa ora mund të bëhej zog dhe zogu njeri?...

Ç'mos u mendua atë natë dhe mund të merrej me mend se sekush ëndërronte të kishte fatin që të bëhej zog...

Dita e hapjes së cirkut nuk ishte si çdo ditë tjetër. Njëfarë heshtjeje shurdhe, që vërehej në të gjitha anët, dukej se edhe njerëzit i kishte bërë si të paqenë dhe tashmë ata ishin bërë gati të pranonin kthimin në zog, mace, kalë apo çfarëdo tjetër,që do t'i lironte nga pesha e mbërthimit të së ligës në të cilën ndodheshin ç'prej kohësh,por pritnin që ndokush ta ndërmernte hapin e parë që pastaj të tjerët t'i shkonin pas...Kjo kishte bërë që rrugët të mbeteshin të zbrazëta, gjë që pronarit të cirkut ia kishte shtuar dyshimin se mund të mbetej pa punë.

Megjithatë, shqetësimin ia hoq Lon Keqi,i cili u pa të shkonte drejt çadrës me dy të tjerë,që i shkonin disa hapa pas dhe ecnin si të kishin këmbë të tepërta. Mbase kjo kishte të bënte me bindjen se tashmë ato nuk u duheshin ngaqë në cirk do të mund t'i zëvendësonin me krahë apo gjëra të tjera.

Pronari i cirkut i shikoi një copë herë si afroheshin dhe uroi që ata të kishin këmbë të mbarë. Përvoja e gjatë ia bënte me dije se kudo në fillim çadrës i afroheshin me përtësë,por edhe me përtësë largoheshin nga ajo. Dronte se ky vend kishte diçka të veçantë dhe se këtë veçanti ai po mendohej ta hetonte edhe tek hapat e hamendshëm të atyre që po i afroheshin çadrës.

Lon Keqi,edhe pse i pari tha se çadra ishte cirk dhe cirqe të tilla gjetiu kishte sa të duash,edhe vetë hamendej,sepse ato që i kishte thënë për cirqet,nuk ishin pjesë e ëndrrës,siç kishte pohuar,por i kishte nga kallëzimet e Sakip Brinit, që e kishin mrekulluar dhe i kishin mbetur në kujtesë pikërisht rreth mundësisë së kthimit të njeriut në zog apo send tjetër me të cilin ai fluturonte apo zhvendosej nga njëra gjendje në tjetrën,që për të do të thoshte çlirim i mrekullueshëm...Në rrugë për në çadër ai kishte këtë dëshirë,por që sa më shumë i afrohej

asaj mbërthehej nga ndjenja e një frike se në vend të zogut mund të kthehej në ndonjë urith apo minj,që të dënohej edhe më rëndë se sa njeriu?... Këtë deshi t'ua thoshte edhe atyre që i shkonin pas,së paku ta kishin parasysh si vërejtje,por ishte shikimi përçues i Trashalecshkurtalecit me të cilin u ndesh dhe sikur ia bënte me dije se nuk kishte kthim prapa,as hamendje,pos futjes në çadër...

Përballë kësaj gjendje Lon Keqi e kishte të qartë se përpara e kishte vetëm çadrën prej nga nuk ishte i sigurt se si do të dilte, çfarë do të paraqiste dhe ç'kah do të merrte jeta e tij?... Në mendje edhe më tutje po i vetëtinin krahët e zogut dhe asgjë tjetër...

Lon Keqi më në fund u fut në cirk. Hamendjet dhe ato që atij me të drejtë i ishin mbërthyer në kokë,nuk i kanë interesuar kronistit. E rëndësishme ishte se ai, pas shalakatjeve dhe hamendjeve,kishte hyrë brenda dhe pas tij, kush më herët e kush më vonë,kishin shkuar edhe shumë të tjerë,ndër të cilët ishin edhe Rremë Batarja,Ukë Currani dhe Lytë Ziu... Më tutje nuk u pa se kush para kujt u fut në cirk. Por, është e vërtetë se në hapësirën e përbashkët në çadër tek ëndërrohej për t'u kthyer në një qenie tjetër më fatlume u gjenden edhe Dan Pelimi,Cenë Karremi,Gogo Geci,Dan Ziu, Shahini i Taliqëve, Njazi i Qerimit,Ukë Canauka, Cyme Shelnja,Lytë Bardhziu, Lam Metahasi,Selami Daci, Shahin Lyta, Selami Koka, Sabri Hamalli, Shahin Lala, Nikë Zogjani, Nikollë Krroçi, Irfan Dibran, Lim Guri, Hilë Lehta, Mon Sefaha, Leci i Lamalecit, e veja e Hyrrit, Zymrija e Kullurit, Liti i Cenit, Riza Probja, Dile Gëzofziu,Gon Xhuxhi, Mon Xhuxhi, Cen Zhegu, Hilmi Gaxha, Xajë Llastra, Gani Pasuli, vejusha Nerimane, Sali Therra, Hilmi Qafgjati e edhe ca të tjerë...

I kënaqur që në arenë kishte shumë veta,Trashalecshkurtaleci,u shfaq në pjesën ballore dhe pasi i shikoi të gjithë një nga një shpjegoi se si gara ishte fare e thjeshtë. Tha se ai do të flisë diçka,çka do, dhe ai që nuk mund të përmbahet,pra që flet apo kundërshton,e lëshon garën,ndërkohë fiton ai që deri në fund i përmbahet heshtjes. Pra, heshtja dhe vetëm heshtja shpërblehej...

Të pranishmit zunë të shikonin njëri-tjetrin habitshëm. Kishin pritur që të ndodhte ndonjë sprovë me të cilën ata do të fitonin mundësinë që nga njeriu të ktheheshin në zogj apo në qenie të tjera dhe jo të heshtnin ndaj atyre që thuheshin?...Por, meqë ishin futur brenda,ia vlente që të provohej gara e parë ku matej heshtja,pra durimi që të mos flitet,që për shumicën e atyre që ishin aty,përmbajtja nuk ishte gjithaq e lehtë, ngaqë ishin mësuar me thashetheme, ku shpejtësia e përfoljeve ,e kthyer në një instinkt, luante një rol të veçantë...

Kronisti, (pra autori i këtyre rreshtave),shikonte si i ngrirë dhe priste me padurim se ç'fjalë ishin ato me të cilat do të sprovoheshin të pranishmit dhe priste se si do të kundërpërgjigjeshin ata që nuk kishin qarë kokën për të pasur mendim të vetin?

Pas pak Trashalecshkurtaleci dha shenjë se gara mund të fillonte.

Hapësira e ngushtë e çadrës u bë edhe më e ngushtë nga jehona e daullës. Kur ajo për pak pushoi,Trashalecshkurtaleci tha:

-Bora është e zezë...

Heshtje.

-Bora është e zezë,tha ai prapë.

Lon Keqi sa nuk tha se bora ishte e bardhë,por kur i shkoi mendja se duhej të heshte dhe kusht për të shkuar më tutje ishte heshtja, mezi u përmbajt. Koka e tij,që nuk ishte mësuar me mendime të thella,u shqetësua dukshëm, ngase për herë të parë duhej të mendonte para se të nxirrte gjuhën. Kjo iu duk tepër e vështirë dhe po të mos e kishte kafshuar atë,doemos se do të fliste.

Edhe të tjerët heshtën. Trashalecshkurtaleci,që i mati mirë e mirë, përsëriti të njëjtat fjalë.

Prapë mbretëroi heshtja. Prapë jehona e tamtameve të daulles plotësonte thekshëm hapësirën e kohës midis fjalëve të pronarit të cirkut dhe sprovës së garuesve.

-Bora është e zezë!

-Bora është e zezë!

-Bora e zezë...

Ato fjalë tashmë ishin kthyer në jehonë dhe të përcjella nga daullet krijonin ndjenjën e territ,që shumëkujt i vinte si një kërcënim tjetër,si diçka që paralajmëronte një ogur edhe më të ligë nga ai nëpër të cilin kapërcenin.

Nuk vonoi dhe nga turma shpërtheu një zë gjithë pezëm:

-Poshtë e zeza!...Mjaft më të!...Mjaft...

Ishte Loni Keqi,i cili sikur t'i kishte rënë mohit, mbylli gojën dhe u shtir sikur të mos ishte ai që kishte folur me mllef.

Trashalecshkurtaleci ua bëri me dorë rojeve për me e nxjerrë atë që kishte folur. Loni kur u ndodh në duart e rojave,që po e nxirrnin,u zu ngushtë, ngaqë nuk ishte i sigurt se a duhej të kundërshtonte apo të pranonte heshtazi humbjen. Por, një ndjenjë mllefi që i shpërtheu bëri t'ia hapte gojën dhe të thoshte se nuk ishte i marrë,se i kishte ardhur te hunda të merrte të bardhën për të zezë dhe të zezën për të bardhë,e tjera e tjera,që ai do t'i fliste edhe më,po mos të kishte përfunduar jashtë...

Në çadër mbeti për pak jehona e fjalëve të Lon Keqit e shkapërderdhur,por qenë tamtamet e daulles që atë shpejt e bënë të paqenë...

-Uji shkon përpjetë,-tha Trashalecshkutalevi.

Heshtje.

-Uji shkon përpjetë,-tha edhe për të dytën herë. E të njëjtën e përsëriti edhe shumë herë.

Prapë heshtje.

Prapë jehuan daullet,që binin gjithnjë e më fuqishëm.

-Uji shkon përpjetë!...

-Uji përpjetë!

-Ujiiiiiii!...

Atë thekamë e ndërpreu një e qeshur po ashtu e thekshme,që u përhap në cirk nga të gjitha anët.

Ai që po qeshte ishte Ukë Currani. Qeshte gjithë djersë dhe i mbante brinjët.

-Kjo nuk është garë por njëfarë gënjeshtre,tha pasi hoqi dorë nga e qeshura e thekshme...Kjo është më se e qartë...Gënjeshtra përdoret që të dalim nga lëkura...

Trashalecshurtaleci nuk u dha kurrfarë shenje ndihmësve ta nxirrnin Ukën,ngaqë ai tha se nuk e kishte ndërmend të rrinte më aty ku gënjehej aq paftyreshëm dhe nuk bënte të kundërshtojë...

-Mos mendo se më munde,tha.-Mashtrohes.

-Loja mbaroi, tha pronari i cirkut qetas.-E humbe garën...

-Nuk e humba,-ia ktheu ai.-Nuk e humba. Përkundrazi e fitova pikërisht pse dola prej saj...Ta pranosh një lojë të tillë do të thotë të pajtohesh me mashtrimin. Këtë nuk e dëshiroj. Mirëmbetshi!

Trashalecshkurtaleci ftohtas përcolli largimin e Ukë Curranit dhe sapo doli tha:

-Hëna në bisht,dielli në gisht...

Ende pa e mbaruar mendimin,dikush priti e tha:

-Gishti në bisht, e bishti në gisht...

Ishte Lytë Ziu,që po fliste gjithë zemrim:

-Pse e dallashon mendimin?...Pse s'ë thua si duhet,ku këtë e dinë i madh e i vogël?...

-Edhe për ty gara përfundoi,foli Trashalecshkurtaleci...

-Unë as që fola,tha Lytë Ziu,përsërita atë që ti e dallashove.

Pronari cirkut heshti. Shtirej se nuk e shihte.

-Lehtë është ta kapësh njeriun për gjuhe dhe ta heqësh pastaj zvarrë,tha Lyta. Kështu secili hedhet në gjunjë...

Lyta tha edhe diçka,por tamtamet e daulleve ishin më të forta se sa fjalët e tij...

-Qengji e ha ujkun,tha Trashalecshkurtaleci.

-Qengji e ha ujkun!
-Qengji e ha ujkun!
Serish heshtje e thellë.
-Qengji e ha ujkun!
-Qengji e ha ujkun!
-Qengji haannnnn!...

Arena shungullonte nga ato fjalë. Të përziëra me tamtamet e daulleve,ato bëheshin edhe më të thekshme saqë ajo haaannëëëë ishte kthyer në një kërcënim.

-Qengjiiiiiiii!...Qengjiiiiiiii!...Haaaaannnëëëë!...

-Mjaft se u çmendëm,folën disa veta si me një zë.-Edhe i marri e di se qengji nuk mund ta hajë ujkun,por ujku e ha qengjin...Mjaft!...

Ata që kundërshtuan ishin Dan Pehlivani,Cen Karremi,Gogo Geci dhe Shahini i Taliqëve. Ndër ta më i zëshmi ishte Gogo Geci, që ishte skuqur dhe bërë all nga çirret. Sa më shumë fliste fjalët i bëheshin të pakuptimta. Nga goja i shpërthenin jargët bashkë me një pështymë që hapej gjithë stërpikë.

-Si s'ke turp të thuash kështu!Çirresh pareshtur me këtë gënjeshtër!...Mendon se jemi të marrë,tha Dan Pehlivani.

-Je vetë ujku, tha Cen Karremi.

Trashalecshkurtaleci nuk ua vuri veshin atyre që po i thoshin ata në të dalë. Ishte i kënaqur që kundërshtimet po bëheshin gjithnjë e më të mëdha dhe ata që largoheshin humbnin torrun. Pas një pushim të shkurtër tha:

-Pleshti sa një buall!

-Gënjeshtër,ndërhyri Njaziu i Qerimit. -Ku ka plesht sa një buall?...Deri kur do t'i durojmë këto muhalife?...Dëgjojmë marrina dhe shtiremi se nuk i dëgjojmë...Deri kur kështu?...Sa vlen çmimi i një mashtrimi të tillë?...Ika...

Ende pa dalë mirë Njaziu i Qerimit,ai tha:

-Bualli sa një plesht!

-Prapë po gënjen,tha Ukë Canauka.-Ku ka buall sa një plesht?...Kujton se jemi të marrë?...

Pronari vuri buzën në gaz sikur t'i vinte mirë që ia kishte dalë t'i bënte të papërmbajtshëm.

-Nuk kam parë,bre vëlla,njeri si ti,që flet rrena klluqe dhe nuk skuqesh fare...Nuk kam parë të tillë...Unë skuqem për ato që thua ti...

-Lepuri ka dy këmbë...

-Jo dy,por pesëmbëdhjetë, foli Lytë Bardhziu gjithë pezëm.-Pse të mos i ketë pesëmbëdhjetë po qe se i ka dy?...

-Sepse i ka vetëm dy,-foli pronari me tallje...

-Kështu është kur ke punë me djaj,tha Lyta.-Kur ke punë me gënjeshtar...Me të tillët humbjen e ke të pashmangshme...

Trashalecshkurtaleci nuk ua vuri veshin atyre që po i thoshte Lyta në të dalë. Mori qëndrim mospërfillës dhe tha:

-Fluturon,fluturon peshku...

-Fluturon jot amë,-ia priti Lam Metahasi.

Sikur ta kishte pritur këtë shkrim Trashalecshkurtaleci zuri të qeshte gjithë nënçmim. Dukej se nga të qeshurat do t'i pëlcitnin mollëzat e mbufatura.

-Edhe ata që dëgjojnë këto gënjeshtër janë të marrë,-tha Lami kur po largohej.- Të gjithë,të gjithë jemi të marrë...Mjerë ne!...

Një nga një arenën e lëshuan shumë veta. Pronari ishte gjithnjë e më i kënaqur,ngase nuk i nevojiteshin më përsëritjet e mundimshme apo zgjatjet, sepse sapo fliste kundërshtojë jo rrallë edhe prej shumë vetash me një gojë.

Kështu ndodhi përderisa në arenë mbetën tre veta:Dile Gëzofziu,Riza Probja dhe Xajë Llastra.

Ata shikonin njëri tjetrin dhe heshtnin.Nuk ia vinin fare veshin pronarit dhe atyre që thoshte ai.

Kjo po e shqetësonte Trashalecshkurtalecin, i cili fliste,çirrej,kërkonte që daullja të binte më thekshëm dhe më zhurmshëm.

Por Dile Gëzofziu,Riza Probja dhe Xajë Llasta nuk jepeshin që nuk jepeshin. I kishin futur veshët në lesh dhe aq u bëhej për ato që dëgjoheshin të thuheshin.

Çastin që mospërfillja e tyre ishte thadruar fare,Trashalecshkurtaleci nisi të çirrej dhe t'u thoshte se ishin të shurdhër,se si të shurdhër nuk e kishin pasur vendin në garë,se ishin mashtrimtar,e tjera e të tjera...

Por ata heshtnin dhe ia bënë me dije se nuk ishin të shurdhër,gjë që pronarit edhe më shumë i shtoheshin gjindtë...

-Mbase jeni të marrë?...Vetëm i marri sillet papërfillshëm ndaj atyre që i thuhën...Vetëm i marri rri si i ngrirë...Të tillë jeni,apo jo?...

Një copë herë ai i fyti.U tha çmos,por Dilja,Rizaja dhe Xaja shikonin njëri-tjetrin dhe nuk ia varnin fare Trashalecshkurtalecit.

Dikur ai urdhëroi të pushonin daullet. Pllakosi një heshtje,në të cilën ai zuri të fliste qetash dhe sikur të mos ishte ai i pakmëparshmi.

-Mbase gabova paksa kur ju quajta të marrë,tha ai?-Ju nuk jeni të marrë. Harrova se jeni në garë dhe e juaja është të qëndroni. Këtë nuk mund t'ia fal vetes. Bëra një gabim të madh. Po shoh se ju jeni të dëgjueshëm...Unë e di se ju po i përcillni ato që po them dhe pajtoheni me to...Gënjen ai që thotë se nuk keni vesh e sy...Gënjen ai që thotë se ju nuk keni gojë...Ju keni gojë,ju keni vesh dhe jeni tepër të dëgjueshëm...Jeni shumë të dëgjueshëm...Të tillë ishit dhe të tillë do të mbeteni...E di këtë...E di...Apo,jo?...

Pas pak zbriti në arenë dhe po u thoshte:

-Ju jeni të mirë...Jeni të dëgjueshëm...Ju jeni me mua?...Apo jo?...

Kur po matej të kthehej në pjesën ballore prej nga fliste,hetoi se ata të tre nuk rrinin më kokë më kokë,por iu kthyen dhe nisen t'i flasin me një gojë se ishte mashtrues.

-Asnjëherë nuk kemi qenë me ty,thanë ata me një gojë.-Flet gënjeshtër! Asnjëherë nuk kemi qenë me ty!...Pse dëshiron të na njollosësh kur e sheh se nuk na nënshtrojnë?...

Dile Gëzofziu,ashtu e madhe që ishte,e zuri për fyti dhe po mos të ishin ndihmësit,që nxituan t'ia hiqnin prej duarve,do ta pëlçiste.

-Pse na fyen,or derr debederr?...Pse flet kështu kur nuk ta kemi borxh?...

Pronari filloi të qeshte.

-A s'e keni të qartë se humbet?...Kush ju ka faj që nuk i dalloni fjalët e mira nga ato me bishta?...Kush ju ka faj që lajkat i merrni për të vërtetat e të vërtetat për lajka?...

-Na e nxore gjuhën,-tha Riza Probja...Por ne të mundëm...

Ai po vazhdonte të qeshte.

-Lajkatar!- shfreu prapë Riza Probja me zërin e hollë si të sorrës.

Xim Llastra po qante. Lotët dhe jargë i shkonin poshtë dhe i vareshin deri te këmbët.

-Tash më nuk ka heshtakë,tha Trashalecshkurtaleci.-U thanë ato që u desh të thuheshin...Unë e bëj edhe gurin të flasë...

Por,çastin që po bënte me dorë për ta shpallur garën të përfunduar dhe të fituar,hetoi se në të gjendej dikush,që lente për të kuptuar se loja nuk kishte përfunduar,se ajo duhej të vazhdonte përderisa në të mos kishte njeri. Pronari fërkoj sytë dhe nisi të thoshte se nuk duhej të kishte tjetër në arenë,ngaqë të fundit ishin tre veta që tashmë atë e kishin lëshuar...

Një copë herë foli ashtu dhe si të kërkonte përkrahje nga publiku doli në arenë.

-A nuk ishin ata tre të fundit?-po pyeste publikun.

Publiku,që po bëhej gati ta lëshonte arenën,hetoi se poshtë rrinte plaka Shahe Kërraba,si e gozhduar.

-Kjo plakë e mallkuar nuk ishte këtu,- tha pronari.-Nga doli tash?...

Pastaj iu drejtua ndihmësve:

-Kush e solli?...

Ata heshtnin dhe dridheshin.

-Nga polli?...Pse shikoni si të marrë?...

-Dyert ishin të mbyllura,- thanë ata.-Nuk kishte mundësi kush të hynte gjatë lojës...

-Mos piku nga qielli?...

Ata rrudhën krahët.

Ai shikoi sërish publikun. Por askush nuk po thoshte gjë. Të gjithë pritnin se çfarë do të ndodhte.

-Mirë pra,-foli ai gjithë zemërim,- përpara kam një plakë kërcunj,e cila çdo çast mund të japë shpirt. Mbase ajo dëshiron që këtë ta bëjë sy botës?...

U kthye në vendin e vet dhe pasi urdhëroi të binin tamtamet me sa forcë kishin,tha:

-Bora është e zezë!

-Uji shkon përtpjetë!

-Qengji e ha ujkun!

-Lepuri ka dy këmbë!

-Bualli si plesht!

-Pleshti buall!

Por,plaka as që ua vinte veshi atyre që thoshte ai. Rrinte në mes të arenës dhe shikonte një pikë të lartë,aty ku bashkoheshin litarët. Dukej se flinte.

-Zhurmë!Sa më shumë zhurmë dua!- tha pronari.

Arena shungullonte nga zhurma e fuqishme.

-Zhurmë!Sa më shumë zhurmë! Sa më shumë zhurmë!Zhurmëëëëëë!...

Zhurma u bë aq e madhe sa disa në publik nuk po mund e duronin. Kërkonin të ndërpritej. Por, Trashalecshkurtaleci nuk pranonte të ndalej. Thoshte se kjo do të varej prej plakës dhe sjelljeve të saj.

-Me të keni punë,-po thoshte.-Ajo mund t'iu shpëtojë... Nëse nuk flet shtriga, do të çmendeni të gjithë...Rrugë tjetër nuk ka...

Të pranishmit po i mbyllnin veshët me duar.

-Nuk ka mëshirë! Nuk ka qetësi! Mua nuk më ka mundur kush...

Dhe plaka Shahe Kërraba dukej se kishte fjetur. Rrinte si e ngrirë dhe shikonte atë pikën në maje...

Nga mospërfillja pronari po çmendej. Kërkoi edhe daulle të tjera,por i thanë se nuk kishte më.

-Më shumë zhurmë! Më shumë zhurmë dua!- po çirrej.

Por daullet zunë të pelcisinin. Një nga një pëlcitën sa pushuan fare.

-Ah,-shfreu ai,- këtë nuk e prisja...Këtë nuk e prisja...

I tha këto dhe u shemb nga vendi prej nga urdhëronte. I shkallmuar kërkonte derën.

-Do të kthehem...Do të kthehem me shumë daulle...Mendoni se do ta harroj këtë?...Mashtroheni...Do të kthehem...

Në arenë mbretëroi një qetësi shurdhe. Shahe Kërraba edhe ca mbeti si e ngrirë.Dikur,si të zgjohej nga ndonjë gjumë i thellë, pasi që ferkoi sytë, tha:

-Ah, kjo qetësia! dhe u bë e padukshme...

Çfarë tha pastaj Shahe Kërraba botërisht pas asaj gare të çuditshme?

Kur e kaloi fushën e Sahatit dhe doli në shesh,Shahe Kërraba dukej si korb. Të paktë ishin ata që mbanin mend kur e kishte kaluar ajo për herë të fundi pragun e derës së shtëpisë. Megjithatë,ajo ecte me mospërfillje,sikur të zotëronte gjithë hapësirën që kishte para bashkë me ato që ishin aty. Një copë herë shikoi andej-këndeje e së fundi u ndal te shatërvani i vogël,

ku sa ora para saj u formua një gjysmërreth, ngaqë sekush dëshironte ta shihte sa më mirë plakën për të cilën flitej aq shumë kohëve të fundit. Si ta hetonte kërshërinë e tyre, Shahe Kërraba, preku currilat e ujit, lagu ballin e u kthye nga ata. Të pranishmit panë një krijesë që dukej si të kishte dalë nga ndonjë akullnajë.

Dhe, shih mrekullinë, plaka pa pritur e pa kujtuar, ia mori një kënge, që e thoshte si ndër hundë. Ata që i rrinin pranë nuk kuptonin gjë prej gjëje nga ato që thoshte plaka. Madje, askush nuk ishte i sigurt se a këndonte apo vajtonte?

-E ka harrur gjuhën e njerëzve, -tha njëri.

-Si të mos e harrojë kur jeton me të vdekur, -foli tjetri.

-Betohem në tokë e në qiell se edhe tash flet me të vdekurit, -shtoi një i tretë.

-Nuk mund të thuhet me tamam se cilës botë i takon kjo plakë: sonës apo asaj tjetrës?...

-Po jetojmë në kohë të papërcaktuara, kur ngatërrohet edhe kufiri midis jetës dhe vdekjes...

Pasi e la këndimin apo vajtimin, plaka zuri të sillej në vend me mospërfillje. I ngrehte duart përpjetë dhe bënte me to kah dielli, sikur dëshironte ta ndiqte rrugën e tij dhe në atë ndjekje të shkëmbente porosi të pavërejtura, që jepen dhe merren vetëm me anën e shenjave të lëvizjeve. Druhej se plaka mund të rrëzohej nga marramendja, që rrok ata që sillen ashtu, por plaka mbahej dhe nuk jepte shenja trullimi.

Kur dielli kishte marrë rrugën e perëndimit dhe po i afrohej majës së Shkëlzenit, plaka foli e tha:

„Mirë se erdhët...”

Bënte si të merrte ngryk dikë.

„Mirë se erdhët...”

„...ju pastë nana...”

-A të thashë se moti ka vdekur, -po i thoshte një tjetri ai që foli pak më parë. -Kjo ka vdekur qëmoti... Vetëm hijallin e ka ndër të gjallë, ndërsa shpirtin në atë dynja...

-Përnjëmend po shfaqet ajo ngatërresa kur të vdekurit bëhen si të gjallë e të gjallët sillen si të vdekur?... -ia ktheu tjetri...

Por plaka edhe më tutje vazhdoi të fliste me dike.

„Bëtë mirë që erdhët... Ishte koha të vinit...” - po thoshte.

„Njëmijë vjet janë si shumë...”

„Njëmijë vjet...”

„Të shkretat...”

Pas një pushimi ajo vazhdoi të fliste me dikë që e shihte pranë dhe mund të merrej me mend se ishin fëmijët kaherë të vdekur.

„More, Xim, sa shpejtë kaluan treqind vjet... Shkuan si uji...”

„Po ty, Xërxo, sa t’u bënë?... Pesqind?... Auuuu?... Pesëqind dhe të duken si shumë?... ”

„Sa qenke rritur, Xyth?... I kalove të gjashtëqindëtat?... ”

„Po, ti, Xen, i mbushe shtatëqind?... Kush do të thoshte se do të mbetesh xhuxhimaxhuxh?... ”

„Shih, shih, Xenin!... Sa t’u paskan rritur mustaqet?... Thua se për to t’u deshën tetëqind vjet?... Auuuu!”

„Të duken pak, njëqind vite Xuma i nanës?... Nuk je më carrok, të pastë nana... Fija e flokut t’u paska dredhur... E ke kohën e begenisë...”

„Po Xixa, nuk do të vijë?... Ti sugar nuk e mbajte fjalën... Thoshe se do ta sjellësh së paku një herë në njëqind vjet?... A e harrove fjalën e dhënë?... Thua se do ta sjellësh?... Po kur?... Kur të bëhen nëntëqind?... ”

Pas atyre që tha, plaka iu kthye ritualit të pakmëparshëm. Zuri të sillej më shpejt. Në atë rrotullim marramendës dukej si një piring i zi, që herë ngrihej, e herë sharronte diku. Kur dielli preku majën e bjeshkës, plaka serish foli.

(Kronisti i shënoi pikë për pikë ato që i tha ajo, qoftë si pyetje, qoftë si përgjigje. U përpoq të mos linte gjë pa e kapur nga ato që ia zinte veshi...)

„...Zhurma... Ka zhurmë... Nuk po ka të ndalë...“

(Pushim i shkurtër. Plaka ngriti duart përtpjetë.)

...Ju thoni dhe pyesin: ku jemi ne?... A?...

-Paj,ku ishim gjithnjë... Nuk kemi se nga t'ia mbajmë...

...Ju thoni dhe pyesni:a duhet të bëjmë diçka?

-Kush thotë se bëjmë vetëm sehir?... A nuk është edhe ky një ballafaqim i madhërishtëm, që po zhvillohet?...

...Ju thoni:a mund të zgjasë shumë zhurma?...

-Do të zgjasë... Do të zgjasë... Kjo dihet fare mirë... Zhurma do të zgjasë... Ajo është pjesë e ballafaqimit tonë me të... Është pjesë e matjes...

...Ju druani se kështu ajo nuk do të ketë të ndalë?...

-Pranë kur do ta kuptojë se mosnënshtrimi do të ngrihet në nivel të kundërvënies...

...Ju thoni se me sehire nuk bëhet kjo?...

-E qartë, e qartë, por edhe durimi është pjesë e kundërvënies... Thadron atë që duhet të shpërthejë, që të mos shkojë huq fuqia e saj...

...Ju thoni se keni frikë nga sëmundja e gjumit?... Se keni frikë nga stërkeqja?... Se keni frikë nga kapja e eshtrave?...

-Nuk po flihet,biro... Nuk është çështje gjumi kjo... Nuk është puna tek pushteti i ëndrrave, por për vetënjohje, për hetimin e asaj që është strukur, që një ditë duhet të lidhet dhe rilidhet me anën e rizgjimit... E gjitha kjo zgjat ngaqë nuk ka zgjim pa rizgjim... Kundërvënia nuk është ndjenjë, por veprim... I duhet kohë për t'u ngritur tek shkalla e lëvizjes së përgjithshme... Pra, nuk është çast, por ndërlidhje e brendshme e vetëdijes si vetëdijesim...

Plaka një copë herë i përsëriti fjalët rreth zgjimit dhe rizgjimit si dhe ato rreth kundërvënies si veprim. Sheshi po jehonte nga fjalët „zgjim,rizgjim“,që i thoshte sikur t'i nxirrte nga një thellësi tepër e madhe, që për t'u liruar prej andej u duhet dridhja e jashtëzakonshme, apo tërmeti shpërthyes... Plaka po fliste rreth atij tërmeti shpërthyes që do të ndodhte patjetër dhe se dukej se pikërisht çasti që zinte n'gojë tërmetin i gjithë sheshi tronditej bashkë me Tendën Blu dhe ushtarët e shumtë,të cilët po e humbin durimin...

Dhe kur dukej se përnjëmend ajo dridhje do të ndodhte,një ushtarak thatak, i veshur me të zeza, urdhëroi të kapej plaka.

-Kapeni gërzhulën-tha,- para se të shpërthejë magjia e saj!

Të pranishmit u ngrinë. Çfarë do të ngjante, vallë?... Mos ashtu fillonte ajo kundërvënia që plaka e kishte paralajmëruar gjatë ritualit të saj?...

Shahe Kërraba nuk ua vuri veshin fjalëve të ushtarakut. Vazhdoi ritualin e saj me fjalët n'gojë rreth zgjimit dhe rizgjimit, që tashmë të ndërlidhura i ngjanin një kumti.

-Kapeni!- u çor prapë ushtaraku.

Por, ushtarët që bënë vetëm disa hapa drejt saj, u ndalën.

Ushtaraku mend plasi nga tërbimi kur pa se si ushtarët mbetën të ngrirë para saj...

-Do t'ua tregoj juve!-tha ushtaraku.-Do t'u hedh në litar!

Megjithatë, ushtarët nuk po e çonin në vend urdhrin edhe përkundër kërcënimit të litarit, që i priste në shesh. Një copë herë shikuan majtas dhe djathtas dhe morën ikën.

-Në litar!Në litar frikacakët!Qe tash të varen!...

Ushtaraku e dha urdhrin dhe u nis nga plaka. Pas dy-tre hapave,zuri të shalakatej. I gjithë sheshi u bë sy e vesh. Nga prapa armët po bëheshin gati. Pritej se çfarë do të bënte plaka kur t'i afrohej ushtaraku?... Shumica uronin që ajo të bëhej e padukshme...

Dhe përnjëmend, sapo ushtaraku iu afrua vetëm tre hapa Shahe Kërrabës, ajo u bë e padukshme.

Aty ku pak më parë sillej dhe ushtronte ritualin, mbeti një zbrazëti, që megjithatë përthekohet nga fjalët zgjim-rizgjim, që edhe më tutje thuheshin dhe prej andej përhapeshin në gjithë sheshin dhe tutje tij si diçka e jashtëzakonshme...

Ushtaraku u rrëzua nga shqetësimi.

-A ju thashë se ajo është frikacake?...A ju thashë se ajo është frikacake?...A nuk ju thashë se asaj nuk ia mban me ne?...

Me këto fjalë n'gojë ushtaraku u ngrit. I trimëruar çuditërisht, ai shkoi mu aty ku kohë më parë rrinte plaka dhe zuri të shqelmonte tokën.

-A ju thashë se ajo është vetëm një përftim i marrë?... Pjesë e magjisë së zezë... Këtë e dija... Këtë e dija...

Zuri të qeshte. Po kërkonte që t'i bashkoheshin edhe të tjerët, që rrinin me armë të ngrehura dhe prisnin urdhrin për veprim.

Por, pa një pa dy, kur masa e ushtarëve ndodhej në lëvizje drejt sheshit, serish u shfaq Shahe Kërraba, pikërisht ku ishte më parë.

Ushtaraku u shemb përdhe si i vdekur.

Një "uuuu" erdhi nga të gjitha anët e sheshit dhe më pas u bë një pështjellim i paparë.

-Mos u kurseni armët e perandorisë,-tha dikush. -Shkreptni nga të gjitha anët!... Shkreptni!...

Më tutje nuk di se çfarë ndodhi... Nata erdhi shpejt dhe terri mbuloi kufomat dhe gjurmët e gjakut...

Në atë gjendje të papërcaktuar që ndodhesha, më bëhej se fjalët e Shahe Kërrabës rreth zgjimit të rizgjimit po i thosha edhe unë, se ato tashmë ishin bërë pjesë e asaj që quhet njohje dhe vetënjohje, që i duheshin kundërvënies...

I bindur se një shumëzërshmeri kishte ndërlidhur shkapërderdhjen që do të shpinte tek rizgjimi i pashmangshëm dhe prej andej edhe deri te kundërvënia e domosdoshme, ndjeva zërin e thirrjes së shpirtit që po u bashkohej të tjerëve dhe se në atë gjendjeje tejte superiore, fare i qetë prita trokitjen e derës dhe thyerjen e saj, që do të ndodhte pas pak..."

Një rreze drite hyri në tendë kur Pashai u ra në fund shënimeve të Poetit. Dhe ajo rreze çuditërisht po ia kthjellonte mendjen, sa që gjithë ato fjalë, gjithë ato ngjarje, gjithë ato veprime, e mbi të gjitha personat po i dukeshin të njohur, thuajse gjithmonë kishte qenë midis tyre! Iu bë se edhe ai gjendej pranë tyre dhe ndoshta do t'u bashkohej po mos ta kishte parë, apo përfytyruar (krejt një), një perde të tejdukshme që po i ndante ata prej tij si me thikë. Ajo perde, madje, nuk po lejonte që zëri të kalonte nga njëra anë në tjetrën. I erdhi keq që ajo perde qëndronte midis tyre dhe pos që i ndante pengonte edhe afrinë e të kuptuarit. Dikur iu bë se përtej perdes pa Poetin të gjakosur me fletore në dorë. Ishte mu ajo fletorja që i ra në fund pak më parë. I dalloi edhe gjurmët e gjakut në të. Ai bëri disa hapa drejt tij dhe u ndal mu aty ku ai e merrte me mend se gjendej perdja e tejdukshme e ndarjes. Ndonëse dukej i shkallmuar, sytë i kishte të kaltër dhe gjithë jetë. Ai po thoshte diçka. Fliste e fliste pareshtur sikur të dëshironte të qartësonte diçka doemos... Dikur zuri të bënte me duar, me kokë dhe ta lëvizte trupin djathtas e majtas... Më vonë Poeti e hapi fletoren dhe po kërkonte diçka në të. Në atë shikim atij fletorja po i rritej e po i rritej sa u bë sa vetë Poeti, ndërkohë që Poeti bënte me gisht kah fjalët e shkëputura, që lidheshin me pika të shumta... Por, pikat tash po bëheshin shumë të mëdha, puse të thella. Mendja ia tha se Poeti kërkonte që hapësira me pika të mëdha, që atij i dukej si hapësirës pusesh, duhej të mbushej me shkronja të tjera, ose me fjalë të tjera, që pusët të mos dukeshin më dhe në vend të tyre të shfaqeshin kuptimet tjera, ato që Poeti qëllimisht i kishte lënë të fshehura nga frika se do të mund të zbërtheheshin dhe kuptoheshin një ditë nga hetuesit dhe prokurorët... Madje, iu bë se Poeti po i thoshte ngulmshëm diçka rreth domosdosë së ndërlidhjes së pikave dhe të zbrazësive, se po ia bënte me dije se ato duhej plotësuar me doemos, se duhej mbindërtuar mendimet, që të

pasqyroheshin pastaj kuptimet e reja... Pa mbindertim të tekstit nuk ka kuptim, nuk ka rikuptim, nuk zbërthehet e djeshmja në të sotmen e nesërme...

Dikur ishte marrë me kuptimin e kohës ciklike dhe ndikimet e saj tek zhvillimi, që pushteti i qëndrueshëm të bëhet edhe më i qëndrueshëm, që pushteti i fortë të bëhet edhe më i fortë, në mënyrë që kapërcimet nga njëra dorë tek tjetra, që janë të pashmangshme, të mos e dobësojnë, por ta bëjnë edhe më të fuqishëm... Çështja e mbindertimit të tekstit në të cilin zbërthehet e djeshmja në të sotmen e nesërme, që iu bë se në atë përfitim e dëgjoi të thuhej nga Poeti, se si po ia bënte me dije një tjetër shtrirjeje të kohës, që nuk ishte vetëm rishtrirje, por rivazhdim drejtvizor i pakufishëm, që i nënshtrohet lëvizjes, që përkonte me shpejtësinë e dritës... Përfitimi që të dallonte një përkufizim të ri të kohës dhe për të të mendonte shtruar iu mbyll sakaq nga mbërthimi i përkufizimit të gjendjes në të cilën ndodhej, ku i shtroheshin vetëm çështjet e një mbijetimi të thjeshtë dhe assesi ndryshe... Kjo sikur e dëshpëroi por assesi nuk e liroi nga mbërthimet e hamendjeve dhe të kuptimeve të thella dhe rindërtimit të tyre, që po i silleshin në kokë dhe assesi t'i largoheshin... Por hetoi se për këtë ishte i papërgatitur apo edhe i paaftë fare ngaqë si vezir e pastaj si vezir i madh kishte lexuar vetëm fermanë dhe urdhëresa të qarta dhe kishte nënshkruar gjithfarë vendimesh, që ia kishin shkruar të tjerët... Dhe pas gjithë asaj sipërfaqësie dhe njëtrajtshmërie dikush po kërkonte që ai të merrej me rilexime dhe me ato që futen midis rreshtave, apo me ato që mund të merren me mend, por që pikat apo presjet bëjnë që gjërat të mos thuhën troç, por të paramendohen dhe të plotësohen...

“Jam i paaftë për këtë, po i thoshte vetes... Jam i paaftë...”

Koka po i shungullonte nga përsëritja, që i bëhej se e rrudhte dhe po e bënte si të paqenë... Dikur iu duk se ngjashëm po i fliste edhe Shahe Kërraba, e cila po i bridhte nëpër kokë dhe assesi t'i ndahej...

“Ndiqi kuptimet e dyta... Kuptimet e dyta, ato që ndodhen në thellësi...”

Ndjeu se çështja e kuptimeve të dyta dhe sfida e tyre e kishin rënduar aq shumë sa druante se nga pesha e tyre do të shembej i tëri drejt një mjegullimi të pafund.

“O zot, ndihmo ta përballoj sipërfaqësinë...”

Deshi të thoshte edhe diçka, por ishte truproja që i solli kafjallin, që e ndau nga lutja dhe po ia bënte me dije se më në fund duhej të hante diçka...

Por kafjallin nuk e futi në gojë. Fjalët e Shahe Kërrabës bashkë me shkëputjet e shumta që kërkonin të plotësoheshin, nuk po i hiqeshin nga mendja. Ato po i vërtiteshin edhe më shumë sa ndjeu t'i digjte koka. Vetëm kur mori sërish fletoren e Poetit, aty për aty ndjeu njëfarë qetësimi pushtues, që ishte i bindur se nuk e kishte nga vetja.

“Çfarë po ngjet kështu?... Dikush është futur në mua...”

Me atë shqetësim, që nuk dinte si ta shpjegonte, hapi fletoren dhe zuri ta lexonte. Tash iu bë se përpara kishte një tjetër shkrim, të mbushur plot e përplot sinkopa dhe shkëputje të tjera... Sytë po i digjin nga pikat dhe presat që i lëviznin andej-këndej sikur të dëshironin të iknin nga hapësira e fletores, ku ishin mbërthyer. Në atë lëvizje edhe fjalët po i shfaqeshin lozonjare, herë të rrumbullakuara kuptimisht, e herë të gjymtuara fare... Bile, edhe ato kuptime që mund t'i lidhte, tevona i dilnin të shthurura, kështu që nuk e dinte se çfarë në të vërtetë kishte përpara: një rrëfim, që pak më parë e kishte lexuar me shumë interes, apo një tjetër merimangë, që nuk ia hetonte kund fillin dhe as fundin?... Në atë përpëlitje edhe personazhet i shfaqeshin të ngatërruar fund e krye, herë si gjysmënjerëz, herë si gjysmëhije, herë si të përdalë fare, e herë si të paqenë... I frikësuar dhe i dëshpëruar njëherësh, mbylli fletoren dhe u shtri me dëshirën që të shkëputej nga ato ngatërime fjalësh dhe shkronjash dhe t'u ikte personazheve që i bëhej se tashmë po e ndiqnin. Megjithatë, ata po i shfaqeshin përpara, në forma dhe trajta fare të tjera, nga ato që i kishte takuar tek rrëfimi i Poetit. Kështu, Lytë Ziu mbante shumë koka në dorë; Himë Keqja dridhte ca litarë që sosnin në një kënetë; Shahini i Taliqëve pastronte thikat që kullonin gjak; Dile Gëzofziu, jashtë përmasave të panatyrshme me të cilat përshkruhej, si e përhumbur, i fliste për disa vrasje të bëra përtej

Urës së Tabakut; Riza Probja i thoshte se kishte parë disa varr të mëdha në Shkuzë, e të tjera e të tjera... Një çast madje iu bë se po e shihte edhe Sylën bashkë me cjamin, me ç'rast cjami po i thoshte se pas kishte ushtrinë më të madhe të botës që së shpejti do ta shkatërronte perandorinë dhe do të nisej për të pushtuar hënën prej nga lidhjet kryesore me botën do të mbaheshin me anën e një shkalloreje që do të vendosej në Çabrat....

Ju nuk e dini, po i thoshte cjami i Sylës, se si në Çabrat ndodhet pika e mesit të botës, që lidh fundin me kokën e saj...

Për ndryshim prej cjamin, që i fliste gjëra që e mrekullonin, Sylja po i tregonte për vendet e disa masakrave të mëdha, që ishin bërë me nënshkrimin e tij...

Me nënshkrimin tënd u bë ploja, po i thoshte ai... Nënshkrimi yt është vetë kobi... Nënshkrimi yt... Nënshkrimi yt na bëri të tillë...Ti...Ti....Tiiiiiiiiiii...

Ajo thekamë po i vinte nga të gjitha anët bashkë me personazhet që po e ndiqnin. Ata tashmë po e futnin në një mes dhe po i kërcënoheshin. Në atë pështjellim dalloj një kalë të bardhë që hingëllonte dhe bridhte majave. As vetë nuk e kuptoi pse i pëlqeu kali i bardhë dhe pse nisi të çirrej në kërkim të kalit të bardhë....

Kalin e bardhë e kërkoi edhe kur pa veqilin që po ia fshinte djersët e ftohta në ballë.

-E dua kalin e bardhë!... Kalin e bardhë të ma sillni menjëherë!...

Veqili mbeti si i ngrirë. Nuk dinte si të vepronte. Por Pashai i tha edhe për të dytën herë se e kërkonte kalin e bardhë...

-Vetëm kali i bardhë më shpëton...

Veqili doli me ngut. Ishte i bindur se ato që po i thoshte Pashai ishin pjesë e ndonjë përfatimi të ngatërruar nga ato që kohëve të fundit e mundonin si shumë. Megjithatë, atij nuk i takonte të bënte pyetje. Duhej t'i pranonte urdhrat dhe të përkujdesej që ato të zbatoheshin me përpikëri.

Kur ia solli kalin e bardhë deshi t'i thoshte se ishte vonë, se kishte kaluar mesnata, se jashtë ishte një skëterrë e paparë... Por Pashai, si ta ndiqte dikush, u ngrit me të shpejtë, qiti veladonin e purpurt krahëve dhe doli jashtë...

-Pikërisht ky kalë më duhej, tha.-Me të do të fluturoj...

Veqili dukej i zverdhur. Nuk mund ta merrte veten fare para atyre që shihte dhe dëgjonte. Një copë herë dëgjoi trokun e kalit që bartte Pashain dhe torqet e kuajve të truprojave që me të shpejtë iu vunë pas...

Seç iu kujtua se dikur kishte dëgjua një këngë në të cilën përshkruhej se si „jeta dhe vdekja ecnin në një kalë“...

Mbase ajo kishte qenë një këngë e pikëllueshme, që bënte fjalë për një të gjallë dhe një të vdekur që kushedi se si u gjendën së bashku në të njëjtin kalë dhe kalëronin fushave, kalëronin maleve, kalëronin dimrit e kalëronin vjeshtës...Vdekja kërkonte jetën e jeta kërkonte vdekjen... Në atë kalërim, megjithatë vdekja heshte, e heshte edhe jeta dhe kështu ndodhte nga bindja se vdekja mendonte se ishte vetë jeta ngaqë asaj që nuk ndalet ia paraqiste vazhdimësinë dhe po ashtu jeta mendonte se me fillimin si fund dhe fundin si fillim edhe vdekja ishte pjesë e saj... Sidoqoftë, atij iu bë se gjendej mu në atë kalë dhe ishte njëherësh edhe jetë e ishte edhe vdekje, se ishte edhe i gjallë, se ishte edhe i vdekur, se sillej në një hapësirë ku jeta ishte vdekje dhe vdekja ishte jetë... Në atë përzierje, kufiri midis jetës dhe vdekjes ishte ngatërruar aq sa mbizotëronte një gjendje e çuditërisht e paparë, ku as jeta nuk ishte e njëmendtë e as vdekja nuk ishte e njëmendtë...

Një çast iu bë se ishte vdekja e para që foli e tha:

„Ç'u ngatërruam keqas?...“

Jeta heshtte. Dëgjohej vetëm troku i kalit, i mbytur në natën e zezë, pise.

„Ç'u ngatërruam keqas?...Dhe assesi të ndahemi?...“

Dikur jeta foli e tha:

„Nuk është ngatërrese kur plotësojmë njëra-tjetrën...“

„Kështu do të duhej të ishte... Por kështu nuk po ndodh...“

Jeta serish heshti. Kërkonte ta përballonte terrin sa më parë. Dikur foli e tha se bashkërisht do të kalëronin në atë kalë për deri sa të zgjaste nata. Më pastaj secila shikon punën e vet.

„Pajtohem“.- tha vdekja.-“Përpara kemi natën e gjatë dhe ajo nuk ka si kalohet ndryshe pos bashkërisht...“

Troku i kalit u bë edhe më i fortë. Ai ishte i bindur se po sharronte thellë e më thellë në një errësirë të pafund. Dikur iu bë se po dëgjonte si bisedonin jeta dhe vdekja:

Jeta po thoshte : çuç...

Vdekja po ia kthente: truç...

Jeta po përsëriste: çuç,çuç...

Vdekja po përsëriste: truç,truç...

Jeta po ngulmonte: çuç,çuç,çuç...

Vdekja po shkulumonte:truç,truç,truç...

Jeta-vdekja:

Çuç e truç,truç e çuç...

Jeta po thoshte: nuk ishim...

Vdekja po ia kthente: ishim...

Jeta po përsëriste: nuk ishim,nuk ishim...

Vdekja po përsëriste: ishim,ishim...

Jeta po ngulmonte: nuk ishim, nuk ishim dhe nuk ishim...

Vdekja po shkulumonte:ishim,ishim dhe ishim...

Jeta-vdekja:

Shishmishishmish...

Jeta po thoshte: andej...

Vdekja po ia kthente: këndej...

Jeta-vdekja:

Andej-këndej...

Jeta po thoshte: poshtë e më poshtë...

Vdekja po ia kthente: lart e më lart...

Jeta-vdekja:

Lartëposhtëposhtëlartë...

Jeta po shoshte:bardhë...

Vdekja ia kthente: zi...

Jeta-vdekja:

Bardhëzizibardh...

Jeta po thoshte: vetëm...

Vdekja po ia kthente: bashkë...

Jeta-vdekja:

Vetëmbashkvetëm...

Jeta po thoshte: hip...

Vdekja po ia kthente: zbrit...

Jeta-Vdekja:

Hipzbrithip...

Jeta po thoshte: ftohtë...

Vdekja po ia kthente: vapë...

Jeta-Vdekja:

Asashtuaaskështu...

Jeta po thoshte: ecje...

Vdekja po ia kthente: ndalje...

Jeta-Vdekja:

Ecendalje...

Jeta po pyeste: si?...

Vdekja po ia kthente: nuk di?...

Jeta-vdekja:

Pikëpyetje?...

Sikur nuk u dëgjuan më. Edhe troku i kalit kishte mbetur në erë. Ishte i bindur se tashmë gjendej fare pranë pa qenësisë së cilës i kishte takuar gjithmonë...

Kur e hetuan rojet, nata ishte në të sosur. Ç'kishte ndodhur vallë që ai vinte ashtu në atë kohë nate i paparalajmëruar?

Ai kaloi pranë tyre sikur të mos shihte njeri. Ata që e panë ishin të bindur se ai kotej dhe ndiqte ndonjë përfytyrim të megjulluar...

Kur hyri në shesh,la kalin mënjanë dhe një copë herë ndoqi yllin e mëngjesit që po shuhej. Kur s'e pa më,u soll marramendshëm rreth shatërvanit të vogël dhe pasi bëri dhjetë hapa në të majtë e po aq drejtas, u nis kah shtëpia e vogël, dera e së cilës mezi dallohej në atë gjysmë zbardhim...

-Të prisnin...

-Gjatë të kemi pritur...

-E dinim se një ditë megjithatë do të ktheheshe...

-Si nuk paske ndryshuar?...

-Para treqind vjetësh të kemi parë të tillë...

-Edhe para pesëqind vjetësh ishe i njëjtë... Edhe para njëmijë vjetësh,madje...

-Mbase është bërë ndonjë gabim,- foli ai me një zë që po i merrej.- Unëëëë nuk jam nga e djeshmja, por e sotmja...

-Kështu thonë ata që nuk e njohin veten...

-Megjithatë,-vazhdoi ai,-këtu sikur fliten gjëra të jashtëzakonshme, që nuk t'i merr mendja dot...

-Kjo është gjuha jonë...

-Megjithatë,unë nuk e kuptoj...

-Si mund ta kuptosh kur si shumë ke bredhur jashtë vetes...

Deshi të fliste edhe diçka, por ndjeu se po i merrej goja,se po djersitej...

-Bredhjet e vonuara i kemi fat...

-Megjithatë, zuri të fliste ai,-megjithatë unë, unë, nuk po marr vesh fare nga ato që thoni... Flisni për treqind vjet, për pesëqind vjet, për njëmijë vjet sikur vitet të ishin çaste?...

-Në të vërtetë ato edhe janë të tilla...

-Më duhet qartësia dhe jo megjullimi i bredhjeve të kota...

-Edhe para treqind vjetësh fole njëjtë... Nuk të kujtohet?...

-Para treqind vjetësh?...Pse po më mundoni kështu?...

-Pikërisht pra treqind vjetësh... Edhe atëherë kalërojnë natën, por me një kalë të zi... Ai heshti. Zuri ta shtrëngonte fytyrën sikur të kërkonte që të ndrynte në thellësi ato që i pengonin të qartësohej.

-Nuk të kujtohet nata e errët, pa yje dhe pa hënë?...

-Nuk të kujtohet heqama?...

-Njëmend nuk të kujtohet gjë prej gjeje?...

-Si mund të harrohen thikat, gjaku, ploja?... Si?...

Deshi t'u thoshte se nuk po i merrte vesh ato që thoshin, se po e megjullonin fare, por ishte shpërthimi i një të qeshur të fortë që, i erdhi si gjëmë e papërmbajtur, që ia mbërtheu fjalët në fytyrë.

-Kishe një thikë të gjatë, shumë të gjatë...

-Nuk të kujtohet as kjo?

-Thikë të tillë nuk kishim parë...

-Vezullonte edhe në terr...

-Ç' thikë që ishte!...

-Ç'priste se...

-Ç'janë këto që thoni për thikat dhe gjakun?... Asnjëherë nuk kam mbajtur thikë... Ato i kisha zët...

E qeshura u ngjall sërish. I bëhej se ajo në të vërtetë as që kishte pushuar.

-Kishe një thikë të gjatë. Thika shkëlqente. E lëvizje në erë dhe ajo lironte vetëtimat që preknin vetullat e malit. Ne e dinim se atë thikë e kishe për Princin dhe një ditë ajo do ta gjente zemrën e tij... Do ta gjente patjetër, sepse ti e lëvizje kah Kështjella dhe pa pra e matje kokën e tij... Dhe ajo ditë erdhi... Që ditë me shi, me një shi të imët dhe në atë ditë me shi thika jote u gjakos... A nuk të kujtohet se si më pas mugulloi bari dhe u shfaqen urithët e bardhë nëpër fushat e pangopura me ujë?... Nuk të kujtohet as kjo?... Ngjet që nuk të kujtohet, meqë kujtesa t'u ka shpërlarë... Por, dije se shiu ra edhe më vonë. Ra aq shumë shi sa dukej se gjithçka do të kalbej, e do të kalbeshin edhe eshtrat e Princit që ranë në tokën e lagur... Shiu zgjati dyzet ditë dhe për habi pastaj frynë do erëra të thata dhe tepër të nxehta, që nuk pushonin ditë as natë... Ah, se ç' erëra të flakta që ishin?... Toka zuri të çahet, urithët shumoheshin të ngordhur pranë vija të thara të ujit e kërmat e tyre kutërbonin rëndë, shumë rëndë... O, se ç' kutërbim i tmerrshëm që ishte ai?... Urdhërova që të mbylleshin edhe frëngjitë e kullave dhe hyrjet e Kështjellës. Urdhërova të mbylleshin të gjitha portat dhe urdhërova të mbyteshin të gjitha bretkosat që kërkonin shpëtim në pusët e Kështjellës, uji i të cilëve po shterej dita-ditë... Urdhërova pastaj që i madh e i vogël t'u dilte ndesh minjve të kuq, sa troha, që vinin nga bjeshka dhe futeshin në Kështjellë. Nuk të kujtohet si çirreshe rreth neverisë së minjve?... Natyrisht se as ethet e mive që ranë nuk të kujtohen bashkë me ato që sollën... Çuditërisht në atë thatësi të paparë, kur pëlciste edhe guri e edhe druri, vetëm thika jote nuk thahej... Gjaku në të prora rrinte i freskët... Nuk të kujtohet as kjo?...

-Seç ju ngatërruar gjërat... Çfarë thikash?... Çfarë princi?... Çfarë minjsh?... Këto mund t'i keni nga përfytyrimet që ju kanë molisur...

Sërish shpërtheu e qeshura.

-Deri kur do të shtireshe?...

-Ha,ha,haaaaa!

-Deri kur do të bredhsh jashtë vetes?...

-Deri kur?...

-Deri kur?...

-Kuuuuur?...

Ai prapë heshti. Nuk dinte se çfarë të thoshte përballë atyre që i vinin nga të gjitha anët. Dikur tha se do të priste ashtu përderisa t'i kthehej kali i bardhë për të fluturuar me të kah terri i pafund...

-Edhe atje takohemi...

-Fatkeqësinë e kemi të përbashkët...

-Kur do të soset kjo natë e pafund?...

-Princi duhej të vdiste patjetër... Ashtu kishte vendosur Perandori i Perandorisë së fuqishme, që synonte ta pushtonte edhe gjysmën tjetër të botës që po përgjumej... Ashtu kishin vendosur edhe ata që ishin kundër Perandorisë, por që Princit njësoj i frikësoheshin si Perandorisë që vinte nga pjesa tjetër e botës, sepse ai dëshironte të mbetej mes, as fillim i fundit e as fund i fillimit, por vetëm mes që lidhte dhe bënte të ditur se hapësira e të kundërtave nuk do të thoshte përjashtim i tyre, por baraspeshën me të cilën lindja është edhe perëndim e edhe perëndimi është edhe lindje... Dhe ai që duhej ta vriste Princin, duhej ta vriste edhe idenë e puqjes, duhej ta vriste përshtatjen si mënyrë të vetme të mbijetimit të atyre që nuk ishin kundërshtarë të hapur të perandorëve, por as dashamirë të tyre, ngaqë e dinin se perandoria pa princër do të thoshte forcë e papërmbajtshme, tirani dhe në fund shkatërrim...

Ai po heshte. Njëfarë turbullimi vogël që po e ndjente sikur po ia hapte pamjen e disa përftimeve të mjegulluara...

-Megjithatë, më e tmerrshme se sa vrasja e Princit ishte ajo që ndodhi më pas. Mbase as kjo nuk të kujtohet? Por, nga ai çast e mori lumi gjithë vendin. Ngaqë filloi lufta e tmerrshme kundër vetëdijes princore, kundër asaj që kahmot ishte shpallur herezi... Nuk të kujtohet si ua hape dyert hetuesve të shumët të Perandorisë, që erdhën valë-valë?...Me siguri se as kjo nuk të kujtohet?... Por, duhet ta dish se ata vinin nga kryeqyteti dhe të parën punë që bënë ishte të futeshin nëpër kisha, të hynin nëpër kulla dhe të mbikëqyrnin çdo skutë të Kështjellës për të kërkuar ato që u duheshin dhe ti nuk e dije se çfarë ishte ato. Ndërkohë që ti pritje titullarët e lartë perandorak dhe shtroje dreka e darka solemne atyre që të kishin shpallur mëkëmbës, dhe ata mbushnin arkat me pergamene, me stema, me emblema dhe me kronikat e vjetrat të kullave dhe të Kështjellës, që i kërkonin ngado me aq ngulm meqë aty ishte shpirti ynë, kujtesa... Nuk të kujtohet si rojat tuaja ruanin arkat para se ato t'i merrte në dorëzim kryehtuesit perandorak?...

-Nuk di asgjë... Nuk di,-tha ai i mbytur në djersë.

-Mund të merret me mend se nuk dije se ç'vlera ishin ato që mblidheshin nëpër zyrat,manastiret dhe bibliotekat e kështjellave, por kryehetuesi e dinte këtë dhe ato i interesonin. Andaj hetuesit dhe përgjuesit tjerë të shumtë, që ua kishin zënë frymën, nuk erdhën për tjetër pos t'i mblidhnin shkrimet tuaja, erdhën t'i merrnin pergamenat tuja, erdhën t'i vjelin stemat dhe emblemat tuaja, erdhën t'i merrnin kronikat tuaja bashkë me kartat që flisnin për përkufizimin e një veçantie mendore dhe shpirtërore...

Prapa fushatës për gjoja pastrimin e Tokës së Lashtë nga herezia, që sipas tyre ishte tepër e rrezikshme, fshihej lufta kundër shpirtit tuaj, qenies suaj dhe gjithë asaj që ndërlihej me dijet e vjetra... Ç'është më keq e gjithë kjo duhej të bëhej me gjoja nënshkrimin tënd, që u duhej hetuesve dhe gjurmuesve të shumët për të kryer punën e nisur...Nuk të kujtohet dekreti kundër herezisë që u shpall me nënshkrimin tënd?...

-Mos më mundoni se plasa...Ngulfatja po ma zë frymën...

-Nënshkruaje dhe nuk e dije se ai nënshkrim ishte i drejtuar kundër vetvetes...

-Mjaft!Mjaft!...

-Është koha që disa gjëra më në fund t'i kuptosh,sepse do ta kesh më të lehtë...

-Tashmë nuk di se kush jam dhe çka jam... Mjaft!.. Mjaft!...

-Po i afroresh pikës së njohjes, por kjo nuk mund të arrihet pa përpjekje për vetësqarim, pa vetëmundim...

-Po ngulfatëm!.. Më ndihmoni!...

-Përfytyro thikën!...

-Përfytyro nishanet e shumtë me të cilët u mbushe!...

-Përfytyro dekoratën e urdhrit të parë që ta dërgoi Perandori!...

-Përfytyro kryqin e artë që ta ndau Sindodi i madh!...

-Përfytyro luanin e artë që e kishe në kraharor!...

-Përfytyro rrobat e veshura me qëndisma të arta!...

-Përfytyro enët e florinjta!...

-Pastaj,përfytyro si ia ndërrove pamjen Kështjellës...

-Nuk po të kujtohen këto?

-Nuk po të kujtohet asgjë?...

-Përpiqu!

-Përpiqu!

-Ndërlidhu me çastin që zure të dyshoje se thika që kishe ishte për ty!...

-Përpiqu!...

Kur ndjeu se ishte shkallmuar i tëri dhe i bëhej se kishte arritur kufirin e njëfarë qartësimi, si një zbrazjeje të çuditshme, që do të mund të krahasohej me atë gjendjen midis të qenit dhe të paqenit, që sikur bëheshin një, hetoi se ishte fare vetëm, pa plakat që e kishin marrë në pyetje bashkë me atë thekamën e hahasë së tyre që herë pas here i sulej nga të gjitha anët.

Mos ishte ky mashtrim?...

Megjithatë, në kokë edhe më tutje i kishin mbetur pjesët e jehonës që kishte dëgjuar pak më parë tek po i silleshin si një pështjellim ngulfatës prej të cilit duhej liruuar disi. Por ndodhi që thekama serish iu kthye dhe ajo po i vinte gjithnjë e më e fortë dhe më e fortë sa dikur ra në gjunjë të mbrohej disi nga vërtitjet.

-Nuk ke nga ia mban,-po i thoshte një zë, i shumëzëshëm...

Kur hapi sytë, pa plakat që po e rrethonin. Rrethi i futës po e mbërthente nga të gjitha anët.

Ato po e shikonin. Sytë i kishin të errësuar si puse të thellë, në të cilat edhe drita më e fortë shuhej. Për t'i ikur atyre shikimeve që po e tmerronin, u ngrit me të shpejtë dhe u rras në këndin e çardakut, ku si fëmijë që trishtuar pa masë kur për herë të parë pa pjesën e jashtme të botës...

Iu kujtua se, kur e shikoi rrugën, nga ajo pikë, atëbotë pa vetëm koka, të cilat i bëhej se notonin në ajër. Ishte i bindur se ato koka ishin të këputura dhe kushedi se si bridhnin. Të et i pat thënë gjithë frikë se po shihte vetëm koka të prera, se ato po i ngatërroheshin çuditërisht me njëra tjetrën, dhe si të prera ato vazhdonin të dukeshin të jeshme. Por ai, si me

shaka, i pat thënë se nga ajo lartësi, xhami nuk e lente që njerëzit t'i shihte të tërë. Pastaj ai i tha se nuk ec koka pa trup, e as trupi nuk ec pa kokë... Të et i pat thënë se pikërisht njerëzit po i shihte të tillë, pra pa koka, ku ato lëviznin të shkëputura, siç shihte edhe trupat ecnin pa kokë...Të njëjtat fjalë ia pat thënë edhe një kushëriri plakë, e cila pastaj, disa ditë me radhë, gjithë shqetësim e pyeste se mos i turbullohej, gjë që ai i pat thënë se kohëve të fundit gjithnjë e më shumë i vinte te kthente kur shihte kokat tek lëviznin ashtu çuditërisht sa një ditë ia bëri me dje se ajo ndjenjë turbullimi po i kthehej në neveritje. I kujtohej si plakës ia kishte pranuar se ato koka të shkëputura gjithnjë e më shumë po i dukeshin sikur të ishin bisha, të gatshme për ta ngrënë... Iu kujtua, pastaj, si kushërira plakë te et i kishte thënë gjithë shqetësim diçka rreth njëfarë „sëmundje të territ“, që ai pastaj i hutuar fare ia kishte kthyer „qoftë larg“ ai kob dhe i kishte thënë se „këtë duhej ta fshehte“ sepse „na merr lumi“...

Kushërira plakë nuk erdhi më, por iu kujtua që i ati atë natë dhe të nesërmen, mbase edhe disa ditë të tjera, e pyeste pareshtur se a po i turbullohej, se a e mundonte ndjenja e neverisë, se a vazhdonte t'i shihte njerëzit si bisha e tjera e tjera, që atij ia shtonin edhe më tepër ngulfaten,që edhe ashtu e mundonte sapo shikonte jashtë. „Këtë mos ma thuaj... Këtë mos ma thuaj“,i drejtohej i ati kur i tregonte për mundimet që i bëheshin gjithnjë e më të mëdha...

Një ditë i ati i solli një xham tjetër, të lyer me sedefe që shkëlqenin, me të cilin ai në tërësi privohej nga shikimi i asaj që ndodhte në rrugë, pra në pjesën tjetër të botës, që atë e mundonte. Ngjyrat ishin të buta dhe të ngrohta dhe për pak i pëlqyen, ngaqë ia krijuan përshtypjen e një imazhi të ngjyrosur tutje tij me të cilin fshihej pjesa e neveritshme... Por nuk vonoi dhe ato ngjyra shpejt iu zbenë dhe ai serish shihte kokat tek valëviteshin bashkë me vijëzimet gjithnjë e më të qarta të shtazarakes në to. Kjo e tmerroi sa nisi të kërkonte terrin. Dua terr, thoshte. Dua terr!... Edhe pse ndodhi që xhamin ia lyen me ngjyra ca më të mbylla, e më vonë ia vunë edhe një perde të errët, nuk i ndihmuan ta mbronin nga ato që tashmë iu kishin kthyer në pamje të rëndomta. Madje i bëhej se edhe po t'ia mbyllnin sytë përgjithmonë dhe po t'ia hiqnin ata fare,kokat e shkëputura me tipare gjithnjë e më të theksuar shtazarakë nuk do t'i shqiteshin. Këtë ia tha t'et dhe ai nuk vonoi dhe i solli dy plaka kërruta,të cilat një kohë të gjatë ia preken shputat e duarve e të këmbëve,pastaj ia prenë thonjtë që ia futën në një façoletë, ia fërkuan qerpikët me një gur të bardhë dhe së fundit ia nxorën dhëmballët e fundit që gojën ia mbushën me një gjak të zi... Tri ditë i dhanë njëfarë uji pa shihje dhe gjatë gjithë kohës kërcunat i rrinin përpara fytyrës dhe i thyenin gishtërinjtë si furka,me të cilët i bëhej se do t'ia nxirrnin sytë. Kërcitja e gishtave ia ngjeshte mishin dhe e bënte të ikte prej atij mundimi,por nuk kishte nga t'ia mbante,ngase ato e mbanin si të lidhur. Kur ato ikën, dy ditë mbeti i mbërthyer në një kllapi të thellë. Nga ajo gjendje doli thuajse përnjëherësh dhe e pa t'et të gëzuar si po i thoshte së ëmës se ajo shtriga (mendonte tek kushërira plakë) e kishte pasur me sherr..Thoshte se ishte i lumtur që nuk i doli fjala...

Tash, pas shumë e shumë vjetësh, dritarja prapë iu bë e ngjyrosur. Para syve çuditërisht po i luante një ylber, që nuk i kishte rënë ta shihte dot. Ylberi i ndërronte ngjyrat dhe ai për herë të parë zuri të mendonte për atë shumësi ngjyrash, e cila po e ngashërente sa ndjeu një fashë shlodhëse, gjithë gjumë. Mbase do të flinte po të mos e kishte dëgjuar një thekamë,që e trandi të tërin. Hetoi se thekama ia kishte marrë ylberin dhe i erdhi keq kur hetoi se nuk e kishte me ylberin para. Kot u mundua ta shihte xhamin e ngjyrosur. Kush e kishte hequr vallë,kur pak më parë ishte i bindur se e kishte përpara?... Aty ishte një xham i thjeshtë, prapa të cilit ferku i dritës vijëzonte çepengjet e vjetra...

Një copë herë priti ylberin, por në vend të tij pa rrethin e plakave, që po i afroheshin. Me të shpejt hetoi rrethin që u mbyll dhe nisi të sillej. Plakat lëviznin ngadalë dhe çirreshin. Asgjë nuk kuptonte nga ato fjalë të shkëputura dhe lemëritëse, që buronin nga një gojë... Ajo sjellje po ia shtonte marramendjen. Druante se do të kthente, mu si në fëmijëri, kur shihte kokat e shkëputura me tipare shtazarake tek lëviznin. Që t'i ikte disi atij përftimi mbylli

sytë. Vallen që nuk e shihte, megjithatë e ndjente gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më pranë tek po e përfshinte sa një çast ishte i bindur se tashmë bashkë me plakatin fluturonte nëpër një hapësirë të errët, ku kishte vetëm zogj të zezë me krahë si shpata, nëpër majat e të cilave kishte gjak të freskët...

Një kohë të gjatë bëri përpjekje të shkëputej nga vallja makrabe. Zogjtë e zezë po ia kërkonin sytë...Sytë po ia kërkonin edhe plakatin...Sytë po ia kërkonin e gjithë bota...

-Sytë!Sytë! - u çirr dhe hetoi se ndodhej i rrëzuar në dysheme, i tëri i mbytur në djersë, me kundërmimi të dërrasave të zhbhiruara nga tenja pranë. Në atë gjendje bëri përpjekje që nga kujtesa t'i përjashtonte ato që nuk i duheshin, sado që nuk e dinte më se ç'ishte ajo që i duhej dhe s'i duhej,ngaqë kufiri i tyre i ishte ngatërruar keqas...As këndeje,as andej,tha dëshpërueshëm...Askund...Medet...

Disa herë nga goja i shpëtuan ato fjalë të gjymtuara dhe sa më shumë që i rrëshqisnin i bëhej se ato ia thoshte dikush tjetër që gjendej i strukur diku në brendinë e tij...Çfarë po ngjet me mua,vallë,deshi të çirrej me sa zë kishte, por ishte "hahaja" e thekshme,që ia la në gjysmë mendimet.

Kur ktheu kokën dhe mezi u ngrit në gjunjë, sërish pa plakatin që po e shikonin qortueshëm. Sytë nuk i kishin të errët, si më parë. Në to thyheshin ca drita që shkëndijonin furishëm, por edhe frikshëm.

-Nuk po e njeh veten,-i tha njëra?

-Ke mbetur në mjegull,-i tha tjetra.

-Njëmijë vjet i shkapërderdhur...

-Njëmijë vjet...

-Kush do të thoshte se do të zgjaste kaq shumë?...

-Varret e shembura...

-Varrmihësit e maskuar...

-Tempujt e humbur...

-Pasqyrat me një mijë fytyra...

-Thikat në kujtesë...

-Njëmijë vjet...

-Kush do të thoshte se do të zgjaste kaq shumë?...

-Njëmijë vjet...

-Një mijë...

-Rrethi i mbyllur...

-Një mijë vjet..

-Një mijë...

-Rrethi...

Fjalën „rreth“ po e thoshin të gjitha me një gojë dhe ai rreth po i afrohej e po i afrohej dhe po ia ngushtonte hapësirën,se po ia rrallonte frymëmarrjen, se po ia soste edhe ajrin... Nuk e kuptoi kur dhe si nga goja i rrodhi fjala „ndihmë“,që e tha me një zë të butë, si frikë e përzier me shqetësim të thellë, dhe për habi vallja u ndal. Rrethi i futës u tërhoq paksa dhe ai pa një fytyrë shumëfyrëshe,të përsëritshme dhe të njëtrajtshme, që po e shikonte dhe po heshte. Ajo heshtje iu duk e rëndë, tepër e rëndë, madje më e rëndë se vallja e territ...

Dikur,nga rrethi i territ u shkëput njëra. Tash, ajo, me një shikim të butë, dukej tjetër. Në sytë e saj po shihte një afërsi të jashtëzakonshme, që iu duk si e ama. Fërkoj sytë për të parë më mirë,dhe,njëmend,u bind se ishte ajo. Mend plasi nga gëzimi. Deshi të klithte me sa zë kishte: Nanë!Nanë!Por shikimi i butë i saj dhe një si përlotje, që e hetoi, sa ora ia lëshoi vendin një brengosje. I bëhej se ajo po e shikonte gjithë dhembje, sa ai uli kokën. Kur pas pak e ngriti kokën dhe serish gjeti shikimin e saj, kishte bindjen se ajo po matej t'i thoshte diçka. Bile, ia pa buzët t'i lëvizte. Folë!Folë,deshi t'i thoshte .Qortomë!... Thuamë çfarë të duash!...Dhe po deshe merrma edhe shpirtin... Ah, sa kohë po e pres atë fjalë, atë veprim... Por, ajo,assesit të nxirrte atë që ai ishte i bindur se ruante për të...

I bindur se do ta cyste të fliste, nisi të thoshte diçka çapitshëm rreth kohës rrethore dhe sjelljes në të... Nuk e dinte se pse pikërisht i ishte qepur ai mendim, por në atë pëshpëritje fjala Nanë i thyhej dhe i përthyhej sa ndjeu të frikësohej se shkëputjet e rrokjeve do t'ia shpërbënin edhe përfytyrimin e saj...

Ajo prapë heshtte. Dukej se ato që kishte thënë aq shthurshëm e kishin ngrysur edhe më.

-Çudi,Nanë,si nuk të paska molisur rruga e gjatë?... Dukesh e njëjtë...

Prapë heshtje. I shkoi mendja se fjalët i kishte të shurdha fare dhe se ato që i thoshte i shkonin kotnasikoti, meqë ato buronin nga zbrazëtia e tij dhe si të tilla serish i ktheheshin asaj zbrazëtie ku mbeteshin pa jehonë. Kjo e dëshpëroi edhe më shumë se heshtja e akullit e së ëmës.

-Medet,oshtiu,medet,edhe fjalët m'u paskan bërë të paqena. Medet,i paqenë...

Pas pak, sikur të kishte shpërthyer diçka e papërmbajtshme nga një thellësi e harruar, ndjeu sikur ajo foli diçka dhe i tha se si sëmundja e territ nuk i ishte hequr dhe se ishte koha ta kuptonte këtë...

Zëri i akullit serish iu kthye ngrirjes prej nga kishte shpërthyer dhe ai hetoi se e ëma ishte bërë pjesë e rrethit të futës.

Ai kot po e kërkonte me shikim. Plakat ishin të njëjta, të ftohta dhe tepër mospërfillëse.

-Sëmundja e territ... Sëmundja e territ,- po flisnin si me një gojë...

-Vazhdon sëmundja e territ...

-Sëmundja...

Si përvaishëm tha se nuk po kuptonte gjë.

-Më ndihmo,Nanë...

-Hijen e ke shtatë pashë thellë në tokë,biro. Hijen e ke shtatë pashë thellë në tokë... Hija po të kërkon...

Në atë çast pa se rrethi i futës po e mbërthente fuqishëm,ndërkohë që sharronte në një skëterrë të pafund...

V A R I A N T E

Po kalëronte në njëfarë rrethi të ngushtë,i zhytur në një kllapi të thellë,kur një zë i tha:

-Po gjëmon...

Nuk ua vuri veshin fjalëve që iu dukën si ishin pjesë e asaj përseritjeje marramendëse.

-Deri kur do të sillesh kështu kot i përgjumur?...

Prapë heshti. Errësira e pafund po i ndillte një gjumë të thellë,ku dëshironte të zhytej sa më parë.

-Nuk po e dëgjon heqamën?

-Ka kohë që nuk dëgjoj gjë...

-Kjo është shenjë e keqe...

-Heshtja shurdhe nuk ka fund...

-Është koha të zgjohesh...Është kohë zgjimi...

-Është kohë gjumi...

-Prapë mund të vonohesh...

-Gjumi...Gjumi...

-Hapi sytë njëherë...

-Gjumi pa natë...

-Shiko përreth...

-Gjumi...

-Po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme...

-Gjumi...

-Heqama po afrohet...
 -Gjumi...
 -Heqama...
 -Gjumi...
 -Nuk po e heton furtunën?...
 -Gjumi,vetëm gjumi...
 -Ka njëmijë vjet që flenë...
 -Terri e do gjumin...
 -Njëmijë vjet gjumë...Njëmijë vjet...
 -Është kohë gjumi...
 -Është kohë heqame...
 -Gjumi...
 -Heqama...Zgjohu!...
 - Zgjimi më rrëzon...
 -Përpiku të mos ndodh kjo...
 -Kot... Kështu ka ndodhur përherë...
 -Përpiku...
 -Do të rrëzohem...
 -Ka mundësi edhe të rrëzohesh...
 -Nuk është kjo punë huqe?...
 -Por, do të ngrihesh...
 -Dhe prapë do të rrëzohem...
 -Dhe prapë do të ngrihesh...
 -Dhe prapëprapë?...
 -Dhe prapëprapë...
 -Deri kur prapaprapa?...
 -Prapë...
 -A nuk ndodh e njëjta?...
 -Ndodh...
 -E,pra?...
 -Lëvizja,vetëm lëvizja ndihmon...
 -Ajo të sjell tek fillimi...
 -Ani?...
 -Kjo më bezdis, sepse ndodh e njëjta... E njëjta... E njëjta... E njëjtaaaaaa!...

Fjalët e fundit i tha çirrshëm. Dikur ndjeu shurdhim dhe të ftohtë, ndjeu vetmi dhe trishtim, ndjeu se nuk ishte në kalë dhe se këmbët po i shqitnin nëpër një akullnajë ku edhe po i sharrnin... Hetoi se ishte një heqamë dhe katrahurë, që po e barte dika dhe se asaj iu nënshtrua i tëri me ndjenjën e gjumit...

Raporti i fundit i kryehetuesit

I gjithëndritshmi dhe i gjithëfuqishmi ynë,

Me urdhrin Tuaj dhe me këshillat Tuaja të shtrenjta u nisa nga Kryeshehëri për në Tokën e Lashtë me detyra tepër të rëndësishme, duke pasur gjithnjë parasysh fjalët Tuaja se kjo nuk është si çdo fushatë tjetër...

Shi për këtë i bëra të gjitha ato që duhet bërë që të dalim faqebardhë. Por ç'ë do që brenda kishim krimbin që po na brente dalëngadalë. Këtë duhet ta them me zemër të plasur dhe unë i përluri Juaj deri në amshim jam në gjendje kurdoherë t'i arsyetoj pandehmat dhe të paguaj me kokë edhe më të voglën lajthitje që shfaqet në këtë drejtim... Pra, Lartmadhëri,Vezirit të Madh nuk ia kam pasur besën asnjëherë. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me

kodeksin profesionit se të dyshosh në secilin është detyrë e parë dhe e përhershme e çdo hetuesi, por më tepër nga njëfarë parandjenje e çuditshme që m'u shfaq sapo ia pashë heshtjen e akullt në sy. Përvoja e deritanishme prej hetuesi të lartë, të dhënë këmbë e krye pas ideve perandorake, më ka mësuar se prirja ndaj saj dhe besnikëria që i falet përherë përcillet edhe me të kundërtën, që zhvillohet si tinëzake dhe e rrezikshme... Andaj, pa u nisur në fushatën e shenjtë, lexova dosjen e fshehtë të familjes së tij dhe nga ato që hasa aty, më së shumti më bëri përshtypje e dhëna që fliste për njëfarë sëmundjeje të çuditshme që iu kishte shfaqur në fëmijëri, nga e cila, me gjasë, ai nuk u shërua kurrë, që në vendlindjen e tij i thonë sëmundja e territ...

Nga ato që mësova fjala është për një sëmundje shumë të rrallë dhe shumë të rrezikshme, që nuk shpirtin. Mjekët tanë nuk dinë gjë për këtë sëmundje dhe kjo është e pafalshme. Madje, një mjek ynë i rëndësishëm më tha se ajo nuk është sëmundje fare, por e gjitha është çështje e një çrregullimi të brendshëm disi të veçantë, që prek sistemin e përgjithshëm të të menduarit dhe të vepruarit në rrethana të caktuara. Pra, sipas tij, e gjithë kjo duhet t'u takojë studiueseve që merren me problemet shoqërore, politike, por edhe gjeografike, gjë që kjo arsyeton edhe më tepër qëndrimin Tuaj që gjithë çështjes t'i jepet një përgjigje shtetërore, çfarë në të vërtetë ishte kjo e fundit. Nga bisedat e shumta dhe hetimet që bëra, mora vesh se sëmundja e territ, që mund të merret edhe si njëfarë çrregullimi i veçantë psikik, instinktin e urrejtjes, që mund të jetë prirjeje e natyrshme e çdo njeriu, e ngrit deri tek përmasat e një veprimi të përgjithshëm, që përcakton edhe karakterin. Kështu, sipas hulumtimeve, shenjat e sëmundjes së territ manifestohen me shfaqjen e një teku në e parë ngacmues, që nis me urrejtjen ndaj familjes (prindërve dhe të afërmeve) për të shkuar më tutje tek farefisi dhe për të përfunduar tek urrejtja ndaj mjedisit dhe gjithë botës... Pra, sëmundja fillon me shfaqjen në fëmijëri, pastaj në moshë të pjekur e së fundit edhe në pleqëri. Në fëmijëri, i sëmuri turbullohet, vjell dhe sheh njerëzit me koka të këputura që vërtiten, e që dalëngadalë ato koka pasqyrojnë dhe shprehin përvijimet e tipareve shtazarak... Më vonë, të sëmurin që e qetëson vetëm gjaku, së pari i familjes dhe i farefisit dhe pastaj i të tjerëve, e mbërthen prirja për shkatërrim të përgjithshëm... Në pleqëri i sëmuri, thuajse pavetëdijshtë, ngushëllohet me shqetësimin e viktimave, të cilave natën ua hap varret dhe ua nxjerr eshtrat, që ua kthen nëpër shtëpi. Ky farë makabriteti nuk është vetëm shqetësim, por tallje dhe nënçmim ndaj të gjallëve...

Thuhet se të sëmurët në fëmijëri nuk janë të rrezikshëm dhe vështirë që merren vesh se vuajnë nga sëmundja e territ, ngase për të vjellë fëmijët vjellin gjithnjë dhe për çka do. Vetëm kur rriten dhe moshohen, befas iu shfaqet një gjendje neurotike e paparë, që thuhet se të sëmurin përkohësisht e qetëson vetëm gjaku i të vetëve, që e merr me dorën e vet. Nga hetimet mësova se i sëmuri, i çmenduri apo ta quajmë si të duam, nuk kënaqet vetëm me pak gjak, ose me një viktimë, që vjen nga familja dhe farefisi, por kjo prirje vjen duke u shtuar dhe zgjeruar tutje familjes dhe farefisit...

Për t'i ikur gjakderdhjeve të tmerrshme, që nuk ka kush i ndal, sipas një ligji të pashkruar, prindërit që hetojnë shenjat e kësaj sëmundjeje tek fëmija, duhet ta vrasin ata sa më parë dhe kjo të bëhet sipas një rituali të përbashkët, ku duhet të marrin pjesë të gjithë, i madh e i vogël, në mënyrë që të bëhet pastrimi i përbashkët nga gjaku i prishtë, siç thonë apo fara e së keqes, e cila çuditërisht tek ata përsëritet herë pas here dhe nuk i lë të qetë kurrë.

Ja se si zhvillohet rituali i lirim nga fara e së keqes apo gjaku i prishtë:

Së pari, me anën e një kumti të veçantë, hapet fjala rreth hetimit të sëmundjes, që nënkupton masat e menjëhershme kundër saj. Sapo dëgjohet kumti i zi, të gjithë e dinë se fjala është për sëmundjen e jashtëzakonshme nga e cila duhet ndarë doemos, kështu që secila shtëpi po atë natë bën një theror (dash apo viç). Me gjakun e tyre stërpiken themelet e shtëpive dhe dyert e jashtme. Mishit zihet gjithë natën dhe të nesërmen hahet me anën e një përtypjeje të përbashkët, që i përngjet një rituali vetëngrënës, që lidhet me besimin se e keqja vetanake

duhet ngrënë dhe mendohet se vetëm kështu ajo për një kohë është e mundur, por jo përgjithmonë, që do të thotë se ajo dikur, pas tri-katër koresh patjetër përsëritet.

Ditën kur fillon përtypja e përbashkët e mishit, meshkujt, nga një për shtëpi, në maje të kodrinës, hapin gropën e thellë, pastaj e sjellin fëmijën e stolisur me lule (po të jetë verë), me ç'rast të gjithë i përkulen me radhë, ia puthin dorën dhe qajnë para tij si para një shenjtëri. Ky ritual zgjat deri para perëndimit të diellit, kur fëmijën e dalë jashtë vetës nga lëngu i disa luleve që i jepet gjatë gjithë natës, e fusin në gropën e thellë që nuk merret për varr. Pasi e mbulojnë me lule, secili merr nga një grusht dhe dhe ia hedh përmbi dhe kështu vazhdojnë deri sa gropa rrafshohet. Së fundit, mbi të mbillet një lis dhe ai quhet lis i shpirtit, të cilit mund t'i thuhet porosi, të bëhen rrëfime që duhet t'i ruajë vetëm toka e zezë për t'i nxjerrë vetëm në rrethana të veçanta...

Për prindërit dhe familjen e ngushtë pasojnë edhe masat e vetmisë së plotë, që në njëfarë mënyre lidhet me shuarjen e tyre të plotë. Dënimi fillon me ngujimin e tyre në një kullë të vetmuar maje një bjeshke, pa të drejtë që t'i kthehen jetës së përbashkët. Me një fjalë, aty ku shfaqet sëmundja, ajo shtëpi shuhet përgjithmonë. Për ata që nuk e paraqesin sëmundjen, e, herdokur, merret vesh kjo, atëherë pason një ndëshkim i tjetër i madh, që përfundon me djegien e atyre që kapën në një turrë drush...

Megjithatë, sa më ra të marr vesh, gjatë pesëqind vjetëve të fundit nuk ka pasur shkelje, edhe pse sëmundja u paraqit katër herë. Së fundit para njëqind vjetësh...

Pra, Lartmadhëri, bazuar në ato që i përkasin masave të mbrojtjes dhe të vetëmbrojtjes nga kjo sëmundje, Veziri i Madh duhej të vritej që moti, si fëmijë. Pse nuk ndodhi kjo, fajin e kanë prindërit e tij, që bënë një shkelje të rëndë. Nuk do mend se ata nxituan të vinin në Kryeshehër për t'ia humbur gjurmët sëmundjes. Dëshironin ta mashtronin vdekjen dhe nuk është për t'u habitur pse ai fëmijë tregoi energji të jashtëzakonshme dhe aq vrullshëm u ngrit deri tek froni i kryevezirit. Në të vërtetë ai ishte i tjetërsuar kahmot dhe kjo i ndihmoi që të përballojë çdo vështirësi. Pa ditë se vuante nga ajo sëmundje, megjithatë, shtytjen e qetësimit me anën e vetëngopjes me gjakun e të vetëve, ai e ktheu në një prirje të vazhdueshme dhe tepër të theksuar për t'u ngjitur deri tek lartësitë më të mëdha pa marrë parasysh vështirësitë që i kishte para. Ajo që cilësohej si ecje e pandalshme dhe e fuqishme përpara, me të cilën krenohej Perandoria, në të vërtetë ishte pjesë e asaj shtytjes së sëmurë për ta pushtuar edhe fronin Tuaj në mënyrë që nga ajo majë të shkatërrohet Perandoria...

Mendja ma thotë se përkundër asaj se ndjenja e derdhjes së gjakut të vet iu zëvendësua me ecjen e furishme përpara, ai nuk u shërua dhe as që u lirua nga qëllimi përfundimtar pa marrë parasysh lojalitetin e madh ndaj Perandorisë. Ç'është më e rëndësishme, edhe pse jetoi shumë larg vendlindjes (dhe sipas në besëtytnive pas shatë bjeshkësh dhe pas shtatë lumenjsh edhe gjaku bëhet tjetër dhe njeriu bëhet tjetër), ai prapëseprapë të vetëve ua kishte borxh vdekjen, atë vdekje që u desh të bëhej para shumë e shumë vitesh, sipas ritualit të tyre të moçëm... Kujtoj se pikërisht ajo vdekje që u desh të bëhej patjetër, solli një shqetësim të përbashkët, sa shpirtrat e tyre u vunë në kërkim të atij shpirti që duhej të mbetej aty, i ndryrë në atë gropën e thellë në kujtesën e brezave. Andaj edhe thashethemet për shfaqjen e plakave, që herë duken e herë nuk duken, për të cilat thuhej se gjoja prej kohësh po mbledhin një ushtri të paparë të të vdekurve, duhet lidhur me domosdonë e ndëshkimit të tij... Plakat u bënë të padukshme dhe do të mbeteshin të tilla deri sa të takoheshin me shpirtin e tij...

Por t'i kthehem edhe një herë asaj nate të kobshme.

Ai erdhi i paparalajmëruar, hipur në kalë të bardhë. Pas i shkonin truprojat që nuk e dinin se po ndiqnin një shpirt të tjetërsuar, i cili duhej t'i nënshtrohej ritualit të vdekjes, asaj vdekjeje fizike së cilës i kishte bishtnuar aq gjatë. Nuk e dinin pra, se po i shkonin pas atij që kërkonte vdekjen e vet...

Në shtëpinë e lindjes ai e dinte se po e pritnin plakat e padukshme, ato që duhej t'ia kumtoni dënimin dhe ta varrosnin shtatë pash thellë në dhe, si të ndëshkuar, që nuk do të ketë

më të drejtë as të përziehet me të tjerët, as ta riprodhojë veten. Jam i bindur se kështu u bë. Sado që shtëpia ishte e kyçur dhe nën mbikëqyrjen e përhershme të hetuesve tanë, ai i takoi ato aty dhe, më në fund, e kuptoi atë që duhej ta kuptonte patjetër. Falë Allahut që u bë ashtu, sepse në të kundërtën druhej se do ta pushtonte edhe fronin e gjithëfuqishëm dhe ne do të shndërroheshim në një perandori vetëngrënëse, në vend se të vazhdohej rruga e shpëtimit të botës nga e keqja dhe terri që sjell perëndimi...

Nuk jam i prirë të merrem me besëtytni dhe as t'u besoj, por këtu fjala është për një prirje të veçantë heretike, tashmë të njohur dhe të pasqyruar në forma të ndryshme që nga lëvizja asnjane e deri tek laramania, e cila, po të mbetej e pazbuluar, do ta helmonte edhe shpirtin tonë me ndjenjën e vetëshkatërrimit...

Sa më përket mua, në rastin e dhënë, veprova më së miri dhe më së drejti. E rrethova shtëpinë. Prita tri ditë e tri net, por ai nuk doli. Se nuk do të dilte këtë e dija. E lutja të madhin që megjithatë të mos ndodhte ndonjë befasi. Pastaj, dhashë urdhër që truproja kryesore të futej brenda. Ai më shikoi vëngër dhe ma kujtoi urdhrin e prerë të Kryevezirit që askush të mos e shqetësonte nga jashtë sa ishte aty. Ai urdhër, i thashë truprojës, nuk vlen më. Truproja hyri, por nuk doli më. Edhe këtë e prisja. Ai kishte rënë viktimë e lemerisë së papritur. Kur hyra brenda, truprojen e mbështolla dhe çevrenë jeshile të rendit të parë perandorak dhe prita deri sa ra terri. Atëherë, hapa fjalë se Madhëria e tij Kryeveziri Hasan Pashë Ohri kishte vdekur nga pika në zemër, që i kishte rënë nga shqetësimi i jashtëzakonshëm që kishte pas takimit pas aq shumë e shumë vitesh me folenë e fëmijërisë...

Urdhërova që tabuti të mbyllej me një arkë të madhe dhe askush të mos e hapte deri në Kryeshehër. I mora të gjitha masat të mos shfaqej as më i vogli dyshim se i vdekuri në tabut nuk ishte Kryeveziri, por një tjetër. Letrën e nisa me postën ushtarake në mënyrë që ta dini të vërtetën pa arritur tabuti në Kryeshehër...

Ma thotë mendja, Lartmadhëri, se kjo ishte rruga më e mirë dhe më e drejtë që t'u priteshin të gjitha burimet e mundshme thashethemeve të tmerrshme, po qe se do të mësohej e vërteta për vdekjen e Kryevezirit. Ne mund të bëjmë gjithfarë gabimesh, mund të pranojmë lëshime, por nuk bën fare të anashkalojmë mësimet heretike që bien ndesh me thelbin e mendimit të shenjtë perandorak...“

Diku në Tokën e Lashtë

Në verën e vitit 1614

(Në vend të mbylljes)

Shtatë ditë e shtatë net tabuti i përcjellë prej katërqind kalorësve të zgjedhur, të cilëve u printe Kryehetuesi, udhëtoi kah thellësia e Perandorisë. Kaloi nëpër krahinat e ndryshme dhe ngado që u shfaq, u shpall zi shtetërore. Në mëngjesin e ditës së tetë, kur kalorësit po i afroreshin detit, tabutin e mori në dorëzim garda perandorake. Kalorësve të lodhur me në krye Kryehetuesin, u thanë se duhej të pushonin. U shtruan drekë festeje dhe të gjithë mbetën me kokë në tepsitë me pilaf dhe hurma... Fshehtas i varrosën në një varr të përbashkët pa marrë vesh kush për fatin e tyre të zi...

Në Kryeshehër zia zgjati dyzet ditë. Myezinet këndonin dhe luteshin për shpirtin e Vezirit të Madh Hasan Pashë Ohrit. Varrimi qe madhështor dhe askush, pos Lartmadhërisë së tij, Sulltan Osmanit të Dytë, nuk e dinte se në atë tabut gjendej trupi i rojës së thjeshtë...

NJËQIND VJET PUSHTET

Ditën e xhumasë së madhe, nga Saraji i praruar, doli lajmi se Niman Pashai u emërua vezir i madh. Lartmadhëria e tij, Sulltan Mustafai i Dytë, krahas dekretit të jashtëzakonshëm shpalli edhe një varg emërimesh të rëndësishme dhe paralajmëroi amnistinë më të madhe në historinë e perandorisë. Kremtja e madhe, që do të mbahej pas dyzet ditësh, bëhej edhe më e madhe ngaqë atë ditë Niman Pashai martohej me bijën e Sulltanit, Xhylysymen e bukur, që thuhej se nuk kishte shoqe në gjithë perandorinë e pafund.

Lajmi për emërimin e kryevezirit të ri nga derë e Qyprillinjve saora fashiti thashethemet që u përhapën pas vdekjes së Hysni Pashës se gjoja sulltani kishte pritur këtë rast që, më në fund, të ndërpritej pushteti njëqindvjeçar i arnautlinjve në postin më të lartë të Portës. E vërteta se njëri nga Qyprillinjtë sërish zinte vendin e vezirit të madh, tash edhe më i fuqishëm (dhëndër i sulltanit), i dëshpëroi pa masë ata që shpresonin se Perandoria nuk do të kishte më në krye „një trup të huaj“, siç quheshin rëndom ata që vinin nga pjesa evropiane e Perandorisë, për të cilët thuhej se trupin e kishin në Lindje ndërsa kokën kah Perëndimi...

Kjo i përcolli edhe Qyprillinjtë shumë herët, qysh nga koha e kryevezirit të dytë me radhë, Ahmetit, kur u shfaqën ca trazira në pjesën lindore të vendit, me ç'rast Veziri i madh nuk pranoi kërkesën e shtruar të mexhlisit që atje menjëherë të dërgoheshin repartet ndëshkuese. Të hetohet njëherë puna mirë e mirë e pastaj të merren masat e duhura, tha. Kjo shkaktoi huti të madhe, sidomos tek pjesa e fanatikëve, të cilët atëbotë kërkonin masa të rrepta ndaj çfarëdo lëvizjeje, pa marrë parasysh se ç'kërkesa fshiheshin prapa tyre. Ahmet Pasha, edhe pse i rrethuar nga dorëfortë të paepur nuk ngurroi të thoshte se „për hir të shëndetit të Perandorisë nevojitej të bëhej një shqyrtim i gjithanshëm i revoltës njerëzore, kudo qoftë ajo...“ Pashai foli gjatë për arsyen dhe për mirëkuptimin si nismë që duhej t'i shërbenin shtetit para çdo veprimi... „Ku do të na çonte përvoja që për gjithçka të kapën armët dhe vetëm me anën e tyre të vihet rregull qoftë edhe kur është fjala për ndonjë pakënaqësi të arsyeshme, e cila mund të jetë shkaktuar nga sjelljet e pamatura të pushtetarëve vendor, të cilët pastaj, duke i fry gjërat dhe duke i ngritur ato deri tek niveli i rebelimit të gjerë, kërkojnë të shfrytëzojnë autoritetin e Perandorisë për t'i qeruar hesapet me ata që me të drejtë kundërshtojnë keqpërdorimin e pushtetit?... Pushteti nuk ushtrohet kundër milletit, por për milletin dhe në mbrojtje të tij... Vetëm kur ndodh kështu atëherë askush nuk ka arsye të ngrihet kundër tij, por përherë të vihet në mbrojtje të tij... Këtë kërkoj, tha Pashai dhe krye në vete dërgoi dy komisione të pavarura në pjesët e rebeluara. „Do të punoni pa ndikimin e jashtëm. Vendimet tuaja janë të pavarura dhe meritore. I dua edhe mendimet e njerëzve të thjeshtë, të tyreve që kanë punë me autoritet vendore. Përpiquni që fjalët e tyre, pa marrë parasysh se të çfarë natyre do të jenë dhe si thuhet, t'i dëgjoni dhe t'i shënoni sa më besnikërisht“...

Dhe prej atij çasti Qyprillinjtë nuk u shikuan me sy të mirë na dorëfortët dhe nga ata që mendonin se Perandoria mund të shkonte përpara vetëm me shpatë. Por, sa më shumë që shtoej smira dhe mosbesimi ndaj tyre, në saje të një fuqie të pashoqe që përherë e gjenin në vetvete, ata ia dolën të futnin rrënjë të thella në fronin më të lartë të Perandorisë sa dikur dukeshin të domosdoshëm dhe si të pazëvendësueshëm. Sulltanët, që e dinin fare mirë se çfarë mendonin fanatikët dhe të tjerët për arnautlinjtë, nuk hiqnin dorë nga Qyprillinjtë, nga arsyeja e vetme se me ta në pushtet ndjeheshin më të sigurt dhe më të fortë. Andaj, jo pa arsye, me një rast, Sulltan Selimi i Parë, botërisht kishte thënë se „Qyprillinjve u ka hije pushteti...“ Sulltani e tha këtë pas fitores së madhe që arriti Mustafa Pashë Qyprilliu ndaj austriakëve në Shkup, në Prishtinë dhe në Nish dhe bëri që themelet e Perandorisë të

forcoheshin befas kur dukej se ishin në shembje e sipër mu në atë pjesë ku duhej të ishin më të fortë.

Të gjendur prore në shënjestrën e atyre që ua kishin zili dhe të sulltanëve që nuk bënëin pa ta, Qyprillinjtë kujdeseshin me mish e me shpirt që të mos bënëin as më të voglin gabim. Bile, mund të thuhet se kjo u kaloi në njëfarë gjeturi të posaçme, saqë dikur edhe kundërshtarët e tyre më të rreptë u bindën se Qyprillinjtë mund të largohen nga froni i lartë vetëm atëherë kur do të ngopen me pushtet dhe assesi ndryshe. Mehmeti plak, i pari ndër Qyprillinjtë që qe ulur në fronin e lartë, pak me shpoti e pak si përnjëmend, pat thënë se „nga ky vend mund të na zbresë vetëm molisja jonë...”

Dhe njëmend, pas Mehmetit, radhazi erdhën hiç më pak se gjatë Qyprillinjë të tjerë, që kush më shumë e kush më pak qeverisi, por që asnjëri nga posti i kryevezirit nuk u ndërrua para kohe. Përkundrazi, nga aty largoheshin kur vdisnin, ose kur vriteshin nëpër fushata të mëdha...

Por, ngopjes me pushtet dhe molisjes, për të cilën njëherë foli Mehmeti plak para njëqind vjetësh, po i shihej fundi me vdekjen e hershme dhe të papritur të Hyni Pashës. Ç’është e vërteta Pashai dinak, që merrej si më i zgjuari ndër Qyprillinjtë, si ta kishte parandier se të shpejt e kishte fundin, u mundua me mish e me shpirt që hasretin, Nimanin, ta afronte rreth vetes, në mënyrë që t’ia shtinte në huj pushtetin. Por djaloshi nuk tregonte ndonjë kureshtje për zejen e Qyprillinjve. Përkundrazi, sa më shumë që rritej, mbyllej në vete dhe i rrinte larg t’et. Kryevezirit një ditë ia bënë me dije se i biri ishte dashuruar thellësisht në libra dhe tregonte prirjen e një mendimtari dhe të poetit. Pashai, që e dinte se ndër Qyprillinjtë gjithnjë ishte zhvilluar një garë e fshehtë për pushtet dhe kjo garë shpesh kishte marrë fund me kurthe, intriga dhe vrasje mizore përbrenda familjes, mend plasi nga zemërimi. Thirri të birin me ngut dhe kërkoi që t’i thoshte se çfarë kishte pushteti që nuk i pëlqente. Djaloshi i zënë në befasi heshti. Heshti edhe atëherë kur Pashai për të dytën herë ia shtroi të njëjtën pyetje thujse kërcënueshëm. Mendjen e kishte gjetiu, te ca vargje që po e mundonin ditë e natë, e që pikërisht kishin të bënëin me përmasat e lirisë. Mbase mënyra se si i foli i ati ia shtoi edhe më tepër bindjen se „ushtrimi i pushtetit ishte një prirjeje e rrezikshme kur kthehej në qëllim të vetvetes...” Madje, para t’et deshi t’i recitonte vargjet, të cilat iu bë se atë çast kishte gjetur fjalën e përshtatshme, me të cilën ato ndërlidheshin dhe krijonin një tërësi mendimi. Vargjet do t’i thoshte po të mos e kishte parë të atin të vërejtur si kurrë. Në atë ndeshje të parë të shikimeve nga afërsia që kishte ndodhur midis të atit dhe të biri, me të cilin sikurse fillonte shpërputhja e parë dhe e fundit e Qyprillinjve me pushtetin më të lartë, Pashai kishte shikuar një copë herë të birin, dhe, vetëm pasi në sytë e tij dalloj njëfarë tisi, që iu duk si megjullim, e pati të qartë se me këtë fillonte fikja e yllit të Qyprillinjve në qiellin më të lartë perandorak. Kjo e dëshpëroi por njëherësh e bëri të përmbahej, sikur të pajtohej me diçka që ishte e shkruar. Megjithatë, kur i biri po largohej nga salloni i praruar, qetas tha se fati dhe fatkeqësia e Qyprillinjve ishte e lidhur me fronin më të lartë...

Ato fjalë Nimanit iu ngulitën në kokë si heshta. Nga ai çast zuri të mendonte pse fati dhe fatkeqësia e tyre ishin të lidhura me fronin?... Ç’ishte ajo që e lidhte atë ngushtë familjen e tij me pushtetin e lartë prej atë kohësh? Dhe, a ishte e thënë se duhej medoemos të mbeteshin në atë majë?... Sa më shumë që vriste mendjen me këto hamendje, ndjehej gjithnjë e më i ngatërruar brenda një labirinti të pafund, ku humbte. Pse vallë duhet të ulem patjetër në atë fron, pyeste?... A thua Qyprillinjtë nuk kishin shteg tjetër pos atij që shpinte tek froni më i lartë?... Psehu sikur nuk kishte fund, saqë ndjeu se po i kthehej në një marramendje, që do ta përplaste diku. I mbërthyer nga ajo sfidë, që nuk i vinte më vetëm nga fjalët e të et, por nga të menduarit rreth kthetrave të pushtetit, një ditë vendosi të hynte në Dhomën e Kronikave për të parë se mos aty e gjente nyjën e pleksjes së Qyprillinjve me pushtetin dhe prirjen që i mbërthente atë fuqishëm për të...

Kur Pashai e mori vesh se i biri, më në fund ishte futur në Dhomën e Kronikave, pandehu se atij i ishte kthyer mendja. Ishte i bindur se tek Nimani ishte shfaqur befas ajo shtytja për pushtet, pa të cilën Qyprillinjtë as që mund të merreshin me mend.

Por heshtja e thellë në dhomën me mure kadifeje të kaltër e frikësoi djaloshin sa ndjeu të dridhura. Të ftohta iu duken edhe shikimet që i erdhën nga shtatë portretet e mëdha, të renditura në pjesën ballore të murit. Njëherë iu bë se portretet e mbërthyer në kornizat e rënda e të stolisura me fjongon e praruar perandorak, po e vështronin butësisht, sikur kërkonin pajtim, por që sa më shumë kalonte koha, kishte bindjen se shikimet e tyre vinin e ftoheshin dhe me përhapjen e vëngërt thuajse ia bënë me dije se nuk e kishte vendin aty. Mbase edhe do të largohej po të mos i kujtohej se aty ishte pikërisht për ta përballuar atë ftohtësinë dhe zbrazëtinë midis tij dhe pararendësve, që në të vërtetë ishte shpërputhje midis asaj që kishte ndodhur, dhe të gjithë i ishin nënshtruar, dhe asaj që do të ndodhte, me të cilën ndërrohej kahu i një prirjeje që familjes së tij ia kishte dhënë fuqinë dhe lavdinë, për t'u zhvendosur diku tjetër, te krijimtaria, te ajo pjesa që i referohej shpirtit dhe mendjes... Në atë përpëlitse, për pak i shkoi mendja se edhe portreti i tij do të mund të gjendej midis tyre dhe kjo i solli të dridhura të shumta, që e mbërthyen nga të gjitha anët me djersë të ftohta... A ka dënim më të rëndë se të futesh përgjithmonë në këtë hapësirë të akullt, psherëtiu dhe u ul në kolltukun e madh përbri tryezës së drunjtë, ku rrinin ca fletë të bardha dhe një bishtpenë. Që t'u ikte shikimeve të akullta, zuri sytë me duar, por edhe pse symbyllas, portretet po i shihte në lëvizje drejt njësimi, ku nga shtatëshja po i formohej një portret i madh, me shumë vija shqetësuese, i cili sikur pushtonte të gjithë hapësirën e dhomës. Hetoi se portreti i njësuar po e mbërthente nga të gjitha anët sa nuk kishte nga t'ia mbante më, pos të futej në një mjegullim, që pos nuk e dinte se ku ndodhej, ndjehej edhe i paqenë fare... Në atë gjendjeje sikur i bëhej se dikush po çirrej, se po thoshte diçka që ai assesi ta kuptonte, por mendja ia thoshte se fjala ishte për një kërcënim që i drejtohej nga dika... Dikur iu bë se portretet, që liroheshin nga korniza e përbashkët, ku ndejën për pak, po e darovisnin mjegullimin dhe po qartësoheshin, sado që edhe më tutje ruanin diçka nga gjymtimi, që herë pas herë i vinin pa sy, pa nofulla, e herë pa gojë apo ndonjë gjymtyrë tjetër... Ato pamje, megjithatë, e trishtuan dhe pa dashas ia nxorën një klithmë, që pasi shkoi nga muri në mur, me të shpejt iu kthye në kokë si një përplasje, që e shembi mbi tryezën e drunjtë...

Kur u kthjellua, pa Kronistin plak, që la diçka dhe u largua përkulshëm. Në shikimin e tij thuajse dalloj këshillën që ai nuk e tha por që e merrte me mend se duhej t'i përkiste madhësisë së kryevezirëve dhe ndjenjës së inferioritetit që prodhon ajo gjatë ballafaqimit, të cilën ai përherë e mbante n'gojë...

“Atij nënçmimi mund t'i bëhet ballë vetëm me krenari dhe vullnet edhe më të madh për pushtet...”

Përse duhet t'i takoj kësaj madhësie?... Përse?... Nuk bën vallë edhe ndryshe?...”

Iu duk se pyetjes që ia shtroi vetes me aq dëshpërim tash po i përgjigjeshin si me një gojë portretet e varura në mur dhe po i thoshin se nuk kishte nga t'ia mbante, meqë fronin e kishin fat dhe fatkeqësi, se tek ai ndodhej ajo pjesë e shpirtit dhe gjithë ajo që lidhej me qenien e tyre...

Ato fjalë që dikur ia kishte thënë edhe i ati, tash i vinin nga të gjitha anët, të kthyer në një jehonë, që i vërtiteshin pandalshëm. Sikur të kërkonte sqarime nga pararendësit, që i drejtoheshin ashtu, serish ktheu shikimin kah portretet në mur dhe hetoi se ato rrinin të ftohta dhe të heshtura. Kjo bëri që ta vriste mendjen se mbase ato që pareshtur i përplaseshin në kokë i vinin nga brendia, nga pjesa e papërmbajtshme që tashmë e shqetësonte padiktueshëm?... Mund të ishte pikërisht shtytja e vet, zërin e së cilës nuk e kishte dëgjuar, nga shkaku se e kishte ndrydhur pamëshirshëm çastin që zuri të merrej me krijimtari?...

Një ditë iu bë se portretet, që rëndom e prisnin ftohtas, edhe përkundër jehonës që herë pas herë ishte i bindur se vinte prej tyre, treguan shenja jete dhe e gjitha filloi me njëfarë shqetësimi, që nisi me ca lëvizje, të cilat në fillim iu duken të lehta, por nuk vonoi dhe ata

një nga një u liruan nga kornizat e rënda, me ç'rast dukeshin se shkundeshin nga pjesa e heshtjes që u rrinte sipër bashkë me pjesën e vdekshme që e bartnin... Nga ajo përpëlitse hetoi përvijimin e flashkët të shtatë vetave që kishin një dukje dhe një qëndrim. Nuk kishin nishane as armë, me të cilat shquheshin në pëlhurë, gjë që pa to iu dukën pak më të afërt. Dikur, madje, iu bë se ata që i kishin folur për fatin dhe fatkeqësinë e fronit si për diçka të pashmangshme, që duhej t'i nënshtroheshin Quprillinjtë, me nga një libër që mbanin në dorë, e shikonin miqësisht dhe se ishin pikërisht librat që i takonin kronikës së familjes, që duhej t'u afrohej sa më parë. Ballafaqimi me ata që ishin liruar nga mbërthimet e portreteve, megjithatë nuk po e daroviste heshtjen shurdhër në të cilën kishin sharruar së bashku. Një copë herë mendoj si ta thyente heshtjen dhe kur druante se në pamundësi që të vinte ndërlidhjen e domosdoshme, ata serish do t'u ktheheshin kornizave në mur, iu bë se si i pari nga e majta, nisi të fliste diçka, që i ngjasonte një gjëmimi...

Ishte Mehmeti, i cili pas tallandisë që liroi nanuritja, po mundohej t'i mbushte me kuptime ato që i shkëputeshin papërmbajtshëm dhe në përpjekje e sipër, që prej tyre të krijonte fjalë dhe fjali, munda të kuptonte se ato që dëshironte t'i qartësonte kishin të bënë pikërisht me kronikën e tyre si shtyllë të Perandorisë...

„Ky libër, që s'i ndahem kurrë, është pjesë e qenies sonë... Pa të do të dukeshim të paqenë...”

Një copë herë dëgjoi fjalët rreth librit dhe qenies, që i ishin nënshtuar një përsëritje, e cila sa vinte e bëhej më e zhurmshme. Dhe kur druante se ato do të treteshin në atë mjegullimin prej nga ishin liruar, Mehmeti nisi të fliste rreth njëfarë kreshpëritje nëpër të cilën derdhej kronika e tyre dhe një shpërndarjeje, që duhej të lidhej...

Ai po thoshte:

„E kisha parasysh se një ditë, herët a vonë, do të takoheshim gjithë tok dhe kjo do të ndodhte kur ylli ynë do të perëndonte... Megjithëqë nuk kemi të drejtë t'u shtojmë e as t'u mungojmë gjë atyre që tashmë i takojnë fronit, kjo nuk na pengon, që midis nesh, t'i hapim zemrat dhe të bisedojmë për ato që nuk kanë ndodhur dhe është dashtë të ndodhin si dhe për ato që kanë ndodhur dhe nuk është dashtë të ndodhin... Tash na lejohet të flasim për shqetësimet, për shtytjet dhe gjithë ato që i kemi ndrydhur e që na dallojnë prej njëri tjetrit, por edhe na bashkojnë... Erdhi, pra koha, t'i hapim zemrat dhe t'i themi edhe ato që nuk ia thamë as vetvetes... E di se betimi na ka mbajtur të lidhur, por kjo nuk do të thotë se përherë duhet t'i mbesim besnik ngrirjes që i takonte vetëm pushtetit të lartë dhe ruajtjes së tij të me çdo kusht... Të menduarit e lirë, që përherë na ka munguar, tash na mundëson të sillemi paksa edhe tutje kufizimeve jashtë kohës dhe hapësirës...”

Plaku për pak heshti. Dukej si një sfinë që ishte aty edhe më tutje për ta mbajtur nën velin e heshtjes atë që koha e kishte gjykuar të mbetej përherë e paprekshme... Por, dikur, sikur të ishte liruar nga kjo, foli e tha:

„Dua të them se nuk isha kurdoherë vetëm det i qetë, siç më njihnin nga jashtë... Jo. Jo. Isha gjithë shqetësim, që më shfaqej si një shtysë nga brenda, qysh atëherë kur, si fëmijë nisa të bredh pas njëmijë dritareve të qytetit tonë, që i shikoja nga pjesa e lumit dhe përpara më rrinin si një thirrje magjike, e cila më bëhej se më thoshte: shko pas yllit tënd... Ylli të pret... Mos u dëshpëro dhe mos u ligështo në kërkim të tij... Yllin e gjithëfuqishëm do ta arrish...”

Asaj thirrje të padukshme, që më vinte nga të gjitha anët, si ndjenjë dhe shqetësim, më kot përpiquesha t'i kundërshtoja me mallin që kisha për qytetin tim dhe njëmijë dritaret që i rrinin përballë... Dikur, ndjeva se ajo thirrje u bë aq e fortë, sa më rrëmbeu të tërin dhe unë, sapo i mbusha të tetëmbëdhjetat, iu nënshtrova një ngashërimi të çuditshëm, ku në një gjendje, që nuk e dija se a isha i fjetur apo i zhytur në një ankth të thellë, m'u shfaq ylli, pra pikërisht ai ylli, që më priste dhe më joshte me hapësirat e lirisë së pafund dhe majën në të cilën duhej të ngjitesha... Hetova se atëbotë drita e yllit m'i mori sytë, por edhe qenien time dhe më vuri në një lëvizjeje të çuditshme, që nuk e di se nga më solli dhe sa kohë isha në atë

bredhjeje të jashtëzakonshme, por që më në fund u ndala para një qyteti të praruar, me ç'rast një zë që erdhi nga lartësia sikur ma bëri me dije se e kisha vendin aty, ku do të bëhesha një me yllin...

Dhe kur përballova atë marramendje, pashë saraje të bardha, pashë prarim mrekullues dhe ç'mos nuk pashë që më mahniste... Kur po hamendesha se mos e gjitha ishte ndonjë vegim mashtrues, i njëjti zë më tha se do të ulesha medoemos në atë majë, por që kjo do të varej nga vullneti im... Dëgjova të më thuhej se më mbetet që pjesën e fundit të rrugës ta kaloja vetëm dhe sa më parë...

Por rruga deri tek sarajet dhe ai prarim, që më dukej se e kisha fare pranë dhe mund ta prekja me dorë, ishte e gjatë, shumë e gjatë, sa nganjëherë më bëhej te besojta se ajo thirrje që më shtynte përpara, nuk ishte tjetër pos përsëritje e ndonjë ëndrrë të shkapërderdhur, që m'u kishte qepur qëllimisht, nga mashtrimi i së cilës do të mbetesh fatkeq gjithë jetës... Dhe kur më bëhej se përhumbesha në mjegullim, serish më qepej ajo thirrja me kërkesën që t'i përballoja të gjitha...

Falë kësaj shtytjeje, një ditë hetova se po ngjitesha përpjetë, se po u afrohesha sarajeve të prarua, se më duhej edhe një hap i vetëm të futesha në to. Por, m'u desh edhe shumë kohë ta bëja atë hap. Dhe kur më në fund e bëra, m'u bë se thirrja e yllit, që më përcolli gjatë dhe përherë më nxititi të lëvizja përpara, ma bëri me dije se kisha ardhur ku u desh të vija, por e gjitha i takonte vetëm një fillimi, ku ajo që duket se është, njëherësh nuk është dhe nuk paraqet tjetër pos përsëritje...

Lum djaloshi, ajo që erdhi më pas ishte vetëm pushtet dhe vetëm pushtet. Njëzet e tetë vjet pushtet mbi Perandorinë e madhe dhe hapësirat e saj të pafund... Njëzet e tetë vjet pushtet mbi popujt e panumërt, njëzet e tetë vjet pushtet mbi gjuhët e shumta, njëzet e tetë vjet pushtet mbi pikëpamjet e ndryshme, që vlonin si një vorbull, të cilave ishte në gjendje t'u rrinte sipër vetëm bindja perandorake dhe asgjë tjetër, si një përcaktim, ku vullneti për fuqi mundësohej vetëm në saxe të ndodhjes në hapësirë të pafund...

Edhe në atë rrethana, ku i vogli bëhej i madh dhe i madhi bëhej i vogël, dikur vërejta se ylli im po zvetënohej... Ylli im po perëndonte, ndërkohë që hetova se po lindte një tjetër, ylli i tim bir, Ahmetit... Në të vërtetë, ai ishte i njëjti yll, që më përcolli mua, por që kthehej sa ora te një fillim, për të bërë prapë udhën e vet të pafund... A nuk ishte kështu?...“

„Sado që nuk pashë kurrfarë ylli, që do të më bartte dhe sado që asnjëherë nuk kisha menduar rreth trashëgimisë së fronit më të lartë, u habita pa masë kur më thanë se më priste ai... Pushteti nuk bën të mbetet thatë, më thanë dhe m'u përkulen sikur ta kisha në dorë atë...“-foli i dyti, që mbante një libër në dorë dhe e shfletonte kujdesshëm, herë nga e majta e herë nga e djathta.

„Ashtu është“, - ndërhyri i pari për të shtuar se të birin nuk i kishte folur për pushtetin, e as që i ia kishte bërë me dije se mund të ulej në të, por që e kishte mbajtur pranë, me bindjen se ai do të mishërohej me të siç duhej, që një ditë ta fitonte atë...

„Kush i rri pranë pushtetit“, - shtoi plaku „medoemos se lidhet me të. Po t'i thosha tim bir se duhej të mësonte dhe të bëhej gati për fron, mbase do të shqetësohej e mbase do të frikësohej prej tij?... Isha i bindur se ca gjëra duhet bërë ashtu vetiu, pa shtytje... A nuk është kështu, biro?...“

Tjetri heshti për pak, por pastaj, ngurrueshëm pranoi se nuk ishte i gatshëm për pushtet nga shkaku i vetëm se mendonte se i ati ishte i pazëvendësueshëm, ishte i pavdekshëm, se edhe pas tij hija e tij do ta udhëhiqte fronin më të lartë...

Plaku qeshi. Nimani ndjeu një shungullimë që u lirua frikshëm prej gojës së tij dhe u përplas nëpër dhomë sikur të ishte furtunë.

„Gjendesha në Krime, - vazhdoi Ahmeti, - kur më thirrën me ngut. Çfarë kishte ndodhur?... Kah nuk më shkonte mendja. Rrugën e gjatë e bëra i menduar dhe i heshtur, e i heshtur, skaj meje rrinte edhe lajmëtari, që erdhi të më merrte. Për pak më shkoi mendja tek nana plakë, e cila u bë helm pas vdekjes së tim ati. Mos kishte vdekur e shkreta nga pikëllimi i

madh? Desha ta pyesja lajmëtarin për përmasat e shqetësimit gjatë atij udhëtimi të ngutshëm, por nuk më la sedra ta bëja këtë. Tek e fundit, një valiut të lartë, nuk i kishte hije të pyeste një nëpunës të thjeshtë të shtetit se ç'la jme sillte dhe çfarë ishin ato, sado që isha i sigurt se nuk isha i burgosur. Ai urdhër shqiptoj, por edhe kur mbahej i fshehur, ishin masat përcjellëse që ndërmerreshin (përcjellja me roja të shumta, njësitet e sigurisë dhe të tjera), që e paralajmëronin atë. Përkundër kësaj, isha i bindur se diçka kishte ndodhur dhe se thirrja me ngut për në kryeshehër lidhej me ndonjë të papritur. Përballë kësaj gjendjeje, sa më shumë që i afroheshim kryeshehërit, kisha dëshirë që ta arrinim natën, ngaqë mendja ma thoshte se të papriturat, pa marrë parasysh çfare, i shkonin vetëm territ. Kështu edhe ndodhi. Dritat e Gjylsarajit dhe të Aja Sofisë i hetova sapo ra terri i parë. M'u duk se po shihja një prarim të jashtëzakonshëm, që rrinte as në tokë e as në qiell dhe se ai rreth i dritës gjithë lëbyr shfaqej ashtu i shkëputur që të më mashtronte... Atë ndjenjë e pata edhe kur pashë rojet e shumta që më përkuleshin, e kisha edhe kur hetova përcjellësit që përzemërsisht më uronin mirëseardhje, e edhe kur vëreja protokollarët e lartë që më prinin kah brendia e Gjylsarajit...

Hutimi m'u tret çastin që dola para Lartmadhërisë dhe ai ma kumtoi vendimin se më kishte emëruar kryevezir. Sapo iu përkula dhe ia putha dorën ai më tha:

„Babën e patë të fuqishëm. Dardha pikë nën dardhë...”

Sapo i tha këto, ushtarakë dhe diplomatët e shumtë, u përkulën dhe si me një gojë bënë aminin.

Jehona e “aminit” sikur shungullonte në të gjitha anët si një thekamë e jashtëzakonshme. Radha ishte të flisja. Por çfarë të thosha? Isha fare i papërgatitur për atë fjalim. Ata ishin mësuar me tim atë të fliste pakë dhe të bënte shumë. Mendja ma thoshte se këtë kërkonte prej meje Lartmadhëria, e këtë e kërkonte e gjithë Perandoria. Një kohë të gjatë bëra përpjekje të them se paku një fjalë të vetme, apo ndonjë mendim fare të thjeshtë, që do të shprehte falënderim. Por, shtangia më kishte mbërthyer dhe nuk më hiqej se nuk më hiqej. Përballë asaj gjendjeje, më kapluan djersë të ftohta dhe zura të dridhesha. Kisha frikë se do të plandoseshin para Lartmadhërisë dhe gjithë atyre që më shikonin me kureshtje.

I bindur se ngurrimin e kisha më shumë nga sedra që e kishin njerëzit fjalëpakë kur ndodhen para përgjegjësive të tilla, Lartmadhëria më ftoi pranë. M'i rrahu miqësisht krahët dhe gjithë butësi ma bëri me dije se më prisnin punë të mëdha. Më tha se froni më donte ashtu të fortë dhe të ngrirë, me përgjegjësi të jashtëzakonshme... “Kujdesu nga të papriturat”, më tha, “se të tjerat i përballon, siç i përballoi yt atë...”

Ç'është e vërteta të papriturat nuk m'u hoqën qafe asnjëherë dhe në vend se të shikoja përpara, gjithë kohen merresha me ato që më tërhiqnin prapa. Kështu, për shumë vjet sa isha në fronin më të lartë, m'u desh t'i shuaja disa kryengritje të mëdha (një në Rumeli, një tjetër në Egjipt dhe dy në Vllahi) dhe të ndërmarr disa fushata qetësuese... Në ato rrethana, kur derdhej gjak, medoemos se shtrohej pyetja se çfarë po ngjiste?... Pse duhej të luftohej më tepër me vetveten në vend se të shkohej tutje?... Ishin ato vetëm çështje rebelimi, siç arsyetoheshin nga shërbimet tona, që rëndom shpjegoheshin si kurthe që venin kundërshtarët e Perandorisë nga të gjitha anët, apo fjala ishte për lëvizje më të thella, që lidheshin me të ardhmen e Perandorisë, në rrethanat e një përbashkësie, e cila duhej të përfillte edhe kërkesat e atyre që e përbënin atë?... Nga ai pikëvështrim, sikur nuk kisha rrugë tjetër, pos të ndiqja atë që qonte vetëm tek forcimi i pushtetit qendror, pa marrë parasysh se mbi çfarë rrymimesh kalonin lavrat e tij... Pushtetit qendror duhej t'i nënshtroheshin të gjithë nga lartë-poshtë dhe nga poshtë-lartë dhe kjo ishte ajo vija e vetme e hierarkisë që duhej të ndiqej pa përfillur vlimet e brendshme, që kur shikoheshin veç e veç edhe mund të dukeshin të arsyeshme... Por, ç'e do që ata që nuk i nënshtroheshin këtij rregulli, pra ata që i priste shpata, që i priste ndëshkimi, që i priste kamarja e turpit dhe mallkimi i përhershëm, ishin gjithnjë e më shumë... Ploja e gjakut, që ishte kthyer në rregull dhe kërcënim të vetëm, sikur gjithnjë e më shumë më bënte të medyshesha rreth asaj se a nuk bënte edhe ndryshe?... Këtë dilemë, megjithëqë gjithnjë e më shumë ia shtroja vetes dhe ajo ma merrte qetësinë, isha i bindur se

froni i lartë dhe ecja e domosdoshme përpara, e përjashtonte, nga shkaku i vetëm se mekanizmi i pushtetit ngrihej dhe mbrohej vetëm me anën e forcës dhe assesi ndryshe... Mirëpo, krahas kësaj, shtrohej edhe çështja e hapësirës së lirisë si dhe atyre që i takonin arsyes dhe të kuptuarit e drejt të pushtetit në shërbim të atyre që ai u përkiste dhe duhej t'u shërbente... Kjo çështje, më në fund, duhej të hapej, që ecja përpara të mos shpërputhej apo të pengohej nga ngecjet prapa, që vinin nga brenda, me të cilat merreshin vetëm shërbimet e posaçme, në formë të pengimit apo luftimit të tyre, që rëndom duhej të mbylleshin me përgjigjen e forcës... Por, kush duhej ta hapte atë çështje?... A lejohej fare ajo?... Ishte vallë koha për to, e të tjera e të tjera... Të gjitha këto i përplaseshin kokës sime për aq sa e ngarkonin atë me mundim e një ngulfate... A thua isha i dënuar të jetoja dhe të veproja në një kohë të papërshtatshme, ku nuk ishte e mundur kurrfarë qasjeje tjetër?... Kjo çështje më ka munduar dhe po më mundon edhe tash...”

Fjalët e fundit të Ahmetit, sikur nxitën një zallahi të lehtë, e cila mbërtheu dhomën me një shungullimë, që Djaloshit iu duk se do të sillte çrregullimin e pakmëparshëm.

„Gjithnjë ke qenë i hamendshëm“, foli i treti, i cili qortoi pararendësin për mëdyshjet e panevojshme, me të cilat ai tha se ka mundur të dëmtohet Perandoria.

Pak më vonë ai shtoi:

„Ndaj kundërshtarëve nuk duhet pasur mëshirë. Perandoria pati kundërshtarë dhe ishte më se e drejtë që përdori dhe përdor sot e gjithë ditën forcën për t'u mbrojtur. Pa forcë nuk ka pushtet e pa pushtet të fortë nuk ka as rregull, nuk ka as shtet e nuk ka as perandori... Gjepura janë ato për gjoja mençurinë e qeverisjes dhe bashkëqeverisjes, apo edhe bindjet me të cilat ruhen lidhjet dhe marrëveshjet midis milletit dhe hyqymetit... Gjepura!... Me to vetëm sa ngatërroresh dhe humbësh... Perandoritë janë ngritur në saje të vullnetit për fuqi dhe janë shkatërruar kur kanë filluar muhabetet rreth ndarjes dhe shpërndarjes së brendshme të pushtetit... Andaj, unë nuk u besoj të tjerave pos fuqisë dhe kjo do të thotë se pushteti, si në kuptimin e ngritjes dhe të mbajtjes, por edhe të ushtrimit, ka vetëm përkrahës, ose vetëm kundërshtarë... Formulimet tjera paraqesin vetëm mashtrime, që shkojnë në dëm të pushtetit dhe të rrënimit të tij, që rëndom fillojnë me frazat rreth zbutjes së tij apo të përshtatjes së ndryshimeve...”

„Nuk do të thosha se pushteti ka vetëm përkrahës dhe kundërshtarë, që e gjitha pastaj të rrudhet në atë ndarjen: miq dhe armiq... Kjo prerje e bën atë të pashpirt, e ngurtëson dhe e kthen kundër vetvetes...” - foli Ahmeti me një zë të qetë.

„Serish ti me ato lajthitjet rreth arsyes dhe ndërlidhjes... Shporri ato njëherë dhe bindu se pushteti ka vetëm ndërtues dhe vetëm rrënues... Tjetër nuk ka...”

„Do të thotë se ne rretohemi vetëm nga miqtë, apo armiqtë?... Se ne jemi ose të mirë ose të keq?... Se dukemi vetëm të bardhë apo vetëm të zi?...“

„Vetëm kështu dhe assesi ndryshe...” - ia ktheu tjetri nxitueshëm.

„Po të jetë kështu, atëherë çfarë duhet bërë që miqtë të jenë më të numertë se sa armiqtë?...“

„Kjo nuk është çështje e pushtetit, por e përcaktimit ndaj pushtetit dhe përmasave të tij...” - ia ktheu tjetri dhe vazhdoi:

„Nëse dikush dëshiron paqe, rregull dhe siguri, atëherë duhet të jetë mik i pushtetit dhe t'i nënshtrohet atij. Në të kundërtën, ai që nuk e pranon atë, deklarohet kundër tij, që do të thotë se vepron kundër tij, që do të thotë se vihet në pozita të kundërshtarit dhe të armikut të tij... Këtu nuk ka kurrfarë filozofie: domosdoshmëria e pushtetit kurdoherë i nënshtrohet domosdoshmërisë së mbrojtjes së tij me të gjitha mjetet...”

„Shikimi bardh-zi çdo gjë rrudh në atë për dhe kundër, që për mua është gjëja më e keqe... Ku mbetet vallë mesi, ajo hapësira e pajtimeve të të kundërtave?...“ - pyeti Ahmeti.

„Lëre filozofinë, or! Pushteti nuk lejon sjelljet edhe-edhe, por kërkon prerjen e qartë... Në të kundërtën rregulli kthehet në shregull... Mos kësaj i thua arsye dhe maturi?...“

„Më trishtojnë skajshmëritë... Sikur të kishte diçka të ndërmjetme?...Me to pengohen thyerjet e ashpra...”-foli Ahmeti.

„Në jetë mund të ketë edhe lidhjeje të tilla, ku dike mund ta kesh më pak mik apo më pak armik dhe në të kundërtën, por shikuar nga prizmi i pushtetit kjo është e pamundur, sepse mikun nuk mund ta shohësh gjysmë-mik, armikun gjysmë-armik, apo mikun edhe gjysmë armik dhe armikun edhe gjysmë mik...Ky ngatërrim e shkatërronte pushtetin...”

„Megjithatë, sikur nuk më besohet se gjatë pushtetit tim kisha të bëjë vetëm me miq dhe vetëm me armiq... Këtë përkufizim nuk mund ta pranoj...”

„E pranove, s’e pranove, kjo është krejt një...E rëndësishme është se gjatë ushtrimit të pushtetit iu nënshtrova kësaj logjike?...“

„Veprua, por nuk isha i bindur se ishte ashtu, se kisha përpara vetëm miq dhe vetëm armiq...”- foli Ahmeti.

„Po ç’ishin tjetër, pos të tillë?...“

„Kishte të kënaqur, më pak të kënaqur dhe të pakënaqur... Ishin pjesë përbërëse e Perandorisë...Ishin mishi dhe gjaku i saj...”

„Po si mund të jesh pjesë përbërëse e saj të ngrihesh kundër saj dhe njëherësh të mos jesh armik i saj?... Po ma thuaj këtë se plasa?...“

„Nuk të kujtohet rasti i Krimesë?...“- pyeti Ahmeti.

„Atje pati shpërthim armiqësie dhe asgjë tjetër, që u desh t’i jepej përgjigjja e merituar “, - foli tjetri ashpër.

„Këtë nuk do ta thosha... Ata, megjithatë, nuk dëshironin luftë...”,- tha Ahmeti.

„Çfarë kërkonin ,pra?...“

„Kërkonin marrëveshje...Kërkonin që të bisedohej shtruar për disa nga kërkesat e tyre...”

„Marrëveshje?... A nuk paraqiste kjo kërcënim për Perandorinë, me të cilin do t’u hapej rruga rebelimeve të tjera, kur sekush do të kujtonte se ka të drejtë ta vejë atë para trysnisë?...“

„Ata pikërisht kërkonin bisedime rreth ardhmërisë së Perandorisë... Kërkonin që ajo të ishte edhe më shumë e ngjizur me qëllimet e tyre...”

„Gjepura!... Ata kërkonin ta rrënonin Perandorinë?...“

„Për perëndi,- zuri të fliste Ahmeti me një zë të butë,- nuk e kishin me të keq... Kur prita përfaqësuesit e tyre, ata më thanë se Perandoria ishte pjesë e tyre, se i besonin, se i krenoheshin kurorës së saj, se ajo ua kishte kthyer besimin se me të dhe vetëm me anën e saj mund t’u bënin ballë vështirësive me të cilat për shumë kohë ishin ballafaquar... Me një fjalë, ata kërkonin që në pjesën tjetër të botës të kishte më shumë Perandori dhe kjo u duhej për t’u mbrojtur më mirë nga rreziku që u vinte nga Veriu...”

„Serish flet gjepura... Ata dëshironin të shkëputeshin prej Perandorisë me arsyetimin se mvetësimi u mundësonte të mbroheshin nga rusët?... A nuk ishte kjo baras me rebelim dhe tradhti?...“

„Nuk do të thosha se ata dëshironin më pak Perandori në atë pjesë të botës... Përkundrazi, ata druanin nga zhvillimet që do të mund t’i sillnin para ndonjë të papriture... Kërkesa për lejimin e njërive të posaçme tatare, të cilat në mënyrë të pavarur dhe kurdoherë do t’i kundërviheshin kërcënimeve ruse,vetëm sa do ta forconte Perandorinë... Edhe sot e gjithëditën kujtoj se u veprua gabimisht kur ajo u hodh poshtë... Një Krime e fortë do të ishte shumë e dobishme për Perandorinë dhe ardhmërinë e saj në atë pjesë të botës...”

„Kjo do ta dobësonte.”- foli tjetri gjithë ashpërsi.- „Çfarë do të ndodhte po qe se në emër të vetëmbrojtjeve të veçanta edhe në pjesët tjera të Perandorisë do të lejoheshin njësitë paralele?... A nuk do të paraqiste kjo mundësinë që ato të vepronin kryenëvete apo edhe të rebeloheshin?... Pastaj, kush do të thoshte se ato ndonjëherë nuk do të binin në kurthin e kundërshtarëve tanë, apo që do t’u nënshtroheshin ndikimeve të ndryshme me të cilat do të

rrënohej forca mbrojtëse e Perandorisë?... Pushteti nuk guxon të shpërndahet, sepse atëherë fillon shpërbërja e tij...Fillon hilja...”

„Lëre hilen, ore! Kjo fjalë më tmerron... Sepse, në emër të saj u bënë masakrat në Krime dhe kudo tjetër...”

„Nuk ishin masakra ato, por qërim hesapesh me armiqtë tanë...”

„Ishin luftë me vetveten dhe kundër vetvetes... Ishin pjesë e fillimit të rrënimit tonë nga brenda...”-u çirr Ahmeti.

„Këtë nuk më bëhet ta dëgjoj”,- kërceu tjetri.-„Si mund të quhet rrënim nga brenda, kundërvënia e veprimit të armikut të jashtëm?... Si?...”

Tjetri për pak heshti, sikur të kursente fjalët me të cilat duhej të mbrohej çastin kur çështjet largoheshin nga hapësira e përshtypjeve dhe kujtimeve për t’iu afruar gjykimeve që i përkisnin përcaktimeve themelore, që lidheshin me besnikërinë ndaj fronit dhe themeleve të Perandorisë, si një ngrehinë, ku forca dhe stabiliteti i saj shiheshin në përputhje me qëndrimet e atyre që ndodheshin në majat e saj dhe me këtë i nënshtroheshin përgjegjësisë më të rreptë, e cila përfundonte tek kufijtë e lojalitetit ndaj saj apo të kundërtës... Kjo mbase bëri që Ahmeti për herë të parë të rrëfente rreth asaj si mëdyshjet e tij kishin filluar çastin kur iu desh të nënshkruante dekrete me të cilat kërkohej luftimi i me çdokush i armikut nga brenda, që binte ndesh me bindjet e tij, që ai i mori për shenja të para të tronditjeve të brendshme...

„Kishe përnjëmend bindjen se ata nuk ishin armiq?...” – i tha tjetri, që nuk i bëhej të dëgjonte përçapjet rreth tronditjeve të brendshme, që ai i quante marri...

„Nuk ishin armiq”, -ia ktheu Ahmeti.

„Por çfarë ishin?... Më thuaj se plasa?...”

„Ishin të pakënaqur, që mendonin ndryshe... Madje, mund të thuhet se ishin të guximshëm...”

„Tash e teprove!...” - ndërhyri tjetri. - „Pse nuk u vure në anën e tyre?...Patjetër se do të bëheshe hero i tyre...Për ty do të këndoheshin këngë të gjata...Ha,ha,ha! Do të bëheshe i pavdekshëm, por në anën e të mundurve, në anën e humbësve, në anën e tradhtarëve!...”

„Deri kur do të shohësh vetëm fitimtarë dhe të mundur?... Deri kur do t’i ndash njerëzit në armiq dhe miq?... Së paku tash nuk kemi arsye të jemi aq të përбетuar ndaj asaj që i kemi shërbyer, kur dihet se kemi pasur edhe mendime të tjera...”

„Unë, nuk kam pasur asnjëherë ngatërresat tuaja... Edhe njëmijë herë po të gjendem në fronin e lartë do t’i shërbeja në të njëjtën mënyrë...Nuk është këtu fjala vetëm për një bindje të natyrshme të atij që ndodhet në fronin më të lartë dhe e ushtron atë, por për më tepër kjo ka të bëjë me përcaktimin perandorak, si njërën ndër mundësitë më të mëdha që me të dhe vetëm me të të arrihet një cak i madh... Sepse, pa perandori të fuqishme nuk ka as përparim. Nuk as zhvillim. Nuk a as ecje përpara... Pa perandori bota do të mbetej një katund i rrudhur, ndërkohë që mendja do të mykej... Nëse ke menduar se kështjellat e shpëtojnë njerëzimin,atëherë është dashtë të mbetesh vali dhe t’i nënshtrohesh përkufizimeve të ngushtësisë dhe jo madhësisë së hapësirës si dhe sfidës së saj...”

„Mbase u desh të bëja diçka që sado pak marramendja e hapësirës të përkufizohej?... Mbase u desh të tregohesha më i vendosur?... Por, ç’ë do që edhe unë isha si të tjerët, me njërën anë, që vepron sipas arsyes dhe bindjes, dhe me tjetrën, që vepron sipas urdhrave... Megjithatë,e rëndësishme është se kam qenë i vetëdijshëm për thirrjen, që tek unë ka treguar shenjat e para të sëmbimit dhe besoj se ai shqetësim ka prekur edhe të tjerët, ke më shumë e ke më pak...”

„Nuk ke të drejtë që shenjat e sëmundjes sate t’ua shohësh edhe të tjerëve, madje gjithë familjes... Kjo është fare e papërgjegjshme dhe e palejueshme, qoftë edhe në rrethanat e tilla...”

„Nuk është punë sëmundjesh kjo, por pjesë e asaj që quhet prirje për vetëkuptim dhe ndërgjegjësim, që edhe mund të ndrydhët, por assesi të ngatërrohet...”

„Dokrra! Dokrra! Ndërgjegjësimi ynë ishte në shërbim të forcimit të Perandorisë dhe jo në të kundërtën. Ne luftuam për majat e saj dhe i arritëm ato me përkushtim dhe mund të madh... Pa perandorinë dhe hapësirat e saj ne do të mbeteshim pjesë e ndonjë katundi dhe asgjë tjetër...Vullneti ynë për fuqi do të shpenzohej për ndonjë luftë vëllavrasëse dhe asgjë tjetër...”

Tjetri heshti dhe ishte e qartë se nuk dëshironte më të shpaloste mëdyshjet. Djaloshit i erdh keq që me aq dhe ashtu do të mund të mbyllej hapja që kishte filluar aq papritmas në Dhomën e Kronikave, me të cilën atij edhe më tuje i shtoej bindja se ushtrimi i pushtetit njëherësh paraqiste edhe një sprovë tjetër të rëndësishme, që ndonëse shfaqej dhe zhvillohej në formën e një mbylljeje, patjetër se ndjehej edhe tek veprimet e jashtme, të cilat jo rrallë mund t’u hapnin udhë kthesave të mëdha, të cilave, për t’u kthyer në termet, u duhen lëvizjet e vogla bashkë me rrymimet e fshehura... Mbase ky mendim, që tashmë po i përpushej në brendi, e kishte nga trysnia e poezisë, që rëndom e mbërthente në rastet e tilla, por ishte një tjetër, pra i treti, i cili, sakaq, pas një belbëzimi, gjithë maturi, nisi të fliste rreth nevojës së sqarimit të gjërave mirë e mirë, së pari për hir të vetvetes, e pastaj për hir të plotësimit të Kronikës edhe me ato që nuk u takojnë dëshmime të shkruara, por që janë të nevojshme të dihen... Më tutje ai u ndal tek çështje e bindjes dhe tek arsyeja, të cilat i quajti pjesë të së njëjtës, që duhen shikuar thellë dhe me guxim, ngaqë vetëm kështu mund të shpëtohet nga njëanshmëria që sjell kundrimi, se përkatësia ndaj pushtetit më të lartë dhe ngjitja në majat e tij lidhet vetëm me vullnetin për fuqi, të cilit i nënshtrohen të gjitha...

- Nuk kemi arsye të harrojmë se ishim njerëz, si të tjerët, dhe nuk kemi arsye të mohojmë prirjen tonë drejt lartësive, që ishte e drejtë dhe e arsyeshme, pa të cilën nuk do të arrinin aty ku synuam dhe nuk do të ishim këta që ishim... Mirëpo, dua të them, ne nuk ishim të zhveshur nga bindjet tona dhe as nga synimi, që edhe në atë rrugëtim dhe në ato rrethana të dëgjonim zërin e vetvetes dhe të arsyes... Për mua besnikëria ndaj Perandorisë ishte pjesë e bindjes sime dhe assesi vetëm çështje e thatë e prirjes për pushtet dhe e ruajtjes së tij të me çdo kusht. Madje, edhe kur më emëruan kryevezir dhe kur Lartmadhëria më pyeti rreth lëvizjeve të ndryshme me të cilat kërkohej njëfarë mvetësimi i krahinave të skajshme, që nuk duhej të shkonte në dëm të pushtetit qendror, por të shtrirjes së tij nga poshtë, në përputhje me interesat e caktuara, e që kishte ngjallur reagime të ndryshme, veçmas tek dorëfortit, të cilët ato i merrnin si kurthe, që mund të çonin tek dobësimi i autoritetit të saj, kërkoja njëzet e katër orë kohë të mendoja shtruar rreth të gjithave, reagim ky që kishte për qëllim të lente për të kuptuar se nuk ishim vetëm robër të urdhrave, që vinin nga lartë, dhe as që i prisnim ato duarëhapur dhe me dëgjueshmëri të padiskutueshme, siç vërehet ndonjëherë, por kishim edhe mendimin tonë, edhe bindjet tona, që nuk ishin jashtë kohës dhe rrethanave të saj...

Pra, gjatë asaj kohe, pareshtur u mora me pyetjen që m’u shtrua si dhe pasojat që do të mund të kishte përgjigjja dhe qëndrimi im, më shumë për ardhmërinë e Perandorisë, se sa për fatin tim, që nuk do të mund të shkonte tutje një dështimi personal. Meqë nuk kisha shumë kohë të shfletoja kronikat e Perandorisë si dhe librat tjera që flitnin për ngritjen e saj të furishme gjatë dyqind vjetshit të fundit, iu dhashë gjykimit të thellë rreth fronit, hierarkisë së pushtetit si dhe domosdosë që ai të manifestohej me strukturë të organizuar, si një pashmangshmëri që shfaqej me kornizat e veta të caktuara, që i shërbenin këtij qëllimit dhe se ky gjykim, së pari më çoi tek nevoja e të qenit të tij, ndërkohë që më vonë ma tumiri bindjen se ishte fuqia dhe vetëm dhuna e fuqisë ajo që mbante këtë mekanizëm, por që nga ushtrimi i saj dhe mënyra e përdorimit përcaktohej përmbajtja e me këtë edhe fati i tij... Kështu, erdha deri tek përfundimi se pushteti ishte i pashmangshëm, se ai duhej forcuar dhe forcuar nga jashtë, ndërkohë që rrënimet e brendshme, pa marrë parasysh se si quheshin dhe të shumtën paraqitnin përpjekje për fërkime të ashpra, ishin çështje e lirisë, përmasat e së cilës nisnin nga individi dhe shkoni deri tek autoriteti i shtetit... Pra, të menduarit për pushtetin dhe shtetin si themel të tij, më solli tek te menduarit edhe për hapësirën e lirë dhe lirinë, që duhej të ishte pjesë e saj dhe assesi shpërputhje apo kundërshtimi e tij, siç mëtohej të shihej nga

shumë anë dhe veçmas nga ata, të cilët kishin bindjen se rruga e forcimit të Perandorisë duhej të mbyllte të gjitha shtigjet tjera pos atyre që i nënshtroheshin autoritetit qendror. Por, a ishte e mundur që këto prirje, në ato rrethana, të ruheshin dhe të shkonin të njëjtës kah, pa u ndeshur dhe pa u kundërshtuar, veçmas kur kihej parasysh se Perandoria shtrihej në tri kontinente, përthekonte qytetërimet që ishin në ndeshje të vazhdueshme dhe bashkonte shumë e shumë gjuhë, që nuk kishin kurrfarë afrie me njëra tjetrën, e që megjithatë paraqitnin shpirtin e etnive të ndryshme, që megjithatë duhej pasur parasysh si diçka të pakapërcyeshme?... Ata që kërkonin Perandorinë e fortë dhe të gjerë mund të thoshin se, së pari, duhej çuar përmasat e shtrirjes së saj deri aty ku ato përfytyroheshin, e pastaj të flitej edhe për të tjerat, gjithnjë duke harruar veçoritë mbi të cilën qëndronte ngrehina perandorake... Ky argument mbase edhe ishte i fortë, por a nuk fshehte rrezikun që një ditë, autoriteti i pushtetit të pakufishëm të binte ndesh së pari me këto larushi që nuk kishte si të anashkaloheshin dhe pastaj me lirinë e brendshme, si pjesë e këtyre cilësive?... Fundja, a nuk do të thoshte kjo pastaj luftë kundër vetvetes, e cila nuk kishte si të merrte fund pos me një dëm që mund të shkonte deri tek shthurja e asaj që quhej piramidë perandorake?... Ishte, pra e domosdoshme që të gjendej njëfarë baraspeshe midis pushtetit, shumësisë etnike dhe hapësirës së lirisë... Atë hamendje, megjithatë, paksa ma rrënoi Tahsini plak, kur më tha se nuk ka pajtim midis pushtetit dhe lirisë me të gjitha që nënkupton ajo, pa marrë parasysh se i pari do të duhej ta kishte si ideal të dytën dhe këtë nuk pushon ta thotë, ndërkohë që e dyta, pra hapësira e lirisë, do të duhej doemos ta ruante kornizën e të parit, për të qenë në gjendje të shpëtojë nga prirja e anarkisë, e cila paraqet një sëmundje të përhershme të saj nga shkak i vetëm se pa autoritetin e forcës ngatërrohen por edhe humben përmasat e asaj që quhet liri personale në raport me vetveten dhe me të tjerët... Qysh se është krijuar bota dhe nga nevoja e ruajtjes së lirisë është shtruar nevoja e vendosjes së rregullit, më tha plaku i mençur, këto çështje sikur ngrenë njëra tjetrën zvarrë, me të vetmin ndryshim se forca ia ka dalë të dëshmohet drejt vendosjes së pushtetit të caktuar, ndërkohë që prirja e lirisë, jashtë shtrirjes së mbikëqyrur, e shkapërderdhur, herë si mendim e herë si ide e përgjithësuar, pa qenë në gjendje të pushtojë hapësirën e duhur brenda asaj që quhet mekanizëm i pushtetit... Mbase kështu ka ndodhur ngaqë forcës i është dashtë organizimi për veprim të caktuar, ndërsa mendimit, e kundërta, dhe kjo ka sjellë deri tek raportet shpërputhëse, të cilat vazhdojnë të mbesin të tilla... Andaj, kundruall këtij zhvillimi dhe në përputhje me bindjen se pushteti duhet shfrytëzuar për të ndryshuar kjo gjendje në dobi të hapësirës së lirisë, në mënyrë që ai të forcohet nga brenda, erdha tek përfundimi se sjellja ime në majë të pushtetit, së pari, do të duhej të mbronte forcimin e tij të mëtutjeshëm, por njëherësh të krijonte kushte që, nga brenda, të hapeshin qepat e mirëkuptimit dhe të mirëbesimit të ndërsjellë, në mënyrë që forcimi i jashtëm të pasqyrohej me zbutjen e brendshme, ku nuk do të ketë kundërshtarë dhe armiq, ku nuk do të ketë heronj dhe tradhtarë, por vetëm aso që mendojnë ndryshe... Këto ia thashë të nesërmen Lartmadhërisë, dhe ai pasi që më dëgjoi gjithë vëmendje, më tha se atij nga lartë i hynte në punë forcimi i Perandorisë, ndërkohë që çështja e miqve dhe e armiqve, në rrafshin e brendshëm, i mbetej sjelljes së secilit ndaj pushtetit dhe autoritetit të tij, që do të thoshte se mua më përkiste e para, ndërkohë që e dyta u lihej për gjykim dhe vlerësim strukturave të ulëta, që lojalitetin e tyre ndaj autoritetit të pushtetit të lartë përherë e ngrihnin dhe e mbindërttonin në dëm të hapësirës së lirisë... Për mua, megjithatë, ky gjykim kishte një domethënie, ngaqë për herë të parë autoriteti qendror dhe forca e saj sikur u nënshtrohej synimeve të jashtme, pra forcimit dhe zgjerimit të mëtutjeshëm të Perandorisë, ndërkohë që lëvizjet e brendshme, pa marrë parasysh çfare, nuk i referoheshin më armikut të jashtëm, që njëherësh nënkuptonte luftimin e tyre me të gjitha forcat... Jam i lumtur që në Rumeli nuk lejova gjakderdhje, por lëvizjen që kërcënonte të kthehej në një plojë të brendshme gjaku, e qetësova dhe e motivova, që si e tillë, të drejtohej kundër qëllimeve të Rusisë dhe miqve të saj për të dalë në „Tokën e Lashtë“. Kështu, ata që deri më dje hamendeshin se mos do t'i lenim në baltë dhe nga ky shkak ishin në gjendje që të kërkonin ndihmë gjetiu, e patën të qartë

se hapësira e tyre do të ruhej dhe mbrohej vetëm me forcimin e mëtutjeshëm të Perandorisë, gjë që edhe kështu ndodhi... Kujtoj se edhe në Krime do të mund të veprohej kështu...”

„Krimenë e kam në qafë unë“, foli Ahmeti gjithë dëshëprim. „U desh të kundërshtoja... Medet, Krimeja... U gjakos pa nevojë dhe aty thyem degën tonë më të fortë...”

„Aty u mbrojtëm nga Rusia. U mbrojtëm nga ortodoksia dhe herezia e saj, që rrezikon njësoj dy botet“, -foli Plaku.-„Ato veprime ishin të domosdoshme...”

„Ishin tepër të ashpra...” - ia ktheu Ahmeti si përçart. -“U desh të isha më i vendosur... Po të ndodhte kjo shumëçka do të ishte ndryshe...”

„Mbase po e gjykon veten si shumë“, -ia ktheu Fadili, i cili kishte folur aq shtruar rreth arsyes dhe bindjes.

„Pa hamendjet tuaja, që u shfaqen në Krime, me siguri se unë nuk do t’ia dilja që të mos gjakoseshim në Rumeli. Ishte pikërisht ai ngurrimi yt, sado i mbyllur që të mos veprohej gjithaq me përkushtim ndaj tatarëve dhe mirëkuptimi ndaj kërkesave të tyre, që për herë të parë vuri në mëdyshje sprovën e me çdo kusht të forcës ndaj vetvetes... Hezitimi yt ndaj veprimit si dhe pësimet që ndodhen më vonë atje, mundësuan kthesën që m’u shfaq mua më vonë...”

„Kot më ngushëllon... Kot... Unë jam vrasës...”

„Këtë nuk do ta thosha“, - foli Fadili.-„Ishe nismëtar i një kthese... Unë ndjeka rrugën tendë dhe pata fat...”

„Isha një hiq-hiq“, tha Ahmeti.

„Lëre vetëfajësimin“, -ndërhyri i katërti, nga radha, i cili kishte një shikim të butë dhe një zë që mezi i dëgjohej. Mëtutje ai tha:

„Edhe pse nuk pata fat të qeveris aq sa të leja gjurmët e mia në fron, megjithatë edhe unë ndjeva sëmbimin e zbutjes së pushtetit nga brenda, si një domosdo, me të cilin ai do të forcohej, gjë që hartova një memorie në të cilën shtrova ato që do të duhej t’i shkonin këtij ndryshimi... Reformat e brendshme si dhe mirëkuptimin nga lartë-poshtë i shihja si shpëtim të Perandorisë, që duhej filluar sa më parë prej nesh dhe jo të detyruara nga jashtë kur e kemi pisk... Kisha mendjen edhe tek hapësira e lirisë si një çështje që doemos duhej pasur parasysh... Kur po dergjesha në shtrat dhe dihej se ditët i kisha të numëruara, erdhi Lartmadhëria dhe më tha:dihe or Sami Pasha, se vdekja është kapak i artë...”

„Po pse t’i tha ato fjalë?“- ndërhyri Plaku...”A e more vesh këtë?”

„Paj, mbase i gëzohej vdekjes sime, ngaqë nuk e kishte ndër mend të duronte që kaut t’i zbuteshin brirët“?...

„Këtë nuk ma thotë mendja“, - foli Fadil Pasha. - „Më tepë e kishte për mundimet e dergjës sate...”

„Sidoqoftë, më vjen keq që nuk kisha kohë të mbetesha edhe pak në pushtet... Mbase disa gjëra do të mernin tjetër kah?...“

„Asgjë nuk do të ndryshonte, pos që do të shënohej fundi i Qyprillinjve dhe mudi i tyre do të shkonte kot... Dikush ndoshta kështu do të gjente arsye të na i shembte edhe varret që të përjashtoheshim dhunshëm nga kujtesa e saj... Kjo do të ishte një vdekje e dyfishtë për ne që majat e saj i kishim synim i përhershëm, por edhe për ata që hapësirën e perandorisë e shihnin si një mundësi të jashtëzakonshme për t’i pushtuar lartësitë e saj...”

Samiu deshi të thoshte diçka, por ndërhyri i pesti, që zuri të fliste me një zë të fortë, sikur të kishte për qëllim të përjashtonte belbëzimet e hamendjeve të fundit.

„E di, o Mustafë Pasha, se shpatën e ke të fortë dhe të pamëshirshme,- më tha Lartmadhëria kur ma uroi fronin.- I tillë i duhesh Perandorisë, që po kërcënohet nga Lindja dhe nga Perëndimi, nga lartë dhe nga poshtë... Andaj, nuk është kohë e rropatjeve, por e veprimeve. Filloja, pra, dhe mos u ndal. Para ke pushtetin e pakufishëm!

Për mua ishte më se e qartë se jo pispillosja e mendimeve dhe ato që thuheshin andej-këndeje rreth pajtimit të brendshëm, por veprimi i ngulmshëm ishte ai që do ta shpëtonte Perandorinë nga ngulfata. Veproma me guxim dhe bëra që kurora jonë serish të shkëlqejë kah

Lindja dhe kah Perëndimi, kah jugu dhe kah veriu. Nga Kaukazi kalova në Evropë dhe ua drodha mirë e mirë kokën pashallarëve që kishin filluar të merrnin nëpër këmbë autoritetin e Portës. A nuk e merituan këtë?... Pa pastrimin e brendshëm nuk ishte e mundur të qëroja hesapet me austriakët dhe të tjerët që ishin futur thellë deri te *Toka e Lashtë* dhe ishin të bindur se do të na e shkëpusnin pjesën më të fuqishme nga trupi ynë. M'u desh që nga Shkupi deri në Prishtinë dhe nga Prishtina deri në Nish dhe pastaj në veri deri tek Danubi ta ndjek këmba-këmbës gjeneralin e Vjenës me të tjerët që i shkonin pas... Bëra që ai si qen i zgjebosur të dergjej skutave të Ballkanit deri sa vdiq i nënçmuar... Më vjen keq që ajo sëmundja, që e mori, ishte më e fuqishme nga shpata ime, që e priste. Sidoqoftë shqiponjësit danubiane shpejt iu dogjën flatrat dhe mua zemra akoma me qanë për të gjorët që i kishte mashtruar me premtimin se do t'ua kthente shkëlqimin e principatave të harruara ortodokse, të cilat kaherë kishin perënduar. Vjena bashkë me të tjerët dëshironte t'i ringjallte ato, por harronin se në *Tokën e Lashtë* dhe përreth saj kryqi ortodoks jo vetëm që kaherë ishte fikur, por qysh nga çasti i ndarjes së kishave, për shumëkënd atje ai paraqiste vetëm një kujtim të ligë që lidhej me çmimin e gjakut që ia kishin paguar atij dhe trysnisë që t'i takonin një gjuhe dhe një fisi të egër që duhej t'i gëlltiste...Të vetëdijshëm se i ishin nënshtruar një mallkimi tjetër, shumë nga ndihmaçarët e gjeneralit të mundur të Vjenës morën rrugën e pa kthim të veriut, sado që shumë prej tyre e dinin se ajo do t'i çonte deri te një shkatërrim tjetër... Më kot u përpoqa t'i ndalja me premtimin se u falej hutimi dhe gabimet dhe se Perandoria, me kusht që t'ia falnin besimin, edhe më tutje mbetej e tyre... Por, ç'e do që ata përpara shihnin vetëm një kryq dhe asgjë tjetër... Për ta kryqi dhe jo vatani paraqiste shpëtim...Të tillëve nuk mund t'u ndihmohej..."

„Mbase mund t'u ndihmohej“, foli Ahmeti, sikur të ishte zgjuar nga një jeremi. „Mbase?...“

„Me se“?- pyeti Mustafë Pasha.

„Sikur të mos përdoreshin topat më të rinj..."

„Si do t'ia bëja ndryshe?“ – shfreu Mustafë Pashai me një zë të fortë. „Si? Kur aty ishte gjenerali i Vjenës me ushtrinë e fortë, që kishte depërtuar thellë deri në Prishtinë dhe Shkup dhe druante që ta shkëpuste gjithë hapësirën e *Tokës së Lashtë* nga Perandoria. E dija se aty ishin njerëzit tanë, të cilët u binte çmimi i haraçit më të madh, por ajo ishte luftë që zhvillohej midis dy perandorive, luftë midis dy boteve, ku në atë hapësirë, më shumë se kudo tjetër, për vdekje përjashtonin njëra tjetrën, siç kishte qenë gjithmonë... Gjenerali i Vjenës kishte bërë për vete disa mijëra veta dhe u kishte premtuar se kishte ardhur koha përfundimisht t'i ktheheshin kryqit ruso-ortodoks dhe frymës së tij dhe me këtë do të gëzonin mvetësinë... A nuk ishte ky një mashtrim i kobshëm me të cilin ndizej lufta e harruar vëllavrasëse, e parë dhe e ndodhur gjatë ndarjes së kishave, që megjithatë vetëm në rrethanat perandorake ishte fashitur?... Sapo kaluan Danubin dhe prekën *Tokën e Lashtë*, emisarët e gjeneralit të Vjenës nxituan të hapnin njëfarë kumti të lirisë, që e lidhnin me kthimin e kryqit në këtë pjesë të botës dhe atë e merrnin për meritë të madhe, sikur ai nuk ishte aty ku kishte qenë edhe në rrethanat perandorake dhe përtëritej madje në saje të autoqefalisë që e kisha ortodokse e kishte bartur tek Porta dhe, jo vetëm që mbijetonte, por edhe zgjeronte hapësirën e shtrirjes. Kur mori grushtin e parë dhe e kishte të qartë se do ta humbte luftën, gjenerali i Vjenës nuk fliste më për misionin e kryqit e as për ata që i kishte mashtruar me emrin e tij, por kërkonte të tërhiqte në veri oficerët e besueshëm, pa qarë kokën se çfarë do të ndodhte me ata që i kishin shkuar pas dhe kishin ngritur dorë kundër Perandorisë. Megjithatë, të tillëve ua fala hakun dhe kërkova që t'u ktheheshin familjeve. Por, ç'e do që murgjit ortodoksë, që kishin frikë nga tradhtia që kishin bërë ndaj Portës dhe e dinin se ajo nuk u falej pas gjithë atyre të mirave që kishin gëzuar në rrethanat perandorake gjatë dyqind vjetëve të fundit, kur asaj ia kishin falë besimin dhe si kundërshtpërbllim kishin marrë mbrojtjen zyrtare për të ushtruar lirisht besimin e tyre, që më së miri u pasqyrua me ngritjen e dhjetëra manastireve ngado që kishte besimtarë, pra të tillët, për ta fshehur të pabërën, mashtruan besimtarët dhe

shumë prej tyre i morën me vete në rrugën e pa kthim. Edhe pse disa prej tyre e ndërruan mendjen dhe u kthyen, më vjen keq për gjithë ata fatkeqinjë që e pësuan nga mashtrimi i dyfishtë. Ata shpejt do ta kenë parë se si as Vjena e as patriarkët ortodoksë nuk do të qajnë më kokën për ta, gjë që do të mbesin në mëshirën e pamëshirë rrugëve të botës...”

„Kështu ndodh kur shkohet rrugës së gabuar“, - foli Fadili. „Megjithatë, ti bërë atë që u desh ta bësh“, - i tha Mustafë Pashës.

„Mendja ma thotë se ata u tmerruan nga gjylet e topave... Sepse aty ku dridhet toka nga plumbi nuk ka jetë...” – foli Ahmeti si përçarhtë.

„Pa topa nuk kishte fitore. Këtë e dimë fare mirë të gjithë, veçmas kur fjala ishte për një luftë dhe një kryeneçësi, që u nxit nga agjentët e Vjenës dhe ata murgjit ortodoksë. Ata i morën në qafë njerëzit tanë, që i mashtruan dhe në fund i lanë në baltë, e jo ne që shkuam t’i ndiqnim ushtritë e tyre... Tek e fundit, krahas mbrojtjes së Perandorisë ne kishim për detyrë të çlironim kështjellat tona nga kryqi. Çfarë do të ndodhte me trungun tonë po të ndodhte kjo?...Do t’i lejonim kambanat e Moskës të harbonin aty dhe me këtë të përvetësonin rrënjët tona?... Falë topave ia dolëm t’i kthejmë kështjellat tona... Ruajtëm qenien tonë kundër nëpërkëmbjes bizantine... Dëmi nuk krahasohet me dobritë...”

„Rikthyem kështjellat, por humbëm shumë nga njerëzit, një pjesë tonë“ - tha Ahmeti.- „Kjo plagë po më tmerron...”

„Nuk ia vlen të merremi me dëmet, por me ato që duhet bërë për të mbrojtur Perandorinë e me këtë edhe kështjellat, që duhej kthyer medoemos, ngaqë shpirti dhe mendimet tona vetëm aty gjejnë prehje... Pa kështjellat tona jemi si trungu pa rrënjë dhe nuk paraqesim asgjë... Pra, atje kemi shpirtin, ndërsa këtu veprën...”,- foli Mahmuti.

„E qartë“, -tha Mustafë Pasha, - „por duhet ditur se trupi dhe shpirti ynë si shenjë të përbashkët kishte dhe ka vetëm Perandorinë dhe rritën e saj, ku lamë gjithë qenien dhe vullnetin tonë për fuqi... Pa të ne do të ishim asgjë, ndërkohë që edhe kështjellat tona do të shembeshin pak nga pak nga përpjekjet e mbijetimit të me çdo kusht, që t’u përshtateshim atyre që vinin nga Lindja apo Perëndimi me kusht që për pak dhe vetëm si vasal të mbeteshim të qetë... Andaj, detyrimi dhe përcaktimi ynë parësor për Perandorinë e fortë dhe ruajtjen e saj si të tillë njëherësh ishte pjesë e të qenit tonë, që vihet mbi çfarëdo interesi tjetër, qoftë ai edhe i lidhur me ndjenjat, që aq shumë po e mendojnë Ahmetin...”

„Ato nuk janë çfarëdo ndjenjash... Janë ndjenja të vatanit, që përcaktojnë shpirtin dhe qenien... Atyre nuk po mund t’u ik... M’u kanë qepur dhe assesi të më ndahen...”

„Pa Perandorinë tonë të fuqishme, nuk do të kishe as vatan, nuk do të kishe as shpirt dhe nuk do të kishe as varr... Aty do të ishte ortodoksia dhe vetëm ortodoksia me kryqin e saj të përgjakur dhe asgjë tjetër... Mbase këtë e di fare mirë“?- tha Mustafa Pasha.

„Di se nuk di...” - ia ktheu Ahmeti.

„Pse nuk lirohesh nga ato mëdyshje, pra?“

„Sepse, ato janë pjesë e atij mallkimi, që i zë ata që përherë duhet t’i nënshtrohen urdhrit dhe vetëm urdhrit...”

„Ç’është gjithë kjo ndjeshmëri ndaj filozofisë?... Sikur harron se pushtetit i duhet mendja, por edhe më shumë forca.“- foli Mustafë Pasha.

„E di dhe pikërisht pse e di këtë po mendojem të gjykoj se a mund të bënte edhe ndryshe?... Se a kishte mundësi shpirti dhe mendja disi të mos kundërshtoheshin gjithaq?...“

„Lëri andrallat“, - ndërhyri Fadili. -“Këtu mund të flasim mbarë dhe mbrapsht, por sekush e di se pushteti ka rregullat e veta, që duhet përmbajtur. Mustafë Pasha veprooi drejt dhe falë ndërhyrjes së tij Perandoria u mëkëmb, ndërkohë ne mund të prehemi të qetë se shpëtuam nga mallkimi i atdheut që do të na zinte po qe se do ta linim në mëshirën e pamëshirë të kryqit ortodoks. Gjaku ynë do të shprishej përgjithmonë...”

„Deri kur gjërat do të shihen bardh-zi?“ – ndërhyri Sami Pasha pas një heshtjeje në të cilën ai ishte zhytur sikur të dëshironte të përjashtonte ato që thuheshin. - „Deri kur do të kapemi vetëm për atë duhej-duhej, që nënkupton pushtetin dhe rrethanat e tij dhe jo edhe për

të kundërtën?... A thua frika nga rishqyrtimi na ka bërë të tillë që t'ï ikim edhe mëdyshjeve më të rëndomta, që megjithatë kanë përcaktuar ato rrjedha, me të cilat janë ruajtur disa baraspeshime të brendshme, që ne ende nuk dëshirojmë t'ï shohim, apo t'ï pranojmë si të tilla, ngaqë kështu druajmë se mund të ngarkohemi me fajësinë e mangësisë së lojalitetit dhe gjëra të tjera?...”

Pasi tha këto Sami Pasha u ndal për pak, sikur t'ï ishin sosur fjalët... Vetëm pasi mori mundimin vazhdoi të fliste me një zë fare të nemitur.

„Kujtoj se sikleti im dhe ngatërrimi me atë far mjegullimi, që quhej sëmundje e shpirtit, nuk ishte tjetër pos çështje e një kundërvënie njëtrajtshmërisë dhe dëgjueshmërisë ndaj fronit, që na kishte mbërthyer... Ajo që ngjau tek unë, ishte vetëm pjesë e trysnisë së ndërgjegjësimit, pra e arsyes, që shfaqej si nevojë qoftë e pavërejtur, me anën e së cilës, mund të frenohej prirja që pushteti të kthehej në një mekanizëm të thatë dhe të ashpër veprues. Kujtoj se falë kësaj prirjeje, që po përsëritet pareshtur, ne po mbahemi në fronin më të lartë dhe jo pse kemi qenë përherë vetëm besnik ndaj Perandorisë, siç përflitet or e çast, nevojë e pa nevojë... Mendja ma thotë se atë çast që do të prishet kjo baraspeshë, atëherë ne bimë nga fronti dhe me këtë as Perandoria nuk do t'ï ketë punët mirë...”

Pas një ngulfateje, Sami Pasha tha:

„Megjithëqë, Qyprilinjë udhëhoqën një Perandori të fuqishme, ajo ua deshi forcën, por jo edhe mendjen...”

Fjalët e fundit të Sami Pashës sikur futen një heshtje të akullt. Nimani hetoi se Qyprillinjë ndodheshin para mëdyshjes të flisnin tutje, apo t'u ktheheshin kornizave në mur, prej nga merrte fund shpalimi i tyre. Çastin që dhomës po i kthehej njëfarë mugëtire dhe dukej se me aq mbyllej një shpalim i papritur, ndodhi që qetësia shurdhe u thye nga fjalët, që shpërthyen nga skaji tjetër. Ai që foli ishte Mahmut Pasha, që si dukej rrinte nën hijen e gjyshit, Mustafë Pashës dhe të atit, Ahmet Pashës dhe përpiquej të tumirte mendimin se Qyprilinjë, përnjëmend, nuk ishin hyzmeqarë, por ishin vetëm pjesë e një mekanizmi të njëtrajtshëm, që me asgjë nuk ndryshoi kahun e pushtetit...

„Sapo u ula në fron,- vazhdoi të fliste Mahmut Pasha, - më shkoi mendja rreth atyre që mund t'ï ndryshoja. Njëtrajtshmërinë e tij e njihja dhe kjo më shtyri të mendoja shtruar për ato që pushtetit t'ï jepnin një frymëmarrje tjetër, veçmas kur mund të thuhej se nga jashtë Perandoria kishte arritur synimet e veta dhe duhej që e gjithë kjo shtrirje të forcohej nga brenda. Mendova dhe çmendova dhe sa më shumë që çaja kokën me to, mendja ma thoshte se pushteti ishte pushtet, pra si ai lumi vërshues, i cili kur ka ujë shumë ecën dhe nuk përfill gjë, ndërkohë që kur t'ï mungojë paksa, ai frikësohet nga rrjedha e natyrshme, pra nga vetvetja, gjë që pjell stuhi për ta mbajtur të hapur përherë në veprim ndjenjën e vërsushmërisë... Në të tillë gjendje e gjeta pushtetin, të cilit dëshiroja t'ia hiqja dridhërimat e brendshme, sado që kjo nuk ishte e mundur... Kjo më qiti në shtrat dhe, falë Perëndisë, sëmundja më shpëtoi nga mundimi i rropatjes me gjëra që nuk kishin të ndrequr... U mbërtheva në shtratin e vdekjes me ngushëllimin se ashtu do të përpushja shkaqet e fatkeqësisë, nga e cila nuk ka shpëtim i gjori njeri...”

„Dhe i gjete“? - pyeti Fadili.

Tjetri heshti për pak. Nimanit iu bë se ai kishte kyçur gojën qëllimisht, nga bindja se kishte thënë edhe ato që nuk duhej të thuheshin.

„E di se ke mbetur në mjegull. Rropatjet e tilla ta marrin qetësinë e t'ï mbyllin shtigjet“, foli serish Fadili.- „Por fajin duhej kërkuar tek perdja e mjegullës që ia kishte krijuar vetit dhe jo gjetiu...”

„Kjo është më se e vërtetë dhe ai që dëshiron këtë do të jetë gjithnjë i shqetësuar, i mbërthyer në vete, - nisi të fliste Mahmuti.- Por, ajo gjendjeje pakënaqësie, edhe si i tillë, a nuk është më e mirë nga tejdukshmëria e zbrazë?... Për Perëndi, nuk ka gjë më të llahtarshme sesa tejdukshmëria... Nga ajo gjithnjë më ka ardhur të vjell, e ngjashëm po ndjej edhe tash që po mendoj për të...”

Fadilin e mbërtheu një e qeshur, e cila më të shpejt pushtoi hapësirën e dhomës.

„Hiq ëndrrave, babaxhan! Hiq! Ç'dobi ke nga ato? Si mund ta fisnikërojë mjegullimi shpirtin?... Shërohu njëherë e mirë...”

„Sëmundja ime,- foli Mahmuti,- ishte shqetësim ndaj asaj që sjell pushteti i njëtrajtshmërisë... Ai mundim e ushqen shpirtin, e mbron nga rrënimi, e mbron nga kotësia dhe madje e fisnikëron... Andaj, kush ecën nëpër mjegull, kërkon diçka, që do të thotë se kërkon dhe kërkimi është prirjeje që shpien kah lëvizja e gjërave dhe ndryshimet.....”

Fadili prapë qeshi. E qeshura e tij tashmë kthehej në një thekamë që përplasej sa andej sa këndeje në hapësirën e dhomës, sikur të paralajmëronte ndonjë thyerje të paparashikueshme.

„Pushteti përnjëmend është i njëtrajtshëm dhe i tillë duhet të jetë për të qenë sa më i qëndrueshëm, por çfarë do të bënim pa të?... Nuk do ta hanim vetveten çastin që atë nuk do ta kishim mbi kokë?”

Mahmuti po nanuriste diçka. Kjo sikur e kallti Fadilin, i cili nisi të pyeste rreth asaj se kush e kishte krijuar pushtetin, se mos ai kishte pikur nga qielli sa për sy e faqe apo pse dikujt i duhej për t'u ngritur mbi të tjerët?... Pyetjeve që i shtroi nxitoi t'ua jepte edhe përgjigjen:

„Pushtetin e krijoi njeriu që të bënte zap veten e të vinte në pranga herezinë që e ka në shpirt, nga shkaku se ajo, herë më pak e herë më shumë, ngre krye dhe kërcënohet. Vetëm pushteti është në gjendje që ato prapësi disi t'i mbajë nën mbikëqyrje...”

„Pushtetin njëmend e lindi nevoja për rregull dhe e forcoi domosdoja e përballimit të huqeve, me të cilat njeriu është deng, - foli Mahmuti, - por, nuk është e thënë që ato të mbesin gjithnjë të njëjta. Njeriu është njeri pikërisht pse ka mundësi t'i përballojë ato dhe t'i fashisë sa më shumë që të jetë e mundur... Andaj, të mbash pushtetin vetëm si të fortë, pra si qëllim i vetvetes, do të thotë të mos kesh besim në asgjë. Madje, të mos kesh besim as në atë që është e ndërgjegjshme dhe e gatshme ta mund të ligën...”

„Nuk ngatërrohet pushteti me filozofi“, - foli Fadili.

„Pushteti pa filozofi është vetëm dhunë“, - ia ktheu Samia.

Çastin që biseda kërcënonte të kthehej në një grindje të thellë midis Fadilit dhe Samiut, ndërhyri Mehmeti, i cili kërkoi që biseda të merrte fund.

„Ka njëqind vjet që rropatemi me muhabete të njëjta...“, - tha ai me një zë kërcënues.

Më pas ra një heshtje e thellë. Nimani zuri kokën me duar, ndërkohë që fjalët „njëqind vjet...” po i silleshin marramenthi, si lëmsh që sa vinte e ngatërrohej nga përsëritja. Dikur iu bë se midis tij dhe hapësirës që e ndante nga portretet në mur ishte futur një tis mjegulle, i cili, sikur ia kishte kollofitur përftimet e pakmëparshme të gjyshërve dhe stërgjyshërve bashkë me ato që kishin thënë... Një heshtje shurdhe që kishte pllakosur Dhomen e Kronikave si dhe mbërthimi i ngrirë në të cilin ishte kyçur, i lënin përshtypjen e ndodhjes së një zbrazjeje të brendshme, që shtrihej në shumë pjesë, e ku secila prej tyre përbënte atë kundërshtimin e brendshme... Këtë ndjenjë ia sfërcoi edhe më tepër picërrima e mekur e flakës së qirinjve si dhe formësimi i një hijeje që lidhej në pjesën e kundërt, prej nga ai shihte një krijesë të shumëzuar, me shumë fytyra të njëjta...

„Është koha të liroheni nga ajri i mbyllur“, - i tha kronisti plak, që po i rrinte pranë.

Nimani fërkoj sytë dhe shikoi përreth me frikë sikur të dëshironte të mbrohej nga ballafaqimi me gjërat e njohura. Në murin ballor hetoi portretet e varura që rrinin ashtu me shikimet e akullta...

Atë natë mendoi gjatë për poezinë dhe filozofinë. Në atë vegulli i bëhej se herë-herë, ato që i kishte shkruar ia recitonin të tjerët pa ndonjë përkushtim, kështu që vargjet i shfaqeshin pa domethënie dhe të ngatërruara fare... Çastin që dëshiroi t'i afrohej dritares për

ta hapur, ndjeu disa trokitje të lehta në derë, të cilat sa ora e nxorën nga ajo gjendje e ankthshme. Ishte lajmëtari që i tha se e kërkonin me ngut.

Në shikimin e lajmëtarit hetoi shqetësim, e shqetësim takoi edhe para dhomës së madhe të Kryevezirit, ku ushtarakët, vezirët dhe titullarët e lartë gjithë sa ishin kokulur thyenin gishtat.

Në dhomë, i ati rrinte shtrirë dhe i zverdhur dyllë. Kur ia puthi dorën, i shpëtuan lotët dhe ndjeu një rrënim të papërmbajtshëm brenda. Sikur të kishte rimarrë atë forcën e fundit nga prekja e të birit, hapi sytë, në të cilët Nimani pa qartë perëndimin e jetës.

„Mos e harro amanetin“, - i tha.

Gjatë kohës së varrimit, i ndodhi diçka e jashtëzakonshme, që do ta mbajë mend gjithmonë. Pra, kur po ecte pas xhematit, që nuk kishte fund, në duart e së cilës i vdekuri dukej se fluturonte, mendja i treti në një hapësirë të paanë, ku nuk kishte tjetër pos poezisë. Fjalët e shumta, pastaj vargjet, strofat, shenjat dhe rimat e panumërta, që ndërthureshin ndër vete, plotësonin gjithçka... Kështu që edhe bimët ishin vargje, edhe drunjtë ishin vargje, edhe lulet ishin vargje, e edhe lumenjtë ishin vjersha... Madje, edhe malet dhe kodrinat nuk ishin tjetër pos grumbuj vargjesh...

Në atë gjithëvargësi, një puhizë e cila frynte nga jugu e nga veriu, bënte që fjalëve t'u shkëputeshin ca rrokje, të cilat pastaj, duke i ndërruar vendet, lëshonin tinguj të ndryshëm, që më vonë krijonin melodi magjike nga ato që përherë joshin shpirtin...

Do të mbetej kohë e mot aty, ku gjithçka i nënshtrohej pushtetit të poezisë, po të mos hetonte një shi të imtë, që i ishte futur në trup për ta mbushur me dridhërima të akullta, të cilat e kthjelluan dhe ai pa një varr të madh, që po bëheshin gati ta mbulonin me dhe të zi. Çuditërisht, iu bë se maje atij dheu të zi, rrinte pema e poezisë, që nuk e dinte si kishte ardhur aty dhe kush ia kishte nxjerrë nga përftimi magjik i pakmëparshëm... Deshi të lutej që mos ta varrosnin drurin e poezisë dhe ishte gati të çirrej po të mos kishte ndjerë një grusht dhe, që dikush ia futi në dorë dhe i tha se trupi i të atit ashtu pushonte më i qetë në atë botë... Ndjeu, se ai që ia dha dheun dhe i tha ta hidhte poshtë, kishte folur se ajo që i takonte tokës njëherë i ktheje asaj dhe se ky mendim i tingëlloi si një varg që tashmë jo vetëm që e kishte dëgjuar, por edhe që i bëhej madje se kush e di se kur e kishte sajuar vetë...

Ecim atij fundi që njëherësh është filli dhe , sosim në fillimin që është fund...

Deshi ta ndiqte atë mendim, që sa e sa herë i ishte qepur dhe përherë i ishte ndarë sikur të kishte për qëllim t'ia bënte me dije se duhej t'i nënshtrohej përsëritjes, por u përdrodh nga përfytyrimi, ku froni perandorak, pamëshirshëm ia ndrydhte strofat dhe vargjet...Tutje atij froni të zbraztë, iu bë se rrinte i ati gjysmë i mbuluar me dhe të lagësht, ndërkohë që anash, si në mjegullim, shihte Qyprillinjtë tjerë, mu ata që i kishte takuar në Dhomën e Kronikës, që rrinin me kornizat e forta përmbi dhe bënin sehir. Me nga një shpatë në dorë, ata po bëheshin gati ta ndiqnin... I lemerisur, mbylli sytë dhe pëshpëriti ta lënin të qetë...

Por, nga ai çast, të qetë nuk e lanë as të vdekurit e as të gjallët... Të parët sikur ia përkujtonin madhështinë që ishte arritur në rrethanat e fronit dhe i thoshin se do ta gjente mallkimi i pafalshëm po qe se ajo nuk mbrohej. Ndërsa, të dytët, kërkonin prej tij që të bëhej pjesë e atij mekanizmi që kishte forcuar pushtetin perandorak...Të vdekurit i thoshin: kij kujdes nga të gjallët, ndërsa të gjallët i thoshin: ruaju nga të vdekurit!...

Në atë gjendje me maktë nuk i ndihmonte më as poezia e as filozofia. Më kot kërkonte që vargjet dhe rimat ta shpinin në botën e thellë të përsiatjeve, ku rëndom gjente prehje dhe mbrohej nga tejdukshmëria e përditshmërisë...I dëshpëruar, kthente në Dhomën e Kronikës dhe i bëhej se dëgjonte bisedat e Qyprillinjve, të cilët sapo hynte aty, zbrisnin nga kornizat dhe shtroheshin në biseda të gjata... Ia fillonin qetë-qetë për t'i përfunduar me ndonjë grindjeje të madhe. Kjo zuri t'i pëlqente dhe ta ngushëllonte madje.

Dikur, në ato biseda, ndërhynte edhe i ati (edhe pse portretin ende nuk ia kishin sjellë aty, ngaqë duhej të kalonte koha e zisë së përgjithshme prej dyzet ditësh dhe të bëhej emërtimi i Kryevezirit të ri, që bazuar nga përvoja e fundit njëqindvjeçare e qeverisjes së Perandorisë,

ai patjetër se duhej të ishte nga dera e Qyprillinjeve). Dhe ai kërkonte nga të tjerët, që t'ia detyronin të birin, të ulej në fron...

“Nuk na shkon neve poezia... Qyprillinjeve u ka hije pushteti e jo pispillosja e fjalëve...U ngrit me shpatë në dorë dhe me shpatë në dorë duhet të ruajë namën e fituar... Mos lejoni të zbresim nga skena e historisë aq lehtë dhe aq pa dinjitet!... Mos lejoni që madhështia jonë të kthehet në palaçollëk!... Mos lejoni të zhbëhet ajo që u bë me aq mund dhe me aq përpjekje... Mos lejoni që të ngushtohet hapësira prej nga sundohet bota...”

Ndodhte që ato që i thoshte si urdhra dhe kërkesa të prera rreth ruajtjes së fronit dhe trashëgimisë së ktheshin në lutje, të cilat përfundonin në ngashërime prekëse.

„Aman, mos lejoni që im bir të vdesë rrugëve si i marrë... Mos lejoni të bëhet gazi i botës...”

Kështu, midis tyre fillonin grindjet e gjata, të cilat sa dukej se fashiteshin, prapë merrnin hov. Ahmet Pashai dhe Mahmut Pashai e kundërshtonin tim atë. Sami Pasha i sëmure fliste për një shpirt, që dëshironte t'i ikte dergjës së gjatë, ndërsa Fadil Pasha dhe Mustafë Pasha kërkonin me çdo kusht që fronti edhe më tutje të ruhej nga Qyprillinjë, qoftë me një edhe nga dera e dytë apo e tretë... Në vllugun e atyre rropatjeve shfaqej Mehmeti Plak, i cili mendohej t'i qetësonte me fjalët se si Qyprillinjtë kishin yllin e vet, që i kishte ngritur në fron, që i kishte përcjellë në të, e që sipas të gjitha gjasave, ai do t'i zbriste prej ti, kur t'i vinte koha kësaj dhe se e gjitha do të lidhej me njëfarë shpagimi të pashmangshëm dhe të përgjithshëm, çmimi i së cilës që më parë ishte përcaktuar pikërisht nga ylli i gjithëfuqishëm, që është pjesë e fatit ... Këtë dakik, thoshte ai, nuk mund ta ndal kush...

Më vonë, në këto biseda, zunë të ndërhyjnë edhe të tjerë, kushëri të afërm dhe të largët, që patën pasur poste të ndryshme në hierarkinë e lartë ushtarake dhe administrative të Perandorisë. Mësoi se shumë prej tyre qenë ushtarakë të rangjeve të ndryshme dhe morën pjesë në shumë betejë, ku, kush më shumë e kush më pak, i ndihmuan çështjes perandorake dhe qëllimeve të saj. Kishte ndër ta edhe titullarë të tjerë, diplomatë, myderrizë dhe nga pjesa e ulemasë... Numri i tyre vinte e shtoej sa një çast iu bë se përpara kishte një armatë të tërë, nga ata që nuk kishin nishane e deri tek ata që kishin nishane të shumtë. Ca prej tyre, pos dekoratave, gjithnjë e më shpesh tregonin këmbët e gjymtuara, duart e këputura, sytë e nxjerrë apo veshët e prerë, që kishin lënë nëpër betejat e panumërta, të zhvilluara në tri kontinentet e botës...

Një natë prej netësh ngjau një pështjellim i madh, në të cilin morën pjesë shumë e shumë nga ata të famshmit. Gjithë kjo rrëmujë u ndez kur para masës u shfaq Mustafë Pashai dhe ca nga oficerët, që kishin shumë nishane e që gjithnjë shkonin bashkë, filluan ta ngrisin zërin kundër kryevezirit, për të cilin dihej se ishte njëri ndër burrështetasit më të fuqishëm të Perandorisë gjatë njëqind viteve të fundit. Oficerët çirreshin dhe kërkonin nga Memeti Plak që Mustafë Pasha të mos u afrohej më.

„Na bëri kurban në Kaukaz, - çirreshin oficerët e lartë... Nëse nuk na deshe për se gjalli, nuk ke arsye të na afrohesh tash...”

Edhe përkundër këtij mospajtimi Mustafë Pasha, me qëndrimin gatitu (si dikur) dhe çehre mbyllur nisi të fliste rreth strategjisë dhe vlerës së saj...Tha se ishte koha që ata duhej ta kuptonin këtë...

Oficerët edhe më tutje kundërshtonin dhe s'u bëhej ta dëgjonin të fliste.

„Deri kur do të na i lodhesh me të njëjtat mesele?...“

Mustafë Pasha nuk hiqte dorë nga përpjekja t'i thoshte ato që kishte bërë gati t'i thoshte sy tjerëve, në mënyrë, që siç pandehte, njëherë e mirë të shkrihej akulli midis tij dhe një numri të oficerëve të lartë të Perandorisë. Që fjalët e tij megjithatë të gjenin veshin e të tjerëve, i ndihmoi një adjutant i lartë, i cili tha se ishte e udhës që njëherë, të vetmen herë, së paku në gjendjen që ishin prej nga gjërat nuk mund të ndryshoheshin më, pos të qartësoheshin, ta dëgjonin njëri-tjetrin...

„Ka njëqind vjet, që grindemi kështu dhe assesi të thyejmë murin e hasmërisë së panevojshme“, foli adjutanti, i cili pak nga pak ia doli t’ia heq shqetësimin masës së nevrikosur, gjë që kjo i mundësoi Kryevezirit të fliste.

„Prapë duhet t’ia nis nga strategjia, - filloi të fliste Mustafë Pasha.- „Ishte pikërisht strategjia që në atë betejë më detyroi të urdhëroja që njësia e trembëdhjetë sulmuese të nisej nga ana e djathtë për të zënë pusinë e domosdoshme në mënyrë që armiku të futej në kurth, prej nga forca e tyre kryesore do të zhvendosej deri tek pika më e përshtatshme, ku mund të shkatërrohej me lehtë. Dhe pikërisht njësia e trembëdhjetë, si më luftarakja, si më e guximshmja, pra si njësia më e përgatitur elite e Perandorisë, duhej të merrte përsipër pusinë, që beteja të ishte shumë e përgjakshme, aq e përgjakshme sa armiku të mos kishte as më të voglin dyshim se e gjithë kjo ishte vetëm një kurban yni i vetëdijshëm, që bëhej për ta venë në grackë forcën kryesore të tij... Për këtë grackë duheshin trimat, ndër më të dalluarit e armatës sonë, pra ata që vdekjen përherë e shohin në sy pa iu trembur fare. Trimëria, pra që kobi juaj... Më vjen keq që u desh të vriteshit ashtu deri në një, por mos harroni se vdekja juaj na solli fitoren, njërën ndër më të rëndësishmet e Perandorisë... A nuk është kjo për t’u krenuar në vend se të ankoheni?... A nuk u dekoruat që të gjithë me urdhrin më të lartë perandorak, që është ëndërr e çdo ushtaraku?... A ka libër historie ku tashmë nuk gjenden emrat tuaj?... Si luftëtarë të paepur, edhe ashtu do të vdisnit, sepse i takonit luftës ku vdekja është pjesë e saj... Unë bëra që vdekja juaj të jetë e madhërishtme, një vdekje që do të mbahet mend përderisa të jetë Perandoria... Pra, vdekja juaj nuk ishte si çdo vdekje tjetër, që do të mund të vinte në ndonjë shkuerinë të harruar, por një vdekje e pavdekshme...”

„Na bëre kurban jo pse ajo vdekje përcaktonte fatet e luftës, por pse i duhej luftës së brendshme për pushtet... Këtë e dimë fare mirë...” - kundërshtuan oficerët.

„E dija se do t’i thoni këto... Është koha të kuptoni se vdekja juaj ishte vdekje e madhe, që nuk mund të përsëritet më edhe po ta donit këtë...”

„Nuk ishte ashtu!“, zunë të çirren oficerët.- „Nuk ishte ashtu!... Në pusi na vunë gjeneralët e tu me Maliq Pashën në krye, ngaqë ata kishin frikë prej nesh se një ditë do t’ua merrnim anën...Ata dridheshin nga nami ynë...Kishin frikë nga qëndrimi dhe fuqia jonë...Ata qëllimisht na bënë kurban dhe ti pranove kurthin e tyre, së cilës që moti kishim filluar t’ia hetonim fitilin...”

„Nuk ishte dredhi kjo, por strategji... Rrufeja nuk vret hithrat por lisat...”,- tha Pashai.

„Mjaft!Mjaft! këtë deshi Maliq Pasha, që na vrau me urdhrin tënd...”

Kryeveziri nuk foli më. Pas tij fjalën e mori adjutanti i ri, i cili zuri të thoshte edhe diçka rreth asaj beteje duke e përshkruar atë me aso emocione sikur të ishte ajo njëra më të rëndësishmet e të gjitha luftërave që ishin bërë deri më atëherë... Duket se kjo i hidhëroi edhe më tepër oficerët, të cilët iu sulën me fjalët më të rënda sa e gjitha u kthye në një rrëmuje të madhe, e cila kush e di se çfarë përmasa do të merrte po të mos ishte ndërhyrja e Mehmetit Plak.

„Deri kur do të grindeni rreth atyre që nuk ndreqen?...“

Fjalët e kryeplakut të Qyprillinjve askush nuk i bëri dysh. U shpërndanë me të shpejtë dhe mu aty ku pak më parë ngjau pështjellimi, Nimani pa një plak të thinjur, me një mjekër të gjatë, që i shkonte deri ndaj belit. Ishte i ngarkuar me ca libra të trasha, që i mbante të lidhura me një litar gjithë nyje.

„Më thonë Selajdin Kronisti,- tha plaku i mbushur frymë.- Ka kohë që në shpinë bart historinë tuaj të paplotësuar, e cila ende gjithnjë përvidhet nëpër libra të harruar, nëpër pergamene të shkatërruara si dhe dokumente, që u ka rënë pluhuri i harresës...”

Plaku heshti për pak. Kishte vështirësi me frymëmarrjen, e cila herë pas herë i zihej dhe ai dukej se ngulfatej i tëri...

„Megjithatë, Seljadini nuk jepet“, tha.- „Ia dhashë fjalën Ahmet Pashës së ndritur se në këtë botë dhe në atë botë do të merrem me ju, që ishit forca më e madhe e Perandorisë...”

Më pas, gjithë mundim, Plaku u ngrit. Lidhi barrën dhe kur po nisej, tha:

„Një ditë do të takohemi... Kemi shumë për t'í thënë njëri-tjetrit...”

Nimani deshi ta pyeste Plakun diçka për librat që mbante në shpinë, por aty ku pak më parë rrinte ai, u shfaq një mjegull e lehtë, e cila sakaq kaloi në një re që treti dika. I mahnitur, por edhe i dëshpëruar, gjithnjë me ndjenjën e atij që i është ngatërruar e jetshmja me të pa jetshmen, e dukshmja me të padukshmen, fryma me hiçin, një kohë të gjatë kërkoi renë. Në atë kundrim të jashtëzakonshëm, iu bë se i ati po ia përsëriste ato që ia tha çastin që po vdiste rreth amanetit...

Amanetin sesi ia përkujtuan edhe kur për herë të parë shkeli në Sarajin e praruar. Ishte ajo një ditë e bukur pranverore e mbushur me diell të shndritshëm dhe me kundërmim jorgovanash... I përballuar me lojën e mahnitshme të dritës në atë hapësirë si dhe thyhej e saj që shpërndareshin harmonishëm në çdo pjesë, Nimani ndjeu se po i afrohej një shfrimi poetik, ku bota e vargjeve dhe e rimave joshej gjithanshëm nga të gjitha anët... Ishte në rrugë që i tëri t'í jepej asaj gjendjeje dhe atë ta përjetonte në mënyrë tejet të veçantë, por një si sfidim që po mundahej t'ia rrëronte atë ndjenjë dhe ta kthente tek ashpërsia e njëmendësisë po i vinte nga dika me pandehmën se ishte një mrekulli që perandoria, e cila ndodhet para fitoreve të reja, në krye të saj do ta ketë një poet e mendimtar... Kjo jehonë, që ishte i bindur se tashmë po e mbërthente nga të gjitha anët, e nxori nga ajo gjendje dhe e ballafaqoi me përmasat fizike të fronit të lartë, që i rrinte përpara për t'ia bërë me dije se aty duhej t'í përfundonte trupi dhe mendja. Madje iu bë se nga lartësia e fronit po dëgjonte t'í thuhej:

„Tash e tutje, në këtë maje, do të pajtohen pushteti dhe arti, veprimi dhe mendimi... A nuk është kjo një mrekulli?...“

I lemerisur si kurrë më parë, hetoi se ishte kthyer në një qenie fare të zbrazur, e bartur ashtu në një hapësirë jashtë kohe, ku megjithatë, herë pas herë një zë i shtjerrë sikur i fliste për gjërat e papajtueshme – për gjuhën e përbashkët të pushtetit dhe të krijimtarisë... Shkallmimi iu bë edhe më përmbysës kur hetoi t'í thuhej diçka rreth asaj si Xhylysymja e bukur, nuk e donte të trishtuar, por të hareshëm, siç i ka hije atij që mban fronin më të lartë të Perandorisë, ku për herë të parë bashkoheshin forca, zemra dhe mendja... Ky është një mashtrim i pashembullt, deshi të thoshte dhe mbase ishte gati ta bënte këtë me sa zë kishte, pa marrë parasysh se a do ta përfillte kush, por në atë gjendje që ishte, hetoi se nuk kishte zë e as fuqi për me nxjerrë as më të voglën fjalë me të cilën do të ngjyrorej kundërshtimi. Kjo, megjithatë, nuk e pengoi që t'í shohë degët e jorgovanave, sa ishin, tek thyheshin dhe shkeleshin pamëshirshëm dhe me këtë i nënshtroheshin një shkatërrimi të pashembullt... Dikur iu bë se si përfytyrimet e trishta po e lenin, por në vend se të kthjellohej për t'iu ballafaquar me ato që e ngacmonin, ishte i bindur se po sharronte në një akullnajë të pafund, ku tashmë kishte bindjen se do t'í ngriheshin fjalët bashkë me mendimet dhe gjithë ato që kishte krijuar... Kjo ndjenjë trishtuese e hodhi para një derdhjeje tjetër shpirtërore, sa të mendonte se e gjitha ishte pjesë e atij mallkimi që e ndjekë njeriun e shkretë, pa marrë parasysh se në ç'shallë qëndron, kah sillet dhe si vepron...

Nga ajo përpëlitje iu bë se doli i ndarë dysh: me pjesën që përfshinte njëzet e tre vjetët e shkuara dhe në atë prej dyzet ditësh, që i shfaqej si e kushtëzuar, e cila në të vërtetë nuk ishte tjetër pos njëfarë meskohë, që edhe mund të vazhdonte, por pa ato njëzet e tri vjetët e shkuara, të cilat duhej të mbeteshin kohë-harresë, për t'ia lëshuar vendin pastaj një tjetre, ku qenia e tij duhej të përcaktohej nga ato që mund të hynin dhe të dilnin lirisht në hapësirën e tij të zbrazët, për të lënë çfarë të donë në të... Kjo ndjenjë i solli të dridhura nga të cilat sesi iu kujtua Dhoma e Kronikës bashkë me shikimet e ftohta të gjyshërve dhe stërgjyshërve, që tashmë i shfaqeshin si një ngarkesë e jashtëzakonshme, me të cilën lidhej mallkimi i fronit, që si urdhër po e ndiqte edhe atë për t'iu bashkuar pas dyzet ditësh... Mbase ishte pikërisht parandjenja e hershme e refuzimit të tij, që e kishte shtyrë të merrej me poezinë dhe me meditimin, me të cilat jo vetëm që do të ndrydheshin shtytjet që lidheshin me prirjen e pasjes

së fuqisë dhe ato që i takonin pushtetit, por që ashtu dhe në atë mënyrë, krijonte kushtet për t'u përjashtuar nga piramida e fronit dhe ato që lidheshin me të nga shkaku i vetëm se pushteti kërkonte veprimtarë dhe jo mendimtarë, kërkonte të dëgjueshëm dhe jo rebelë... I ngashënjyer sadopak nga këto përftime të çastit, i vinte mirë që më në fund, Qyprillinjtë, pas pushtetit njëqindvjeçar, do t'u ktheheshin edhe çështjeve të shpirtit dhe se akulli i Dhomës së Kronikave do të shkrihet nga ata, që në të ardhmen do të futeshin në të për të dëshmuar se krahas atyre që i takonin njëtrajtshmërisë së pushtetit, të cilin e kishin ngritur me aq mund dhe përkushtim, kishte edhe poetë, filozofë dhe krijues të tjerë të panumërt, që e plotësonin harmoninë e tij... Ngazëllimi i çastit madje sikur ia sëmbeonte pyetjen e frikshme se çfarë do të ngjiste po qe se familja e tij, në vend se të humbte gjithë atë energji pas pushtetit, të merrej me poezi dhe meditim?... Njëpër pahintikë i shfaqeshin libra të panumërta dhe vargje të nduardurta, të cilat preknin zemrën, shpirtin dhe mendjen e të gjithëve... Shihte pastaj piktura me ngjyra mahnitëse, ndjente tinguj magjeps muzike dhe përfytyronte pallate të mrekullueshme, që do të shtriheshin nga të gjitha anët... Megjithëqë realiteti shfaqej tjetër, e që nuk mund të zhbëhej, se si iu qas dilema se ç'kah do të kishte jeta e tij po të mos ishte Qyprillinjas?... Aty për aty iu shfaq një hapësirë e rrudhur, ku megjithatë mund të bridhte dhe të bridhte pandalshëm si i shkretë, pa ngjyrë, një zero, një hiq... Kjo i solli të dridhura, veçmas gjendja e hiqit, veçmas kur iu bë se edhe në atë hapësirë dhe në atë gjendje, dikush po këpuste luleshqerrat, prej nga ato shtriheshin të vyshkura e të ndrydhura pamëshirshëm, që i përkonin me fatin e vargjeve dhe meditimeve me të cilat i ishte lidhur qenia... Ai trishtim e ktheu tek gjendja e pakmëparshme dhe vorbulla i rastisjeve, ndër të cilat iu pikas ajo se çfarë do të ngjiste po qe se i ati të jetonte gjatë, shumë gjatë, apo të mos vdiste fare, të cilat nuk paraqisnin tjetër pos një ngushëllim me të cilin ushqehen të pashpresit... Gjithçka po i afrohet hiqit, pëshpëriti dhe desh i ta harronte kohën që kishte lënë pas, nga shkaku se lidhja më të si dhe pamundësia që t'i mbetej besnike, e bënte fare të paqenë, si një qenie së cilës i është marrë e nesërmja, por edhe për më tepër e djeshmja, pa të cilën nuk kishte kuptim as e sotmja dhe asgjë tjetër... Dhe ashtu fare i përdalë, zuri të mendonte për kohën si kuptim dhe për kahen e saj, herë si të shtrirë deri në pafundësi, e herë si të kthyeshme e të përsëritshme... Sado që do ta dëshironte të parën, pra shtrirjen drejtëvizore, ku çdo gjë bartet kah thellësia dhe plotësimi i përhershëm dhe i pandalshëm, gjë që në tërësi përkonte me të kuptuarit e lëvizjes si çështje e pasosshme, mendja ia tha se koha e përsëritshme, herdo-kur do t'i mundësonte kthimin tek vetvetja dhe qenia me të cilën ishte përmbushur njëzet e tre viteshi, prej të cilit duhej të ndahej përgjithmonë... Por, mendja ia tha se përcaktimi për kohën si vlerë që përsëritet, në të vërtetë do të mund ta kthente tek ndarja me vetveten, që nis si tiktak i një lavjerrësi, i cili kishte për qëllim që të shënonte atë shkëputjen e domosdoshme nga koha e dyzet e tre viteshit, për tek koha e urdhrave, që nuk ishte tjetër pos kohë e huaj... Për herë të parë ndjeu dëshirë që lavjerrësi i orës të ndalej dhe ai të mbetej në hapësirën e ngrirë dhe të shurdhër, prej nga do të harrohej... Një çast madje kishte bindjen se lavjerrësi ishte ndalur dhe ai kishte sharruar në atë zbrazëtinë, që nuk ishte tjetër pos ngecje dhe vetëm ngecje... Në të vërtetë, mendja ia tha se e gjitha ishte një mashtrim, sepse lavjerrësi ecte dhe se në atë rrjedhë e kishte më se të qartë se edhe ai po ecte, por se ajo ecte po e shpinte në një drejtim tjetër, mbase anës së kundërt, kah një tjetërsim i pandalshëm, ku ai përfundonte të ishte ai që dëshironte, për t'ia lënë vendin një tjetri, që nuk ishte... Ajo bindje e mbushi me një zbrazëti sa ndjeu se ishte vetëm hija e asaj që tashmë nuk i takonte, që e kishte lënë përgjithmonë me mundimin e përfuturit të së pakthyeshmes...

Kur doli nga Saraji i praruar, pa se dita ishte në të sosur dhe këtë e mori vesh prej hijes së vet, e cila po i rritej e po i rritej përpara sikur të ndiqte fundin e padukshëm, që ndodhej brenda një përmbytjeje të errët, të cilën e kishte fare pranë. Zvarritja pas hijes megjithatë e solli para shkallores, ku hetoi derën e Dhomës së Kronikës, që rrinte e hapur, e ku hyri qetas me bindjen se mbase mund të ishte pikërisht ajo shtytja e lavjerrësit të kohës që e kishte

bartur deri tek pika, ku tashmë ishte më se i bindur se ndodhej fundi i fillimit dhe fillimi i fundit, prej nga ai duhej të kuptonte se nuk kishte lëvizur fare, pos që me përsiatjet e tij kishte prekur çështjen e të kuptuarit të lëvizjes, përmasat e së cilës i ishin mbyllur pa e ndjerë fare dridhërimën e saj... Mendja ia tha se e gjithë ajo, megjithatë, kishte sfiduar shqetësimin e brendshëm, të hetuar gjatë ballafaqimit me familjen e vet në hapësirën e ftohtë të Dhomës së Kronikës dhe se ishte pikërisht ajo dridhje e padukshme që e kishte kthyer aty, prej nga tashmë kishte filluar një shqyrtim, me të cilin gjërat mund të zhvisheshin nga mbërthimi i paprekshmërisë... Një çast, madje, iu bë se ishte aty pikërisht për të vendosur lidhjen midis shkëputjeve, që e sotmja të mos dukej si e djeshme dhe e nesërmja të mos ishte vetëm e djeshme, por si njëfarë ndërlidhjeje midis të sotmes në të nesërmen e djeshme, ku përsëritja nuk do të paraqiste vetëm njëtrajtshmëri, por edhe lëvizje kuptimore... Në atë vërtitje mendore megjithatë gjithçka iu duk sikur i ngjasonte pajtimit midis pjesëve të kundërta, që nuk ishin të mundshme nga shkakut e vetëm se ashtu ato tmerrësisht përjashtonin njëra tjetrën... Jo, jo, oshtiu...Jo... Jo... Edhe dyzet vjet, edhe dyqind vjet, apo mijëra vjet nuk mjaftojnë të lidhen të kundërtat... Pushteti është dhunë, shfreu dhe shtoi se i tillë do të mbetet përherë... Këtë mendim e kishte pasur gjithmonë dhe me kot ishte munduar Hajredini plak, njëri prej këshilltarëve më të mirë të pallatit, t'i a mbushte mendjen se ato që ai thoshte për pushtetin nuk ishin tjetër pos një ikje nga vetvetja dhe nga përgjegjësia që e priste pikërisht pse ishte Qyprillinjë... Plaku i kishte thënë se mendimet e të pakënaqurve ishin të dobishme, por që ato duhej të gjenin vendin dhe jo të mbeteshin të shkapërderdhura nëpër hapësirë... Pushteti, ia përkujtonte këshilltari pareshtur, duhet ndihmuar të mos marrë nën udhë dhe këtë duhet ta bëjnë të dijshtmit dhe ata që mendojnë me kokën e vet... Gjuha e përbashkët midis pushtetarëve dhe mendimtarëve paraqet gjënë më të rëndësishme, me të cilën pengohet që pushteti të mbrohet nga varësit dhe varësit të mbrohen nga pushteti... Plaku pastaj i thoshte: pushtetin mund të mos e duash, por mos pandeh se ai është i panevojshëm apo i tepërt. Ai është si demi i egër, që duhet të zbutet për aq sa është e mundur, sepse kur e shikon me ftohtësi ai egërsohet...

Sa herë që plaku i fliste kështu, i kthej poezisë dhe mendimit,që i ndihmonin për të krijuar një si mburojë të brendshme kundër brirëve të demit të egërsuar. Kështu, kishte thurur një mori vargjesh, në të cilat figurativisht tërhiqej paralelja midis bririt dhe fjalës... Bota mbi brirët e demit... Bota në brirë?... Demi dhe bota... Ç'metaforë e bukur?... Ç'lahtari e madhërishtme, mendonte?... Bota dhe brirët?... Pastaj demi i egërsuar, që e mban botën në brirë?...Si do të përfundojë e gjitha?... Cila duhet të jetë ajo mburojë që do ta shpëtojë botën nga brirët e demit të tërbuar?... Në pamundësi ta njëmendësonte mburojën që do ta shpëtonte botën nga brirët e demit të egërsuar dhe pa qenë në gjendje që atë ta kthente në një shpresë, ai krijonte një mur të madh përreth që kthehej në një hapësirë të mbyllur, ku jo vetëm që nuk shihte brirët e demit të tërbuar, por për më tepër, zbulonte fuqinë e vetmisë dhe të mbylljes, që i shfaqej e domosdoshme, dhe se, atë gjendje, nga jashtë, gjithnjë e më shumë ia shprehnin fjalët por edhe qëndrimi, që një ditë bërë që i ati, ta thërriste dhe të kërkonte sa më parë të dilte prej fortesës së çuditshme. Është koha të shohësh jashtë, i tha dhe i premtoi se do t'i ndihmonte, siç tha, të kthehej nga ardhmëria e ndritshme... Në fillim solli mjekë, e më vonë gjithfarë këshilltarësh, ku nuk munguan edhe magjistarët dhe shpjeguesit e ndryshëm të shenjave, të cilët e cyesnin për muhabete të gjata, gjithnjë duke e dëgjuar me vëmendje dhe pa dhënë kurrfarë shkasësh të mendohej se ata vinin me qëllime të caktuara për ta kthyer nga rruga që ndiqte... Kur i kaloi të shtatëmbëdhjetat, moria e përcjellësve të dukshëm dhe të padukshëm, sikur e lanë paksa të qetë dhe vendin e tyre serish e zuri Hajredini plak, me të cilin krijoi njëfarë ndërlidhjeje që i afrohej dashurisë prindore. Ndonëse i fliste për ato që lidheshin me pushtetin dhe rëndësinë e tij, që ishte i pashmangshëm për çdo shoqëri, jo rrallë ndjente dëshirë ta kishte pranë që t'ia thoshte vargjet që i thurte, dhe ato që i vilte nga vjershëtarët tjerë, me të cilët shoqërohej err e terr... Poezia është e madhërishtme, i thoshte plakut, kur zhytej në morinë e vargjeve... Pa to do të ndjehesha i varfë dhe i paqenë... Pa

vargjet çdo gjë duket e zbrazët dhe e pakuptimtë... Plaku e dëgjonte me vëmendje dhe jo rrallë ia përmirësonte theksin. I thoshte se për të duhej të tregonte më shumë kujdes. Ai ia pranonte telashet me theksin, por vërejtjet që i bëheshin, përkonin me kallepët, që ia përkujtonin veset e pushtetit dhe të pushtetmbajtësve... Theksi ka të bëjë me përkufizimin e lirisë së shprehjes, shtonte, ndërsa që plaku ia kthente se nuk ishte fjala për kurrfarë prirjeje pushtetmbajtëse, por për çështje që çojnë kah rregullsia, që është e domosdoshme për secilin krijues... Për ta bindur plaku i pat zënë n'gojë punën e rimave, të cilat, kur shihen nga këndvështrimi formal, nuk paraqesin tjetër pos përkufizimeve të qëllimshme, që i hynë në punë rregullsisë së domosdoshme. Çfarë anarkie do të mbretëronte në poezi, po që se rimat nuk do të ishin, apo sikur ato të vihen aty ku nuk e kanë vendin?... Mund të ketë vallë poezi të mirë pa rima?... Dhe, nëse pareshtur thuhet se poezisë së mirë i duhen rimat, mos do të thotë kjo prirje kah rregullsia e pushtetshme, e cila më së miri shfaqet në krijimtari?... E dëgjonte me vëmendje dhe i thoshte se rimat përnjëmend duken si mbërthime të domosdoshme, e ndonjëherë edhe të dhunshme, që vihen në shërbim të një tingëllimi të bukur dhe të natyrshëm, por pikërisht pse janë të tilla, ato shprehin të kundërtën, pra atë harmoninë që i takon lirisë... Bisedat e tilla rëndom përfundonin me çështjen e demit dhe zbutjen e tij. Plaku përherë thoshte: demin zbutë, bëjë për vete, nëse dëshiron që bota të mos përfundojë në brirët e tij të ashpër...

Refreni i plakut me kërkesën që bota të mos përfundonte në brirët e demit të egër, pakngapak sikur po e kthente tek çështja e përgjegjësisë, që si krijues kishte ndaj saj. Kishte, vallë, mundësi që me anën e vargjeve dhe rimave kjo të arrihej, apo e gjitha duhej të vihej në shërbim të asaj që quhet pushtetim, që pastaj pashmangshëm kthente tek pajtimi i mendimit me veprimin, të cilën ai nuk mund ta përfytyronte dot. Nga e gjithë ajo lëkundje, plaku sikur kishte hetuar njëfarë mëdyshjeje, që e kishte quajtur njerëzore dhe hallkë të domosdoshme kah një kapërcim tepër i rëndësishëm drejt përrputhjeve të shpërrputhjeve... Ne kemi të njëjtin mendim dhe synojmë të njëjtën, i kishte thënë ai, sado që rrugët tona shkojnë kaheve të ndryshme...

Këto ishin fjalët e fundit të plakut, që i kishte nxjerrë nga thellësia sikur të kishin qenë të ndryera kush e di se kur. Nuk shkoi shumë dhe mori vesh se kishte vdekur me një libër në dorë, që më vonë kishte kuptuar se ai ishte libri gjysmë i ndaluar i Lutfi Pashës, me mendimet e të cilit u mor një kohë të gjatë nga shkaku se ishte i vetmi burrë shteti, ku hetohej thellësia e mendimit dhe prirja për krijimtari. Rreth mendimeve të Lutfi Pashës plaku i kishte folur shumë herë, gjithnjë duke theksuar se froni i lartë nuk mund të bëhet pengesë për t'u bërë mendimtar dhe poet i mirë... Edhe pse e nderonte Lutfi Pashain dhe gjithnjë e më shumë gjente prehje tek mendimet e tij, shëmbëllesa e tij, që plaku e zinte n'gojë aq shumë, megjithatë, sikur ia përkujtonte fatkeqësinë e pashmangshme të atyre që kërkojnë t'i pajtojnë të papajtueshmet... Lutfi Pashai mbeti as andej e as këndeje, i thoshte plakut... Pushteti e shkatërroi atë dhe veprën e tij deri aty sa ai të ndjejë njësoj mallkimin e krijimtarisë dhe të pushtetit, ngaqë u mbeti hak të dyjave... Eseja e tij rreth „moralit të dyfishtë“ dhe meditimet për amshueshmërinë a nuk shpjegojnë fatkeqësinë e atij që duhet të ketë një mendim si të fshehur për veten dhe një tjetër për opinionin, që thellësisht kundërshtohen, por që kjo nuk duhet të gjejë shprehjen e hapur jo vetëm nga shkaku i paragjykimeve, por i rrezikut nga shpërrputhjet që ndodhen midis njeriut moral dhe tjetrit?... Lutfi Pashai kërkonte një shoqëri të hapur, që di të mendojë dhe di të gjykojë, që di të kritikojë dhe të kundërshtojë, por ai e pa se kjo ishte e pamundur në ato rrethana kur kërkohet vetëm sjellja brenda rrethit të urdhrave që vinë nga lartë dhe asgjë tjetër... Në pamundësi që gjërat të ndryshoheshin nga poshtë, pra prej nga fillonte pushteti i njëmendët i njeriut të lirë dhe gjykimi i tij dhe i bindur se kjo prirje që ishte e drejtë pikërisht do ta shtonte trysinë e së kundërtës ndaj saj, Pashai nisi të përfytyronte pushtetin ideal, që vjen nga lartë, që nuk ishte tjetër pos një alternativë dhunës që ushtrohej në emër të tij nga ata që atë e merrnin si çështje të një posedimi të pakufishëm dhe jo të qeverisjes, që nënkuptonte ai në përputhje me vullnetin e përgjithshëm... Për ta

përligjur këtë të drejtë, Pashait iu desh të merrej me perfiditetin e të menduarit, që për kohën, nga pushtetmbajtësit u shfrytëzuan fare njëanshëm, për atë sa qasja e thellë filozofike u shpërqendrua vetëm tek prirja e përkufizimit të pushtetit si dhunti e jo si shqyrtim i ndërsjellë... Por, plakut nuk pranonte se Lutfi Pasha kishte mbetur në gjysmë të rrugës... Me qëndrimin e tij prej mendimtari, thoshte, se ai bëri lëvizjet e para drejt përligjjes së rishqyrtimeve kritike si pjesë e baraspeshës së domosdoshme shoqërore... Pa këto mësimë, shtonte plakut, edhe si gjysmë të ndaluara, shumëçka do të ishte ndryshe... Njëherë madje i tha se Lutfi Pashai ishte pararendës i tij dhe e vetmja mënyrë që demit t'i zbutën brirët ishte vazhdimi i rrugës së tij... Kështu, më çon kah humbja dhe nënçmimi i pashmangshëm, i kishte thënë plakut, ndërsa ai ia kishte kthyer se rrugë tjetër nuk kishte pos asaj me leqe, që duhej kaluar me kujdes të madh dhe me përkushtimin e atij që ecën në tel...

Me vdekjen e plakut iu bë se humbi lidhjen e vetme dhe të fundit që kishte me botën që e rrethonte dhe, sa më shumë që kalonte koha, ndjente se afërsia e tyre kishte qenë e madhe, shumë më e madhe seç mendonte dhe shumë më e thellë seç e kujtonte, një hallkë që padiktueshëm lidhte të pakënaqurit. Në të vërtetë ajo kishte kaluar në një lidhjeje të brendshme që trashej nga hapja e shtigjeve të padukshme, me anën e të cilave gjithnjë e më shumë qartësoheshin ato afërsi nga shqyrtimet e gjata qofshin edhe aso që u takonin rastisjeve... Kur u gjend i vetmuar te pragu i Dhomës së Kronikës, ndjeu nevojë të ethshme ta kishte pranë plakun, sado që e dinte se ai do t'i thoshte diçka nga ato, ku refreni për demin me brirët e mprehtë që duhej zbutur, do të ishte i pashmangshëm... Sidoqoftë, në atë gjendjeje do të parapëlqente çfarëdo që do t'i thuhej prej tij dhe këtë do ta merrte si ndihmesë. Përballë asaj thyerjeje se si iu bë se po dëgjonte zërin e plakut dhe se ai zë nuk po i vinte nga jashtë, po si shkëputje nga brendia, një si dridhërimë shpërthyes fare e papërmbajtshme, përzierje mes unit dhe një tjetri që e kundërshtonte... Kjo i solli ankth bashkë me të menduarit se mbase ndodhej përballë gjendjes së shembjes së asaj që e merrte për të pa rrënueshme... Zëri, që herë i dukej si i plakut, e herë si i veti, e herë i huaj fare, ia krijonte ndjenjën e një përzierje dhe shtresimi që tashmë nuk e mbikëqyrte dot... O zot, fshau, ç'është kjo shturje?... Filloi kështu, vallë, koha e shkëputjes nga vetja, koha e zbrazjes?... Në atë hakërrim iu bë se zëri tjetër, që nuk e dinte në ishte i plakut apo i dikujt tjetër, me shkëputma, po i vinte si një thekamë, që i krijonin marramendje... Po zbrazëm, tha dëshpërueshëm... Po futem në kohën e pakohë... Medet!

Fjalët *kohë pa kohë* i kishin mbetur të ngjizura për gjuhe dhe po i silleshin shkërmoqshëm dhe se nga ajo përsëritje e rrudhshme dhe fare e ngatërrueshme dikur hetoi një gjësim mllëfi të paqartë, që megjithatë, dikur e gjitha iu kthye në një çirreje të thekshme, ku i bëhej se ashtu ndodhej para ballafaqimit me një ploje të madhe gjaku, me plot koka të prera, që sikur tok e ndiqnin me lutjen që disi t'u ndihmonte... Nga ajo zallahi e shpëtoi një si errësirë e thellë, ku iu bë se u fut ashtu i lemerisur prej nga pastaj fitoi bindjen se ishte bërë i paqenë dhe se pikërisht pa qenësia e kishte bartur në një hapësirë të vdekshme...

Kur u zgjua pa se gjendej në Dhomën e Kronikës fare i rraskapitur dhe i dëshpëruar me bindjen se prapë do t'i nënshtrohej sfiliteve të pa dinjitetshme, ku pareshtur duhej të vdiste dhe të ringjallej për t'u ballafaquar me nënçmime të pafundme... I shkallmuar dhe me dëshirën që serish të kthehej aty ku do të merrte fund e gjitha, dhe, kur mendja ia thoshte se po i jepej asaj gjendjeje, ndjeu një zë që po i thoshte se „kot e kërkonte fundin...”

Në fillim nuk deshi t'ua vente veshin atyre që i dëgjo, sado që ato po i përsëriteshin dhe po i përsëriteshin dhe, pak nga pak, po i ktheheshin në një si shtytje, që e hetonte si një tronditje, e cila një pas një po e tërhiqte kah fillimi, ku valëvitja trullosëse po i hapte një si perde, nëpër të cilën si nëpër mjegull po i përvijoheshin gjyshërit dhe stërgjyshërit, që po e rrethonin sikur kërkonin ta kthenin midis tyre, në një si akullnajë, e cila nuk kishte fund... Me ndjenjën e një mërdhimi të jashtëzakonshëm i shikoi një copë herë sikur ashtu të dëshironte t'i shkëpuste nga ajo gjendje dhe ndodhi që nga ajo pikasje ata vetëm sa përfunduan brenda

kornizave, që u rrinin në mur. Si i dalë jashtë vetes shikoi portretet dhe u bind se ato megjithatë qëmtonin të heshtura si mumie të ftohta, në mesin e të cilave, në pjesën e skajshme, çuditërisht dalloi edhe shikimin e të et. Lente përshtypjen se përherë kishte qenë aty me ata që ishin të njëjtë, të përsëritshëm e madje si qenie të shkapërderdhura pafundësisht për të shumëzuar vetveten... Mos vallë jam i tillë, tha dhe ky mendim sikur pa dashas e nxori nga gjendja e plogështisë në të cilën dëshironte të mbetej përgjithmonë dhe ishte pikërisht zëri me fjalët se „të gjitha rrugët sjellin këtu...“, që i futi një tjetër trandjeje të madhe. Në përpëlitjen që disi të harrohej para se t’i nënshtrohej një dëshpërimi tjetër shkallmues, megjithatë ndjeu sikur dikush po i thoshte se „kot e kërkonte harrimin...“, që iu duk se kishte për qëllim t’ia bënte me dije përsëritjen e së njëjtës, e cila e kthente tek ata, që tashmë ishin futur në kornizat e portreteve të kornizës dhe rrinin ashtu bashkë të gjykuar për të vuajtur dënimin e amshueshëm të dëgjueshmërisë... Kjo të mos ndodh, nisi të fliste gjithë mundim. Vetëm kjo të mos ndodh. Por, sa më shumë që thoshte ato fjalë, i bëhej se diçka e pashpjegueshme po e tërhiqte kah një kjasinë, e mbushur me myshqe, që sharronin diku në një turbullim të çuditshëm, ku edhe ai duhej të bëhej pjesë e asaj kalburine dhe se në rrugë e sipër iu duk se po e shoqëronin disa vargje, që mendja ia thoshte se ishin të poetit Jahja Dukagjin Zade, që megjithatë nuk i kujtohej se kur dhe si i kishte takuar ato.

*„Ndiqe dritën e qiririt,
flakën e tij shndërro në përfytyrim.
Ndiqe.
Ndiqe vetminë që nuk është vetmi...”*

Vargjet e poetit të dashur sikur e qetësuan. Sikur bënë që disi t’i ikte sharrimit në kjasinë, por që pak më vonë ato po i ngatërroheshin me disa të tjera, që ndonëse i merrte për të vetat, i dukej se nga çasti në çast humbnin ngjyrimet e ndjenjave për t’iu afruar urdhrave, kështu që refreni rreth „vetmisë që nuk ishte vetmi“, jashtë asaj “ndjekjes që kthehet në vullnet dhe në fuqi”, në atë përsëritje të papërmbajtshme, po merrte tingëllimën e „vetmisë së përbashkët“. Ç’ishte vallë ajo „vetmia e përbashkët“, pyeti, sikur të kishte të bënte me diçka të panjohur dhe fare të largët?... A nuk ishte ajo një si përzënie nga *vetmitë e veçanta*?... Këtë deshi ta thoshte me sa zë kishte dhe të çirrej madje, por zëri që po e ndjente pranë i tha:

„Të përbashkëtat krijohen nga të veçantat...”

„Këtë nuk do ta thosha“, deshi të kundërshtonte, por hetoi se mendimi, fare pa u kthyer në fjalë, thuajse dhunshëm iu tërhoq kah thellësia, ku kishte shumë paqartësi të tjera dhe hamendje të panumërta të pleksura shumëfish, ndërkohë që i bëhej se nga anash edhe më dëgjonte t’i flitej rreth *së përbashkëtës*, ku pikasej qëndrimi se *veçantia jashtë të përbashkëtës ishte e pavlefshme*, ngaqë *shkëputej prej tërësisë*... I bindur se tashmë duhej të kundërshtonte doemos, dhe këtë, në mos ndryshe, duhej ta bënte edhe me anën e artikulimit të pasthirmës së vetme „jo“, si mlllef, ndjeu se kishte sharruar në një shurdhim, prej nga hetoi se jo vetëm gjuha, por edhe mendja, po i ngrihej...

Një copë herë u mundua të thoshte „jo“-në që po ia digjte kraharorin, por nuk ia doli ta hapte atë nyjë, për t’u çliruar nga dufi i brendshëm, kështu që, fare i dëshpëruar, sikur pranoi humbjen e pashmangshme, që e kishte fat... Dhe kur ishte më se i bindur se ashtu e gjitha merrte fund dhe ai fund duhej të ishte i tillë, pa se si kornizat në mur lëviznin dhe se portretet që ishin brenda tyre po dilnin dhe po i afroheshin qetas saqë dikur i pa të ulur pranë me libra të trashë që i mbanin dhe pareshtur i shfletonin. Hetoi se fletët e atyre librave ishin të vrugëta dhe me gjithfarë shkronjash e shenjash të ndryshme, që lironin fjalë, fjali dhe mendime, të cilat dukej se herë-herë, në atë hapësirë, silleshin të pavarura dhe lironin rrëfime të shkëputura...

Pas gjithë atyre vërshëllimave të shfletimeve, megjithatë ishte Mehmeti, që e la librin mënjanë dhe nisi të fliste rreth njëfarë malli, që e kishte djegur, e që i ngjasonte një zjarri, që

thoshte se sa më shumë zgjat bëhet aq më i pa shushëm... Pas një përpëlitjet me fjalët për zjarrin, tha se mall dhe zjarr e kishte vendlindjen, që sa më larg saj përfundonte, aq më pranë i vinte, sado që përfytyrimin e saj të flashkët e ruante vetëm në saje të njëmijë dritareve, që i kishin mbetur në shikimi të shkapërderdhura dhe të hapura, çastin kur po largohej prej andej i bindur se po ndiqte thirrjen e yllit të përflakur, që pareshtur e cyste ta ndiqte rrugën e tij...

„Edhe më vonë“, vazhdoi të rrëfente Mehmeti, „kur zura të fitoja nishane dhe t’i afrohesha lartësive, njëmijë dritaret dhe shkëndijimi i tyre sikur më mbushnin me fuqi të re... Dhe pas njëzet vjet luftimesh, kur u bëra vezir, vendosa t’u kthehesha njëmijë dritareve e t’i falënderoja për ushqimin e shpirtit që ma kishin dhënë pareshtur edhe atëherë kur më bëhej se nuk do të arrija majat. Çastin kur u nisa prej nga kisha ardhur, pra asaj rruge që më kishte mbetur në mendje si një fije lëmshi që niste dhe përfundonte në njëfarë tisi mjegulle, më kaploi një dridhërimë, që mbërthen të frikësuarit nga kthimi i vonuar. Ç’ ishte vallë ajo ndjenjë, që sa më shumë që i afrohesha vendlindjes, aq më shumë më ligështonte?... Një natë se si m’u qep një ëndërr, ku qyteti i lindjes m’u shfaq e zhytur në një vegim të turbull dhe pa njëmijë dritaret. Në vend të tyre, pak nga pak po më përvijoheshin thera të zeza dhe zogj pa pupla... Gjithë ankth dhe i tmerruar pyeta shpjeguesin e ëndrrave se ç’ domethënie kishte ajo ëndërr? Ai më shikoi ftohtë, bëri disa lëvizje kah dielli dhe më tha se mund të ndodhte që rruga duhej ndërprerë... E shikova vëngër atë fytyrë të verdhë e me sy të mbufatur dhe më shkoi mendja t’ia merrja kokën pa dëgjuar të tjerat që do të m’i thoshte. Sado që puna e donte të përmbahesha, nuk pata fuqi ta ndrydhja tërbimin që më shpërtheu... Këtë rrugë kam pritur gjithë jetës, thashë! Kjo është rruga ime më e rëndësishme, që duhet ta bëj patjetër për të mos mbetur as në tokë e as në qiell... E ai, si mumie që ishte, (bile m’u bë se prej tij kishte folur një shpirt kaherë i ikur), më tha se më kuptonte, por që kishte për detyrë të ma bënte me dije se atje kishte sëmundje, një sëmundje tepër të rrezikshme...

-Ç’ sëmundje është ajo që njeriut ia kthen rrugën drejt vendlindjes?...

-Nuk është si çdo sëmundje tjetër, madhëri, tha me po të njëjtën ftohtësi.

-Çfarë na qenka pra?...

-Duket se është murtajë... Të gjitha shenjat thonë se është e tillë...

Pas një heshtjeje ai tha:

-Unë merrem me shenjat, madhëri dhe më ndje po se ato duhet t’i shpjegoj drejt...Këtë e kam për detyrë...

Tjetër nuk tha ndërkohë që unë mbeta si i ngrirë dhe u përplasa poshtë me kokën lëmsh me shungullima, që më dukej se prej tyre do të më pëlciste ajo. Kërkova të më lenin vetëm dhe gjithë atë natë nga mendja nuk m’u hoqën lulet e vyshkura, që po i shihja nëpër njëmijë dritaret e vendlindjes sime, që më vinin të mbyllura me katran. Lulet kishin gonxhe të zeza, që rrethoheshin nga ca miza të zeza, të cilat shumoheshin e shumoheshin aq shpejt sa ktheheshin në re të zeza, që pastaj mbulonin qiellin dhe gjithë botën...

Në mëngjes ma sollën lajmin se ç’prej disa ditësh murtaja kishte kapluar *Tokën e Lashtë*. Vdekja ka zënë vend atje, tha kryeroja gjithë shqetësim... Nuk mund të shkohet tujte, tha ai dhe bëri të ditur se ky ishte urdhër i Lartmadhërisë.

Atë çast preka shpatën dhe po bëhesha gati që tehun e hollë ta futja në zemër. Çfarë më duhej jeta pa njëmijë dritaret e vatanit dhe shkëlqimin e tyre që më kishte përcjellë gjithë jetës?...Mbase do ta gjykoja veten rëndë po të mos ishte një zë i brendshëm që më tha të ndalesha se kisha për të bërë edhe shumë e shumë...“Vendlindjen e vogël mund ta shpëtosh vetëm nëse ngjitesh lart e më lart në fronin perandorak... Vetëm ashtu atë e mbron dhe ia lan hakun...Vetëm ashtu!...Ndryshe ajo bëhet e paqenë, do të humbet në mjegullën e pafund...”

Ato fjalë, që po më përplaseshin, nuk e dija me tamam se prej nga më vinin: nga thellësia ime, apo nga jashtë?... Në atë përhumbje dhe i këputur fare, atyre që po më thuheshin desha t’u ankohesha për njëmijë dritare e mia që nuk ishin më, t’u thosha se në vend të tyre kishte thera me gonxhe të zeza si dhe një re e mizave, që po shumohej e po shumohej gjithandej. Por, ishte po ai zë po më thoshte se jeta ringjallet...“Ka pasur edhe më parë murtajë

atje... Mbase nuk do të jetë as e fundit?... Kjo është pjesë e të qenit...“ O zot, thashë, sëmundja vdekjeprurëse pjesë e të qenit?... Po ç’është jeta atëherë?... Koka po më ushtonte nga ato vërtitje, të cilat pak më vonë shoqëroheshin me një si urdhër, prej nga më bëhej me dije se më priste froni i lartë, që duhej ta fitoja për ta ruajtur vendlindjen nga harresa... Prapë u dëshpërova... Prej nga, vallë, kjo shtytje kaq e rreptë, që po më udhëheq pareshtur?... Nuk paska rrugë tjetër pos e asaj si luftë për pushtet?...

Këtë pyetje ia shtrova vetes shumë herë. Madje edhe kur u bëra kryevezir dhe gjendesha në maje të Perandorisë së pafund...“

Mehmeti heshti sikur të mos kishte folur fare. Heshtja shurdhe që po lëshohej sikur paralajmëronte rifillimin e fërshëllimës së shfletimit dhe përhapjen e gjysmëfjalëve dhe rrokjeve të shkëputura në atë hapësirë të ftohtë.

„Unë e di se ç’ ishte ajo që të urdhëroi...“

Nimani ndjeu një zë të qet, përkundër tjetrit që ishte i fortë dhe hove-hove i rrëmbyeshëm. Ishte Ahmet Pashai, që po i fërkonte sytë, sikur të kërkonte të shihte më mirë Mehmetin pas atyre që tha. Por, Mehmeti heshti. Priste që tjetri të fliste për të qartësuar ato që thoshte se i dinte. Dukej se edhe të tjerët pritnin fjalën e Ahmet Pashës, i cili nisi të shpjegonte sa gjatë kishte menduar për atë dyqindvjetëshin që ishte si lidhje e diçkahes, por që tha se kishte vështirësi të kuptonte se ç’ ishte në të vërtetë... Pastaj ai tha se për ta hequr mjegullimin që e bartnin, i kishte dhënë detyrë kronistit Selajdin, të gjurmonte nëpër të gjitha defterët. „I thashë t’i shfletonte të gjitha regjistrat e Perandorisë dhe i thashë të futej nëpër të gjitha bibliotekat dhe arkivat e të shkonte madje nëpër botë për të lidhur fillet e kronikës së familjes sonë. Ke për detyrë, i thashë, ta heqësh vellon e mjegullimit që na ka mbërthyer dhe po na i fsheh gjurmët tash e sa kohë...“

Pasi i tha këto Ahmet Pashai sikur u ndal për pak për t’i lënë kohë Kronistit të qartësohej brendapërbrenda rrethit të mbyllur të kryevezireve, gjë që Nimanit iu bë se tashmë ai po i formësohej nga disa libra të trasha, që dukeshin manash dhe gjithnjë e më shumë tërhiqeshin nga mesi.

„Ky i uruar, vazhdoi Ahmet Pashai,- trembëdhjetë vjet rresht, err e terr, nuk hoqi kokën nga librat, nga defterët, nga pergamenat, nga emblemat dhe nga shkrimet tjera të shpërndara në të katër anët e botës... Pas trembëdhjetë vjetësh, më tha se e kishte kryer urdhrin tim. Meqë nuk e kisha parë gjatë, m’u duk si i lodhur dhe fare i harruar. I dhashë leje të fliste dhe ai më tha se si kishte për të më thënë shumë, shumë... Aq më mirë, i thashë, këtë prita... Ai pohoi me kokë dhe vetëm pasi i thashë se isha i gatshëm t’i dëgjoja deri në fund me vëmendje ato që kishte për t’i thënë, shtoi se me urdhrin tim, i kishte marrë në shqyrtim të gjitha dokumentet e Perandorisë së re e të fuqishme, por që shumë kohë ishte sjellë edhe në ato të Perandorisë së vjetër dhe të tjerave, që nuk ishin më. „M’u desh të sillem nëpër Bizant,- shtoi,- ngase dera juaj si dhe gjithë *Toka e Lashtë*, ishte shumë kohë në përbërjen e tij dhe paraqiste një shtyllë të rëndësishme në të. Megjithatë, dyqindvjetëshi që erdhi më pas, nuk ishte tjetër pos një fashë e pakuptueshme, por edhe e mundimshme, kur nga bujarët, fisnikët dhe ushtarakët e dalluar, dalëngadalë ratë, sa një ditë mbetet ushtarakë pa nishane ose qatipë të thjeshtë...Dhe, po të mos ishte vendosmëria e Mehmet Pashë Qyprillisë, shumë shpejt do të humbnit në morinë e mijëra e mijërave qatipëve të tjerë të Perandorisë, që nuk dallohen as për të mirë e as për të keq... Të dhënat e mbledhura, ndonëse të shkëputura dhe të shkapërderdhura, tregojnë se trangu juaj u ngrit nga një rrënjë e fortë e futur thellë në brendinë e *Tokës së Lashtë*, e cila për shtatëqind vjet dha shumë bujarë, fisnikë madje edhe princa të fuqishëm, ku i pari ndër ta ishte Princ Dhimitri, ndërsa i fundit princ Gjoni. Të parin, pra Dhimitrin, e ngriti perandori i Bizantit, Justini rreth vitit 520, ndërsa i fundit, Gjoni, pas vdekjes së Kryeprincit, për trembëdhjetë vjet luftoi pareshtur në kështjellën e fundit. Kronikat e lashta tregojnë se perandori Konstantin, i cili po ashtu ishte nga *Toka e Lashtë*, të parin princ nga derë e juaj, Dhimitrin, e pati dorë të djathtë. Kur kishte nevojë, nga princi nxirrte ushtarë të përgatitur mirë, që i dërgonte nëpër betejat vendimtare. Si shpërblim për këtë Dhimitri

ruajti mëvetësinë e derës princore, megjithëqë Roma e kishte rrënuar, nga frika që kishte prej princave vendës. Te shekujt e Romës nuk shkova, pasi për këtë më duhej edhe shumë kohë që shumëçka të qartësohej. Shpresoj se një tjetër kronist apo shumë sosh, që do të kenë vullnet, shëndet dhe mbështetjen tuaj, do t'i hynë kësaj pune, që hallkat tuaja të lidhen që nga kohe më të lashta...

Pra, unë u ndala tek shtatë shekujt e fundit dhe mund të them, madhëri, se dera juaj princore, që nga Kostandini i Dytë, Justini, Justiniani, Luani, Kostandini i Katërt e deri te Komnenët, ishte e pranishme në këto zhvillime dhe, në përputhje me rrethanat, mundohej që këtë ta dëshmonte. Nga ato që nuk duken nga jashtë, por që siç lënë për të kuptuar disa dokumente, duhet theksuar se në kohën e Luanit, kishte disa ngatërresa midis perandorit dhe princ Tanushit, që do të vazhdojnë, por gjithnjë si të fshehura, shkas i të cilave do të bëhej njëfarë poeti, që i thoshin Gropan, të cilin princ Tanushi e mbante në kështjellë dhe ndaj tij sillej me respekt dhe dashamirësi të veçantë. Sa mund të shihet, pos vjershave që i shkruante, të cilat Princi i lexonte herë pas here dhe ndodhte që rreth tyre hapte edhe biseda me bujarët dhe fisnikët, Poeti kishte zënë të hartonte historinë e derës suaj në vargje, e që ato i shkruante me shkronja të tjera nga ato që lejonte Perandoria e madhe. Ai thoshte se poema duhej të shkruhej në gjuhën e vendit dhe në frymën kalorësiake... Në një sqarim, të cilit i kanë humbur disa pjesë, mund të lexohet se poeti Gropan thoshte se gjuha e shpirtit dallon nga gjuha e administratës perandorake dhe se ai synonte krijimin e një shkolle poetike, në të cilën do të mbizotëronte metrika e mirëfilltë, që do të përkonte me atë që ishte krijuar prej shekujsh, e që ai thoshte se kishte mbetur e shkapërderdhur dhe e nënçmuar sa nga moskujdesi i atyre që më shumë kishin menduar për punët e shpatës se sa të mendjes dhe sa nga përpjekjet e administratës perandorake, që gjuha e saj të jetë gjuhë e elitës shtetërore dhe e klerit dhe assesë ndryshe...

Njerëzit e Luanit, që mund të merret me mend se ishin kudo dhe ngado, madje edhe në qarqet më të besueshme të Princit për të përgjuar me vëmendje ato që nuk përputheshin me të menduarit perandorak, me të shpejtë njoftuan Kostandinopojën dhe vetë Perandorin lidhur me ato që ngjishnin aty. Mund të dëshmohet se qarkoret e fshehta nga kështjella e princit, që kishin arritur kryeqytetin dhe madje edhe veshin e Sinodit të Madh, kishin qenë gjithë shqetësim dhe me njoftime se në Principatë kishte filluar të përhapej herezia e rrezikshme, me theksimin se po mori hov, do ta rrezikonte Perandorinë më shumë se gjithçka tjetër... Ata që shkruanin gjëra të tilla gjithë shqetësim, nuk ngurrenin të kërkonin fushata të egra, që siç thoshin, bima e ligë të hiqet nga rrënja dhe menjëherë... Në një shënim tepër të ngutshëm, pos tjerash, thuhej se me përhapjen e merimangave të tyre (mendohet tek vargjet e poetit Gropan), do të fillojnë të çarat e para, që mund ta rrënojnë mësimin perandorak!... Një prift, që shtirej si palaço i futur në Kështjellë dhe dukej se mbikëqyrte edhe ato që nuk i shihte syri më përgjues, do të alarmojë se kishin nisë të shfaqen shkronjat e mallkuara dhe herezia... Më tutje ai thoshte gjithë pezëm se „me shumë-gjuhësinë që kërkohej nga Principata e skajshme, me shumë-shkrimet, që aty përdorej, me shkarravitjen, që merr hov ngado, rrënohet ngrehina perandorake dhe fryma e saj hyjnore... Shumë-gjuhësia, shumë-shkrimësia, shumë-shprehësia, shkruante ai, mund të kthehen në një sëmundje të pashërueshme... Kjo nuk duhet lejuar, çirrej ai!... Pengoni helmin e herezive të tilla!... Pengoni sa nuk bëhet vonë!“... Ai këshillonte shpalljen e fushatës së shenjtë bashkë me kryqëzatën shpëtimtare. Thoshte se nuk duhej kursyer gjë që herezia të çrrënjosej sa më parë, edhe me gjak, madje me një det gjak...

Mbas sa e sa shkrimeve gjithë shqetësim që vinin nga *Toka e Lashtë*, duket se gjërat morën aso kohe saqë vetë Perandori u nis me ngut drejt Principatës së skajshme për të parë dhe për t'u bindur rreth përmasave të herezisë, për të cilën flitej me aq shqetësim dhe frikë jo vetëm nga Sinodi i Madh por edhe nga ushtarakët. Kështu, një ditë, me vete mori ushtarakët më të zgjedhur bashkë me shumë njësi ndëshkimore dhe armatime të reja. Hapi fjalë se po nisej të bënte një luftë të shenjtë, një luftë që nuk do të ishte si çdo luftë tjetër, por që prej saj varej fati i mëtutjeshëm i Perandorisë. Kronistëve u tha se ditën dhe datën e nisjes duhej ta

shënonin si luftë të parë për mbrojtjen e shpirtit dhe të frymës perandorake në një vend që assesi të lirohej nga herezia të lidhura me Dijet e Vjetra...

Princ Tanushi, që e dinte fare mirë se nuk kishte kaçik t'i fuste brirët me perandorinë më të fortë të botës, bëri çka bëri dhe gjithë çështjen e rrudhi përbrenda një shakaje të pakripë të një të çmenduri, të cilën pastaj, armiqtë e Perandorisë dhe kundërshtarët e panumërt e shfrytëzuan si shumë për intriga. Bile, me rastin e pritjes madhështore që ia bëri Perandorit në Drilon, tha se falë asaj thashetheme, Principata e tij pati nderin të vizitohej nga Perandori më i fuqishëm i botës. "Po ta dinim se kjo do të arrihej kështu dhe aq lehtë, atëherë do të shpifnim diçka edhe më të rëndë..."

Perandori kishte buzëqeshur thartë dhe mbase mbeti i kënaqur që Princi po i fliste ashtu, sado që ishte i bindur se aty kishte edhe lajka me të cilat ai ishte mësuar, prapa të cilave fshihej edhe hilja e mendimit heretik. Gjatë festës së madhe që shtroi për Perandorin dhe përcjellësit, Princ Tanushi disa herë përsëriti se i nënshtrohej kurorës perandorake edhe për faktin se dera e tij kishte derdhur shumë gjak për ta mbrojtur Perandorinë dhe po ashtu për të satën herë shprehu gatishmërinë që në përbërje të njërive të zgjedhura të gjendeshin edhe luftëtarët e tij sa herë që ta kërkonte nevoja. „Perandoria është jona... Pa të do të ishim kurrkush... Ajo na forcon, ndërsa zgjerimi i saj na i hap horizontet“, tha Princi dhe solli shumë dokumente dhe regjistra, në të cilat shihej fare mirë si në Principatë respektoheshin njësoj që të dy shkrimet zyrtare të Perandorisë...

Bile, për të hequr çdo dyshim, e për ta shpëtuar Principatën nga egërsia e fanatikëve perandorak, që përgjonin ngado, gjatë ahengut, Princi solli vetë Gropanin dhe i tha të shpalonte disa nga palaçollëqet dhe t'i thoshte disa hoka, (natyrisht në gjuhën perandorake), që u përcollën me shqyerje gazi, saqë vetë Perandorit i shkuan lotët. „Ja, Lartmadhëri pse na duhet ky njeri bashkë me marifetet,“ - tha Princi dhe uroi që shakatë e tij të vazhdonin të keqkuptoheshin në mënyrë që Perandori serish ta vizitonte Principatën...

Duket se me këtë shfaqje zyrtarisht gjithçka mori fund mirë. Perandori i Perandorisë më të madhe të botës, ndenji disa ditë në *Tokën e Lashtë* dhe kërkoi ta vizitonte Urën e Shenjtë me ç'rast shkoi edhe deri në Pashtrik për të parë ca burime të bardha, dhe pastaj pasi mori me vete edhe ushtrinë e pafund dhe hapi fjalë se fushata e shenjtë kishte qenë e suksesshme, u kthye në Kryeqytet.

Nga disa të dhëna që tashmë janë të kapshme, megjithatë, puna e Gropanit dhe e shkrimeve të tij, edhe përkundër asaj që Princi bëri përpjekje ta paraqiste si një shaka të pakripë, kishte zgjuar shqetësim tek zyrat e posaçme perandorake, ku çështja e përdorimit të gjuhës dhe e shkronjave të vjetra kishte mbetur si një plagë e përhershme, me të cilën ishin ushqyer mosbesimet e Perandorisë ndaj *Tokës së Lashtë* dhe veprimeve të saj, që jo rrallë kishin shërbyer për fushata, që përherë ishin arsytuar me rrezikun që vinte nga herezia, e cila thuhej se në ato hapësira shfaqej si shpirt i ligë, që ringjallej herë pas here për të helmuar mësimet perandorake... Nga të dhënat shihet se Luani i tretë dhe perandorët tjerë pas tij kishin nxjerrë dekrete të rrepta, herë zyrtare e herë gjysmëzyrtare, të shumtën të maskuar me formulime, ku mallkoheshin shkronjat që shfaqeshin në *Tokën e Lashtë* dhe gjithë të tjerat që binin ndesh me gjuhën e administratës. Kisha, e cila qysh nga në kohën e perandorit Justinian, që vinte nga *Toka e Lashtë*, u bë religjion perandorak dhe mori mbi vete gjithë çështjet e shpirtit dhe përgjegjësinë për edukimin e njeriut të ri perandorak gjithandej nga shtrihej ajo, nuk prani të ndiqte gjurmët e shkrimit të Gropanit dhe atyre që thoshte ai... Jo zyrtarisht, merret vesh, se me t'u kthyer Perandori në Kostandinopojë, shumë shpejt u mblodh Sinodi i Madh dhe pas një shqyrtimi të fshehtë, mallkoi çdo përpjekje që sado tërthorazi do të mund të shpinin tek përdorimi i shkronjave tjera pos atyre perandorake... Klerikët fanatikë kishin marrë aso urdhra të prera që besimtarëve t'u bëhej me dije pesha e mëkatit me të cilën mund të ngarkoheshin pavetëdijshëm nëse edhe rastësisht fërkoheshin nga shkronjat dhe mësimet që ishin tjera nga ato kishtaret... Ortodoksia është e shenjtë dhe i vetmi mësim i zotit, thoshin klerikët e Kostandinopojës. Kush mendon ndryshe është heretik dhe i mallkuar! Mos e

ngarkoni shpirtin me mëkate të panevojshme!... Flakni shkronjat e djallit!... Mos e mjegulloni mendjen!... Kthehuni vetëm kishës dhe shenjtoreve të saj...

Me ato mendime dhe kërcënime, klerikët futeshin nëpër kulla, hynin nëpër kështjella dhe shkonin edhe në katundet e thella malore pa ngurrur që kështu të merreshin jo vetëm me punët e fesë, por t'i përziheshin drejtpërsëdrejti Princit dhe bujarëve në çështjet e brendshme, gjithnjë me avazet „e mbrojtjes nga herezia e re...”

Me të njëjtat detyra, pos klerikëve të panumërt, në Principatë erdhën edhe ekspeditat e shumta perandorake si dhe komisione të shumta, që nuk lenin dy gurë bashkë. Atëbotë, qenë bërë arrestime të shumta, nën masat e mbikëqyrjes së rrebet, qenë mbyllur shumë veta nëpër kështjella të errëta dhe qenë zhdukur shumë prej tyre pa an e nishan... Gjatë fushatës qenë djegur të gjitha librat që nuk ishin bizantine...

Krahas kësaj dhune, hetuesit e shumtë, bashkë me klerikët fanatikë, futeshin nëpër të gjitha skutat dhe kërkonin dokumente, kërkonin shkrime dhe kërkonin pergamene, kërkonin stema dhe kërkonin emblema të vjetra. Dikur nisën të kërkojnë piktura, të kërkojnë ikona dhe ç'mos tjetër... I duam, thoshin, ato që helmojnë shpirtin... I duam ato që ushqejnë herezinë...

Kështu, ato që i gjenin, i merrnin dhe i futnin nëpër arka metalike dhe me roja i dërgonin me ngut për në kryeqytet. Princ Tanushi me bujarë dhe fisnikë të nënçmuar si kurrë, gjithë helm i shikonte veprimet e hetuesve, të kryehetuesve, mbihetuesve si dhe të komisioneve, nënkomisioneve, mbikomisioneve dhe të tjerëve që hynin e dilnin lirisht në tokën e tij si t'u tekej dhe kur t'u tekej pa kërkuar leje për asgjë, me ç'rast kurdisnin gjithfarë kurthesh që në sytë e Perandorisë dhe të Sinodit të Madh, „herezia shpirtërore“ të dukej sa më bindëse dhe sa më e përhapur, si pjesë e një sëmundje kahmot e thadruar, me të cilën arsyetoheshin veprimet dhe qëndrimi i tyre në atë pjesë... Për ta marrë nëpër këmbë Princin dhe për të nxitur ndonjë rebelim, që e dëshironin aq shumë për ta përdorur pastaj ushtrinë kundër tij dhe Principatës plëngprishëse, ardhësit burgosnin si t'u tekej dhe këtë e bënë me shumë ashpërsi, ku tortura fizike përcillej me ato shpirtërorët, gjithnjë të udhëhequra nga klerikët, që ishin pjesë e aparatit të gjithëmbarshtëm të dhunës... Nënçmimet e tilla rëndom përfundonin me mbajtjen e gjyqeve të hapura nëpër sheshe dhe vende të tjera publike, që bëheshin pa u pyetur autoritet e Principatës, ndërkohë që pastaj të dënuarit dërgoheshin në pjesët e skajshme të Perandorisë, prej nga nuk ktheheshin kurrë... Ç'ishte edhe me fyese për Princin dhe bujarët vendorë, klerikët dhe i gjithë aparati i dhunës, jo rrallë duhej të shoqërohej prej tij gjatë veprimeve të tilla që e rrëqethnin dhe pastaj, pos falënderimeve, sy popullit që err e terr torturohej pamëshirshëm prej tyre, duhej t'u shtronte edhe darka dhe dreka për të ngritur dolli, ku tumireshin fjalët kundër herezisë dhe duhej të lavdërohej Perandori dhe Perandoria rreth „përkujdesjes dhe mundit që tregohej për t'u mundur e liga e madhe“...

Në ato dolli Princi pareshtur duhej të zotohej se u mbetej besnik mësimëve të shenjta perandorake dhe të theksohej gatishmëria se për to vdiste në çdo kohë me ato që kishte...

Në të vërtetë Princi i shkretë e dinte fare mirë sa i pafuqishëm ishte dhe si e merrnin nëpër këmbë, dhe e dinte se e vetmja gjë që mund të bënte ishte të luftonte sa më pak kundër vetvetes, në mënyrë që të shpëtohet ajo që mund të shpëtohej përballë atyre që thoshin klerikët e tërbuar nëpër kisha dhe çfarë kërkonin, gjithnjë duke ia mallkuar shpirtin... Të gjitha, të gjitha i dinte e megjithatë duhej të shtirej se ajo që ndodhte bëhej për të mirën e tij dhe të Principatës! Në ato rrethana sillej si hije dhe mundohej të mos u jepte kurrfarë shkasesh fanatikëve të tërbuar, që kërkonin ta derdhnin njëherë i mirë tërbimin e mbledhur mbi *Tokën e Lashtë*, që siç thuhej në një dokument të asaj kohe „të bëhej pastrimi i saj i përgjithshëm nga fara e ligë...“ Kësaj i druante Princi dhe gëlltiste helm kur duhej të ngrinte dolli për Perandorin dhe Perandorinë dhe të përshëndeste morinë e atyre që i ishin futur në Kështjellë dhe ia gërryenin themelet ngado. Por, edhe karshi atij nënçmimi dhe dhunë që ushtrohej nga të gjitha anët, Princi mendonte se nëse Principata do t'i shpëtonte ndonjë fushatë të tmerrshme (pa marrë parasysh viktimat e shumta që nuk kishin të sosur), do të ruhej bërthama e

mëvetësimi... Kur bujarët dhe fisnikët e dëshpëruar i ankoheshin, ai sa nuk u thoshte: duroni, themelet nuk vihen pa gurë të rëndë... duhet t' i mbrojmë me çdo kusht dhe gjithsesi...

Këtë e kishte të qartë edhe kleri fanatik kur kërkonte fushatë të domosdoshme, ngase ata ishin të bindur se Gropani vepronte, dhe Princi me ato që i kishte thënë rreth palaçollëqeve që bënte ai, e kishte mashtruar Perandorin, dhe se pa marrë parasysh mbikëqyrjen dhe dhunën që i ishte vu, koha punonte për *Tokën e Lashtë*. Prandaj, jo pa arsye ata i ankoheshin Sinodit të Madh se aty nuk ishte fjala vetëm për një poet, por për shumë sosh, pra për një mendim të formuar, që paraqiste herezi të ndërthurur...

Në të vërtetë, e liga për të cilën flitej dhe e preokuponte edhe Sinodin, kishte të bënte me formësimin e një vetëdije, meqë, përkundër masave ndëshkimore, poeti Gropan u kthye në një shpirt të përsëritshëm, që hasej kudo... Madje, thuhej se e gjithë ajo që ndodhi gjatë pritjes së Perandorit, kishte qenë vetëm një mashtrim finok i Princit, i cili më kohë kishte udhëzuar Poetin të ngjitej në Kullën e Hijes në Pashtrik, ndërsa ai që argëtoi Perandorin ishte një tjetër ndër të shumtë që ushtronin vjershërimin. Dhe, Gropani, pasi që kishte kaluar disa kohë në Pashtrik dhe atje ishte mbushur me frymëzime të tjera, kishte bredhur pjesëve të ndryshme të Principatës, gjithnjë i rrethuar prej poetëve të rinj, të cilëve ua mësonte zejen e poetikës së të menduarit...

Klerikët dhe hetuesit perandorakë i dinin këto dhe sa më shumë që kalonte koha, ishin të bindur se nuk po luftonin me një poet të rebeluar, që sillej nëpër skutat e kështjellave të harruara, por kishin të bënin me një frymë, e cila hapej ngado duke lënë vjersha dhe shkronja, që ata i quanin heretike dhe të mallkuara... Ngjante ndonjëherë që ndonjë vjershë e tij apo e nxënësve të tij (krejt një), t' u binte në duar dhe sapo ndodhte kjo bëheshin rituale të papara shfrenimi, kur vjersha kallej para të gjithëve, ndërkohë që klerikët silleshin si të dehur rreth zjarrit, duke lexuar psalme dhe lutje bashkë me pjesë të librave të shenjta... Orgjia e ngjizur e gjithë pezëm, dikur kthehej në një ritual të shthurur, ku shkuleshin flokët, haheshin thonjtë dhe shpoheshin qerpikët... Luftë!... Luftë!... Çirreshin ata... Të gjithë në luftën e shenjtë! Luftë!... Luftë!... Dhe kur dukej se orgjia do të fashitej me shembjen e tyre të plotë, që u pasqyrohej në fytyra e në shpirt, në saje të urrejtjes, rimernin veten për t' i prirë fushatës së ndjekjes dhe të pastrimit, që vazhdonte me ditë të tëra. Me fjalët n' gojë për mallkimin dhe herezinë, që duhej të merrte fund njëherë e përgjithmonë dhe të shoqëruar nga njësitë e ushtruara që kishin për detyrë dhunën, klerikët urdhëronin burgosjet, torturat, bastisjet që të shumtën përfundonin me gjak dhe tmerre të tjera të papara... Më vonë, ndjekja dhe fushata e pashembullt, që nuk kishte të sosur, u sanksionua me norma ligjore, administrative dhe morale... Por, përkundër përligjjes së ndjekjes dhe gjithë atyre që solli ajo, gjurmët e Gropanit, çuditërisht shfaqeshin shumë e më shumë dhe ai mbi katërqind vjet i qëndroi si fantazmë mbi kokë Perandorisë, duke e shqetësuar atë për aq sa të ndëshkoheshin edhe fëmijët...

Tevona, jam i bindur se poeti Gropan u shfaq si shpirt me emra të ndryshëm...

E sa për heshtjen dyqindvjeçare dhe atë fashën që i rri në mes, mund të thuhet se shpirti që del si i formuar, patjetër se ruhet edhe në rrethanat tejet të vështira, edhe përkundër asaj se ndonjëherë duket se ndodhet në grahmen e fundit..."

Pas një heshtjeje të shkurtër, Kronisti iu dha një mendimi përmbyllës, që Nimanit i erdh kështu:

„Isht në prag të rrënimit, por pikërisht ajo fryma shumëshekullore që e la poeti Gropan, nuk lejoi të ndodhte më e keqja. Si ngacmim e herë si sëmbim i pavetëdijshëm, ajo shfaqej për të sfiduar shqetësime dhe kryeneçësi, që shumë herë nuk kuptoheshin, por që i nënshtroheshin thirrjes së saj, e cila shpesh herë shfaqej si e panjohur dhe si mundim i papërcaktuar..."

Fjalët e fundit sikur mbetën të varura pranë një mjegullim, që përvijohet nga ana e poshtme e Dhomës së Kronikës, e cila kishte filluar të zhytej në një terr të lehtë, që ishte aty

për t'i bërë të pakapshme ato që deri pak më parë u shfaqen si mendime... Ndonëse Kroniku nuk po dukej dhe Nimanit i bëhej se shfaqja e tij mund të ishte vetëm një përfitim, në atë përvijim kishte përshtypjen se në fikje e sipër ndonëse shthurshim, po dëgjonte diçka të thuhej rreth poetit Gropan, që kishte mbetur si frymë e përsëritshme bashkë me një sqarim drejtuar Fadil Pashait, nga shkaku se kishte ndërprerë hulumtimet e Kronikut me arsyetimin se duhej ecur medoemos përpara dhe vetëm përpara...

„Kronikat e vdekura duhej lënë manash për shkak të kronikave të gjalla, që lidheshin me lavdinë që na priste“, foli Fadil Pashai me një zë të flashkët që mezi ia qartësonin mendimin.

Ai shpjegoi se Lartmadhëria e kishte thirrur dhe i kishte thënë se ishte koha të shkohej kah veri-perëndimi, por që për ta bërë këtë duhej përballuar një rrafshinë që rrinte si e pafund midis dy boteve që nuk pajtoheshin...

„Yt gjysh, Mehmeti, zgjeroi hapësirën tonë kah Lindja për të kaluar edhe mbi lartësitë e Kaukazit andej kah na shkonin vetëm ëndrrat. Ty të takon që të shkosh kah Perëndimi, që t'i lidhim dy krahët e botës...”

Një kohë të gjatë ndeja me kokë të varur kah harta në të cilën shtrihej ajo hapësira e rrafshët, nëpër të cilën duhej të kaloja për ta ngulitur flamurin perandorak tek pjesa perëndimore. Mblodha rreth vetes këshilltarësh e shumtë, ushtarakët më të shquar të kohës, pastaj mjekë, myderrizë dhe falltarë... Me vëmendje dëgjova ato që m'i thanë dhe në fund dhashë urdhër për themelimin e kalorësisë së re, e cila në luftë do të futej nga prapavija me sulme të befasishme, që sa dukeshin dhe sa nuk dukeshin. Dhashë urdhër edhe për formimin e njërive të posaçme, që do të infiltroheshin në radhët e armikut, si tebdil, për të vepruar në përputhje me rrethanat e krijuara. Isha i bindur se lufta e re kërkonte organizim të ri ushtarak, që mund të kryhej vetëm përballë fushatave të tilla dhe assesi ndryshe. Dhe ditën e vitit të dytë të uljes në fronin e kryevezirit, kërkoja leje nga Lartmadhëria për me u nisë kah veri-perëndimi. Ishte syri i pranverës dhe kundërmim i jargavanëve ma mbushi kraharorin me gjallëri të paparë që më bënte të shpresoja se do të kthehesha fitimtar për t'u nderuar me kurorat e lavdisë... Këtë e parandjeva edhe nga shikimi i Lartmadhërisë dhe nga urata që ma tha, kur ma ledhatoi butësisht supin. Ajo prekje magjike sikur ma vuri përpara jeshillëkun e gjithë botës, një jeshillëk të pafund që nuk m'u hoq sysh edhe kur kalova Azinë dhe u futa në Evropë... Jeshillëk shihja kudo dhe ngado, madje edhe kur m'u shfaqen akullnajat e para bashkë me mjegullat e ulëta që përpinin botën... Allah, thashë gjithë kënaqësi, të qofsha falë që po ma hap rrugën kështu...

Por, ndodhi që një ditë, xheneti, për të cilin Shpjeguesi i ëndrrave pareshtur më thoshte se e kisha hak, sikur më treti befas dhe vendin e tij së pari e zuri një pamje e zvetënuar si shkretëtirë e bardhë, që më vonë m'u kthye në një acar të paparë. Kështu, pas depërtimeve të para, erdhi një kohë shurdhe, ku thujse asgjë nuk ndodhte... Të zënë në një mjegull të dendur, ushtarët më ngjanin të përgjumur dhe të përhumur, e të njëjta më dukeshin edhe njësitë armike, të cilat sa s'i preknim me dorë. Mjegulla bezdisëse na kishte bërë troç dhe gati na i humbte ndjenjat e armiqësisë që kishim ndaj njëri-tjetrit! Kështu që, midis nesh e tyre ishte një heshtje e ftohtë (që bëhej edhe më e trishtueshme nga një shi i imët që nuk kishte të ndalur) dhe mjegulla e dendur që nuk lëvizte dot, brenda së cilës nuk ndodhte asgjë, pos që përhapej njëfarë shkallmimi i çuditshëm i shpirtit që na lente pa kurrfarë vullneti... Ajri i përgjumur bashkë me atë shtypjen e çuditshme, një ditë nisi të shprishet nga njëfarë ere e ftohtë, gjithë akull që erdhi nga veriu, e që paralajmëronte se asaj letargjie mbase po i vinte fundi. Por, përfutim se i kishim shpëtuar atij ngujimi megjithatë ia lëshoi vendin një gjendjeje tjetër edhe më të rëndë, që pasqyrohej me një lëshimin e një mjegulle të dendur të përzier me një borë të imtë, që po na kthente në peng të një kohe pa kohë, ku nuk ndodhte asgjë dhe lufta e përfytyruar me fitore të mëdha ishte kthyer në një betejë të heshtur me vetveten, ku nuk kishte as armiq e as kundërshtarë, pos një ndrydhjeje shkallmuese nga brenda... Në kulmin e atij dëshpërimi këshilltarët më thanë se fjala ishte për një stinë të ngatërruar keq, që

megjithatë përsëritej në fillim të çdo qindvjetëshi. Në këtë pjesë të botës, më thanë, qindvjetëshat gjithnjë ndërrohen kështu në një kohë të pakohë, që shkallmon gurë dhe dru. Mend plasa nga tërbimi. “Pse nuk ma thatë më parë këtë për ta anashkaluar këtë kohë të pakohë?...” Më thanë se e gjitha ishte shkaktuar nga mungesa e syqelësisë dhe mbështetja vetëm në shenjat perandorake, që nuk përfillnin ato të botës tjetër, pra të Perëndimit... Kjo më hidhëroi edhe më shumë sa u thashë se dredhitë dhe të tjerat që i kërkonte lufta nuk pyesnin për rregulla dhe parime, por duhej vepruar në përputhje me arritjen e qëllimit... Desha një luftë të madhe dhe një fitore të lavdishme dhe jo një luftë kënetash, thashë gjithë dëshpërim.

Por ç’ë do se as shfrimi dhe as të kuptuarit se isha futur në një luftë të bezdisshme nuk më ndihmonte të lirohesha prej saj. Përballë asaj gjendjeje të pashpresë vetëm tingujt e klarinetës më ngushëllonin paksa. Klarinetisti plak, ditë e natë rrinte me instrumentin e vet në dorë dhe unë përfytyroja një stinë të re, qo dikur do të vinte, por që zgjatej e zgjatej deri në përhumbe.

Çuditërisht, një ditë prej ditësh, kur druaja se kisha humbur përmasat e kohës dhe të hapësirës, pashë se bora po ia lëshonte vendin një behari të lehtë, i cili i qiti në shesh konturat e ushtrisë së lodhura dhe gjithë shkallmim, që kishim përpara. Ushtria kundërshtare, e molisur deri në thyerje, nuk shfaqte kurrfarë vullneti për kundërvënie. Madje, ajo na u dorëzuar sapo u hoq tisi i parë i mjegullës bashkë me vesën që i kishte bërë si të ngrirë me shpjegimin se këtë kishin ndërmend ta bënin ngaherë, por që kishin pritur një ditë të çelur që e gjitha të mos dukej si keqkuptim që do të mund t’u kushtonte... Ndërkohë që ata rrinin të shkretë dhe të mërdhirë, dikush zuri n’gojë një fitore të madhe, të merituar. Shikova vëngër dhe urdhërova të mos flitej për kurrfarë suksezi, pos që kishim fituar një barrë të rëndë që do ta bartnim zvarrë si gurë në qafë, nga e cili do të mund të ngulfateshim... Le të shkojnë nga të duan, thanë ushtarakët... Ç’punë kemi me ta kur nuk na kundërshtojnë?... Edhe më keq se të na kundërshtonin, u thashë... Fola se serish do të na i qesin përpara dhe serish do të na dorëzohen dhe ne serish do t’i falim për t’i hequr qafësh, por ata prapë do të na zënë rrugën dhe ne do të futemi në një rreth të mbyllur që i thonë luftë e luftë nuk bëhet... A nuk është kjo për keqardhje, shfrevë dhe mendja më shkoi se si nganjëherë qyqyarllëku është kundërshtar më i rrezikshëm nga kundërvënia e hapur, ngaqë ashtu shkallmohej vullneti për luftë, i cili kalitej në beteja të lavdishme... Ç’taksirat që më zuri, thashë gjithë dëshpërim...

Megjithëqë, pas asaj ngecjeje, bëme një lëvizje sa për të thënë, ç’rast morëm kështjellat që na dolën përpara (ah ç’kështjella të mjera që dukeshin ato të rrasura në baltë), serish m’u bë se gjendeshim në të njëjtën hapësirë, ku shihja të njëjtat moçale, ku ndeshja të njëjtat çufrina, ku ngatërroheshim të njëjtave barëra të liga dhe zvarriteshim nëpër të njëjtat kënetë të kalbura nga myshqet që na i zinin këmbët... Në atë ngarendje në rreth na shfaqeshin të njëjtat pamje të ngrira, na përcillnin të njëjta kufoma që nuk bëheshin kërma dhe prapa tyre vinte ajo mjegulla e lagësht bashkë me heshtjen shurdhe, ku nuk ndodhte gjë... Zot, ç’luftë të pakuptimtë që bëjmë me vetveten, thashë një ditë gjithë dëshpërim. Kronisti, që më rrinte pranë dhe si hije m’i përcillte lëvizjet, për herë të parë mori guximin të thoshte se nuk kishim humbur, se po luftonim ç’prej vitesh duke kaluar nga beteja në betejë dhe duke i fituar edhe ato që duken të pamundshme... “Lufta jonë, tha ai, tashmë ka mbushur me shpresë gjithë Perandorinë, e cila pret me të drejtë prej nesh t’i dhurohet edhe krahu tjetër i botës për t’u bërë e tërë...”

Seç m’u qep një e qeshur e thartë në fytyrë, nga ato që më bëhej se më kishin ikur përgjithmonë. Sillemi kot së koti, folë gjithë nënçmim... Sorollatemi si të marrë dhe përfytyrojmë beteja të mëdha dhe fitore të mëdha, ndërkohë që nga çasti në çast sharrojmë në këtë ligatinë të pafund, të bërë qëllimisht për t’i bërë zap ëndërrimtarët, që dëshirojnë t’i bashkojnë të pabashkueshmet, t’i pajtojnë të papajtueshmet dhe t’i lidhin të palidhshmet... Kronisti heshti. Psherëtimë, që më vinte nga të gjitha anët fliste për gjendjen e tij të vështirë. Pak më vonë i thashë: shëno se Fadil Pashai po sillet në një cirk të madh e të pafund, ku njëherësh është aktor dhe shikues, ku në të njëjtën kohë qesh dhe qan... Shëno se kësaj nuk i

thonë as luftë, e nuk i thonë as paqe, pos një dergije të pa fund... “Madhëri, ju ka molisur koha e ligë”, më tha dhe shtoi se si në këtë rrafshinë ajri kundërmon rëndë dhe sjell shqetësim. „I tillë është ky vend, që kështu mbrohet nga ata që dëshirojnë ta nxjerrin nga mallkimi që e ka zënë“... Është ferr, ia ktheva dhe mjerë ai që ngatërrohet në të...

Kronisti heshti dhe nuk di si në atë gjendje fare të shthurur m'u kujtuan ca fjalë që m'i kishte thënë dikur rreth nevojës për të gjurmuar diçka nëpër botë. „Nëse del ndonjëherë nga kjo ligatinë, jepu bredhjeve“, i thashë, pa qenë i sigurt se për çfarë ishte fjala... E ai, si i thyer ma ktheu, se ishte bërë vonë, shumë vonë për të shprishur mjegullën që i ishte qepur kujtesë sonë... “Syri im nuk i zë më shkronjat e fshehta...” I thashë se ishte i lirë të largohej nga t'ia merrte syri dhe e luta që nëpër bredhjet që do t'i bënte të mos harronte ndonjëherë të hapte fjalë se Fadil Pashai kishte pasur fatin të ngujohej në një mjegullim të pafund, pikërisht në një vend, ku bota duhej të mbahej e paprekshme, për të mos u bërë as Lindje as Perëndim, as ditë e as natë...”

Fjalët e fundit të Pashait sikur ishin të zgjedhura për një fund të qetë, me të cilën do të anashkalohej ajo që Nimanit i dukej si ndërhyrje e Kronistit, që bëhej për ta thyer heshtjen dhe njëtrajtshmërinë e Dhomës së Kronikës, dhe mbase do të ndodhte kështu, po mos të shfaqej serish zëri i Kronistit, që nga Fadil Pashai po kërkonte me çdo kusht të hiqte vellon e mjegullës për të shpaluar sëmbimet që e rëndonin nga brenda...

„Isha i vetëdijshëm se tek ju po fliste një shpirt i sublim, kaherë i pakënaqur në gjendjen në të cilën ndodhej“, tha Kronisti për të sqaruar se kur ishte nisur për në kryeshehër (nga leja që kishte marrë prej tij), kishte qenë i bindur se lajmi i kobshëm do të shkonte para tij atje.

„Dhe, sapo iu afrova kryeshehrit ndjeva tellallët që me gjithë zërin përhapnin lajmin rreth rënies heroike të Fadil Pashait në luftën e shenjtë!... Ushtria jonë korri fitore të madhe! Thuhej. Pashai shpallet shehit i Perandorisë!... A nuk ishte ky një mashtrimi pashoq, Pasha?“

„Si ta marrësh“, foli Fadil Pashai me një zë të butë. “Si ta marrësh?“

„Ishte ky një mashtrim i madh, Pasha...”

„E di se po sharroja në atë mjegullim të bezdisshëm, sa dikur m'u err bota... Koha shurdhe ishte e pamëshirshme... Humba në atë kohë dhe të tjerat ishin të parëndësishme, qofshin ato edhe që merren si fitore...”

„Megjithatë, ju nuk ratë heroikisht në luftën e shenjtë...”

„Ishte fare i parëndësishme fundi, kur dihej se nga ai ngujim nuk do të lirohesha kurrë“.

„Ju korret fitore, por ajo nuk ishte kurrfarë lufte e shenjtë...”

„Edhe kjo ishte e parëndësishme...”

„Megjithatë, Ju bëtë vetëvrasje, Pasha! Nuk e ditke këtë?“

Pashai heshti. Dukej sikur ishte kthyer në një hije, që ishte pajtuar me gjendjen në të cilën mund të fshihej.

„Bëtë vetëvrasje dhe këtë e bëtë ngase ai shpirti i trazuar nuk ju la të qetë. Ai kërkonte prej jush ato, që nuk ishit në gjendje t'i bënit... Dhe, në atë luftë e sipër me atë që pareshtur e ndjenit, por që nuk e zbërthenit dot, zgjodhët thikën. Ushtarakët, (gjithsesi me udhëzimet që do t'i kenë marrë nga kryeshehri), hapën fjalë se armiku u fut tebdil në tendë për të marrë hak për disfatat e njëpasnjëshme nëpër fushëbeteja! Zyrtarisht gjithçka ishte e saktë, ndonëse e gjitha ishte një mashtrim publik, i cili medoemos i duhej edhe Perandorisë, shërbimet e fshehta të saj, nisen hetimet për të parë arsyet e njëmendat që sollën deri te kjo... E vërteta, që tash duhet thënë troç para Djaloshit, është se përnjëmend u përcollët nga një mjegullim i dendur që nuk ju hoq syve dhe mendimeve tuaja... Është e vërtetë, po ashtu, se mendonit se sillleshit në një arenë ku gjërat përsëriteshin dhe shfaqej ajo kotësia e zyrtë... Është e vërtetë se bezdiseshit pa masë kur futeshit në mesokohën shurdhe, pra të kalimit nga stina në stinë, kohë kjo që nuk ishte as për luftë e as për paqe... Është e vërtetë se ju mundonin gjithfarë përfytyrimesh të ngatërruara, që ju shkallmonin dhe ju molisnin, por që kjo molisje i

kundërshtonte gjendjes në të cilën ndodheshit dhe ndodhte kështu pse tek ju vërtitej pareshtur shpirti i njëmendët, i cili luftonte kundër zbrazësisë, pra ai shpirti i poetit, atij, që ishte i përsëritshëm dhe gjithëkohor, që i kthehej vetvetes dhe kërkonte shpalim të mëtutjeshëm...”

„Ah, për perëndi mos më ngatërro me poetët!... Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja te poezia dhe të tjerat që shthurin mendjen... E di mirë këtë...”

„Këtë e besoj, Pasha. Sado që ju e donit luftën, sado që e donit shpatën, sado që e donit fronin më të lartë pa të cilin as që mund të rrinit, Gropani, me kohë u bë pjesë e qenies suaj... Natyrisht se në ato rrethana mendja juaj përpëlitej pareshtur me luftëra, merrej me armë dhe me strategji ushtarake që i nënshtroheshin vetëm fitoreve dhe përjashtonte të tjerat. Tekefundit, a nuk ua solli famën ai përkushtim? A nuk u bëtë ushtarakët më të fuqishëm të Perandorisë falë kësaj?... Dhe kur arritët në majë, në atë majën që e kishit përherë synim, ndodhi ajo që e hetuat si boshllëk apo si fashë, ku sukseset nuk ju kënaqnin si dikur. Madje, edhe fitoret e mëdha, që Perandoria i priste me ngazëllim, i përjetonit si gjëra të rëndomta, që pak nga pak ktheheshin në një përsëritje të së njëjtës, që ua merrte qetësinë, që assesi ta kuptonit e lërë më ta shpjegonit. Në ato rrethana nisi të shfaqej mjegullimi, nisi të dukej ngatërimi i gjërave dhe të paraqitej ajo gjendja që ua merrte vullnetin, e ngjashme me njëfarë ngrirjeje të brendshme, një si zbrazëti që ndjenit bashkë me lodhjen e pakuptueshme, që nuk ishte kurrfarë ngarkese me çështjet e mëdha, siç ju thoshin mjekët dhe këshilltarët, me të cilat ballafaqohen ata që u bien telashet e botës mbi kokë, por ishte fillimi i një lufte të brendshme, që zhvillohej midis të dukshmes dhe të padukshmes, midis pjesës së urdhrave dhe kundërshtimit të urdhrave, dhe se kjo ndeshje, që nuk prante, kishte për pasojë amullinë, humbjen e vullnetit dhe shfaqjen e molisjes, që edhe suksesin më të madh e rrudhte deri tek përmasat e zhvleftësimit dhe e bënte të dukej i kundërt... E gjitha kjo, pra paralajmëronte se ju po i iknit ngadalë jashtësisë, ku ndodheshit dhe, me anën e ngacmimit të vetëdijes, po i ktheheshit shpirtit... Ishte kjo një thirrje e brendshme, por tepër e thellë dhe tepër e ndrydhur, për ta njohë vetveten, që nuk ishte tjetër pos pjesë e atij ndryshimi, prej nga vullneti për fuqi duhej të ndërlihej me vullnetin për liri...”

„Mjaft!... Mjaft!... Kështu po ma shton mjegullimin, që assesi të më hiqet. Mjaft!... Mos më ngatërro me ato që ma shtojnë bezdinë...”

„Është koha, Pasha që ky shqetësim të përballohet... Nuk është e thënë që të mbeteni gjithnjë në atë mjegullim...”

„Ah, mjegulla?... Mjegulla...”

„Duhet hequr, Pasha, sa më parë...”

„Nuk e di?... Mbase mjegullimi u shkon disa gjërave, që të mos kuptohen kurrë, ngaqë kursejnë nga hamendjet dhe dëshpërimi?... Tek e fundit, isha ushtarak dhe ushtarakut i duhet vetëm të kryente urdhrat...”

„Them, Pasha, se pikërisht pse ishte kështu dhe pse mendoje se do të ishte kështu, këtu zunë fill telashet tuaja, që nuk t’u hoqën sa t’u kthyen në kob... Në të vërtetë, urdhri i jashtëm, kundërshtohet nga urdhri i brendshëm. Dhe kjo ndodhte fare pavetëdijshëm dhe ndodhte pse ai shpirti i poetit të ngacmonte...”

„Serish po më qëllon me atë shpirt të poetit?... Deri kur do të më ngasësh kështu?...”

„Përderisa ta pranosh këtë...”

„Mjaft!... Mjaft!... Më mirë është të mbetem i ngujuar në mjegullim se sa në vorbullën e hutive...”

„Nuk ke rrugë tjetër, Pasha...”

Fadil Pashai po dëneste. Kishte zënë sytë me duar dhe pak nga pak po tretej. Kur Nimani mendoi se e gjitha do të merrte fund me vellon e mjegullimit, që sikur po e mbërthente edhe gjithë hapësirën e Dhomës së Kronikës, ndjeu një zë, i cili po thoshte se kronisti kishte të drejtë.

„Pse të mos mendojmë shtruar për të gjitha?...”

Duke e ndjekur zërin,që po i vinte nga ana tjetër, Nimani pa t'i shfaqej një mesoburrë me sy të mbufatur prej të cilëve mezi shpalosej një shikim i lodhur. I prekte ata herë pas here, si të kërkonte prej tyre të hiqte perden e errët që e pengonte të shihte. Dikur nis të fliste se si Lartmadhëria nga ai kishte kërkuar forcën e të et Fadilit dhe mendjen e gjysh Ahmetit.

„Ç'është e drejta, unë isha njëfarë gjysmë-gjysme, që barte dy pjesë të kundërta, me ç' rast pareshtur hetoja praninë e njëres që ishte e butë, e heshtur, e qetë dhe gjithë prirje për meditim e poezi, dhe tjetrës, që ishte e ashpër, e vullshëm dhe gjithnjë plot shqetësim për t'u ngjitur sa më lartë... Si t'i pajtoja vallë, skajshmëritë?... Dhe, a mund të jetohej me ato kundërthënie, kur ato përpëliteshin në mua dhe nga dita në ditë ndesheshin shumë e më shumë mes vete? Një kohë të gjatë u përpoqa t'i zbutja, t'i rrudhja vetëm deri tek një shqetësim, që i duhet secilit për të ruajtur baraspeshën e natyrshme... Por, kjo ndeshje me vetveten, nga dita në ditë merrte përmasat e një lufte midis dy vetave, që jetonin nën të njëjtin kulm, në të njëjtën hapësirë dhe në të njëjtat rrethana, por që assesi t'u nënshtroheshin atyre... Kjo luftë, pra ishte e përhershme dhe thuajse nuk kishte të sosur sa më shtynte të mendoja se do të isha fatlum sikur të fitonte njëra anë, cila do qoftë. Mbase jeta ime pastaj do të kishte rrjedhë të njëtrajtshme, qoftë andej apo kënde, pa marrë parasysh kah... Por, ç'e do që të dy anët ishin njësoj të forta dhe assesi të lëshonin pe apo të shfaqnin shenjat e lodhjes. Grindeshin e grindeshin derisa shkallmoheshin. Atëherë te unë flisnin dy zëra që njëri thoshte se e donte poezinë e tjetri ia kthente se i donte armët. Dhe kështu i pari fliste për poezi, ndërsa tjetri për armë dhe gjithçka merrte formën e një ngatërrimi që më përplaste... Në pahintikë, megjithatë ndjeja ato që thuheshin në njërin anë si poezia është e amshueshme, dhe në tjetrën anë se arma është e madhërishtme... Dikush thoshte se poezia është vetëdije, është ushqim shpirti, është përcaktim i amshueshëm, ndërsa tjetri thoshte se arma është forcë, se forca është siguri, se siguria është liri dhe lira është pavarësi... Pastaj ndodhte që njëri fliste rreth asaj se liria e amshueshme gjendej vetëm në mbretërinë e muzave, ku gjithçka ishte harmonike e thellë, e bukur, ndërkohë që tjetri ia kthente rreth domosdosë së baraspeshës së fuqisë si kusht për liri, me ç' rast thuhej se pa të nuk ka mendim të lirë dhe asgjë pos ëndrrave... Ky farë ngulmimi nga secila anë, që nuk kishte fund, assesi të më hiqej. Herë njëra dhe herë tjetra anë shtronte pyetje; herë njëra e herë ana tjetër më ngacmonin dhe më kërkonin të tërin. Por, unë, megjithatë dëshiroja të mbaja asnjansinë dhe pikërisht kjo më moliste. Më shembte përtokë sa mallkoja fatin e zi që isha bërë log i betejave të pafund. Dëshiroja të rrija ashtu si i paqenë, por shpejt dëgjoja të më thuhej:

-Jepu poezisë!... Ki besim tek poezia...

-Fuqia, vetëm fuqia ndihmon!

-Poezia...

-Fuqia...

-Mendimi...

-Liria...

-Mos!

-Mo!

-M...

Mos-mosi i padukshëm nuk më la të qetë asnjëherë, sikundër nuk më la të qetë as kërkesa rreth pajtimit të mendjes me fuqinë në rrafshin shtetëror. Prej meje kërkohej kjo kthesë, që thuhej se ishte e domosdoshme... Dhe kur u ula në fron, vendosa t'i lë veprim të lirë mendjes dhe fuqisë. Pse jo? Le të zhvillohen njësoj, sepse me lirinë ndalohen abuzimet e shtetit, ndërsa me shtetin shmangim abuzimet e lirisë... Pra, ndërlidhja e këtyre mundëson pushtetin ideal... A thua gjithë ajo trysni e brendshme një ditë do të shpaguhej?... Por, nuk vonoi dhe hetova se mendimi i lirë nuk shkonte barabar me fuqinë dhe pushtetin. Forca ecte shumë më shpejt dhe shkonte shumë larg, ndërkohë që mendimi ngecte... Në atë shpërputhje sikur dëgjova si njëra pjesë më thoshte:

-E ke tash të qartë se ç'ngjet kur mbizotëron fuqia?...

-Desha pushtetin ideal...

-Lirinë e kupton drejt dhe si duhet vetëm pjesa e vetëdijshme... Tjetra, me anën e fuqisë që e ve në veprim, sapo gjen hapësirë, bëhet e papërbajtshme, nga shkaku se ajo i nënshtrohet lëvizjes, ku çështjet e shpirti dhe të tjerat harrohen fare... A nuk po sheh se lëvizja e fuqisë po na tëhuaj nga të menduarit e domosdoshëm?... Kjo nuk duhet lejuar...Nuk duhet lejuar!...

Pjesa që më fliste kështu kishte të drejtë. Keqardhja ime u bë edhe më e madhe kur pashë se ishte tepër vonë që ndryshohet gjë. Nga dëshpërimi i thellë dhe me ndjenjën e një fajtori rashë në shtrat dhe nuk u çova më...

Për habi, në çastet e fundit, kur më dukej se bota, e tëra i ishte nënshtuar lëvizjes së fuqisë dhe turrit të saj, m'u qepën ca vargje dhe m'u lidhen ca mendime të shkëputura, të gjitha të rimuara... Vargjet nuk po më ndaheshin, ndonëse shumë prej tyre nuk i kuptoja, ngaqë ato ngatërroheshin me një gjuhë të panjohur. Por edhe përkundër kësaj, ato po më ngashërenin çuditërisht sa më bëhej se pak nga pak liroheshin nga ndjenja e fajit për militarizimin e vrullshëm të Perandorisë sa isha në krye të saj... Vargjet e panjohura, që kishin mbërthyer mendjen dhe shpirtin tim sikur më kishin kthyer në poet, që gjithë jetën ishte marrë me një poemë të shprishur, e cila kishte bredhur brez pas brezi, herë e ndrydhur e herë shkëputur, që në një farë mënyre edhe unë merrja pjesë në ripërtëritjen e saj... Është edhe jotja... Duhet ta plotësosh, po më thoshte një zë, që më vinte nga një thellësi... Shpirti juaj ndodhet nëpër gjymtyrët e saj...

Ç'ishte vallë, ajo që m'u qep ashtu dhe më shpëtoi nga vuajtja e amshueshme?... Mos ishte ndonjë mashtrim përfutës?..."

„Nuk ishte kurrfarë mashtrimi, por ishte shpirti juaj, ishte ajo ndjenjë e pranisë së tij, e cila nuk u largua prej jush edhe kur ju hoqët dorë prej saj dhe ishit në gjendje që kundër saj edhe të luftonit“.

Kronisti pastaj shpjegoi se nëpër kronika të ndryshme kishte hetuar se qysh nga koha e Princ Dhimitrit, e edhe më vonë, me mish e me shpirt i ishte kundërshtuar asaj ndjenje. „Nuk u ngurrua që ajo të luftohet haptazi dhe ndodhi dikur që çfarëdo shqetësimi shpirtëror të shpallet herezi e rrezikshme... Disa, madje, para perandorëve dhe perandorive që shkonin e vinin, u betuan se me gjithë zemër do të luftonin kundër atij shqetësimi siç luftohet gjaku i prishtë, të cilit herë pas herë i duhet pastrimi, për t'u liruar nga mbërthimi i të keqes...“ Kronisti pastaj tha se ai farë „gjaku i prishtë“ jo rrallë u pastrua me heqjen e kokave më të mira të Principatës, që u prenë në pabesi dhe pastaj iu dhuruan perandorëve të huaj, që si shpërblim kishin dekoratat e vasalitetit që merreshin prej tyre...

„Por mu pse ngjiste kështu, ajo ndjenjë, në vend se të shuhej, siç pritej, kundërvepronte si ëndërr, si shqetësim krijues apo si gulç i paqartë, që qepej... Ndodhte që ky farë shqetësimi, qoftë edhe i pavetëdijshëm, ishte aq i fuqishëm dhe aq rrëmbyes sa përfundonte në kob. Kështu, ngjiste që ushtarakëve të lartë, të betuar në normat perandorake dhe me një mijë dëshmi lojaliteti ndaj saj, të shumtën të bëra edhe në dëm të vetvetes, kjo ndjenjë ua turbullonte mendjen befas, sa ata fare pavetëdijshëm shfaqnin huti, shprehnin shqetësime dhe kundërshtime madje, gjë që nga të besueshmit që ishin ktheheshin në të dyshimtë, nga të urtët dhe të dëgjueshmit ktheheshin në rebelë, nga të përkulshmit që ishin ktheheshin në kryeneçë, që e gjitha ishte e natyrshme të çonte deri tek grindjet e papritura me perandoritë, pa ditur se ç'ishte ajo që i drejtonte kundër tyre, pa ditur çfarë në të vërtetë kërkohej... Ndonëse kryeneçët ndëshkoheshin rëndë dhe gjithçka pastaj shpjegohej me ambicie të sëmura për pushtet dhe ndonëse çështjet nuk dramatizoheshin, shërbimet e veçanta të perandorive megjithatë e dinin se për çfarë ishte fjala dhe përpiqeshin që atë shqetësim përherë ta ndrydhnin me anën e ndërlikohjes sa më të ngushtë me pushtetin dhe majat e tij, ku energjia e brendshme duhej t'i shërbente vullnetit për fuqi si veprim dhe jo fuqisë së vullnetit të veprimit të lirë. Kështu ngjau në kohën e Romës. Kështu ngjau në kohën e Bizantit. E, kështu po ngjet edhe tash. Dhe, kështu do të ngjasë edhe në të ardhmen përderisa do t'i

nënshtroheni lëvizjes si fuqi, asaj që mbikëqyret dhe udhëhiqet dhe jo fuqisë si lëvizje, që çon vetëm deri tek majat e pushtetit të njëtrajtshëm perandorak me qëllim të vetëm zgjerimin e përhershëm të hapësirës, ku të menduarit sipas urdhrave kthehet në përmbajtje vepruese...”

„Nuk pajtohem me këto që thotë Kronisti... Nuk pajtohem... Po na sjell megjullim të panevojshëm me atë farë poetin dhe me fosilet që na qenkëshim shpërndarë nëpër kohë, që pastaj sulmuakan shpirtin... Me pandehmën rreth ngatërimit të së pavetëdijshmes me të vetëdijshmen dhe anasjelltas, që gjoja nuk janë hetuar si duhet dhe sa duhet, synohet nënçmimi ynë...”

Ai që foli ishte një burrë me shpatulla të gjëra. Kishte një fytyrë të përheqtë, në të cilën shikimi i vrenjtur i dukej i ngrirë. Nimani vërejti se atij i fliste i gjithë trupi.

„Sa për vete, mund të them se pata bindjen e pathyeshme perandorake. Punova ditë e natë për të mirën e saj dhe gjithnjë do të veproja ashtu edhe po të kisha njëmijë jetë, sepse vetëm ashtu dhe në përbërje të saj mund të bëhesha i madh, mund të bëhesha i fuqishëm... Pa Perandori, do të isha një hiq...”

„Nuk të thotë kush, or Mustafa Pashë Qyprilliu, ta ndërrosh bindjen. Këtu duhet biseduar më pak rreth atyre që kanë ndodhur e më shumë rreth atyre që nuk kanë ndodhur e mbase është dashtë të ndodhin“, foli qetë Kronisti.

„Dua të them se punova me mish e me shpirt për të mirën e Perandorisë, meqë ajo paraqet atë parakushtin e arritjes së majave“, ndërhyri Mustafa Pasha po me atë zë të kumbueshëm. „Pastaj, mund të flitet për të gjitha, por duhet pasur parasysh atë se askush nuk na e fali fronin më të lartë dhe askush nuk na i dhuroi nishanet e hierarkive ushtarake...Të gjitha, pra që të gjitha, i fituam me mund të madh dhe me përkushtim të jashtëzakonshëm, që e derdhëm nga gjenerata në gjeneratë. Pa këtë përkushtim askush nuk do të na vente veshin. Do të mbeteshim pjesë e turmës së përdorshme... Nënshtrimi lëvizjes së fuqisë ishte një domosdo dhe assesi ndryshe...”

„Këto nuk i luan topi, Pasha“, foli Kronisti. „Por nuk duhet harruar se ju ishit pjesë e një lëvizjeje, e cila përherë duhej të mbikëqyrej që të mos ndodhte që ajo të kthehej në forcë të vetëdijshme lëvizëse, sepse me këtë ndryshonte kahu i historisë, ku ju nuk do të ishit vetëm shërbyes, por edhe përcaktues të saj...”

„Ah, lëri dokrrat rreth vetëdijes së fshehur dhe të tjerave. Vetëdija ime ishte Perandoria dhe rritja e saj... Ajo për mua ishte e gjitha dhe mbi gjithë botën dhe për të e dhashë jetën pikërisht në pjesën e trungut tim, kur isha gati t’i afrohesha Vjenës...”

„Është e vërtetë se i shërbyet asaj si asnjëri tjetër. Shuat shatë kryengritje të mëdha, shkuaat deri në Krime dhe tutje Kaukazit, por ç’është më e rëndësishme, në vendlindje, betë një luftë të madhe kundër gjeneralit të Vjenës, me ç’rast, soji juaj u nda në dysh për të mbrojtur mbretëritë më të mëdha të botës. Kështu, një pjesë, (mijëra sosh,si ushtarë të rregullt), i kishe në anën tënde dhe një pjesë, (po ashtu mijëra sosh), kishin zgjedhur anën e gjeneralit të Vjenës. Dhe në atë luftë, siç ngjet me lumenjtë e Tokës së Lashtë, që rëndom derdhen në dy dete, edhe gjaku juaj, edhe fuqia juaj dhe gjithë përkushtimi juaj, në të njëjtën kohë u derdh në dy anë për të mbrojtur perandoritë e ndryshe, që paraqesin dy bota, dhe u derdh për të mbrojtur dy bindje dhe dy qytetërime të kundërta, që prej shekujsh, pikërisht në hapësirën tuaj, luftojnë njëra me tjetrën, duke e kthyer atë në një tokë të shkretë. Në Shkup, në Prishtinë e deri në Nish vëllezërit e një nënë e të një babai vriteshin me njëri-tjetrin nën flamujt e ndryshëm. Mbase e di se në grykën e Kaçanikut, ndodhte që gjatë pushimeve, kur ushtarët e taborëve kundërshtarë linin për pak armët mënjanë dhe ndiznin ndonjë duhan, ia thoshin të njëjtës këngë, që dëgjohej në të dy anët e grykës para se prapë t’i suleshin njëri-tjetrit deri në vdekje?...“

„Pse m’i zë n’gojë këtë, kur dihen dhe ishin të pashmangshme“? - ndërhyri Mustafë Pasha.

„Ngase janë pjesë e tragjikes suaj“, - tha Kronisti.

„Ishin pjesë e një luftë për mbijetim, që bënte Perandoria në atë pjesë të botës, ku vendosej ardhmëria e saj dhe e jona njëherësh...”

„Ishte edhe luftë me vetveten...” - foli Kronisti.

„Mjaft!... Mjaft!...” -po çirrej Mustafë Pasha.

„Pse shqetësohesh, or?... Këtu nuk flasim më si kryevezisë e as si ushtarakë, që mund të vendosin fatin e luftërave. Tash jemi të lirë të merremi me gjithfarë rishqyrtimelesh, na pëlqyen apo nuk na pëlqyen. Ndryshe nuk shkruhet historia, së cilës i takojmë me të bëmat dhe të pa bëmat tona...”

„Shekulli ynë perëndoi, ndërkohë që filloi ai i kronistëve dhe të tjerëve që do të merren me të. Gjykimeve që do të jepen duhet t’u nënshtrohemi, ngaqë nuk kemi nga ia mbajmë...”

„Këtë e them, pasha i nderuar”, foli Kronisti. -“Imja është të qes në shesh të gjitha dëshmitë, pa marrë parasysh si merren ato...”

„Nga e vërteta nuk kemi dëm. Është koha që çështjet t’i shohim edhe ashtu si nuk na pëlqejnë”, foli njëri, që rrinte në pjesën e skajshme thuajse të errësuar, i cili me ato që tha sikur dëshironte t’ia bënte me dije Kronistit të vazhdonte të shpaloste ato që kishte për t’i hapur, ndërkohë që ai, pas një vështrimi të shkurtër që ua lëshoi të gjithëve radhazi, tha se ata kishin luftuar pareshtur dhe kishin bërë luftëra të mëdha, me të cilat ishte forcuar Perandoria, por që duhet pranuar se e gjitha e atyre luftërave për hapësirat, njëherësh ishte pjesë e ngritjes, e rritës, por edhe e rënies, që tashmë mund të dëshmohet shumëfish, dëshmi që mund të hedhën përpara dhe të shpalohej pa ndonjë mund...

Kronisti sikur u pajtua me këtë dhe shtoi se dëshmitë dhe shënimet tjera nuk i mbante kot në shpinë dhe rëndohej prej tyre pareshtur, meqë si të tilla duhej të ngjallin shqetësim, pikërisht atë shqetësim, që dikur, nga brenda ngacmonte pareshtur dhe kërkonte kthimin fuqisë së lëvizjes si kuptim dhe përmbajtje, në vend që përherë verbërisht të ndjekej lëvizja e fuqisë...”

„Gjërat nuk duhet parë njëanshëm e as të shkëputura nga rrjedhat e kohës. Për mua Perandoria nuk ishte vetëm fron i lartë, prej nga mund të drejtohej një pjesë e madhe e botës, por ajo ishte kulmi i të gjithave, që paraqiste një hapësirë të gjerë dhe të pakufishme, në të cilën përmbusheshin edhe ato që dukeshin vetëm ëndrra. A nuk ishte kështu?...” - foli Mustafë Pasha.

„Për këtë nuk dyshoj”, - ia ktheu Kronisti.

„Pse më mundon, pra?”

„Që ta kuptosh vetveten...”

„Vetveten?...”

„Pikërisht këtë...”

„Do të thotë se paskam qenë vetëm një send që ka vepruar i kurdisur?”

„Këtë nuk e them...”

„Po, çfarë thua pra?...”

„Dua të them se kishe frikë nga shqetësimi që e ndjeje, i cili të shtoej sa më shumë që ngjiteshe lart dhe jo rrallë të shfaqej si ngulfatje...”

„Këtë nuk do ta thosha...”

„Dua të them se kishit një ngacmim të përhershëm, nga brenda dhe sa më shumë dëshiroje ta anashkaloje atë bëheshe më i egër, bëheshe më i padurueshëm, bëheshe më i ashpër... Andaj, gjithë këtë mundoheshe ta fshehje dhe ta shuaje disi me anën e vringëllimës së shpatës, që dukej se paksa të qetësonte, përderisa e gjitha të rikthehej dhe të shfaqej si dridhërimë frike...”

„Flet dokrra. Paskam pasur frikë nga ajo ndjenjë dhe këtë e paskam shprehur përmes ashpërsisë?... Përnjëmend dokrra...”

„Quaj si të duash, Pasha, por jam i sigurt se dikur këtë do t’ia pranosh vetes...”

„Nuk do t’u nënshtrohem thashethemeve...”

„Nuk janë thashetheme, por shpalime Pasha i nderuar, heqje e maskave, pa marrë parasysh se çfarë zbulojnë...”

„Boll se plasa!.. Boll!...”

Pasi i tha këto, Mustafë Pasha befas u zhbë, treti... Nimani hetoi një si mjegullim që kridhej aty ku pak më parë ishte ai, ndërkohë që iu bë se edhe të tjerët shpërfillshëm po u ktheheshin kornizave në mur.

„Nuk do të largohemi pa i sqaruar të gjitha”- ndërhyri Mehmeti plak.“Koha është t’i shpalojmë një nga një ato që na sëmbuan nga brenda dhe nuk deshëm t’i përfillim. Pse të mbesim në mjegull dhe me bindje të rreme?... Pse?... Pse të fshihemi në lëvozhgë kur ajo nuk na duhet më?...Nuk bën të ikim nga ajo që edhe ashtu na ndjek...”

„Këtë them, Pasha i nderuar...Vetja do njohur gjithsesi dhe ky është ai kushti i parë që të pastrohet ndërgjegjja, sado që kjo nganjëherë është punë e vështirë, që përcillet me shumë pengesa dhe vështirësi.”

„Detyrën që ke marrë do ta kryesh”, i tha Mehmeti Plak Kronistit.”

Kronisti u falënderua dhe pas pak tha:

„Mustafa Pasha po e ndjente ngacmimin e qenies, që i shfaqej si ndjenjë, që ky nuk e përcaktonte dhe nuk e qartësonte dot saqë e gjitha një çast iu bë se i kaloi në një lëmsh të papërmbajtshme. Sado vonë, më në fund, Pashai e kuptoi se kishte luftuar kundër një pjese të vet, kundër asaj që ai nuk e kishte të qartë se ishte qenia e njëmendët, që kërkonte të shpërthente me çdo kusht... Nëse Sami Pashai kishte hetuar dridhërimat e ngacmimit të pashpjegueshëm dhe së fundit i ishin sjellë ca vargje që e munduan si ngulm i rëndë, ndërkohë që Fadil Pashai kishte vërejtur një shqetësim të vazhdueshëm, që nuk dinte ta shpjegonte, Mustafa Pasha ishte shumë afër t’i nënshtrohej urdhrit të shpirtit, atij shpirti që bridhte brez pas brezi dhe mëtonte që një ditë të lidhte fillet e shkapërderdhura... Me ashpërsi të jashtëzakonshme, pra me mund të madh, ky i kundërshtoi kësaj ndjenje. E kam të qartë se ç’çaste të vështira përjetoi Pashai i nderuar, veçmas kur dëgjoji zërin e njëmendësisë ta qortonte, tek ia bënte me dije se lëvizja e fuqisë po e bartte edhe andej kah rridhte gjaku i vet, kah hapeshin varret e pafund dhe ngjiste shkretimi... Mbi të gjitha, i rëndë ishte ballafaqimi me Priftin dhe ata që i shkonin pas, që tashmë ishin kthyer në kufoma që zvarriteshin humnerave të pafund, që megjithatë prapa lenin një si gjësim, që pak nga pak po kthehej në një jehonë, e cila nuk ishte tjetër pos ajo e Poetit Gropan, e kthyer në vargje, të cilat i drejtoheshin shpirtit... A nuk ishte kështu?”

Mustafë Pasha rrinte i heshtur me shikim e ulur. Ca djersë të ftohta po i shkonin çurg ballit.

„A nuk ishte kështu, Pasha”? - pyeti serish Kronisti.

Pashai vazhdoi heshtjen. Dukej se do të shkrihej i tëri nga djersët dhe avulli që i ishte ngjitur mbi kokë.

„A nuk është kështu?”

Pashai zuri të murmuriste diçka, por nuk ishte në gjendje të qartësohej.

„Është koha të flasësh!... Hiqe mundimin!... Hiqe se do ta kesh më të lehtë!...”

„Po ngulfatëm”, foli Pashai pas një përpëlitjeje.“Po ngulfatëm...”

„Fol”, i tha Kronisti.“Thuaje atë që as vetes nuk ke guxuar t’ia pranosh... Kështu do të çlirohesh...”

„Kështu do të vdes”, tha Pashai që dukej se po e merrte veten.

„Përkundrazi, Pasha. Do ta fitosh qetësinë e humbur...”

“Do të bëhem i paqenë...”

„Do ta njohësh vetveten bashkë me të vërtetën se ke qenë vetëm pjesë e lëvizjes së fuqisë dhe asgjë më tepër...”

Fjalët e fundit të Kronistit sikur e qetësuan Pashain. Befas nisi të fliste rreth një shtrëngimi të brendshëm që e kishte përcjellë ngaherë.

„Diçka e fuqishme më mbërthente për kraharor sa herë nisesha nëpër beteja të reja...Ç’ ishte vallë ai mundim?... Pyeta mjekë... Pyeta mendimtar... Pyeta shpjegues të shenjave dhe pyeta shumë të tjerë... Por, të gjithë më thoshin se kisha shqetësimin e njerëzve të mëdhenj... Është shqetësim i madhështisë, që ngacmon pa pra ata që mbajnë botën në supe... Dhe, sa më shumë që ngjitesha përpjetë, në vend se të më hiqej shqetësimi, më shtoej. Kot mundohesha t’i bishtnoja me anën e lëvizjeve të përhershme... Së fundit, gjithçka m’u shndërrua në një shungullimë të paparë. Ndihamo, zot, thashë çastin që hetova se po futesha në një lëmsh të ngatërruar prej nga nuk kishte kthim... I mbërthyer nëpër labirintet e errëta, nuk e di se si m’u shfaq Prifti, i veshur i tëri me parzmore lufte dhe nishane të gjeneralit të Vjenës, që po më ftonte në një luftë të re... Prapë do të luftojmë kundër njëri-tjetrit, më tha... Prapë do të gjakosemi në anët e kundërta... M’u bë se tek fliste ashtu po kthehej në një hije, e cila po më ndiqte bashkë me shumë e shumë të tjera, që i shkonin pas dhe thoshin diçka rreth një beteje të papërfunduar, e cila do të përsëritej si mallkim sa herë që do të dukej e sosur... Dhe ajo ndjekje e përndjekshme sikur nuk ka të sosur, ku përdëllimi i Priftit nuk më le të qetë... Ajo edhe tash po më qepet dhe po kërkon prej meje diçka që nuk e kuptoj...”

„Është qenia juaj... Është qenia juaj që t’u ka qepur dhe nuk të ndahet... Pjesëzat e saj kërkojnë të bashkohen dhe kjo bëhet vetëm me anën e shqetësimit të përhershëm, që duhet kuptuar dhe qartësuar...”

Pashai ishte kyçur i tëri. Qetësia shurdhe po kthehej në një zallahi të padurueshme.

„Shpirti juaj po formësohej mundimshëm“, vazhdoi të fliste Kronisti.- „Po vinte koha kur lidheshin hallkat e tij dhe këtë e ndjenit si shqetësim, që shfaqej si ngacmim dhe shungullimë e pashpjegueshme. Mustafa Pasha që i fundit që kësaj ndjenje i bëri ballë me shpatë në dorë. Mahmut Pashai dhe Hysni Pashai, që erdhën pas tij, paralajmëronin shfaqjen e Poetit...”

Fjalët e fundit Nimanit i erdhën të ftohta dhe gjithë dridhërimë. Mbylli sytë dhe një copë herë u shoqërua me terrin që ia krijoi vetes. Kur u përmor, pa portretet në mur që rrinin si të ngrira, tepër të ftohta, të shoqëruara me heshtjen shurdhe, të njëjtë me atë që hasi kur hyri. Në atë përpëlitje desh ta pyeste Kronistin për atë kohën dyqindvjeçare, që ai i quajti kohë të përpëlitjeve të brendshme, por hetoi se ishte vetëm fillikat dhe se aty ku mendja ia thoshte se pak më parë rrinte dhe fliste ai, ndodhej vetëm tavolina e drunjte me plot e përplot kronika përmbi. Fërkoj sytë disa herë, si të kërkonte të hiqte mjegullimin që iu duk se i qe shfaqur para, por prapë iu shfaqen librat e trasha dhe portretet në mur. Asnjë gjurmë dhe asnjë shenje e skenës së pakmëparshme dhe atyre që ndodhën. Ç’përftime ishin ato vallë, deshi të thoshte, por hetoi se kokës së tij serish po i riktheheshin pjesëzat e Sarajit të praruar me njëfarë si ngatërrimi të çuditshëm, ku kishte nga të gjitha nga pak prej nga e djeshmja i vinte si e tashme dhe e tashmja si e djeshme në të sotmen e nesërme... Ky pështjellim po ia merrte mendjen dhe po ia shtonte turbullimin, kështu që për t’i ikur më të keqes mbylli sytë me duar dhe ndolli një terr të thellë me shpresën se mbase njëherë e përgjithmonë, në një kohë të ngrirë, do të mbytej ajo përzierje sfilite e të panjohurave dhe e paqartësive... Megjithatë, tek po merrej me kohën e ngrirë dhe përfytyrimin e saj, ku ajo humbte përmasat dhe kthehej në një rreth të mbyllur, hetoi formësimin e një libër të trashë, që po i hapej ngadalë dhe ai libër, për habi, shkronjat i kishte të ndritshme, që shquheshin dhe si të tilla ia pushtuan mendjen sakaq...

(Koha e dyqindvjeteshit dhe Libri shtesë i Kronsitit Seljadin)

„Sanxhakbej Ali Evrenozi rrinte në tendën mavi dhe pinte shurupin e freskët. Nga mendja po i shquheshin relievat e ashpra ku ndërroheshin pareshtur malet, bjeshkët, grykat e zeza e lumenjtë që herë gumëzhnin e herë treteshin si t'í kishte përpirë toka. I bëhej se lundronte në atë ngatërrim me bindjen se sillej nëpër një vend mashtrimtar, që njëherë mund ta përpinte pabesisht... Ky mendim e frikësoi dhe dëshiroi ta flakte sa më parë, gjë që e shtyri para kohe të thërriste Kadiasqerin t'í raportonte. I veshur me të zeza dhe veladonin që i rrinte si hije, Kadiasqeri dukej i frikshëm, i njëjtë me kufomën. Madje, një çast, iu bë se përpara kishte një të vdekur... Ç'është e vërteta çastin që e emëruan sanxhakbej të *Tokës së Lashtë* i shkoi mendja se atij vendi medoemos i duhej një mumie e tillë, që sjell shqetësim të përgjithshëm dhe frikë deri në palcë. Por, tash, që po i rrinte përpara dhe priste urdhrin për të folur, iu duk si vetë kobi, që po e ndiqte kushedi sa kohë, nga i cili nuk kishte shpëtim...Në atë përballim të ftohtë, pa dashas preku fytyrën, pastaj sytë e lodhur që iu mbyllën, gjë që e gjitha iu kthye në një terr të mistershëm, ku i bëhej se sharronte bashkë me Kadiasqerin dhe bashkë me ta përmyteshin edhe taborët e ushtrisë, përmyteshin edhe topat e rëndë që kishin me vete dhe po sharronin edhe tendat e panumërta, të cilave u shiheshin vetëm flamujt me shtizat e thyera, sipër të cilëve kullonte njëfarë gjaku i trashur... Ky përfitim e trishtoi aq shumë sa me nxitim hoqi duart nga fytyra, e fërkoj atë disa herë dhe pasi kërciti gishtat, u ngrit rrëmbimshëm dhe u soll nëpër tendë pa ditur se çfarë kërkonte.. Të gjitha këto i vërejti Kadiasqeri finok, i cili hetoi çastin se duhej të fliste, pa marrë parasysh gjendjen e tij, që pasqyronte një shqetësimi të thellë që po i vinte nga brenda. Kështu që fare prajshëm nisi të fliste se si rrethimi ishte krye pikërisht ashtu siç ishte paraparë bashkë me ndërmarrjen e masave të tjera që po ashtu ishin paraparë dhe lejuar prej tij... Kadiasqeri tha edhe disa gjëra të tjera që ai nuk ua vuri veshi, por që i erdhën si vërshëllima.

Sanxhakbeu një copë herë u soll pa cak, e pastaj pasi u kthye në shilte dhe mbajti shikimin jashtë, sikur t'í ishte kujtuar diçka që po e kërkonte, pyeti rreth telasheve me të cilat ishte ballafaquar.

Kadiasqeri bëri të ditur se ushtria i ishte afruar Kështjellës nga ana e lumit dhe nga ana e kodrinës, ashtu siç ishte paraparë dhe se kur ishin bashkuar te ana ballore, për ta krijuar gjysmërrëthin e nevojshëm, zogu i zi në shtizën e lartë në majte të pirgut i ishte dukë i përgjumur. Kadiasqeri vazhdoi të fliste si zogut të zi gjatë ia kishte përcjellë valëvitjet dëshpëruese për të shtuar më tutje se me padurim priste çastin kur ai shpend ogurzi njëherë e përgjithmonë do të shembet nga ajo lartësi për t'ia lëshuar vendin flamurit perandorak, i cili duhej të mbetej aty për jetë të jetës.

„Aktet e tilla i pres me padurim dhe më bëhet zemra mal kur shoh se si, një nga një, stemat, emblemat, flamujt dhe shenjta e tjera të princërve të mundur përgjithmonë ua lëshojnë vendin shenjave tona“, shtoi Kadiasqeri, i cili përkujtoi se nga çasti kur princi-vasal do të ulë flamurin e vet, fillonte një kohë tjetër, koha e Perandorisë së madhe, me të cilën në këtë pjesë të botës do të mbizotëronte madhështia perandorake me ç'rast njëherë e përgjithmonë merrte fund herezia e laramanisë...

Dukej se fjalët e fundit Sanxhakbeut nuk i bënë gjithaq përshtypje dhe as që la për të kuptuar se ato e ngazëllenin, siç do të pritej në rastet e tilla. Madje, i mbërthyer nga një sëmbim i brendshëm, që ia ndrydhte çfarëdo vullneti për kremte, nuk ua vuri fare veshin atyre që Kadiasqeri po ia thoshte rreth veprimeve që duhej t'í bënte Princi vendas gjatë ceremonialit të ngritjes së flamurit perandorak, që shoqëroheshin me pranimin e kartës së vasalitetit të përhershëm. Sikur ta hetonte këtë, Kadiasqeri ia përsëriste të gjitha një për një dhe sa herë që e bënte këtë, ngrinte zërin, saqë atij i dukej se nga jehona përplasëse do t'í pëlçiste koka...

„Tash e tutje, në këto anë, do të dëgjohen vetëm këngët perandorake, do të dëgjohen vetëm ato dhe asgjë tjetër...“

Në kulmin e asaj që iu duk si çirrje e padurueshme, Sanxhakbeu dha shenjë se biseda kishte marrë fund. Tha se i duhej pushimi dhe uli kokën që të mos e shihte më në fytyrë

Kadiusqerin, ngase kishte frikë prej përfutimit të pakmëparshëm, kur ai hyri në tendë dhe iu duk si kufomë. Por, sado që nuk e pa kur u largua (veç ia dëgjoi hapat, ata hapa me të cilët ishte mësuar tash e sa kohë), aty për aty, mendja ia krijoi pamjen e një kufome të mistershme që lëvizte e mbështjellë me veladon të zi dhe se në atë lëvizje ajo kapte yje, i shuante dhe ashtu të shkrumbuar i ngarkonte mbi krahët e zezë. Iu bë se kufoma, që ishte rritur e zmadhuar së tepërmi, po i sulej tendave përreth Kështjellës. Një klithje e thekshme i shpëtoi Sanxhakbeut dhe ajo ishte aq e fuqishme sa bëri që kryeroja që rrinte në paradhomë të hynte me nxitim. I përballuar me shikimin kureshtar të kryerjes, që po i rrinte pranë si i ngrirë, desh ia bëri me dije se prapë e kishte munduar përfutimi i ligë, të cilit ia pati frikën.

Për t'i ikur shfaqjes së sërishme të ligështimit, urdhëroi t'ia sillnin klarinetistin plak.

Kur hyri plaku me klarinetë, Sanxhakbeu po rrinte i kërrusur dhe po merrej me ligështimin, që kohëve të fundit gjithnjë e më shumë i qepej. Plaku e dinte se çfarë duhej të bënte dhe, aty për aty ia mori një melodie nga ato që i pëlqenin Sanxhakbeut kur ndjehej i shqetësuar. Tingujt e klarinetës filluan ta mbushnin tendën me ngrohtësi dhe ai ngadalë po lirohej nga mërdhitja që e kishte pushtuar, kështu që pas pak mori tespihet e qelibarit, të cilët nisi t'i luante plogësht, thuajse gjithë forcën ia kishte thithur heshtja përreth që thyhej nga melodia e klarinetës. Ishte hera e parë që koha njëditëshe para marrjes së kështjellës i ishte kthyer në një shqetësim të ethshëm, për të cilin nuk kishte shpjegim. Ç'është e vërteta, gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të fundit, ai kishte marrë në dorëzim shumë kështjella (disa në Rumeli, dhe një në Greqi), ndërkohë që princat e tyre kishin pranuar vasalitetin, por nuk i kishte ndodhur që para apo pas ceremonialeve të ngjashme të shqetësohej apo të ligështohet sa të kërkonte shpëtim nga klarineta, që e donte aq shumë dhe përherë e merrte për plotësim të haresë e jo për të kundërtën... Përkundrazi, në ato raste ndjehej i fortë, krenar dhe mbi gjithë botën dhe uronte që çastet kur princat e mundur ndër beteja, apo ata që e lutnin për paqe, (ngaqë e dinin se nuk kishin nga t'ia mbanin), të ishin sa më të shpeshta dhe sa më të hareshme...

Të tillë e paramendoj edhe çastin e marrjes së Kështjellës së tanishme. Bile kur e njoftuan se emërohej sanxhakbej i *Tokës së Lashtë* (bashkë me sqarimet plotësuese se një pas një do t'i merrte edhe kështjellat tjera që shtriheshin deri atje ku puqej kufiri i devotshëm i dy botëve, i Lindjes dhe i Perëndimit, u ngazëllye sakaq, sepse e dinte se tutje-tëhu shtrihej bota për të cilën flitej tash e sa kohë se pa të Perandoria „ishte e gjymtë...“, gjë që kjo ia forconte bindjen se të jesh sanxhakbej i sanxhaqeve të mesme, që kufizoheshin paqësisht me njëri tjetrin, ishte njësoj si të rrijë kot një shtrat të përgjumur. Andaj, lajmi se do të qeveriste sanxhakun e skajshëm, aty ku kishte arritur pushteti perandorak me aq mund e prej nga duhej të bëhej ajo kthesa e vetme madhështore, ia regëtiu shpresën se nuk do të zhytej në ndonjë gjumë të thellë shumëvjeçar (siç i ngjau gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të fundit), por doemos do të ndodhej në qendrën e vlimeve prej nga do të kthehej në krye të asaj lëvizjeje... E kjo do të thoshte shumë, tepër shumë, ngaqë i binte barra por edhe nderi që t'ia thyente asnjësinë hapësirës ku me shekuj ishin fërkuar besimet e kundërta dhe ishin ndeshur dhe varrosur perandoritë e panumërta, të cilat sikur aty dhe në atë vend duhej pashmangshëm të ndaleshin dhe të shuheshin madje pa qenë në gjendje që barrën ta hidhnin në pjesën tjetër...

Sado që aty tashmë nuk kishte luftë dhe gjithçka i ishte nënshtruar një heshtjeje shurdhe, Sanxhakbeu e dinte se nyjat e ambicieve të ndryshme aty gjithmonë qenë pleksur e nuk do të shplekseshin kurrë qoftë edhe me mashtrime, dorëzime të kështjellave apo me pranimin e vasalitetit, siç ishte rasti i fundit pa ndodhur që prej andej të shkulej mendimi heretik, që ishte futur thellë tek secili bashkë me bindjen se bota ishte e ndryshueshme, se perandoritë medoemos duhej të mbeteshin të përkohshme dhe përherë të paafta të shlyenin kufirin që i ushqente dallime dhe skajshmëritë... Një njohës i rrethanave të përgjithshme i kishte thënë se në atë vend, asnjëherë nuk ka pasur paqe dhe as që ndonjëherë do të ketë, nga shkak se aty lufta shikohet si paqe dhe paqja si luftë, përherë të ndërlidhura që të mos mbizotërojnë as gjendja e parë dhe as e dyta, por një ndërmjetësi e çuditshme që do ta ruante

baraspeshën e të kundërtave... Ai i kishte thënë se mbase ishte pikërisht ajo paraqitje që at vend e kishte kthyer në një nyje të puqjeve të pabesueshme, ku edhe fillimi ishte fund dhe fundi fillim njëherësh, ku ajo që diku niste si një vlim rrëmbyes aty patjetër soste në kahen e kundërt, e ku gjërat merrnin përherë kuptime të reja, të shumtën pajtuese, pa marrë parasysh qëllimin e nismës... Në atë vend, i kishte thënë njohësi i rrethanave, fama është kob dhe kobi është famë...

Ballafaqimi me këtë mendim, në vend që t'i sillte të dridhura, siç i kishte sjellë çastin që njohësi i rrethanave ia kishte bërë me dije, sikur nisi ta ngushëllonte dhe i erdh mirë që kjo po ngjiste kur ndodhej para thyerjes së pashmangshme. Nyja e botës, pëshpëriti... Nyja e botës?... Aty edhe shembja është ngritje... Sa lartë e sa poshtë?... A nuk është kjo e madhërishtme?... Këto mendime po e mbërthenin fuqishëm, ndërkohë që melodia e klarinetës iu bë më e gjallë, më përshkruese dhe më domethënëse saqë uroi që koha të ecte më shpejt, në mënyrë që drita aty për aty ta zëvendësonte natën e me këtë të vinte çasti kur do ta merrte në dorëzim Kështjellën për të cilën tashmë ishte i bindur se ishte më e rëndësishmja e Perandorisë së pafund, që gjithsesi do të lidhej fund e krye me emrin e Ali Bej Evrenozit...

Dhe ashtu i shpërqendruar siç ishte dhe i bindur se e kishte përballuar shqetësimin e madh, me të cilin ishte ballafaquar atë kohë të fundit, Sanxhakbeut përpara çuditërisht i ishte qepur një faqe e madhe e historisë, si një fletë përrallore, ku shkronjat e panumërta ngatërroreshin e ngatërroreshin shthurshëm duke spikatur në të gjitha anët lavdinë e tij, atë lavdinë e madhe që do të shndriste në të gjitha anët e vendit... Iu bë se emrit të tij po i përkuleshin të gjithë me radhë ngado dhe kudo gjithandej kah shtrihej bota e pafund perandorake dhe se kulmi i lavdisë do të kurorëzohej çastin kur do të ecte nëpër qilimin e kuq, që po e priste para Sarajit të praruar... Në atë hakërrim ai përfytyronte fishekzjarrë, përfytyronte jeshillëk të pafund si një det mbi të cilin fluturonte me anën e krahëve të bardhë që i ishin qepur...

Nga ai mbërthim doli vetëm atëherë kur hetoi se po agonte. Fërkoj sytë dhe pa klarinetistin plak si kotej me instrumentin e lagur pranë... Pa se dita hynte e gjymtë dhe kjo i solli të dridhura të shumta...

Jehona e daulleve, megjithatë, në tendë hyri me rrezen e parë, atëherë kur Sanxhakbeu ende nuk i ishin shqitur fijet e mendimeve të shkapërderdhura dhe ato i erdhën si ogur i lig. Në e parë mendoi se edhe ato qenë pjesë e atyre që e rënduan gjatë natës, por shpejt kuptoi se oguri po shtohet e po shtohet sa çdo pjesë e tendës, që po i ngushtohet, i shfaqet si pjesë e një humnere që po e priste ta përpinte... I bartur nga ndjenja e rrënimit deshi të ikte nga tenda dhe gati po nisej kah dalja, por ishte fytyra e zverdhur e Kadiasqerit, që po i rrinte si mumie, që e ndali.

-Ç'është kjo gjëmë - pyeti Sanxhakbeu, pa qenë në gjendje të përmbledhte shqetësimin që ia pasqyronte i gjithë trupi.

-Po bien daullet e tyre,- foli Kadiasqeri qetas duke bërë me dorë kah Kështjella.-Dhe kjo do të thotë se ata shkelën marrëveshjen?

Sanxhakbeu ende nuk e kishte marrë veten, ndonëse përpiquej të qartësonte ato që dëgjoji rreth thyerjes së marrëveshjes.

-Në marrëveshje shkruan se me rastin e dorëzimit, pra të marrjes së Kështjellës, nuk guxojnë t'i prekin armët dhe daullet.

-Do të thotë se marrëveshja është thyer?...

-Mund të thuhet edhe kështu, sado që, në raste të tilla, ka disa çështje që megjithatë u takojnë atyre përjashtimeve që nuk çojnë kandarë...

Sanxhakbeu nuk shtoi tjetër, pos që la për të kuptuar se kërkonte sqarime të menjëhershme.

- Fjala është për ca zakone që ata mendojnë se nuk u nënshtrohen marrëveshjeve, - foli me maturi. -Ndër to bien edhe daullet, të cilat i mbajnë pranë gjatë gëzimeve dhe

hindhërimeve... Çastin që e marrim Kështjellën, të parën gjë që mund ta bëjmë nisim luftën kundër adeteve të tilla sa t'i bëjmë që të heqin dorë prej tyre... Për këtë kemi kohë...

-Kohën e kemi për të luftuar përtej, e jo për t'u marrë me dokrrat...

-E qartë, madhëri... Nuk duhet t'ua vejmë veshin të gjitha cikërrimave, por gjithsesi se në kalim e sipër edhe ato nuk duhet t'i lëmë manash. Tek e fundit, imtësitë përherë u shërbejnë si shkas veprimeve kryesore...

Sanxhakbeu për pak u mendua dhe thajse fare papritmas urdhëroi kalljen e çallgive.

-Le ta shqyejnë qiellin,tha.

Kadiasqeri nxitoi me sa i hanin këmbët të kryente urdhrin, ndërsa Sanxhakbeu u përpoq që me zhurmën e çallgive, që filluan të binin nga të gjitha anët, ta qetësonte peshën e zemrës së sflitur, që i solli jehona e daulleve, që vinte nga Kështjella. Por, për habi, sado që fuqia e çallgive ishte e madhe, tepër e madhe dhe ishte kthyer në një uturimë shurdhuese, i bëhej se ato ishin të pafuqishme ta mbulonin jehonën e daulleve, që shpërndahej nga lart. I lemerisur, urdhëroi që çallgive t'u bihet edhe më shumë. „T'i kallni, t'i kallni“! tha edhe atëherë kur Kadiasqeri ia bëri me dije se kishte kohë që tamtamet e mallkuara nga ana e Kështjellës nuk dëgjoheshin më, se ato kishin tretur fare bashkë me ata që u binin. Por, Sanxhakbeu gjithë tërbim shfreu se tamtamet shungullonin, se ato nuk kishin prajtur dhe nuk do të pranin përderisa të bëheshin copë e grimë, një nga një dhe bashkë me ata që u binin... Me një zë që i dridhej, Kadiasqeri nisi t'i thoshte se për t'u kryer urdhri i tij do të kryhej, por që duhej pritur, së paku deri sa Kështjella të merrej sipas marrëveshjes, sepse në të kundërtën punët do të ngatërroheshin sa të kishte pasoja të padëshirueshme... Për të qenë më bindës, Kadiasqeri bëri të ditur se nga Kryeshehri kishte marrë udhëzime plotësuese se aty-këtu mund të lëshohej pe nëse vlerësohej se çështjet pa arsye mund të merrnin nën udhë... “Tek e fundit, këtu nuk jemi sot për sot, por për gjithmonë, që do të thotë se duhet mësuar edhe me ndonjë lajthitje të vogël, që nuk bie ndesh me qëllimin e përgjithshëm...”

Pandehma se raste të tilla mund të përsëriteshin dhe ato duhej marrë si të natyrshme, e që për to ishin dhënë edhe udhëzime plotësuese pas shpinës së tij, e bëri të dridhej gjithë tërbim e përcjellë me një shtrëngim, që iu ngjit në fyt çastin që nëpër kokë nisi t'i sillej një si kërcënim, që dikur kishte dëgjuar rreth asaj se aty ku ngatërroheshin vijat e botës nuk kishte tjerë pos të ngjitesh shtatë pash lartë apo të biesh shtatë pashë poshtë...

Të menduarit rreth ngritje-rënies fatale, që ishin pjesë e të njëjtës, gjatë iu qep në kokë si një vërtitje shungulluese, që dalëngadalë nisi t'ia krijonte përshtypjen se tamtamet e daulleve dhe jehona e çallgive, që pamëshirshëm kishin mbushur gjithë hapësirën përreth me një orgji të papërmbajtshme, ishin të domosdoshme dhe gjithsesi se i shkonin gjendjes, ku të kundërtat me përjashtiminë, bashkëjetonin madje. Ai mendim i papritur, që nuk diti ta shpjegonte pse e mbërtheu ashtu që çështjet t'i shohë në kahen e përputhje-shpërputhjeve, në vend se të ishte e kundërta, çuditërisht zuri t'ia ushqente bindjen se mbase *dysia*, qoftë si mendim apo si qëndrim i thjeshtë, jo vetëm që plotësonte baraspeshën që i duhej pushtetit për t'u mbajtur, por edhe e forconin atë, si të mbikëqyrur... Trysnia e këtij gjykimi mbase bëri që mesokohën e pritjes së marrjes së Kështjellës ta kalonte në një gjendje fare të qëndrueshme, thajse përpara kishte aktin e pranimit të të kundërtave deri në skajshmëri dhe jo çastin kur përballë bindjes perandorake, ato shpalleshin heretike... Megjithatë, e gjitha mori fund, kur në atë fashë hetoi se si nga pjesa e hyrjes po i shfaqeshin vijat e hijes së Kadiasqerit, e cila, e zgjatur tej mase dhe përdredhëse, po i afrohej për t'ia bërë me dije se fillonte koha e marrjes së Kështjellës, një formalitet, që atij iu duk si një hyrje drejt një mjegullimit dhe gjithë asaj që nuk mund ta kuptonte, aq më pak ta shpjegonte apo ta pranonte...

Kur doli jashtë, dielli i vrau sytë dhe kjo mjaftoi që përpara t'i ngjitej një perde, që aty për aty sendet dhe njerëzit ia ktheu në trajta të shpërqendruara, që sakaq u bënë pjesë e ngatërimit që po i shfaqej. Kështu që, në vend të atyre që po i përkuleshin nga të dy anët, (që në të vërtetë ishin ushtarët e rreshtuar), ai shihte hije të shthurura, që ngatërroheshin dhe

zgjateshin drejt një grumbulli tjetër vijash, të cilat po ashtu thyheshin tek një pikë, që ishte i bindur se paraqitnin Kështjellën... Një kohë të gjatë gjërat i pa ashtu të përdala dhe jashtë njëmendësisë, por dikur, pak nga pak, ato zunë t' i ndreqeshin, dhe para se të bëhej kjo, pra të ndodhte kapërcimi nga njëra gjendje në tjetrën, mesokohën e ndjeu të përmbushej me një shqetësim ndjellakeqes, që befas iu vërtit çastin që po i afrohej shkallores së Kështjellës, mu aty ku qe paraparë Princi t'ia dorëzonte çelësat e Kështjellës, e ai t'ia jepte kartën e perandorisë, që për Princin do të thoshte hyrje në vasalitet të plotë, ku principata e tij i humbte kufijtë që kishte dhe përfundimisht shkrihej në hapësirën e madhe perandorake, bashkë me ata që nuk ishin më...

I liruar nga ngatërrimi i pakmëparshëm dhe ajo ndjenja e gulçit, më kot po i kërkonte kështjellarët me rroba solemne dhe me lule në duar, tek po pritnin t' i dëshironin mirëseardhje nga të dy anët e shkallores. Në vend të tyre po i hapej një zbrazëti e frikshme, që muret e ftohta e bënë edhe më të theksueshme. Mendja i shkoi te ndonjë befasi, që ia përgatisnin ata, të cilët kalonin në vasalitet të përhershëm. Iu kujtua se kur e pat marrë kështjellën e dytë me radhë (diku në Rumeli), pati përjetuar çaste shqetësimi të përkohshëm, ngase ata që duhej t' i dilnin përpara në kohën dhe vendin e paraparë nuk po i shihte. U desh të bënte edhe njëmbëdhjetë hapa të tjerë (jashtë marrëveshjes) dhe qe gati të pyeste se çfarë po ndodhte, kur nga pjesët e fshehura të mureve, dolën ca vasha të veshura me të bardha, me lule shumëngjyrëshe, që prej tyre sakaq, gjithë shkathtësi formuan një kurorë të madhe, të cilën ia vunë mbi kokë. Pastaj iu shfaqën edhe të tjerët, të cilët u përkujdesën që rrugën deri tek vendi i dorëzimit të Kështjellës ta bënte mbi lule që kundërmonin këndshëm... I shkoi mendja për një kurorë të ngjashme dhe për ato që do të pasonin... Në atë përfytyrim iu duk se i madh e i vogël po bëheshin gati ta prisnin dhe ta përshëndesnin me sa zë kishin, si një shpëtimtar, që do t'ua hapte dyert e mrekullisë... Por, kur po merrej me shqetësimin e të papriturës dhe ato që do të ndodhnin, nuk diti as vetë pse parandjeu shfaqjen e surratit të Kadiasqerit dhe përfitim prej kufome? Dhe njëmend nuk kaloi shumë (pasi iu afruar pjesës ku zgjerohej shkallorja dhe fillonte ngushtica që shpinte kah porta e Kështjellës), hetoi Kadiasqerin me atë pamjen e ftohtë dhe shikimin e ngrirë, që mendja ia tha se paralajmëronte diçka të ligë. E vërejt qortueshëm dhe deshi ta flakte prej shikimit, por ndjeu si ai nisi t' i thoshte diçka që koka ia zuri me vështirësi, por që bënte fjalë për një mashtrim, që kishte ndodhur... Sanxhakbeu mbeti si i ngrirë dhe përkundër aktrimit të mospërfilljes, la për të kuptuar se kërkonte sqarime të mëtutjeshme, sado që ato me dëshirë nuk do t' i dëgjonte. Kjo bëri që Kadiasqeri të ngushtohej dhe të ndjente njëfarë mbërthimi të brendshëm, që e pengonte të përsëriste ato që kishte thënë pak më parë... Dikur megjithatë ia doli të ndërlidhte ato që flisnin për një mashtrim, që nuk e qartësonte dot, por që gjithsesi tha se duhej dhënë një kundërpërgjigje të fortë dhe të menjëhershme, që vasalëve do t' u shërbente si mësim i mirë për mot të moteve... Ai madje nxori fjalën gjak, që iu ngjiz për gjuhe dhe i mbeti e trashur, sikur ta kishte zënë ngulfatja e derdhjes së brendshme.

Sanxhakbeu e la Kadiasqerin në atë gjendje të turbullt dhe u nis me të shpejt kah porta e madhe e Kështjellës, pa çarë kokën fare as për ato që deshi t'ia thoshte oficeri i sigurimit lidhur me rreziqet që aty paraqiste ecja vetëm, para të tjerëve. Oficeri i sigurimit, që e dinte mirë punën e vet, nuk u nxu ngushtë e as që u ndal, por u dha urdhër truprojave, që të nxitonin nga të dy anët për të parandaluar të papriturat, duke ua bërë me dije se kishin për detyrë të pamundësonin çfarëdo lëvizjeje në atë hapësirë pa marrë parasysh ato që duhej të përdoreshin... Kundruall masave për të cilat nuk i hante palla, Sanxhakbeu, që i dukej se qante ndonjë fërfëllizë, si të ishte hije, filloi rrugicave të zbrazëta, gjithnjë me bindjen që sakaq iu qep se ashtu dhe në at gjendje po i afrohej një akullnaje, ku merrte fund diçka, që kishte parandjenjën se lidhej me përfytyrimin e ogurit të ligë, që i ishte përplasur çastin që Kadiasqeri i kishte folur për gjakun, që duhej derdhur sa më parë dhe doemos... Vetëm kur iu afrua portës së madhe, që sa s' e preku me fytyrë, u ndal dhe mori frymë thellë, sikur të dëshironte të lirohej sa më parë nga shtytja e ngjijtes drejt majës së akullnajës, që iu duk

tepër e frikshme nga shkaku i parandjenjës se e gjitha duhej të përfundonte me rënie të pashmangshme çastin që do të arrihej pika më e lartë. Në atë shtangim përpëlitës, i përfutur mendimi se sa mashtrimtare ishin ceremonialet e marrjes së kështjellave, kur zhvilloheshin nga gjoja marrëveshjet midis fitimtarëve, që synonin vendosjen e pushtetit të pakufishëm dhe vasalëve, që pranonin gjendjen e nënshtrimit, të bindur se me përshtatje do të mbijetonin disi, që do të thoshte se edhe fitimtarët e edhe humbësit nuk u besonin marrëveshjeve, ndërkohë që pa i nënshkruar mirë përqendroheshin për t'i kundërshtuar dhe për t'i ndryshuar secili në mënyrën e vet... Ky mendim nuk e shqetësoi, pos që i solli njëfarë qartësie, që mbase do të duhej ta kishte parasysh qysh me rastin e marrjes së kështjellës së parë për të flakur besimin se fitimtari ishte vetëm fitimtar, ndërsa humbësi vetëm humbës i nënshtruar. Mendja ia tha se edhe fitimtari, edhe humbësi, përherë i nënshtroheshin trysnisë së ndryshimit të gjendjes në kahet e kundërta, ku raportet fitues-humbës dhe humbës-fitues përcaktoheshin në përputhje me lëvizjen e fuqisë apo fuqinë e lëvizjes dhe assesi ndryshe... Ky gjykim sa ora ia përjashtoi mllëfin, të cilit i ishte nënshtruar pak më parë dhe sikur e ktheu tek njëmendësia, që megjithatë, në ato rrethana, iu shfaq e trishtë dhe e përmbushur me ndjenjën e një çorientimi të pakapshëm, që po i sillej vërdallë dhe nuk ishte i sigurt se kjo kishte të bënte me mospraninë e princit vasal dhe asaj që lidhej me ceremonialin e marrjes së Kështjellës, apo e gjitha ishte pjesë e ballafaqimit me të vërtetën e papërcaktuar, që do të mund të merrej edhe si mendim, e cila shfaqej për të përmbushur atë, që ndodhej midis lëvizjes së fuqisë dhe fuqisë së lëvizjes, brendapërbrenda së cilës pastaj ndërtoheshin pleksjet tjera, me të cilat synohej që pikëpjekjes mos t'i ndryshohej rrezja e veprimit, që i duhej *Tokës së Lashtë*, e që hapësirës përreth ia kishte dhënë pietetin e nyjës së botës, ku fillimi ishte fund dhe fundi njëherësh ishte fillim bashkë me pashmangësinë e përsëritjes së të njëjtës...

Ishte gati t'i jepej kësaj mëdyshje, që edhe më tutje të rremonte në të, po mos të ishte përfuturi i një legjende të dëgjuar moti, në të cilën flitej për shpirta, që bredhin pandalshëm dhe përmotshëm, duke u kthyer nga qenia në send dhe anasjelltas, me ç'rast sikur edhe gurtë, edhe urat, dhe kështjellat madje marrin frymë dhe ngjethen që edhe jeta e edhe vdekja ngatërroheshin aq shumë sa ndodhte se ato ishin të vdekshme dhe të jetshme njëherësh, e që pasqyrimin më të ankthshëm e gjenin në legjendën ku në një kalë bashkërisht kalëronin pandalshëm jeta dhe vdekja... Atëbotë i qe turbulluar mendja keqas, e njëjta po i ndodhte edhe tash kur po rrinte si i ngrirë para portës së madhe dhe po priste që të ndodhte diçka, çka do qoftë, që do ta nxirrte nga mendimi rrëqethës rreth makabritetit, ku njeriu mund t'i shfaqej në të njëjtën kohë në të dy gjendjet: i gjallë dhe i vdekur, pa ditur me tamam se me ke ka punë. Punë djalli kjo, deshi të thoshte, por u frikësua nga pandehma me të cilën pranohej fuqia e tjetrit, pra atij që pranonte vasalitetin me të cilën ndërroheshin rolet midis fitimtarit dhe të mundurit... Në të vërtetë, ndjeu se kjo tashmë kishte ndodhur, se ai i ishte nënshtruar asaj loje dhe se e gjitha duhej të paraqiste njëfarë parapërgatitje drejt të kuptuarit të kësaj njëmendësie, përkundër asaj që ai nuk duhej ta pranonte atë kurrë, qoftë edhe me çmimin e një aktrimi që duhet ta bënte përherë... I bindur se ndodhej në kthetrat e një mashtrimi prej nga nuk kishte nga ia mbante, por që duhej të shkonte deri në fund, Sanxhakbeu deshi t'i kthehej njëmendësisë, pra për të kapërcyer derën kryesore të Kështjellës, por hetoi njëfarë shtangimi, që e mbante si të ngrirë. Kjo i solli të dridhura, që tashmë kishin zënë t'i shqetësonin edhe ata që i rrinin pas dhe prisnin ta bënte hapin vendimtar, me apo pa Princin. Bile, Kadiasqeri, njëherë u mat t'i thoshte se duhej të hynte sa më parë atje për ku ishte nisur, ngaqë koha e marrjes së Kështjellës po kalonte. Megjithatë, Sanxhakbeu e kaloi portën e madhe vetëm atëherë kur ishte i bindur se, sado që nuk e shihte Princin, ai ishte me të dhe po e shoqëronte qysh para shkallës së madhe... Atij që pak më parë i dridhje trupi dhe fytyra i shfaqte një ngrirje të frikshme, befasi i ishte kthyer çehurja bashkë me ecjen e rëndomtë e krenare madje, që i përgjigjej ceremonialit të marrjes së Kështjellës. Ky kapërcim, megjithatë, nuk e kishte liruar nga mpirja e brendshme, e as nga veprimet e paqarta, të cilat Kadiasqeri i kishte cilësuar si të habitshme, veçmas ato që lidheshin me përfutimin, siç ishin ato kur në shesh nisi të fliste

sikur të kishte përpara masën e vasalëve dhe jo vetëm disa pleq të rralluar mendsh, apo kur iu dha aktrimi të marrjes së stemës dhe emblemës së kështjellës nga ana e Princit, që nuk ishte. Kështu, siç kishte vepruar edhe me rastin e marrjes së dy kështjellave të tjera, së pari qëndroi gatitu, pastaj shikoi djathtas e majtas (sikur t'ia kishte vasalët përpara) dhe me hap të rëndë u nis drejt pjesës ballore të sheshit, aty ku kulla e Princit dukej e shkretë, pa stemë, pa emblemë dhe pa flamur... Foli me vete, herë duke ngritur zërin, e herë duke shtruar ndonjë pyetje pa marrë parasysh që nuk merrte përgjigje, që lente për të kuptuar se bashkëbiseduesin e përfytyronte pranë si bashkëveprues...

Sorollatjet e Sanxhakbeut dhe stepja e atyre që i rrinin pranë vazhduan deri sa dielli iu afrua majës së malit dhe rrezet e tij e humbën dritën që kishte deri më atëherë. Atë çast Sanxhakbeu kërkoi t'ia sillnin flamurin e Princit para se ta ngrihte atë perandorak. Kadiusqeri, që deri atëherë kishte heshtur i brengosur, u zu ngushtë. Si t'ia thoshte Sanxhakbeut se Princi e kishte marrë me vete flamurin bashkë me stemat dhe emblemat? Si t'ia bënte me dije se shtiza ishte e shkretë që nga mëngjesi i asaj dite ogurzezë?... T'ia thoshte të vërtetën, druante se ai prapë do të bënte sikur shihte flamurin dhe do të kërkonte me këmbëngulje ta përdhoste. Çfarë të bënte, pra? Për herë të parë mallkoi fatin e zi që ishte ngritur në atë post për të përcjellë titullarë të lartë, ambiciet e të cilëve, drejt lartësive, jo rrallë kthehen në ankthe të papara... Ajo dilemë sa vinte e i përpushej nga brenda dhe ai nuk gjente derma. Pas një hamendje, pa dhënë shpjegime, foli e tha se Princi nuk ishte aty, siç nuk ishte as stema, siç nuk ishte as emblema e nuk ishte as flamuri...

-Princin e kamë pranë,- ia ktheu Sanxhakbeu.-Princi po më shoqëron. Nuk e sheh se sa i dëgjueshëm është?...Gjithnjë do ta kem pranë...

Sapo i tha këto, që Kadiusqerin e mbërthyen me dridhërima të fuqishme, Sanxhakbeu vazhdoi të bënte sikur fliste me Princin, të cilit po i thoshe se do të shkonin bashkë të njëjtës rrugë drejt majës së akullnajës... Nuk do të ndahemi dot, po i thoshte...Sepse, kemi të njëjtat qëllime dhe të njëjtin fat...

Pak më vonë, megjithatë kërkoi t'ia sillnin flamurin e Princit dhe tha se ai duhej të mbetej aty ku ishte, bashkë me atë perandorakun. I bindur se atë e kishte në dorë, Sanxhakbeu iu drejtua shtizës së flamurit dhe bëri të ngjitej në të, sado që ishte e qartë se e gjitha do të përfundonte me një plandosje të shpejtë, që kështu edhe kështu ndodhi... Ajo që ngjau pastaj ishte më së nënçmuese jo vetëm për Kadiusqerin, për ushtarakët e lartë dhe shoqëruesit tjerë, por edhe për vetë Sanxhakbeun, i cili çirrej, çapitej dhe qante njëherësh...

Sanxhakbeu doli nga akthi diku nga mëngjesi. Kur drita e gjymtueme i preku fytyrën, kërkoi ujë. Mandej, Kadiusqeri, si t'ia fliste një të huaji, i tregoi një nga një rreth asaj si Princi kishte thyer marrëveshjen duke marrë me vete stemat dhe flamurin dhe i tregoi për repartin ndëshkues që e kishin nisur me të vetmin qëllim për me e zanë sa më parë dhe ta sillte të lidhur përmes principatës, por që mjerisht, ata nuk ia kishin dalë këtë ta bënin, ngase askush nuk ua kishte thënë asnjë fjalë për ecejaket e tij, pos që dikush nga ata të njësisë së gjurmimit, si në mjegull i kishte thënë se mbase Princi bashkë me kapedanët, bujarët dhe me flamurtarët besnikë ishte nisur kah Kështjella e skajshme për të hapur një luftë të re... I tregoi më tutje për hyrjen në Kështjellë, i foli për ata pak veta që i kishin gjetur (kryesish pleq, pak fëmijë dhe disa të hallakatur) dhe i tregoi pastaj për vardisjen nëpër Kullën e Princit, ku, për habi, kishin gjetur një kërthi, që po qante.

-Kërthiu bënte një vaj të thekshëm sa na u rrëqeth misht,- shtoi ai.-Vaji i tij ishte herë gjëmë e çuditshme burri, herë çirrije bishe... Qau gjithë natën e ndoshta edhe tash me zërin thikë po i çmend ata që e ruajnë.

Sikur atë thikë ta shihte përpara, sakaq Sanxhakbeu doli nga gjendja e plogështisë së rëndë për ta mbushur me dridhërima të brendshme. Ktheu kokën dhe nuk e diti as vetë pse pyeti se mos fëmija i gjetur ishte ndonjë qenie e shëmtuar.

-Është alamet fëmije, madhëri,- e siguroi Kadiusqeri që t'ia hiqte dyshimet.-Fëmijë të tillë nuk më ka rënë të shoh...

Sanxhakbeu prapë heshti. Iu bë se një vajë bashkë me një gjëmë po i vinte nga një thellësi e mistershme dhe po kërkonte t'i ngjitej për fytyrë.

-Qanë dhe gjëmon edhe më tutje? - Pyeti.

-Nuk i mbyllet goja, madhëri.

Pas një mëdyshje Sanxhakbeu pyeti se i kujt ishte fëmija.

-Këtë nuk e kuptuam, madhëri.-Ia ktheu Kadiusqeri dhe vazhdoi të shpjegonte se kishte pyetur pleqtë, por ata kishin rrudhur krahët...

-Çudi,-tha Sanxhakbeu me gjysmë zëri. -Çudi... Fëmija qan, gjëmon dhe ulërin njëherësh në kullën e Princit dhe askush nuk e di se si u shfaq aty dhe i kujt është?...

Kadiusqeri heshti, ndërkohë që Sanxhakbeu luante kokën dhe herë pas herë përsëriste fjalët „çudi, çudi“... Dikur, pas një hamendje të ndjeshme, si t'i kishte shkrepur diçka që moti e kishte kërkuar, tha:

-Tash po e di...

Kadiusqeri pa një zbardhëllimë në fytyrën e Sanxhakbeut, që asaj po i jepte shenjat e shpresës.

-Tash po e di... Fëmija duhet të jetë nga dera e Princit... Fëmija doemos se është gjak i Princit...

Një copë herë u soll mendueshëm brenda hapësirës së sexhadës dhe pasi u ul ku ishte, tha se e dinte pse e kishin lënë fëmijën aty dhe pse qante, gjëmonte dhe ulërinte ashtu pandërprerë me atë zë piskë, që i bëhej se e dëgjonte dhe që e kishte pritur madje...

Kadiusqeri vazhdoi të rrinte i shtanguar. Fjalët e Sanxhakbeut sikur po ia shtonin bindjen se Sanxhakbeu ende nuk ishte liruar nga ankthi i gjatë, që i ishte shfaqur pas plandosjes para shtizës së flamurit. Andaj, nuk e shihte të arsyeshme të ndërlidhej me ato që thoshte përdërisa të përmirrej i tëri.

-Fëmijën e lanë qëllimisht, -foli prapë Sanxhakbeu.- E lanë dhe të gjitha i kam të qarta pse e lanë, të gjitha i kam të qarta...

Ato fjalë Kadiusqerit po i silleshin përpara të ngjizura me një pjesë të mjegullimit, që Sanxhakbeut ia hetonte nga jashtë.

-Mendon se na e hedh?... Princit ia ha mendja se ne jemi të marrë dhe nuk mund ta dimë se kërthiun e la qëllimisht aty, që ta marrim dhe ta rrisim, si çdo fëmijë tjetër që mund të gjendet, që kur të rritet të na gërryen dheun nga brenda?...

Sapo i tha këto Sanxhakbeu serish u ngrit në këmbë dhe zuri të sillej nëpër sexhade, sikur të kërkonte të lirohej sa më parë nga shtrëngimet e brendshëm, që duhej flakur doemos.

-Vë bast se ai fëmijë ka ndonjë shenjë të posaçme në trup, me të cilin ai duhet të dallohet prej të tjerëve, shenjë kjo që do ta kthejë në shpëtimtar dhe shenjtëror të tyre madje... Por kjo nuk do të bëhet... Sepse ne djallëzinë do ta parandalojmë dhe të parën gjë që do ta mësojë do të jetë sprovimi kundër vetvetes...Të tillët na duhen dhe assesi ndryshe... Ata do t'i nënshtrohen lëvizjes së fuqisë së madhe dhe të pandalshme që duhet Perandori...

Një copë herë Sanxhakbeu foli gjithë ngazëllim ashtu, ndërkohë që Kadiusqeri po matej t'ia përkujtonte masat që rëndom ndërmerreshin ndaj fëmijëve të dyshimtë dhe robërve të tjerë, që lidheshin me urdhrin për zhdukjen e tyre të menjëhershme, pa lënë gjurmë.

-Këtë dhuratë e kemi pritur... Sepse i duhet luftës sonë të shenjtë- tha Sanxhakbeu dhe vazhdoi të sqaronte se ashtu fillonte koha e larjes së kujtesës, që ishte shumë e rëndësishme, veçmas në rrethanat kur stërkeqa e shpirtit, në mënyra të ndryshme tinëzare, mëtonte ta pengonte apo ta frenonte këtë nismë...

Kur po bëhej gati të largohej Kadiusqeri, Sanxhakbeu tha se fëmija duhej të merrte emrin Mehmet, ndërsa mbiemrin ta kishte sipas ushtarit që e kishte gjetur, e që i thoshin Qyprilli...

(Shënimet plotësuese të Kronistit)

„Fëmija që i lanë emrin Mehmet (sipas Kadiasqerit që kishte udhëhequr fushatën) dhe mbiemrin Qyprilli (sipas ushtarit që e kishte gjetur në Kështjellë), u bë kryejenicher dhe njëzet vjet më vonë, nën drejtimin e padishahut, Fatihut të Dytë erdhi të luftonte në *Tokën e Lashtë*, pra në vendlindje, pa ditë se si në kokë i ishte futur një urdhër i prerë se duhej t’ia ngulte thikën Princit të Kështjellës së skajshme, pikërisht aty, ku ai, para njëzet vjetësh, me kapedanët më të njohur dhe parinë e gjithëmbarshme të vendit, i ishte bashkuar Kryeprincit që të zhvillonte kundërvënien më të mëdha që deri më atëherë i ishin bërë Perandorisë në rrugën e saj drejt Perëndimit... Fati i luftës deshi që kryejenicheri Mehmet Qyprilliu i ri u vra nga kështjellarët kur po bëhej gati të hynte në kullën, ku rrinte Princi i Kështjellës së *Tokës së Lashtë*, çastin që ai po mendonte si t’i ndalej disi turri ushtrisë më të madhe të botës, që kishte nxirë fushën që nga deti e deri rreze mureve të Kështjellës. Princi po sillte ndërmend ngjarjet e para njëzet vjetësh dhe mbase zemra ende po i kullonte helm për kërthiun e sapolindur, që pa dijen e tij në kullë e kishte lënë Princesha, e cila kishte qenë e bindur se do të ktheheshin po atë natë... Kur i thanë se e ushtarin e huaj e kishin vlarë mu në prag të kullës dhe ia bënë me dije se do ta futnin në hu për ta parë të vetët që të binden të vetët se ç’fat e gjente atë që merrte guximin të futej në Kështjellë, Princi nuk diti as vetë pse e la mënjanë atë kokë, e shikoi një herë, sikur të njihte diçka në të dhe, së fundit, urdhëroi ta varrosnin me të tjerat në Kështjellë.

Fatih, sado që i dëshpëruar me ngjarjet në fushëbetejë, kryejenicherin Mehmet Qyprilliu e shpalli shehit, meqë ishte i pari ushtarë perandorak, ndër ata njëqind e pesëdhjetë mijë që kishte me vete, i cili ia doli të futej në Kështjellë. Edhe pse e la kokën pa kryer detyrën (pra që ta vriste Princin), Fatihu urdhëroi që fëmijët e tij (Myslimi, Shahini dhe Hyneni) të merreshin nën përkujdesen e drejtpërdrejtë të Portës. Dhe kështu, i pari, Myslimi, u bë jeniçer dhe tregoi vullnet të madh për pushtime të reja kah Krimeja. I dyti, Shahini, u ngjiti deri në shkallën më të lartë të kadiut, ndërsa i treti, Hysniu, u bë kadisaçer. E dërguan me shërbim të lartë në vendlindjen e t’et (sado që këtë nuk e dinte) dhe vdiq i dëshpëruar që shërbeu shumë vjet në një vend të shkrumbuar nga luftërat e gjata që vazhduan për një gjysmë shekulli... Shahini pas vetit la dy djem: Mehmetin e Qerimin, që të dy ushtarak të lartë. Mehmeti dhe Qerimi, pastaj patën njëmbëdhjetë fëmijë (shtatë djem e katër vajza), me të cilët Qyprillinjët zunë të hapnin rrënjë në të gjithë Perandorinë si ushtarak të dalluar dhe nëpunës të vyeshëm, me ç’rast, sipas një rregulle të pashkruar, në secilën kore të tyre, patjetër se përtëritje emri Mehmet, me të cilin mburreshin që të gjithë. Dhe pas dyqind vjetësh bezdisjeje në hierarkinë e mesme të ushtarakëve dhe të qatipëve, njëri prej Mehmetëve që përsëriteshin shpesh e më shpesh, u nis drejt lartësive, me fjalët n’gojë se po ndiqte rrugën e një ylli, i cili Qyprillinjët i nxori nga mpirja e gjatë...”

Fjalët „mpirje e gjatë“, të shkëputura nga të tjerat, po i silleshin ashtu vërdallë sa dikur nuk ishte i bindur se i lexoi diku apo ia tha një zë i huaj. Hamendja iu bë edhe më e madhe kur hetoi se librin që pak më parë e kishte pranë, ndodhej përballë në raftin e drunjtë, i rrasur mes librave të tjerë, që kishin pluhur...

Çfarë po ngjet me mua, tha Nimani dëshpërueshëm?... Ndërkohë që heshtja sa vinte e bëhej më shurdhe, ajo pyetje po i sillej në kokë dhe po i kthehej në një uturimë të brendshme, që pak nga pak po e zbrazte nga njëmendësia dhe po e kthente në një krijesë të flashkët, e cila herë zgjatej, herë ngushtohet, pa mundur të shkëputej nga pika në të cilën mendja ia thoshte se ishte ngulitur përgjithmonë dhe se asaj tashmë, me fjalët se nuk kishte nga t’ia mbante, po i kërcënoheshin shpata të shumta, që vezullonin nga të gjitha anët... Dikur iu duk se shpatat po i afroheshin dhe po i afroheshin sa e preknin dhe në atë përpëlitje, që i dukej gjithnjë e më e pakuptimtë, vendosi qetas t’i jepej asaj që po e priste. I dëshpëruar, mbylli sytë, për t’i ikur disi shpatave dhe ndjeu se ashtu po bëhej i paqenë. Kjo i pëlqeu dhe uroi që hiqi të

mbërthente çdo gjë. Por, kur ishte i bindur se i tëri i ishte dhënë asaj gjendjeje, sakaq hetoi se aty ku pak më parë parandiente shpatat, po i formësohej dikush, që mendja ia tha se mund të ishte vetëm Kronisti i ngarkuar me shumë libra... Në atë përfitim, Kronisti dukej se rrinte në libra dhe nga një shkëndijim që herë pas herë i shpërndahej prej syve të errtë, krijonte përshtypjen e një qenie të përzier në gjësend, që herë pas herë ndryshonte gjendjen...

„Po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme“, -foli Nimani gjithë shqetësim, pa qenë në gjendje që ta plotësonte mendimin.

Qenia e përzier me sende, që ai e merrte për Kronistin, nuk iu përgjigj, sado që ishte i bindur se aty dhe ashtu ishte që ta dëgjonte, apo t'i jepte ndonjë porosi.

Në atë përpëlitse, Nimani vazhdoi të fliste se si „kohë më parë“, që nuk e dinte as vetë se a kishte ndodhur kjo pas një leximi të një libri të panjohur apo pasi që kishte dëgjuar një rrëfim nga dika, (kjo tashmë nuk kishte rëndësi), por më pas kishte hetuar njëfarë ngarendje të shpatave, shumë syresh, që sikur i suleshin dhe ia kërkonin kokën pa ditë se pse...

Pas një heshtjeje, që kishte zgjatur bukur shumë, si nëpër uturimë kishte dëgjuar si nga pjesa ku qëndronte Kronisti, një zë po i thoshte se kundër kishte Perandorinë dhe sojin e vet...

Një copë herë zuri veshtë, por ajo „nuk e ditke këtë?“ ia bënte me dije se dikush e kishte dëgjuar me vëmendje...

„Kujt nuk i kam hak, pos që iu dhashë poezisë dhe filozofisë...“, - foli hamendshëm.

„Pikërisht këtu qëndron kobi yt“, i tha Kronisti. „I hidhërove njësoj të dy anët...“

„Ndoqa thirrjen e shpirti dhe zërin e mendjes...“

„Deshe të bëhesh tjetër...“

„Këto nuk do ta thosha... Desha të jem për veten... Me shpirtin tim...“

„Nuk iu nënshtrova lëvizjes së fuqisë...“

„Ju nënshtrova rimave dhe vargjeve... Ka vallë këtu diçka të keqe?...“

„Ka si nuk ka. Ishte diçka e rrezikshme... Sepse, vargjet dhe mendimi i lirë paraqesin hapin e parë me të cilin lëvizja e fuqisë kthehet në fuqi lëvizëse...“

„Pse më mundon me gjëra të tilla, kur dihet se asnjëherë nuk më ka shkuar mendja tek ky ngatërrim... Gjuha e poezisë është gjuhë e ndjenjave... Vetëm ajo më mbërthen të tërin...“

„Gjuha e poezisë është gjuhë e lirit nga urdhri i jashtëm, është udhë që çon kah të menduarit vetanak, me të cilin çdoherë mendimi mund të kthehet në fuqi... Nuk e ditke këtë?...“

„Nuk kam qarë kokën me përkufizimet, por jam ndalur vetëm tek shija e ndijimit, ku kam gjetur qetësi dhe jam ndjerë i lumtur...“

„Këtë ta besoj, por mos harro se je Qyprilli, që duhet të ketë vetëm pushtet, që i shërben dhe i nënshtrohet...“

Nimani heshti. Pak nga pak po i kthjellohej ajo që kishte dëgjuar nga dikush apo kishte lexuar diku (krejt një) për gjyshërit dhe stërgjyshërit e vet gjatë dyqind vjetëve të para të Perandorisë. I bëhej se po e shihte foshnjën e lënë tek qante, se po e shite të rritur dhe së fundit po e shihte me thikën e fshehur përtej mureve të kështjellës, duke ia kërkuar kokën Princit, që në të vërtetë kërkonte kokën e të et... Iu bë se ajo thikë po e kërkonte edhe atë, se e kishte fare afër dhe nuk e diti pse u bë gati ta priste, sikur ajo të ishte pjesë e asaj që e priste qysh moti... Mbylli sytë dhe ishte gati t'i jepej gjendjes që e përfytyronte diku në atë pikë, ku puqej fillimi me fund si një shkrirje e papërsëritshme, por për habi kur ishte i bindur se nuk kishte kthim prapa, në duar ndjeu një libër, që po e shtrëngonte sikur të ishte vetë shpëtimi, që nuk e dëshironte.

„Duhet ta lexosh sa më parë“, po i thoshte një zë, që tashmë ishte i bindur se ishte i Kronisti.

Nimani hapi sytë dhe përnjëmend pa një libër të trashtë, me kopertinë lëkure.

„Mos i harro ato që dëgjove këtu, sepse disa prej tyre thuhet vetëm njëherë dhe nuk përsëriten...“, po i thoshte i njëjti zë, që në atë pahintikë më shumë e përfytyronte seç e shihte.

“Quprillinjtë janë të çuditshëm. Kanë aso huqe që vështirë shpjegohen, ndër të cilat gjithsesi se sjellja e guacës pothuajse u është kthyer në një shenjë dalluese, që i afrohet virtytit... Unë që merrem ç’prej njëmijë vitesh me sjelljet e tyre, bëra çmos që t’i nxisja të thoshin diç që do t’i shërbente kronikës, por më kot. A flet guri, ashtu flasin ata. Megjithatë, duke i shikuar dëshmitë e ndryshme si dhe të dhënat që ruhen, erdha te përfundimi se gjatë qëndrimit në fronin më të lartë të qeverisjes së Perandorisë, shumë nga Qyprillinjtë rrallë herë kishin shprehur ndonjë mendim të plotë, e ndonjëri prej tyre madje, siç ishte Hysni Pasha, gjithë atë që e kishte thënë ishte rrudhur në mohim-pohime të shkurtra dhe urdhra: bën, nuk bën, merre, jepe dhe luftë... Në shumë mbledhje të rëndësishme të qeverisë ai kishte thënë vetëm një „po“ apo vetëm një „jo“. Madje kishte edhe aso mbledhje ku ai dëgjonte e dëgjonte me orë ushtarakë të lartë, adjutantë, mjekë, këshilltarë bashkë me përcjellësit e shenjave dhe ato mbylleshin pa folur ai fare. Mjaftonte vetëm një shenjë e vetme, që porositë të kuptoheshin me të shpejt prej të gjithëve pa ndodhur të kërkoheshin sqarime të tjera. Të mësuar me ato lëvizje, procesmbajtësit megjithatë jepnin shënime plotësuese, ndër të cilat ajo „uli kokën“ do të thoshte „u pajtua“, „lëvizi kokën majtas-djathtas“, do të thoshte „nuk u pajtua“, „ngriti kokën përpjetë“, do të thoshte se „kërkonte sqarime të mëtutjeshme“... Por kishte edhe ca shenja të tjera, si për shembull „bënte me dorë“, „rrudhte fytyrën“, „zinte sytë me duar“, „mbyllte njërin sy“, „hapte gojën më shumë se rëndom“, „kruante njërin vesh“, që secila veç e veç paraqiste një urdhër dhe si të tilla ktheheshin në dekrete të larta perandorake me të cilat ndodhte që të fillonin fushatat dhe luftërat e rëndësishme madje...

„Të pagojë“ e madje memecë nga soji juaj, që ngjiteshin deri tek majat e larta të pushtetit pati si shumë. Ndër ta duhet dalluar dymbëdhjetë ushtarakë të lartë, që me të vërtetë ishin memecë. Më i dalluari ishte Sami Beu, që ishte serasqeri më i njohur që ndonjëherë pati Perandoria. Njëri prej sulltanëve, me gjasë Sulejmani kishte thënë se do të ishte fat i madh për Perandorinë po qe se ushtarakët e lartë do të ishin të pagojë si Sami Bej Qyprilliu, që ishte nip i Ahmet Pashës. Sepse, Sami Beu i pagojë bëri atë që fjalamanët më të mëdhenj nuk do ta bënin. Me mësimet e tij që jepeshin si të shkruara dhe me anën e vizatimeve të shumta, futi rregull dhe shkathtësi të jashtëzakonshme në armatë dhe ç’është më e rëndësishme, ia doli të zhvillonte doktrinën e sulmeve të befasishme me njësi të vogla, të cilat deri më atëherë nuk kishin qenë të pranishme në strategjinë e luftës.

Ç’është më e habitshme, nga disa kronika mësohet se hierarkinë e pushtetit të lartë e arritën edhe të tillë që ishin të verbër. Njëfarë Billal Beu, që jetoi në kohën e Mustafa Pashës, u bë i famshëm në saje të aftësisë së jashtëzakonshme për të shpjeguar shenjat e luftës dhe parashikimet që lidheshin me qartësimin edhe të fenomeneve të tjera shoqërore dhe shkencore të kohës. Billal Qorri, siç i thoshin i madh e i vogël por me shumë respekt, me përpikëri të paparë shpjegonte fatet e luftërave që do të bëheshin si dhe kahen e tyre. I mjaftonte ndonjë shenjë e thjeshtë, që të jepte mendime meritore, të cilave u nënshtroheshin të gjithë. Për shembull, kur e njoftonin se para nisjes në ndonjë fushatë apo luftë, flamuri në shtizë hiqej paksa i fashitur, thoshte se punët do të shkonin keq; kur i thoshin se filan pashait i është kruar tri ditë rresht vetulla e majtë dhe i ka lëvizur syri i djathtë, bënte të ditur se ai do ta lërë kokën në fushë të betejës, por që lufta do të fitohet, e të ngjashme... Jo rrallë ndodhte që prej ngjyrës së zërit të ushtarakëve, në prag të betejave, të përcaktonte kahet e tyre... Ata që nuk i përfillnin shpjegimet e Bilall Qorrit, nuk kalonin mirë. Ka shumë dëshmi që ndonjë pasha kokëfortë apo sadriazem i etshëm për fitore e kishte lënë kokën kot në ndonjë fushatë vetëm e vetëm pse nuk i kishte përfillur shpjegimet e tij. Së voni, Bilall Qorri ishte kthyer në një urdhërdhënës fjala të cilit, nuk e bëhej dysh as sulltanët, kështu që ndodhte që shumë herë ajo që planifikohej gjatë nga ushtarakët ambiciozë nuk vlente një para, nëse nuk puqej me shpjegimet e Bilall Qorrit. Ky njeri, që nuk e pa asnjëherë botën me sy dhe nuk dinte përmasat e saj fizike, u bë njeriu më i rëndësishëm i kohës, këshillat e të cilit vlenin më shumë se të atyre që shihnin mbi tokë dhe nën tokë e që kishin fuqi të pakufishme në duar. Është e çuditshme dhe madje e pabesueshme si ai njeri, i mbërthyer për terrin e përmotshëm, ndjente

dhe shihte me syrin e mendjes edhe ato gjëra që të tjerët as që mund t'i përfytyronin dhe ia dilte të përcaktonte edhe hollësitë e fenomeneve që ai vetëm mund t'i imagjinonte... Mbase kjo beri që disa të dyshonin se Sami Beu, që dinte, ndjente dhe hetonte më shumë se të tjerët dhe ishte në gjendje të parashihte edhe ato që do të ndodhnin dhe të lexonte shenjat që kërkonin kundrim të veçantë, të kishte shumë sy të padukshëm, që thuhej se mund t'i kishte në maje të gishtave apo diku tjetër prej nga depëronte në kokën dhe në shpirtin e njerëzve dhe ia dilte të parandiente me lehtësi edhe ato që do të ndodhnin... Një dervish, madje kishte thënë se Sami Beu ishte një si dhunti perëndie, që i ngjasonte evliasë, që duhej shpallur të tillë sa më parë, para se të ndodhte që dikush ta merrte për djall apo krijesë tjetër të afërt me qoftëlargun...

Rasti i Sami Beut dhe të tjerëve që shquheshin kështu, megjithatë përforcon bindjen për sëmbimin e shtytjeve të brendshme dhe shpërthimin e tyre, që në ato rrethana të ngritjes në fronin më të lartë dhe nënshtrimit të të gjithave atij dhe vetëm atij, i shfaqeshin si baraspeshë lëvizjes së fuqisë, me të cilën Perandoria përherë zgjeronte kufijtë e saj nga Lindja dhe Perëndimi... Ishte e natyrshme, që në ecje e sipër, kjo shtytje më shumë u hetua si një mundim i pashpjegueshëm se sa u kuptua, por kjo nuk pushoi se vepruari përderisa një ditë arriti shkallën e një shqetësimi, që së pari iu shfaq Mehemet Pashait për të shkuar pastaj deri tek Hysni, dhe së fundi për t'u pasqyruar si krijim dhe mendim, që e gjitha lidhet me nënshtrimin fuqisë së lëvizjes, si një pashmangshmëri nëpër të cilën duhet të kalojë Perandoria, për të qenë në gjendje që trupi t'i nënshtrohet kokës dhe kështu të përballojë sprovën e zhvillimit në rrethanat e reja, kur botën do ta mbizotërojë përbashkësia e fuqisë së idesë e ideja e përbashkësisë së fuqisë... Natyrisht se domosdoja e këtij ndryshimi çështjet nuk i thjeshtëson dhe as që i zhvendos sa çel e mbyll sytë në kahun tjetër dhe të duhur, por përkundrazi ato i pleks më tepër dhe i ashpëron, ngaqë fjala është për një kapërcim të jashtëzakonshëm, me të cilin duhet të shënohen kthesat e mëdha historike, pikërisht të tilla siç i përfytyronte Bilall Qorri, kur thoshte se duhet shaluar kalin e mendjes në vend të nënshtrimit mendjes së kalit, se duhet prekur pikën në vend se të kapet pika, e të tjera, me të cilat ai qartas paralajmëronte kohën e fuqisë së mendjes dhe jo mendjes së fuqisë...

Nimani rrinte si i shtanguar dhe koka sikur nuk ia kapte ato që i dëgjonte nga Kronisti. Dikur, nuk e diti as vetë pse iu tek te mendonte se çfarë do të ishte fati i Qyprillinjve dhe i tij po që se fëmija në Kështjellë të mos gjendej fare?... Mendja ia tha se asgjë nuk do të ndryshonte, sepse me apo pa shumë jeniçerë të shkathtë, me apo pa shumë ushtarakë të fortë dhe qatipë tejet besnikë, e mbi të gjitha me apo pa shtatë kryevezirët Qyprillinjë, që njëri pas tjetrit, me ndonjë përjashtim të shkurtër, e mbajtën fronin e saj për njëqind vjet radhazi, Perandoria do të ishte e njëjtë... Në atë përdëllim, sikur të ballafaqohej me përgjigjen që tashmë e njihje, iu bë se po dëgjonte një zë të brendshëm, që po i thoshte diçka rreth një vullneti që i njëson të gjitha prirjet dhe fuqitë e caktuara kur ai ecën drejt forcimit të jashtëm...

“Ishit vetëm një pjesë e asaj lëvizjeje së cilës iu nënshtruat me aq vullnet për t'u bërë fuqi e saj“, po i thoshte ai zë, i cili po i sqaronte edhe diçka rreth hapësirës së përbashkët dhe rrathëve të saj, që nisin nga qendra për të shkuar drejt një hapjeje të pandalshme...

“Pa këtë hapësirë dhe pa gjerësinë e saj nuk do të ndodhte asgjë... Energjitë do të shkapërderdheshin, ndërkohë që vullneti për fuqi do të përplasej brenda për brenda rrethit të mbyllur gjithnjë në dëm të vetvetes...”

I ballafaquar me këto pjesëza të mendimeve, që i vërtiteshin nëpër kokë, sëç iu vardisën vargjet „për rrethin dhe pikën“, që kohë më parë i kishte shkruar, të cilat edhe më tutje sikur ia ngacmonin mëdyshjet rreth fëmijës në Kështjellë...

„Në rreth ndodh vdekja, ndërsa në hapësirë jeta“, po bëhej gati t'i thoshte Kronistit, por hetoi se ai nuk ishte më ku e përfytyronte pak më parë tek rrinte i ngjizur me fletët. Përpara shihte një libër me mbështjellëse të trasha dhe të brejtura, që shkëndijonte një dritë lëbyri... Ishte po ai libër që Kronisti i pat thënë se mund të ishte pjesë e të menduarit të tij apo

e shumë syresh, që ishte shkapërderdhur si fletëz e humbur, ku ishin shkruar të pashkruarat dhe ato që i takonin kujtesës...

Libri i Kujtesës...

Kapitulli i parë

**(Ëndrra që e pa kryejeniçeri Mehmet Qyprilliu
para se të vritej në Kështjellë...)**

...Gjumi më treti çastin që më thanë se isha ngarkuar me detyrën e shenjtë. Koka m'u kthye në një log betejash që nuk i kuptoja... Ç'ishte vallë kjo: shqetësim i përgjegjësisë së jashtëzakonshme apo frikë nga vetvetja, megjithëqë nuk dëshiroja të merresha me vetveten, nga shkak i vetëm se qenia ime nuk ishte për mua por për veprën që më ishte ngarkuar, që do të thotë se gjithçka imja i nënshtrohej këtij qëllimi të lartë... Megjithatë, ajo që më ndante nga ky qëllim ishte një mur i mallkuar i Kështjellës, që duhej ta kaloja doemos dhe t'ia merrja kokën Princit... Serasqeri më thoshte se kjo për mua paraqiste një nder të madh, që nuk mund të matej me asgjë... Ai, po ashtu më thoshte se krahas shërbimit të madh që i bëhej Perandorisë, me çka përfundimisht rrënohej edhe guri i fundit, ku ishte mbështetur herezia e laramanisë dhe e mësimëve të bashkëjetesës së të kundërtave, njëherësh thyhej gënjeshtria e një besimi, që ka ushqyer këtë mësim, i cili kufirin e dy boteve e ka shpallur si domosdoshmëri të ruajtjes së baraspeshës së brendshme... Kjo gënjeshtër duhet të marrë fund njëherë e mirë... Kjo gënjeshtër duhet të pushojë...

Fjalët e serasqerit ma morën qetësinë. Këtë ma shfaqte edhe zëri, që më dridhej dhe këtë ma pasqyronte edhe njëfarë hije e meitit, që më shtoej gjithnjë e më shumë. Haruni plak, që kishte për detyrë të më rrinte pranë e pranë dhe të më ushqente me tregime të ndryshme nga historia e ngritjes së Perandorisë, thoshte se po më kthehej nuri i shenjtoreve...

"I lumi ti, i lumi", uronte plaku dhe shtonte se shpejt do të shkoja atje ku më prekin vetëm mendimet... "Paçim fatin tënd!..."

Mandej, plaku më fliste rreth domosdosë së njësimit shpirtëror me të madhërishtmen dhe të lartësueshtmen...

"Ai që arrin këtë patjetër se mund çdo vështirësi dhe ia del të bëjë vepra të shenjta..."

Ndërkohë që shqetësimin që më shtoej gjithnjë e më shumë, e lidhte me shkallën e përkushtimit tim ndaj veprave të mëdha, të cilin ai e shihte gjithnjë e më qartë tek unë.

Nga ato që dëgjoja sikur u mpiva. Kjo qenka vallë ajo gjendje kur njeriu lirohet nga vetvetja dhe pengi i saj, që ndalonte të përshpirtshmen, për të cilën më fliste Haruni plak?... Sa më shumë që shtroja këtë pyetje dhe sa më shumë që merresha me të, ndjehesha edhe më i zbrazur deri sa dikur, ashtu i shkallmuar, iu dhashë njëfarë ëndrre, ku m'u shfaq një fushë e gjerë, e përhumur, në të cilën vërtiteshin kuajt të bardhë, që hingëllonin thekshëm... Në atë ëndërr, pra, kuajt e bardhë shkonin nga njëra anë në tjetrën dhe sa herë ktheheshin linin pas një trokëllimë shurdhe, e cila sikur krijonte ndjenjën e kllapurisë që sfidonte zgjimin, gjendje

kjo që nuk do ta dëshiroja... Sado që nuk e di sa zgjati vërtitja e kuajve të bardhë me jele të zeza, më kujtohet se në atë përvijim, ndodhi që kuajt e bardhë me jele të zeza nuk u kthyen më, edhe përkundër asaj që hingëllima e tyre dëgjohej të vinte si një fërshëllimë ere, që lirohet prej dika fare befas... Pak më vonë, nga ajo fërshëllimë, u përhapën gjithfarë fluturash, që shkonin grumbuj-grumbuj si re të lehta dhe nga moria e fluturave u formësua një e madhe, e cila nganjëherë më dukej se merrte pamjen e një kali të bardhë, që kishte krahë larosh dhe kali i bardhë, gjithnjë duke fluturuar, u soll e u soll gjithandej derisa u kthye në një zog të zi dhe zogu i zi, që kur ra në tokë, u bë lis dhe lisi ashtu padiktueshëm u rrit e u rrit sa hapi degë të mëdha dhe degët hapën gjethe, e gjethet shpejt u thanë dhe lisi mbeti pa degë, i tëri i shkallmuar dhe më tutje ndodhi që lisin fillikat zunë ta rrahin ca stuhi, të cilat u shfaqen befas nga qielli dhe e qëlluan dhe e qëlluan po lisi fillikat mbeti aty ku ishte deri sa dikur zuri të binte një shi i imët, i cili nuk kishte të ndalë, që ra e ra pareshtur sa nga zgafellja e lisit zuri të rridhte një vijë uji, që pastaj, ajo vijë u bë përroskë, e përroska u bë përrua, përroi u bë lumë, lumi u bë det dhe u bë një det që mbuloi gjithë hapësirën e paanë, që u kthye në një fushë gjithë jeshillëk me kuaj të bardhë me jele të zeza që shkonin tufa-tufa dhe kalëronin me lazdrim... Pak më vonë, andej ku kishte jeshillëk, prapë u shfaq uji i turbullt që nuk kishte fund, ku maja e lisit fillikat shihej dhe rrinte e fuqishme mu në mesin e mesit e tij... Dhe për habi dikur u shfaq një zog i kuq në maje të asaj maje të lisit fillikat dhe po shikonte mendueshëm ujin e turbull dhe gjithë atë përmytjeje që nuk kishte fund. Zogu i kuq për një çast mbylli sytë e zi dhe sapo i mbylli sytë serish m'u shfaq po ajo hapësira e paanë, ku prapë kalëronin kuajt e bardhë me jele të zeza... Uji treti sikur të mos ishte dhe unë prapë pashë jeshillëkun që më kishte mahnitur... Dhe kur po kënaqesha me atë jeshillëk, se nga u shfaq një shpatë e madhe e cila vërtitej furishëm në erë dhe ajo shpatë që vezullonte e vezullonte po më afrohej, që ta kapja dhe ashtu me të në dorë t'i sulesha zogut të kuq me sy të zezë, që rrinte si i përgjumur në majën e lisit të shkallmuar... Duhet t'ia marrësh kokën atij zogu, po më thoshte dikush dhe unë mora shpatën dhe u nisa hamendshëm drejt lisit të shkallmuar, ku zogu i kuq me sy të zezë ëndërronte, por ç'e do që në atë vërtitje e sipër, më bëhej se vendnumëroja dhe këtë më së miri ma thoshte largësia e njëjtë që mbetej midis meje dhe zogut të kuq në majën e lisit... Megjithatë, nuk u ndala, sado që isha i bindur se vendnumëroja dhe zogu i kuq në maje të lisit të shkallmuar ëndërronte... Dhe kur më bëhej se ngarendja ime nuk do të kishte të sosur, zogu i kuq hapi sytë dhe sapo i hapi sytë e zezë, shpërtheu një vetëtimë, që sa ora më dha forcë dhe krahë për të fluturuar drejt qiellit... Kur u ngjita atje prej nga zogu i kuq duke si pikë e vogël, e lëshova shpatën pingul dhe ajo gjithë flakë u sul mbi zogun e kuq dhe zogu i kuq sa ora mbeti pa kokë... Nuk e di as vetë pse pasi ia mora kokën zogut të kuq me sy të zezë fjeta. Por, kur u zgjova, serish pashë zogun e kuq me sy të zezë, që e kishte kokën në vend. Bile tash e kishte edhe më të madhe. Prapë u ngrita përpjetë dhe prapë shpata që mbaja u lëshua pingul mbi zogun e kuq me sy të zezë dhe prapë pashë kokën e zogut si u nda nga trupi ti tij, që prapë ma solli gjumin... Nuk e di sa kohë iu nënshtrova gjumit që nuk e doja, por kur më doli pashë se gjelbërimi ishte vyshkur, se lulet ishin tharë, se therët kishin vu pushtet anembanë e megjithatë zogu i kuq me sy të zezë rrinte ende i fjetur në maje të lisit të tharë... M'u bë se një zë po më thoshte diçka rreth kotjes së zogut të kuq me sy të zezë dhe njëfarë reje të errët, e cila së shpejti do ta mbulonte qiellin dhe do të sillte shira që nuk do të kishin fund... Nëse nuk vepron, edhe më tutje do të kalbësh, m'u bë se po më thoshte ai zë i thellë... Dhe, hajt e hajt, prapë u ngrita lartë dhe prapë shpata që më ishte lidhur për dore prapë vringëlloi dhe prapë pashë kokën e zogut të kuq me sy të zezë tek ndahej nga trupi i tij... Nuk e di pse kisha përshtypjen se ajo ishte prerja e fundit, që njëherësh do të thoshte shpëtim nga ajo re e errët që do të mbulonte qiellin për të sjellë shirat e përhershme. Dhe kur po bëhesha gati të kotesha, ia hodha një shikim zogut të kuq me sy të zezë, që ta shihja pa kokë, por shih moj mrekulli, zogu i kuq me sy të zezë serish m'u shfaq me kokë! Bile tash e kishte edhe më të madhe... Ishte serish ai zëri që më tha se zogun duhej ndarë përgjysmë, sepse vetëm ashtu ai nuk do të jetë në gjendje të nxjerr kokë... Dhe, hajt e

hajt, prapë iu sula zogut të kuq me sy të zezë. Shpata, që më ishte lidhur për dore, flakëronte ndërkohë që ai më vinte i madh e më i madh sa kur iu afrova hetova se zogu i kuq me sy të zezë kishte kokë njeriu!... Ç'është ky mashtrim, oshtina! Herë zog e herë njeri?... Qoftëlargu këtu ka punë... Dhe koka e njeriut më shikonte nënçmueshëm, gjë që ma shtoi dëshirën ta merrja sa më parë. Dhe pa një e pa dy, shpata që më ishte lidhur për dore, preu kokën dhe koka u rrokullis, por edhe si e prerë ruante shikimin nënçmues... Nuk e di pse m'u dha që kokën e prerë ta merrja me vete dhe ashtu t'i jepem një ngarendjeje nëpër hapësirën e paanë, ku në vend të beharit kishte njëfarë mjegulle të lehtë, e cila herë pas here ndahej nga disa re të flakëruara... Gjatë asaj ecejake m'u bë se dikur koka nisi të fliste dhe të më thoshte se në të vërtetë gjatë atij gllabërimit që assesi të kishte të sosur, nuk kisha bërë tjetër pos që kisha prerë kokën time, dhe po ashtu më tha se gjithë ajo që kishte ndodhur nuk kishte qenë tjetër pos një përpëlitse për ta vrarë veten, që e gjitha pastaj ishte pjesë e një mallkimi, që nuk mund t'i ikej... Mbase koka e prerë do të vazhdonte edhe më tutje të më bezdiste, por kur hetoi se po kotesha, më tha se vetëvrasjen e kisha hak, ngaqë të tillët nuk hetojnë as kur ecin pa kokë... Kjo bëri që ta kërkoj kokën, por pashë se përnjëmend atë nuk e kisha, se tashmë ecja prapa asaj që ishte e këputur dhe më printe drejt një humnere...

Kur më doli gjumi isha i djersitur dhe gjithë ethe...

“Allah, thashë, më shpëto nga shpirti i lig, që m'u ka qepur dhe assesi të më ndahet...”
(E shënoi *Irfan Allajbeu*, nëpunës i *Tabir Sarajit*)

Kapitulli i dytë:

(Dëshmia e kryerjes për heshtjen e thellë të Sami Pashë Qypriliut)

„E njoha tjetër për tjetër... Sado që i madh e i vogël thoshte se ai fliste pak, ngase kishte pushtet të pakufishëm dhe dëshironte ta ruante autoritetin e vet dhe të Perandorisë, them dhe këtë e mbroj me kokë, se ai pareshtur fliste me heshtjen e vet, se tuje saj hapej një det i pafund i mëdyshjeve që atë e mbërthenin përherë, e që atyre u jepej me gjithë fuqinë... Dikush mund të thotë se heshtja është pjesë e mbyllur e njeriut, ku ai mbrohet nga të tjerët. Megjithatë heshtja e tij nuk ishte mbrojtjeje nga jashtësia. Përkundrazi, ai në të futej gjithë shqetësim dhe largohej prej saj fare i shkallmuar, por përherë fitues. Betohem në të gjithëfuqishmin se ai mezi priste çastin t'i kthehej kësaj prehjeje të mundimshme... Unë që e përgjova shumë e shumë kohë nga e njëjta pikë vrojtimi dhe pata për detyrë t'ia ruaja qetësinë, e dija se ai nuk fuste gjumë në sy (sado që dukej se flinte) e as që ndonjëherë ishte i qetë. Pra shtirej se flinte, e në të vërtetë pareshtur mejtonte, gjithnjë duke bredhur i vetmuar pas të madhërishtes... Se ishte kështu, këtë më së miri e dëshmonte njëfarë ngrirjeje që e përcillte shumë kohë pasi që të lirohej prej saj. Madje, jashtë vetes, pra i lidhur me gjendjen e njësimin me mejtimin e thellë, pra të përumbjes në mendime, ishte shpesh edhe kur bënte punë të rëndësishme perandorake... Kur them këtë nuk më shkon mendja të hap dyshimin se ai kalonte shkarazi nëpër detyrimet që i takonin. Assesi. Lartmadhëria, edhe symbyllas dhe i ngrirë (pra, pa u liruar nga mejtimi) dinte më shumë se gjithë njerëzit e botës, shihte më mirë se të tjerët dhe vëneronte edhe imtësitë që të tjerëve nuk u shfaqeshin dot... Ai, pra dinte pa hesap dhe pikërisht pse dinte aq shumë dhe pse shihte aq larg kërkonte të shképutej disi nga pjesa e përditshmërisë dhe tejdukshmëria e saj, që e vlerësonte si të mëkatshme... Dikush mund të pyes se nga i di këto që i them dhe mos ato janë fjalë kuturu?... E kam dëshmitar perëndinë dhe këtë mund ta them nën benë më të madhe se një herë, të vetmen herë, pata rastin t'i lexoj ca nga shtytjet e heshtjes së hershme, që madhëria i pat shkruar, e të cilat i kalli ende pa i përfunduar mirë... Këtë e bëri diku nga mëngjesi dhe unë që po e veneroja e mora me mend se ashtu shkruante diçka tejet të rëndësishme, me të cilën dëshironte një herë për të vetmen herë të nxirrte në shesh diçka nga ai det... Dhe kështu, shkroi e shkroi deri në iqindi dhe pasi u

përplas për minderi, befaz e zuri një kllapuritje e thellë... Iu afrova gjithë kureshtje dhe ai dukej si i pajetë. Gjendja e tillë më shqetësoi, por meqë prej tij kisha urdhër të prerë që edhe vdekja për dyzet e tetë orë të mos i shpallej, ua lëshova një sy atyre që kishin shkruar... Hetova se aty kishin gjithfarë mendimesh të shkapërderdhura, të shumtën të këputura dhe të papërfunduara... Madje, ca nga fjalitë, dukej se nuk kishin as fillim e as mbarim, ndërkohë që vende-vende shihej ndonjë fjalë e vetme si të kishin ikur qëllimisht nga moria e të tjerave... Çfarë nuk pashë në ato letra, por çuditërisht, nga ajo mori në kujtesë me mbetën fjalët „e lartësueshmja“, „e madhërishmja“, „e gjithëfuqishmja“, „shfrim“, „thellim“, që ishin nënvizuar dhe herë-herë të shkruara me shkronja të mëdha...

Letra përfundonte me fjalinë:

“Hiqësia është e pafund...”

Nga ajo gjendje doli i frikësuar. Kapi ato që kishin shkruar dhe pasi i shpeshurisi në duar, fare qetas, ua vuri zjarrin... Tymi që u lirua prej tyre ishte i lehtë, por mua më duk se e përpiu një botë të padukshme, që nuk do të shfaqej dot...

Kur ia solla shurupin ishte tjetër. E pashë të dalë prej vetvetes me fytyrën si një det të liru nga tallazet e mëdha, ngaqë shqetësimin e kishin bartur kah thellësitë që nuk shiheshin... Pasi piu shurupin dhe më dha shenjë që të largohesha serish iu kthye mejtimit prej të cilit nuk u lirua kurrë më... Kur u hap lajmi i pikëllueshëm se lartmadhëria kishte ndërruar jetë, e kisha të qartë se ai as që kishte ndërruar jetë, pos që i kthehej vazhdimi të amshueshëm prej nga për pak ishte ndarë...

Kapitulli i tretë

(Çfarë tha Bilall Bej Qyprilliu për errësirën e kësaj bote?)

1. ...është e madhërishme...
2. ...e shpërrallos tejdukshmërinë...
3. ...shlyen kufijtë e rrejtshëm me të cilat ndahen përkufizimet dhe përcaktimet...
4. ...njëmendësinë e zhvesh nga kufizimet e realiteti...
5. ...u jep mundësi vrojtimit të amshueshme...
6. ...e bën të paqenë ndjenjën e kohës dhe të hapësirës...
7. ...e flak rrezikun e përsëritjeve...
8. ...nuk e pranon të djeshëm, as të sotmen dhe as të nesërmen...
9. ...peshën e bën të papeshë, ndërsa të papeshën e kthen në peshë...
10. ...shpirtin e bën të përhershëm...

P r a n d a j

- a) Mos i beso asaj që sheh!
- b) Dysho dhe vetëm dysho!
- c) Hiq ngazëllimit!
- d) Shporre kënaqësinë!
- e) Qasu thellimit!
- f) Mos rri mendjefjetur!
- g) Ec vetëm!
- h) Mat!
- i) Çmat!
- j) Mos u ndal!

(Koha pas dyzeditëshit)

Sapo i sollën plikon e kaltër, Sulltan Mustafai urdhëroi të mos e trazonin. Një copë herë e shikoi letrën dhe iu bë se në të ishte vetë Niman Pashë Qyprilliu, i zvogëluar në përmasa nënçmuese. Të tillë po i shihte edhe Qyprillinjtë tjerë. Do të mjaftonte fare pak mund (madje vetëm një grisje e plikos), që gjithçka e tyre të shkatërrohej si të mos ishte. Kjo ndjenjë e trimëroi aq sa plikon e kapi sikur në dorë të kishte gjithë Qyprillinjtë... Por, çuditërisht, mjaftoi vetëm një e prekur e lehtë e letrës, që serish t'i kthehej zemërimi i pakmëparshëm, që i ishte qepur çastin që Niman Pashai nuk e kishte pranuar postin e kryevezirit. Qafiri!-shfreu. Edhe këtu nuk po më lë të qetë, tha dhe aty për aty, në kokë iu lidh mendimi që ta kallte letrën pa e lexuar fare. Tekefundit, ç'rëndësi kishin hollësitë që nuk i duheshin për asgjë?... Letra edhe ashtu duhej të asgjësohej doemos. Andaj, pse të mos e bënte këtë pa e hapur fare?...

Dhe, kur ishte gati ta kallte letrën në shandanin e madh, iu bë se dëgjoji një zë që mendja ia thoshte si ishte i Niman Pashë Qyprilliu, që po i thoshte diçka rreth frikës që nuk do t'i hiqej kurrë...

Sulltani u rrëqeth. Flaka e qiriut iu duke e zbehtë dhe e pafuqishme...

„Ke frikë, o babaxhan... Ke frikë... Për të nuk ka ilaç...”

„Ti, tiuuu u frikësove...“, foli Sulltani gjithë shqetësim. „Ti u frikësove nga përgjegjësia, nga vetvetja... Kërkoje të fshiheshe midis librave të vjetra dhe pergamenave...”

„Aty e kisha vendin...Duhej të kthehesha prej nga kam dalë...”

Sulltani nisi të kërcënohej dhe të thoshte se ishte i paqenë...

Iu bë se zëri edhe më tutje qeshte dhe po i thoshte „se i ishte bashkuar thirrjes së shpirtit, se ishte kthyer në mendim me të cilin fillonte koha e fuqisë së lëvizjes...”

„Mjaft!... Mjaft!...”-po çirrej Sulltan Mustafai. „Mjaft!... Koha e fuqisë nuk do të kalojë kurrë... Kurrë!...”

Hetoi se e qeshura e zërit i ishte kthyer në një përqeshje dhe ajo po e ndiqte në të gjitha anët. Mendja ia tha se nga ai mundim do të shpëtonte sapo ta kallte letrën, por kishte bindjen se flaka e qiriut ishte e pa zonja ta bënte atë. Deshi të kërkonte flakë, një flakë të fuqishme, por kishte frikë se do t'ia hetonin shqetësimin. Në atë përpëlitse iu bë se dikush po i thoshte ta griste letrën dhe kjo e qetësoi për pak sa pasi i fshiu djersët dhe u shtir se shqetësimin e pakmëparshëm as që e kishte dhe as që duhej ta kishte ndonjëherë, me duart që po i dridheshin, mezi hoqi fjongon e kuqe, por ato nuk po e dëgjonin urdhrin që ajo të grisej fare. Një copë herë e shikoi ashtu letrën përderisa denjoi se nuk kishte fuqi ta griste. Kjo e ligështoi se tepërmi, por nuk e diti prej nga iu qep një mendim se mbase leximi i asaj që ia shkruante ysqedari do t'ia kthente forcën... Me këtë mendim, që sikur e qetësoi, e hapi atë dhe nisi ta lexonte:

„Dyzet ditë isha hija e tij“, i shkruante ysqedari.

Kjo fjali sikur prapë ia ktheu shqetësimin, por frika nga nënçmimi i pakmëparshëm e shtyri të vazhdonte leximin:

„E ai, siç bënte gjithnjë, zuri të futej nëpër libra dhe ditë e natë fliste me to... Herë qeshte, herë ngrinte zërin e ndonjëherë çapiste gjithfarë fjalësh sikur ta kishte gjithë sikletin e botës në kokë... Jo rrallë thoshte vargje dhe kur zbrazej prej tyre shtrihej si i pajetë dhe mua më dhimbsej pse shpirti i tij nuk gjente qetësi...”

...Një ditë prej ditësh, nga muri ballor hoqi portretet e farefisit, i rreshtoi para dhe i qortoi... U tha ç'mos... Kisha frikë se do t'i dëmtonte, por për habi, pasi ua lexoi një vjershë, prapë i ktheu. U tha se dënoheshin amshueshëm me dëgjim poezie...

...Kur ia lash gotën pranë dhe pritja që më në fund ta pinte, me çka duhej të merrnin fund vuajtjet e tij dhe tonat, ishte fare i shkallmuar. Thoshte përçartë disa vargje që nuk i kuptoja, që të shumtën përbëheshin prej fjalëve:

„lëvizje“

„fuqi“

“vullnet për fuqi“ dhe

„fuqi lëvizëse...“

...Për habinë time të madhe, po atë mbrëmje kur u nisa bashkë me trupin e tij të ngrirë dhe sipas udhëzimeve të marra nga kryesheri shpalla lajmin se Pasha vdiq nga pika në zemër, mu në çastin më të rëndësishëm kur po bëhej gati të merrte postin e kryevezirit, trupi i tij i pajetë, më bëhej se nxirrte fjalët:

„fuqi“

“lëvizje“

„mendim“

...Kjo më frikësoi pa masë, kështu që nxitova ta varrosja sa më parë. Madje, edhe pasi që trupin e vdekur e mbulova me dheun e zi, m'u bë se nga varri i fshehur në kështjellën e harruar të Krimesë, herë pas here liroheshin ato fjalë të mallkuara... Dhe, po ato fjalë, më dukej se po i thoshte pastaj edhe tabuti i rremë, që e nisa me nderime të mëdha në kryeshehër...“

Sulltan Mustafai nuk e lexoi letrën deri në fund. E bëri shuk dhe e gjuajti në shandanin e madh, ku qiriu lëshonte një flakë të dobët. Tek po e shikonte iu duk se flaka e qiriut do t'i nënshtrohej letrës, por nuk vonoi dhe ajo, sikur t'ia kishte kuptuar frikën, u rrit befas dhe e përpiu bashkë me shkronjat dhe dyllin, kundërmimi i të cilit i dha forcë të shfrynte:

„Qafiri, mendonte se mund t'i bënte ballë edhe zjarrit perandorak“.

Një buzëqeshje e thartë ishte gati të zinte vend në fytyrën e tij të zyrtë, por shpejt i iku ngase iu bë se Nimanin bashkë me Qyprillinjt tjerë i kishte pranë, tek po bëhej gati t'i fliste rreth „mendimit fuqi lëvizëse“.

„Qafiri“oshtiu gjithë zemërim dhe me të shpejtë shkroi fermanin me të cilin urdhërohej që tabuti (i rremë) i Niman Pashë Qyprillit, që ishte në rrugë e sipër për në kryeshehër, të përcillej me shumë e shumë hoxhallarë... Po ashtu urdhëroi që ditën e varrimit, e cila duhej të dukej madhështore, tabutit t'i rrethoheshin të gjithë hoxhallarët e kryeshehrit dhe të luteshin me sa zë kishin...

Çastin kur tabuti (i rremë) i Niman Pashë Qyprillit kaloi pranë Gjylsarajit e nga lutjet e hoxhallarëve po dridhej saraji i madh, Sulltan Mustafajt iu bë se pranë e kishte Nimanin. Aty për aty urdhëroi të kalleshin të gjitha librat e Qyprillit të fundit si dhe kujtimet që lidheshin me të. Kadiasqerit më të besueshëm i tha t'i asgjësonte edhe dokumentet dhe letrat tjera që kishin të bënin me sojin e tij. Po atë ditë dha një urdhër të fshehtë. që menjëherë të vritej ysqedar Halim Ozali dhe të varrosej në Krime...

Prishtinë, 1986-1988

Bon, 1990-1991

...

